**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË**

# VJETARI SHKENCOR “FEF”

**(Botim i veçantë i Buletinit Shkencor të Universitetit “Fan S. Noli”)**

Ky botim bëhet në kuadrin e Projektit “Ndihmesat e pedagogëve doktorantë në fushën e edukimit dhe të filologjisë”, nën kujdesin e veçantë të Rektorit të Universitetit “Fan S. Noli”, prof. as. dr. GJERGJI MERO.

# VJETARI SHKENCOR “FEF”

**(Botim i veçantë i Buletinit Shkencor i Universitetit “Fan S. Noli”)**

**REDAKSIA PËR BOTIMIN:**

**Prof. dr. ALI JASHARI**

**Prof. as. dr. BASHKIM JAHOLLARI**

**Doc. DONIKA DARDHA**

**Prof. as. dr. ELONA ÇEÇE (BIBA)**

**Prof. as. dr. PAVLLO CICKO**

**Redaktimi dhe përgatitja për shtyp: Msc. OLGER BRAME**

promo print
Publishing House

**SHTËPIA BOTUESE: PROMO PRINT Sh.p.k**

**ISSN: 2078-7111**

**KORÇË, 2014**

## DY FJALË PËR PËRCJELLJEN E BOTIMIT

*Qysh prej dy vjetësh, Këshilli i Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë vendosi që të përgatitë një botim të veçantë me prurjet më të reja shkencore të pedagogëve. Tashmë këtë botim e kanë në dorë të gjithë, si një fryt të punës së gjatë dhe këmbëngulëse që kanë bërë pedagogët doktorantë, por edhe të tjerë, që janë futur me shumë seriozitet në rrugën e vështirë të veprimtarisë shkencore.*

*Siç do të lexoni më poshtë, janë 35 pedagogë që, ose kanë mbrojtur tezat e doktoraturës, ose janë në rrugë e sipër për të arritur në këtë shkallë të rëndësishme të karrierës së tyre shkencore dhe mësimdhënëse.*

*Ata janë përfaqësuar në Vjetarin Shkencor "FEF" me hulumtimet e tyre më të spikatura nga fushat në të cilat zhvillojnë kërkimet e tyre, nën drejtimin e profesorëve nga Universiteti i Tiranës (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Shoqërore), Qendra e Studimeve Albanologjike dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit si në Italí , Rumani, Maqedoni etj., të cilët, duke mos mundur t'i përmend të gjithë me emra, dua t'i falënderoj për ndihmën e pakursyer që kanë dhënë dhe dashamirësinë e treguar për kualifikimin shkencor dhe përngritjen intelektuale të pedagogëve të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë në Universitetin e Korçës.*

*Vjetari Shkencor është organizuar në katër sythe: gjuhësi, letërsi, histori-gjeografi dhe edukim-mësimdhënie, duke rrokur kështu të gjitha drejtimet shkencore dhe pedagogjike që mbulon Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë. Prurjet shkencore në këto fusha kanë qenë të shumta nga stafi akademik i Fakultetit dhe janë botuar edhe në organe të tjera shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë, por punimet origjinale të këtij Vjetari do të jenë një hap tjetër në rritjen e cilësisë së veprimtarisë shkencore në shërbim të mësimdhënies.*

*Në këto fjalë përcjellëse të Vjetarit Shkencor, dua t'i përgëzoj të gjithë pedagogët që marrin pjesë me punimet e tyre, por, në mënyrë të veçantë falënderoj pedagogun Olger Brame, i cili punoi me përkushtim dhe profesionalizëm për përgatitjen e botimit.*

*Duke shpresuar që ky Vjetar Shkencor të jetë i përçdovitshëm, uroj që ai të bëhet një tribunë e vërtetë e mendimit shkencor dhe pedagogjik për të gjithë.*

**Prof. dr. ALI JASHARI**

**Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë**

**TABELA E PËRMBAJTJES**

## *GJUHËSI*


- **ALBINA PAJO.....11**

**Përkufizimi i konceptit të fjalisë dhe llojeve të saj në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar**

- **ALDA CICKO-JASHARI.....18**

**Analiza e kompozitave nga pikëpamja e motivimit të brendshëm**

- **ALMA POGONI.....31**

**Teoria e akteve të të folurit. Shqyrtim teorik**

- **DANIELA STOICA.....48**

**Aspekte të bilinguizmit në të folmen e femrave arumune nga Korça. Bashkëpërkime leksikore dhe frazeologjike**

- **EDIOLA NASE.....58**

**Aspekte teorike të retorikës përmes shembujve praktikë**

- **LIRI SEITLLARI.....68**

**Pasuria sinonimike në veprën e Kutelit**

- **LORENA ROBO.....78**

**Vështrim përqasës i njësive frazeologjike me vatër semantike me pjesë të trupit në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe**

- **MIGENA RIZA.....90**

**Mënyrat e fjalëformimit në leksikun e gjellëtarisë**

- **OLGER BRAME.....99**

**Rreth ndihmesave teorike në fushën e semiotikës**

- **SUELA KOÇA.....115**

**Përkthim i togfjalëshave të qëndrueshëm idiomatikë nga anglishtja në shqipe**


## *LETËRSI*


- **ALMA KARASALIU.....131**

**Roli i rrëfimtarit në veprat e shkrimtarit Xhonatan Suift**

- **BENITA STAVRE.....140**

**Shqipëria dhe shqiptarët gjatë viteve 1921-1939 në shkrimet e autorëve anglezë**

- **ERINDA PAPA.....151**
**Psikologjia e gruas në procesin e plakjes – një nga shqetësimet e vazhdueshme të Doris Lesingut**

- **ERIOLA BONJA- QAFZEZI.....159**
**Përkthimi i letërsisë për fëmijë në aspektin teorik dhe praktik**

- **ERIS RUSI.....172**
**Dimensionet e fantastikes në letërsinë shqipe të shekullit XX**

- **FABIOLA KADI.....182**
**Poezia fetare franceze gjatë epokës moderne**

- **ILIR SHYTA.....192**
**Teoritë receptive në veprën e Lasgush Poradecit. Receptim përmes një pyetësori**

- **NELI NAÇO.....210**
**Mesianizmi në rrëfimet e Mitrush Kutelit**

## *HISTORI –GJEOGRAFI*

- **ADELINA NEXHIPI .....219**
**Polarizimi politik dhe krizat politike në Shqipëri**

- **ALBA KREKA.....235**
**Ndikimi i Revolucionit Kulturor Kinez në shoqërinë shqiptare**

- **DORIAN KALLANXHI.....245**
**Besimi në neolit në Shqipëri**

- **EDLIRA MENKSHI.....256**
**Integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin social-ekonomik rajonal dhe lokal. Rasti i qarkut të Korçës**

- **EFTIOLA THANAS.....271**
**Elemente dekorativo-arkitektonike të banesave në gjysmën e parë të shekullit XX në qytetin e Korçës**

- **ERMIRA JASHIKU.....279**
**Vlerat dhe risqet gjeologjike në zonën Korçë- Devoll**

- **METIN VENXHA.....288**
**Historia ekonomike e Shqipërisë ndërmjet viteve 1920-1939**

- **ORJON AGO.....299**
**Kosova, lufta për çlirim dhe e drejta për të patur shtet**

- **RUELA AGO.....308**
**Zgjedhjet elektorale të vitit 1945 në Shqipëri**

## *EDUKIM , MËSIMDHËNIE*

- **ARJAN KAMBURI.....321**
**Takimi interkulturor. Prespektiva teorike dhe praktika sociale**

- **DONIKA DARDHA.....333**
**Identifikimi i vështirësive të të nxënit në arsimin fillor dhe ndikimi i tyre në gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta edukimi (NVE) në klasa normale**

- **DORELA KAÇAUNI –KONOMI.....340**
**Mësimdhënia e gramatikës së gjuhës angleze te nxënësit e klasës së tretë**

- **EDLIRA XEGA.....348**
**Aspekti kulturor në mësimdhënien e gjuhës angleze në kontekstin shqiptar**

- **EVIONDA PYLLI.....360**
**Aspekte të shfaqjes së komunikimit në klasë në funksion të një mësimdhënieje efektive në arsimin fillor**

- **JULIANA ÇYFEKU .....369**
**Përdorimi i korporave në mësimdhënien e gjuhës angleze në auditor**

- **LINDITA KAÇANI.....376**
**Analizë e strategjive të përdorura në vendin tonë në mësimin e gramatikës së gjuhës angleze**

- **OLSA PEMA.....383**
**Aktualizimi i parimeve pedagogjike dhe pragamtika e ligjërimit në materialet dëgjimore në mjediset virtuale**

# GJUHËSI

# PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË FJALISË DHE LLOJEVE TË SAJ NË TEKSTET E GJUHËS SHQIPE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**ALBINA PAJO**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Punimi doktoral në tërësinë e tij përfshin përdorimin e gjuhës shqipe, të koncepteve gjuhësore e terminologjinë shkencore në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit paraunuversitar. Për këtë do të bëhet një analizë e detajuar e koncepteve gjuhësore dhe e terminologjisë në këto tekste, duke i përqasur me arritjet më të kodifikuara të shkencës gjuhësore shqiptare.

Punimi në fjalë do të trajtojë konceptet e fjalisë dhe llojeve të saj, trajtimin e tyre në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar.

Objektivat e punimit së pari lidhen me një analizë të detajuar të konceptit të fjalisë në tekstet e gjuhës shqipe, me evidentimin dhe diferencimin e përdorimeve jokorrekte të konceptit të fjalisë, fjalisë së thjeshtë, të përbërë etj. në këto tekste, përkufizime të vështira të pasqaruara mirë. Të gjitha këto synohet të përballen nëpërmjet një analize krahasimore me arritjet më të mira të shkencës gjuhësore shqiptare. Nëpërmjet këtij punimi synohet të jepen rekomandime konkrete për përmirësimin dhe saktësimin shkencor të konceptit të fjalisë dhe llojeve të saj.

Strategjia kërkimore në të cilën është mbështetur hartimi i punimit tonë ka në themel të tij hulumtimin dhe kërkimin e thelluar, por edhe analizë krahasimore pasi do të krahasohen dy njësi; nga njëra anë konceptet gjuhësore të fjalisë e llojeve të saj të përdorura në tekstet e gjuhës shqipe, nga ana tjetër konceptet për fjalinë në literaturën bazë teorike të cilat përbëjnë normën standarde gjuhësore. Kësisoj, punimi ka për qëllim jo vetëm të nxjerrë , të evidentojë e të klasifikojë problemet që lidhen me konceptin e fjalisë e llojeve të saj nga tekstet e gjuhës shqipe , por edhe të japë zgjidhje e rekomandime konkrete të bazuara shkencërisht për saktësimin shkencor të tyre në përputhje me klasën, moshën e nivelin e nxënësve, në këtë rast të arsimit nëntëvjeçar.

**Fjalë çelës:** *përkufizim, koncept, fjali, gjuhë shqipe, tekst, botim*

**Abstract**

The doctoral dissertation as a whole includes the usage of the Albanian language the linguistic concept and scientific terminology in the Albanian language school texts of the pre university education. A detailed analyses of the linguistic concept and the terminology, which are part of these school texts, will take place in this study in compliance with the most notable achievements of the Albanian language science.

The following scientific paper will treat the concept of the sentence itself and of its kinds, the way they are treated in the Albanian language school texts of the pre university education. The objectives are: Firstly, to make a detailed analyses of the concept of the

sentence in the Albanian language school texts. Secondly, to point out and to differentiate incorrect usage of the sentence concept. Simple sentence, composed sentence etc, difficult and non well explained definitions, to face them through a comparing analyses with the best achievements of the Albanian language science. Thirdly, to give concrete recommendation for the improvement and the scientific accuvacy of the sentence concept its kinds. The research question of this doctoral dissertation is: How are the linguistic concepts and basic technology being used in the Albanian language school text? Meanwhile, the research question of this scientific paper is: How is the concept of the sentence and its kinds used in these school texts? In order to be helpful to the main idea, several other questions are being asked: What are the concept related to the sentence and its kinds used in a non correct form? What is the level of the difficulty of these concepts in proportion to the age, grade and the level of the students? The Albanian students should get from the first grade to the ninth one, in relation to the age and according to the standards and the criteria which are well studied. So this study tends not only to point out and to classify the problems related to the concept of the sentence and its kinds from the school books, but also to give solution and concrete recommendation scientifically based for a scientific accuracy in relation to the age, grade and level of the students especially those of the secondary school.

**Key words:** *definition, concept, sentence, Albanian language, text, edition*

Arsyeja për të realizuar një punim doktoral që ka në qendër përkufizimet gjuhësore dhe terminologjinë në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar shpjegohet nga problemet që janë hasur në lidhje me konceptet e trajtuara jo drejt në këto tekste, të cilat janë vërejtur gjatë punës së përditshme. Kështu përpos arritjeve pozitive të vërejtura në tekstet e gjuhës shqipe në përcaktimin e drejtë të të terminologjisë gjuhësore dhe koncepteve sipas shkences gjuhësore shqiptare, vërehen edhe probleme që kanë të bëjnë me deformimin apo pasaktësinë e këtyre koncepteve. Nga vëzhgimi që u është bërë këtyre teksteve dalin në pah mjaft koncepte e terma gjuhësore të formuluara jo drejt në disa disiplina si në morfologji, fonetikë, sintaksë, leksikologji etj. Në veçanti, në fokus të këtij punimi do të jenë disa koncepte gjuhësore rreth fjalisë, llojeve të saj të gjurmuara këto nga hulumtimi që u është bërë teksteve të gjuhës shqipe kryesisht nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë. Njësia themelore sintaksore që formëson shprehjen e mendimit është fjalia dhe nxënësit njihen me këtë koncept qysh në vitet e para të shkollës. Duke filluar nga klasa e pestë , por dhe më herët, nxënësit njihen dhe mësojnë koncepte të tjera e njësi të ndryshme sintaksore paralelisht dhe me koncepte të tjera gjuhësore në disiplina të tjera. Por le të fokusohemi tek koncepti i fjalisë. Në tekstin e klasës së tetë koncepti i fjalisë jepet kështu : "*Fjalia përbëhet nga një sërë fjalësh ose grupe fjalësh që ndodhen midis dy grupe pauzash të gjata dhe që përfshihen nga një intonacion i caktuar dhe i plotë. Ato janë të lidhura me njëra- tjetrën nëpërmjet marrëdhënieve gramatikore. Fjalia është një grup fjalësh që ka si bërthamë një folje të zgjedhuar në një nga mënyrat vetore e kjo folje zakonisht ka kryefjalën e vet.*" (Beci, et all, 2003,p. 157).

Siç shihet , në këtë përkufizim janë përfshirë njëherazi shumë elemente e koncepte të paqarta e të pasakta të cilat nuk japin në mënyrë të plotë konceptin e

fjalisë si njësi sintaksore. Ndërkohë përkufizimi i fjalisë në Gramatikën e gjuhës shqipe është: "*Fjalia është fragment i ligjërimit,e përbërë prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota të bashkuara sipas raportesh të caktuara,në bazë të ligjeve të një gjuhe në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore*." (Çeliku, Domi et all, 2002, p.60). Siç shihet, përkufizim i marrë nga Gramatika e gjuhës shqipe, ndryshon pothuaj tërësisht nga përkufizimi i dhënë në tekstin e gjuha shqipe 8: *"…fjalia përbëhet nga një sërë fjalësh, ose grupe fjalësh, që ndodhen midis dy grupe pauzash…"*(Beci et all, 2008). Elementet përbërëse të këtij përkufizimi, jo vetëm nuk janë të sakta nga ana gjuhësore , por edhe termat gjuhësore të përdorura në të nuk janë korrekte, *"sërë fjalësh, grupe fjalësh"* apo "*grupe pauzash*". Pra, në tërësi, koncepti i dhënë për nxënësit e klasës së tetë nuk jep një përkufizim të plotë, të qartë, të kuptueshëm mbi fjalinë. Duke qenë se bëhet fjalë për nxënës të klasës së tetë, atëhere koncepti që duhet t'u jepet për fjalinë si njësi themelore e kumtimit duhet të jetë shkencor në përputhje me njohuritë e marra prej tyre qysh në vitet e mëparshme në lëndën e gjuhës shqipe. Kësisoj këto kërkesa i përmbush mjaft mirë koncepti i cituar më lart nga Gramatika e gjuhës shqipe , i cili i ka të gjitha termat gjuhësore kyç që një nxënës i klasës së tetë i ka të njohura, si: *ligjërimi, fjalë kuptimplota, tërësi gramatikore, intonacionore* etj. Një tjetër variant i qartë i konceptit të fjalisë mund të jetë edhe përkufizimi: "*Fjalia është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht, të shqiptuara me një intonacion mbarimi dhe që shpreh një gjykim,një pyetje ,një dëshirë,një nxitje a një ndjenjë si dhe qëndrimin e folësit ndaj realitetit të brendisë së kumtimit*"(ASHSH, 2002, pp. 111-112).

Nëse vazhdojmë analizën tonë në lidhje me konceptin e fjalisë, mund t'i referohemi edhe një koncepti tjetër: "*Fjalia është njësia më e vogël kumtuese,mjeti kryesor i formulimit dhe i shprehjes së mendimit.*" (Jashari, Kryeziu ,2010, p. 300). Siç edhe shihet, ky koncept përmban të gjithë elementet e nevojshme që një nxënës i klasës së tetë duhet t'i dijë.

Jo vetëm kaq, por elementet përbërëse të këtij koncepti janë të qarta, të thjeshta , lehtësisht të kuptueshme e që mbahen mend lehtë prej tyre. Natyrshëm që koncepti bazë i fjalisë , nëse jepet ashtu siç duhet, përbën premisën e duhur edhe për konceptet e tjera të llojeve të saj si fjalia e thjeshtë , fjalia e përbërë e nënllojet e saj. Edhe përsa i përket fjalisë së thjeshtë vërehen koncepte të shumëllojshme në tekstet e gjuhës shqipe. Koncepti i fjalisë së thjeshtë në tekstin e Gjuhës shqipe 5 jepet kështu: "*Fjalia e thjeshtë është ajo fjali që përmban vetëm një folje në një nga format e zgjedhimit të saj. Ajo formohet zakonisht nga dy grupe fjalësh,nga një grup emëror dhe nga një grup foljor. Secili nga të dy grupet mund të zgjerohet ose zvogëlohet.*"(B.Beci et all, 2002, p. 33). Koncepti i dhënë në këtë tekst ka probleme. Pjesa e parë e tij qëndron, pra, fjalia e thjeshtë ose e mëvetësishme, (term ky që gjendet në literaturën gjuhësore) mund të ketë një folje; por në pjesën e dytë të tij ka pasaktësi , pasi nuk është e thënë që fjalia e thjeshtë të përbëhet nga dy grupe fjalësh, e aq më tepër, të jetë si kusht që secili prej tyre të zgjerohet apo zvogëlohet. Këto janë elementet përbërëse të fjalisë në përgjithësi që mund të mësohen më vonë për të krijuar një koncept më të plotë për fjalinë, përgjithësisht si njësi sintaksore, nga nxënësit e klasës së pestë, por nuk përbëjnë bazën e vërtetë konceptuale për

fjalinë e thjeshtë. Në këtë kontekst nxënësve të klasës së pestë mund t'u jepet një përkufizim më i qartë, p.sh: "Fjalia e thjeshtë(e mëvetësishme) është njësi kumtuese, karakterizohet nga plotnia e kuptimit, jep intonacionin e mbarimit dhe ka një njësi kallëzuesore."(ASHSH, 2002, pp. 60-61). Një tjetër koncept për fjalinë e thjeshtë që ka elementet e duhura do të ishte: "*Fjalia mund të jetë e mëvetësishme dhe ka të gjitha tiparet e saj; plotësinë e kuptimit, intonacionin e përfunduar dhe ka vetëm një bërthamë kallëzuesie.*"(Jashari & Kryeziu, 2010, p.301).

Pra , nëse vazhdojmë më tej analizën tonë mund të themi se nga këto tri elemente përbërëse të konceptit të mësipërm për fjalinë e thjeshtë ,vetëm njëri prej tyre jepet në përkufizimin e cituar nga teksti i gjuhës shqipe 5. Në asnjë tekst apo gramatikë të gjuhës shqipe nuk citohet si fakt i domosdoshëm që fjalia e thjeshtë të përbëhet nga dy apo më shumë grupe fjalësh të cilat mund të zgjerohen apo të zvogëlohen. E ndërsa përkufizimi i dhënë për nxënësit e klasës së pestë për fjalinë e thjeshtë siç e pamë më lart, duket i ngarkuar me terma e elemente të gjata, të panevojshme e të pasakta, në tekstin e gjuhës shqipe 8 , ky koncept jepet mjaft i thjeshtuar. "*Quajmë fjali të thjeshtë atë fjali që ka vetëm një folje të zgjedhur ose disa folje homogjene*."(Beci et all, 2003, p. 158). Elementët e këtij përkufizimi nuk janë as thelbësorë, as të domosdoshëm për të dhënë një një informacion të saktë shkencor për nxënësit e klasës së tetë lidhur me fjalinë e thjeshtë, pasi siç shihet përjashtohen elementët e qenësishëm si njësi kumtuese, intonacioni i mbarimit, plotësia e kuptimit etj. Ajo që mund të themi nga këta shembuj , por edhe të tjerë të nxjerrë nga tekstet e gjuhës shqipë në lidhje me konceptin e fjalisë së thjeshtë, është fakti se këto përkufizime nuk japin një përcaktim të qartë, të plotë, të thjeshtë e të kuptueshëm që të mbahen mend e të përthithen lehtësisht nga nxënësit. Kësisoj koncepti që u jepet nxënësve për fjalinë e thjeshtë nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë, është i paplotë, fragmental dhe jo i njehsuar si koncept shkencor gjuhësor, duke mos u ofruar atyre njohuri te sakta lidhur me këtë çështje.

Ajo që përbën një fakt të rëndësishëm për nxënësit e arsimit parauniversitar, është të mësuarit e koncepteve e termave gjuhësore jo vetëm sipas disiplinave, pasi kjo realizohet, por edhe shkallë- shkallë e më një renditje sistematike. Kështu, në sintaksë, elementet e së cilës kemi marrë për studim, vihet re një studim i shkallëshkallshëm i njohurive, në rastin tonë ato që kanë lidhje me fjalinë. Vërejmë se në mënyrë të drejtë nxënësit mësojnë konceptin për fjalinë, fjalinë e thjeshtë e më pas fjalinë e përbërë e nëndarjet e saj. Edhe për konceptin e fjalisë së përbërë,vihen re përkufizime të llojeve e natyrave të ndryshme në varësi të teksteve. Nxënësve u jepet herët, qysh në klasën e pestë koncepti për fjalinë e përbërë e ajo që kemi vënë re, janë mangësi konceptuale të dukshme. Në një tekst të klasës së pestë thuhet: "*Fjalia e përbërë ka më shumë se një folje që të gjitha në një nga mënyrat e zgjedhimit të foljes. Çdo folje e tillë formon një pjesë të fjalisë së përbërë. Nuk formojnë pjesë të fjalisë së përbërë foljet që janë në një nga format e pashtjelluara*"(Beci et all, 2002, p.279).

Përpara se të bëjmë analizën e këtij koncepti, le të shohim se si jepet përkufizimi për fjalinë e përbërë apo periudhën në një botim të mirëfilltë shkencor: *"Periudha përbëhet prej dy ose më shumë njësish kallëzuesore dhe formon një njësi kumtuese, gramatikore dhe intonacionore."*(ASHSH, 2002, p.423).

Nëse i marrim veç e veç elementet përbërëse të konceptit në fjalë, ato mund

të qëndrojnë. Pra, vërtet fjalia e përbërë ka më shumë se një folje në një nga mënyrat e zgjedhimit apo çdo folje mund të formojë një pjesë fjalie, por ky formulim nuk i jep nxënësit të klasës së pestë në këtë rast, një koncept të qartë e konkret për fjalinë e përbërë e, nëse i shkojmë më tej argumentit tonë shohim se në këtë përkufizim janë lënë jashtë elemente të domosdoshme që kanë të bëjnë më fjalinë si njësi kumtuese, intonacionore dhe gramatikore të cilat përbëjnë thelbin e një përkufizimi të saktë jo vetëm nga ana shkencore por edhe nga ana metodike.

Ajo që kemi evidentuar përsa i përket dhënies së këtij koncepti, është fakti se ai thjeshtohet mjaft nga klasa në klasë, duke u bërë më i paplotë e duke i rudhur elementet përbërëse më të nevojshme. Ja disa prej tyre: "*Fjalia e përbërë ka dy ose më shumë folje që shoqërohen nga kryefjala e vet.*"(Gjuha shqipe 6, p. 18); "*Fjalia e përbërë përmban disa grupe fjalësh që kanë secili nga një folje të zgjedhuar në një nga mënyrat vetore*."(Gjokutaj et all, 2006); "*Quajmë fjali të përbërë atë fjali që përmban të paktën dy pjesë të krijuara rreth dy foljeve të zgjedhuara*."(Beci et all,2003, p.158). Akoma më shumë thjeshtohet koncepti për fjalinë e përbërë në një tjetër tekst: "*Fjalia e përbërë është fjalia që përbëhet nga dy a më shumë fjali të thjeshta*"(Beci et all, 2006, p.178).

E pra, teksa sheh gjithë këto formulime të llojllojshme të përkufizimeve për fjalinë e përbërë të shkëputura nga një larmi tekstesh mësimore, arrin në përfundimin se ato u jepen nxënësve jo vetëm të paplota, por edhe të rrëmujshme, pa sistem, e siç thotë prof Ali Jashari, "*autorët e teksteve i futin nxënësit në një labirinth nga i cili nuk dalin dot edhe mësuesit që i shpjegojnë këto njohuri për nxënësit.*" (Jashari, 2009,p.193). Konceptet e lartpërmendura në lidhje me fjalinë, fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë, pasohen në tekstet e gjuhës shqipe edhe me nënlloje të kësaj të fundit, ku më kryesoret janë fjalia e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje si dhe ndarjet e tyre.

Kështu, koncepti i fjalisë së përbërë me bashkërenditje në këto tekste përgjithësisht jepet i qartë, i plotë, i kuptueshëm, madje edhe në përputhje me moshën e nxënësve dhe nivelin e njohurive të marra prej tyre. Qysh në klasën e pestë jepet kështu përkufizimi i fjalisë së përbërë me bashkërenditje: "*Fjalia me bashkërenditje formohet nga disa pjesë të pavarura. Ato lidhen me anë të lidhëzave bashkërenditëse. Lidhëzat që përdoren më shpesh për të lidhur pjesët e një fjalie të përbërë me bashkërenditje janë: dhe, edhe, e, ose, por, kurse etj*." (Beci at all, 2002, p.281), koncept ky që përsëritet në të njëjtën formë edhe në një tekst të klasës së shtatë e që jep një informacion të plotë për këtë lloj fjalie (Beci at all, 2003, p.170).

Pjesë e kulturës gjuhësore që marrin nxënësit e arsimit nëntëvjeçar nga tekstet e gjuhës shqipe në përgjithësi, e nga sintaksa në veçanti, janë edhe llojet e tjera të fjalive si ajo me nënrenditje e nënllojet e saj, fjalia pa lidhëza, fjalitë e ndërkallura, ato të përziera etj., të cilat në tërësi përbëjnë një shumësi njohurish të pasistemuara mirë. Ajo që duam të themi është fakti se nxënësve u jepen informacione mjaft të ngarkuara teorike në lidhje me të gjitha llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje, deri në hollësi të panevojshme të cilat më shumë sesa i formojnë ata i hallakatin më tepër përmes koncepteve e termave duke i larguar nga prakticiteti e aspekti funksional i gjuhës. Po kështu veprohet në këto tekste edhe me skemat e fjalive të përbëra, sidomos ato me më shumë se dy pjesë, të cilat paraqesin vështirësi serioze përsa i përket të nxënit. Për ta, skemat e fjalive të përbëra janë abstrakte kur ato bëhen për

fjali me më shumë se dy pjesë, ndërkohë që mund të mjaftohej vetëm me dhënien e disa skemave tip e të thjeshta si ato të fjalive të përbëra me bashkërenditje, ku pjesët përbërëse vendosen në skemë paralel me njëra tjetrën apo të fjalive me nënrenditje ku për nxënësit mjafton të jepet një skemë e thjeshtë që të tregojë varësinë e pjesës së varur nga pjesa kryesore. Sigurisht që njësitë sintaksore janë të shumta e përveç fjalisë e llojeve të saj, mjaft të rëndësishme janë edhe togfjalëshi e gjymtyrët e fjalisë si elemente të rëndësishme, të cilat duke u bashkuar ndërmjet tyre krijojne raporte gramatikore dhe kuptimore në funksion të një ligjërimi të lidhur. Kësisoj fjalia si njësia sintaksore themelore është mjeti kryesor i formulimit të mendimit e duke parë rëndësinë e madhe që ka lipset të mësohet qartë, drejt e saktë në tekstet e gjuhës shqipe duke u bazuar në mënyrë korrekte në përkufizime shkencore të studiuara mirë e mirë. "Sintaksa si disiplinë gjuhësore ka rëndësi të madhe teorike dhe praktike. Nëpërmjet kategorive të saj realizohet funksioni i gjuhës si mjet marrëveshjeje midis njerëzve, si mjet komunikimi. Struktura sintaksore është e lidhur me mendimin më shumë se çdo rrafsh tjetër gjuhësor."(ASHSH, 2002, p.54). Kjo do të thotë që dhënia e koncepteve të sakta e të qarta për njësitë përbërëse sintaksore, së bashku me tërësinë e koncepteve e termave gjuhësore, në përgjithësi u japin nxënësve kulturë gjuhësore e nivel të kënaqshëm teorik e praktik.

**Përfundime**

Nga sa u trajtua në këtë kumtesë mund të veçojmë disa përfundime.

Hartimi i një teksti për gjuhën amtare, si një punë që kërkon jo vetëm përgatitje shkencore e metodike, por edhe përgjegjshmëri qytetare e profesionale, duhet të zërë një kohë relativisht të gjatë dhe me shumë përbërës përgatitorë. Sigurisht që në këtë punim u trajtua vetëm një aspekt i tërësisë së koncepteve që u jepen nxënësve në tekstin e gjuhës shqipe; koncepti për fjalinë e disa lloje të saj , ku u veçuan edhe probleme e pasaktësi, por qëllimi kryesor i punimit të plotë doktoral në tërësi është nxjerrja dhe evidentimi i të gjitha koncepteve e termave gjuhësore të devijuara nga norma për të gjitha nënsistemet e gjuhës dhe dhënia e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e tyre.

Lidhur me përkufizimin e fjalisë e llojeve të saj mund të themi se përveç punës së mirë që është bërë në tekstet gjuhësore, veçanërisht pas vitit 2002, hasen edhe probleme serioze në mënyrën e formulimit të tyre, si dhe pasaktësi të nivelit shkencor. Njohuritë për fjalinë , siç edhe e prekëm gjatë trajtimit të kumtesës , në mjaft raste jepen të ngarkuara qysh në klasën e pestë, me terma e togfjalësha të panevojshëm, që nuk japin në mënyrë të drejtpërdrejtë, qartë e thjesht përkufizimin e fjalisë, në mënyrë që ai lehtësisht të përvetësohet prej nxënësve për t'u zbatuar më tej në situata konkrete gjuhësore, ndërsa në klasat më të larta konceptet për fjalinë e llojet e saj jepen tejet të thjeshtuara, e në ndonjë rast edhe me mangësi shkencore. Lidhur me këtë fakt është e nevojshme që hartuesit e teksteve duhet të japin njohuritë, lidhur me fjalinë në këtë rast, shkallë- shkallë, fillimisht ato më të thjeshtat në klasën e pestë e me radhë të rritet shkalla e vështirësisë së tyre në përputhje me nivelin e moshën e nxënësve. Gjithashtu, është mirë që në tekstet gjuhësore, lidhur me konceptin e fjalisë, termat e fjalët të jenë jo vetëm të qarta, por edhe të mund të jepet diçka e re nga një klasë në tjetrën, nga një nivel në tjetrin, në mënyrë që rimarrja të mos jetë përsëritje, pasi vetëm kështu mund të arihet të mbahet nën kontroll kureshtja dhe interesi i nxënësit, i cili sigurisht është

më i lartë kur ai pret të mësojë nga teksti koncepte të reja.

Shpeshherë nga hartuesit e teksteve, termat, përkufizimet, por edhe formulimi gjuhësor i tyre, në rastin tonë për fjalinë , merren apo quhen të ditura e të njohura gjë që e vështirëson më shumë përvetësimin e tyre nga ana e nxënësve. Nxënësit detyrohen të mësojnë përmendësh duke krijuar një zbrazëti serioze mes të mësuarit formal dhe formimit gjuhësor të natyrshëm. Mendojmë që për hartimin e teksteve të gjuhës shqipe hartuesit e tyre, vërtet u referohen profesorëve dhe akademikëve të nderuar, por është e nevojshme që materiali gjuhësor në përgjithësi e ai për fjalinë në veçanti, si arritje e standardeve gjuhësore, duhet të studiohet mirë e të "ulet" në nivelin e nxënësve, sipas moshës e klasave, pikërisht në nivelin mesatar të tyre pa rënë në thjeshtëzime filloreske me një fjalor të varfër, apo ndërtime gramatikore shabllone. Është, pra, rasti të theksojmë nevojën e rritjes së shkallëzuar të përmbajtjes strukturore të formulimit të konceptit të fjalisë ashtu si për çdo lloj koncepti tjetër gjuhësor, pasi vetëm kështu mund të shtresëzojmë tek nxënësi koncept pas koncepti, term pas termi një kulturë gjuhësore të formësuar sipas arritjeve më të mira në këtë fushë. Pra në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar, përveç nivelit shkencor dhe formulimeve të qarta gramatikore e sintaksore të koncepteve, përkufizimeve dhe terminologjisë gjuhësore, lipset të ketë modele të arrira të natyrës së shqipes, larg ndikimeve të panevojshme nga gjuhë të tjera.

Gjuha e përdorur, sidomos në tekstet e gjuhës shqipe, duhet të jetë modeli më i mirë i një shqipeje standarde të pastër e të pasur.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002). Gramatika e Gjuhës Shqipe 2,Tiranë.

Beci B., Bubani L., Gurabardhi Z. (2003). Gjuha shqipe 5, Shtëpia botuese Morava,Tiranë

Beci B., Bubani L., Gurabardhi Z. (2008). Gjuha shqipe 8, Print 2000, Tiranë

Beci B., Bubani L., Gurabardhi Z.(2002). Gjuha shqipe 5, ShBLSH, Tiranë

Beci B., Bubani L., Gurabardhi Z.(2003). Gjuha shqipe 7, Shtëpia botuese AlbPaper, Tiranë

Beci, B.et al. (2003). Gjuha Shqipe 8,Tiranë, .

Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe, probleme dhe detyra. Konferencë Shkencore,Tiranë, 2009.

Gjokutaj M., Ballhysa A., Bishqemi A., (2006). Gjuha shqipe 7, Shtëpia botuese Morava, Tiranë.

Jashari A. (2009), Terminologjia gjuhësore në tekstet shkollore,Tiranë,

Jashari, A., Kryeziu B. (2010). Gjuhë amtare, Prishtinë.

# ANALIZA E KOMPOZITAVE NGA PIKËPAMJA E MOTIVIMIT TË BRENDSHËM

**ALDA CICKO-JASHARI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë kompozitat e shqipes nga pikëpamja e motivimit semantik, për të zbuluar formën e brendshme të tyre. Teoria e Humboldit për formën e brendshme, një nga tezat më të spikatura të filozofisë së gjuhës të shekullit XIX vlerëson në mënyrë të veçantë aspektin krijues të gjuhës si mjetin kryesor për të shprehur shpirtin e individit dhe të popullit. Sipas Humboldit aftësia krijuese gjuhësore është e rrënjosur thellë në trurin e njeriut ose në mendjen e folësit duke dalë në përfundimin se "gjuha e një populli është shpirti i tij dhe shpirti i tij është vetë gjuha".

Forma e brendshme e gjuhës është pasqyrimi më i qartë dhe më konkret i veçorive dhe dallimeve midis gjuhëve, sidomos në fushën e leksikut dhe frazeologjisë, duke u bërë në të njëjtën kohë mjeti më i fuqishëm që përçon mendësinë, botëkuptimin dhe, mbi të gjitha, shpirtin krijues të një populli. Në këtë aspekt, ndër elementët e leksikut që përshfaqin më së shumti veçori dalluese, karakterizuese dhe identifikuese, përzgjodhëm kompozitat.

Teoria e formës së brendshme është plotësisht e përligjur në rastin e analizës sonë dhe na çoi në përfundimin se mënyrat si kategori të logjikës sendërtohen materialisht në shenja gjuhësore, janë pasqyrim i botës së brendshme shpirtërore dhe se mënyra se si folësit e shqipes e perceptojnë realitetin, lidhja dhe materializimi i veshjes tingullore me konceptin që shprehet me anë të saj, përzgjedhja e elementeve gjuhësore origjinale që bashkësia gjuhëfolëse zgjedh për të shenjuar një realie, për të shprehur një përmbajtje të caktuar, nuk mund të shpjegohet tjetër veçse me traditën, kulturën, botën materiale, mendësinë, shkallën e njohjes së realitetit objektiv etj. Veç të tjerash, dallimet e dukshme në fushën e leksikut përcaktohen nga ndasitë e parimeve të brendshme të logjikës dhe perceptimit.

Kjo analizë ka për qëllim zbërthimin e përbërësve semantikë dhe kundrimin e dukurisë së formimit të kompozitave të shqipes në raport me realitetin objektiv dhe rrafshin e mendimit. Interpretimi i lidhjeve dhe raporteve të cilësimit dhe shkallëzimi i tyre në rastin e mbiemrave cilësorë të shqipes, është parë gjithmonë në raport me qëndrimin subjektiv të folësit përkundrejt vlerësimit të tiparit që do të nxjerrë në pah dhe referentin të cilit i vishet ky tipar, çka bën që këto shenja gjuhësore të jenë të ngarkuara me nuanca kuptimore dhe ngjyrime të theksuara emocionuese.

**Fjalët çelës**: *formë e brendshme, njësi leksikore, shenja gjuhësore, kompozita, motivim i brendshëm, referent.*

**Abstract**

The principle aim of this paper is to conduct an inquiry on one of the most important thesis of the 19th century linguistic studies established by Wilhelm Von Humboldt , the principle of inner form, as well as to demonstrate that the inner form of the language which serves as a means of expressing the psychic content of it, is the most concrete and

evident demonstration of the particular features and special characteristics a language possesses especially in terms of dialectical lexicon and phraseology as it transmits and conveys the national spirit, point of views and general outlook.

Humboldt believed that languages acquire their individual character as a result of their being animated by "a more or less fruitful principle of mental development". Humboldt's theory appeared of great interest and provided us a lot of evidence to fully justify the fact that during the process of shaping and structurally formalizing the basic sound patterns of the Albanian language, people have dissolved their spirit, their mentality, their way of thinking and understanding.

The notion of the inner form is not neither abstract nor inconceivable, it represents and purely reflects a kind of association between the sound sequence and the notion/concept it perceives, is a mechanism people chose to objectivize the thought into meaningful and concrete instruments i.e. specific linguistic signs.

The characteristic features of Albanian have naturally arisen from the laws of thinking shared by all member of this language speaking community. Exploiting the power of Albanian dialectical lexicon we became aware of the fact that the signifying words used or the selection of different linguistic elements to nominate one and the same objective reality's component was not at all neither identical nor similar and this data gave us the immense possibility to advance arguments that a native language speakers perceive, understand, interpret and shape the real world in different distinct, original ways and that the devices people choose to cut up their reality apparently differ not only from dialects to dialects but sub dialects as well.

While analyzing different aspects of inner form in terms of lexical units, compound words held our attention because of the great diversity in both structure and content, the original character, distinctive word formation combinations, infinite expressiveness, the variegation of the semantic nuances and connotative values.

**Key words**: *inner form, lexical units, compound words, referent, inner motivation, lexical-semantic variants.*

Siç dihet, fjalë e përbërë (kompozitë) e mirëfilltë në gjuhën shqipe është quajtur ajo njësi dygjymtyrëshe, që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintaksore gjithnjë si një fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të përbërësve të saj (Kostallari,1972,I p.83). Kompozitat shpesh cilësohen si "prodhim" i një "akti krijimi", të cilat ndërtohen sipas gjedhesh të njohura në gjuhë dhe që nga pikëpamja strukturore ndahen gjithmonë në dy gjymtyrë, të cilat ruajnë pak a shumë në mënyrë të qartë kuptimet materiale, leksikore dhe hyjnë në lidhje të përcaktuara e shumë të ndryshme semantike-sintetike në bazë të ligjësive të brendshme të gjuhës shqipe. Për shkak të lidhjeve të brendshme kuptimore në të cilat hyjnë gjymtyrët e kompozitës, del një njësi e re leksikore.

Duke u mbështetur në arritjet teorike për studimin e fjalëve të përbëra dhe në trajtimin leksikografik në fjalorë të shqipes, ne kemi marrë në studim analizën e njësive të tilla leksikore nga pikëpamja e motivimit semantik, për të zbuluar "formën e brendshme" të tyre. Një analizë

e tillë bëhet e mundur duke këqyrur emërtimin e realieve mbi bazën e *një tipari të caktuar*, i cili lidhet me një shkallë mjaft të hershme të zhvillimit shoqëror e botëkuptimor dhe që shërben si bazë për motivimin e kompozitave. Ky tipar është kyçi për të zbuluar *formën e brendshme* të tyre (Kostallari,1972,I, p. 83). Kjo është një nga tezat më të spikatura në gjuhësinë e shekullit XIX, të shtjelluar nga Vihlelm von Humboldi, që në teoritë e tij vlerëson në mënyrë të veçantë aspektin krijues të gjuhës, të cilin e sheh të konkretizuar në të ashtuaquajturën "formë të brendshme", si mjeti kryesor për të shprehur shpirtin e individit dhe të popullit. Sipas Humboldit, aftësia krijuese gjuhësore është e rrënjosur thellë në trurin e njeriut ose në mendjen e folësit dhe, duke e shtjelluar më tej konceptin e Herderit për lidhjen e gjuhës me mendimin, ai shprehet se "gjuha e një populli është shpirti i tij dhe shpirti i tij është vetë gjuha"(Jashari, 2003, p.27).

Teoria e Humboldit për formën e brendshme të gjuhës na u duk me interes dhe plotësisht e përligjur
në rastin e shqipes. Duke qëmtuar shembuj për hartimin e një studimi të plotë lidhur me aspektet e pasqyrimit të shpirtit, botëkuptimit, kulturës dhe mendimit shoqëror në gjuhë, ajo që na tërhoqi më tepër vëmendjen ishte fakti se veshja tingullore apo përzgjedhja e elementeve gjuhësore që përdoret për të shenjuar të njëjtën realie nuk ishte gjithmonë e njëjtë, çka na bën të mendojmë se dhe brenda të njëjtit komunitet gjuhësor, folësit e një gjuhe e perceptojnë, e kuptojnë apo e interpretojnë realitetin objektiv në mënyra të ndryshme dhe se mjetet e përzgjedhura për të shenjuar një realie, për të komunikuar një ide apo një përmbajtje të caktuar, ndryshojnë jo vetëm nga një gjuhë te tjetra, por edhe brenda një gjuhe, nga dialekti në dialekt apo nga një e folme në tjetrën. Për të bërë një analizë të tillë, së pari, kemi marrë në vështrim kompozitat mbiemra, të cilat vlerësohen si një nga mjetet më të fuqishme për gjallërimin dhe pasurimin e leksikut të shqipes.

Mbiemrat cilësorë mbartin të gjitha vlerat semantike e konotative të sintagmës dhe bëjnë që, në tërësi, struktura të fitojë një përmbajtje cilësore, e cila i vishet si atribut një realieje tjetër për ta cilësuar. Pjesa më e madhe e kompozitave mbiemërore që do të analizojmë në këtë artikull përdoren në mënyrë të figurshme, janë metaforizuar duke fituar vlerat e mbiemrave cilësorë. Megjithë karakterin e ndërmjetuar të shënimit të tiparit dhe mënyrat e cilësimit të pjesës që zotëron realia, këta mbiemra ngjallin drejtpërsëdrejti parapërfytyrimin mbi dukuri të caktuara të realitetit (Kostallari, 1972, p. 98).

Analiza jonë për këta mbiemra ka për qëllim të parashtrojë disa prej teknikave më të rëndësishme që ka përdorur bashkësia shqipfolëse gjatë procesit të emërtimit dhe të sintetizojë disa prej gjedheve më të përdorura të këtij procesi. Gjatë vjeljes së materialit ne kemi skeduar **977** kompozita mbiemra dhe i kemi klasifikuar ato sipas disa kritereve, të cilat lidhen me mënyrën se si është shenjuar tipari, duke u bazuar në cilësitë që zotëron vetë realia e cilësuar nga mbiemri apo nëpërmjet krahasimit me një realie tjetër, duke i veshur të shenjuarit një nga tiparet dalluese të tij.

Gjithashtu, analiza jonë ka për qëllim zbërthimin e përbërësve semantikë dhe kundrimin e dukurive gjuhësore në raport me realitetin objektiv dhe rrafshin e mendimit. Interpretimi i lidhjeve dhe raporteve të cilësimit dhe shkallëzimi i tyre është parë gjithmonë në raport me qëndrimin subjektiv të folësit përkundrejt vlerësimit të tiparit që do të nxjerrë në pah

dhe referentit të cilit ky tipar i vishet, çka bën që këto shenja gjuhësore të jenë të ngarkuara me nuanca kuptimore dhe ngjyrime emocionuese.

**Motivimi i brendshëm i kompozitave mbiemra sipas tipareve të referentit**

**a.** Tiparet e jashtme fizike të realies, të cilësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe që mbartin një ngjyrim emocionues pozitiv, përbëjnë një fushë të caktuar konceptore dhe leksikore. Gjymtyra e strukturës së përbërë, ajo që mbart edhe konceptin, është një pjesë e trupit të njeriut dhe gjymtyra plotësuese mbiemërore (ajo që mbart ngarkesën kuptimore dhe emocionuese) është zakonisht një mbiemër që shënon:

**b.**Tipare fizike dalluese të ngjyrës si p.sh.: *flokartë, flokargjend, leshkuq, vetullzi, kokëkuq, qimeartë, qimebardhë, qimelarmë, qimemurrmë, qimeverdhë, qimezi, pendëkuq, bishtakuq, bishtartë, bishtbardhë, bishtkuq, dhëmbëflorinjtë, bukëkuq, mustaqebardhë, mustaqekuq, faqekuq, faqeverdhë, mjekërzi, mjekërbardhë, sylarmë, syartë, sybardhë syblertë, kokëzezë, këmbëkuq, flokëkuq (qimekuq)* etj. Interesante janë përzgjedhjet e referentëve frymorë (kafshë ose njerëz) dhe nxjerrja në pah e përbërësve të treguesve të realies që do të cilësohen nga spektri i gjerë i ngjyrave. Frymorët kafshë janë identifikuar më tepër me ngjyrat e shtresës mbuluese të trupit (pendë/ qime/ lesh) dhe treguesve më të dukshëm të ndërtimit trupor (kokë/ bisht/ qafë). Edhe origjinaliteti i përzgjedhjes së ngjyrave është po kaq interesant, fusha konceptore e ngjyrave që bëhet tregues dallues përcaktues për këto realie ka sendërtuar një fushë të gjerë leksiko-semantike ku përfshihen që nga ngjyrat bazë të perceptura lirisht përmes shqisës së të parit ( e kuqe/ e zezë/ e bardhë), deri te nuancat dhe kombinimet e ngjyrave që abstragohen për shkak të përfyryrimeve më të thelluara apo për shkak të ngjashmërisë me elementë të realies që kanë këtë ngjyrë tipar mbizotërues (e artë/ e argjendtë/ e blertë/e larmë/ e murrme). Duket se treguesi i ngjyrës ka shërbyer jo vetëm si cilësues, por edhe ka formësuar strukturalisht njësi të veçanta leksikore të leksikut të specializuar të fushës së bimëve dhe kafshëve, që shërbejnë si emërtime të përbëra *faqekuq* (zog i vogël këngëtar me kokë të kuqe), *këmbëkuq* (shpend sa një pëllumb zakonisht me ngjyrë të murrme me sqep të kuq), *bishtkuq (*zog i vogël këngëtar me bisht si të kuqërremtë), *bishtartë* (lloj future që e ka pjesën e poshtme të trupit me këtë ngjyrë), *pendëkuq* ( një lloj krapi që ka ngjyrën e kuqe) etj .

Nga ana tjetër, frymorët njerëz janë identifikuar më tepër përmes cilësimit të tipareve të fytyrës (sy/ mjekër/ flokë/ faqe), por nuk mungojnë edhe rastet kur një tipar i veçantë identifikues në vetvete, siç është rasti i leksemës *mustaqe*, të përforcohet në më tepër se një mënyrë, duke u cilësuar edhe përmes ngjyrës (*mustaqezi, mustaqebardhë, mustaqekuq*) etj. Perceptimet e ngjyrave në pjesën më të madhe të rasteve janë më konkrete dhe më të kapshme dhe treguesi i ngjyresës nuk jepet në mënyrë të ndërmjetuar.

Të gjitha këto kompozita mund të motivohen duke i zbërthyer në struktura më të zgjeruara që shprehin marrëdhënie përkitësie me realien që shenjojnë: *që e ka vetullën të zezë, që i ka flokët të zinj, që i ka sytë të bardhë, që i ka faqet të verdha* e kështu me radhë. Treguesi i qenësishëm cilësues i ngjyrës ka shërbyer në jo pak raste edhe në formësimin e kategorisë së emërtimeve që e shenjojnë realien në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, siç janë nofkat, duke e nxjerrë treguesin e ngjyrës si tipar mbizotërues, përcaktues e në shumë raste edhe identifikues për

frymorët njerëz që e mbartin këtë veçori, si: *kokëkuqi, mustaqeziu, sybardhi, kokëziu, qimekuqi (leshkuqi), vetullziu* etj.

**c.**Tregues të cilësive të jashtme të lidhura me formën, gjatësinë, madhësinë, butësinë, ashpërsinë etj.: *flokëgjatë, flokëlëshuar, flokëpakrehur, flokë prerë, leshashpër, leshpalarë, barkmadh, bark rrumbullak, buzëmadh, buzëtrashë, qafëgjatë, qafëhollë, kokërruar, këmbëgjatë, këmbëshkurtër, këmbëprerë, krahëfortë, qimeshkurtër, pendëgjatë, bishtgjatë, bishthollë, bishtkëputur, bishtprerë, bishtshkurtër, këmbëthyer, këmbëvogël, këmbëzbathur, mjekërbutë, mjekërgjatë, mjekërashpër* etj.

Këto kompozita mbiemra cilësojnë më së shumti tipare fizike lehtësisht të dallueshme dhe me përbërës të realies që indetifikohen qartazi. Tiparet referenciale, që janë formësuar strukturalisht me anë të këtyre mjeteve gjuhësore, u asociohen kryesisht treguesve të jashtëm të fytyrës, trupit, aftësive fizike ose mungesës së tyre, si psh.: *buzë, flokë, kokë, bark, hundë, këmbë, mjekër, mustaqe* etj.

Këta tregues kryesisht shenjohen me mbiemra cilësorë të panyjshëm (këmbëvogël, krahdrejtë, bishtshkurtër), ose me mbiemra të krijuar prej pjesorës së foljes(krahëprerë, kokërruar, qimedredhur) e më rrallë i përkasin strukturës ***emër +pa+pjesore*** (flokëpakrehur, leshpalarë, qimepadalë etj.), të cilët hyjnë në përbërje dhe grupime semantike që shprehin lidhje antonimike të tipit: *i gjatë-i shkurtër, i hollë-i trashë, i madh-i vogël, i drejtë-i shtrëmbër, i fortë-i dobët, i ashpër- i butë* etj., si: *flokëgjatë* (që i ka flokët e gjatë)- *flokëshkurtër* (që i ka flokët e shkurtër); *buzëtrashë* (që i ka buzët e trasha)- *buzëhollë* (që i ka buzët e holla); *këmbëvogël* (që e ka këmbën të vogël)- *këmbëmadh* (që e ka këmbën të madhe); *bisht shkurtër* (që e ka bishtin të shkurtër)- *bishtgjatë* (që e ka bishtin të gjatë) e kështu me radhë *qimehollë-qimetrashë, mjekërbutë-mjekërashpër, hundështy pur-hundëpërpjetë, krahëgjatë - krahëshkurtër, qafë hollë-qafëtrashë* etj.

Të gjitha leksemat mund të zgjerohen strukturalisht duke përcaktuar raporte përkitësie midis dy përbërësve të kompozitës, marrëdhënie në të cilat elementi i dytë përcakton lidhjet cilësore me përbërësin e parë. Shumica e leksemave të përbëra të sipërpërmendura përveçse i kanë shprehur cilësitë në mënyrë të drejtpërdrejtë pa ndërmjetësinë e ndonjë referenti tjetër, u janë nënshtruar lëvizjeve semantike, duke zgjeruar kuptimin dhe duke fituar një kuptim të ri të figurshëm, madje duke zgjeruar edhe strukturën kuptimore në kushtet e shumëkuptimësisë ku këto njësi operojnë. Ky proces vihet re qartë te kompozitat: *barkmadh* "që pasurohet në kurriz të të tjerëve" nga tema semantike "që e ka barkun e madh", *gojëmadh* "llafazan, që nuk i pushon goja" nga "që e ka gojën të madhe", *krahëprerë* "që i është kufizuar mundësia vepruese" nga "që e ka krahun të prerë", *bishtprerë* "që nuk ka përkrahje, nuk ka ndikim te të tjerët" nga "që e ka bishtin të prerë", *buzëhollë* "që zgjedh shumë e bën naze në të ngrënë dhe në të pirë" nga "që i ka buzët të holla", *buzëçarë* "që ka hequr shumë në jetë, i shumëvuajtur" nga "që e ka buzën të çarë", *buzëtrashë* "që ha çdo gjë pa e kuptuar se çfarë po ha" nga "që i ka buzët të trasha", *buzëthatë* "që nuk ka vënë asgjë, i mjerë" nga "që i ka buzët të thata" etj.

Shumë interesante janë strukturat me përbërësin nominal "bisht": *bishtpërpjetë, bisht prerë, bishtkëputur, bishtdredhur/ përdredhur, bishtundur*, përbërës, i cili, megjithëse shënon tipa re të jashme të cilësuara drejtëpërsëdrejti që u referohen kafshëve, është shndërruar në mënyrë të figurshme, duke shënuar cilësi të karakterit

të njerëzve, duke përligjur edhe një herë faktin se procesi i formimit të kompozitave ka kaluar nëpërmjet më shumë se një etape. Një pjesë e këtyre kompozitave shënojnë cilësi fizike të amplifikuara qëllimisht dhe që përdoren si mjete identifikimi apo etiketimi dhe në pjesën me të madhe të rasteve mbartin ngjyrim emocionues negativ. Në këtë kontekst, duhet përmendur edhe fakti që folësit e gjuhës shqipe i kanë përdorur këto mjete cilësuese si kategori të përgjithësuara të gjykimit dhe paragjykimit për individë të veçantë, duke i përdorur si apelativa për të strukturuar semantikisht dhe për të shënuar nofka të tipit: *kokëmadhi, këmbëgjati, barkmadhi, buzëtrashi, hundëgjati, hundëpërpjeti, mjekërgjati* etj. Procesi i emërtimit të këtyre njësive ka shërbyer për formësimin e njësive të reja leksikore dhe për të rritur vëllimin e tyre semantik.

Në raport me mbiemrat e sipërpërmendur, kompozita mbiemra, që e shprehin cilësimin e tiparit në mënyrë të ndërmjetuar, pra nëpërmjet krahasimit me një realie tjetër, duke i veshur të shenjuarit një nga tiparet dalluese të saj, janë të shumtë në numër dhe të shumëllojshëm për sa i përket shkallës së ndërmjetimit. Pjesa më e madhe e formimeve të tilla kanë në bazë metaforën që ka përftuar një varg njësish leksikore të cilat dallohen për njëjtësinë midis strukturës së jashtme dhe anës përmbajtësore. Gjatë analizës semantike vërejmë disa tipe të motivimit të brendshëm të strukturave semantike, të cilat mund të klasifikohen sipas mënyrës se si është ndërmjetuar veçoria dalluese dhe mbizotëruese nga i cilësuari drejt referentit, tipari i të cilit po krahasohet.

**a-**Referenti, që mbart tipare mbizotëruese e që nëpërmjet metaforave të krijuara sipas besimit popullor dhe entitetit (qenësisë) mendor të folësve, i janë veshur një realieje tjetër, mund të jetë një kafshë a shpend: *arushë, lepur, derr, dosë, mace, mushkë, dele, buall, sorrë, cjap, dac, gomar, stërg, maçok, ujk, flutur, akrep, dallëndyshe, dhelpër, gjel, kalë, pallua, shkabë, shqerrë, shqiponjë* etj. Të tilla janë kompozitat: *flokarushë, gjumëlepur, barkderr, barkdosë, barkmace, buzëmushkë, buzëdele, gojë-buall, gojëbilbil, gojëgjarpër, gojëlopë, gojënepërkë, qafëderr, qafëlejlek, qafëpatë, qafësorkadhe, vetullsorrë, kokëbuall, kokëcjap, kokëdac, kokëdac, kokëgomar, kokëmushkë, kokëstërg, këmbësorrë, bishtakrep, bishtdallëndyshe, bishtdhelpër, bishtgjel, bishtkali, bishtpallua, syshqerrë, syshqiponjë,* etj.

Ndërtimi i brendshëm kuptimor i kompozitës si një njësi e vetme është realizuar përmes metaforës, ku të bie menjëherë në sy karakteri i ndërmjetuar i përcaktimit cilësor të tipareve. Barasvlerësimi i imazhit apo shembëllimit të një realieje konkrete frymor kafshë me një tipar dallues dhe identifikues të njeriut është i paramenduar dhe i mirëmenduar përveçse shpreh qartë karakterin e mendësisë së folësve që i kanë sendërtuar këto tipare dhe ndërveprimin midis gjuhës dhe kulturës sidomos në rrafshin e leksikut të hershëm burimor të gjuhës, pjesë e të cilit janë emërtimet e kafshëve dhe nga ku është marrë substanca semantike bazë e perceptueshme fizikisht, mbi të cilat është ndërtuar krahasimi.

Ndërtimet leksikore të kësaj natyre janë produkt i drejtpërdrejtë i folësve dhe rrethanave konkrete jetësore, diktuar drejtpërdrejt nga kushtet natyrore të mjedisit, mënyra e jetesës apo mënyrat e sjelljes së individëve.

Figurshmëria dhe kuptimi i ri i fituar ka rritur aftësinë shprehëse të fjalës, sikundër e ka pasuruar me një kuptim të përforcuar dhe me ngjyrim të ri emocionues.

Treguesit cilësorë, që janë përdorur si temë semantike për të ndërtuar njësi të

prejardhura kuptimore, shënojnë tipare të jashtme të fytyrës apo trupit të njeriut si ngjyra, gjatësia, madhësia, mprehtësia dhe përbërësit nominalë të përcaktuar më shpesh janë *qafë, kokë, sy, buzë, hundë, bark* etj. Mënyrat se si shqipfolësit i kanë dalluar dhe përzgjedhur realiet mbi bazat e kategorizimeve të treguesve mbizotëruesë është shumë interesante dhe është pashmangshmërisht e përligjur me mënyrën se si këta folës e kanë perceptuar këtë realitet, andaj referentët e përzgjedhur jo rastësisht mbartin tipare të përgjithësuara.

Shndërrimet metaforike të këtyre njësive jo vetëm që rritin figurshmërinë dhe mjetet shprehëse të gjuhës, por edhe dëshmojnë për një njohje të plotë të të gjithë treguesve të realies nga bashkësia folëse, njohje e cila duket të jetë krahasimisht e njëjtë, përderisa në areale të ndryshme gjeografike folësit e kanë prerë realitetin në mënyrë të ngjashme dhe kanë zbuluar tipare të njëjta mbizotëruese të realieve për t'i bërë objekt identifikimi. Ja se si e ka zhbirruar konkretisht realitetin entiteti shqipfolës: treguesin cilësor të gjatësisë dhe formës e ka shprehur figurshmërisht përmes metaforës *qafëlejlek* "me qafë të hollë, të gjatë si të lejlekut", ku referenti që ka shërbyer si objekt krahasimi është *lejlek* "shpend me *qafë* dhe sqep *të gjatë*". E njëjta cilësi është identifikuar edhe në rastin e kompozitës *qafëpatë* "me qafë të gjatë dhe të bardhë si të patës", me ndryshimn se referenti i krahasuar është një shpend tjetër, *patë* "shpend i butë a i egër, me *qafë të gjatë* dhe me këmbë në trajtë të pëllëmbës". Në të njëjtën mënyrë është perceptuar imazhi në rastin e leksemës *qafësorkadhe* "me qafë të hajshme e të bukur", ku referenti është përsëri një frymor kafshë, *sorkadhe* "gjitar dythundrak me brirë dhe qafë *të gjatë*". Leksema *kokëbuall* "me kokë të madhe si të buallit", është shenjuar materialisht duke marrë për bazë një tjetër tipar, atë të madhësisë, dhe elementi i krahasuar është marrë përsëri nga bota e kafshëve *buall* "kafshë shtëpiake me trup më *të madh* se te kaut" me dallimin e vetëm se treguesi mbizotërues i formës është transferuar instiktivisht dhe qëllimisht te pjesa më dalluese e trupit të njeriut: *koka*. I njëjti arsyetim vlen edhe për përzgjedhjen *kokëlopë* "me kokë të madhe" me dallimin e vetëm se referenti i krahasuar është një kafshë tjetër, por që në perceptimin e përgjithshëm dallohet për trupin e madh dhe të rëndë. Kompozita *kokëdele* "me flokë të bardhë që në lindje, i thinjur" ka kaluar nëpërmjet një niveli tjetër abstragimi: ngjyra si tregues cilësor identifikues për këtë kafshë, nëpërmjet metaforizimit i është veshur njeriut.

Te kompozitat mbiemërore me përbërës fjalën *sy*, përkatësisht *symëshqerë* "me sy të mëdhenj e me shprehje të butë dhe të ëmbël" dhe *sypetrit/ shqiponjë* "me sy të mprehtë dhe të fortë" butësia dhe mprehtësia janë njehësuar figurativisht me dy kafshë të zgjedhuar qëllimisht nga folësit mbi bazën e tërësisë së perceptimeve që kanë ndërtuar mbi këto realie shumë të njohura për ta. Vlerat shprehëse të këtyre krijimeve origjinale dallohet dukshëm edhe në rastet e kompozitave të mëposhtme, ku tiparet e gjatësisë, trashësisë, formës dhe ngjyrës janë transformuar metaforikisht dhe përzgjedhja e referentëve është origjinale, e motivueshme, e perceptueshme lehtësisht mendërisht, sepse realiet e përcaktuara i mbartin më së miri vlerat dalluese të klasës që ata përfaqësojnë.

Duke i analizuar referentët rast pas rasti vërejmë se për kompozitën *buzëviç* "me buzë të trasha e të gjera si referent ka shërbyer fjala *viç*; *qafëderr* "me qafë të trashë dhe të shkurtër, shumë i shëndoshë" krahasimi është ndërtuar mbi

fjalën *derr* “kafshë shtëpiake me trup dhe qafë të trashë”; *hundëshqiponjë* “që e ka hundën të kthyer si sqepi i shqiponjës” nga *shqiponjë* “shpend i madh grabitqar me sqep të kthyer e me sy të mprehtë”; *vetullsorë* “që i ka vetullat e zeza si pendët e sorrës” nga *sorrë* “shpend me pendë të zeza dhe sqep të kthyer”; *mjekërcjap* “që e ka mjekrën të gjatë dhe me majë, mjekërgjatë” nga *cjap* “kafshë me lesh të gjatë dhe të ashpër”; *barkzhabë* “që e ka barkun të madh, të fryrë dhe të squllët” nga zhabë “kafshë e vogël me trup të gjerë dhe këmbë të gjata” etj. Vihet re se edhe pse kompozitat e sipërpërmendura nga pikëpamja e strukturës kuptimore janë në vetvete realizime leksikore të metaforizuara figurativisht, në mjaft raste u është rritur aftësia shprehëse duke iu mbivendosur një kuptim të ri të figurshëm leksikor çka bën që për nga fusha leksikore e njësive që cilësojnë tipare fizike të jashtme të frymorëve, të kategorizohen si leksema që shprehin cilësi karakteriale të tipit *syshqiponjë* “trim, guximtar”, *kokëlopë* “i trashë nga mendja”, *kokëmushkë* “kokëfortë”, *buzëviç* “jo i zgjuar, i trashë”, *gojëbilbil* “që flet gjithmonë me fjalë të ëmbla dhe të mira” etj.

Në disa raste krahasimi i metaforizuar ka bërë që ndërmjetimi i tipareve të mos bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, si në shembujt e përmendur më lart, por në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke dëshmuar një shkallë shumë të lartë abstragimi të imazhit të cilësuar. Këto kompozita nuk mund të zbërthehen si struktura me marrëdhënie përkitësie, por mund të shpjegohen kuptimisht me anë të sinonimeve leksikore përkatëse, kryesisht mbiemra. Kështu *shpirtujk/shpirtqen* nuk zbërthehet semantikisht “që e ka shpirtin si të qenit/ të ujkut”, por “që është shpirtlig, shpirtkeq, i pamëshirshëm”, e kështu me radhë: *këmbëlepur* “këmbëshpejtë, që vrapon shpejt”, *gojënepërkë/gjuhënepërkë* “që flet keq, që i merr të tjerët nëpër gojë”, *barkbuall* “i pangopur, hamës i madh”, *kokëmushkë* “i pabindur, kryeneç”, *gojëgjarpër* “gjuhëhelm, që sulmon të tjerët me fjalë therrëse”, *gjumëlepur* “që e ka gjumin shumë të lehtë, që fle me merak”, *zemërpulë* “që trembet lehtë, që nuk ka guxim”, *zemërqen* “që nuk ndien dhembje, i pamëshirshëm, mizor”. Në këtë kontekst, vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e këtyre kompozitave mbartin nuanca të konotacionit negativ.

**b**-Një tip mjaft të pasur përbëjnë edhe kompozitat mbiemërore, të cilat raportin e krahasimit e ndërtojnë mbi bazën e asosacionit me tipare të dukshme të referentit që mund të jetë një lule, bimë apo frut: trëndelinë, bozhure, burbuqe, trandafil, shegë, piperkë, mollë, patate, patëllxhan, spec, pjeshkë, portokall, rrush, kaçka (arra), bajame, manushaqe, qershi, lule etj. Sipas këtij kriteri janë klasifikuar kompozitat e mëposhtme: *leshbozhure, leshratrëndelinë, buzëburbuqe, buzë trëndafile, buzëkarafile, buzëshegë, gojëmarraqkë, gojëpiperkë, kokëgorricë, kokëmollë, dorëpiper, hundëpatate, hundëpatëllxhan, hundëspec, faqemollë, faqerrush, sykaçkë, sybajame, symanu shaqe, syqershi, qimegështenjë,* etj.

Të gjithë shembujt e lartpërmendur kanë ngjyrime të dukshme emocionuese dhe, nga pikëpamja e motivimit të brendshëm kuptimor, ato shprehin cilësi të lidhura me pamjen e jashtme ku vlerat kuptimore e ngjyrimet emocionuese i ka gjymtyra e dytë, si një referent që mbart të gjitha tiparet e qenësishme. Të marra së bashku, ato krijojnë një fushë të gjerë konceptore të tipareve fizike, kryesisht të lidhuara me pjesë të fytyrës. Shqipfolësit i kanë marrë realiet e krahasuara që kanë prodhuar edhe bërthamën e çerdhes leksikore të këtyre njësive nga qasja e drejtpërdrejtë dhe njohja e plotë me realitetin, prandaj këto kompozita

tingëllojnë shumë të thjeshta dhe të natyrshme dhe përligjen bindshëm me veçoritë dhe ligjësitë e brendshme të fjalëformimit të shqipes. Këto kompozita, fryt i perceptimit të imazhit dhe përfytyrimit popullor si pasuri e gurrës popullore, u janë atribuar kryesisht vajzës, gruas, shoqes dhe mikes, si *buzëtrëndafile* "që i ka buzët e kuqe si trëndafili" dhe me një sërë lulesh, si: *burbuqe, trëndelinë, karafil, manushaqe, bozhure* etj., duke krahasuar, sipas rastit, herë ngjyrën, herë formën dhe herë me aromën tyre.

Të gjithë shembujt e lartpërmendur mbartin nuanca të dukshme konotative dhe, nga pikëpamja e përmbajtjes semantike, ato shprehin cilësi të lidhura pamjen e jashtme dhe vlerat kuptimore i mbart gjymtyra e dytë, një referent që mbart të gjitha tiparet dalluese. Po kaq të afërta dhe të ngrohta janë kompozitat e formësuara gjuhësisht mbi bazën e referentëve *fruta* në njësi të tilla me konotacion pozitiv, si: *faqemollë* "që i ka faqet e kuqe dhe të mbushura, që i ka faqet si mollë"; *faqeshegë* "që i ka faqet e kuqe si shegë, që është plot shëndet"; *buzëqershi* "që i ka buzët e vogla dhe me ngjyrë të kuqe" e duke vijuar me referentë të tjerë, si: *bajame, kaçkë, rrush, portokalle*, etj.

Por jo të gjitha referencat përkundrejt këtyre realieve kanë përftuar kompozita mbiemra që shprehin qëndrim subjektiv pozitiv apo tipare cilësisht të pëlqyeshme. Nën këtë arsyetim mund të përmendim kompozitat *kokëshinik* "që e ka kokën shumë të madhe"; *hundëpatate* "që e ka hundën të madhe" (me të njëjtin kuptim është përdorur edhe *hundëpatëllxhan*); *hundëspec* "që e ka hundën të kuqe"; *buzëmushkë* "që i ka buzët e mëdha dhe të përveshura"; *gojëmaraq* "i belbër, që i mbahet goja kur flet"; *kokëkungull* "që e ka kokën të madhe dhe të gjatë si të kungullit) etj.

Lëvizjet kuptimore me bazë tropet gjuhësore (në shumicën e rasteve me metaforë) ka bërë që edhe ky grup kompozitash të shoqërohen me zgjerim të strukturës kuptimore, ku kuptimit të parmë i është pranëvënë edhe një kuptim i figurshëm, i cili nuk mund të zbërthehet në përbërës kuptimorë që shprehin marrëdhënie përkitësie si në strukturat e përmendura më lart, por është sendërtuar materialisht mbi bazën e një imazhi psikik më të ndërlikuar, i cili perceptohet mbi bazën e parimeve të brendshme të zhvillimit mendor të folësve dhe çkodohet individualisht duke prodhuar kuptime të tilla të metaforizuara. Kompozitat e poshtëshënuara e kanë marrë kuptimin leksikor të figurshëm falë këtij procesi ndërmjetimi: *kokëshinik* "kokëngjeshur, kokëfortë"; *hundëspec* "që kërkon të grindet, grindavec"; *gojëpiperkë/gojëspec* "që flet fjalë therrëse, që thumbon me fjalë"; *dorëpiper* "që është i prapë, që nuk lë gjë pa lëvizur", *gojësheqer/gojëmjaltë* "që flet butë dhe shtruar, gojëmbël"; *kokëkungull* "I trashë nga mendja, kokëtul" etj. Edhe këtu përftesat vijnë nga ndërtime të tilla, si: *që i ka buzët si burbuqe, që e ka hundën si patate, që e ka gojën si piperkë* etj.

**c-**Motivimi i brendshëm kuptimor mund të shfaqet dhe në tipa të tjera kompozitash, kur realia e krahasuar është një objekt, send apo material konkret: *gur, calik, kacek, ledh, vozë, shpatë, kuti, brisk, bucelë, kamare, fyell, rrotë, sepete, cung, penë, lopatë, sqepar, sharrë, rrogoz* etj. Referentët janë pëzgjedhur nga fushat konceptore të veshjeve, pajisjeve të punës, materialeve të përdorura në jetën e përditshme etj., ndërsa tiparet e krahasuara lidhen me cilësi fizike të realies. Si të tilla mund të përmendim: *leshgur, leshmëndafshi, leshratendë, barkcalik, barkdërrasë, barkkacek, barkvozë, gojë-shpatë, gojëkuti/kutizë, gojëbrisk,*

*gojëcorap, qafëdrapër, qafëgastare, vetullgjilpërë, vetullkalem, kokëbucelë, kokëdru, kokëfyell, kokëgaruzhde, kokërrotë, kokësepete, kokëtrung, kokëgdhë, kokëdaulle, bishtlopatë, dhëmbësqepar, dhëmbësharrë, hundëbri, faqerrogoz* etj.

Në mendësinë dhe përvojën kolektive të folësve të gjuhës shqipe realiet e përzgjedhura, tiparet e të cilave qëndrojnë në thelb të bërthamës kuptimore që formëson njësitë e metaforizuara, e mishërojnë dhe e transmetojnë më së miri tiparin e qenësishëm që i identifikon ato, edhe për faktin se këto realie janë provë e njohjes konkrete që ata kanë me ata çka i rrethon, ndaj edhe këto struktura i rrinë kaq mirë dhe i vijnë kaq për shtat shqipes. Duke i njohur me hollësi të gjithë treguesit e realies, folësit e shqipes i shndërrojnë natyrshëm këto njësi në konstrukte semantikisht të figurshme. Metafora është kaq e fuqishme në të gjitha rastet e poshtëshënuara, sepse buron së brendshmi dhe merr jetë nga qasjet dhe perceptimet e ngushta, të përditshme të realitetit. Të gjithë referentët u përkasin kulturës materiale, karakterit bujqësor dhe blegtoral të jetës së banorëve, të gjitha të prekshme, të kapshme, konkrete dhe të nevojshme.

Ndër të tjera, duhet theksuar fakti se një pjesë e leksemave që u përgjigjen referentëve të cilësuar i përket lëndës gjuhësore të fondit të vjetër të leksikut popullor apo një leksiku më të specializuar, por që gjallon në letërsinë artistike dhe në folklor. Cilësitë e transferuara figurshmërisht janë të lidhura kryesisht me treguesit e fortësisë, formës, ashpërsisë apo butësisë si,p.sh.: *barkcalik / barkacek* "barkfryrë", në të cilat referenti është një objekt konkret *calik-kacek/shakull* dhe cilësia e shprehur është *fortësia*; *barkdërrasë* "që e ka barkun të tharë e të futur nga të pangrënit", ku krahasimi bëhet me realien *dërrasë* "fletë prej druri që nxirret duke sharruar një trung" dhe cilësia është dobësia trupore; *qafëcungal* "që e ka qafën të shkurtër dhe të trashë", ku krahasimi bëhet me realien *cungal* "dru i shkurtër që vihet mbi trarët e çatisë", dhe cilësia është gjatësia; *qafëgastare* "që e ka qafën të hollë dhe të gjatë", ku referenti është *gastare* "enë prej qelqi, gotë, shishe" dhe cilësia e krahasuar është gjatësia; *qafëdrapër* "që e ka qafën të shtrëmbër", përbërësi i realies krahasohet me drapër "vegël bujqësore me presë si hark" cilësia është forma; *vetullgjilpërë* "që i ka vetullat shumë të holla", krahasimi bëhet sipas formës së referentit *gjilpërë* "fill i hollë çeliku me majë të mprehtë"; *vetullkurorë* "që i ka vetullat si hark", ku përsëri treguesi i formës është shprehur në mënyrë të figurshme duke u krahasuar me *kurorë* "rreth i thurrur me degë a me lule"; *leshmëndafshi* "që i ka flokët të butë", ku butësia dhe shkëlqimi janë cilësitë e krahasuara në këtë rast me një realien *mëndafsh* "fije të holla dhe të shndritshme"; *dhëmbëbrisk* "që i ka dhëmbët shumë të mprehtë", në të cilën fortësia dhe mprehtësia janë nxjerrë si tipare dalluese përmes krahasimit me *brisk* "thikë çeliku me teh shumë të mprehtë"; *këmbëqiri* "që i ka këmbët e holla, të gjata dhe të drejta", ku si referent për formën dhe trashësinë ka shërbyer realia *qiri* "shkop i drejtë prej dylli a dhjami që ndizet për të bërë dritë" etj.

Shkalla e abstragimit dhe niveli i ndërmjetimit, të para në planin krahasues me kompozitat e lartpërmendura, është më i theksuar dhe më mbizotërues te kompozitat, në të cilat gjymtyra përcaktore që mbart ngarkesën plotësuese është emër, kuptimi leksikor i të cilit, i veshur edhe me mbishtresimin konotativ, përftohet mbi bazën konkrete sendore-konceptore të referentëve me cilësi

veçanërisht të dallueshme për mendësinë e përzgjedhësve të këtyre njësive.

Karakteri idiomatik është më i theksuar te strukturat e mëposhtme dhe ngarkesa semantike është më e madhe, pavarësisht se cilësimi i realies nuk është shënuar formalisht në mënyrë të drejtpërdrejtë *zemërkëllirë, zemërakull, zemërflori, zemërçelik, zemërshkëmb, zemërgur, zemërhekur, zemërkëllirë, zemrëkatran, buzëshkrumb, dorëflori, shpirtgur zemërhekur* etj. Vëllimi semantik i këtyre ndërtimeve leksikore është edhe më i theksuar për shkak se vetë gjymtyra përcaktuese është një emër që, për vetë shkallën e përgjithësimit që ka, i mbart në vetvete të gjitha tiparet.

Me të gjitha rastet metafora shënon vlera të absolutizuara që realia e shprehur me gjymtyrën përcaktuese ia transmeton edhe elementit të përcaktuar. Edhe ky proces gjuhësor është i lidhur ngushtë me procesin e njohjes dhe të bashkëshoqërimit të imazheve të abstraguara me konceptin dhe veshjen tingullore përkatëse.

Leksemat e përzgjedhura kanë kuptim të drejtpërdrejtë të intensifikuar dhe koncepti i përtëritur përshfaqet në gjuhë nëpërmjet realizi meve konkrete të këtyre kompozitave.

Bërthama semantike e këtyre krijimeve qëndron te njëri element, i cili natyrshëm ia transferon vlerat e amplifikuara elementit tjetër. Kështu ka ndodhur me kuptimin tërësor të kompozitës *zemërkëllirë*, e përftuar mbi temën semantike të emrit *këllirë* "papastërti, zhul" ku transferimi i imazhit të perceptuar mendërisht është bërë natyrshëm dhe organikisht për shkak të zgjedhje së duhur të bazës lëndore.

Nëpër të njëjtin proces ka kaluar *zemërakull-* nga *akull*, një metaforë e hiperbolizuar. Treguesit e vlerës, rëndësisë, forcës, ashpërsisë, ligësisë etj., janë shprehur metaforikisht me leksemat *flori* "monedhë ari me vlerë të çmuar"; çelik "metal i fortë"; *shkëmb* "gur shumë i madh dhe i fortë"; *hekur* "metal i rëndë"; katran "lëng i trashë me ngjyrë të zezë"; *shkrumb* "lëndë e zezë që mbetet kur digjen plotësisht sende të ndryshme"; *gur* "lëndë minerare e fortë dhe e patretshme në ujë" etj.

**ç.** Figurat e besimit popullor zakonor, fetar dhe ato të demonologjisë kanë shërbyer edhe si objekt krahasimi në përftimin e një numri kompozitash mbiemra, ku cilësitë e përzgjedhuara janë të hamendësuara, jokonkrete, joreale dhe jo të prekshme, por ato mbartin vlera të theksuara kuptimore. Figurat janë marrë nga mitologjia, legjenda dhe folklori burimor, si: *kuçedër, shtrigë, stihi, lubi, djall, lugat, engjëll, arap* etj. Shembuj të tillë janë: *flokëkuçedër, flokështrigë, barkstihi, barklubi, shpirtdjall, shpirtlugat, sylugat, syengjëll, zemërdjall, zemërnjerkë, zemërshtrigë, gojënjerkë, flokarapi* etj. Karakteri i ndërmjetuar në këto njësi leksikore është më i theksuar për shkak se realiet e konceptuara janë më abstrakte dhe fryt i imagjinatës së shqipfolësve, të cilët, edhe pse nuk e kanë realizuar njohjen e këtyre realieve përmes përvojave reale të drejtpërdrejta, kanë arritur të çkodojnë me anë të tingujve të gjitha imazhet e perceptuara, duke dëshmuar në të njëjtën kohë se i kanë zbërthyer më së miri të gjithë treguesit e realieve, të cilat i kanë ndihmuar për t'i përfytyruar konceptualisht ashtu siç duhet dhe për t'i dhënë veshjen e duhur tingullore.

Edhe në këto raste procesi i emërtimit është i motivuar dhe mund të argumentohet si më poshtë: për kompozitat *flokëkuçedër, flokështrigë* dhe *flokarapi*, është tipari i flokëve të çrregullt, që u atribuohet njerëzve të gjinisë femërore. Edhe figurat e krahasuara të krijimtarisë popullore janë përfytyruar si

krijesa femërore, përkatësisht, *shtrigë* "plakë e keqe dhe e shëmtuar" apo dhe me kuptimin e metaforizuar "grua a plakë e vetmuar dhe e keqe "; *kuçedër* "gjarpër i madh me dy dhe trembëdhjetë kokë" dhe me kuptimin e figurshëm "grua zemërligë". Më të ngarkuara emocionalisht janë kompozitat *zemërnjerkë, zemërshtrigë, zemërdjall, shpirtlugat*, të cilat i lidh një temë semantike "shpirtkeq, zemërkeq" dhe refrentët e zgjedhur si subjekt për të realizuar krahasimin janë *djall* "qenie e mbinatyrshme e përfytyruar si sinonim i së keqes"; *shtrigë* "figurë e besimeve popullore që ha njerëz dhe bën magji të liga"; lugat "figurë e besimit popullor i cili në gjallje është shumë i keq dhe pas vdekjes ngrihet dhe tremb njerëzit".

**Përfundime**

Analiza e kompozitave, si një nga mjetet më të fuqishme të pasurimit të leksikut të shqipes, na jep mundësi të shqyrtojmë nga pikëpamja praktike se dukuritë gjuhësore janë të lidhuara njëkohësisht me rrafshin e realitetit dhe të mendimit, me mënyrën se si një bashkësi gjuhësore e abstragon realitetin duke nxjerrë në pah tipare të veçanta të realieve, me mjetet që kjo bashkësi përzgjedh për të përpunuar formën e shprehjes, imazhet psikike që folësit sendërtojnë gjatë procesit të pështfaqjes së koncepteve, me përfytyrimin që kanë këta të fundit për botën që i rrethon duke "prodhuar" një shumësi shenjash të ndryshme, origjinale dhe lehtësisht të dallueshme nga njëra tjetra. Dhe, në këtë kontekst, nuk mund të lihet pa përmendur fakti se këto shenja gjuhësore formojnë një varg të zgjeruar sinonimik.

Të njëjtat njësi formojnë një tërësi fushash konceptore dhe leksikore të bazuara te treguesit themelorë të realies, të përzgjedhur dhe të sintetizuar mendërisht në bazë të perceptimeve të ndryshme që folësit zgjedhin për të asociuar simbolikën tingullore me një përkatësi "natyrore" të përmbajtjes së fjalës. Në rastin e kompozitave "substanca kuptimore" e lidhur me tërësinë e perceptimeve, qëndrimeve subjektive të folësve, ndjenjave dhe abstragimeve mendore, është e ndryshme.

Përdorimi i një spektri të gjerë kompozitash nga fondi burimor i shqipes, veçanërisht leksiku popullor, ai dialektor apo krahinor, dëshmon pë karakterin e thellë krijues të gjuhë shqipe, përshfaqen në variacione dhe përthyerje të efektshme, shmangin monotoninë dhe përsëritjen, gjallërojnë stilin, përsosin mjete të fuqishme të përdorimit figurativ, duke paraqitur një qerthull mundësish për të konktetizuar dhe përgjithësuar dëshirat, qëndrimet dhe vlerësimet e individëve folës të gjuhës. Sinonimia është përftuar duke shfrytëzuar me përpikmëri ngjyrimet dhe nuancat, duke i plotësuar me konotacion shtesë tipare karakteristike të ligjërimit të thjeshtë (thjeshtligjëri mit). Së bashku me tipat dhe gjedhet fjalëformuese të "brumit të shqipes" vërehet se në këto raste është rritur shkalla e abstragimit dhe janë përtëritur format e shprehjes.

**Bibliografi e shfrytëzuar**

Cipo K. (1972). *Rreth disa kompozitave*. Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I. Tiranë.
*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*.(1980),Tiranë.
*Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe*. (1996) Tiranë.

Jashari A. (2003).*Përsiatje për gjuhën shqipe*. Korçë.
Kostallari A. (1972).*Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë.
Thomai J. (1989).*Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*. Akademia e Shkencave, Tiranë.
Thomai J. (2001).*Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*. Tiranë.
Thomai J. (1999).*Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë.
Xhuvani A. (1980).*Kompozitat*, Vepra, 1, Akademia e Shkencave, Tiranë.

# TEORIA E AKTEVE TË TË FOLURIT. SHQYRTIM TEORIK

**ALMA POGONI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Punimi synon një përmbledhje dhe analizën e disa prej teorive të quajtura "tradicionale" të zhvilluara në fushë të studimit të akteve të të folurit. Teoria e akteve të të folurit (Speech Act Theory; SAT) njihet sot si një nga teoritë më të reja dhe gjithashtu, edhe më të diskutuara në fushë të studimeve gjuhësore më saktë, si teoria që zgjoi interesin më të madh nga të gjitha çështjet e teorisë së përgjithshme të përdorimit të gjuhës.

Njësia e bashkëveprimit apo e komunikimit gjuhësor nuk është, sikurse është pretenduar, fjala apo fjalia, por realizimi i fjalës apo fjalisë në performimin e një akti të foluri. Kjo do të thotë se realizimi i një fjalie në kushte të caktuara përbën një akt të foluri dhe aktet e të folurit (aktet ilokutive) janë njësitë bazë ose minimale të ndërveprimit gjuhësor. Shumë studiues kanë sugjeruar kriteret dhe klasifikimet e tyre për aktet e të folurit (kryesisht duke mbështetur apo kundërshtuar klasifikimin e Sërlit).

Në përgjithësi studiuesit bien dakort në faktin se klasifikimi i akteve të të folurit shpesh paraqitet i vështirë dhe madje, se është gati e pamundur të arrihet ky klasifikim për të gjitha llojet e thënieve, sidomos kur numri i kritereve dhe numri i klasave është relativisht i vogël.

Megjithatë, studimet praktike në këtë fushë kanë nxjerrë si vështirësi më të qenësishme mbështetjen e këtyre teorive mbi përcaktimin e kushteve të mjaftueshme dhe të domosdoshme për klasifikimin e akteve të të folurit, mbështetje, që konsiderohet gjithmonë edhe më e lëkundur në raport me disa tori të tjera që gjejnë reflektim mbi teoritë e përgjithshme të njohjes njerëzore.

***Fjalët çelës***: *teoria e akteve të të folurit, teorik, ilokutiv, klasifikim, kushte.*

**Abstract**

This study aims at an overview and analysis of some of the theories called "traditional", developed in the field of study of speech acts. Speech Act Theory (SAT), is known today as one of the most innovative and also debatable theories in the field of linguistic studies; precisely is considered as the theory that aroused the greatest interest of all matters of the general theory of language use.

Unit interaction or linguistic communication is not, as claimed, the word or sentence, but the realization of the word or sentence in the performance of a speech act. In other words, the realization of a sentence in certain circumstances constitutes a speech act and speech acts (ilocutionary acts) that are basic or minimal units of the linguistic interaction.

Many researchers have suggested their criteria and classifications of speech acts (mainly supporting or opposing Searle's classification). Generally, they agree on the fact that the classification of speech acts often appears difficult and even, it is almost impossible to achieve this classification for all types of claims, especially when the number of criteria and the number of classes is relatively small.

However, practical studies in this field have drawn as the most inherent difficulty, the support of these theories upon the determination of necessary and sufficient conditions for the classification of speech acts, a support, that is always considered less solid even in relation to some other theories that find reflection on the general theories of human cognition.

***Keywords:*** SAT, illocutionary, theoric, taxonomy, conditions.

Ky shqyrtim teorik përmbledh një pjesë të rëndësishme të rrugëtimit filozofiko-gjuhësor, duke bërë një paraqitje të zhvillimeve që ndodhën në degëzimin e filozofisë me origjinë në traditën britanike të të menduarit për gjuhën, e njohur më vonë si *Teoria e aktit të të folurit (Speech Act Theory; SAT),* e cila pati një ndikim të madh në filozofinë e gjuhës, rrjedhimisht në gjuhësi dhe sidomos në fushën e pragmatikës, por jo vetëm, ajo ndikoi edhe në disiplina të tjera, si shkenca të njohjes, psikolinguistikë, sociolinguistikë dhe antropologji.

Pragmatika është "niveli i tretë përbërës i gjuhësisë", duke qenë se dy të parët konsiderohen sintaksa dhe semantika. Ideja e përgjithshme që mbizotëron njohjen për këtë disiplinë është se ajo ka lindur së fundmi, ka pasur një përhapje të shpejtë dhe nuk ka shumë histori për të folur. Sidoqoftë, kjo e fundit është e gabuar, pasi rrënjët e disiplinave në dukje të reja janë më të thella nga sa kërkohen në të vërtetë në histori. Kështu, pragmatika është zhvilluar prej interesit për gjuhën në qarqet filozofike, por duhen pasur parasysh edhe rrënjët e saj të shtrira në gjuhësi dhe në psikologji.

Teoria e akteve të të folurit, sipas Levinsonit (Levinson, 1983, p. 226), është teoria  që zgjoi interesin më të madh nga të gjitha çështjet e teorisë së përgjithshme të përdorimit të gjuhës. Të gjitha ndërveprimet gjuhësore përmbajnë në vetvete akte të foluri. Njësia e bashkëveprimit apo e komunikimit gjuhësor nuk është, sikurse është pretenduar, fjala apo fjalia, por realizimi i fjalës apo fjalisë në performimin e një akti të foluri. Thënë ndryshe, realizimi i një fjalie në kushte të caktuara përbën një akt të foluri dhe aktet e të folurit (aktet ilokutive) janë njësitë bazë ose minimale të ndërveprimit gjuhësor.

**Vitgenshtajni dhe lindja e konceptit të aktit të të folurit**

Duke filluar nga L. Vitgenshtajni (Ludwig Wittgenstein) filozofët nisën të studiojnë dhe të analizojnë gjuhën e përditshme dhe kuptimet e saj. Analiza e Vitgenshtajnit te *"Hulumtime filozofike"* (Philosophical Investigations, 1953) vendos në qendër gjuhën e përdorimit të përditshëm dhe funksionin e saj duke hequr dorë nga ndërtimi i një gjuhe ideale si nevojë për shprehjen filozofike[1].

"Kur flas për gjuhën (fjalë, fjali etj.) e kam fjalën për gjuhën e përditshme. Por, mos vallë kjo gjuhë është shumë e rëndomtë dhe materiale për ato që na duhet të themi? Por, si do të ishte një tjetër gjuhë që do të mund të ndërtonim?

[1] Këta filozofë zhvilluan teoritë e tyre si kundërshtim i një shkolle tjetër filozofike, asaj të Pozitivizmit logjik. Pozitivizmi logjik u zhvillua si drejtim filozofik prej një grupi filozofësh të quajtur *Rrethi i Vjenës* në vitet 1920 dhe 1930. Ata pranojnë si të vlefshme vetëm dijen (njohjen) shkencore dhe matematikore, ndaj "çdo pohim tjetër, i cili nuk mund të analizohet përmes logjikës ose eksperimentimit është i pakuptimtë". Kjo do të ishte privilegjimi i gjuhëve shkencore (logjike, matematikore) në raport me gjuhët natyrore. Sipas pozitivistëve logjikë, dija (njohja e botës) e vërtetë mund të arrihet vetëm nëpërmjet logjikës dhe vëzhgimit empirik; pohimet shkencore janë ose të vërteta, ose të gabuara dhe këto fakte mund të vërtetohen, ndërsa gjuhët natyrore janë të paqarta dhe shpesh, vetëm "dërdëllitje dhe konkluzione të pabazuara", ndaj gjuha e përditshme sipas tyre, do të ishte e dobishme vetëm për përdorim të  përditshëm dhe jo për mendime serioze.

Dhe a ka kuptim që ne të mos arrijmë të themi ato që duam me këtë gjuhë që kemi!?" (HP.I.120).

Në fillim të studimit "Hulumtime filozofike" Vitgenshtajni sjell në vëmendje mendimin e Shën Augustinit se fjalët emërtojnë objektet dhe fjalitë janë kombinime të emrave që i vendosen objekteve (*HP.I.1*), duke vazhduar se sistemi i komunikimit i përshkruar prej tij nuk përfaqëson në të vërtetetë atë që ne quajmë sot gjuhë. (HP.I.3) Në vazhdim Vitgenshtajni prezanton një term të ri, që do të zëvendësojë konceptimin e që ekzistonte deri në atë kohë në gjuhë, termin e *lojës gjuhësore (language-game).*

*"…Të mendosh (imagine) një gjuhë është të mendosh për një formë të jetës..."* (HP.I.19);

"…*Të folurit e një gjuhe është pjesë e një veprimtarie …* ." (HP.I.23).

Pra, këtu shfaqet një anë e re, e pastudiuar e gjuhës, gjuha si një lloj kuptimplotë i sjelljes njerëzore, si një mjet komunikimi, si një formë e veprimtarisë shoqërore (duke përmbysur pretendimin se format e jetës janë pjesë e gjuhës). Për Vitgenshtajnin zotërimi dhe përdorimi i një gjuhe përfshin të gjithë ndërliqësinë e praktikave shoqërore. Pra, koncepti i lojës gjuhësore është përdorur për të përfshirë në gjuhë si veprimtarinë gjuhësore (përdorimin e gjuhës), ashtu edhe veprimtarinë jogjuhësore si dhe çdo aktivitet tjetër parapërgatitor.

Në këtë mënyrë, teoria e Vitgenshtajnit do të kalojë nga një teori e kuptimit si përfaqësim i objektit në një teori të kuptimit të fjalës si përdorimi i saj dhe në këtë qasje pragmatike ndaj kuptimit, gramatika (studimi i gjuhës) përqendrohet si asnjëherë më parë në gjuhën reale, konkrete, në të cilën modelet dhe përdorimi i fjalëve (gjuhës) lidhet me praktikat shoqërore, siç ai i quan *forma të jetës (forms of life).*

"Në shumicën e rasteve, edhe pse jo në të gjitha rastet në të cilat flasim për kuptimin, mund të themi se kuptimi i një fjale është përdorimi i saj në gjuhë" (*HP.I.*43).

Ajo që Vitgenshtajni ka ndërmend me *"përdorim"* është kuptimi i fjalës, i cili varet nga konteksti dhe qëllimi i përdorimit të saj, duke përfshirë edhe rolin e mohuar deri më tani të pjesëmarrësve në ligjërim. Kështu, ai apelon kalimin nga një kuptim i vetëm ideal i sintaksës logjike në kuptime *të pafundme* të një gjuhe të gjallë.

Vitgenshtajni flet për një shumëllojshmëri të jashtëzakonshme të lojërave gjuhësore dhe formave të jetës. Në ilustrimet e tij për llojet e lojërave gjuhësore parashtrohen më së shumti shembuj që nuk janë përshkrues duke theksuar një fakt tjetër të rëndësishëm, atë që *gjuha nuk përdoret thjesht për të përshkruar*. Sipas tij, mënyrat e përdorimit (pra, jo thjesht përshkruese) të simboleve, fjalëve dhe fjalive, pra, "lojërat gjuhësore" nuk kanë të bëjnë me një set të pandryshueshëm tiparesh, por me një grup elementesh gjithmonë në lëvizje dhe që shfaqin ngjashmëri "farefisnore" me njëra-tjetrën.

"Por, sa lloje fjalish ka? ... Janë të panumërta llojet e tyre: lloje të panumërta dhe të ndryshme të përdorimit të atyre që i quajmë "simbole", "fjalë", "fjali"? Kjo shumëllojshmëri nuk është diçka e fiksuar, e dhënë njëherë e përgjithmonë; tipe të reja gjuhësh, lojëra të reja gjuhësore lindin, të tjera vjetërohen ose harrohen… ." (H.P.I. 23).

Llojet e ndryshme të "lojërave të ligjërimit", si p.sh., të dhënit e një urdhri, të përshkruarit e një objekti, të raportuarit e një ngjarjeje, të formuluarit e një hipoteze, të paraqiturit e rezultateve të një eksperimenti, të pyeturit, të falënderuarit, të luturit etj., të përmendura si shembuj pas këtij konstatimi të rëndësishëm janë

shumë të ngjashme me ato që më vonë do të quhen, *akte të foluri*.

**Ostini dhe teoria e akteve të të folurit**

Më 1950 Ostini (J. L. Austin) vendosi themelin për teorinë moderne të akteve të të folurit, e cila u zhvillua më vonë prej pasardhësit të tij, Sërlit (John Rogers Searle). Ostini përmendi termin *akt i të folurit* (Speech Act) në leksionet e tij në Oksford dhe Harvard. Në të vërtetë, ky term përdoret relativisht rrallë prej Ostinit dhe në rastet kur përdoret nuk është fort e qartë se çfarë përfshihet nën këtë term. Përdorimi i gjerë i këtij termi dhe sigurisht edhe qartësimi i dukurisë që shënon është meritë e Sërlit dhe librit të tij *"Aktet e të folurit: Një ese në filozofinë e gjuhës" ("Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language", 1969).*

Tema kryesore e Ostinit te *"Si të bësh gjëra me fjalët" ("How to do things with words", 1962)* është kalimi i dallimit të hershëm midis performueseve dhe konstatueseve në një teori të përgjithshme të akteve të të folurit. Ky dallim te Ostini mbështetet në analizën e kushteve të vërtetësisë/të pavërtetësisë në raport me kushtet e kënaqësisë/të pakënaqësisë, sikundër është paraqitur edhe në tabelën më poshtë:

***THËNIE***

| *JOPERFORMUESE (KONSTATUESE)* | *PERFORMUESE* |
|---|---|
| *thonë diçka* | *bëjnë diçka përmes të thënit* |
| *të vërteta /të pavërteta (true) / (false)* | *të kënaqura/të pakënaqura (happy) / (unhappy)* |

Ostini përdor një terminologji të posaçme për të analizuar më thellë veçoritë e performueseve. Sipas tij, në realizimin e një akti performues, në mënyrë që thënia të jetë "e kënaqur" (happy) duhet që të plotësohen një shumësi kushtesh. Sipas tij, do të mjaftonte zbatimi i gjashtë rregullave (të cilat ai i ka quajtur rregullat e performueses) që thënia të quhej "e kënaqur":

**A.1.** Duhet të ekzistojë një veprim konvencional me një ndikim të përcaktuar konvencional (të pranuar nga të gjithë). Ky veprim duhet të përfshijë shqiptimin e disa fjalëve të caktuara, nga persona të caktuar, në kushte të caktuara.

**A.2.** Personat dhe rrethanat e përcaktuara duhet të jenë të përshtatshme për të bërë të mundur kryerjen e veprimit.

**B.1.** Veprimi duhet të ndiqet (ekzekutohet) nga të gjithë pjesëmarrësit në mënyrën e duhur (e drejtë);

**B.2.** plotësisht.

**C.1.** Personat pjesëmarrës duhet të kenë mendimet dhe ndjenjat e duhura për ta përmbushur veprimin;

**C.2.** duhet që në këto mendime dhe ndjenja t'i çojnë drejt përfundimit të shprehur.

Në mungesë të kushteve të përshtatshme thënia mbetet "e pakënaqur" (unhappy). Ostini shtyhet më tej duke përcaktuar dallime të qarta midis rasteve të shkeljes së secilës rregulle. Dallimi më i madh paraqitet midis 4 rregullave të para dhe 2 të fundit duke i quajtur rastet e para *akte të dështuara* (missfire) dhe të dytat *abuzime* (abuses). Paraqitja e rasteve kur thënia mund të jetë "e pakënaqur" i ka dhënë formë asaj që Ostini e quan *doktrina e pakënaqësive* (Austin, 1962, p.16).

Dallimi i hershëm *("teoria e veçantë")* mendohej se shpërfaqte dallimin e thënieve, të cilat janë pohime ose përshkrime dhe thënieve, që ndryshojnë prej të parave dhe mund të jenë premtime, kërkesa, baste, paralajmërime etj. Por, në vazhdim të analizës del se rasti "i veçantë" i thënieve (performueset) përfshinte rastin "e përgjithshëm" të thënieve (konstatueset), të cilat (këto të fundit) del

se janë thjesht disa raste (midis të tjerave) të akteve të të folurit. Pikërisht këtë dallim, Ostini synon ta shtrijë në teorinë e përgjithshme të të folurit si dallim midis akteve lokutive dhe akteve ilokutive, për t'i shtuar më pas edhe krahasimin e dy të parave me një akt të tretë, atë perlokutiv. Pra, për Ostinin në shqiptimin e një thënieje vërejmë 3 akte të ndryshëm dhe të dallueshëm nga njëri-tjetri:

***a. Akti lokutiv*** është akti i të shqiptuarit të një shprehjeje të kuptimshme, me një farë kuptimi dhe referimi (Austin, 1962, p.108) (sense and reference), d.m.th., akti i të thënit të diçkaje sipas rregullave të një gjuhe. Ostini e analizon aktin lokutiv duke bërë tri dallime të përgjithshme midis aktit fonetik (phonetic), retik (rhetic) dhe fatik (phatic).

**-** *Akti fonetik* është akti i të shqiptuarit të disa zhurmave (tingujve);

**-** *Akti fatik* është shqiptimi i fjalëve të caktuara, pra i tingujve të disa llojeve, që i përkasin një fjalori të caktuar, apo përputhen me një gramatikë të caktuar;

**-** *Akti retik* është përdorimi i këtyre fjalëve me një domethënie dhe referencë të përcaktuar ose pothuajse të përcaktuar (Austin, 1962, pp. 95-96). Të marra së bashku këto formojnë aktin lokutiv, ndërsa secili prej tyre është një abstraksion sikundër janë edhe vetë akti lokutiv dhe ilokutiv.

***b. Akti ilokutiv*** është akti i synuar prej folësit, është shprehje, e cila ka një lloj force konvencionale. Ai realizohet (performohet) me anë të shqiptimit të thënies dhe është vetë forca apo funksioni i saj. Akti ilokutiv është të shpallurit, të urdhëruarit, të paralajmëruarit, të premtuarit etj.

Sipas Ostinit, dallimi midis aktit lokutiv dhe atij ilokutiv ishte dallimi midis të shprehurit (uttering) e një fjalie me një kuptim të caktuar (sense and reference) dhe të realizuarit e një fjalie me një forcë të caktuar. Akti lokutiv, ashtu si akti ilokutiv nuk është gjë tjetër veç një abstraksion: çdo akt i vërtetë i të folurit është lokutiv dhe ilokutiv. Për më tepër, duhet të shmanget ideja që mund të krijohet se akti ilokutiv është pasojë e aktit lokutiv dhe gjithashtu, ideja se çfarë shprehet në përkufizimin e ilokutivit është një adresim shtesë për disa nga pasojat e lokutivit. Për të zbuluar rrugën deri tek ilokutivi nuk duhet që të kthehemi nga ai tek akti fonetik dhe më pas tek një akt fizik minimal në të njëjtën mënyrë siç mund të kthehemi nga gjuajtja e lepurit tek tërheqja e këmbëzës së armës (Austin, 1962, pp. 113-114). Ajo që shprehet me aktin ilokutiv nuk është pasojë e lokutivit, por e marrëveshjes së forcës ilokutive e cila shfaqet në rrethana të veçanta të realizimit të thënies.

***c. Akti perlokutiv*** është ajo që ne shkaktojmë me të thënët e diçkaje, si p.sh., të bindim, të frenojmë, madje edhe të çuditim apo të mashtrojmë (Austin, 1962,p. 108), d.m.th., efekti i aktit ilokutiv. Sipas Levinsonit (Levinson, 1983, p. 236), perlokutivi është "arritja e efekteve te dëgjuesi (audience) me anë të shqiptimit të fjalisë, efekte, që përcaktohen nga rrethanat në të cilat realizohet thënia. Karakteristikë e aktit perlokutiv është që përgjigjja e marrë ose pasoja mund të arrihet (e tëra ose një pjesë e saj) pa mjete lokutive (pa shprehje gjuhësore). Kështu, mund ta frikësosh dikë duke tundur shkopin ose duke ia drejtuar armën (Austin, 1962, p. 108). Duhet dalluar ilokutivi nga perlokutivi, që do të thotë se duhet dalluar *"duke thënë diçka unë e kam paralajmëruar atë"* nga *"me të thënët e diçkaje unë e kam bindur atë, ose e kam bërë të ndalojë"* (Austin, 1962, p. 109). Ostini vë në dukje se, edhe pse i dallueshëm nga perlokutivi, akti ilokutiv është i lidhur me shkaktimin e pasojave në disa kuptime. Kështu, derisa të arrihet një

efekt i caktuar, akti ilokutiv nuk mund të quhet i performuar në mënyrë të suksesshme. Kjo nuk do të thotë se akti ilokutiv është arritja e një efekti të caktuar, pasi në përgjithësi, efekti i aktit ilokutiv do të thotë të arrihet të kuptuarit e asaj që synohet, pra të realizuarit e forcës së ilokutivit. Gjithashtu, shumë akte ilokutive provokojnë sipas marrëveshjes një përgjigje, kërkojnë kryerjen e një veprimi të dytë nga folësi apo dikush tjetër, por ky lloj akti, sado i lidhur qoftë me aktin ilokutiv është më se i dallueshëm prej tij dhe nuk mund të përfshihet në rrjedhën fillestare të veprimit. Në mënyrë konkrete këto dallime paraqiten në shembullin e dhënë nga vetë Ostini (Austin, 1962, pp. 101-102):

***Veprimi (A) ose Lokucioni***

*Ai më tha: "Qëlloji asaj!"*

***Veprimi (B) ose Ilokucioni***

*Ai më shtyu (nxiti, këshilloi, urdhëroi) t'i qëlloja asaj.*

***Veprimi (C. a) ose Perlokucioni***

*Ai më bindi t'i qëlloja asaj.*

***Veprimi (C. b)***

*Ai më bëri t'i qëlloja asaj.*

Veprimi ilokutiv madje edhe veprimi lokutiv përfshijnë marrëdhëniet, ndërsa veprimi perlokutiv përfshin atë që në një mënyrë janë pasojat. Efektet që rrjedhin nga veprimet perlokutive janë pasoja të vërteta, të cilat nuk përfshijnë efekte konvencionale.

Nën dritën e zhvillimeve të mëtejshme të teorisë së përgjithshme sipas Ostinit del në dukje nevoja për një listë të *"forcave ilokutive të një thënieje"* (Austin, 1962, p. 148-149), e cila së bashku me kriterin gramatikor të foljeve në vetën e parë njëjës, në të tashmen, dëftore, veprore, vendosen në bazë të klasifikimit të Ostinit për aktet ilokutive. Ostini përdor provat e bëra mbi performueset eksplicite, të cilat i shërbejnë (madje më mirë) klasifikimit të atyre foljeve që e bëjnë të dukshme forcën ilokutive të një thënieje, apo që përcaktojnë se ç'lloj akti ilokutiv përbën një thënie e caktuar. Kështu, ai dallon 5 grupe të mëdha të këtyre foljeve (Austin, 1962, p. 150):

**1. Vendimet** (verdictives) kanë të bëjnë me nxjerrjen e një përfundimi zyrtar ose jozyrtar (vlerësim, llogaritje ose njësim) mbi të dhëna ose vlerësime të fakteve, për aq kohë sa ato janë të dallueshme. Ky grup aktesh kanë një lidhje të dukshme me të vërtetën dhe të pavërtetën; saktësinë dhe pasaktësinë; drejtësinë dhe padrejtësinë. Një akt vendimi është një akt gjyqësor (juridik, kritik) në dallim nga legjislativi apo ekzekutivi, të cilët janë të dy akte ushtruese. Shembuj të vendimeve, sipas Ostinit janë thënie që përmbajnë folje si: *administroj, analizoj, besoj, caktoj shumën, çmoj, diskutoj, fajësoj (shpall fajtor), gjej (përcaktoj) vendndodhjen, klasifikoj, konstatoj, llogarit, marr masat, më duket se, numëroj, njoh, paguaj, qeveris, sistemoj, shqyrtoj, tipizoj, vendos, vlerësoj, zbërthej* etj.

**2. Ushtrueset** (exercitives) janë ushtrimi i forcës, të drejtave ose ndikimit. Një ushtruese është të dhënit e një vendimi pro apo kundër rrjedhës së një veprimi. Kemi të bëjmë me një vendim që diçka duhet të bëhet kështu, në dallim nga një gjykim që tregon se diçka është kështu; është një vendim dhe jo një vlerësim. Shembuj janë emërimi, votimi, urdhri, kërkesa, këshilla, paralajmërimi etj. dhe folje si, *adresoj, anuloj, bëj të ditur, caktoj, dirigjoj, dorëzoj, dhuroj, gjobit, hap, informoj, kërkoj, kushtoj, lë trashëgim, paguaj, pretendoj, prezantoj, rekomandoj, rekrutoj, sekuestroj, shfuqizoj, shkarkoj, shpall, urdhëroj, votoj, vë veto, zbuloj* etj.

**3. Parashtrueset** (commissives) përfshijnë premtimin ose ndryshe një lloj sipërmarrjeje për të bërë diçka; parakuptojnë angazhimin, por përshijnë edhe deklarimin apo shpalljen e qëllimit, të

cilat nuk janë premtime si dhe disa shprehje të paqarta, të cilat mund të quhen *"espousals".* Ato kanë lidhje të dukshme me gjykimet dhe ushtrueset. Shembuj janë: *adoptoj, angazhohem, betohem, bie dakord, birësoj, deklaroj synimet, detyrohem, favorizoj, garantoj, jap fjalën, kontraktoj, lidhem, marr për grua (burrë), nënkuptoj, ndërmarr, organizoj, përkrah, projektoj, premtoj, tërheq, ujdis, vë të betohet, zgjedh, zotohem* etj.

**4. Reagueset** (behabitives) përfshijnë nocionin e reagimit ndaj sjelljes dhe pozitës së njerëzve të tjerë dhe shprehjes së qëndrimeve ndaj mënyrave të shkuara ose të afërta të të sjellurit të dikujt. Ka lidhje të dukshme midis të pohuarit dhe të përshkruarit e ndjenjave tona dhe shprehjes apo shfrehjes së tyre. Shembuj janë të kërkuarit ndjesë, përgëzimi, vlerësimi, ngushëllimi, mallkimi (sharja) dhe të sfiduarit, pra, veprime që shprehen me folje të tilla si, *aprovoj, dënoj, duartrokas, falënderoj, favorizoj, kërkoj ndjesë, kritikoj, kundërshtoj, lavdëroj, mëshiroj, më vjen keq, mirëpres, ngre dolli (shëndet), ngushëlloj, nderoj, përcjell, përgëzoj, përkrah, përshëndes, qofsh bekuar (mallkuar), sfidoj (të), s'vë re, shfaq pakënaqësi, shfryj, shpërfill, uroj, vë faj* etj.

**5. Gjykimet** (expositives) janë të vështira për t'u përkufizuar. Ato e bëjnë të qartë (të plotë) sesi thënia jonë ndërfutet në rrjedhën e një argumenti apo bisede, si ne i përdorim fjalët, ose në përgjithësi janë përshkruese, shpjeguese. Gjykimet përdoren në akte të shpjegimit (parashtrimit) duke përfshirë parashtrimin e ideve, argumenteve dhe sqarimin e përdorimeve dhe referencës. Mbi këtë grup ekzistojnë mjaft debate për raste kur këto janë gjithashtu vendime, ushtruese, reaguese dhe parashtruese; si dhe raste të tjera kur ato mund të ngatërrohen me akte të thjeshta të përshkrimit të ndjenjave, veprimeve etj. Shembuj janë *argumentoj, akuzoj, caktoj, çmoj, besoj, dalloj, druaj, dyshoj, frymëzoj, hamendësoj, interpretoj, jap llogari, kallëzoj, komentoj, kundërshtoj, lëshoj, lyp, mendoj, miratoj, ndreq, njëjtësoj, njoh, organizoj, përmend, pranoj, qortoj, referoj (referohem), rishikoj, supozoj, tërheq, veçoj, vërej* etj.

*"Për ta përmbledhur ne mund të themi se një akt vendimi është një ushtrim (përdorim) i gjykimit (vendimit); një akt ushtrimi është një mbrojtje e ndikimit ose ushtrim i fuqisë; një akt parashtrimi është të marrit e përgjegjësisë për të deklaruar një qëllim; një akt reagimi është përshtatja e një lloji të caktuar të të sjellurit; një akt gjykimi është sqarimi i arsyeve, argumenteve,transmetimit (komunikimit)"* (Austin, 1962, p. 162).

**Sërli dhe zhvillimi i teorisë së akteve të të folurit**

Në veprën e tij, *"Aktet e të folurit: Një ese në filozofinë e gjuhës" ("Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language", 1969)* si dhe në punimin *"Një klasifikim i akteve ilokutive"* ("A classification of illocutionary acts", 1977) Sërli rimerr dhe zhvillon analizën e Ostinit për aktet ilokutive te *"Si të bëjmë gjëra me fjalët"*.

Sipas Searle (Searle,1969, pp. 23-24), në shqiptimin e një fjalie performohen së paku 3 akte të dallueshme:

**1**.Shqiptimi i fjalëve (morfemave, fjalive) që ai e ka quajtur ***akt i shqiptimit (utterance act),*** i cili i përgjigjet konceptit të Ostinit për aktin fonetik;

**2.**Referimi (referring) dhe predikativiteti (*predicating)* ose ***akti i pohimit të një fakti (propositional act)***; Kur dy akte ilokutive kanë të njëjtin referim dhe predikativitet, thuhet se është shprehur i njëjti fakt (proposition). Një propozicion (fakt i shprehur) duhet dalluar me kujdes nga pohimi dhe nga deklarimi i tij. Deklarimi dhe pohimi janë akte, ndërsa faktet nuk

janë të tilla. Një propozicion është ajo që pohohet në një akt pohimi dhe ajo që deklarohet në një akt deklarimi. Shprehja e një fakti është një akt propozicional, jo një akt ilokutiv. Kur një fakt pohohet, kjo bëhet vetëm në realizimin e një akti ilokutiv. Sipas Sërlit, në strukturën e thellë, ndryshe nga struktura sipërfaqësore, ne mund të identifikojmë gjithmonë ato elemente që i përgjigjen treguesit të faktit të shprehur dhe treguesit të forcës ilokutive. Këtë dallim ai e paraqet sipas simbolikës ***F(p)***, ku ndryshorja *"F"* tregon mjetet treguese të forcës ilokutive dhe *"p"* është për shprehjet propozicionale, pra, shprehjet që faktojnë diçka (Searle, 1969, p. 29-30).

**3.**Akti i të pohuarit, i të pyeturit, i të komanduarit, i të premtuarit etj., i cili është quajtur ***akti ilokutiv*** (illocutionary act), është ajo që arrihet me anë të performimit të një fjalie në kushte të caktuara dhe që sipas Sërlit, përbën njësinë minimale të komunikimit gjuhësor.

Edhe Sërli, sikundër Ostini vë në dukje se ndarja e aktit të të folurit në pjesë nuk do të thotë se këto janë veprime të ndara që folësi i bën në të njëjtën kohë, por, që performimi i një akti ilokutiv parakupton ekzistencën e aktit propozicional dhe të aktit të shqiptimit. Ajo që na bën të abstragojmë mbi ekzistencën e secilit prej këtyre akteve sipas Sërlit, është fakti se "kriteret e identitetit" janë të ndryshme në çdo rast. Kështu, i njëjti akt i pohimit të një fakti mund të jetë i zakonshëm për akte të ndryshme ilokutive dhe nga ana tjetër është e mundur që me realizimin e një akti shqiptimi të mos realizohen as akti propozicional dhe as ai ilokutiv (dikush mund të shqiptojë fjalë pa thënë në të vërtetë asgjë). Në mënyrë të ngjashme themi se mund të performohen i njëjti akt i pohimit të një fakti dhe i njëjti akt ilokutiv duke performuar akte të ndryshme shqiptimi.

Koncepteve të para Sërli (ashtu si Ostini) i shton konceptin e ***aktit perlokutiv***, i cili përfshin rrjedhojat apo efektet që aktet ilokutive kanë mbi veprimet, mendimet, besimet etj. e dëgjuesve. P.sh., duke argumentuar diçka, mund të bindim dikë, duke e paralajmëruar mund ta frikësojmë, duke bërë një kërkesë, mund ta bëjmë të kryejë diçka, duke e informuar, mund ta frymëzojmë, udhëzojmë etj. Nëse aktet e para janë akte ilokutive, të dytat janë akte perlokutive.

Para se të parashtrojë kriteret dhe klasifikimin e tij për aktet e të folurit Sërli vë në dukje se klasifikimi i Ostinit paraqet një sërë mangësish (Searle, 1973, pp. 35-38):

**-**Nuk ka një parim ose set parimesh të qarta dhe të qëndrueshme.

**-**Klasifikimi i Ostinit është klasifikimi i foljeve ilokutive të anglishtes dhe jo i akteve ilokutive, gjë që do të thotë se për Ostinin klasifikimi i foljeve ishte gjithashtu edhe klasifikimi i akteve ilokutive, pra, aty ku kemi dy folje jo sinonime të njëra-tjetrës, themi se kemi dy lloje të akteve ilokutive. Sipas Sërlit, dallimi midis foljeve dhe akteve ilokutive bëhet i qartë nëse kemi parasysh faktin se aktet ilokutive janë pjesë e gjuhës, ndërsa foljet ilokutive janë pjesë e gjuhëve të veçanta (anglisht, gjermanisht, frëngjisht etj.). Foljet e ndryshme ilokutive janë një kriter i mirë, por nuk mund të jenë në asnjë mënyrë, sipas Sërlit, një udhëzues i sigurt për dallimet mes akteve ilokutive.

**-**Jo të gjitha foljet e listuara nga Ostini janë performative.

**-**Si rrjedhojë e mungesës së parimeve të qëndrueshme, një numër i madh foljesh gjenden në pozicion të ndërmjetëm midis dy a më shumë klasave. Jo vetëm që ka mbivendosje kategorish, por gjithashtu, brenda së njëjtës klase janë futur lloje foljesh të dallueshme për nga natyra e tyre.

-Jo të gjitha foljet e renditura brenda klasave i përmbahen përkufizimeve të dhëna, edhe nëse këto përkufizime apo kufij do të shihen me lakueshmëri.

Sërli hedh poshtë iluzionin e Vitgenshtajnit se përdorimet e gjuhës (lojërat gjuhësore) janë të pakufishme. Sipas tij, ky iluzion e ka origjinën te paqartësia e kritereve që përdorim për të dalluar një lloj loje gjuhësore nga tjetra. Me përcaktimin e kritereve mund të arrijmë në një klasifikim shterrues të përdorimeve të gjuhës, ose të gjërave që mund të bëjmë me anë të gjuhës, si p.sh., t'i detyrojmë të tjerët të bëjnë diçka, të angazhohemi vetë në bërjen e diçkaje, të shprehim ndjenjat apo qëndrimet tona etj. Nga ana tjetër, edhe pse interpretimet e një thënieje mund të jenë të shumta dhe të vështira për t'u interpretuar, ato janë gjithmonë shterruese.

Në përpjekjen për të klasifikuar llojet e ndryshme të forcave ilokutive, Sërli zbulon parime të ndryshme të klasifikimit, që do të thotë se ekzistojnë lloje të ndryshme dallimesh, që na mundësojnë të themi se forca e një thënieje është e ndryshme nga ajo e një thënieje tjetër. Ai dallon 12 përmasa të dallimeve, nëpërmjet të cilave aktet ilokutive ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe prej tyre ai veçon tri përmasa si më të rëndësishmet (Searle, 1979, pp. 1-8):

**a-** Dallime që shfaqen në qëllimin e (llojit të aktit; qëllimin ilokutiv *(illocutionary point),* cili është pjesë e forcës ilokutive, por jo e njëjtë me të. Kështu, p.sh., qëllimi ilokutiv i kërkesës është i njëjtë me atë të urdhrit; të dyja kanë për qëllim që dëgjuesi të bëjë diçka, ndërsa forca ilokutive është e ndryshme (paraqitet në shkallë të ndryshme). Për Sërlin, forca ilokutive është përmbledhje e shumë elementeve, ku qëllimi ilokutiv është përbërësi më kryesor.

**b-**Dallime në drejtim të përshtatjes mes fjalëve dhe botës, përshtatje, e cila mund të jetë nga fjala drejt botës, d.m.th., fjala t'i përshtatet botës si në rastin e pohimeve, përshkrimeve dhe shpjegimeve; gjithashtu mund të jetë nga bota drejt fjalës, d.m.th., bota t'i përshtatet fjalës si në rastin e kërkesave, urdhrave, betimeve, premtimeve etj. Drejtimi i përshtatjes është gjithmonë një rrjedhim i qëllimit ilokutiv.

**c-** Dallime të gjendjeve psikologjike të shprehura, ku gjendja psikologjike e shprehur në performimin e një akti ilokutiv është *kushti i sinqeritetit* të aktit (Searle, 1969,p. 60). Ky dallim mund të arrijë i vetëm të klasifikojë lloje të akteve ilokutive, p.sh., pohimet, konstatimet, vërejtjet, shpjegimet, por edhe përfundimet, deklarimet, argumentimet, pranimet karakterizohen nga besimi i folësit; premtimet, betimet, kërcënimet, zotimet i bashkon qëllimi i folësit; urimet, përgëzimet, mirëseardhjet i bashkon vullneti (dëshira) i folësit e kështu me radhë.

Gjatë klasifikimit ndihet edhe nevoja e përmasave të tjera si, *dallime të forcës me të cilën është paraqitur qëllimi ilokutiv, dallime në statusin e folësit dhe dëgjuesit*, të tilla që të ndikojnë në forcën ilokutive, *dallime në mënyrën sesi thënia lidhet me interesin e folësit dhe dëgjuesit, dallime në lidhjen me pjesën tjetër të ligjërimit, dallime në përmbajtjen propozicionale*, të cilat përcaktohen prej mjeteve treguese të forcës ilokutive, *dallime midis atyre akteve që duhet të jenë gjithmonë akte të foluri dhe atyre që mund të jenë, por që nuk është e thënë të performohen si akte të foluri, dallime midis akteve që kërkojnë rregulla shtesë (përveç atyre gjuhësore) dhe akteve që nuk kanë nevojë për të tilla, dallime midis akteve, ku folja ilokutive ka një përdorim performativ dhe atyre ku nuk e ka një të tillë dhe dallime në stilin e performimit të aktit ilokutiv.*

Klasifikimi i Sërlit përfshin 5 klasa të akteve ilokutive:

**1.Paraqitëset** (assertives)

Qëllimi i akteve që hyjnë në këtë klasë është të bëjnë folësin të marrë përsipër vërtetësinë e aktit propozicional të shprehur. Këto i nënshtrohen vlerësimit e vërtetë/e pavërtetë. Qëllimi ilokutiv është ai i pohimit; drejtimi i përshtatjes është që fjalët t'i përshtaten botës; gjendja psikologjike e shprehur është *besimi*. Prova më e thjeshtë që mund t'i bëhet një pohueseje është nëse për të mund të themi *e vërtetë/e pavërtetë,* megjithëse kjo provë nuk është gjithmonë as e nevojshme dhe as e mjaftueshme.

**2.Udhëzueset** (directives)

Qëllimi ilokutiv i këtyre akteve ka të bëjë me përpjekjen e folësit për ta bërë dëgjuesin të bëjë diçka. Ato mund të jenë përpjekje të përmbajtura (ftesa, sugjerime etj) ose të forta (urdhra, këmbëngulje etj.). Drejtimi i përshtatjes është që bota t'i përshtatet fjalës; gjendja e shprehur psikologjike është ajo e *dëshirës (urimit, nevojës)*. Përmbajtja propozicionale është që dëgjuesi të kryejë një akt të caktuar, p.sh., të kërkuarit, të urdhëruarit, të komanduarit, të luturit, të përgjëruarit, të lypurit, të ftuarit, të lejuarit, të këshilluarit, madje edhe të guxuarit të kundërshtuarit, të sfiduarit, të dyshuarit etj.

**3.Parashtrueset** (commissives)

Parashtrueset janë ato akte ilokutive, qëllimi i të cilave është angazhimi (commit) i dëgjuesit për rrjedhën e ardhshme të veprimit. Drejtimi i përshtatjes është që bota t'i përshtatet fjalëve; gjendja psikologjike e shprehur është *qëllimi*. Përmbajtja propozicionale shpreh faktin që folësi në një të ardhme kryen një akt të caktuar si p.sh., të premtuarit, të angazhuarit, të marrët përsipër, të siguruarit, të garantuarit etj.

**4.Shprehëset** (expressives)

Qëllimi ilokutiv i këtyre akteve është të shprehë gjendjen psikologjike të përcaktuar në kushtin e sinqeritetit për një fakt të caktuar të shprehur në përmbajtjen propozicionale. Shprehëset nuk kanë drejtim të përshtatjes, pasi e vërteta e propozicionit të shprehur është e parakuptuar. Sidoqoftë, edhe pse përmbajtja propozicionale e një shprehëseje mund të jetë e ndryshme, ajo duhet të jetë e lidhur ngushtë ose me folësin ose me dëgjuesin. Akte shprehëse janë të falënderuarit, të kërkuarit ndjesë, të uruarit, të përgëzuarit, të mallkuarit, të bekuarit etj.

**5.Deklarueset** (declarations)

Përfaqësojnë një grup mjaft të rëndësishëm të ilokutiveve, të cilat janë trajtuar qysh herët si raste të akteve të të folurit, si p.sh., *"Je i pushuar!", "Ju emëroj…", "Ju shpall… ."* etj. Në këto thënie, fakti i shprehur ekziston vetëm në sajë të deklarimit të tij, pra, performimi i suksesshëm i asaj *që thuhet* realizon *faktin,* ndaj dhe, midis përmbajtjes propozicionale dhe forcës ilokutive nuk ka asnjë dallim formal. Qëllimi ilokutiv është ai i deklarimit; drejtimi i përshtatjes është në mënyrë të njëkohshme i dyanshëm; nuk karakterizohen nga shprehja e ndonjë gjendjeje psikologjike. Statusi i thënieve të kësaj klase është i veçantë, sepse për performimin e sukseshëm të tyre nevojitet një sistem rregullash, që i përket një institucioni jo gjuhësor dhe që i mbivendoset rregullave themelore gjuhësore. Folësi dhe dëgjuesi duhet të kenë statusin e tyre, jo vetëm në institucionin gjuhësor, por edhe në këtë institucion të shtuar, që mund të jetë kisha, ligji (drejtësia), prona private, shteti (pushteti vendor dhe lokal) etj.

Disa akte deklaruese i mbivendosen përfaqësu eseve, ndaj Sërli njeh brenda deklarueseve një nënlloj të quajtur *"deklarata përfaqësuese",* të cilat ndryshe

nga deklarueset e tjera i nënshtrohen kushtit të sinqeritetit. Kështu, gjykatësi, juria, arbitri mund të gënjejnë, ndërsa dikush që shpall luftë nuk mund të themi se gënjen gjatë realizimit të aktit të deklarimit. (Searle, 1973, p. 42)

Brenda grupit të deklarueseve Sërli përfshin ato akte që performohen me shqiptimin e një fjalie që ka në përbërjen e saj një folje performative në vetën I, koha e tashme, mënyra dëftore me një fjali të thjeshtë të përshtatshme plotësuese (në funksionin e plotësit). Për performimin e këtij lloji të deklarueseve nuk është nevoja e përfshirjes së një institucioni tjetër, pasi gjuha në këto raste është institucion i mjaftueshëm. Për këto veçori që shfaqin, Sërli i quan *performativet* ***"deklaruese gjuhësore (linguistic declarations)"*** ndryshe nga pjesa tjetër, që janë ***"jo gjuhësore (extra-linguistic)"***.

Për të kuptuar më mirë natyrën e akteve të të folurit Sërli (Searle, 1979) zhvillon më tej konceptin e kushteve të përmbushjes së aktit (felicity conditions FC) duke i dalluar këto si:

-kushte thelbësore, të cilat qartësojnë se çfarë lloj akti duhet të kemi. Këto kushte janë më të rëndësishme për përmbushjen e aktit pasi pikërisht këtu pasqyrohet edhe forca ilokutive e një thënieje, pra, fakti sesi merret (kuptohet) një akt i performuar në shqiptimin e një thënieje të caktuar në një kontekst të caktuar. Sipas Sërlit, kjo arrihet kur një publik mirëkuptues njeh dhe mirëpret qëllimet e folësit dhe në këtë mënyrë bën të mundur që folësi të përmbushë aktin si të tillë. Studiuesit e TAF sugjerojnë se do të ishte e nevojshme të shtjellohej më tej se çfarë e bën një akt të merret si i tillë.

-kushte për përmbajtjen propozicionale, të cilat përcaktojnë natyrën e kuptimit të thënies. Zakonisht, natyra e llojit të aktit të të folurit kushtëzon përmbajtjen propozicionale, p.sh., përmbajtja e disa akteve ka të bëjë me një fakt që ka ndodhur (falenderimet, ngushëllimet, ankesat, konstatimet etj.), ose me me një fakt që do të ndodhë (premtimet, urdhrat, këshillat etj.) Pra, këto kushte mbështeten në kuptimin e vetë thënies bazuar në një kontekst të caktuar;

-kushte të sinqeritetit janë kushte që lidhen gjithashtu me qëllimet dhe ndjenjat e folësit, por edhe të dëgjuesit dhe që duhet të specifikojnë se në ç'mënyrë folësi dhe dëgjuesi duhet të shprehin hapur qëllimet e tyre (të tregohen të sinqertë) ose të bëjnë të mundur performimin haptazi të aktit të të folurit;

-kushte parapërgatitore, pra, parakushtet e aktit, të cilat kanë lidhje si me qëllimet e folësit (para dhe pas), besimin dhe qëndrimin ndaj asaj që shpreh, ashtu edhe me fakte që i përkasin situatës së ligjërimit, analizimi i të cilave në shumicën e rasteve nuk është i lehtë. Te këto kushte Sërli përfshin gjithçka tjetër që ka të bëjë me aktin e të folurit.

Nëse këto kushte shihen në rastin e një paralajmërimi si p.sh., *"Të paralajmëroj të mos e bësh atë."* do të konkretizoheshin në këtë mënyrë:

- **Kusht i përmbajtjes propozicionale** është fakti që folësi *F* duhet të bëjë fjalë për të paralajmëruar kryerjen (moskryerjen) e një veprimi apo akti *A* që do të kryhet (nuk do të kryhet) në të ardhmen nga dëgjuesi *D*. Gjithashtu, përmbushja e kushteve të përmbajtjes propozicionale kërkon që folja e pjesës kryesore të thënies të jetë në kohën e tashme, në vetën e parë, ndryshe nëse folja do të jetë në një nga kohët e së shkuarës apo të së ardhmes, p.sh.,

*"Të paralajmërova…",*
*"Të kisha paralajmëruar…"*
*"Do të të paralajmëroja…",*
*"Do të të kisha paralajmëruar…"*, ky do të ishte një pohim dhe jo një paralajmërim;

- **Kusht parapërgatitor** do të përbënte fakti se folësi F është i bindur që kryerja

(moskryerja) e një veprimi në të ardhmen do të jetë në interes të dëgjuesit D. Gjithashtu, si kusht parapërgatitor mund të merret edhe fakti se folësi F beson se dëgjuesi D nuk është në dijeni që kryerja (moskryerja) e veprimit të mësipërm do të ishte në interes të tij.

**- Kusht i sinqeritetit** do të ishte besimi i vërtetë (i sinqertë) i folësit F që kryerja (moskryerja) e aktit A do të ishte në interes të dëgjuesit D.

Duke marrë parasysh tri grupet e para të kushteve të përmbushjes, kushti thelbësor do të jetë fakti se kjo thënie duhet të merret (të kuptohet) si një paralajmërim i folësit F për kryerjen (moskryerjen) e një akti A nga ana e dëgjuesit D.

Studiuesit janë të mendimit se njëri nga problemet më të qenësishme që del nga analiza e teorisë së Sërlit lidhet pikërisht me kushtet e përmbushjes së aktit dhe është fakti se deri në njëfarë mase, koncepti i aktit të të folurit dhe i atij të aktit të përmbushur të të folurit bëhen të padallueshëm nga njëri-tjetri.

**Sërli dhe aktet e tërthorta të të folurit**

Studimi dhe analiza e paraqitur më sipër i takon dhe merr në shqyrtim vetëm aktet e drejtpërdrejta të të folurit. Koncepti i aktit të drejtpërdrejtë të të folurit përputhet me aktin e të shqiptuarit të një fjalie, kuptimi i së cilës shpreh qëllimin e folësit në mënyrë të fjalëpërfjalshme (litteral) pra, me thënien që ka një kuptim të drejtpërdrejtë, mbart gjithmonë një forcë ilokutive të drejtpërdrejtë dhe përbën një akt të drejtpërdrejtë të të folurit.

Duke pasur parasysh aftësitë e fjalive me kuptim të drejtpërdrejtë për t'u realizuar si akte të drejtpërdrejta të foluri, mund të arrihet të kuptohen dhe të analizohen edhe ato fjali, kuptimi i të cilave nuk është më i drejtpërdrejtë, pra, qëllimi i folësit nuk është ai që është shprehur në mënyrë të fjalëpërfjalshme dhe të cilat përbëjnë akte të tërthorta të të folurit (Indirect Speech Acts, ISA). Sipas Sërlit (Searle; 1979, p. 30) ekzistojnë disa arsye (mirësjellja është njëra prej tyre), për të cilat kuptimi i drejtpërdrejtë i një fjalie nuk përkon me forcën ilokutive të aktit të shprehur në shqiptimin e saj.

Sërli konstaton (Searle, 1975, pp. 30-31) "ndërsa folësi shqipton një fjali, nënkupton atë që thotë, por gjithashtu ka ndërmend diçka më tepër". Shembulli i përdorur prej tij *"A mund ta kalosh kripën?" (Can you pass the salt?)* në kuptimin e fjalëpërfjalshëm (literal) referon për aftësinë fizike të dëgjuesit për të kryer veprimin e marrjes së kripës, ndërsa kuptimi që përmban edhe qëllimin e folësit është që dëgjuesi t'i kalojë kripën folësit.

Kështu, akti i tërthortë i të folurit përkufizohet si një thënie, me të cilën një akt ilokutiv, të cilin Sërli e quan *akt parësor (primary illocution)* realizohet nëpërmjet performimit të një akti tjetër ilokutiv, të quajtur *akt dytësor i fjalëpërfjalshëm (secondary illocution)*. Koncepti i Sërlit për aktin i tërthortë kundërshton pikëpamjen e Ostinit, sipas së cilës performativet eksplicite kanë një forcë të drejtpërdrejtë (të saktë), të përcaktuar nga folja performative e përdorur në fjali. Në të vërtetë, pjesa më e madhe e ndërveprimeve gjuhësore në të folurin e përditshëm nuk përbëjnë akte të drejtpërdrejta.

Analiza e aktit të tërthortë bëhet duke u bazuar në analizën e kushteve që duhet të plotësojë një akt i të folurit. Problemit të analizimit të tij Sërli i jep dy zgjidhje të mundshme:

Së pari, duke përdorur arsyetimin filozofiko-semantik, Sërli e sheh aktin e tërthortë të të folurit si kombinim i dy akteve, *aktit parësor* dhe *aktit dytësor ilokutiv*.

Së dyti, nëpërmjet një qasjeje pragmatike, që do të thotë se akti i tërthortë mund të performohet në mënyrë të fjalëpërfjalshme ose jo, duke ndarë në këtë mënyrë *kuptimin e fjalisë (sentence-meaning)* prej *kuptimit të thënies,* ku përfshihet edhe aktori folës *(speaker's utterance-meaning)*. Këtu, Sërli pa nevojën e dallimit të kuptimit të fjalisë nga kuptimi që shpreh folësi, edhe pse fjalitë zotërojnë në të njëjtën kohë edhe paraqitjen semantike edhe funksionin komunikues.

"Me anë të akteve të tërthorta të të folurit folësi i komunikon dëgjuesit më shumë nga sa thotë; kjo arrihet duke u mbështetur në informacionin që ata ndajnë së bashku, qoftë ky gjuhësor apo jogjuhësor si dhe në aftësitë arsyetuese dhe konkluduese të dëgjuesit. Për të qenë më të saktë, mjeti i nevojshëm për të shpjeguar "tërthorësinë" e akteve të tërthorta të të folurit përfshin një teori aktesh të foluri dhe disa parime të përgjithshme të bashkëbisedimit" (Searle, 1979, pp. 31-32)

Sipas Sërlit, natyra e akteve ilokutive (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) është plotësisht konvencionale, ndaj dhe analiza e tyre bëhet duke ndërtuar një set rregullash, të cilat përcaktojnë përdorimin konvencional të mjeteve që tregojnë llojin e aktit të realizuar. Ky konceptim përbën një pengesë të pakapërcyeshme kur vjen puna te analiza e akteve të tërthorta duke e detyruar Sërlin të vërë përkrah analizës konvencionale edhe një shpjegim në lidhje me rolin që luan nxjerrja e konkluzioneve (inference) në kuptimin e një thënieje si një lloj i caktuar akti ilokutiv. Kjo do të thotë se analiza e akteve të tërthorta të të folurit sjell në vëmendje tri elemente të lidhura ngushtë me të:

-kushtet e përmbushjes (felicity conditions) së akteve të drejtpërdreja të të folurit;

-konteksti i thënies;

-parimet e bashkëbisedimit të hartuara nga Grajsi (H.P. Grice, 1975).

Gjatë përpunimit të teorisë së tij Sërli bën dallimin midis dy llojeve të akteve të tërthorta të të folurit, *akte konvencionale (conventional)* dhe *akte të përllogaritura (calculated)*, megjithatë ai nuk e shtyn më tej analizën e këtij dallimi deri në mënyrat e ndryshme sesi folësit arrijnë t'i përkapin këto lloje aktesh. Mënyra e vetme për të kuptuar sesi një akt përdoret për të performuar një akt tjetër (pavarësisht dallimit të dy llojeve të tilla) është përmes procesit të nxjerrjes së konkluzioneve (implicatures: të kuptuarit e asaj që thuhet, jo përmes kuptimit të fjalëpërfjalshëm, por përmes rrethanave të kumtimit). Dallimi brenda akteve të tërthorta të të folurit të dy llojeve të ndryshme është hapi i parë për veçimin e atyre shprehjeve që u quajtën më vonë konvencione të përdorimit (conventions of usage).

Për ta bërë më të qartë këtë dallim të fundit të Sërlit mund të vlejë sjellja në vëmendje e shtjellimit të këtyre koncepteve nga një tjetër autor dhe njëkohësisht, njërit prej pasuesve të tij. Morgani (Morgan, 1978, pp. 269-280) ndërfuti në teorinë e akteve të tërthorta të të folurit konceptin e të kuptuarit me lidhje të shkurtër (short-circuiting implicatures). Sipas Morganit arsyeja pse akte të tërthorta si p.sh*., Mund të SF…* në krahasim me *Je i aftë të SF….*paraqiten potencialisht ndryshe për nga shkalla e tërthorësisë shpjegohet pikërisht me faktin se ato i përkasin dy fazave të ndryshme të procesit të të bërit të zakonshëm të përdorimit të një fjalie (conventionalization) me një qëllim të caktuar. Ajo shprehje që përdoret më shpesh dhe që ka arritur një shkallë më të lartë të përdorimit për një qëllim të caktuar është më afër të shndërruarit nga një *konvencion i përdorimit (convention of usage)* në në një *konvencion gjuhësor*

*(convention of language)*, pra, përdorimit të saj vetëm ose më së shumti me këtë kuptim (apo qëllim). Sipas Morganit, në rastet e konvencioneve të përdorimit folësi dhe dëgjuesi janë të aftë të bëjnë dallimin midis kuptimit të fjalëpërfjalshëm dhe përdorimit të shprehjeve si akte të tërthorta të të folurit (mjeteve dhe qëllimit) dhe megjithatë, ata arrijnë në mënyrë të mënjëhershme të përkapin kuptimin e tërthortë (qëllimin e vërtetë) të thënies, pasi shprehje të caktuara janë pranuar tashmë nga folësit e një gjuhe si mjete konvencionale për të realizuar akte të tërthorta të të folurit.

**Metodologjia e Vunderlihit në studimin e akteve të të folurit**

Vunderlihi (D. Wunderlich) ka bërë një përqasje më konstruktive ndaj teorisë së akteve të të folurit. Sipas tij, asnjë klasifikim i bërë (i Ostinit, i Sërlit apo i ndonjë autori tjetër) nuk mund të quhet me të vërtetë bindës. "Asnjë akt të foluri nuk mund të performohet në mënyrë të veçuar. Për më tëpër, asnjë akt të foluri nuk mund të ndjekë tjetrin në një rrjedhë arbitrare." (Wunderlich, 1980, pp. 293)

Duke pasur parasysh klasifikimin e Sërlit, ai sheh nevojën e rishikimit të kësaj teorie në të paktën tri drejtime (Wunderlich, 1980,p. 297). Sipas tij:

a. Parashtrueset nuk përfaqësojnë një klasë universale, pasi ato fare mirë mund të trajtohen si reagime ndaj udhëzueseve.

b. Pyetjet mund të formojnë një klasë të madhe të akteve të të folurit, pasi janë të dallueshme nga pikëpamja gramatikore dhe nga ana tjetër përfshirja e tyre brenda klasës së udhëzueseve merr parasysh vetëm pyetjet e kufizuara dhe nuk lë mundësi për përfshirjen e pyetjeve të qëllimshme (deliberative questions), pyetjeve retorike (rhetorical questions) etj.

c. Në klasifikimin e Sërlit nuk ka vend për akte të tilla si, paralajmërimet, këshillat, propozimet, ofertat, të cilat shfaqin tipare si të paraqitëseve, ashtu edhe të udhëzueseve (apo të parashtrueseve) (Wunderlich, 1977a).

Sipas Vunderlihit, konceptet më të rëndësishme që na ndihmojnë të analizojmë aktet e të folurit janë: radha, lëvizja (drejtimi), aktet e pritshme të të folurit, njësia e përbërë e ligjërimit, lloji i bashkëbisedimit dhe origjina e aktit.

- *Radha* i referohet radhës së bisedës (radhës së marrjes dhe dhënies së fjalës) midis dy ose më shumë folësve. Një radhë përbën një thënie minimale, e cila nuk është e thënë të përbëjë të paktën dhe as vetëm një akt të foluri. Është e rëndësishme që radhët e bisedës të mos mbivendosen në mënyrë që të arrihet të kuptuarit e natyrës së akteve të të folurit.

- *Drejtimi i bisedës* përcakton funksionin e aktit të të folurit në zhvillimin e bisedës (sekuencave të saj), e cila mund të ndryshojë vazhdimisht drejtimin (nga sekuenca e fillimit, vazhdimit, reagimit etj.). Kështu, pyetjet dhe kërkesat kanë prirje të funksionojnë si sekuenca të fillimit të bisedës, ndërsa përgjigjet dhe pohimet si sekuenca të reagimit. Nëse një pohim do të përbënte një akt të përgjigjes, të paraqitjes apo ndonjë lloj tjetër akti të foluri, kjo varet sidomos nga vendi që zë ai në rrjedhën e bisedës.

- *Aktet e pritshme* të të folurit janë sekuenca "të rregulluara" sipas marrëveshjes gjuhësore (që janë bërë të zakonshme në përdorim) në mënyrë të tillë që vendi i këtyre sekuencave të mbushet nga lloje të përcaktuar aktesh të foluri, p.sh., çiftet pyetje-përgjigje, propozim-shpjegim, hapëse-mbyllëse të bisedës etj.

- *"Njësia e përbërë e ligjërimit"* si koncept shënon morinë e akteve të të folurit të performuar nga i njëjti pjesëmarrës në ligjërim. Të tilla njësi janë rrëfimi, argumentimi, përshkrimi, të cilat zakonisht kanë një fillim, një pjesë të

shtjellimit dhe një përfundim; asnjëra prej pjesëve të tyre nuk mund të lihet jashtë njësisë dhe të gjitha bashkë kanë një funksion kompleks. Në analizën që do t'i bëhet funksionit të njësisë së përbërë të ligjërimit duhet pasur parasysh se një fjali e plotë (kufijtë e kësaj njësie nuk janë gjithmonë të qarta) është e aftë të përbëjë një akt të veçantë të foluri, ndaj dhe funksioni i secilit akt duhet të merret parasysh në kuadër të funksionit kompleks të njësisë.

*Lloji i bashkëbisedimit* është njësia më kompleksee ligjërimit dhe që përcaktohet nga realizimi i të gjithë bisedës. Kjo njësi mund të përcaktohet më qartë kur kemi të bëjmë me një intervistë, me dhënien ose marrjen e udhëzimeve, me shkëmbime mendimesh (në rastin e një debati) etj.

*Origjina e llojit të aktit* përcakton një ndarje midis aktesh të cilat janë të domosdoshme për çdo lloj të ndërveprimit gjuhësor, njerëzor; të cilat janë natyrore, parësore (primary) dhe një grupi tjetër, që përfshin akte dytësore (secondary), të cilat kanë një lloj përkatësie institucionale (përmbushin nevoja të veçanta të shoqërisë). Institucione të këtij lloji janë rregullorja e shkollës, marrja në pyetje në sallën e gjyqit, debati politik (në kulturën anglo-amerikane), fushata tregtare etj.

Në bazë të rëndësisë që paraqesin elementet e lartpërmendura, Vunderlihi përcakton 4 kritere të ndryshme për klasifikimin e akteve të të folurit:

*Së pari*, aktet e të folurit mund të klasifikohen sipas shenjuesve kryesorë gramatikorë dhe gjegjëseve funksionale në një gjuhë të caktuar. Në anglisht këta shenjues janë llojet kryesore të fjalive (main grammatical moods). Kështu, fjalia pyetëse përdoret për akte të të pyeturit (erotetic type); fjalia urdhërore për akte udhëzuese; fjalia dëftore për akte të përfaqësimit (representative type) dhe gjithashtu, forma e performatives për akte deklaruese (në një shtrirje më të gjerë se deklarueset e Sërlit).

*Së dyti*, klasifikimi duhet të bëhet sipas përmbajtjes propozicionale dhe sipas kushteve të përmbushjes së aktit. Lloji i përmbajtjes propozicionale është i lidhur ngushtë me llojin e aktit të të folurit, aq sa duke analizuar pjesë të aktit mund të arrihet (edhe pse, jo gjithmonë) të interpretohen lloje të caktuara të përmbajtjes propozicionale. Lidhja midis tyre theksohet edhe më shumë nëse kihet parasysh fakti se përmbajtja propozicionale përcakton bazën e ndërtimit të kushteve të përmbushjes së aktit në shumicën e rasteve kur këto dallohen midis tyre (në rastet kur përmbajtja propozicionale është e njëjtë me një pohim si akt i të folurit, atëherë kushtet e vërtetësisë janë të njëjta me kushtet e përmbushjes).

*Së treti*, duke e vendosur studimin e akteve të të folurit në lëmë të pragmatikës, Vunderlihi risjell në vëmendje funksionin dhe kontekstin e performimit të aktit të të folurit si përcaktues të kuptimit (të fjalëpërfjalshëm ose jo) të një fjalie, aktet e të folurit mund të klasifikohen në bazë të rolit që luajnë në ligjërim (si sekuenca të fillimit, të mbarimit etj.)

*Së katërti*, aktet e të folurit mund të klasifikohen duke marrë parasysh origjinën e tyre si akte parësore (primary) natyrore apo si akte dytësore institucionale. Sipas Vunderlihit, teoria e akteve të të folurit e përqendron vëmendjen në studimin e funksionit të gjuhës duke lejuar në këtë mënyrë, ndërthurjen e metodave dhe fushave të ndryshme të studimit, si të gjuhësisë, filozofisë, teorisë së studimit të kuptimit, teorisë gramatikore, teorisë së studimit të bisedës, teorisë së ndërveprimit etj., ndaj dhe përparësia e njërit apo tjetrit kriter do të varej nga përparësia e teorisë, në fushë të së cilës do

të shtrihej studimi (Wunderlich, 1980, p. 297).

**Përfundime**

Teoria e akteve të të folurit (Speech Act Theory, SAT) njihet sot si një nga teoritë më të reja dhe gjithashtu edhe më të diskutuara në fushë të studimeve gjuhësore.

Teoria e parë mbi studimin e mirëfilltë të akteve të të folurit është ajo e Sërlit, e cila njihet gjithashtu edhe si teoria më e lakuar. Shumë studiues kanë sugjeruar kriteret dhe klasifikimet e tyre për aktet e të folurit duke mbajtur ose një qëndrim deri diku miratues ndaj teorisë sërliane dhe duke e zhvilluar atë në drejtime të caktuara, ose duke u përpjekur të parashtrojnë argumente kundërshtuese ndaj kësaj teorie. Në përgjithësi studiuesit bien dakort në faktin se klasifikimi i akteve të të folurit paraqitet më i vështirë nga sa pretendon Sërli dhe madje se është gati e pamundur të arrihet në klasifikimin e të gjitha thënieve aq më tepër vetëm në pesë klasa, kjo sepse shumë lloje thëniesh mbeten jashtë skemës së tij të klasifikimit.

Ndërthurja e teorive të ndryshme në analizën e aktit të të folurit është një qasje dhe një propozim mjaft interesant në këtë fushë. Konceptet që Vunderlihi ndjen nevojën të veçojë në analizën e aktit i ka zbatuar në analizën e një bisede telefonike, dhe që këtu ka dalë në përfundimin se ndarja dhe përkatësia e akteve të të folurit në klasa të ngurtësuara mund të përbëjë një pengesë për analizën e bisedës reale.

Këto klasifikime të quajtura "tradicionale", përveç arritjeve të dukshme në fushë të studimit të akteve të të folurit, kanë edhe mangësitë e tyre, shumica e të cilave sipas studiuesve, e kanë burimin tek mbështetja mbi një teori objektiviste për klasifikim sipas kushteve të domosdoshme dhe të mjaftueshme.

Një linjë tjetër studimesh në këtë fushë ngrihet mbi përpjekjen për të përcaktuar kritere të ndryshme klasifikimi, kritere të cilat janë më afër asaj që sot njihet si aftësia njerëzore për të kategorizuar (human ability to categorize) dukuritë në përgjithësi dhe sigurisht, edhe aktet e të folurit. Autorë të tjerë kanë përcaktuar kriteret e tyre të klasifikimit të akteve të të folurit bazuar në teoritë e njohjes (cognitive). Këto kritere dhe këto teori do të jenë objekt i një qasjeje tjetër që do të pasojë dhe do të plotësojë këtë shqyrtim mbi klasifikimin dhe studimin pragmatik të akteve të të folurit.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Austin, J. L. (1962). *How to Do Things with Words.* Oxford: Clarendon Press.

Bach, K. and Harnish, R. M. (1979). *Linguistic Communication and Speech Acts.* Cambridge, Massachusetts, and London, England: The MIT Press.

Bach, K. (1994). *Conversational implicature*. Mind and Language 9, p. 124-162.

Cole, P. and Morgan, J. L. (eds.). (1975). *Syntax and Semantics Vol. 3. Speech Acts.* New York, San Francisco, London: Academic Press.

Grice, H.P. (1975). *Logic and conversation.* P. Cole, and J. L. Morgan (eds.).

Levinson, S. C. (1983). *Pragmatics.* Cambridge: Cambridge University Press.

Lyons, J. (1977). *Semantics.* Cambridge: Cambridge University Press.

Morgan, J.L. (1978). T*wo types of conventions in indirect speech acts.* Cole, P. (eds.).

Searle, J. R. (1969). *Speech acts: An essay in the philosophy of language*. Cambridge, Cambridge University Press.

Searle, J. R. (1973) (1977). *A classification of illocutionary acts*. In: A. Rogers, B. Wall, and J. P. Murphy (eds.). *Proceedings of the Texas Conference on Performatives, Presuppositions and Implicatures.* Washington, DC:Center for Applied Linguisitcs, p.27-45.
Searle, J. R. (1975). *Indirect Speech Acts.* P. Cole, and J. L. Morgan (eds.). Syntax and Semantics Vol. 3.Speech Acts. New York, San Francisco, London: Academic Press, p.59-82.
Searle, J. R. (1979). *Expression and meaning: Studies in the theory of speech acts.* Cambridge, England: Cambridge University.
Searle, J. R., Kiefer, P. and Bierwisch, M. (eds.) (1980). *Speech Act Theory and Pragmatics*. Dordrecht: D. Reidel Publishing.
Searle, J. R. & Vanderveken, D. (1985). *Foundations of illocutionary logic*. Cambridge, University Press.
Witgenstein, L. (1953). *Philosophical Investigations*. New York: Mscmillan.
Wunderlich, D. (1980). *Methodological remarks on speech act theory*. In: J. Searle, P. Kiefer and M. Bierwisch (eds.). *Speech Act Theory and Pragmatics*. Dordrecht: D. Reidel Publishing, p. 291-312.

# ASPEKTE TË BILINGUIZMIT NË TË FOLMEN E FEMRAVE ARUMUNE NGA KORÇA. BASHKËPËRKIME LEKSIKORE DHE FRAZEOLOGJIKE

**DANIELA STOICA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Në këtë punim do të analizojmë disa aspekte të dygjuhësisë te femrat arumune nga zona e Korçës (të cilat i përkasin grupit të fërsherotëve), duke nxjerrë në pah një seri konkordancash leksikore dhe frazeologjike midis të folmes fërsherote dhe dialektit tosk pikërisht nga zona e Korçës.

Studimi për këtë punim bazohet mbi një korpus tekstesh të mbledhura në periudhën prill-qershor 2013, gjatë periudhës së anketimeve gjuhësore. Femrat e intervistuara (20) u përkasin grupmoshave të ndryshme (14-25, 30-45, 50-65, 65-80 vjeç). Kemi marrë parasysh në analizën tonë edhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë si për shembull arsimimi, profesioni, ose në qoftë se folësja banon në zonën rurale apo urbane.

Qasja me gjuhën shqipe, pikërisht me dialektin tosk, u realizua duke përdorur studime të specializuara në këtë fushë, me karakater sociolinguistik, studime që analizojnë të folmen e femrave shqiptare nga zonat e Korçës, ashtu edhe punime leksikografike si për shembull *Fjalorin thesar i dialektit aumun, i përgjithshëm dhe etimologjik (Dicţionarul dialectului aromân, general şi etimologic)* të Take Papahaxhit, Bukureshti, 1974, botimin e dytë të zgjeruar, *Fjalorin etimologjik* të Vladimir Orelit (*Albanian Etymological Dictionary* 1998), *Fjalorin shqip-rumanisht* (*Dicționarul albanez-român)*, 2003 (autorë Luan Topçiu, Renata Topçiu dhe Ana Melonashi).

**Fjalë çelës:** *dygjuhësi, femra arumune, Korçë, konkordancë leksikore, konkordancë frazeologjike, anketim*

**Abstract**

In this paper, we are going to analize several aspects of the bilingualism with the Aromanian women from Korce area (community belonging to the Fersherot group), highlighting several lexical and phraseological concordances beteween the Fersherot speech and the Tosk dialect spoken in Korce area.

The study relies on a corpus of texts recorded between April and June 2013. 20 women were interviewed, belonging to the following age groups 14-25, 30-45, 50-65, 65-80. Our analysis has taken into account several extra linguistic factors such as the age, the level of the education, the profession of the informant, and if the informant lives in urban or rural areas.

The comparison with Albanian, particularly with the Tosk dialect, has been drawn by making use of other similar studies in this field, of sociolinguistic nature, which analize the speech of Albanian women from Korce area, as well as of lexicographic works such as *Dicţionarul dialectului aromân, general şi etimologic, second edition,* improved, Bucharest,

1974*, Vladimir Orel's Albanian Etymological Dictionary, Albanian-Romanian Dictionary,* 2003 (Luan Topçiu, Renata Topçiu, Ana Melonashi).

**Key words:** *bilingualism, female Aromanian, Korca, lexical concordance, phraseological concordance, survey*

Në këtë punim do të analizojmë disa aspekte të dygjuhësisë te femrat arumune nga zona e Korçës (të cilat i përkasin grupit të fërsherotëve), duke nxjerrë në pah një seri konkordancash leksikore dhe frazeologjike midis të folmes fërsherote dhe dialektit tosk, pikërisht nga zona e Korçës. Studimi bazohet mbi një korpus tekstesh të mbledhura në periudhën prill-qershor 2013, gjatë periudhës së anketimeve gjuhësore.

Femrat e intervistuara (20) u përkasin grupmoshave të ndryshme (14-25, 30-45, 50-65, 65-80 vjeç). Kemi marrë parasysh në analizën tonë edhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë si për shembull arsimimi, profesioni, ose në qofte se folësja banon në zonën rurale apo urbane.

Qasja me gjuhën shqipe, pikërisht me dialektin tosk, u realizua duke përdorur studime të specializuara në këtë fushë, me karakater sociolinguistik, studime që analizojnë të folmen e femrave shqiptare nga zonat e Korçës, ashtu edhe punime leksikografike si për shembull *Fjalorin thesar të dialektit aumun, i përgjithshëm dhe etimologjik (Dicţionarul dialectului aromân, general şi etimologic)* të Take Papahaxhit, Bukuresht, 1974, botimin e dytë të zgjeruar; *Fjalorin etimologjik* të Vladimir Orelit (*Albanian Etymological Dictionary* 1998); *Fjalorin shqip-rumanisht* (*Dicționarul albanez-român)*, 2003 (autorë Luan Topçiu, Renata Topçiu dhe Ana Melonashi).

Para se të kalojmë në prezantimin e materialit të mbledhur dhe në analizën e tij, do të bëjmë një përmbledhje të shkurtër të studimeve që kanë trajtuar të folmen e femrave arumune, duke e përmendur B. Récatas dhe studimin e tij të vitit 1934 *L'état actuel du bilinguisme chez les macédo-roumains du Pinde et le role de la femme dans le langage* (Gjendja e tanishme e dygjuhësisë te makedo-rumunet e Pindit dhe roli i grave në gjuhë), ku autori tregon se e folmja e femrave arumune është rezultati i specializimit sipas gjinive të dialektit arumun brenda në komunitetin e arumuneve të Pindit, komunitet i cili gjendej në një situatë dygjuhësie. Me fjalë të tjerë, bëhej fjalë për një përdorim të dialektit në sektorë të ndryshme të jetës shoqërore, por jo krejt të izoluar ose të ndarë njeri nga tjetri (Récatas, 1934, p.18).

Në punimin e tij të vitit 1943, *Gjuhë dhe kulturë,* duke u referuar pikërisht arumuneve të Shqipërisë, të cilët gjendeshin në një situatë dygjuhësie, madje edhe shumëgjuhësie, e cila vazhdon ende sot, Theodor Kapidan flet për ''një dualizëm në gjuhë, në kuptimin që, brenda në të njëjtën familje, në një mënyrë flasin individët që i përkasin gjinisë mashkullore dhe në një mënyrë tjetër flasin femrat.'' (Kapidan, 1943, p.78) Këtë fenomen e ilustron dhe e shpjegon nëpërmjet këtij shembulli: '' Një rast të veçant më ka rastisur të shoh në një komunë të Shqipërisë. Femrat flisnin ndryshe nga meshkujt. Divergjencat vinin nga të dyja anët. Femrat ruanin më mirë gjuhën e trashëguar, e cila ndryshonte nga gjuha e meshkujve për shkak të disa veçorive, por sidomos për shkak të shqiptimit uvular të *r*-së me më shume vibracione, shqiptim i cili ndryshonte timbrin e zanorëve të afërta. Meshkujt, përkundrazi, kishin humbur qartë këtë veçori të të folmes fërsherote për shkak të bilinguizmit dhe të

trilinguizmit ''(Kapidan, 1943, pp. 78-79).

Ky specializim për të cilin flasin Récatas dhe Kapidan shpjegohet nëpërmjet roleve të ndryshme që luante femra arumune fërshërote brenda në komunitetin e vet:

-rolin e nënës, e cila ka pjesën më të rëndësishme në edukimin e fëmijëve, kryesisht në vitet e para, duke u mësuar dhe transmetuar fëmijëve atë që njëzëri e quhajmë gjuhën e nënës (Capidan 1943, p.78; Recatas, 1934, pp. 21- 22).

-rolin e shtëpiakes- në të kaluarën, femrat arumune lëviznin dhe vepronin në një hapësirë shoqërore mjaft të kufizuar – atë të shtëpisë, pa pasur kontakte pothuajse fare me folës jashtë komunitetit (për shembull shqipfolës) ose duke pasur kontakte me anëtarë të komunitetit arumun vetëm me disa raste, me rastin e festave fetare për shembull dhe, atëhere kryesisht me femra.

Sipas studiuesve Récatas dhe Kapidan, konservatorizmi gjuhësor i femrave shpjegohet edhe nëpërmjet nivelit e tyre të reduktuar përsa i përket arsimimit , por edhe përsa i përket pjesëmarrjes në jetën ekonomike të komunitetit. Tradicionalisht, por edhe për shkak të stilit shtegtar të jetesës të arumuneve, sidomos arumuneve fërsherotë, femrat arumune nuk ishin të shkolluara. Récatas tregon në studimin e përmendur më lart që as pas vitit 1913 arumunët e Pindit nuk i dërgonin vajzat e tyre, dhe nganjëherë as djemtë, në shkollë, duke preferuar të paguajnë gjobë për këtë arsye (Récatas, 1934, p.24).

Si përfundim, duke mos studiuar në gjuhën e shumicës, në gjuhën me më shumë prestigj (greqishtja në rastin e arumuneve të Pindit dhe shqipja në rastin e fërsherotëve të Shqipërisë), idioma e folur nga femrat arumune nuk u nënshtrua ndikimeve gjuhësore te jashtme, duke mbetur uniforme dhe homogjene. Përveç këtij aspekti, Kapidan sinjalizon edhe një faktor tjetër- mobilitetin shoqëror më të madh të meshkujve krahas me atë të femrave, mobilitet i cili i ka detyruar ata të hyjnë në kontakt me popullsi të ndryshme që flisnin gjuhë të tjera, gjuhë të cilat meshkujt arumunë i mësonin shpejt. Me fjalë të tjera, meshkujt ishin ata që sillnin të renë, ndyshimin në dialektin arumun.

Këto përfundime të mëparshme janë konfirmuar edhe nga anketat tona, shumica e informatorëve të anketuar që u përkasin grupmoshave 65 deri në 80 vjeç, kishin mbaruar shkollën fillore (pas vendosjes/sedentarizimit e tyre dhe të familjeve të tyre në zonën e Korçës) ndërsa disa nga ato nuk kishin shkuar kurrë në shkollë, kontakti i tyre me gjuhën shqipe kishte qenë shumë më i reduktuar. Ato u bënë dygjuhëshe më vonë gjatë jetës së tyre.

Nga pikëpamja e sociolinguistikës, e folmja e këtyre femrave mund të konsiderohet si një shembull i besnikërisë gjuhësore (*language loyalty*), fenomen i cili shfaqet, siç tregojnë studimet përkatëse, në kushtet e dygjuhësisë. T. Kapidani vetë e paraprin këtë koncept në *Gjuhë dhe Kulturë*, duke e quajtur atë një formë të rezistencës gjuhësore ndaj gjuhës të prestigjit, por të kufizuar në kohë. (Kapidan, 1943, pp. 79-80).

**Fjalori dhe frazeologjia**

**Fjalët me origjine turke dhe greke në të folmen e femrave arumune dhe në atë të femrave shqiptare nga zona e Korçës**

Në të folmet e femrave arumune ashtu edhe shqiptare, kemi vënë re që në fillim numrin e madh të fjalëve me origjine turke dhe greke të përdorura prej tyre në kontekste të ndryshme, si për shembull, në lidhje me jetën familjare ose ngjarje të rëndësishme të jetës familjare dhe komunitare, si lindja, martesa, pagëzimi ose vdekja e anëtarëve të familjes ose të komunitetit, por edhe në urime ose

mallkime. Këto elemente leksikore janë shpjeguar nëpërmjet kontakteve të arumunishtes dhe shqipes, gjatë shekujve, me gjuhët turke dhe greke. Prandaj shpeshherë është e vështirë të thuhet nëse në rastin e arumanishtes këto huazime, sidomos ata me origjinë turke, rrjedhin drejtpërdrejt nga gjuha origjinale ose kanë hyrë në arumanisht nëpërmjet shqipes.

Është vërejtur se shpeshtësia e fjalëve me origjinë turke, kuptimi themelor i të cilave është i njëjtë me atë etimologjik, fjalë që janë përdorur për të përshkruar aspekte të ndryshme të jetës personale dhe shoqërore, është më e lartë te femrat arumune dhe shqiptare të grupmoshave 60 deri në 75-80 vjeç, sidomos nga zonat rurale.

Te femrat arumune dhe shqiptare të grupmoshave 30 deri në 40-45 vjeç, nga zonat rurale por edhe urbane, ne kemi zbuluar fenomenin e zgjerimit të fushës semantike në rastin e një numri mjaft të madh fjalësh, si në shembujt në vijim:

***adet-i*** **(shq.)** (<**tc.** ***adet***) 1.traditë, zakon-kuptimi themelor nga turqishtja: *I bëmë të tëra* ***adetet*** (***adetet*** përdoret në vend të fjalës me origjine sllave *zakonet,* që përdoret më shpesh nga kategoritë më të reja të folësve) 2. Përdoret si eufemizëm për marrëdhënie seksuale: *Bënë adetin*.

**adéta (arum.)** përdoret me kuptimin themelor nga femrat arumune të grupmoshave 60 deri në 80 vjeç. **(***Fătsiám* ***adétili****, túti li fătseám*), por edhe me kuptimin e marrëdhënies seksuale te grupmoshat 30 deri në 45 vjeç *( Fátse adéta).*

**dodi-a (shq.)** (<**turqisht** ?) 1. femër elegante 2. përdoret me kuptim negativ nga femrat shqiptare të grupmoshave 60 deri në 80 vjeç, sidomos në shprehjen *Rri si dodi,* e cila do të thotë *rri kot, pa bërë asnjë punë*.

**dodíe,-a (arum.),** me etimologji të paqartë, shfaqet sidomos në shprehjen *Şedz ca dodíe* dhe përdoret me të njejtin kuptim negativ nga femrat arumune të grupmoshave 50 deri në 80 vjeç dhe më rrallë nga grupmoshat 30 deri në 45 vjeç.

**dynja-ja (shqip)** (<**tc. dounïâ** te Papahagi, **dünya** te Çabej 1987:497**)** 1.botë *S'ia mbyll dot gojën* ***dynjasë*** përdoret në vend të fjalës *botës-* 2.njerëzit, në përgjithësi, kuptim i cili gjendet edhe në fjalorët e shqipes bashkëkohore (*Flasin* ***dynjaja****.),* duke vënë re formën e shumësit të foljes. Çabeji sinjalizon ekzistencën e kësaj fjale me këtë kuptim edhe në gjuhë të tjera ballkanike. Në tekstet e regjistruara shfaqet si një ndryshim kodi, siç shqiptohet në gjuhën shqipe, dhe folja është përsëri në numrin shumës: *Gpéscᵘ düniáia.* Te fjalori thesar i Take Papahaxhit, shfaqet me formën *dun'eáe*, të ngjashme me atë të shqipes, me specifikimin se këtë formë përdoret në veri, domëthënë te fërshërotët, por edhe me formën ***duneáuă****,* më afër me formën e emrave femërore në arumanisht, por të dyja me kuptimin *botë*.

**hair-i** (**shq.**) (<**tc haïyrly)**. 1.begati, lumturi, mirëqenje 2. fat, sukses, kuptim që gjendet edhe në fjalorin e shqipes bashkëkohore *Bëfsh hair!* Në fjalorin e T. Papahaxhit shfaqet me format ***hairlít(i)ca, hairlî'tca***, **haírula**, me kuptimin ''me fat të mirë''. Në tekstet e regjistruara nuk shfaqet.

**iatro- i (shq.)** (<**gr**. **γιατρός**) 1. mjek, doktor. Nuk shfaqet në tekstet në shqip me këtë kuptim, nuk përdoret me këtë kuptim nga folëset shqiptare. Për këtë kuptim përdoren vetëm fjalët *mjek* ose *doktor* 2. Përdoret në mënyrë eufemistike nga femrat e reja dhe të moshuara, duke patur edhe një nuancë humoristike duke i referuar burrit në marrëdhënie me gruan e tij *Erdhi iatroi tani rri e qetë.*

**iátru (arum.)** Në tekstet e regjistruara shfaqet vetëm me kuptimin e parë, themelor: *Mi vidzú iátru míni*. (Mua më pa mjeku.), pikërisht si në fjalorin e T.

Papahaxhit, i cili e regjistron me formën *ɣeátru*.

**jaran-i (shq.) (<tc. jaran** me kuptimin themelor në turqisht ''i sjellshëm, mikpritës'')**** 1.** shok, mik 2. përdoret me ngjyrim negativ, me kuptimin dashnor: *I erdhi jarani.*

**iaránd,-u** (në tekstet e regjistruara në arum.) me të njëjtat kuptime si në shqip *Ɣiní iaránd*$^{u}$.(Erdhi dashnori) Në fjalorin e T. Papahaxhit gjejmë formën ***iarán***, me kuptimin dashnor: *Aveá un iarán*. (Kishte një dashnor)

**kadënë-a (shq.**) (<**tc *qadyn*** me kuptimin etimologjik zonjë, femër e respektuar**)** 1. skllave haremi 2. përdoret me kuptim pozitiv për një femër të shëndetshme, të ushqyer mirë, domethënë të bukur. *Është si kadënë.*

**cadănă,-a (arum.)** 1. Papahaxhi regjistron jo vetëm sensin themelor, skllave haremi, por nga shembujt që jep del edhe kuptimi ''e bukur'', ''e shëndetshme''**.** *Arumâ'nile mușeáte par cadî'n'ĭ* (Gratë arumune të bukura duken si kadëna). Kuptimin ''femër të shëndetshme, të ushqyer mirë'' e kemi regjstruar te femrat arumune, te reja dhe të moshuara: *Ari faptă ca cadănă* (Është bërë si kadënë).

**kallogre-ja (shq.)** (<**gr. καλογραία )** 1. murgeshë ortodokse 2. femër shumë e vetmuar, pa fëmijë ose familje *Mbeti kallogre* Në tekste shfaqet edhe me kuptimin femër e shkretë, e gjorë: *Erdhe me kallogre?!*

**calugpeáuă,-a (arum.)** përdoret me të njëjtat kuptime si në shqip, *Șédz ca calugréauă.* (Rri si kallogre). Ndërsa Papahaxhi e regjistron vetëm me kuptimin themelor- murgeshë.

**kësmet-i** (**shq**.) (<**tc**. **qysmet**)1. fat 2. përdoret edhe si eufemizëm për bashëshortin e ardhshëm, për burrin i cili fati e zgjedhur për një grua *Kur të vijë kësmeti* (*të dalë fati*).

**căsméte,-a (arum.)** Te Papahaxhi gjejmë kuptimin themelor- ''fat''. Në tekstet arumune shfaqet me të dyja kuptimet: 1.fat *El ari căsmetea a lui* (Ai ka fatin e tij) dhe 2. bashkëshort i ardhshëm. Në këtë kontekst, një fjalë në arumanisht që lidhet drejtpërdrejt me fjalën *kësmet* në shqip është fjala **caşmetele**, e cila shfaqet bashkë me ***mirele, albele, hărăsitele,*** fjalë që përdoren për të tretat e natës (Berciu-Drăghicescu et all 2005:68). Fjalori i Papahaxhit regjistron vetëm format **căsméte/ cîsméte** vetëm me kuptimin ''fat'', ''e ardhmja'', por jo edhe formën **caşmete**.

**kurban-i (shq.)** (<**tc**.**qourban** me kuptimin themelor ''sakrificë'') 1. qengji i cili sakrifikohet te myslimanët, me rastin e festave; sakrificë 2. përdoret në zbunime, me kuptimin i/e dashur, si për shembull, *Kurban i mamit! / T'u bëfsha kurban!*

**curbán (arum.)** 1. mish qengji i pjekur; sakrificë 2. përdoret edhe me kuptimin i/e dashur, i/e adhuruar, për t'i përkëdhelur fëmijet, si zbunim, si në shqip, përdorim i cili gjendet edhe në fjalorin e T. Papahaxhit *Curbani mami! Țe și-ț pitrec, curbánea- a mea?* (Çfarë të të dërgoj, i dashuri i mamit?)

**kufet-ë, a (shq.) (<gr. κουφέτα)**1. bombone që ofrohet me rastin e pagëzimeve ose të dasmave 2. një femër ose vajzë e bukur.

**cufétă, -a (arum.)** shfaqet në tekstet e regjistruar vetëm me kuptimin femër/vajzë e bukur *Eásti ca cufétă*. Fjalori i T. Papahaxhit e regjistron vetëm me kuptimin ''bombone''.

**lebeti-a (shq.) (<tc)**. 1.tmerr 2. fig. njeri shumë i shëmtur, tmerrësisht i shëmtuar *Pu-pu lebetia!=Pu- pu i (e) shëmtuara!*

**lebetí, -a (arum.)** Në tekstet arumune të regjistruara shfaqet vetem me kuptimin e parë *Băgă lebetía* (Vuri tmerrin te njerëzit). Nuk gjendet në fjalorin e T. Papahaxhit, prandaj mendojmë se mund të jetë një huazim i ri.

**mathim-ë, a (shq.)** (<**gr. μάθιμα)** 1. mësim. 2. shembull, zakonisht negativ. *Ke marrë mathima të mira, posi!*

**máthimă,-a (arum.)** shfaqet në tekste vetëm me kuptimin themelor- ''mësim''. Edhe Papahaxhi regjistron vetëm këtë kuptim për fjalën **máθιmă**.

**mesele-ja (shq.)** (<**tc. mesele)** 1.problem 2. fig. me ngjyrim negativ ''ngatërresë'' *Ta marrim vesh këtë meselen*ë *tënde.*

**meseleie (arum.)** në tekste shfaqet me kuptimin ''ngatërresë'', si ndryshim të kodit *Spune meseleie de-a ta* (Na thuaj ndonjë ngatërresë tende). Nuk gjendet të shënuar në fjalorin e T. Papahaxhit.

**myzhde-ja (shq.) (<tc.mujdé)** 1. lajm i mirë 2. dhuratë e vogël që i jepet personit i cili sjell një lajm të mirë *Solli myzhden*ë *e djalit.*

**müjdéia (arum.)** në tekste shfaqet me këtë formë, si në shqip, me kuptimin ''lajm i mire'': *Dedu müjdéia* (Dha lajmin e mirë). Në fjalorin e Papahaxhit shfaqet me formën **mujdé,** duke pasur këto kuptime 1. lajm i mirë 2. dhuratë e vogël që i jepet personit i cili sjell një lajm të mirë, kompensim.

**nojmë-a** (shq.) (<**gr. νόημα)** 1**.** Shenjë që i bëhet dikujt me dorë 2. (me ngjyrim negativ) sjellje e papërshtatshme (zakonisht për femrat) në një situatë të caktuar, naze. *S'durohen ato nojma që bën.*

**noímă,-a (arom.)1.** kuptim, shenjë parandjenje 2. gjest që i jep dikujt për të kuptuar diçka *l'i-da cu nóima căpitánlu* (Kapendani i bëri nje gjest me nënkuptim) Në fjalorin thesar nuk shfaqet kuptimin e figurshëm ''naze''.

**rixha-jat (shq.)** (<**tc. rédjâ**) 1. lutje, kërkesë 2. (me ngjyrim negativ) kokëçarje, kuptim i cili nuk gjendet në fjalorin shqip-rumanisht *ç'i bën rixha atij, me aman*?

Në fjalorin e T. Papahaxhit shfaqet me format **rigé/rigeáie**, me kuptimet 1. kërkesë, lutje *Rigeáie ț-fac, o more!* (Po të bëj një kërkesë, mor!), ndërsa në teskstet e regjistruara në arumanisht shfaqet si në shqip, si një ndryshim kodi, edhe me kuptimin ''kokëçarje''.

**savanos (shq.)**(<**gr**. σαβανόνω) 1. të mbulosh me një copë të hollë (zakonisht një të vdekur) 2. përdoret me ngjyrim negativ në shprehjen *E savanosi atë të shkretin* (E dërgoi në botën tjetër).

Te Papahaxhi gjejmë format **săvănuisescu/ săvăniusescu –** por vetëm me kuptimin ''të mbulosh me një copë të hollë një të vdekur''**.** Në tekstet arumune nuk shfaqet kuptimin ''të dërgosh dikë në botën tjetër''.

**stis (shq.)** (<**gr. στήνω)** 1. të ngresh, të montosh 2. përdoret me kuptim negativ ''të imagjinosh,të fantazosh, të shpikësh diçka jo të vërtetë'': *E ka stisur këtë*.

**stăsescu/stisescu (arum.) –** Në tekstet e regjistruara dhe në fjalorin e Papahaxhit shfaqet vetëm kuptimi themelor të ngresh, të montosh, të ndërtosh. Në asnjërin nga burimet nuk shfaqet kuptimi të imagjinosh, të shpikësh.

**tabiat, tabiate (shumës) (shq.)** (<**tc. taby'at)** 1. zakon. 2. zakon i keq, për shembull në shprehjen *Tabiatet tona.*

**tabiéte –** në tekstet arumune shfaqet me ngjyrimin negativ ''zakon i keq'' *Ari tabiete a ei.* (Ka zakonin e saj të keq). Fjalori i Papahaxhit regjistron formën **tabiéte**, vetëm me ngjyrimin negativ ''zakon i keq''.

**thagm-ë, a (shq.)** (<**gr θάυμα)** 1**.** mrekulli, çudi 2. fig. përdoret me ngjyrim negativ në lidhje me diçka të dyshimtë *Është thagmë.*

**θámă/ θávmă (arum.) –** 1. mrekulli; në tekstet arumune nuk shfaqet kuptimi negativ i shqipes ndërsa fjalori thesar e regjistron vetëm kuptimin e parë, themelor.

**yrnek (shq.) (<tc. oeurnek)** 1. model, tipar, mostër, shembull 2. përdoret në mallkime, me ngjyrim përkeqësues *Yrneku i djallit!*

**iurnécă (arum.)** në tekste shfaqet me kuptim pozitiv, p.sh.: *Ia iurnécă di la María* (Merr shembull nga Maria). Në fjalorin e

Papahaxhit shfaqet me të njëjtën formë **iurnécă**, vetëm me kuptimin pozitiv ''model, shembull'': *Ș' di năsă loată iurnecă* (Dhe nga ajo të merrni shembull).

**zileps (shq.) (<gr. ζιλεύω)** 1. të kesh zili dikë 2. fig. në mënyrë të figurshme, të adhurosh, të duash shumë dikë *U zileps pas saj=E dëshiron atë.*

**zileps/zilipséscu (arum.)** – në tekste shfaqet vetëm me kuptimin e parë- ''të kesh dikë zili''. *Zilipsésc$^{u}$ ațea feată (E kam zili atë vajzë).* Në fjalorin e T. Papahaxhit shfaqen edhe kuptimet ''të lakmosh, të dëshirosh diçka me pasion''.

**Figura mitologjike në veprat folklorike dhe në të folmen e femrave arumune dhe shqiptare nga zona e Korçës.**

Një tjetër karakteristike e të folmes së femrave arumune dhe shqiptare është shprehja e supersticiozitetit në jetën e përditshme, por edhe në rrethana të ndyshme, në këngë dhe poezi popullore të cilat recitohen me rastin e festave ose me rastin e evenimenteve të ndyshme nga jeta e komunitetit- lindja e fëmijëve, fejesa, martesa, vdekja etj. Kjo nënkupton praninë e disa figurave mitologjike në urime, zbunime, por edhe në mallkime, figura si për shembull *dodolja*, i cili shfaqet në megleno-rumanishten me formë të ngjashme *dudulețu,* por edhe në dakorumanishten; *ëma e vatrës*, me ekuivalentin *muma ali casă* në arumanisht; *flama*, me të njëjtin emërtim edhe në arumanisht**;** *Të mirat/ Të tretat e natës*, të cilat kanë më shumë emërtime në arumanisht, me etimologji të ndryshme *mirele, albele, hărăsitele, cașmetele*; *Lugati,* figurë e cila shfaqet edhe në tekstet e regjistruara në arumanisht me formën *luvgat* (megjithëse fjalori i Papahaxhit nuk e regjistron); *Hija*, me ekuivalentin *umbra* .

Do të ndalemi te figura e dodoles, e cila lidhet me zakonin mjaft të përhapur edhe në popuj të tjerë në Ballkan, për të kërkuar/shkaktuar shiun gjatë periudhave të thata. Format *dudula, dudulica, dodolă* në rumanisht, *dudulë*, *dudulja* në shqip, *tuntule* në greqisht, *dudulya, didilya* në gjuhët sllave jugore mendohet se kanë të njëjtën origjine thrake**.** (Decev, 1957, p.151, Paliga, 2011, p. 34) Në Shqipëri, pikërisht në zonën e Jugut, ekziston zakoni që një person të vishet me veshje të vjetra dhe, i shoqëruar nga njerëz të tjerë nga fshati, të ndalet para shtëpive dhe banorët e këtyre shtëpive ta lagin me ujë**.** Kështu ka lindur shprehja *dodol (U bë qull),* e cila, në zonën e Korçës përdoret edhe për fëmijet që urinojnë jo vullnetarisht. Ekuivalenti i *dodoles* në arumanisht është *pipiruna* (fjalë e cila gjendet në dakorumanisht me formën *paparudë* dhe në gjuhët sllave jugore me formën *peperuda*), që përdoret për një vajzë e cila vishet me një lloj fustani prej gjetheve. Vajza shoqërohet nga shumë vajza të tjera, duke kërcyer nëpër rrugët e fshatit dhe duke ndaluar te shtëpitë e njerëzve, të cilët e spërkasin me ujë.

Përsa i përket figurës *e ëma e vatrës***,** duke patur parasysh vjetërsinë e fjalës *vatër*, kjo figurë mitologjike duhet të jetë shumë e vjetër. Studime në këtë fushë konsiderojnë se mund ta ketë origjinën që nga periudha e matriarkatit (Tirta, 2004, p.180). Shënojmë atributet e saj pozitive, të cilat konside rohen më të vjetra, ndoshta që nga periudha e matriarkatit (ëma e vatrës ishte një qënie e mirë, e cila jetonte brenda në vatrën e zjarrit dhe duhej ushqyer dhe trajtuar me respekt), por edhe negative, të cilat konsiderohen zhvillime semantike të mëvonshme- një plakë e shëmtuar, me flokë të gjata dhe me sytë të dalë nga orbitët, e ngjashme me një shtrigë. Me këtë kuptim përdoret në fjali si për shembull: *Ç'më je bërë kështu si e ëma e vatrës?* Këtë ngjyrim negativ e ka edhe togfjalëshi *muma ali casă* në arumanisht.

*Flama (<lat. flamma)* është një tjetër figurë, e cila, në mitologjinë

shqiptare përfaqëson një grua të vdekur, e cila nuk ka gjetur paqen në varr dhe për këtë arsye i shqetëson njerëzit e gjallë, duke u shkaktuar edhe sëmundje të ndryshme, si për shembull epilepsinë. Figura e flamës është shume e ngjashme me atë të *lemur*-it (shumës *lemures*) në Romën e lashtë, që përfaqesonte shpirtrat e të vdekurve që nuk gjenin qetësinë në varr. Në shqip përdoret shpesh në mallkime: *Të hëngërt flama!*Megjithse nuk shfaqet në tekstet e regjistruara në arumanisht, fjala *flama* shfaqet në fjalorin e T. Papahaxhit me kuptimin e flakës të zjarrit, por edhe në mallkime me të njëjtin kuptim në shqip *Fláma ș' pira s' ti-árdă* (*Të hëngërt flama!).* Th. Kapidan konfirmon këtë përdorim të fundit në mallkime, por jo të parin (flakë zjarri) në studimin e tij mbi të folmen fërsherote *Raporturile albano-române* (Raportet shqiptaro-rumune), duke dhënë këto shembuji: *S-ti l'ea fleama, s-lu l'ea fleama* (Ta marrë flama/dreqi!) (Kapidan,1922, p.530). Megjithatë, në të njëjtin fjalor, Papahaxhi jep edhe formën *fléamă*, siç e jep Kapidani (me diftongun *ea*, në vend të zanores *a*, alternim fonetik tipik për të folmen e fërshëroteve të Shqipërisë) fjalë që, sipas Papahaxhit, rrjedh nga fjala shqipe *flamë*, fjalë e cila shfaqet edhe në mallkime të tipit *Fleáma s'lu l'eá* (Ta marrë flama/dreqi!).

Në mitologjinë shqiptare, *të mirat* janë gjithmonë tre, si në mitologjinë e arumuneve. Paraqet interes fakti se në vend të emrit *ursitoare*, i cili përdoret në dakorumanisht për të mirat (në arumanisht egziston edhe folja *urséscu,* me kuptimin urdhëroj, komandoj, por edhe sundoj bashkë me emrin *ursire* që do të thotë urdhër, sundim dhe mbiemrin *ursitoru* me kuptimin urdhërues, sundues), arumunet përdorin më shpesh emërtimin *mire (mirele* nr. shumës, trajtën e shquar), si në shqip, bashkë me disa emërtime të tjera si *albele, hărăsitele, caşmetele*. Në të folmen e femrave shqiptare e zbulojmë edhe në mallkime si "Të marrtë e mira!", por jo në të folmen e femrave arumune.

*Të tretat e natës* mendohet se janë caktueset e fatit të fëmijës. Në grupmoshat e vjetra, gjejmë shprehjen: *Kështu ia kanë shkrojtur të tretat e natës,* kur diskutojnë për fatin e mirë a të keq të dikujt. Te arumunet, siç përmendëm më lart, gjejmë format *cele trei mire* (fjalë për fjalë ''të tre mirat'', njësi frazeologjike ku zbulojmë edhe numërorin *tre* si në shqip), *mirele*, *albele, hărăsitele, caşmetele,* me etimologji të ndryshme.

*Lugati,* në besimin popullor shqiptar, është i vdekuri që ngrihet nga varri dhe që ka bërë shumë mëkate kur ishte gjallë. Këtë fjalë e gjejmë si sharje dashamirëse për fëmijët e prapë, por në ligjërimin grarisht kjo fjalë përdoret edhe për të emërtuar një njeri shumë të keq: "*Lugat e ka bërë Perëndia"*. V. Orel regjistron në fjalorin e tij etimologjik edhe formën *luvgat* dhe shpjeon origjinën e tij nëpërmjet fjalës latine *lupus.* Në tekstet arumune shfaqet forma *luvgat*, e cila përdoret nga femrat arumune me të njëjtin ngjyrim përkeqësues si në shqip: *Vini acasă ca luvgat* (Erdhi në shtëpi si lugat). Megjithatë, fjalori thesar i T. Papahaxhit nuk e regjistron këtë fjalë, fakt që na bën të mendojmë se është një huazim relativisht i ri nga shqipja.

Gratë e rrethinave të grupmoshës së vjetër, myslimane dhe të krishtere, besojnë se shpirti pas vdekjes, 40 ditët e para endet në formën e një hijeje. Këtë fjalë e gjejmë edhe në shprehjet që përfshijnë fjalën *hije*: *Ka shkelur hije; I dalin hije; Ka hije,* të cilat përdoren kur të sëmurit nuk i përcaktohet qartë diagnoza në trajtimet mjekësore. Në tekstet arumune gjendet me leksemën *umbra* (<lat. umbra), fjalë e cila në të folmen e femrave arumune ka kuptimin e fantazmës, të hijes si në shqip. Në fjalorin

arumun shfaqet edhe me formëm *aumbră* (me protezën *a*, fenomen fonetik mjaft i përhapur në arumanisht), në kontekste si për shembull *l-călcă aumbra* ( fjalë për fjalë ’’ E shkeli hija’’, me të njëjtin kuptim si në shqip).

**Përfundime**

E folmja e grave arumune dhe shqiptare nga zona e Korçës paraqet fenomenin e specializimit sipas gjinive të dialektit arumun (në rastin e femrave arumune të Korçës) dhe të dialektit tosk (në rastin e femrave shqiptare të Korçës) brenda të dyja bashkësive gjuhësore, specializim i cili ka ndodhur për shkak të pozicionit dhe roleve që luajnë në shoqëri dhe brenda në komunitetin e tyre femrat arumune dhe shqiptare. Duke përdorur termat e Gumperzit (Guperz, 1968, p. 66), këto të folme mund të konsiderohen si variante të mbivendosura (*superposed variants*), ndërsa e folmja e femrave arumune (konservatorizmi i tyre gjuhësor) konsiderohet si një formë e lojalitetit gjuhësor (*language loyalty*), lojalitet i cili përshkruhet nga T. Kapidani si një formë rezistence gjuhësore. në qoftë se marrim parasysh situatën e dygjuhësisë në të cilën gjenden femrat arumune nga zona e Korçës (Kapidan, 1943, pp. 79-80).

Siç kemi treguar më lart, e folmja e grave arumune dhe shqiptare përfshin një numër mjaft të madh me origjine turke dhe greke, fjalë që kanë hyrë me kalimin e kohës, gjatë shekujve. Siç e kemi vënë re, sidomos në shqip (në veçanti te grupmoshat 30 deri në 50 vjet), këto fjalë kanë zgjeruar fushën e tyre sematike duke shtuar edhe kuptime të reja, kuptime që janë huazuar nga arumanishtja, por jo masivisht. Siç e kemi parë në analizën tonë, shumë fjalë me origjine turke ose greke në të folmen e grave arumune të Korçës kanë ruajtur vetëm kuptimin themelor, shumë shpesh identik me atë të këtyre fjalëve në gjuhën turke dhe greke, fakt që na vërteton se gratë arumune tregojnë një konservatorizëm gjuhësor, duke vazhduar rolin e tyre si ruajtëse të gjuhës së nënës. Në rastet kur këto fjalë shfaqen me kuptimet e reja në të folmen e këtyre grave, kjo ndodh në rastin e ndryshimeve të kodit.

Gjithashtu, kemi analizuar praninë e figurave mitologjike në të folmen e grave shqiptare dhe arumune të zonës së Korçës, figura që shfaqen me të njëjtat emra ose me emra të ndryshme, por duke u referuar koncepteve të njëjta dhe duke folur për një të kaluar të përbashkët dhe një spiritualitet të ngjashëm.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Berciu-Drăghicescu, A.et al. (2005). *Ipostaze ale spiritualității orientale*, București, Editura Universității București.

Capidan, T. (1943). *Limbă și cultură*, București, Editura Fundațiilor Regale.

Capidan, T. (1931). *Fărșeroții. Studiu lingvistic asupra românilor din Albania*, București, Cartea Românească.

Capidan, T. (1922). *Raporturile albano-române,* në Dacoromania viti II, Cluj, Editura Institutului de Arte Grafice ’’Ardealul’’ (443-554).

Çabej, E. (1987). *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.

Decev, D. (1957). *Die thrakischen Sprachreste*, Wien, R.M. Rohrer.

Gumperz, J. (1968). *The Speech Community* në Duranti, Alessandro (ed.) Linguistic Anthropology: A reader (66-73).

Orel, V. (1998). *Albanian Etymological Dictionary*, Brill, Leiden.
Papahaxhi, T. (1974). Dicționarul *Dialectului Aromân General și Etimologic*, ediția a doua, București, Editura Academiei Republicii Socialiste România.
Paliga, S. (2011). *Influenţe romane și preromane în limbile slave de sud* (Ndikime romake dhe pararomake në gjuhët slave jugore) në https://oceanospotamos.files.wordpress.com/2011/11/paliga_inflromane.pdf
Récatas, B. (1934). *L'état actuel du bilinguisme chez les macédo-roumains du Pinde et le role de la femme dans le langage*, Parsi, Librarie E. Droz.
Tirta, M. (2004). *Mitologjia ndër shqiptarë*. Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Kulturës Popullore, Dega e Etnologjisë.
Topçiu, L. et all (2003). *Dicționar albanez-român*, București, Polirom.

# ASPEKTE TEORIKE TË RETORIKËS PËRMES SHEMBUJVE PRAKTIKË

**EDIOLA NASE**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Edukimit**

**Përmbledhje**

Mundësitë gjuhësore janë kaq të mëdha dhe të thella, saqë ne, asnjëherë nuk arrijmë ta zotërojmë të shkruarin dhe të shprehurin plotësisht dhe përfundimisht, ndaj ky punim ka për qëllim të na njohë me disa teknika të përgjithshme të retorikës, për të përsosur aftësitë tona gjuhësore.

Kështu,synojmë të bëjmë një paraqitje të disa prej figurave kryesore të fjalës dhe të mendimit në retorikë, duke shpjeguar së pari se si funksionojnë ato dhe, ç'është më e rëndësishme, cilat janë këshillat apo vërejtjet e duhura për të mos patur keqkuptime të mundshme gjatë përdorimit të tyre.

Përmes shembujve konkretë do të shohim pse retorika ka një rëndësi vendimtare përsa i përket zgjedhjes së fjalës, interpretimit dhe përdorimit të saj si mjet i fuqishëm mbi bazën e të cilit ngrihet çdo shkencë.

Qëllimi, mbetet të jetë aftësimi ynë për t'i theksuar këto mekanizma gjatë ligjëratës apo shkrimit tonë, duke dalë kështu në përfundimin se si ato mund dhe duhet të funksionojnë në favorin tonë dhe jo kundër nesh.

**Fjalë çelës**: *retorika, figura të fjalës, figura të mendimit.*

**Abstract**

The linguistic opportunities are so deep and great that we can never presume to hold tight entirely and definitely to its writing and expressing form. It is, therefore, the aim of this paper to make known some of the general rhetorical techniques, which might help us improve our linguistic skills.

Hence, we intend to present some of the main figures of speech and thought in rhetoric not only by emphasizing their function but, most importantly, by providing some pieces of advice which might help overcome possible misunderstandings generated in the process.

Based on concrete examples, we will argue on the important place rhetoric takes in connection to diction, interpretation and word usage, indispensable foundations of almost every science.

It seems imperative to us to reinforce such mechanisms through our speech or writing, coming, thus, to the conclusion that they should and ought to function as our ally and not as our enemy.

**Key words**: *rhetoric, speech figures, thoght figures.*

Ka pasur mjaft përkufizime për retorikën në gjithë historinë e saj, sidomos ato të grekëve të lashtë dhe romakëve në veçanti. Gjithsesi, retorika është kuptuar si studimi i shkrimit dhe të folurit efektiv, pra është vlerësimi i mënyrës se si funksionon gjuha, kur ne e shkruajmë apo e flasim atë, si dhe përdorimi i disa teknikave për të folur dhe për të shkruar "më mirë". Se çfarë kemi parasysh kur themi "më mirë", kjo është diçka që kërkon diskutim dhe pikërisht këtu del në pah koncepti "negativ" i retorikës, që ka të bëjë me përshkrimin e retorikës si "arti i bindjes", ku bindja e të tjerëve mund të ngatërrohet lehtë me arsyetimin e shtrembër që përdoret në vend të argumentimit bindës.

Dallimi ndërmjet përmbajtjes dhe formës- çfarë themi dhe si e themi atë- është theksuar nga Aristoteli në termat "logos" dhe "lexis" (Piazza, 2008), apo në çfarë komunikohet dhe në ç'mënyrë. Kjo ndarje jo fort e qartë, e bazuar në një pikëpamje të gjuhës,në diçka më shumë se kuptimi me të cilin ne shprehim mendimet tona, nuk merr parasysh llogaritjen e pandashmërisë së ideve dhe gjuhës që përdoret për t'i shprehur ato. Në fakt, mënyra se si ne shprehemi, lidhet me qëllimin e dëshiruar të transmetimit të ideve te të tjerët. Në këtë kontrast ato që themi nuk janë "fjalë", por përbëjnë "ligjërim", sidomos kur të dyja palët shprehen dhe kuptohen njësoj.

Deri më sot janë bërë mjaft analiza shkencore për mjetet apo pjesët përbërëse të retorikës. Një prej këtyre analizave është ajo që e sheh atë si qasje të tri kërkesave (mjeteve) që na nevojiten kur flasim apo shkruajmë (Kennedy, 1991):

1) *Logos*, thirrja për arsye;

2) *Pathos*, thirrja për emocion;

3)*Ethos*, thirrja për karakter (stili i personit që flet apo shkruan).

Në një ndarje të tillë duhen patur parsysh edhe ndërthurjet: një argument mund të jetë i ndërtuar mbi bazën e arsyes, por njëkohësisht baza e tij mund të jetë e lidhur me anën emotive,dhe gjithsesi, mbetet një argument. Kështu, ne flasim në retorikë për bindje argumentuese, e cila mund të mbështet njësoj si në metodat arsyetuese (logjika) dhe në ato joarsyetuese (ndjenja). Ndërsa me"ethos", Aristoteli quante një "thirrje të karakterit" si një orvajtje nga ana e folësit apo e shkruesit për të paraqitur njohuritë e tij në lidhje me çështjen, si dhe dashamirësinë e tij drej auditorit; që të dyja si kushte të mira për një vëmendje të sigurt nga ana e dëgjuesit apo lexuesit.

Ndërkohë mund të flasim edhe për "rregulla të arta" të retorikës, të cilat janë çelësi për sukses në këtë drejtim (Shkurtaj, 2008):

**1.Gjetja**, që ka të bëjë me kërkimin dhe grumbullimine argumenteve, mbi bazën e të cilave do të mbështetemi.

**2.Përndarja**, është dispozicioni i argumenteve, sipas një farë rendi dhe oportuniteti të përmasave të ndërsjella.

**3.Zgjedhja**, është gjetja e duhur e fjalëve dhe e teknikave retorike që mund të vlerësojnë më mirë argumentet e organizuara më parë.

**4.Memorizimi**, është përpjekja për të ngulitur në mendje diskutimin e përpunuar me shkrim.

**5.Shqiptimi ose interpretimi,** pra mënyra me të cilën oratori e paraqet diskutimin e vet nga pikëpamja e tonit, e zërit dhe variacioneve të mundshme të intonacionit në çaste të ndryshme, e gjesteve, e mënyrës së qëndrimit përballë auditorit.

Disa prej tyre janë të qarta, por ka nga ato që janë paksa delikate.

**Përndarja,** për shembull, përfshin mënyrën se si të bashkojmë pjesët e një shkrimi apo fjalimi, në kuptimin që vendosim nëse na duhet të fillojmë me një përmbledhje apo diçka të tillë ta paraqesim në fund. A do të na duhet të

reshtojmë argumente apo t'i përfshijmë ato në një trup të vetëm të argumentit tonë?

Në mënyrë të ngjashme, **memorizimi** përfshin jo vetëm aftësinë e përqendrimit të folësit apo shkruesit (përveç të tjerave nëse mbajmë shënime për ato që duam të kujtojmë si më të rëndësishmet apo më interesantet), por, gjithashtu, lidhet me vlerësimin e faktit se sa auditori mund të ndjekë apo të mbajë mend nga ato që thuhen, gjë që varet nga ato që ne theksojmë, çka do të ndihmojë ndjeshëm edhe në përmbledhjet e nevojshme që mund të bëhen herë pas here.

Po ashtu, **shqiptimi** lidhet me situata të tilla, si: A kemi të bëjmë me një çështje që duhet të trajtohet me seriozitet apo një shaka do të na ndihmonte për një marrëdhënie efektive me auditorin? A do të bënim mirë ta shoqëronim çdo fjalë me anë të mimikës ose të lëvizjeve të duarve? Një përdorim i dendur i gjestikulacionit të fytyrës do të lodhte auditorin dhe, për më tepër, do të ngjante me një aktrim duke mos e bërë kështu fort të besueshme çështjen në fjalë?

Të gjitha këto aspekte kanë rolin e tyre në të folur dhe në të shkruar, prej nga del dhe rëndësia e studimit të retorikës. Natyrshëm themi se retorika është në bazë të argumenteve dhe diskutimeve të çdo fushe qofshin. Duke pasur parasysh këtë ne mund të analizojmë teknikat me të cilat ajo operon në mënyrë që t'i përdorim efektivisht ato.

Për të vënë në dukje vlerën e figurave retorike, shkenca që merret me to (retorika dhe neoretorika) tradicionalisht ka dalluar dy lloje a grupe: figura të fjalës dhe figura të mendimit. (Shkurtaj, 2008), një paraqitje të përgjithshme të të cilave do të mundohemi ta bëjmë më poshtë

**Lidhëzorët logjikë theksues**

Lidhëzorët logjikë, si: *për këtë arsye, prandaj, sidoqoftë, sigurisht, megjithatë, por, përkundrazi, shkurtimisht, si përfundim, në krahasim, si pasojë, në fakt, nga ana tjetër, atëherë, si rrjedhojë, pra, kështu* etj., ndihmojnë mjaft për tërheqjen e vëmendjes, duke u shoqëruar dhe me një ton të veçantë të zërit, çka e bën akoma më të qartë rolin e tyre theksues. Përsa i përket vendit që këta lidhëzorë zenë në fjali, ata tërheqin vëmendjen njëlloj si në fillim, në mes, ashtu edhe në fund të saj. Për shembull:

*-Shkurtimisht, duhet të jesh më e kujdesshme.*

*-Intelekti, atëherë, është ana kritike, krijuese dhe mediituese e mendjes.*

*-Rezultatet ishin të pritshme, siqurisht.*

Ajo që duhet të kemi parasysh kur ndeshemi me lidhëzorët logjikë, është fakti se autorët i përdorin ato me qëllim që të na udhëheqin drejt një arsyetimi që ata e quajnë të drejtë, por jo gjithmonë e drejta sipas tyre është e drejta e vërtetë (Mortara & Garavelli, 2010). Kështu, p.sh., kur lidhëzorët logjikë përdoren me qëllime të errëta gjatë një ligjërate politike, kërkohet të jemi tepër të kujdeshëm si në rolin e lexuesit, ashtu edhe të dëgjuesit.

**Krahasimet**

Një nga teknikat më të përdorshme të retorikës është krahasimi, i cili nënkupton të krahasuarit e dy gjërave, që mes tyre kanë të paktën një ngjashmëri, me qëllim konkretizimin e dukurisë apo fjalës. Krahasimet shoqërohen dendur nga lidhëzat *si, ashtu si, porsi.*

*-Ecja e saj ngjante si fëshfërima e gjetheve.*

*-Shpresa po përhapej dalëngadalë në sytë e tyre ashtu si vjen drita e ditës së re.*

*-Lajmi u përhap porsi një rrufe në qiell të hapur.*

Po ashtu, shprehje frazeologjike të shqipes që ndërtohen me këtë lidhëz, p.sh.: *si kofini pas të vjeli; si peshku pa ujë, si nuse me tela* etj., janë mjete të fuqishme krahasimi.

Aftësia për të vendosur lidhje, shoqërime, përbashkësi të ngjashme përbën vlerën më të madhe të krahasimeve si edhe fuqinë për të zgjeruar dhe harmonizuar përvojën tonë (Kane, 2010). Gjithsesi, duhet patur kujdes në përdorimin e tyre pa vend. Gabime bëhen sidomos kur krahasimi jo vetëm që nuk është i afërt, por as që përputhet me situatën dhe qëllimin. Kështu, për shembull, nuk do të ishte me vend përshkrimi i një vajze të ndrojtur me anë të krahasimit:

*-U skuq si domate e pjekur* ose, në një rast tjetër, është përdorur pa vend krahasimi:

*-Ne kemi nevojë për krijime të reja, ashtu si kemi nevojë për ajrin që thithim.*

Nga ana tjetër po qe se gjykojmë se dy situata janë kaq të afërta sa që mund t'i quajmë pa frikë identike, atëherë kemi të bëjmë më **metaforën** (*gr. metaphora*- përdorimi i një fjale a një shprehjeje me kuptim të figurshëm në bazë të krahasimit sipas ngjashmërisë)**,** si figurë mjaft të përhapur të retorikës, për shembull:

*-Dështimi i dredhisë së këtij diskutimi po vret mundësinë për kompomis.*

*-Debati është një luftë që kërkon përdorimin e të gjitha armëve në dispozicion.*

Ashtu si krahasimi, analogjia, edhe metafora, mund të ketë përdorime jo të drejta përsa i përket zgjedhjes së fjalëve për ndërtimin e tyre. Për shembull:

*-Kjo ide pa vlerë po bëhet mjaft e populluar.*

*-Kjo ide pa vlerë ka filluar të infektojë opinionin publik.*

*-Kjo ide pa vlerë është kthyer në një virus për opinionin publik.*

*-Kjo ide pa vlerë është një kancer për shoqërinë tonë.*

Pra, shihet se roli i autorit (folësit apo shkruesit) mund të jetë shumë larg realitetit, prandaj duhet të mësohemi të mbajmë edhe rezerva ndaj metaforave të këtyre përmasave, (të shumëgjendura këto në stilin publicistik), sidomos kur përdoren me qëllim dezinformimin dhe jo informimin.

**Metonimia** (*gr. metōnymia*- ndërrim i emrit) është një lloj metafore, në të cilën krahasimi është i lidhur me diçka, por nuk është identik me qëllimin e diskutimit (çështjes). Ndryshimi kryesor nga metafora është se lidhja metonimike bëhet mbi bazën e afrisë së pranishme jashtë gjuhës dhe është e shprehur me fjalët përkatëse në tekst (Kane, 2010):

*-Kurora (në këtë rast -mbretëria si formë qeverisjeje) u mor seriozisht me persekutimin e saj.*

*-Shteti (në këtë rast- jo si person, por si grup personash) nuk u kujdes aspak për veprat që ajo la.*

**Personifikimi,** që njihet ndryshe dhe me termin anthropomorfizëm (*gr. anthropomorphos* - që ka formën ose pamjen e njeriut) gjithashtu, është ajo teknikë e retorikës, e cila na lejon t'u veshim objekteve, stituatave, kafshëve etj., karakteristika njerëzore .

*-Ligji është duke më sulmuar në këtë çështje.*

*-Mjerisht, më duhet të pranoj se kam takuar më shumë qenë besnikë sesa njerëz.*

*-Ndieja se ajri rreth meje ishte ngritur në protestë.*

Kalimi i caqeve në situata të tilla mund të na çojë në përshkrime të çuditshme, sigurisht, por personifikimi, në fund të fundit, na ndihmon të mund të rimodelojmë një ide të vështirë në terma njerëzorë për të rrokur më të lehtë kuptimin e saj (Kane, 2010).

**Hiperbola** (*gr. hyperbalo*-tejkaloj, teproj).

Ndonjëherë na del e nevojshme të zmadhojmë gjërat për efekte retorike, kështu themi:

*-Në radhë prisnin miliona njerëz.*

*-Do më duhet gjithë jeta të mbaroj këtë punë.*
*-Këto masa politike shënojnë fundin e qytetërimit , ashtu siç e njohim ne.*

Këto zmadhime të qëllimshme nuk duhen marrë fjalë për fjalë, por në funksion të një aspekti të veçantë të fjalisë. Një hiperbolë e përdorur pa masë dhe pa vend bën që dëgjuesit dhe lexuesit të mos e marrin seroizisht atë çka thuhet dhe dëgjohet.

**Litota** (gr.litotēs- thjeshtësim, pakësim, zbutje).

Litota, nga ana tjetër është nënçmimi që ka për qëllim theksimin e shprehjes duke mohuar konceptin e kundërt që pritej. Për shembull:
*-Performanca të tilla nga Celine Dion, janë jo të pazakonshme. (1)*
*-Performanca të tilla nga Celine Dion, janë të zakonshme.* (2)

Rasti i dytë, në dallim nga i pari, thjesht informon për situatën, pra pavarësisht se në fund të fundit pohon të njëjtën gjë me të parin, loja gjuhësore me efekt që përdoret me anë të litotës, e bën rastin e parë shumë më mbreslënës se të dytin.

**Analogjia** është një lloj i veçantë krahasimi, me anën e të cilit sillet një temë tjetër për të treguar një ngjashmëri, e cila shpjegon ose përligj diçka nga tema kryesore. Analogjitë ndryshojnë nga krahasimet e zakonshme në dy drejtime kryesore ( Kane, 2010).

Së pari, ato përqendrohen vetëm në një temë apo nëntemë, ku analogjia është vetëm dytësore dhe shërben vetëm për të sqaruar ose theksuar.

Së dyti, objekti analogjik mund të ketë, një natyrë krejt tjetër. Krahasimi zakonisht ka të bëjë me gjëra krejt të ngjashme, mali dhe kodra, shkolla e mesme dhe universiteti, vetura dhe mikrobusi etj. Vlera e analogjisë, nga ana tjetër shtohet nga gjetja e ngjashmërive në gjëra të pangjashme, si për shembull, "lënda e të shkruarit krijues" dhe "vizita në kopshtin zoologjik" apo "parlamenti" me "kopshtin e fëmijëve" etj.

Përveç sqarimit, analogjia përdoret shpesh edhe për forcën e saj bindëse. Në këtë funksion nuk duhet ngatërruar analogjia "retorike", që po diskutojmë, me analogjitë "logjike". Në logjikë, analogjia është një lloj prove e veçantë dhe rigoroze. Ndërsa analogjia retorike jo gjithmonë është një formë prove a vërtetimi. Ajo, në vetvete, nuk mund të demonstrojë të vërtetën e asnjë përfundimi të nxjerrë. Në rastin më të mirë, ajo është një "formë e dobët arsyetimi" sipas së cilës, meqë A ngjan me B në disa drejtime, duhet të ngjajë me të edhe në shumë drejtime të tjera. Të tilla raste janë pohimet:
*-Jeta është si lojë fati.*
*-Njeriu që ka një shprehje të qetë prej tirani në fytyrë,është si ai personi që ka dështuar në dhënien e alarmit për një zjarr që ka rënë.*

Në përdorimin e tyre shpesh gjen edhe lëshime, sepse situatat analoge për dikë nuk mund të jenë po aq analoge për një tjetër. Gjithsesi analogjitë janë gjëra personale që duhet të rrjedhin nga përvoja dhe vlerat e gjithsecilit.

**Nënvlerësimet,** janë mjete që nënkuptohen, por nuk shprehen drejtpërdrejt. Nënvlerësimet përdoren sidomos prej satirizuesve, të cilët mbahen si mjeshtër të përdorimit të tyre, por, si një teknikë të retorikës, ne mund t'i përdorim ato për të bindur dikë duke riformuluar idenë me terma më pak fyes (Lanham, 1991). Përshembull, ta zëmë se besojmë se ideja e dikujt është një gabim, të cilin duam ta vemë në dukje, çka mund të shprehet me anë të alternativave të mëposhtme:
*-Në përfundimin që ke nxjerrë, mendoj se janë disa faktorë të tjerë, të cilët nuk i ke marrë parasysh.*
*-Analiza jote është diçka elementare.*

*-Asnjë s'ka për ta marrë seriozish idenë tënde marramendëse.*

Pavarësisht bindjes sonë për nënvlerësimin e idesë së personit, ne nuk mund të anashkalojmë faktin që ai mund të jetë një ithtar i asaj, që ne e quajmë pa vlerë. Gjithashtu, kur bëjmë një nënvlerësim apo një vlerësim negativ, duhet të kemi parasysh nëse po i drejtohemi një miku, i cili mund të mirëpresë pa problem kritikat tona; apo një të huaji, që nuk ka të njëjtën pritshmëri për kritikën tonë në lidhje me një vlerësim elementar apo minimal që ne po i bëjmë. Pra, çështja e zgjedhjes së fjalëve kërkon vëmendje, sidomos kur bëhet fjalë për situata të tilla kritike, duke theksuar këtu faktin që, në fund të fundit, vërejtja nga këshilla nuk është shumë larg.

**Pyetjet**

Në retorikë pyetjet nuk përdoren thjesht kur duam një përgjigje për një të panjohur. Për shembull:

*-Ç'mund të themi për mundësinë e ndikimit të faktorëve shoqërorë në një krizë ekonomike? Kritika me sa duket iu shmanget këtyre faktorëve, sepse…*

*-Cilat janë pasojat e ndotjes së mjedisit? –*

*-Patjetër që janë disa, por më e rëndësishmja është…*

Kështu, siç shihet, është bërë një pyetje, së cilës më pas i është dhënë dhe një përgjigje dhe, kjo e fundit, nga ana e saj, sjell "përfitime", pasi na lejon të nxjerrim paraprakisht përfundime, të cilat lexuesi apo dëgjuesi mund t'i ketë në mendje. Po ashtu, edhe po qe se ata nuk janë të orientuar drejt një këndvështrimi të tillë, me anë të kësaj pyetjeje ne sigurojmë kanalizimin e çështjes në fjalë. Kjo është një teknikë e përdorur nga folësit me një pauzë të vogël para se të përgjigjemi, në mënyrë të tillë që të japim një mundësi reflektimi dëgjuesve. Të tilla pyetje në retorikë quhen **ipofora, pyetje orinetuese** *(gr. hipophoro- mbaj, sjell, drejtoj),* (Lanham, 1991) dhe janë mjaft të përdorshme nga mësimdhënësit në ligjëratat e tyre).

Ndërsa ato pyetje që nuk bëhen për të marrë patjetër një përgjigje, apo përgjigjet e të cilave nënkuptohen lehtë pasi janë të dukshme, i quajmë **pyetje retorike.**

*-Cila nënë nuk do fëmijën e saj?*

*-Cili është ai që mund të verë një bast për moslindjen e diellit nesër?*

Një alternativë tjetër e përdorimit të pyetjes retorike është përdorimi i saj për të krijuar një përshtypje në favor ose jo të një ideje apo argumenti. Për shembull:

*-Kjo mënyrë të menduari kërkon që ne të heqim dorë nga pavarësia jonë. Por, a është vërtet kjo ajo që ne duam?*

Pyetje të tilla retorike na ndihmojnë për të ndriçuar situata të ndërlikuara (si shembulli më sipër, pra fitimi i diçkaje në këmbim të lirisë), ku pretendime të diskutueshme ndiqen nga pyetje retorike, të cilat mohojnë një përfundim që dilte i gabuar, si rezultat i një arsyetimi të shtrembër.

Një tjetër mundësi paraqitjeje e pyetjes retorike është ajo që nuk kërkon përgjigje pasi diskutimi i mëparshëm e ka përfshirë atë. Për shembull:

*-Ju e dini që një votë për kundërshtarin tim do t'ju kushtonte juve punën, pa të cilën nuk mund të bëni dot. A do të vazhdosh akoma ta mbështesësh atë?*

Këto lloj pyetjesh, karakteristike të një debati politik, e thjeshtojnë punën për një përpjekje të sforcuar, që detyron lexuesin apo dëgjuesin të veprojë në një mënyrë të caktuar.

Retorika, njeh gjithashtu, dhe **arsyetimin e rremë të pyetjes së ndërlikuar** (Kane, 2010) të tipit:

*-A e rreh me gruan?*

*-A vazhdon të jesh një alkolist?*

Pyetje të tilla në formën e "grackës" bëhen qëllimisht për të marrë përgjigjen e kërkuar. Ato fshehin dy pyetje brenda një

pyetjeje të vetme (në fushën juridike janë pyetje të zakonshme).

Së fundi, **prokatalipsis** (gr. *procatalepsis* - paragjykimet**),** janë mjete për pyetje dhe përgjigje duke parashikuar vërejtje të caktuara (Lanham, 1991). Për shembull:

*-Mendohet se kjo skuadër nuk do t'i kushtojë vëmendje organizimit në mesfushë, gjë qëështë për të ardhur keq, pasi kështu neglizhon përvojën e fituar në ndeshjen e fundit …*

*-Shpesh mendohet se mësuesit, janë e vetmja përgjegjësi për mbarëvajtjen e fëmijëve, ndërsa unë mendoj se duhet t'i kushtojmë vëmendje edhe…*

Kundërargumente të mundshme mund të paraqiten në formën e tyre më të ashpër. Diçka e tillë zakonisht varet nga fakti se sa pozitiv është shkruesi ndaj një teme ose se sa është duke e përmirësuar apo përkeqësuar ai situatën me anë të një përshkrimi të mangët, në mënyrë që të ndikojë drejt një vlerësimi pozitiv apo negativ të atij që lexon apo dëgjon mbi të.

**Asindeti dhe polisindeti.**

Shohim fjalinë e mëposhtme:

*-Ai dallohej për bujarinë, për zgjuarsinë, për forcën, për inteligjencën, për bukurinë*.

Duke e lexuar dhe duke shkuar drejt fundit të saj, ne duhet të shpreheshim "inteligjencën dhe bukurinë". Diçka e tillë bëhet enkas për të lënë përshtypjen se lista e cilësive të dikujt mund të vazhdonte edhe më. Këto janë shembuj të ndërtimit **asindet (***gr. asýdenton,stil*. mospërdorimi i lidhëzave midis fjalëve dhe fjalive), kur lidhëzat mënjanohen për të lënë pikërisht përshtypjen e shumëllojshmërisë ose idenë se ekziston dhe diçka tjetër, e cila nuk është thënë ende.

Po qe se rastin e mësipërm e paraqesim në formën:

*-Ai dallohej edhe për bujarinë, edhe për zgjuarsinë, edhe për forcën, edhe për inteligjencën, edhe për bukurinë*, atëherë kemi një ndërtim **polisindet** (*gr. polý + sýndeton* - shumë lidhëza, *stil*. përdorimi i lidhëzave të shumta në fjali), çka lidhet me vendosjen e të gjitha lidhëzave të mundshme. Tani efekti i retorikës është përpjekja për ta shprehur me pak fjalë diçka që në të vërtetë është shumë më e ndërlikuar, ose e thënë ndryshe teknika "për t'u kapur rob" brenda një fjalie të vetme. Si rezultat në një ndërtim të tillë të krijohet përshtypja se pas çdo lidhjeje po vjen një fund, një fund i cili zgjat më tepër se ç'duhet. Këto ndërtime mund t'i përdorim sidomos kur duam të japim përshtypjen se po shpjegojmë diçka dhe për të fituar kohë, thjesht bëjmë një "tërheqje në sipërfaqe të çështjes në fjalë" (Kane, 2010). Në letërsinë artistike, të gjitha ndërprerjet që bëhen me anë të lidhëzave në ndërtimin me polisindet, mund të paraqiten edhe si fjali më vete. Për shembull:

*-Gjithçka e tij ishte e bardhë. Edhe mjekra.*

*-Edhe mustaqet. Edhe flokët. Edhe plisi. Edhe tufa e deleve. Edhe shtëpiza.*(Demolli, 2012).

**Paralelizmi**

Në fjalinë:

*-Tha se ajo nuk kishte asnjë shpresë dhe shtoi se ne nuk kishim asnjë shpëtim*, kemi një ndërtim të balancuar, ku pjesa e parë "*ajo nuk kishte asnjë shpresë"*është paralele me pjesën e dytë "*ne nuk kishim asnjë shpëtim*". Një ndërtim i tillë quhet paralelizëm dhe ndihmon për t'i treguar një lexuesi apo dëgjuesi që pjesët e fjalisë kanë të njëjtën rëndësi. Ndërkohë, mund të hasim ndërtime më të ndërliqura se rasti në fjalë:

*-Falë zellit të tyre, falë përkushtimit të mësuesve, falë punës së prindërve dhe falë talentit që i karakterizon, fëmijët bënë një paraqitje dinjitoze.*

Është pikërisht ngjashmëria e pjesëve paralele të periudhës, e cila ne lejon të kemi nën kontroll kontekstin e fjalisë,

edhe po qe se ajo zgjat shumë më tepër se në shembullin e fundit.

**Kiazma** (*gr. chiasmos* –kryqëzim, vendosja e diçkaje në trajtën e shkronjës X)

Ndërtimi i anasjelltë i një paralelizmi me veçorinë për të mos humbur kuptimin, është quajtur **kiazmë.** Kjo teknikë përdoret dendur në krijimin e aforizmave (Kane, 2010).

*-Nëse do shpirtin, harroje trupin, nëse do trupin, harroje shpirtin.*

*-Piktura është poezi që e shohim, kurse poezia është pikturë që e dëgjojmë.*

**Të vërtetat"e thëna dhe të pathëna"**

Ndodh që shkruesi apo lexuesi të përmendë diçka, por pa patur qëllimin deklarativ të asaj që thotë:

*-Unë do të të quaja qënjeshtar dhe mashtrues, po qe se ti nuk do të ishe shoku im.*

*-Për fat të mirë, na është ndaluar të gjykojmë besnikërinë martesore të kundërshtarit, meqë morali i tij duhet mbajtur lart, dhe kjo sipas besimit personal që ai ka për veten.*

Aludime të tilla janë quajtur **apofasis** *(gr. apophasis - vendime)* (Lanham, 1991) dhe përfshijnë ngritjen e një çështjeje, ndërkohë që na duhet të përmendim një justifikim që, pavarësisht se bie në kundërshtim me të, arrin të pohojë të kundërtën me anë të një efekti retorik, që, nga ana e vet, ka një mungesë sinqeriteti në përmbajtjen e tij.

Ndërsa në shembullin:

*- Jam i sigurt zonjë, se nuk më duhet t'ju kujtoj, se pirja e duhanit nuk lejohet në makinë,* -nuk na nevojiten qëndrime të caktuara, por qëllimi është të sqarojmë, të sjellim argumente, madje me mirësjellje, të kërkojmë vëmendje ndaj një shkeljeje (siç është rasti në fjalë), duke mos dashur të vemë në pozicion të vështirë atë që gjendet përballë.

**Entiemema** (*gr. en thýmō – logj.* përfundim i shkurtuar i nxjerrë nga një premisë, derisa tjetra mbetet e pathënë.)

Vërejmë shembujt e mëposhtëm:

*-Meqë u dënua, duhet të ketë qenë fajtore.*

*-Kemi vetëm dy mundësi dhe ndërkohë kemi parë që e para dështoi.*

*-Ai është polic dhe ju i keni dëgjuar barcaletat për policët.*

Entimema është një silogjizëm jo i rregullt, në të cilin mungon njëra prej premisave ose vetë përfundimi (Kane, 2010). Entimemat përdoren kur pjesët që përmenden si dhe ato që mungojnë, janë të dyja të kuptuara dhe të pranuara nga lexuesi e dëgjuesi, njësoj sikur silogjizmi të jepej me të tre përbërësit e tij, pra, e thënë ndryshe, entimema kuptohet lehtë ashtu si silogjizmi, nga i cili e ka prejardhjen.

**Metanoia** (*gr. metanoia* - gjunjëzim, pendesë) ose thënë ndryshe **përfundime me pendesa**.

Kur duam të shpalosim një qëndrim, por duke fshehur qëllimin e tij, përdoret *metanoia*:

*-Propozimi juaj do të jetë dobiprurës për gjithë fshatin, madje për gjithë zonën përreth.*

*-Zbatimi i masave që ju morët dështoi - ose të paktën ju nuk i konsideruat pasojat e tyre seriozisht.*

Pjesa e dytë e periudhave ose informacioni që atyre u shtohet, mund të diskutohet përsa i përket kështillës që ajo pretendon të japë: mund të shihet pjesa e parë si një ide e gabuar dhe kështu ajo që vijon është shpëtimi i saj. Kur shkruesi apo folësi duket se na nxit drejt një përfundimi, që është më shumë se ajo që nënkuptohet nga konteksti ose është duke moderuar një mendim të guximshëm, atëherë na duhet të bëjmë kujdes përkundrejt një gabimi në arsyetimin e tij të fshehur (Lanham, 1991).

**Aporia**(*gr.aporia* – luhatja)

Një teknikë e retorikës që përdoret për të shprehur pasiguri, dyshim apo luhatje

quhet *aporia*, e cila shpeshherë mund të merret edhe si mungesë çiltërsie, deri në dredhi. Ndërtohet me anë të pjesëzave paradalëse: *më duket se, kam frikë se, dyshoj se, më ngjan se* etj.Për shembull:

*-Nuk jam i sigurt nëse burimi i informacionit është i saktë, por është e qartë se…*

-Më ngjan se*një libër i tillë nuk ka për të dalë në treg.*

Duket qartë,që shembulli i parë, është ndërtuar me modesti nga autori, gjë që nuk mund të thuhet për shembullin e dytë, ku autori mëton më shumë se ç'duhet (po qe se pranojmë faktin që ai e mendon seriozisht atë që shpreh) ose mund të ndodhë edhe më keq, kur autori është duke dredhuar për të fshehur përçmimin e tij në lidhje me librin (në një rast të tillë kemi të bëjmë me një ironi të fshehur).

**Paranteza** (*fr. parēnthèse***-** fjalët ose fjalitë e tilla që futen në kllapa)**,** është diçka që thuhet për të mbështetur ose plotësuar diçka tjetër (kohët e fundit "është e modës" që edhe folësit bëjnë me shenja përdorimin e thonjëzave për t'u tërhequr vëmendjen të tjerëve se po shtojnë diçka apo ajo që thonë nuk po përdoret me kuptimin e saj të drejtpërdrejtë). Për shembull:

*-Shqetësimi im kryesor- i cili përbën dhe pikën kritike të çështjes- është fakti që njohuritë e marra nuk mund të gjejnë lehtë zbatim në praktikë.*

*-Ndodh shpeshherë (dhe ky është një prej atyre rasteve) kur kryefjala mungon në fjali.*

Paranteza përdoret shpesh në retorikë. Ndërkaq, është me vend të bëjmë një dallim të rastit të parë (ku paranteza ndahet me vizë lidhëse) dhe të rastit të dytë (ku paranteza shënohet midis kllapash). Parenteza që shënohet midis kllapash nuk theksohet aq sa ajo që shkruhet me vizë lidhëse (Garavelli, 2010). Kjo e fundit paraqitet më dinamike për vetë faktin se vjen papritur si një ide e re që nuk mund të lihet pa përmendur, në dallim nga paranteza midis kllapash, e cila është thjesht një ide mbështetëse dhe nuk përbën problem edhe sikur të mungojë.

**Përfundime**

Siç shihet, nga sa u parashtrua në këtë punim, retorika gjendet gjithandej duke iu larguar gjithmonë e më shumë ngjyrimit negativ, i cili e ka shoqëruar rëndom. Ne nuk mund të kritikojmë një shkrues apo një folës se po përdor shumë "pathos" apo shumë "logos", pasi efektiviteti i përdorimit të tyre varet nga faktorë të tjerë siç janë vendi, qëllimi, auditori apo stili.

Po qe se ka nga ata që nuk binden nga argumentet tona, do të jetë një gjykim i gabuar të bëjmë fajtorë ata që nuk na kuptuan duke i etiketuar si "tabularasa" dhe, do të ishte mirë të shohim në mënyrë kritike teknikat retorike që ne përdorëm për t'i bindur, pasi mund të jetë përdorimi i gabuar i tyre që çoi në një rezultat të tillë.

Duke u familjarizuar me përdorimin e teknikave të retorikës, ne ndërgjegjësohemi për të kuptuar se si disa ligjërata të caktuara apo pjesë të shkruara janë më bindëse se disa të tjera. Në të njëjtën mënyrë, me bindjen tonë kultivojmë te të tjerët suksesin e përdorimit të tyre, si dhe jemi në gjendje të dallojmë nëse dikush po i përdor këto teknika për të ndikuar në mendjen tonë.

**Bibliografi e shfrytëzuar**

Corbett, Edward P. J., Connors, Robert J. (1991).*Classical Rhetoric for the modern student*, Oxford University Press,.
Demolli, A .(2012). *Plaku zemërbardhë*, në Gjuha shqipe 4, SHBLSH, Tiranë.
Garavelli, B. Mortara (2010). *Manuale di Retorica*, Tascabili Bompiani
Guingan, Brendan Mc (2007). *Rhetorical devices:A handbook and activities for student writers*, Prestcwik House, INC.
Kane, Thomas S. (2010). *Si të shkruajmë shqip (Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe Retorikën),* CDE
Kennedy, George A. (1991). *Aristotel, on Rhetoric: A Theory of Civic Discourse*. NY/Oxford: Oxford University Press.
Lanham, Richard A. (1991). *A handlist of Rhetorical terms*, University of California Press,
Lauer Janice M., (2004), *Invention in Rhetoric and Composition*, Parlor Press
Mojello, Carlo (1998). *L'arte di parlare in pubblico*, Editoriale libri Paoline
Piazza, Francesca (2008). *La Retorica di Aristotele*, Canocci
Shkurtaj, Gjovalin (2008). *Si të shkruajmë shqip,*Botimet Toena.

# PASURIA SINONIMIKE NË VEPRËN E KUTELIT

**LIRI SEITLLARI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Të studiosh gjuhën në prozën e Kutelit duhet të pranosh se je përpara një gurre pasurish të pashtershme. Në konceptet e tij për artin merr vlerë të veçantë forma, prandaj natyrshëm ai përpiqet ta estetizojë dhe ta rrisë shprehësinë e teksit. Për këtë e ndihmojnë dy faktorë të rëndësishëm: mundësitë e ofruara nga vetë shqipja si dhe njohja e thellë e autorit kundrejt saj.

Mjetet gjuhësore me të cilat Kuteli rrit cilësinë dhe shprehësinë e tekstit janë të shumta, por në këtë punim do të ndalemi te sinonimia. Përmes hulumtimit të gjerë dhe analizës, ky punim ka për qëllim të ofrojë pamjen e pasur dhe cilësore të paradigmës sinonimike kuteliane. Me anë sinonimisë Kuteli përpiqet ta përcjellë sa më të plotë, sa më të qartë, sa më të saktë mesazhin te lexuesi dhe, ndërkohë, realizon edhe qëllimin e tij prej shkrimtari që shprehja gjuhësore të marrë funksion estetik.

Kuteli krijon paralele sinonimike duke shfrytëzuar burime të ndryshme popullore dialektore, por më së shumti atë juglindor, duke nxjerrë prej harrimit shumë prej tyre, por edhe duke krijuar vetë neologjizma. Elementet e reja të vargjeve sinonimike janë më së shumti fjalë të prejardhura dhe në një grup më të vogël janë fjalë të përbëra. Ndërsa, në aspektin leksiko-gramatikor vërehet se rastet më të shumta i shënojnë emrat, të cilët pasohen nga mbiemrat, foljet dhe më pas ndajfoljet.

Në shërbim të synimeve estetike është jo vetëm përzgjedhja, por edhe mënyra e strukturimit të sinonimeve. Në këtë pikëvështrim, te Kuteli ndeshen rëndom dy lloj grupimesh: së pari, çifti sinonimik që krijohet nga pranëvënia e dy elementeve të një paradigme në një sintagmë, përdorimi i shpeshtë i të cilit kthehet në një tipar karakteristik të stilit të tij dhe, së dyti, vargjet sinonimike te të cilët hyjnë në marrëdhënie sinonimie edhe njësi që nuk janë të tilla.

**Fjalët çelës:** *Paradigmë sinonimike, sinonim i mirëfilltë, sinonim kontekstual, çift sinonimik, varg sinonimik, dukuri gjuhësore*

**Abstract**

Kuteli is and will remain the great master of Albanian prose, because he, like nobody else, could use Albanian language qualitatively, which is evident in his high attention to the selection and use of language. Studying language in Kuteli prose should know that you are in front of a rill inexhaustible riches. In his concepts of art, forms takes special value, so naturally he tries to increase expressive of text.

For this help two important factors: the opportunities offered by the Albanian language and the author's the deep knowledge of it. Linguistic tools which Kuteli increases the quality and expressive text are numerous, but in this paper will focus on synonyms.

Through extensive research and analysis, this paper aims to provide the rich appearance and quality in Kuteli synonymous paradigm. Through the synonyms Kuteli try

convey as full, as clear, as precise message to the reader and, meanwhile, realizes the intention of the writer to express his linguistic take aesthetic function.

Kuteli creates synonymous parallel using popular dialect different sources, but mostly the southeast dialect, by deriving more of them, but also creating neologisms themselves. Elements of the new arrays synonymous are mostly derivative words and in a smaller group of words are composed. In the lexicon-grammatical noted that most cases are names that are followed by adjectives, verbs and adverbs. Aesthetic importance is not only the selection, but also ways of structuring synonymous.

In this view, to Kuteli often encounter two types of entities: first, the synonymous couple created by putting next two elements of paradigm in a syntagma, frequent use of which becomes a characteristic feature of his style and, secondly ranges synonymous to synonymous , which enter into synonymous relationship with units that are not such.

**Key words**: *Paradigm synonymous, authentic synonym, contextual synonym, synonymous couple, synonymous range, linguistic phenomenon*

Kuteli është rasti i shkrimtarit të përgjegjshëm, që punon pa u lodhur me gjuhën, i shkrimtarit të pakënaqur nga vetja e vazhdimisht kërkues, që vërtet e shfrytëzon të folmen e krahinës së vet, por duke e riorganizuar atë artistikisht *për të mos rënë në ngjyresa krahinore ose në një ligjërim të rëndomtë* (Thomai, 2001, p. 140).

Vepra e tij dëshmon më së miri njohjen e thellë që ai ka ndaj gjuhës shqipe në përgjithësi si dhe gjuhës së popullit në veçanti, prandaj në veprën e tij dalin si në dritën e diellit vlerat e kahmotshme të gjuhës, të pasuruara më tej si në planin kuptimor, emocionues, shprehës dhe në atë fjalëkrijues. Ai të mëson ta duash gjuhën shqipe, të bind natyrshëm që të kesh vlerësimet më të larta për të dhe, mbi të gjitha, të ndihmon me zellin e një mësuesi pasionant. Të lexosh veprën e Kutelit, do të thotë të ndjekësh një kurs të shkëlqyer në fushën e gjuhës shqipe, por dhe më tej, sepse proza e tij dallohet në gjithçka: në pasurinë e leksikut, në qartësinë dhe shprehësinë e admirueshme, në begatinë e paradigmave, në lidhjet e veçanta fjalësore, në strukturimin e togfjalëshave, fjalive dhe frazave.

Duke qenë se një nga parimet kryesore krijuese të tij është kujdesi i posaçëm për formën, vjen natyrshëm dhe vëmendja e lartë në përzgjedhjen dhe përdorimin e mjeteve gjuhësore. Në këtë studim do të merremi me pasurinë e çmuar që Kuteli sjell në fushën e sinonimisë, me të cilën vërteton atë që thuhet se çdo fjalë, ose shprehje mund të ketë, ose mund të krijojë sinonimi. Siç dihet, sinonimet për leksikologjinë janë fjalë me kuptim të njëjtë ose të ngjashëm, ndërsa *për stilistikën ato trajtohen në kuptim të gjerë dhe konsiderohen ndër çështjet qendrore* (Lloshi, 2005, p. 136). Një pjesë e mirë e krahinorizmave të Kutelit kanë sinonimet përgjegjëse jo vetëm në gjuhën letrare, por edhe në dialekte dhe të folme të tjera.

Kuteli është këmbëngulës në gjurmimin apo krijimin e sinonimeve dhe me anë të tyre bën saktësimin më të plotë të dukurisë, apo të mendimit që përshkruan, shmang përsëritjet dhe rutinën që mund t'i sillte kjo tekstit dhe rrit ndjeshëm shprehësinë dhe bukurinë e tij. Ashtu siç thotë Jani Thomai, *begatia sinonimike e shqipes pasqyrohet në veprën e tij në një sistem të pasur e të ndërlikuar sinonimesh e mënyrash sinonimike të cilat autori i përdor sipas rastit, herë për të bërë nuancime të holla kuptimore e emocionuese, herë për mbushjen e fushës*

*semantike dhe variacionin leksikor të frazës* (Thomai, 2001, p.143). Për shembull:

***Hedh sytë*** *rreth e qark e nuk* ***sheh*** *veçse gurë e cungje. Afrohet e* ***këqyr*** *gurët e bjeshkës dhe i* ***njeh*** *pas shenjës kreshnikët e tij.* (Vepra 4, p. 63); *Mrizet, sheshet, gurrat mbeten* ***të jeremitur****. Në mes të kësaj* ***jeremie*** *qëndron vetmitare,* ***e habitur****, nusja e Mujit*. *Veç ajo ka mbetur e gjallë, po* ***s'di ç'të bëjë*** *e* ***nga t'ia mbajë****.* (Vepra 4, p. 62); *Kur të dilni majë bjeshkës, do të gjeni tri mrize të mëdha. Aty* ***ruajuni****, mos lodroni,* ***kini mendjen,*** *mos uli të* pushoni***, mbani veten*** *e mos flladiti gurrave.* (Vepra 4, 1990, p. 61); *Nuses i vanë sytë tek unaza, e njohu menjëherë dhe* ***i shpëtuan lotët*** *syve,* ***iu rrokullisën sumbulla – sumbulla*** *faqeve të kuqe****, i ranë pika – pika*** *gjirit të bardhë.* (Vepra 4,1990, p. 45); *Kuçedra është shumë e keqe:* ***të përvëlon, të ha, të përpin****.* (Vepra 4, 1990,p. 17); *As vetë Xheladin beu nuk dinte përse ndiente një* ***zbrazëtirë*** *aq të madhe në zemër atij mëngjezi vjeshte të dytë. Një* ***zbrazëtirë*** *sa një* ***zgërbonjë*** *gështenje që e ka brejtur krimbi përbrenda, një* ***shembëtirë,*** *një* ***turbullirë*** *e një* ***neveritje*** *pa fund e pa anë.* (Vepra 1, 1990,p. 63); *Veshi më nge rrobat e kadifesë së gjelbër me vija e* ***sumbulla*** *argjendi, që i kish apostafat për udhë e gjah.Sheqerja u ul në bisht e i mbërtheu* ***kopsat*** *poshtë nën gjunjë.* (Vepra 1, 1990, p. 88); *Jo vetëm graria e* ***fëmija,*** *që dihet që kanë mendje* ***çilimiu****, po edhe burrat me mustaqet gjer në vesh.* (Vepra 2,1990, p. 296) etj.

Kuteli krijon paralele sinonimike duke shfrytëzuar burime të ndryshme popullore dialektore, por më së shumti atë juglindor, duke nxjerrë prej harrimit (si rezultat i mospërdorimit për arsye nga më të ndryshmet) shumë prej tyre, por edhe duke krijuar vetë neologjizma, dhe në këtë pikë duket se autori zhvillon aktivitet krijues gjuhësor, qoftë në mënyrë origjinale, qoftë duke u mbështetur tek modelet ekzistuese të fjalëformimit të shqipes.

Në vështrim leksikor vërehet se ndërthurjet sinonimike krijohen më së shumti me fjalë dialektore, të cilat kanë kuptim konkret, me fjalë të cilat kanë lidhje me bimësinë, kafshët, me etnologjinë e zonës dhe më pak me fjalë të kuptimit abstrakt. Thuajse të gjitha *vargjet sinonimike kanë një a më shumë fjalë me shtrirje më të gjerë e që janë bërë normë, por në disa vargje dallimi i mbizotërueses ka qenë më i lehtë për shkak të njësisë mbidialektore* ( Thomai, 2001,p. 94). Për shembull: *sem, sinor, kufi, mezhdë; largqofti, qoftëlargu, djalli, xhixhima, i paudhi, i pagoji, i paemri, gojëlidhuri, gojëkyçuri; njëherë e njëkohë, qëmoti, në kohët e moçme; krye, kokë, kaplloqe; kapua, kaposh, kokosh, këndes; kanare, zhaurimë, burbujë; feste, kapë, takije, kësulë; rrëngë, rrëc, dingë, dëngës; çupë, çupërlinë, vashë, vasho, cucë, kopile, kedhe; djalli, dreqi; trastë, torbë, krahosh; kalor, kalorës; vrik, shpejt; qan, logorit, lebetitet, vajton; e bukur, bukurezë, perri, hyrije, rënëqielli; skorovod, lugat, kanxhallos, kukuth; tintëllin, tingëllin, xhingërin; koskë, kokallë, eshtër; ndrin, shndrin, vezullon, vetëtin; fillthi, fillall, vetëtimthi, rrëmbimthi, njëmenthi; atëlosh, babëlosh, babale; beriha, tevatyrë; s'ia var, s'e begenis, s'e vë në refene; komçë, sumbull, kopsanjë; një moti, një viti; i ngjeshur, dërdëng; kroçkë, dru, gdhë; vegël, qojle, orendi; shtohemi, shumohemi, shumëzohemi; ngadalë, më nge, kothere, koromane, kafshore; frymë, firomë, shpirt, xhan; zbardh, lbardh, zbardhëllon; e bardhë, e zbardhylët, bardhosh, bardhok; kuqëlon, kuqëron, përskuq, skuq, lkuq; shkes, shkesëtar, mbles, mblesëtar; krushqar, krushk; përkëmbej, mëkëmbej, javitej, çelej, çeledisej; fugoj, rent, harboj, gjëmoj, ngas, kaptoj; e athët, majoshe, e thartë; mastrapan, çupallkë, jamake;*

*jeremi, vilani, përhumbje, të fikët, përdhesi; tani, tashi, tanithi; asohere, atëherë, atëkohë, atëbotë; papandyer, befas, papandehur, menjëherë, njëmend, njëmendthi, papritur, pakujtuar; shkarazi, kaluarthi, rrëshqitazi, për brinjësh; shkarrëzimë, shembëtirë, rrëzomë; kulluzmë, blatë, abuz; kërr, kërriç, pulisht; zamzane, damixhan; dimite, çitjane; barkmadh, barktul, barkor; hiç, asfare, aspak, asnjë çikë, hiçgjë, mosgjë, vëlla, byrazer, vëlasho; bret, thërret, vikat; ngamot, vit për vit, përherë*.

Vargjet sinonimike të mësipërme, e të tjera të papërmendura, i shfaqin më qartë diferencat e tyre kuptimore e stilistike në përdorimet e ndryshme mikrokontekstuale e makrokontekstuale.Për shembull:

E *meqë bota s'kish përse të qahej, gjeti të qahej se s'kish* ***grunarë*** *e* ***koshare*** *ku ta derdhë këtë të uruar bukë.* (Vepra 2, 1990, p. 115); … *Edhe* ***qan*** *e* ***vajton*** *babanë e tij… vrarë me plumb romak.* (Vepra 2, 1990, p. 113); *Po kur kthehej Shkurtua në pinoku, dilte edhe e* ***përqeshte*** *në të ecur, me duar prapa, sa* ***gajasnim*** *që të gjithë.* (Vepra 2, 1990, p. 110); *Tërë Kotorret* ***zgërdheshen, qeshen, tallen****.* (Vepra 4, 1990, p. 99); …*po të vijë djali, ju bën* ***copë*** *e* ***gri më****.* (Vepra 4, 1990, p. 83); *Zëri i tij* ***çjerr*** *ajrin e bjeshkës,* ***gërvisht*** *dritën e hënës.* (Vepra 4,1990, p. 77); … *është vetë shqahu Paji Harambash,* ***i rëndë, i zymtë, zemërak****.* (Vepra 4,1990, p. 750); *Doriu është* ***i kapitur****. Ymer Aga është* ***i drobitur****.* (Vepra 4,1990, p. 49) etj. Pra, siç vihet re në shembujt e mësipërm, njësitë sinonimike në veprën e Kutelit nuk thonë qind për qind të njëjtën gjë, përkundrazi, për çdo rast, ato sjellin diçka shtesë, qoftë në rrafshin kuptimor, qoftë në rrafshin stilistikor. E nisim argumentin, së pari, me një rast, ku diferencën kuptimore midis dy fjalëve sinonimike e shpjegon vetë autori: *Asohere Zefi nga lugat që ish ra e u bë* ***kanxhallos****, njëzet herë më i keq se* ***lugati***. (Vepra 2,1990, p. 313). Diferencime të tilla saktësuese vihen re edhe në shumë shembuj të tjerë, si: *Sado që e mbante të mbyllur* ***në kyçe*** *e* ***kafaze****, gjithë bota e dinte se e shoqja e Zefit ish bukuria vetë nën dhe.* (Vepra 2, 1990, p. 312). Në këtë rast të dyja njësitë e paraleles sinonimike *në kyçe* e *në kafaze,* japin idenë e mbylljes, burgosjes, por në mënyrë më të intensifikuar e shpreh atë e dyta, sepse *kafazi* është hapësira më e vogël e mundshme, ku mund të mbyllësh e kyçësh dikë. Ndërsa në rastin: ***Qante*** *e* ***lebetitej*** *e shkreta grua brenda në shtëpi, me lugatin pranë, po s'kish njeri që ta mbrojë* (po aty); të dyja këto njësi sinonimike, përveç thelbit të tyre të përbashkët, kanë diferencë në ngjyresat e tyre kuptimore. Kështu *lebetitej* mbart një veprim njerëzor, i cili vjen prej një situate më të vështirë, më dëshpëruese dhe më pa rrugëdalje se sa ç'mbart leksema *qante,* sepse njeriu mund të qajë jo vetëm kur i ndodhin fatkeqësi të ndryshme, por pse jo, shpeshherë edhe prej të kundërtës, prej gëzimit, prej suksesit etj. Më tej, mund të themi se *lebetitej* përdoret posaçërisht në një situatë negative, pra është i qartë roli i saj saktësues përkundrejt fjalës tjetër paralele më të.

Natyrisht, rol të padiskutueshëm në sqarimin e marrëdhënieve kuptimore, por edhe stilistikore, në lidhjet sinonimike luan edhe konteksti i përdorimit të tyre, por në pamundësi për t'i bërë analizat e diferencave të të gjitha rasteve sinonimike, për arsye se vepra e Kutelit është plot me të tilla, më poshtë po japim thjesht shembujt, ku vërehet çka u tha më sipër. Për shembull:

*Kësi lugetër të mërzitur që punojnë vetëm* ***rengje*** *e* ***të këqija*** *kanë dalë e dalin ngamot në fshatin tonë.* (Vepra 2, p. 307); *Po ca kohë buza e lumit mbeti* ***kërr, e zhveshur****.* (Vepra 1, 1990,p. 360); **Mendohem** e **shtypem** e s'e sjell dot për

mend. (Vepra 2,1990, p. 304); *E si ngjallen… zënë e bëjnë **trazira** e **zullume**, si mos më keq… **punojnë të një mijë e njëqindat**.* (Vepra 2, 1990, p. 295); … *ranë në qef e nisën t'ia thonë këngës me këto **të thirrura**, me këto **të buçitura**, sa zëri u ngrihej qiri gjer lart te plepi.* (Vepra 2, 1990, p. 286); *Pasqyra… tregonte një burrë me **lapra, brezda** e sy të skuqur*. (Vepra 1, 1990, p. 74); ***Një** ishte Xheladin beu në atë mëngë të mbretërisë, **një e me vulë**.* (Vepra 1, 1990, p. 76); ***Shqyen** berra, **çan** derra e s'ngopet me gjak.* (Vepra 4, 1990, p. 297) etj.

Duke e shqyrtuar begatinë sinonimike të veprës së Kutelit, vërehet se ajo shfaqet si e tillë edhe në rrafshin fjalëformues dhe se elementet e reja të vargjeve sinonimike janë më së shumti fjalë të prejardhura dhe në një grup më të vogël janë fjalë të përbëra, për shembull:

-**ndajfolje**, te të cilat bie në sy prirja për sintetizim dhe për krijimin e mjeteve të reja shprehëse, si: *arithi* (ngrihem si ariu), *capthi*; *linkthi, fillthi, vetëtimthi, njëmentthi* (me të shpejtë); *rrokas, fytas, grykas* (e zë për fyti, për gryke); *qetë, qetas* etj.

**-emra**, te të cilët përfshihen kryesisht leksema që shprehin marrëdhënie farefisnore: *babëlosh, atëlosh, babale; nënoke, none, nënë; birth, evlath; vëlla, vëllam, vëllauth, vëllaçko; çupkë, çupëz, kunatë, kunatëz* etj., të cilat marrin nuancat kuptimore të përkëdhelisë nëpërmjet prapashtesave zvogëluese përkatëse.

**-mbiemra**, si: *dhelpërake, dhelpërore; i keq, keqan; murrak, i murrtë; shtrigore, shtrigushe; thatime, thatoke* etj., të cilët nuancojnë dallueshëm brenda të njëjtit spektër kuptimor. Për shembull: *keqan* është më e fortë kuptimisht se fjala *i keq*, sepse ajo e përcakton negativitetin e një individi të lindur si i tillë, ose i keq në tërësinë e tij, ndërsa mbiemri i dytë përdoret për karakterizuar një person, që është i keq në një, ose në disa aspekte të caktuara.

-**folje** të formuara me parashtesat -*sh,* -*për,* -*l* etj. Njësitë e krijuara prej tyre marrin kuptim më të intensifikuar dhe shprehësi më të lartë se gjegjëset e tyre sinonimike, si: *shndrit* përkundrejt *ndrit*; *përhumb* përkundrejt *humb; lkuq, lbardh* përkatësisht përkundrejt *skuq, zbardh* etj. Veçanërisht, dy foljet e fundit, duket qartë që marrin karakter shumë më poetik se sa përkatëset e tyre.

Po kështu, i kanë shumë të theksuara dhe në mënyrë të përhershme ngjyrosjet emocionuese dhe shprehëse sinonimet në formën e kompozitave, shpesh për shkak të natyrës së tyre të metaforizuar. Ato kthehen në të tilla vetëm po të vështrohen në kontekstin e caktuar, për shembull:

*Pra, fytyrat nuk i përshkruam pikërisht për shkak të këtyre të nëmosurave **kapela-luadhe** ose **kapela-bostane**, që ua fshihnin dhe ua bënin të mistershme… … Kish leshra të prera shkurt "**alla bebe**" ose më saktë "**alla bebekë**" apo "**allabebeçkë**".* (Vepra 1, 1990, p. 316); *Ky Beluli na kish pasur një zonjë **të bukur rënë-qielli**.* (Vepra 2, 1990, p. 307); *Kur e kur kolonel Shabedin Agua e mbledh shtabin nën rogoz, me ato kupa **të mëdha** përpara, me ato vozat **barkmadhe** aty pranë.* (Vepra 2, 1990, p. 293); *Ka moj motër, në botë, ca **sypëgërë** e **syplasje** që jarebi.* (Vepra 2, 1990, p. 83) etj.

Në veprën e Kutelit krijohen sinonimi edhe me ndërtimet frazeologjike, proverbat, thëniet popullore, urimet, mallkimet etj., të cilat janë në përputhje me frymën e përgjithshme të gjuhës së saj, me mbështetjen në tabanin gjuhësor të popullit, me frymën e ngjarjeve të kohës e të mjedisit ku ndodhin, me psikologjinë e personazheve, dhe si të tilla i japin një pamje dinamike e krejt të veçantë ligjërimit.

Shpeshtësia e përdorimit të tyre është shenjë e potencialit të shqipes në

këtë drejtim, por edhe e njohjes së saj prej autorit dhe e përzgjedhjes së tij cilësore, për shembull: *e hidhura me të hidhurën, e keqja me të keqen; dardha e ka bishtin mbrapa, mënon, duron, po s'harron; punon bulku, ha ulku, punon kali i barrës, ha kali i shalës; më rrofsh, të paça; me të zbardhëllyer dita, me të gdhirë; shpirt njeriu, i miri; për faqe të zezë, për turp të zotit; mbledh buzët, var hundët, var turinjtë; buzë më buzë, majë më majë; ishin bërë hi e shpuzë, nuk u kish mbetur nam e nishan; i iku mendja, e humbi toruan; i ke paret me bisht, i ke paret me lopatë* etj. Për shembull:

*…Ka bërë tri dasma në një dimër. E jo dasma* ***sidokudo, sa për të shkuar radhën****…*

*E si të mos ishte kështu, o i bekuar, kur buka ra nga qielli, sa* ***nuk matej dot me shinik*** *e* ***nuk peshohej dot me kandar****? Ra njashtu siç bie shiu në vjeshtë e dëbora në dimër* ***plot e përplot****. Sikush në kohën e vet, të lashtat e të vonat, erdhë e* ***u bënë det****, sa s'dukej brenda kalori hipur mbi kale.* (Vepra 2, 1990, p. 115); *Po Shkurtua* ***nuk nxirrte zë… rrinte*** *brenda* ***i tulitur*** *si miu, se macet ishin jashtë.* (Po aty, p. 111); *… i kollej në sy jo për gjë tjetër, po për* ***të ecurit*** *e saj* ***qibar, me kokën lart, si pisërënga****.* (Po aty, pp. 107-108); *Ti që na bëre këtë të mirë,* ***hap gojën*** *e* ***fol*** *çdo të të japim.* (Po aty, p. 99); *Më tha ai t'ia rrëfej se do të më nxjerrë një pizgë të madhe, një bilbil të madh pa gdhë, e* ***çmos*** *e* ***çnuk****, po unë jo e jo.* (Po aty, p. 95); *Paji Harambash* ***bëhet tym*** *e* ***mjegull****, hamullin fort e më fort.* (Vepra 4, 1990, p. 76); *Pastaj, e drejta ime është* ***sheshit*** *se, si të ha ai,* ***një fshat që duket, s'do kallauz****.* (Vepra 2, 1990, p. 280); *Ai…* ***është zymtuar*** *fort,* ***i kanë hipur në kaptinë furitë e zeza*** *të honeve e gropave.* (Vepra 4,1990, p. 75); ***I hyn frika në palcë, i dridhet buza****.* (Vepra 4, 1990, p. 448); Mos **të ka vdekur** ndonjë mik i mirë? Apo **ta ka tharë zemrën** ndonjë bir a bijë. (Vepra 4, 1990, p. 30); *E dini ç'tha kur* ***hapi sytë*** *e* ***ra ndër mend****.* (Vepra 2, 1990, p. 297); *Po ta bësh këtë punë* ***s'të djeg as zjarri i xhehenemit****, Xheladin bej.* ***S'të tret dheu****.* (Vepra 1, 1990, p. 95); ***mbani vesh e dëgjoni****.* (Vepra 3, 1990, p. 496); *Mbeta* ***qyqe vetëm*** *këtu e tani po vjen nata.* (Vepra 4, 1990, p. 270)*; Murga Trëndelino mbeti* ***fillthi*** *në mal,* ***njeri pa njeri****, midis egërsirash.* (Po aty, p. 269)*; Nxjerrin bukën nga trasta e zënë të* ***hanë pa zë, tërë hundë****, sikur t'u* ***paskej ngrënë derri brumët*** (Po aty, p. 491); ***Jep e merr*** *e* ***s'di ku të futet****.* (Po aty, f 41); *Po vasha flet* ***qetas, s'lot fare vendit****.* (Po aty, p. 144); *E ngre shkëmbin dhe e ve në cep të supit, e mban lart dhe* ***qëndron shtyllë, s'tundet fare****.* (Po aty, p.56) etj.

Te Kuteli, sinonimia krijohet edhe duke përdorur fjalë të leksikut shqip dhe fjalë të leksikut të huaj. Për shembull: *sedërli, namusqar; maskara, dinsëz, edepsëz; tregtar, dyqanxhi; dëshmitar, shahit; skamje, qesatllëk, fukarallëk; odë, konak; birth, evlat; e premte, e xhuma; dhëndër, bandill; e keqja, belaja; dritëzore, penxhere; parajsë, xhenet; ferr, xhehnem; mjeshtër, usta; mendje, tepelek; e përdalë, xhadi; vëlla, byrazer; flori, alltën; të këqija, alamete* etj. Në përgjithësi, fjalët e huazuara nuk sjellin ndonjë gjë të re në planin semantikor, megjithatë në kontekste të caktuara, ku ato përdoren, mund të krijojnë diferencime të karakterit stilistik, për shembull:

*Shkurtua me të tijtë, Qosja me të tijtë, që të dy me nga një palë size vënë mbi hundë,* ***psallnin*** *e* ***kanaqisnin*** *në kishë.* (Vepra 2, p. 111); *…I vulosi të gjithë në ballë që të dijë* ***bota*** *si e qysh… jalla u përmbystë kjo* ***dynja***! (Vepra 2, p. 288); ***Bujqit, raja*** *e* ***harbutë****, të gjithë me dorë në zemër si nuse kauri.* (Vepra 1, p. 64); *Këtë punë e bënin qehallarët, "trimat", siç u thosh beu, apo "****lanxhot****", "****larot****", "****zybat****" siç u thoshin me gjysmë goje ata të tjerët, vegjëlia.* (Vepra

1, p. 65); *Nuk e harronte… as* ***adëmin*** *e madh,* ***të parin*** *e haremllëkut të sulltanit.* (Vepra 1, p. 65); *Kjo* ***oda*** *e madhe e* ***konakut*** *të madh… i qerthullohej beut ashtu siç qerthullohen kuajt në lëmë.* (Vepra 1, p. 66); *Se Xheladin beu kish qenë gjithnjë, që në të ri,* ***njeriu i qejfit, hashari****.* (Vepra 1, p. 67); ***Derman*** *pasha!* ***Vër dorë në zemër****! Çupa është jetime.* (Vepra 1, p. 81); *Baba Sulltani, mblidhte njerëz me harxhe, paguante tink-tik* ***alltën*** *e* ***argjend****.* (Vepra 1, p. 91); *Hëm, hëm,* ***xhenaze*** *biçimi…****Dy të vdekur*** *në një ditë… … Dovleti ka* ***haznë*** *të madhe, ka* ***taraphanë****.* (Vepra 1, p. 92); *Flije* ***mendjen*** *e* ***fiqirë****, Kuma Maro.* (vepra 4, p. 283); *U bëra siç thotë bota,* ***buf*** *e* ***matup.*** (Vepra 1, p. 274) etj.

Julies Marauzeau shprehet se *gjuha ka repertor shumë të gjerë mjetesh e mundësish, ndërsa shkrimtarit i mbetet të zgjedhë* (J. Marauzeau, 1946, p. 10). Në këtë kontekst, Kuteli përpiqet të zgjedhë njësinë më të qëlluar, më të veçantë, në përputhje me atë që kërkon teksti, mikrokonteksti, me atë që kërkon përmbajtja, tema, ideja apo rrethana emocionale.

Ashtu si në të gjitha rrafshet, edhe në atë sinonimik, ai di të shfrytëzojë të gjitha mundësitë stilistike dhe të krijojë një regjistër sa të pasur, aq edhe origjinal zgjedhjesh. Zgjedhjet e përzgjedhjet e elementeve gjuhësore sipas konteksteve të caktuara bëhen në përputhje me qëndrimin, me ndjenjat dhe mendimet e tij ndaj dukurive e ngjarjeve jetësore, ndaj sjelljeve të ndryshme njerëzore etj. Me anë të tyre ai përpiqet ta përcjellë sa më të plotë, sa më të qartë dhe më të saktë mesazhin te lexuesi dhe gjithashtu realizon qëllimin e tij prej shkrimtari, i cili synon që shprehja gjuhësore të marrë funksion estetik. Në shërbim të këtyre synimeve është jo vetëm përzgjedhja, por edhe mënyra e strukturimit të tyre. Në këtë pikëvështrim, te Kuteli ndeshim rëndom dy lloj grupimesh:

Së pari, çiftin sinonimik që krijohet nga pranëvënia e dy elementeve të një paradigme në një sintagmë, përdorimi i shpeshtë i të cilit kthehet në një tipar karakteristik të stilit të Kutelit. Çiftet sinonimike në veprën e tij paraqiten interesante në çdo pikëpamje, por sidomos në planin semantikor dhe atë të shprehësisë. Ato sjellin përforcim semantikor dhe rritje shprehësie, pothuajse, në mënyrë të rregullt. Për shembull: *Të treqindët* ***ndritnin e vetëtinin****: rrobat i kishin të arta; edhe shpatat krejt të arta, shigjetat dhe heshtat krejt të ngrira në ar.* (Vepra 4, p. 60); *… fishkëllon era nëpër ahe, bubullojnë e vrungullojnë bjeshkët (Vepra 4, p. 62); Gurija priste me* ***tmerr e krupë*** *se çdo të ndodhte më tej*. (Vepra 1, p.71); *Xhixhe-hanëmi ish nga derë e madhe, bijë pashai e mbesë veziri, po* ***shterpë e barkthatë****… Ai ia kish frikën sidomos Xhixhe hanëmit, një gamile tërë* ***koska e kokalla****.* (Vepra 1, p. 79); *… kjo Galiçica e thatë së bashku me Shëndaumin e një pjesë të liqerit, ku s'kish rënë hija e maleve, u bënë* ***flakë e prush*** *i gjallë.* (Vepra 1, p. 105); *Burrat si burrat, njerëz si gjithë bota: me dy duar, me dy këmbë… domosdo të* ***rruar e të kruar****.* (Vepra 1, p. 318); *Prandaj, disa ishin, siç thonë ata të Shqipërisë së Mesme* ***bullafiqë e barkulë****, si ca gra shtatzëna në muajin e tyre gat-gati.* (Vepra 1, p. 318); *Qielli ndrin* ***i larë e i shpëlarë*** *dhe lart, në kupën e qiellit, vetëtin vetë zoti diell…* ***Ndrit e shëndrit*** *tërë bota e në mes të kësaj bote* ***ndrit e shëndrit*** *e vogla.* (Vepra 4, p.441); *Unë jam Paji Harambash… që* ***pres e shtyp*** *e* ***vras e pres****.* (Vepra 4, p. 76); *… gjeti të qahej se s'kish* ***grunarë e koshare*** *ku të derdhë këtë të uruar bukë.* (Vepra 2, p. 115); *Po kur sosën të vjelat…* ***vozet e këllbrat, koshat e kofinat*** *nuk nxinin veçse gjysmën e pemës*. (Vepra 2, p. 117); *Do të*

*shkoj… të bëj* ***vëllamë e kumbarë*** *e pastaj të kthehen.* (Vepra 4, p. 25);

Në veprën e Kutelit përbëjnë një grup të madh dhe tepër karakteristik, me vlera të veçanta shprehëse e stilformuese çiftet sinonimike, ku fjalët e reja si njësi përbërëse të tyre, krijohen me anë të parashtesës *-stër* dhe në një numër më të paktë me parashtesat *-sh, -për* etj.; rregullisht, në to nuk mungojnë ngjyrimet semantikore e stilistikore, si: *lëng, stërlëng; pyet, stërpyet; kuçkë, stërkuçkë; ndrijnë, vetëtijnë; humb, përhumb; tundet, shkundet; vesh, përvesh; u tha, u përtha; e qeshi, e përqeshi* etj., ose formohen me prapashtesa, ose të kombinuara: *shtrigë, shtrigore; dhelpërake, dhelpërushe; thatime, thatoke; i murrtë, murrak; fill, fillthi; skuq, lkuq; më pas, pasandaj; rrudhat, dërrudhat* etj., për shembull:

*… U martua me bijë pashai, mbesë veziri,* ***baxhanakë e tërbaxhanakë*** *sulltani.* (Vepra 1, p. 83); *Krushqit ia sollën nusen në shtëpi me suvarinj, me salltanet të madh me* ***allallajka e stërallallajka*** *prapa, po pa çupëri*. (Vepra 1, p. 84); *I zoti dyqanit na ish një rondokop* ***i ngjeshur e stërngjeshur*** *me sy të bardhë.* (Vepra 4, p. 485); *Bardhoku* ***shtypet e përshtypet****.* (Vepra 4, p. 480); *Çupa është bukuroshe, llërëplotë, pulpëbardhë.* ***E kolme, e përkolme****.* (Vepra 4, p. 477); *E futën në një thes copa-copa, koka veç, dora veç, krahu veç, dyqind* ***fela e fërtela****.* (Vepra 4, 1990, p. 423); *… i madhi* **fryn e shfryn,** *nxjerr gjuhën një pëllëmbë, si qen i ngordhur.* (Po aty, p. 414) etj. Gjithashtu, nivel të lartë shprehësie dhe emoconaliteti ndeshim edhe në rastet, kur njëri element i çiftit sinonimik, në pikëpamje të fjalëformimit, është krijuar me anë të prapashtesës **-ore**: *Allah-bir, janë* ***frëngë e frëngore****.* (Vepra 1, 1990, p. 317) etj.

Së dyti, në veprën e Kutelit zënë jo pak vend vargjet sinonimike, të cilat krijohen nga vendosja radhazi e disa sinonimeve. Vërehet, se në këtë rast hyjnë në marrëdhënie sinonimie edhe njësi që nuk janë të tilla dhe me to krijohen tufa përftesash të gjera, të cilat janë të ngarkuara me ngjyresa kuptimore dhe me vlera të larta shprehësie. Me hollësitë që sjellin, ato nxisin një qëndrim aktiv të lexuesit për të mos mbetur një pjesëmarrës sipërfaqësor, por të hyjë në thellësitë e kumteve të veprës. Në vargjet sinonimikë nuk mungojnë edhe shkallëzimet stilistike, të cilat e bëjnë tekstin më tërheqës e më artistik, për shembull: *Të dy ishin kërmë:* ***shpirtzinj, nakarmëdhenj, gjakatarë****.* (Vepra 4, 1990, p. 428); *Ky ra pas* ***qejfeve*** *e* ***ahengjeve****, pas* ***grave****, pas* ***zullumeve****.* (Vepra 1, 1990, p. 83); ***Rënkonte****,* ***gulçonte*** *e* ***shfrynte*** *nëpër hundë e nëpër gojë.* (Vepra 2, 1990, p. 305); *Një pjesë të madhe të udhës, e zinte një grua* ***e plotë*** *dhe* ***stërplotë, deng me dhjamë****,* ***më e ngjeshur nga shoqet****… …me ca krahë* ***dërdëngë****.* (Vepra 1, 1990, p. 314); *Ah,* ***këpucët****, ose më saktë* ***këpuckat, skërpinjkat****, ishin vepra të vërteta arti.* (Vepra 1, 1990, p. 314); *Kam frikë se mos më zërë derën ndonjë* ***kobeshë****,* ***çotillë*** *e* ***mish në mashë****, për të trembur laraskat.* (Vepra 4, 1990, p. 477); *Një ditë, dy, tri,* ***kapiten, taraksin, bien*** *e* ***dergjen*** *të sëmura.* (Vepra 4, 1990, p. 441); *Ajo ndrit, të motrat* ***murtohen, zymtohen, nxihen*** *sikur t'i paskej djegur rrufeja e kulmeve.* (Vepra 4, 1990, p. 441); *E madhja* ***marroset****, e mesmja* ***xhindoset*****:** *… Ti, naprane, i* ***ke bërë magji*** *yllit, e* ***ke shushatur*** *hënën, e* ***ke budallepsur*** *diellin.* (Vepra 4, 1990, p. 440); *Aty sheh një* ***kutullaç*** *të qepur si majmun pas çengelit…* ***Lugat*** *shkuar lugatit!* ***Tartakut****.* (Vepra 4, 1990, p. 419); *… i shihje pragjeve e udhës, nëpër pluhur,* ***të dregosura, të qurrosura, të palara****.* (Vepra 1, 1990, p. 75); *… po ju shoh se si* ***shtypi*** *e* ***përshtypi****,* ***vrisni****:* ***mendjen, varni vetullat*** *e nuk më jepni dot përgjigje.* (Vepra 1, 1990, p. 175); *Këtë*

*punë duhet ta marrim shtruar:* ***ta shkoqim, ta shoshim, ta sitim***. (Vepra 2, p. 13… *të gjitha rrinë tulitur, në errësirë, nëpër* ***strofulla*** *e* ***gufu****, nëpër* ***brima*** *dheu e* ***brima*** *drurësh, nëpër* ***çerdhe****, shkurre e degë.* (Vepra 4, 1990, p. 74) e *E në s'ka shok, ka* ***flamur****, ka* ***nishan****, ka* ***tarap.*** (Vepra 2, 1990, p. 293) etj.

Kuteli përdor gjerësisht sinoniminë kontekstuale, gjë që flet për aftësinë e tij për të bërë përzgjedhje stilistike, por edhe për atë që dihet se sinonimia, në fund të fundit, shfaqet e hetohet shumë më mirë në kontekste të caktuara. Për shembull: *Çuditej një botë e tërë e thosh:* ***kroçkë*** *paska qenë,* ***gur****.* (Vepra 2, 1990, p. 130); *Hiqte e vuante po nuk epej: gjithnjë* ***kroçkë*** *e* ***gdhë****.* (Vepra 1, 1990, p. 165); *Punojnë* ***ditë e natë, derrçe****, me djersën e ballit.* (Vepra 4, 1990, p. 481); *Ne* ***vegjëlia*** *apo* ***çocërrit*** *e ugareve, siç na thoshin me të qeshur, s'dinim ç'ishte "i sotmi".* (Vepra 2, 1990, p. 125*); Njëra nga çupat … nisi të na rrëfente* ***me zë të platitur (zë nate!), shtruar-shtruar*** *një përrallë.* (Vepra 2, 1990, p. 130); *Tani* ***u veshe, u ngjeshe****, bëre shtëpi të reja, mban edhe zybat me bukë.* (Vepra 4, 1990, p. 412); *Fundi i fundit, përse ata të mbeteshin* ***faqekuq*** *si molla, kurse ai, beu hanedan, të* ***zverdhej*** *e të thahej dita ditës.* (Vepra 1, 1990, pp. 66-67); *E jo dasma sidokudo, sa për të shkuar radhën, po dasma nga ato që* ***ha qeni petulla*** *e* ***kërcasin trarët e shtëpisë****.* (Vepra 2, 1990, p. 115); *Koçanët mbeteshin* ***lakuriq, jetimë****.* (Vepra 2, 1990, p. 117) etj.

Sinonimet kontekstuale, pra emërtimet e tjera për të njëjtin emërtim gjuhësor, e çojnë Kutelin, ashtu si edhe shkrimtarët e tjerë deri te metaforizimet, sepse ato e sjellin dukurinë në një këndvështrim të ri, duke ndriçuar edhe karakteristika të tij. Për shembull: *Më shumë nga të gjithë e thumbon* ***atë****,* ***emërharruarin… Trambalukun, dudumin, krushkun***. (Vepra 3, 1990, p. 415). Fjala *krushk* zëvendësohet katër herë me trajta dialektore në vargun sinonimik dhe përmes sinonimisë kontekstuale kjo leksemë asnjanëse apo leksemë bazë kalon në lidhje metaforike me to. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shembujt e mëposhtëm: ***Ti*** *je* ***Thana e ilirëve****,* ***perëndesha e gjahut dhe e grigjeve, tmerri i ujkut dhe të paudhit, shëmbëlltyra e hënës****.* (Vepra 3, 1990,p.13); ***Florinjtë*** *ishin bërë qymyr i zi,* ***të flamosurit, viranët****.* (Vepra 2, 1990, p. 159) etj.

Teksti estetizohet në nivel më të lartë, sidomos, kur elementet e vargut sinonimik krijojnë lidhje fjalësore të figurshme, si për shembull: *Ka të drejtë Agatoni i Athinës që thotë se dashuria u sjell* ***heshtjen erërave****,* ***qetësinë deteve****,* ***pushimin*** *dhe* ***gjumin brengave****,* ***paqen njerëzve****.* (Vepra 3, 1990, p. 12); ***Buçimat e përrenjve, gurgullimat e kronjve*** *dhe* ***zhaurima e erës*** *nëpër gjethet* ***mbytnin hapat e vrapit****, por nuk* ***mbytnin*** *dot* ***thirrmat e përgjigjet****.* (Vepra 3, 1990, p. 15) etj.

**Përfundime**

Në këtë punim janë arritur këto përfundime:

1. - Mitrush Kuteli, si njohës shumë i mirë i gjuhës shqipe, shfaq aftësi të veçanta në përzgjedhjen e elementeve gjuhësore në përputhje me kontekste të caktuara. Ai është këmbëngulës në gjurmimin apo krijimin e sinonimeve dhe me anë të tyre bën saktësimin më të plotë të dukurisë, apo të mendimit që përshkruan, shmang përsëritjet dhe rutinën që mund t'i sillte kjo tekstit dhe rrit ndjeshëm shprehësinë dhe estetizmin e tij.
- Në aspektin leksiko-gramatikor, rastet më të shumta të sinonimisë i shënojnë emrat, të cilët pasohen nga mbiemrat, foljet dhe më pas ndajfoljet. Kuteli krijon sinonimi edhe me ndërtimet frazeologjike, me proverbat, me shprehjet popullore si

dhe me urimet dhe mallkimet, si: *e keqja me të keqen, e hidhura me të hidhurën* etj.

- Kuteli krijon paralele sinonimike duke shfrytëzuar burime të ndryshme popullore dialektore, më së shumti atë juglindor, por edhe duke krijuar vetë neologjizma, si: *shtrigore, shtrigushe; thatoke, thatime* etj. Në këtë pikë duket se autori zhvillon aktivitet krijues gjuhësor, qoftë në mënyrë origjinale, qoftë duke u mbështetur tek modelet ekzistuese të fjalëformimit të shqipes.

- Në vështrim leksikor vërehet se ndërthurjet sinonimike krijohen më së shumti me fjalë dialektore, të cilat kanë kuptim konkret, me fjalë të cilat kanë lidhje me bimësinë, kafshët, me etnologjinë e zonës e të tjera, si *kapua, këndes, kokosh*, dhe më pak me fjalë të kuptimit abstrakt. Te Kuteli, sinonimia krijohet edhe duke përdorur fjalë të leksikut shqip dhe fjalë të leksikut të huaj.

- Përsa i përket mënyrës së strukturimit të çiftit sinonimik, Kuteli pranëvendos shpesh dy elemente të një paradigme në një sintagmë, duke e kthyer këtë në një tipar karakteristik të stilit të tij, si: *ndritnin e vetëtinin, koska e kokalla* etj. Me vlera të veçanta shprehëse e stilformuese paraqiten veçanërisht çiftet sinonimike, ku fjalët e reja, si njësi përbërëse të tyre, krijohen me anë të parashtesës *stër-,* si: *lëng, stërlëng; pyet, stërpyet* etj. Ndërsa, përsa i përket vargjeve sinonimike Kuteli vendos në marrëdhënie sinonimie edhe njësi që nuk janë të tilla (pra përdor gjerësisht sinoniminë kontekstuale) dhe me to krijon tufa përftesash të gjera, të cilat janë të ngarkuara me ngjyresa kuptimore dhe me vlera të larta shprehësie sidomos kur vendosen në lidhje figurshmërie midis tyre. Me hollësitë që sjellin, ato nxisin një qëndrim aktiv të lexuesit duke e ndihmuar atë të hyjë në thellësitë e kumteve të veprës.

Të gjitha sa thamë tregojnë më së miri begatinë e gjerë sinonimike të veprës së Kutelit dhe ndihmesën që sjell ai edhe me anë të saj në pasurimin e gjuhës shqipe. Nisur nga ky fakt, ky studim mund të shërbejë si bazë për studime të tjera të mëtejshme dhe më shteruese në këtë fushë.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Islamaj, Sh. (1968). *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 4.

Jashari, A. (2000).*Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar, Kotti*, Korçë

Jashari, A. (2003). *Përsiatje për gjuhën shqipe*, Kotti, Korçë.

Kuteli, M. (1990*). Vepra letrare 1*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.

Kuteli, M. (1990*). Vepra letrare 2*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.

Kuteli, M. (1990*). Vepra letrare 3*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.

Kuteli, M. (1990*). Vepra letrare 4*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.

Lloshi, Xh. (2005), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë.

Marauzeau, J. (1946), *Preécis de stylistique française*, Paris.

Thomai, J. (2001), *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë.

# VËSHTRIM PËRQASËS I NJËSIVE FRAZEOLOGJIKE ME VATËR SEMANTIKE ME PJESË TË TRUPIT NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE

**LORENA ROBO**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Njësitë frazeologjike nuk janë pjesë më vete e gjuhës, por ato zënë një pjesë të rëndësishme të leksikut të përgjithshëm në gjuhë. Qeniet e gjalla rriten, zhvillohen dhe ndryshojnë,duke u bërë një faktor tregues dhe mundësi e zhvillimit të gjuhës.

Në këtë punim do të shihet çështja e idiomaticitetit, përkufizimit të njësive frazeologjike, dhe formimit të tyre, e parë nga këndvështrime gjuhësore të autorëve shqiptarë dhe të huaj, në një përvijimin leksikologjik deri në ditët e sotme. Burimet e njësive frazeologjike janë të një numri të madh krahasuar paralelisht në të dy gjuhët, në shqip dhe anglisht, ka tregon një reflektim te mendësisë, traditave dhe kulturës së dy popujve. Punimi trajton qasjen burimore të njësive frazeologjike në të dy gjuhët.

Qëllimi i tij është të identifikojë njësitë frazeologjike me pjesë të trupit në anglishte dhe të japë gjegjëset e tyre në shqipe.

Të dhënat janë nxjerrë nga tre fjalorë të marrë për studim: Fjalori Frazeologjik i Gjuhës Shqipe i J.Thomait (2010), Fjalori Frazeologjik Anglisht-Shqip i I. Stefanllarit dhe V.Dherit (1980) dhe Fjalori me Shprehje të Huazuara në Gjuhën Shqipe i Ali Jasharit (2007). Njësitë janë analizuar sipas përbërësve leksikorë, semantikë dhe pjesëve të trupit të njësive përbërëse.

Nëpërmjet një qasjeje kontrastive do të analizohet përbërësi që përmban peshën kryesore kuptimore të njësive, duke dalluar dhe qasur njësitë frazeologjike të dy gjuhëve me vatër të njëjtë dhe të ndryshme semantike-kuptimore, si edhe realizimin kuptimor brenda njësisë frazeologjike.

***Fjalët kyçe:*** *Vatër sematike, njësi frazeologjike, burim, përbërës leksikor, mendësi, kulturë*

**Abstract**

Phraseological units are not a separate part of the language but they take an important part of the overall lexic of the language. Living things grow, develop and change,an imporatant and potential factor of the language development. Idiomaticity, phraseological unit definition and their formationis the subject of this article which is seen in a lexicological outline of the foreign and Albanian linguistis.

Sources of phraseological units are of a great number compared to both languages which reflect the mentality, traditions and culture of English and the Albanian nation.

The focus of the paper is to present a source approach of the phraseological units. This article aims at identifying phraseological units with body parts in English and to give its equivalents in Albanian.

Data are drawn from three phraseological dictionaries Phraseological dictionary of the Albanian Language (Thomaj, 2010), English – Albanian Phraseological dictionary (Stefanllari & Dheri, 1980) and the Dictionary of Foreign Phrases in Albanian Language (Jashari, 2007) and analyzed according to their semantic and the lexical components of the body parts.

Contarastive analysis is used to analyze the component which holds the semantic importance of the unit in both languages with the same and different semantic focus and the meaning realisation within the phraseological unit.

***Keywords*:** semantic focus, phraseological unit, source, lexical component, mentality, culture.

Duke qenë se frazeologjia zë një vend të veçantë si fushë me vete në gjuhësi, kontributet nga linguistë të ndryshëm nuk kanë munguar që nga gjysma e dytë e shekullit XX dhe në vazhdim.

Ne shpesh lexojmë dhe dëgjojmë frazën "*language is a living thing*" (Seidl, McMordie, 1978,p. 1), por shumica prej nesh vazhdojnë të mendojnë se *si* dhe *pse* kjo është e vërtetë. Qeniet e gjalla rriten, zhvillohen dhe ndryshojnë.

Prirjet e anglishtes, por edhe të gjuhës shqipe synojnë drejt përdorimit idiomatik, të figurshëm. Është e rëndësishme që në këtë punim mbi njësitë frazeologjike duhet të tregojmë se si zhvillohet gjuha. Njësitë frazeologjike zënë një pjesë të rëndësishme të leksikut të përgjithshëm në anglisht dhe shqip.

Në përbërjen e leksikut të një gjuhe hyjnë përveç fjalëve edhe disa bashkime prej dy ose më shumë fjalësh, të lidhura historikisht, të shkrira në një kuptim të vetëm përgjithësisht figurativ (Thomai, 1981). Sipas Thomait (1981), *këto janë togfjalësha të qëndrueshëm të formuar historikisht, që nga ana kuptimore janë ekuivalentë me një fjalë të vetme dhe, sikurse fjala, shprehin nocione dhe karakterizohen nga funksioni emërtonjës. Të tilla shprehje përbëjnë frazeologjinë e një gjuhe*.

Në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike gjejnë përdorim që me Gj. Buzkun, F.Bardhin, N.Frashërin te punimi i Nonda Bulkës *Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit "Histori e Shqipërisë"*, Buletin i Univesitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, 1958, I. etj. Në gjuhën angleze frazeologjia si mjet i identifikimit të kulturës, historisë, mitologjisë dhe traditave të një populli, është një çështje e studimeve gjuhësore e cila ilustron në një shkallë të lartë lidhjen midis gjuhës dhe kulturës së një populli. Njësitë frazeologjike hasen që në shkrimet e Shakespeare-it, Ch.Dickens-it, J.Chaucer-it, J. Milton-it, J. Swift-it, W. M.Thackeray-it, W.Scot-it e autorëve të tjerë.

Në këtë punim do të fokusohemi kryesisht mbi analizën e përbërësve të njësive frazeologjike duke dhënë ekuivalentet në gjuhën shqipe dhe duke parë se si realizohet mbajtja e peshës kuptimore të njësive, duke dhënë llojin e njësive frazeologjike sipas kuptimit gramatikor. Gjithshtu do te jepen disa përpjekje përkufizimesh dhe kontributi i linguistëve të ndryshëm vendas dhe të huaj për përvijimin e kufijve të frazelogjisë angleze dhe shqipe, disa perpjekje mbi nocionin idiomë dhe çështje të terminologjisë.

Punimi do të bazohet në një studimin të korporava në tri fjalorë frazelogjikë të marrë për studim. Janë trajtuar njësitë frazeologjike me pjesë të trupit në gjuhën shqipe të nxjerra nga Fjalori Frazeologjik i Gjuhës Shqipe (Thomai, 2010) të cilat numërohen rreth 2240 njësi frazeologjike

nga 10.000 njësi frazeologjike që ka ky fjalor gjithsej dhe rreth 300 njësi frazeologjike me pjesë të trupit në gjuhën angleze të nxjerrra nga Fjalori Frazeologjik Anglisht-Shqip i I. Stefanllarit dhe V. Dherit (1980). Gjithashtu është përdorur edhe Fjalori me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe, i A. Jasharit (2007), prej të cilit janë nxjerrë disa qindra njësi frazeologjike, ndër to dhjetëra janë kalke frazeologjike dhe disa dhjetëra njësi me ndryshim të një përbërësi leksikor.

Përpara se të bëjmë analizën të bazuar në korporat e nxjerra nga fjalorët e parashtruar më sipër, do të jepet një qasje krahasuese rreth përkufizimit të idiomave dhe veçori të formimit të tyre.

Në këtë punim do të jepet gjithashtu kontributi lidhur me klasifikimin e njësive frazeologjike që kanë si gjymtyrë fjalë me pjesë të trupit, do të analizohen dhe veçohen njësi me vatër kuptimore gjymtyrën që emërton pjesë të trupit, do të jepen vëzhgime mbi strukturën e njësive frazeologjike, do të behen disa grupime të njësive duke u mbështetur në kritere të veçanta. Variantet sinonimike frazeologjike do të jepen, nëse ndodh ndryshimi kuptimor sipas ndryshimit të rendit të fjalëve në njësi, etj. Probleme të tilla do të trajtohen me hollësi si më poshtë.

**Mbi nocionin idiomë**

Origjina e fjalës idiomë daton që në shekullin XVI dhe vjen nga fërngjishtja *idiōma*, e cila ka hyrë në frëngjisht nëpërmjet latinishtes nga greqishtja, që do të thotë pronë private nga fjala *idiousthai* "të bësh diçka tënden", *idios* "diçka private".

Ekzistojnë shumë përkufizime të njësive frazeologjike (idiomave) të cilat reflektojnë disa ndryshime në kriteret bazë të përdorura nga autorë të ndryshëm. Sipas Nunberg (1994), *idiomat janë kategori të paqarta, të ngatërruara.* Moon (1998), i përkufizon si *semantikisht të padepërtueshme dhe metaforike.* Filipec and Čermåk (1985), i shikon si *kombinime anomalie të elementeve të gjuhës.* Bilkova (2000), i sheh si *struktura të paplota transformuese*. Sipas Fernando (1996) dhe Ifill (2002), si *njësi që mund të ndryshojnë brenda disa kufijve.* Laval (2003), i përkufizon si *shprehje ku ka një ndryshim midis asaj që thuhet dhe asaj që nënkuptohet*. J.Strassler (1982), thekson se *idioma është një vargëzim i më shumë se një lekseme kuptimi i së cilës nuk është kuptimi i pjesëve përbërëse dhe nuk përbëhet nga një folje + pjesëz ndajfoljore/ parafjalë*. Michael McCarthy dhe Felicity O'Dell (1994), nënvizojnë se *idiomat janë shprehje të ngurosura me kuptim i cili nuk është kuptimi i pjesëve përbërëse*. Sipas Hockett (1958), *idioma është një frazë kuptimi i së cilës është jokompozicional, kuptimi i idiomës nuk është shuma e pjesëve përbërëse.* Për J.Sedl dhe W.Mc.Mordie (1978*), idioma është një grup fjalësh të cilat në kushtin e bashkimit të tyre nënkuptojnë diçka absolutisht të ndryshme në krahasim me kuptimin individual të fjalëve, duke formuar një idiomë*.

Koncepti 'njësi frazeologjike (unite phraseologique) u përdor për herë të parë nga *Charles Bally*-së, koncept i marrë nga V.V.Vinogradov-i dhe linguistë të tjerë sovjetikë, të cilët e përkthyen nga '*frazeologiceskaja edinitsa'*. Bally-ja i përkufizon ato si *njësi të gatshme të trashëguara brez pas brezi dhe janë përdorur në procesin e ligjërimit si kombinime fjalësh tradicionale*. Shansky (1969), i përkufizon njësitë frazeologjike si *struktura të ngrira të gjuhës që përbëhen nga dy ose më shumë komponentë dhe që lejojnë pak ose aspak ndryshueshmëri në formë, strukturë ose kuptim.*

Sipas A.V. Kunin-it (1970), njësitë frazelogjike janë togfjalësha të qëndrueshëm me kuptim transferues të

pjesshëm ose të plotë. R.S.Ginzburg-u (1966) i përkufizon në këtë mënyrë : *Njësitë frazeologjike janë zakonisht të përcaktuara si togfjalësha jo të motivuar të cilat nuk mund të ndërtohen lirisht në ligjërim por riprodhohen si njësi të gatshme*. N.N.Amosova (1963) i përkufizon njësitë frazeologike si *njësi të një konteksti fiks, një kontekst i karakterizuar nga një sekuencë specifike e pandryshueshme e komponentëve të caktuar leksikorë me një lidhje semantike e veçantë.* Sipas Rosemarie Gläser-it(1998), *një shprehje frazeologjike është një grup fjalësh bileksemike ose polileksemike e cila ka stabilitet semantik dhe sintaktik, mund të idiomatizohet mund të ketë edhe ngjyrime të ndryshme, si dhe funksion të theksuar në një tekst.* Jani Thomai te *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, (2002, 2011) jep këtë përkufizim: *Njësia frazeologjike është një njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme.*

Sipas përkufizimeve të dhëna njësia frazeologjike gëzon qëndrueshmërinë gramatikore dhe leksikore të përbërësve, mungesën e motivimit dhe kuptimin figurativ, veçori që e dallon atë nga kombinimet e lira të fjalëve dhe shprehjeve me kuptim të drejtpërdrejtë. Të njëjtin qëndrim mbajnë edhe shkollarët letonezë si A.Naciscione, A.Veisbergs.

Termi *idiomë* dhe *njësi frazeologjike* janë përdorur në këtë punim si ekuivalente të njëra- tjetrës. A janë këto terma ekuivalente me njëra-tjetrën? Gjuhëtarët lindorë duke përmendur këtu linguistët rusë A.I.Smirnitsky, V.V. Vinogaradov-i dhe ata shqiptarë si J. Thomai, i emërtojnë ato si njësi frazeologjike. Linguistët perëndimorë, anglezë, francezë, gjermanë pranojnë dhe përdorin termin *idiomë.* J.Thomai tek *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe* (1981), bën dallimin midis njësive frazeologjike dhe idiomave duke mos i pranuar si terma ekuivalente, por kohët e fundit, vihet re që ai pranon termin *idiomë* si të barazvlershëm me termin *njësi frazeologjike.*

**Qëllimi i studimit**

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë njësitë frazeologjike me pjesë të trupit në të dyja gjuhët, të nxjerrë në pah ngjashmëritë, të veçantat, të bëjë dallimin strukturor të njësive dhe pjesëve përbërëse të tyre, të gjejë gjegjëset përkatëse në të dyja gjuhët, të analizojë përqindjen që zënë kalket frazeologjike me pjesë të trupit në lëmin e njësive të marra për studim në fjalorët përkatës, të nxjerrë rezulate të vlefshme për studime të mëvonshme dhe të krijojë hapësira për t'u plotësuar nga studime të tjera.

**Pyetjet e kërkimit:**

Ky artikull ka për qëllim t'u përgjigjet pyetjeve:

1. A ndryshon vatra semantike e njësisë frazeologjike në anglisht dhe shqip dhe si shfaqet kjo tek të dyja njësitë?
2. Çfarë qasjeje gëzojnë nga ana ndërtimore njësitë frazeologjike në anglisht dhe shqip?

**Metodologjia e kërkimit**

Qasja e njësive frazeologjike është bërë nëpërmjet një analize kontrastive në të dyja gjuhët. Studimi është bazuar në analizën e të dhënave (korporave), përkatësisht njësive frazeologjike me pjesë të trupit në gjuhën angleze dhe shqipe duke qasur veçori të ndërtimit të njësive.

**Rezultate dhe diskutime**

**Analiza e të dhënave (njësive frazeologjike) nga fjalorët shqip-shqip dhe shqip-anglisht**

Në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike me pjesë të trupit janë në një numër të

madh. Në gjuhën shqipe dallohen njësi frazeologjike me emra të pjesëve të trupit të tilla, si: *zemër, sy , shpatull, shpinë, shpirt, tru, vesh, bark, buzë, dorë, faqe, fytyrë, gojë, hundë, kokë, krah, kurriz, mend, thonj, zorrë, zverk, qafë, këmbë, gjuhë, gjoks, gisht, fyt, dhëmbë:* p.sh., *ka zemër të artë; Më dolën sytë* (m'u lodhën shumë sytë duke bërë një punë të imët); *E mban mbi shpatull* (e ka si barë a si detyrë diçka); *U ngjitën shpinë më shpinë* (u bashkuan dhe e ndihmojnë shumë njëri-tjetrin); *Ia punoi pas shpine* (ia hodhi); *Më helmoi shpirtin* sh. "më helmoi zemrën"; *(*u shqetësua shumë nga një e keqe); *I ikën trutë (e kokës) ; S'është mirë nga trutë sh." i kanë rrjedhur trutë"; Iu kalbën trutë* (u bë matuf); *i ra veshit (*u mendua mirë); *më bie (më vjen) në vesh (*e dëgjoj diçka rastësisht); *S'ma do barku* (s'më pëlqen); *Më dhemb barku (*e dua shumë); *Me buzë të fryra (*shumë i zemëruar e i mërzitur); *Me buzë të plasur (*shumë i dëshpëruar); *U bë një dorë* ( mblodh kruspull); *S'më bën dora* (më vjen keq ta bëj diçka); *Ia doli në faqe (*ia arriti qëllimit); *S'më bën goja (*se them dot diçka të rëndë); *e ka hundën të hollë (*i kap shpejt e mirë erërat e ndryshme); *i hipi në kokë* (u ndez menjëherë); *e humba kokën* (u hutova krejt); *nuk i ka mendtë në kokë* (nuk di se ç'bën); *i bie krahëve (*e merr me të mirë); *rrashë në kurriz; blen mend (*merr nga të tjerët këshilla të mira); *ra në thonjtë* (u vu dikush nën shtypjen e padurueshme të dikujt); *s'i del gjë prej thonjve* (është shumë dorështrënguar); *i dridhen zorrët e barkut* (trembet shumë); *i bie gjoksit (*mburret shumë për diçka) ;*U bë gisht* (dikush) (u dobësua e u hollua shumë) ; *fyt më fyt* **(**fytafytas); *sa i ha fyti (m*e zë të lartë); *s'i kanë dalë dhëmbët, shpërfill. (*është ende i ri dhe i papjekur) ; *i ka buzët me qumësht; dhëmb për dhëmb (*në mënyrë të vendosur e të rreptë),etj.

Vihet re se këto njësi janë formuar me emrat e pjesëve të trupit, por shohim edhe njësi ndërtimi konotacioni kuptimor i të cilave rezulton me krahinat dhe vendet e ndryshme të truallit shqiptar duke veçuar njësi frazeologjike nga rrethi i Kolonjës, i Korçës, i Pogradecit, i Beratit, etj. Njësi frazeologjike që përdoren në pjesën e jugut, karakteristike për zonën e Korçës (Mustaka ,1986, pp. 209-215) si p.sh.,*duhet të kesh dy barqe me dikë: një ta çash, një ta mbash*; *tall breshka kërmillin*, *t'i sharron brirët*, s*'është brumë për petulla*, etj. Njësi nga rrethi i Pogradecit p.sh.,*është si bukë me brumë, prej një dashi nuk nxirren dy lëkurë*, etj. Nga rrethi i Kolonjës (Hajdini,1985, pp.159-162) vihen re njësi frazeologjike të tilla si: *ka një barrë lezet*, *ma bëri gojën copë*, *e kthen detin*, *të ngjitet dora*, *është bërë dyshek*, *me një gisht noton gjashtë muaj*, *për një gjuhë kau*, *i bëri këmbët bilbil*, *krihi kokën e morrin lërja në flokë*, etj.

Po kështu shohim edhe njësi me pjesë të trupit në anglisht për të cilat ne kemi njësi ekuivalente, kalke frazeologjike si p.sh. *Aladin's lamp- llampa e Aladinit; the apple of discord- mollë sherri; çelës i artë- golden key; besimi lëviz malet- faith can remove mountains; Acheeles heel- thembra e Akilit; Elektra complex- kompleksi i Elektrës; the black sheep- dele e zezë; Platonic love- dashuri platonike; Attic salt- kripë atikase; with apothecary scales- me peshores e farmacistit; Penelope's web- Pëlhura e Penelopës; Noah's ark- Vaka e Noes; kapërcej Rubikonin- cross (pass) the Rubicon; puthja e Judës- Juda's kiss; peri (filli) i Arianës- the thread of Ariane; mundimet e Tantalit – the torments of tantalus;* etj.( Jashari, 2007).

Gjatë nxjerrjes së të dhënave nga fjalorët frazeologjikë shqip-shqip dhe shqip-anglisht sipas vatrës semantike dallojmë:

1. Njësi që kanë si vatër kuptimore gjymtyrën që emërton pjesën e trupit. P.sh., *to have something on the tip of one's tongue, smile from ear to ear*, *put one's back into something*; *më zien koka nga hallet*, *ua mbath këmbëve*, *nuk i punon truri*, *i bie në gjunjë, çaj me gjoks, e tregojnë me gisht*, *mbeti me dhëmbët jashtë*, *e ka mendjen prapa kokës*, *m'u turbullua mendja*, *e mbylli gojën*, *i iku fytyra*, *mbledh buzët*, *më shurdhoi veshët*, *vuan nga trutë e kokë*s, *më plasi shpirti*, *iu hap syri*, *me zemër të thyer,* etj.

2. Njësi, ku si vatër kuptimore nuk shërben gjymtyra me pjesë të trupit, por një fjalë tjetër përbërëse e njësisë si p.sh folja, mbiemri, si: *hiqmu nga sytë*, *iu ndezën sytë, iu njomën sytë*, *më rrodhën sytë, i fërkon krahët, e uli shpinën, s'është mirë nga trutë, s'më djersin veshi,i fryn djalli në vesh,i hoqi (i shkuli) veshin (veshët), më shkeli në bark,më doli nga dora,i plasi në duar,merr faqe*, *u prish në fytyrë*, *s'i pushon goja*, *e bluan në kokë*, *më mbeti në qafë*; mbiemër: *me shpirt të vrarë*, *i qesh fytyra*; *carry on its face, fix one's eyes on, box somebody's ears, use one's brains, etc.*

Vihen re njësi frazeologjike të mënyrës urdhërore në të dyja gjuhët, në të cilat vatra semantike nuk është gjymyra, kuptimi i së cilës jepet në anglisht, por një folje, si: *Hands off!* -Mos prekni! ose një gjymtyrë tjetër, p.sh. në anglisht vatra semantike është emri *kokë* (head) në shqip vatra sematike është fjala *mendje*, si: *Head off!* - Mbaj mendjen! Të ka vdekur mendja!. Njësi të tjera me vatër të njëjtë semantike me gjymtyrë pjesë të trupit në anglisht dhe shqip, por të shprehur jo me të njëjtën gjymtyrë janë: *eat one's heart out* - ha veten me dhëmbë (*heart* vatra semantike në anglisht, *dhëmbë* në shqip); *cut one's throat* - i hanë kokën njëri-tjetrit (*throat* (grykë, gurmaz) –*kokë*); *in (to) somebody's face* - në sy (face ( fytyrë)- sy); hold one's tongue -s'hap gojën (tongue (gjuhë)-gojë); *lie in one's teeth* - gënjej sy për sy (teeth (dhëmbë)-sy); *know somebody like the palm of one'shand* - e njoh në majë të gishtave (hand (dorë)-gisht); *get the length of somebody's foot* - I njoh dhëmbë e dhëmballë (foot (këmbë) - dhëmb, dhëmballë); as *if he had been spit out of his mouth* -sikur e ka nxjerrë i ati nga hundët (mouth (gojë)- hundë); *pass one's lips* -fus në gojë (lip (buzë) – gojë); etj. (Stefanllari & Dheri, 1980)

Dallohen një numër i madh njësish frazeologjike me vatër semantike me gjymtyrë me pjesë të trupit në anglisht por që në strukturën e njësisë në shqip nuk jepet me gjymtyrë me pjesë të trupit. Të tilla janë: *bow somebody's* ***ears*** -I jap një dackë (shuplakë); *break one's* ***spirit*** - dekurajoj; *burn one's fingers* -e pësoj, digjem; *carry a stiff under* ***lip*** -mbahem si burrë'; *clear one's****throat*** -kollitem; *come down to brass* ***nails*** -hyj në thelb të çështjes; *follow one's* ***nose*** – eci, ku këtu njësia gjegjëse është e shprehur vetëm me një folje; *get off the wrong* ***foot***- filloj keq; *get out of* ***hand***- dal nga kontrolli; *give somebody's the cold* ***shoulder*** - sillem me përbuzje; *grease a person's* ***hand*** -jap ryshfet; ***hand*** *in glove with somebody* - lidhur ngushtë me; *hat in* ***hand*** -sillem me servilizëm; *have a good* ***head*** *forsomething* -kam aftësi në; *have a good* ***mind*** *to do something* - jam tepër i predispozuar; *frame of* ***mind*** - gjendje shpirtërore; *get one's* ***teeth*** *into something* - I hyn punës me vrull; *have an eye for* -jam njohës i mirë; *have not a* ***leg*** *to stand on* -është pa baza; ***head*** *and* ***ears*** - I mbytur në borxhe; *rub* ***elbows*** *with* -miqësohem, *split* ***hairs***-hyj në hollësira të panevojshme; *by the* ***skin*** *of one's* ***teeth*** -për qime, *carry somebody off his* ***feet*** - ngre peshë, entuziazmon pa masë , *cut off one's* ***nose*** *to spite one's* ***face***- në vend të vë vetulla nxjerr sytë, *get the upper* ***hand*** - bëj zap,

*get under somebody's* ***skin***- shpoj, i ngre nervat, *give one's* ***ears*** - sakrifikoj gjithçka, *hang heavy (heavily) on one's hands* - mezi kalon (koha, etj), *jump down somebody's* ***throat*** - ndërpres në mënyrë të ashpër, *keep a good* ***heart***- e mbaj veten ,etj. (Stefanllari & Dheri, 1980)

Kemi njësi frazeologjike me vatër semantike me gjymtyrë që janë pjesë të trupit në shqipe, por jo me vatër semantike me pjesë trupit në anglishte si p.sh: *ia preku telat e zemrës –find right button to press with; low one's colours – heq dorë.* Vatra semantike është *telat* (e zemrës) dhe *dorë;* në anglisht kemi gjymtyrët *button* dhe *colours.*

Vërejmë njësi frazeologjike që në anglishte shprehen me një emër të përveçëm ndërsa në shqipe me gjymtyrë me pjesë të trupit. P.sh., në anglishte vatra semantike është një emër i përveçëm (*Jack)* dhe në shqip kemi fjalën *syri* dhe *dora*: *Jack of all trades* 'Ç'i sheh syri i bën dora'

Në gjuhën shqipe ashtu si edhe në gjuhën angleze vihen re njësi frazelogjike që janë sinonime dhe kanë të njëjtin kuptim të cilat nga struktura formale janë të ndryshme duke ndryshuar një emër, folje apo mbiemër në strukturën përbërëse, por nga ndërtimi semantik janë të njëjta p.sh: *ngre kryet –ngre kokën, e ka zemrën të artë- e ka zemrën flori*; *i janë veshur sytë- iu mjegulluan sytë; vajti për balluke e la kokën- shkoi për lesh e doli i qethur; më zuri goja bar- më zuri goja erë! Të ha (të qëron) të bardhën e syrit- të thyen arrën në dorë*; *më hapi barkun- më plasi barkun- më çori barkun- më helmoi zemrën; më ka hyrë në beben e syrit- më ka hyrë në zemër- më është ngulur në zemër- më ka hyrë në shpirt; trupi boçkë e mendja lomçk- nga këmbët borroviq e nga mendja eksiq*; *kruan dhëmbin- kruan thonjtë- tund derën- vret miza- dredh zinxhirin- numëron qimet e postiqes*. Në anglisht kemi: *by a hair/ by a hair's breadth/ by the skin of one's teeth*; *by mouth/ by word of mouth; get out of mind/get smb/smth out of one's head;know somebody like the palm of one's hand/ know somebody as a person knows his fingers; by heart/learn by heart/ get by heart/ get off by heart; from head to foot/ from tip to toe;* etj. (Stefanllari & Dheri, 1980; Thomai, 2010).

Sipas Sh. Islamajt (1986, p. 119) sinonimet frazeologjike mund të jenë:

a) Sinonime ndërmjet fjalëve dhe njësive frazeologjike

b) Sinonime ndërmjet dy a më shumë njësive frazeologjike

Në planin semasiologjik, frazeologjizmat kanë kuptimin e përgjithshëm kategorial të fjalëve, prandaj thekson ajo *është e natyrshme që në mes të një njësie frazeologjike dhe një njësie leksikore të krijohet sinonimi e mirëfilltë*.

Frazeologjizmat përqasen me sinonimet si nga ana e përmbajtjes, po ashtu edhe nga ana e përdorimit në gjuhë. Mjafton të shohim këto shembuj: *hedh sytë-vërej, fus hundët – ndërhyj, ma ngrohu zemrën – më gëzoi, e do si dritën e syve- e do shumë, sa të thotë goja-shumë etj.* Sipas saj, *sinonimi ndeshim jo vetëm ndërmjet një njësie leksikore të ndryshme dhe të një njësie frazeologjike, por edhe ato të krijuara midis fjalëve me elemente leksikore të përbashkëta*, p.sh.: *me krahë hapur-krahëhapur; me zemër të çelë-zemërçelë; me kokë ulur-kokëulur.* Islamaj thekson se *sinonimi kemi atëherë kur dy a më shumë njësi frazeologjike, kanë funksion sinonimie dhe kanë kuptim leksikor objektiv të afërt ose të njëjtë, por edhe ngjyrë emocionale a forcë shprehëse të njëjtë*. P.sh. *i ka luajtur terezia- s'i ka mend në krye, i ka luajtur mendja, i ka kaluar mendja,* etj. Në këtë rast sinonimet krijohen me të njëjtin emër *mendje.*

Vëmë re njësi që si vatër semantike kanë të njëjtën gjymtyrë në shqip dhe

anglisht por në shqip njësia ka në strukturë edhe një numëror p.sh.: *have one's weather eye open* - i bëj sytë katër. Vatra semantike në njësinë *I bëj sytë katër* është numërori *katër*(sytë), ndërsa në njësinë në anglisht kemi si vatër semantike gjymtyrën *open* (eye).

Në gjuhën shqipe ashtu si edhe në gjuhën angleze vemë re njësi frazeologjike që kanë në strukturën e tyre të njëjtat pjesë, pra me vatër të njëjtë semantike, për të dhënë të njëjtin kuptim p.sh., në anglisht kemi: *with open arms* -me krahë hapur, *put one's back into something* - shtro kurrizin, *turn your back on somebody* -t'i kthesh dikujt kurrizin, *turn a deaf ear* - me vesh të shurdhër, *smile from ear to ear* -të qeshësh vesh më vesh, *in the eyes of somebody* -në/para syve të dikujt, *have the world at your feet* -ti kesh të gjithë poshtë vetes, këmbës, *to have a heavy foot* - të kesh këmbë të rëndë, *to have one foot in the grave* - me një këmbë në varr, *at the hands of somebody* - në duart e dikujt, *to be in safe hands* -të jesh në duar të sigurta, *to be out of somebody's hands* - të mos e kesh në dorë, *to fall into the wrong hands* - të biesh në duar të gabuara, *to dirty your hands* -të ndotësh duart , *from hand to hand* - nga dora në dorë, *to have/keep something at one's fingertips* -ta kesh në majë të gishtave, *to be in somebody's hands* - të jesh në duart e dikujt, *to lift/raise a hand against somebody* - të ngresh dorë mbi dikë, *somebody's right hand* - dora e djathtë e dikujt, *with your bare hands* -me duar të pastra, *to twist/wind someone around one's little finger* - ta rrotullosh/lëvizësh dikë me gishtin e vogël, *to do something behind someone's back* -t'ia punosh dikujt mbrapa krahëve, *to have something on the brain* - të mendosh në mënyrë konstante për diçka, *turn a deaf ear* - të bësh një vesh të shurdhër, *to say something to someone's face* -ta thuash hapur dhe në mënyrë direkte edhe pse mund të jetë e pakëndshmë, *to have something in hand* - ta kesh në dorë, në kontroll, *to raise your hand against somebody* - ta godasësh dikë, të ngresh dorë mbi dikë, *to put an idea into someone's head* - ti japësh dikujt një mendim apo sugjerim për diçka, t*o know/learn something by heart* -ta mëshosh përmendësh diçka, *to have something on the tip of one's tongue* - në majë të gjuhës.

**Veçori të ndërtimit të njësive frazeologjike me pjesë të trupit**

Veçoritë semantike dhe strukturore të njësive frazeologjike në të dyja gjuhët janë tregues evidentë për të dalluar dhe qasur njësitë frazeologjike në gjuhët e mara në studim. Ngjashmëritë dhe të veçantat midis tyre janë trajtuar nëpërmjet një analize qasëse dygjuhëshe duke renditur karakteristikat bazë të njësive frazeologjike me vatër semantike me pjesë të trupit si vijon.

Përsa i përket strukturës së njësive frazeologjike në gjuhën angleze vihen re ndërtime me përsëritje të së njëjtës fjalë ose nga dy fjalë të lidhura kuptimisht. Ndërtimet më të zakonshme janë ndërtimet **me + emër + parafjalë + emër** dhe **me + emër + mbiemër.** Në të dyja gjuhët gjymtyrët bashkohen me ndihmën e një fjale shërbyese dhe në disa raste e prirë nga **një parafjalë +emër + parafjalë+ emër**, p.sh., *me gisht në gojë, me bisht në (ndër) shalë, me shpirt në gojë, me dorë në zemër***,** *me lotë ndër faqe, me armë në dorë, me kokë në torbë, me mend në kokë*si p.sh: *from ear to ear, to see eye to eye, from hand to hand*, *to go hand in hand*, *hand over hand, in one's heart of hearts (in one's heart's heart)*, *neck and neck etc.*

Në shqipe kemi frazeologjizma ndajfoljorë me përsëritje të nënrenditur me parafjalët:

**-më** me kuptim të përgjithshëm vendor te njësitë: *faqe më faqe, gojë më gojë, nofull*

*më nofull, kokë më kokë, vesh më vesh.* Në anglisht kemi parafjalën ***to, for****, etj., ear to ear, face to face, mouth to mouth, etj.*

**- për** e cila tregon gjithashtu vend: *kokë për kokë, krah për krah, ballë për ballë, dorë për dore, dhëmb për dhëmb.*

**- pas** në kuptimin e kohës dhe të mënyrës si: *bark pas barku, dorë pas dore, gojë pas goje, këmbë pas këmbe,* etj.

**- në**: *në këmbë e në dorë, në majë të gishtave, në majë të gjuhës*,etj.;

**- nga:** nga sytë këmbët, nga këmbët kokën,

**- pa**: pa mend në kokë etj.;

**- me:** *me mish e me shpirt, me thonj e me dhëmbë, me këmbë e duar* etj.

Një grup tjetër përbëjnë togjet e nënrenditura pa parafjalë, por me një emër në emërore dhe një në dhanore – rrjedhore të shquar ose kallëzore të shquar, si: *dora dorës/dora dorën, këmba këmbës/këmba këmbën* etj.

Vemë re edhe njësi frazeologjike që nisin me një parafjalë p.sh., me parafjalën **për:** *për sy e faqe, për mustaqet e Çelos* dhe me parajalë të tjera si: **në, me, nga, tek, pa.**

Ajo çka është tipike në të dyja gjuhët, është formimi i njësive frazeologjike mbi bazën e **metaforës, krahasimit dhe metonimisë**. Ka një numër të madh shprehjesh në anglisht dhe shqip që janë ndërtuar mbi bazën e figurave letrare duke e bërë kuptimin e tyre figurativ, idiomatik.

Njësi të formuara me anën e metaforës janë: *the heart of the city, the foot of the mountain/bed/stairs, to give a hand, to break somobody's heart*, *tospill the beans,* etj. Strukturë tipike e njësive të ndërtuara mbi bazën e krahasimit është struktura në anglishte *as…as* në shqipe *po aq sa*. Shumica e krahsimeve janë të ndërtuara me strukturën:

**as + adjective (mbiemër) + as + (a/the) + noun (emër)** si p.sh: *as clear as the nose on your face, as red as nose, as plain as the nose on your face,* në njësi të tjera kemi: *as black as the Ace of Spades, as black as cool, as cold as charity, as cunning as a fox, as firm as a rock, as flat as a board, as good as a play, as green as grass, as round as an apple, as smooth as oil, as silent as stars, as wise as Solomon, etj.*

**Verb+like + (a/an) + Noun**. p.sh: *to drink like a fish, to eat like a horse, to fight like a cat and dog, to get on like a house on fire, to go like the wind, to run like a hare, to sing like a bird/lark/nightngle, to sleep like a dog, to smoke like a chimney, to swim like a fish, to work like a Troyan, etj.*

Një grup tjetër janë ndërtimet pa ndonjë strukturë të veçantë, por të ndërtuara mbi bazën e krahasimit me pjesëzen ***like*** si p.sh: *to be like a red rag to a bull, like a fish out of water, as the crow flies, like water off a duck's back,a memory like an elephant, eyes like a ferret, a hide like a rhinoceros, like a bear with a sore head,etj.*

Në frazeologjizmat e pjesëve të trupit ka njësi që kanë vetëm kuptim pohor, ndërsa kuptimi mohor nuk ekziston. P.sh. *më hëngri veshët, i plasi delli i ballit, hëngri buzën me dhëmbë, më zien koka nga hallet* etj.

Në gjuhën shqipe ka raste kur ndërrimi i parafjalës në një njësi sjell ndryshimin e kuptimit të shprehjes, p.sh. *të mban në gojë= të kujton për mirë, të mban nëpër gojë= flet keq,* etj.

Paralelet midis dy gjuhëve vihen re si nga struktura formale ashtu edhe nga ndërtimi semantik. Tipi më i zakonshëm janë njësitë frazeologjike që janë formuar nga shndërrimi i togfjalëshave të lirë në ata frazeologjikë p.sh: *hap gojën, fut hundët, i doli për hundësh, mbylli sytë, i pret gjuha, i ktheu kurrizin (shpinën), më doli nga dora, vari hundët, i nxorri bërrylin, i nxori gjuhën, mbeti me gojë hapur, nuk e mbanin këmbët, i ha kurrizi, na hëngri veshët* etj. - *dust somebody's eyes*, *fix one's eyes on*, *in the public eye*, *to keep an eye on*

*something/someone*, *watch somebody out of the corner of one's eye*, *turn a blind eye*, *with an eye to doing something*,*to have sticky fingers*, *to have a finger in the pie*, *came out with clean hands*, *to take something in hand* , *to have or to keep something at one's fingertips, know somebody (something) like the palm of one's hand*, *to raise your hand against somebodyneck*, *to have something on the tip of one's tongue,*etj.

Ndryshe nga njësitë frazeologjike në anglishte, në gjuhën shqipe vihen re njësi, të cilat janë të burimit turk, p.sh.: *është eksiq nga koka, kabull të bëj edhe mbi kokë e sipër, mori fjala dynjanë, kishte rënë nga dynjallëku*, *oxhaku është i çelun për çdo kënd, tallaze-tallaze asht ky burri im*, *nuk lëviz xhanxhi njeriu*, *bezér ta shohësh me sy*, *kam berzah për dike* etj. Këto njësi kanë hyrë gjatë periudhës së sundimit osman. Por me zhdukjen e pushtimit ky numër ka erdhur duke u zvogëluar, dhe sot në pjesën më të madhe cilësohen si barbarizma. Anglishtja nuk ka pasur ndikim të fjalëve turke në përbërjen e frazeologjisë angleze. Në anglisht ndihet ndikimi i gjuhëve të tjera si nga frëngjishtja p.sh, *kings have long arms*, *Burdian's ass*, etj; nga latinishtja p.sh, *vox populi, a capella, etj;* nga gjermanishtja: *blood and iron*; spanishtja: *blue blood*; kinezça: *loselsave face*, etj. A.V. Koonin-i dallon edhe amerikanizma ndërmjet njësive frazeologjike. Ato ndahen gjithashtu në njësi që u sollën nëpërmjet kontakteve të ndryshme dhe nëpërmjet burimeve të drejtpërdrejta si p.sh: *a shot on the arm* -një stimul; *all singing, all dancing* -me shumë cilësi, atribute; *an arm and a leg* -një shumë e madhe lekësh; *the bee's knees* - i shkëlqyer; *foot in the door* - një prezantim apo mënyrë drejt diçkaje, etj.

Ndër këto burime kemi edhe shumë njësi frazeologjike që nuk i përkasin vatrës semantike me pjesë të trupit dhe për këtë qëllim nuk janë përfshirë në shembujt e dhënë.

Në gjuhën shqipe disa njësi frazeologjike përbëhen nga dy a më shumë emra, nga të cilët njëri është si përcaktues për emrin tjetër; mund të jenë në rasa të ndryshme, me ose pa parafjalë p.sh. me *djersën e balli t- the sweat of one's brow; drita e syve- the apple of one's eye; dorë e hekurt- iron hand; me thonj të duarve, në lule të ballit* etj. Kemi njësi frazeologjike:

i) me marrëdhënie kundrinore: *i ka plasur cipa e ballit, s'e njeh qeni të zonë, mos e bëj mizën buall, të merr gjak në vetull, vëri gishtin kokës, i ishte bërë shpirti derr,* etj.

ii) me marrëdhënie përcaktore p.sh *me gojë thatë, me krahë hapët,*etj

iii) me marrëdhënie rrethanore p.sh. *ecën drejt hundës, i ra zemra fash,* etj.

Shumica e frazeologjizmave, përveç kuptimit leksikor objektiv, kanë edhe *ngjyrim emocional*, tregojnë edhe vlerësimin e folësit për atë që përmend. Kjo duket qartë po të krahasojmë frazeologjizmat me fjalët asnjanëse si: *e solli kokën* "erdhi", *e theu qafën* "iku", *i ranë pendët* "u shtrua, *i heq dru* "kritikoj", *ua mbath këmbëve* "iki", *i marr shpirtin* "e mundoj", *kockë e lëkurë* "i dobët" *shes mend* "mburrem" etj. Një grup frazeologjizmash për shkak të përmbajtjes së tyre të rëndë, i përkasin ligjërimit bisedor ose ligjërimit të thjeshtë. P.sh. vihen re njësi frazeologjike që shprehin ironi, mospërfillje, mallkim shpërfillje, urim, përçmim, përkëdheli, njësi me kuptim keqësues etj. si: *i bëj gropën, i krip trutë, i ha grykën, ndeu këmbën, na la shëndenë* etj.

Në këtë mënyrë, frazeologjizmat, më shumë se fjalët, e konkretizojnë situatën, janë të një shkalle më të lartë aktualizimi, i japin ligjërimit përmbajtjen e kërkuar, prandaj ne ndeshemi më rrallë me frazeologjinë në letërsinë shkencore, ku

abstaraksioni e përgjithësimi janë në fushën e vet, po ndeshemi shumë më dendur në letërsinë artistike, në pamflete politike, në shkrimet satirike e humoristike, në gjuhë e estradës, në ligjërimin e përditshëm etj.(Thomai, 1981).

Te këto njësi vihet re ndryshimi i strukturës së njësive frazeologjike si pasojë e përforcimit emfatik, e kërkesave të stilit a të gjinisë letrare etj. Për këtë shkak ndryshon struktura e njësive frazeologjike edhe tek urimet, mallkimet, etj. Duke qenë se vlera shprehëse-emocionale është e përhershme, ajo ka sjellë që skema dytësore e rendit të fjalëve jo në përputhje me skemën e gjedhës fillestare, të jetë më e zakonshme në përdorim. Ndërtimi i tyre me folje në mënyrën dëshirore i përgjigjet ngarkesës emocionale që mbajnë dhe kjo ka çuar në ngurosje më të madhe të lidhjeve sintaksore dytësore. P.sh. në monografinë "Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe", (Thomai,1981), jep këto shembuj: *Këmbëmbarë qoftë! Më qafë më paçi! Vaj më rëntë pika! etj.* E njëjta gjë vihet re edhe në proverbat, fjalët e urta etj. P.sh. *Tym pa zjarr nuk ka kurrë. Fli të marrtë lumi, etj.*(Po aty)

Rol përcaktues në njësitë frazeologjike që lidhen me pjesët e trupit luan edhe rendi i fjalëve në njësi. Kuptimi nuk ndryshon edhe kur gjymtyrët ndërrojnë vendin edhe pse ato janë të përcaktuara dhe nuk lejojnë lëvizshmëri të madhe brenda njësisë, tipar karakteristik i njësive frazeologjike lidhur me ngurtësinë dhe stabilitetin leksikor. Ky ndryshim mund të ndodhë për qëllime stilistikore dhe për të shpreur qendrimin emocional të folësit p.sh. *i lëshon goja lëng, goja lëng i lëshon; e la me gisht në gojë me gisht në gojë e la,* etj.

**Përfundime dhe rekomandime**

Qëllimi i kumtesës është të paraqesë në mënyrë të saktë dhe të zgjeruar njësitë me vatër semantike, njësi me pjesë të trupit në anglishte dhe shqipe duke i paraqitur nëpërmjet një analize qasëse krahasuese në të dy gjuhët. Gjatë punimit është trajtuar realizimi i kuptimit të njësive gjegjëse në të dyja gjuhët dhe nëse janë shprehur me të njëjtën pjesë të trupit apo jo. Janë dhënë rastet kur kemi ndryshime të vatrës semantike në të dyja gjuhët, rastet kur janë paraqitur me pjesë të ndryshme të trupit apo me ndonjë emër a njësi tjetër që nuk është pjesë e trupit. Sipas analizës janë vënë re:

-njësi me pjesë të trupit në anglisht për të cilat ne kemi gjegjëset përkatëse, kalke frazeologjike. Sipas vatrës semantike dallojmë: a) njësi që kanë si vatër kuptimore gjymtyrën që emërton pjesën e trupit b) njësi ku si vatër kuptimore nuk shërben gjymtyra me pjesë të trupit, por një fjalë tjetër përbërëse e njësisë si p.sh. folja, mbiemri. Vihen re njësi frazeologjike të mënyrës urdhërore në të dyja gjuhët, në të cilat vatra semantike nuk është gjymyra, kuptimi i së cilës jepet në anglisht, por një folje.

Dallohen një numër i madh njësish frazeologjike me vatër semantike me gjymtyrë me pjesë të trupit në anglishte, por që në strukturën e njësisë në shqipe nuk jepet me gjymtyrë me pjesë të trupit. Kemi njësi frazeologjike me vatër semantike me gjymtyrë me pjesë të trupit në shqip, por jo me vatër semantike me pjesë trupit në anglisht. Vërejmë njësi frazeologjike që në anglisht shprehen me një emër të përveçëm ndërsa në shqip me gjymtyrë me pjesë të trupit. Në gjuhën shqipe ashtu si edhe në gjuhën angleze vihen re njësi frazelogjike që janë sinonime dhe kanë të njëjtin kuptim të cilat nga struktura formale janë të ndryshme duke ndryshuar një emër, folje apo mbiemër në strukturën përbërëse, por nga ndërtimi semantik janë të njëjta. Vemë re njësi që si vatër semantike kanë të njëjtën gjymtyrë në shqipe dhe anglishte, por në shqip

njësia ka në strukturë edhe një numëror. Në gjuhën shqipe ashtu si edhe në gjuhën angleze hasen njësi frazeologjike që kanë në strukturën e tyre të njëjtat pjesë, pra me vatër të njëjtë semantike, për të dhënë të njëjtin kuptim.

Në punim janë parë edhe veçori të ndërtimit të njësive frazeologjike me pjesë të trupit. Në shqip kemi frazeologjizma ndajfoljorë me përsëritje të nënrenditur me parafjalët: **më, për, pas, në, nga, pa**, **me.** Ka një numër të madh shprehjesh në anglisht dhe shqip që janë ndërtuar mbi bazën e figurave letrare duke e bërë kuptimin e tyre figurativ, idiomatik. Paralelet midis dy gjuhëve vihen re si nga struktura formale ashtu edhe nga ndërtimi semantik. Tipi më i zakonshëm janë njësitë frazeologjike që janë formuar nga shndërrimi i togfjalëshave të lirë në ata frazeologjikë. Shumica e frazeologjizmave, përveç kuptimit leksikor objektiv, kanë edhe *ngjyrim emocional*, tregojnë edhe vlerësimin e folësit për atë që përmend. Rol përcaktues në njësitë frazeologjike që lidhen me pjesët e trupit luan edhe rendi i fjalëve në njësi. Kuptimi nuk ndryshon edhe kur gjymtyrët ndërrojnë vendin edhe pse ato janë të përcaktuar dhe nuk lejojnë lëvizshmëri të madhe brenda njësisë, tipar karakteristik i njësive frazeologjike lidhur me ngurtësinë dhe stabilitetin leksikor.

Punimi lë vend për trajtime dhe plotësime të tjera nga gjuhëtarë dhe studiues të tjerë të interesuar në këtë lëmë të leksikologjisë, duke sjellë prurje të reja dhe duke dhënë ndoshta një analizë më të detajuar të njësive frazeologike në të dyja gjuhët, të parë pse jo edhe nga një këndvështrim tjetër.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Cowie, A.P.(1988).*Sable and creative aspects of vocabulary use*, in R.Carter and M.McCarthy (eds.) 1998. Vocabulary and Language Teaching London: Longman. 126-139.

Ginzburg R. S.et al. (1979).*A Course in Modern English Lexicology, M*.

Gläser, R. (1998). *The stylistic potential of phraseological units in the light of genre analysis*. In ed. A. P. Cowie, 125-143.

Hajdini, G. (1985).*Njësi frazeologjike nga rrethi i Kolonjës*,S.P., Nr.3, p.159-162

Islamaj,Sh. (1986).*Sinonimia Frazeologjike në gjuhën shqipe*, S.F, Nr.4

Jashari, A. (2007).*Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Korçë.

Mc.Carthy, O'Dell P. (1994). *English idioms in use,* Cambridge University Press.

Moon,R. (1998).*Fixed expressions and idioms in English: A corpus-based approach,* Alarendon Press.

Mustaka, N. (1986). *Njësi frazeologjike nga rrethi i Korçës*, S.P., Nr.3, p.209-215

Seidl, J., McMordie,W. (1978).*English idioms and how to use them*, Oxford University Press.

Stefallari, I., Dheri, V. (1981).*Fjalor frazeologjik Anglisht-Shqip*, Tiranë.

Strässler, J.Norr (1982).*Idioms in English; A pragmatic analysis.*

Thomai, J. (1981).*Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe,* Tiranë.

Thomai, J. (1966).*Mbi Rendin e Fjalëve në Strukturën e Frazeologizmave të Shqipes*, S.F, Nr.1.

Thomai, J. (1965).*Vëzhgime mbi frazeologjizmat e Gjuhës shqipe*, Studime Albanologjike, Tiranë.

Thomaj, J. (2010).*Fjalori Frazeologjik i Gjuhës Shqipe.*

Thomai, J. (2002).*Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.

# MËNYRAT E FJALËFORMIMIT NË LEKSIKUN E GJELLËTARISË

**MIGENA RIZA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Punimi ynë paraqet një analizë të pasurisë së kësaj fushe semantike sipas *"Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*. Kemi nxjerrë së pari të gjitha emërtimet që janë shënuar me shkurtimin *gjell*. (= gjellëtari) duke vënë në dukje vendin që zënë këto emërtime në tërësinë e *"Fjalorit"*, por në të njëjtën kohë nuk kemi mënjanuar edhe emërtime te të cilat ky shënim mungon.

Në punim bëhet një analizë e këtij leksiku nga pikëpamja e formimit dhe e motivimit, duke dalluar: **a)** fjalë të parme **c)** të prejardhura **d)** të përbëra **e)** me konversion.

Vëmendja kryesore në këtë punim i kushtohet fjalëve që janë formuar sipas gurrës së gjuhës shqipe, për të sintetizuar në tërësi mjete fjalëformuese, që kanë prekur këtë pjesë të lëksikut. Pas vjeljes, klasifikimit, renditjes dhe analizës tërësore të materialit kemi vënë në dukje mjete më prodhimtare, të cilat janë bërë burim kryesor për formimin e këtyre emërtimeve.

Punimi synon të hapë një diskutim për mënyrën si janë pasqyruar këto emërtime me ose pa shënime *gjell*. (= gjellëtari), si dhe të ndihmoj me ide të reja për një pasqyrim më të plotë të emërtimeve të kësaj fushe në një fjalor të ardhshëm të gjuhës shqipe.

**Fjalë çelës:** *gjellëtari, fjalëformimi, motivim, semantikë*

**Abstract**

This paper analyses the wide semantic field of cookery shown in the *"Current Albaninan Dictionary"*.

First of all, we have picked up all the entries bearing the subject label *gjell*. (= gjellëtari – cookery), underscoring their part in the "Dictionary", not overlooking cookery entries not determined by this label.

In this paper we analyse the cookery lexicon focusing on word-formation and motivation and distinguishing: **a)** prompt words; **b)** derivative words; **c)** compound words; **d)** conversion formed words.

Main goal of this paper is showing intrinsic Albanian word-formation concerning this lexicon. After collecting, classifying, ordering, and analysing thoroughly the corpus we have underlined more productive ways, that are now main forming sources of these words.

This discourse aims to start a discussion about the way these entries are shown in "The Dictionary", with or without the subject label *gjell*. (= gjellëtari - cookery), as well as to help with new ideas for a thorough representation of the cookery words in a future Albanian reference.

**Key words:** *cookery, word-formation, motivation, semantics*

Punimi ynë është një trajtesë e detajuar mbi mënyrat e fjalëformimit të emërtimeve që i përkasin sferës semantike të gjellëtarisë. Lënda bazë ku jemi mbështetur është *"Fjalori"* i vitit 1980, i cili mbetet ende fjalori më i plotë i gjuhës shqipe deri më sot, sidomos nga pikëpamja e zbërthimit dhe ilustrimit të kuptimeve dhe të fjalëve, si dhe e pajisjes me shënime stilistike e terminologjike. Në rreth 41 mijë fjalë që përmban ky *"Fjalor"* ne kemi vjelë fillimisht të gjithë emërtimet që lidhen me sferën e kuzhinës dhe më pas, prej tyre kemi shkëputur vetëm emërtimet e gatesave. Në etapën e veçimit të tyre dallojmë dy grupe emërtesash, një grup na shfaqet me shënimin *gjell.* dhe një pjesë tjetër, jo më pak e rëndësishme, dalin pa këtë shënim.

Duke pasur si qëllim parësor të qenit sa më gjithëpërfshirës dhe objektiv në analizë i kemi trajtuar të dy grupet në mënyrë që korpusi i emërtimeve të kësaj sfere të ishte sa më i plotë e i saktë.

Synimi kryesor në këtë punim i kushtohet analizës fjalëformuese, për këtë arsye na është dashur të trajtojmë vetëm ato fjalë që janë formuar brenda gjuhës shqipe, me mënyrat fjalëformuese të gjuhës sonë, ndërsa fjalët me prejardhje të huaj nuk analizohen nga pikëpamja e fjalëformimit, sepse ato janë marrë të gatshme nga gjuha e huaj ku janë formuar. Realizimi i këtij punimi është me rëndësi gjuhësore, sepse nëpërmjet tij ne mësojmë cilat kanë qenë mjetet kryesore të formimit të fjalëve nga sfera e gjellëtarisë, por ky punim ka edhe rëndësi shoqërore dhe historike sepse nëpërmjet leksikut të kësaj fushe njohim llojet e gjellëve, gatesave që kanë përdorur tradicionalisht shqiptarët deri në daljen e këtij *"Fjalori"*.

**Materialet dhe metodat**

Vjelja e lëndës nga *"Fjalori"* ka qenë një punë me përgjegjësi, sepse kemi synuar të pasqyrojmë në mënyrë të plotë të gjithë materialin që ka lidhje me temën, duke pohuar bindshëm se në fund të punës sonë ne kemi arritur një vjelje shteruese të të gjithë emërtimeve. Grumbullimi, por dhe klasifikimi i materialit, ka qenë një etapë po kaq e rëndësishme e punës sonë e cila na ka lejuar jo vetëm një renditje të të tij, por dhe një grupim në përputhje me synimet kryesore të një analize fajlëformuese sa më të saktë.

Shembullarizimi është përdorur nga ne si një metodë e cila na ka shërbyer për të konkrtetizur raste e ndryshme. Shpeshherë na është dashur të bëjmë përqasje dhe përballëvënie të materialit për të parë ku bashkohen dhe ku ndahen këto emërtime, apo kategori leksiko-gramatikore në bazë të tipareve të marra në shqyrtim. Natyrisht, kemi përjashtuar materialin që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me temën. Kjo punë na ka çuar në një analizë e cila ka synuar rezultate konkrete të cilat siguronin unitetin dhe harmoninë e gjithë punimit, duke përcjellë informacion të vlefshëm me bazë shencore.

**Vërejtje të përgjithshme rreth lëndës së vjelë nga FGJSSH**

Etapa e parë e punës sonë ka të bëjë me vjeljen shteruese nga *"Fjalori i gjuhës së sotme shqipe"* (FGjSSh) të emërtimeve që janë shënuar me shkurtimin *gjell*. (= gjellëtari), të cilat po i japim më poshtë:

1. **Ajkëtor, ~i***m. sh. gjell*.
2. **Akçiash, ~i***m. gjell*.
3. **Arapash, ~i***m. gjell*.
4. **Ashur/e, ~ja***p. sh.* **1.** *gjell*.
5. **Bacarak, ~u***m. sh. gjell*.
6. **Beshamel, ~i***m. gjell*.
7. **Bibish, ~i** *m. gjell*.
8. **Biftek, ~u***m. sh. gjell*.
9. **Bisbiq, ~i***m. sh. gjell*.
10. **Bonjër/i, ~a***p. sh.* **1.** *gjell*.
11. **Brobull, ~a** *p. sh. gjell*.
12. **Brumanik, ~u***m. sh. gjell.*

13. **Brushtu/ll, ~lli***m. gjell.*
14. **Buding, ~u***m. sh*. *gjell*.
15. **Bukafec, ~i***m.* sh. gjell.
16. **Bukëval/e, ~ja***p. sh*. **1.** *gjell.*
17. **Bumbar, ~i***m. sh. gjell*.
18. **Burani, ~a***p. gjell*.
19. **Byreçk/ë, ~a***p. sh. gjell*.
20. **Byrek, ~u***m. sh. gjell*.
21. **Byreksheqer, ~i***m. sh. gjell*.
22. **Cive, ~ja***p. gjell*.
23. **Copkanik, ~u***m. sh. gjell. krahin*.
24. **Çallm/ë, ~a***p. sh.* **3.** *gjell*.
25. **Çervish, ~i** *m. vjet.* **1.** *gjell.*
26. **Çomlek, ~u***m. gjell.*
27. **Çorb/ë, ~a** p. **1.** *gjell*. **2.** *gjell*.
28. **Dërrmash, ~i***m*. **2.** *gjell.*
29. **Djathanik, ~u***m. sh. gjell*.
30. **Dollma, ~ja***p. sh. gjell*.
31. **Dredhanik, ~u***m. sh. gjeli*.
32. **Fërli, ~a***p. sh. gjell*.
33. **Gajgana, ~ja***p. sh. gjell*.
34. **Garnitur/ë, ~a***p. sh*. **1.** *gjell.*
35. **Groviq/e, ~ja***p. gjell*.
36. **Gjalpanik, ~u***m. sh. gjell.*
37. **Gjethanik, ~u***m. sh. gjell*.
38. **Gjizanik, ~u***m. sh. gjell.*
39. **Gjoks, ~i** *m. sh.* **2**. *gjell.*
40. **Gjylaç, ~i***m. gjell*.
41. **Gjysleme, ~ja***p. sh. gjell.*
42. **Gjyveç, ~i***m. sh*. **1.** *gjell*.
43. **Hardall, ~i***m. sh*. **2.** *gjell.*
44. **Hasud/e, ~ja***p. gjell*.
45. **Iç, ~*i*** *m. sh. gjell*.
46. **Imambajalldi, ~a***p. gjell*.
47. **Jahni, ~ja***p. sh. gjell*.
48. **Japrak, ~u***m. sh. gjell*.
49. **Kanape, ~ja***p. sh.* **2.** *gjell.*
50. **Kapama, ~ja***p. sh. gjell*.
51. **Kaurma, ~ja***p. sh. gjell.*
52. **Këmbëkuq/e, ~ja***p. gjell*.
53. **Kim/ë, ~a** *p. gjell*.
54. **Kole, ~ja***p. sh. gjell*.
55. **Kordhëz, ~a***p. sh*. **1.** *gjell*.
56. **Kripanik, ~u***m. sh*. **2.** *gjell.*
57. **Kukurec, ~i***m. sh. gjell*.
58. **Kungullnik, ~u***m. sh. gjell*.
59. **Kuvare, ~t***p. vet. sh. gjell*.
60. **Lakror, ~i***m. sh. gjell.*
61. **Lakuriq, ~i***m. sh*. **2.** *gjell*. **3.** *gjell*.
62. **Laropit/ë, ~a***p. gjell*.
63. **Leshnik, ~u***m. gjell*.
64. **Majonez/ë, ~a***p. sh. gjell*.
65. **Matur, ~a***p. Gjell.*
66. **Maz/ë, ~a** *p. sh.* **4.** *gjell.*
67. **Mbushj/e, ~a***p. sh*. **5.** *gjell*.
68. **Mesnik, ~u** *m. sh. gjell.*
69. **Mez/e, ~ja***p. sh.* **1.** *gjell.*
70. **Mëmëlig/ë, ~a***p. sh. gjell*.
71. **Musaka, ~ja** *p. sh. gjell*.
72. **Omëlet/ë, ~a***p. sh. gjell*.
73. **Paç/e, ~ja** *p. sh*. **1.** *gjell.*
74. **Paluz/e, ~ja** *p. gjell*.
75. **Pastiço, ~ja***p. sh. gjell*.
76. **Pendespanj/ë, ~a**. *gjell.*
77. **Qebap, ~i***m. sh*. **1.** *gjell.* **2.** *gjell*.
78. **Qeshqek, ~u***m. gjell*.
79. **Qoft/e, ~ja***p. sh. gjell*.
80. **Qoftor/e, ~ja***p. sh. gjell*.
81. **Qullanik, ~u***m. gjell*.
82. **Qullash, ~i***m. sh. gjell*.
83. **Radhanik, ~u***m. sh. gjell*.
84. **Ragu, ~ja***p. gjell*.
85. **Reçel, ~i***m. sh. gjell*.
86. **Reshedi, ~a***p. sh. gjell*.
87. **Revani, ~a***p. sh. gjell*.
88. **Rishte, ~t***vet. sh.* 1. *gjell.*
89. **Rosto, ~ja***p. sh. gjell*.
90. **Roshnica, ~t***p. vet. sh. gjell*.
91. **Rrethanik, ~u***m. sh*. *gjell*.
92. **Rrufk/ë, ~a***p. sh.* **2.** *vet. sh. gjell*.
93. **Salc/ë, ~a***p. sh. gjell*.
94. **Salsiç/e, ~ja***p. sh. gjell.*
95. **Samsa, ~ja***p. sh. gjell*.
96. **Sarma, ~ja** *p. sh gjell.*
97. **Suxhuk, ~u***m. sh. gjell*.
98. **Sytliaç, ~i** *m. gjell*.
99. **Shapkat, ~i***m*. *gjell*.
100. **Shishqebap, ~i***m. sh. gjell*.
101. **Tarator, ~i** *m. sh. gjell*.
102. **Tasqebap, ~i***m. gjell*.
103. **Trahana, ~ja***p.* **2.** *gjell*.
104. **Trazor/e, ~ja** *p. sh*. **1.** *gjell.*

**105. Turli, ~a***p. gjell*.
**106. Turshi, ~a***p. sh. gjell*.

Në përfundim të kësaj pune vëmë re se në FGjSSh ky shënim është vendosur vetëm në 107 fjalë, pra nga rreth 41 mijë fjalë që përmban *"Fjalori"* vetëm 107 mbajnë shënimin *gjell.* Por kjo shifër nuk është tregues përfundimtar për përfshirjen e leksikut të kësaj sfere semantike në "Fjalor", pasi ky shënim nuk është vënë kudo me të njëjtin kriter, p.sh. janë shënuar me shkurtimin *gjell*. fjalët *qullanik* e *qullash*, por jo vetë fjala *qull*, prej së cilës janë formuar e motivohen ato; po kështu te fjala *çorbë* është vënë shënimi *gjell*., ndërsa te fjala *supë* mungon; ose është vënë te fjala *reçel*, por mungon te fjala *gliko*, e cila shpjegohet si një lloj reçeli...; mungon shënimi *gjell*. te fjalë, si: *pelte, pure*, *fërgesë, përshesh, dhallanik, kripanik, misërnik, palanik, prushanik, shpuzanik, bllacore, çerepore, përvëlorë, thartor, biralec, larash* etj. Shembuj të tillë ka me dhjetëra, prandaj na u desh të vjelim edhe një herë me kujdes FGjSSh duke nxjerrë edhe emërtimet të cilat nuk e kishin shënimin *gjell*., në mënyrë që korpusi i emërtimeve të kësaj sfere të ishte pasqyruar i plotë në punimin tonë.

Fjalët e këtij korpusi, më pas janë vështruar nga pikëpamja fjalëformuese. Siç do të shpjegohet edhe më poshtë te analiza fjalëformuese, një pjesë jo e vogël e emërtimeve të kësaj fushe janë fjalë shqipe ose formime nga fjalë shqipe që shënojnë sende ushqimore, si: (*ajkë-tor, brum-anik, bukë-vale* etj.), veprime që kryhen për përgatitjen e tyre, si: (*mbush-je, trazo-re*) etj.

Kështu, në analizën fjalëformuese do të trajtojmë ato fjalë që janë formuar brenda gjuhës shqipe, me mënyrat fjalëformuese të gjuhës sonë, ndërsa fjalët me prejardhje të huaj, të cilat në fushën e gjellëtarisë në gjuhët e Ballkanit kanë hyrë

***107.* Zerva, ~ja***p. gjell., krahin.*

kryesisht nga turqishtja (por, siç është vënë në dukje, vetë turqishtja, një pjesë të mirë të emërtimeve të kësaj fushe i ka marrë nga persishtja, pasi persët kanë pasur një traditë qytetërimi më të pasur e më të lashtë në krahasim me turqit osmanë, që kanë qenë popull nomad derisa u ngulën në Azinë e Vogël.); si: *akçiash, arapash, ashure, hardall, hasude, imambajalldi, qebapi, qeshqek,* etj., kjo si pasojë e ndikimit të qytetërimit oriental të bazuar në fenë islame, nuk i nënshtrohen kësaj analize. Përveç orientalizmave ajo që vihet re është dhe ndikimi i gjuhëve perëndimore, që shfaqet në huazime të tilla, si: *beshamel, buding, majonezë, omëletë, rosto, salcë, salsiçe* etj., të cilat po ashtu nuk analizohen nga pikëpamja e fjalëformimit, sepse ato janë marrë të gatshme nga gjuha e huaj ku janë formuar.

**Leksiku i gjellëtarisë nga pikëpamja e fjalëformimit**

Emërtimet që i përkasin sferës së leksikut të gjellëtarisë, me ose pa shkurtimin *gjell*. në FGjSSh, hyjnë në kategorinë leksiko-gramatikore të emrit. Shumica e tyre janë fjalë të parme, si: *bukë, bulmet, djathë, gjizë,* etj., ose huazime nga gjuhë të tjera, si *byrek, çomlek, çorbë, pilaf* etj. (orientalizma); *biftek, majonezë, supë, salcë* etj. (huazime moderne), që nuk i nënshtrohen analizës fjalëformuese brenda shqipes dhe merren gjithashtu si fjalë të parme. Por një numër emërtimesh të tjera janë formuar brenda gjuhës shqipe dhe klasifikohen në:

**Fjalë të prejardhura**

Pjesa më e madhe e emërtimeve të pahuazuara janë formime me prapashtesa. Prapashtesa zakonisht bashkohet me një temë emërore që shënon lëndën prej së cilës përgatitet gatesa.

- **–nik**

Bie në sy se prapashtesa më e përdorshme për formimin e emërtimeve të gjellëtarisë është -n*ik*; kjo prapashtesë ka përhapje më të dendur në toskërishten verilindore, ku përfshihet edhe zona Pogradec – Korçë – Kolonjës. Sipas Çabejt dhe Xhuvanit kjo prapashtesë ka hyrë në gjuhën shqipe prej emrash sllavë pastaj ajo është bërë produktive edhe në fjalë shqipe duke prekur më së shumti edhe emërtimet e kësaj sfere (Xhuvani & Çabej, 1962,pp. 518-519).

Prapashtesa -*nik* zakonisht bashkohet me një temë emërore që shënon lëndën kryesore prej së cilës përgatitet gatesa, ose një lëndë përbërëse të rëndësishme, p. sh., : *brumanik* "byrek që bëhet me brumë të ardhur, me vezë, me gjalpë e me qumësht" (motivohet nga lënda kryesore e brumit); *djathanik* "byrek me djathë" ( motivohet nga *lënda e djathit*); *dhallanik* "lakror misri me dhallë ose me kos" (motivohet nga *dhallë*); *gjalpanik* "1. lloj byreku, që bëhet zakonisht me dy petë, të cilat tëhollen duke u palosur e duke u lyer me gjalpë disa herë (motivohet nga *gjalpë*); *gjethanik* "lakror që bëhet me gjethe preshi, qepësh të njoma" (motivohet nga *gjethe*); *gjizanik* "byrek me gjizë; gatesë që bëhet në sini, ku shtrohet mbi disa petë si të byrekut një sasi e madhe gjize e rrahur me qumësht e me vezë, e cila piqet në furrë pa petë përsipër" (motivohet nga *lënda gjizë*); *kripanik* "lakror i gatuar me miell misri, me gjizë të kripur e me dhallë" (motivohet nga *kripë*, pra gjiza e cila është konservuar me kripë, sasia e kripës te ky lakror mund të jetë më e lartë se normalja); *kungullnik* "lloj lakrori vetëm me një petë mbi të cilën shtrohet çi i përgatitur me kungull dhe me vezë" (motivohet nga *kungull*); *misërnik* "bukë misri." (motivohet nga *misër*, bukë e bërë me miell misri); *petanik* "lloj byreku me shumë petë, i përgatitur me gjalpë ose me vaj dhe me mish, me oriz, me fasule etj. të shtruara mbi çdo petë; byrek me disa petë të lyera me gjalpë, të vëna njëra mbi tjetrën dhe të pjekura në furrë" (motivimi vjen nga *petë*, pra përbërja me shumë petë); *qullanik* "1. bukë e hollë që bëhet me miell misri të përvëluar me ujë të nxehtë ose të trazuar me ujë të ftohtë" (motivohet nga *qull*); këtu mund të përfshihet edhe fjala *leshnik* "lloj ëmbëlsire me qumësht delesh e me miell", sepse tema *"lesh"* në këtë rast ka kuptimin "qumësht i bagëtive të leshta" (dele).

Me prapashtesën -*nik* janë formuar edhe emërtime te të cilat motivimi nuk lidhet drejtpërdrejt me lëndën, por mënyra e motivimit mund të shpjegohet vetëm duke u bazuar te shpjegimi semantik që secila fjalë ka në fjalor, p.sh.: *copkanik* "bukë misri e hollë, e gatuar me ujë të valë" (ndoshta sepse duke qenë e hollë, thyhet lehtë copa-copa); *dredhanik* "lloj ëmbëlsire me petë të mbështjella rrumbullak e të vendosura rrotull në tepsi, së cilës, pasi të piqet, i hidhet përsipër sheqer a sherbet; radhanik" (motivohet kuptimisht nga veprimi i dredhjes së petëve); *mesnik* "byrek me copa mishi e me petë të pjekura në mes" (motivimi nga mes, petët të pjekura në mes ); *palanik* "1. byrek me disa shtresa brumi të patëholluara, të cilat piqen pak, lyhen me yndyrë dhe shtrohen njëra mbi tjetrën 2.kulaç me petë të trasha të lyera me gjalpë" (motivimi nga vendosja palë-palë e petëve, ose nga vendosja e petëve njëra mbi tjetrën); *prushanik* "kulaç që piqet në prush" (motivimi nga vendi i e pjekjes); *radhanik* "dredhanik" (motivohet nga vendosja radhë-radhë në tepsi); *rrethanik* "ëmbëlsirë e gatuar me petë të dredhura si kukurec e me arra brenda, që piqen në furrë e zbuten me sherbet; dredhanik" (motivohet nga forma rrethore); *shpuzanik* "kulaç që piqet në hi" (motivimi nga vendi i e pjekjes, pra në prush të imët, në hi të

nxehtë, që mbetet kur është duke u shuar zjarri).

- **-or**

Një prapashtesë tjetër që dallohet në sferën e gjellëtarisë është edhe prapashtesa *–or*. Për këtë prapashtesë kanë shkruar A. Xhuvani dhe E. Çabej në veprën e tyre *"Prapashtesat e gjuhës shqipe"*. "Me këtë prapashtesë – shkruajnë autorët e këtij libri- janë formuar emra prej emrash, me kuptim të ndryshme" (Xhuvani &Çabej, 1962,pp. 78-79).

Emrat e prejardhur në *–or* që emërtojnë një gjellë a një gatesë të cilat janë formuar kryesisht nga **temash emërore** (kjo prapashtesë te disa emërtime na shfaqet herë-herë edhe në trajtën femërore *–ore*) p.sh.: *bllacore* "lakror me miell misri të shtruar në fund dhe me spinaq a me lakra, me vezë, me gjalpë e me qumësht përsipër" (motivimi nga bllacë, diçka e qullët, si një bukë e pakulluar e cila mbetet si qulle); *çerpore* "bukë e pjekur në çerep, bukë çerepi" (motivimi nga çerep enë në të cilën piqet, ose pjekja në saç); *lakror*"byrek me lakra të grira, me presh, me kungull etj. (motivohet nga lakër); qumështor "lloj ëmbëlsire, e përgatitur me qumësht, vezë, niseshte e sheqer, që rrihen bashkë, shtrohen në tepsi e piqen në furrë 2. lloj byreku me qumësht, vezë e miell dhe me një petë të trashë poshtë; byrek me qumësht" (motivimi nga qumësht).

Kemi dhe një grup të dytë emërtimesh të cilat janë formuar po me këtë prapashtesë, por nga një **temë foljore** p.sh. : *përvëlorë* "bukëvale e fërguar me dhjamë derri" (motivimi vjen nga *përvëloj*, i hedh ujë të valuar); *trazore* "lloj buke e valë, që bëhet me miell misri, me gjalpë e me djathë dhe që piqet në furrë." (motivohet nga trazoj, përzjej miellin me ujë të valuar, i cili kërkon një farë kohe për t'u trazuar); *thartor* "byrek me hirrë" (motivohet nga thartoj, nga hirra e thartuar e cila i jep shije të athët edhe byrekut).

- **–më**

Prapashtesa –më (prapashtesë zvogëlimi) na del te këto emërtime: *rrufkë* "petulla të bëra me miell, me qumësht e me vezë dhe të skuqura me shumë vaj, që përvëlohen në sherbet" (motivimi është i paqartë) dhe *arushkë* "lloj bukëvale me miell të grunjtë, që gatuhej në mbrëmjen e Vitit të Ri" (motivimi buron, ndoshta, nga forma e veçantë e tyre).

- **–tor**

Kjo është një prapashtesë e cila na shfaqet në dy emërtime gjellësh të cilat janë: *ajkëtor* "gatesë me miell, me ajkë qumështi a me gjalpë, e pjekur në tepsi" (motivimi nga *ajkë*); *dhallëtor* "bukë misri e zënë me dhallë a me kos" (motivohet nga *dhallë*). Kjo prapashtesë duke u zbërthyer na del në dy trajta që janë për toskërishten dhe gegërishten përkatësisht
*–tuar* e *–tuer*, ku këto dy emërtime në veprën e A. Xhuvani dhe E. Çabejt *"Prapashtesat e gjuhës shqipe"* na dalin në trajtat *ajktuer* dhe *dhallëtuer e cila është pjesë e gegërishtes* ( Xhuvani, 1980, pp. 551-552).

- **-ëz**

Me prapashtesën zvogëluese *-ëz*, janë formuar *kordhëz* "zorrë bagëtish të imëta, të pleksura në disa radhë dhe të ziera a të pjekura në tavë" (motivohet me sa duket nga emërtimi *kordë/ kordhë* me kuptimin "diçka që gërshetohet në një formë të zgjatur"); dhe *bukëz* "bukë e vogël, e rrumbullakët ose gjatoshe" (motivimi nga *bukë*).

- **-ar**

Prapashtesa *–ar* na shfaqet në dy trajta përkatësisht në trajtën mashkullore dhe atë femërore, pra na del në një zgjerim kjo prapashtesë p.sh. në trajtën femërore *furrare* "bukë e madhe, që piqet në furrë" (motivohet nga *furrë*); dhe në trajtën mashkullore te *flakari* "bukë e hollë,

zakonisht e rrumbullakët, që piqet shpejt e shpejt në zjarr, bukë e pjekur me një flakë" (motivohet nga *flakë*, bukë e pjekur shumë shpejt, me një flakë).

- **-ac**

Kjo prapashtesë formon zakonisht emra konkretë me kuptim përkeqësues, por kjo prapashtesë nuk merr këtë ngjyrim në sferën e gjellëtarisë, si tek: *furracë* "bukë misri e gatuar me ujë të valuar" (motivohet nga *furroj*). Kjo prapashtesë na del në këtë rast në trajtën e saj femërore –*acë*. Përmendim këtu se kjo prapashtesë ka hyrë sipas N. Joklit në gjuhën shqipe nga serbokroatishtja. *Prapashtesa –ac e ka rrënjën nga serbokroatishtja e vjetër –ac dhe i përgjigjet prapashtesës –ec të bullgarishtes dhe –iec të rusishtes. Burimin serbokroat të kësaj parapashtese e tregon fakti që kjo është përhapur më tepër në gegërisht, kurse në toskërisht haset më fort prapashtesa –ec e bullgarishtes; kështu gegërishtja ka –ac, p.sh. burrac, toskërishtja më shumë burrec*. (Xhuvani, 1980,pp. 426-427).

- **–ak**

Sipas G. Meyerit, Beliçit e Selisçevit kjo prapashtesë është me gurrë sllave. Sipas Bariçit ajo është e burimit sllav në emrat etnikë, si romak, ulqinak, po thjesht shqip në fjalë të tjera si plak. I këtj mendimi është edhe Jokli. (Xhuvani, 1980,pp. 433-434). Me prapashtesën –*ak* kemi emërtime gjellësh të formuara **prej foljesh** p.sh. *përvëlak* "bukë misri e hollë, e gatuar me ujë të valë" (motivohet nga *përvëloj*); *përcëllak* "kulaç i hollë me miell gruri ose misri, i zënë me ujë të ftohtë dhe i pjekur në hi a në zjarr me flakë" (motivohet nga përcëlloj), por dhe emërtime të formuara **prej emrash** p.sh. *thanakë "*reçel ose shurup thanash" (motivohet nga *thanë*).

- **-ash**

Emërtime gatesash na dalin të formuara dhe prej parapashtesës –*ash,* p.sh. *larash* **"**lakror me lakra, me presh ose me qepë" (motivohet nga *larë*); *qullash* "lakror me petë të trasha, me presh ose me lakra dhe me oriz e vezë" (motivohet nga *qull*).

- **–uq**

Me prapashtesën –*uq* është na del emërtimi i një gatese që është në trajtën femërore p.sh. *gogëluqe "*qofte të vogla dhe të rrumbullakëta si gogla*"* (motivimi nga *gogël*).

- **-ush**

Prapashtesa –*ush*, e cila na del në trajtën femërore –*ushe* del p.sh. *gogëlushe* "gogëluqe" (motivimi po nga *gogël*).

Prapashtesa të tjera janë:

- **-arak**, te *bacarak* "lakror që bëhet me miell misri dhe me presh, me hithra ose me lakra të tjera", Sipas E. Çabejt është një variant fonetik i fjalës *përcëllak* ( Çabej, 1976, p. 122).
- **-ash**, te: *dërrmash* "djathë i butë, i thërrmuar e i përzier me bukë a me miell misri dhe me gjalpë, që piqet në furrë a zihet në kusi të mbyllur e hahet i ngrohtë" (motivohet nga folja *"dërrmoj"*); *qullash* "lakror me petë të trasha, me presh ose me lakra dhe me oriz e vezë" (motivohet nga *"qull"*);
- ***-çkë***, te *byreçkë* (prapashtesë zvogëlimi) motivohet nga fjala "byrek" , por në përmasa më të vogla.
- ***-ec,*** te *bukafec* "lakror i bërë me brumë të ardhur lakror i mbrumë" (motivohet nga *bukë*);
- ***-ere,*** te *qoftere* "lloj qofteje e madhe, e gjerë dhe pak si e hollë".
- ***-esë,*** te *fërgesë* (nga folja *fërgoj*); *gatesë* (nga folja *gatuaj*); *mëlmesë* (nga folja *mëlmej*).
- ***-je***, te *mbushje* "lëndë e parapërgatitur me të cilën mbushen speca, domate, byreku etj." (motivohet nga folja *mbush*).
- ***-ri***, te *bonjëri* "gjë e mirë në të ngrënë, gatesë shumë e shijshme, ëmbëlsirë" (ndoshta motivohet nga emri

*bonjë*: ***"1**. Bletë femër, që mbledh mjaltin lule më lule;* ***2.*** *përd. mb. fig. Që e do punën, që punon shumë e mirë, e pa përtuar, punëtore e madhe (për gruan)"*.

**Fjalë me konversion**

Me këtë mënyrë janë formuar dy emërtime:

***lakuriq-i*** "gatesë me miell, me gjalpë, me vezë etj., që shtrohet në tepsi pa u mbuluar me petë dhe piqet në furrë" (quhet kështu meqë nuk mbulohet me petë);

***e matur*** "ëmbëlsirë e përgatitur me miell, sheqer, gjalpë ose vaj dhe me ujë në të njëjtën masë, që, pasi zihet, shtrohet në tepsi dhe piqet në furrë a në saç" (motivohet nga folja *mas - matur*).

**Kompozita**

Fjalët kompozita nga kjo fushë janë të rralla: *bukëvale, byreksheqer, këmbëkuqe, laropitë*. Te *bukëvale* e *byreksheqer/e* kemi bashkimin e një teme emërore (*bukë, byrek*) me një tjetër temë emërore (*vale, sheqer*); edhe te *laropitë* "njëlloj lakrori që bëhet me miell misri të përzier me barishte të ndryshme (zakonisht me spinaq) e me djathë të grirë" kemi dy tema emërore *larë* dhe *pitë* (nga djathi i grirë ky lloj lakrori duket lara-lara); te *këmbëkuqe* "mëmëligë e gatuar me miell misri dhe me sheqer; bukë misri e thërrmuar dhe e fërguar me gjalpë, që hahet me sheqer, me pekmez ose me mjaltë" kemi bashkimin e një teme emërore me një temë mbiemërore (i paqartë motivimi).

**Përfundimet**

Në përfundim të punimit tonë pohojmë se puna me *"Fjalorin"* ka qenë një punë e frytshme e cila na ka ofruar një material të bollshëm, por edhe të vlefshëm për temën tonë (nisur dhe nga fakti se, siç dihet fjalorët kanë burim të drejtpërdejtë nga rrethanat historike e ekonomike të jetës së popullit, nga kontaktet me popujt e tjerë të afërt e të largët me kulturat e tyre, prandaj dhe informacioni i mbledhur është një informacin mjaft i çmuar). Përveç materialit gjuhësor të vjelë, në të njëjtën kohë, ne kemi marrë, njohuri të veçanta mbi mënyrën e të ushqyerit, element ky me rëndësi etnografik.

Mbështetur në shënimet përkatëse që përmban *"Fjalori"*, të cilat na kanë shërbyer si tregues me karakter udhëzues, ne kemi mundur të veçojmë 107 emërtesa që përmbajnë shënimin *gjell.*, një e dhënë kjo me rëndësi statistikore, por dhe një përbërës i cili vuri në diskutim faktin se ky shënim nuk është vendosur në *"Fjalor"* duke zbatuar ndonjë kriter të mirëpërcaktuar më parë. Ky fakt nuk është vetëm një vërejtje, por më tepër edhe një sugjerim që duhet të merret parasysh kur të hartohen fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe.

Nga analiza konkrete e materialit të nxjerrë ne mund të pohojmë se të gjitha fjalët shqipe që i përkisnin kësaj sfere semantike i takojnë kategorisë leksiko-gramatikore të emrit. Kështu, këto emërtime pas analizës fjalëformuese, na dalin disa lloje:

*së pari* ato na shfaqen si fjalë të parme,
*së dyti* si fjalë të prejadhura,
*së treti* si fjalë të përbëra,
*së katërti* si fjalë të formuara me anë të konversionit.

Në fjalët e prejardhura të bie në sy se mënyra e vetme e fjalëformimit të këtyre emërtimeve është ajo e formimit të fjalëve të reja me anë të parapashtesave. Ndër prapashtesat që ndeshim janë: *-arak, –or, –më, –tor, -ëz, -ar, -ac, –ak , -ash , –uq, -ush etj.*

Në përfundim të analizës, që shqyrton mënyrën se si janë formuar emërtesat e gjellëtarisë, mund të pohojmë se në shumicën e fjalëve të prejardhura motivimi është i qartë, ilustrojmë këtë fakt me fjalën *dhallanik*, por nuk përjashtohen rastet ku motivimi është më i ndërlikuar për t'u zbërthyer, shembull sjellim si rast fjalën

*tharrtor*. Nuk mungojnë dhe rastet ku motivimi është i pamundur si te fjala *rrufkë*.

Në këtë sintezë të shkurtër përmbyllëse kemi synuar të vëmë në dukje rezultatet më thelbësore të arritura nëpërmjet këtijj punimi, duke mëtuar për një përgjithësim, por pse jo dhe për një këndvështrim të ri mbi mënyrën si është trajtuar kjo pjesë e leksikut të shqipes.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Çabej, E.(x), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. vëll. I, II. III, IV, VI, VII. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Kostallari , A., Thomai, J., Lloshi, Xh., Samara, M., Kole, J., Daka, P., Haxhillazi, P., Shehu, H., Leka, P., Lafe, E., Sima, K., Feka, Th., Keta, B., Hidi, A. (1980). *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.

Samara, M. (2000). *Hulumtime në leksikografi*, Tiranë.

Thomai, J. (1964). *Mbi mënyrën e pasqyrimit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe*, SF, 4, Tiranë.

Thomai, J. (2005). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.

Xhuvani , A. (1956). *Studime gjuhësore*, Tiranë.

Xhuvani, A., Çabej E.(1962). *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.

Xhuvani, A. (1980). *Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar*, Tiranë.

# RRETH NDIHMESAVE TEORIKE NË FUSHËN E SEMIOTIKËS

**OLGER BRAME**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Komunikimi me anë të shenjave nuk është diçka e re, që i përket kohës që jetojmë. Komunikimi i njeriut me shenja i ka fillesat që në antikitetin e hershëm, por nuk është parë si një fushë dijeje e veçantë.

Studimi i kësaj lëmie paraqet interes pasi ka të bëjë me dije që shtrihen dhe lidhen me shumë fusha të veprimtarisë jetësore. Njeriu ka komunikuar dhe është interesuar për shenjat shumë herët, megjithëse kuadri i studimit të tyre për një kohë të gjatë ka mbetur ose i paprekur, ose është parë brenda ndonjë shkence tjetër. Studimi i shenjave në përgjithësi është i ndërliqur, për vetë natyrën që ato kanë. Ndoshta kjo ka qenë dhe arsyeja që kërkimet në fushën e shenjave dhe hulumtimet rreth semiotikës a semiologjisë nuk u paraprinë dhe nuk morën atë zhvillim e ritëm që morën shkencat e tjera gjuhësore.

Punimi ynë është rezultat i një hulumtimi rreth materialeve dhe literaturës që sot qarkullon lidhur me semiotikën apo semiologjinë.

Objekt i punimit tonë është semiotika në një kuadër të përgjithshëm, i cili përvijohet në disa aspekte studimi të karakterit teorik, kryesisht në ndihmesat teorike rreth kësaj fushe.

**Fjalë çelës**: *komunikim shenjor, semiotikë, ndihmesa teorike, hulumtime në semiotikë.*

**Abstract**

Sign communication is not something new, belonging to our generation. Sign communications dates back to the early antiquity, but has never been seen as a special field of knowledge.

Research about it is of special interest as it has to do with knowledge concerning various activities of life. People have communicated and been interested in the signs early although research on them has been untouched or involved in another science. Research concerning signs is generally complex due to their nature. Maybe this was the reason that research on semiotics and semiology did not have the same rhythm of development that other language sciences had.

Our paper is the result of a research on materials and literature concerning semiotics.

The object of our paper is semiotics in a general point of view that is organized over some aspects and issues of a theoretical character especially on the theoretical aids concerning this field.

**Key words:** *semiotics, sign communication, theoretical aids, research on semiotics.*

**Gjurmë të hershme të semiotikës**

Semiotika si fushë studimi apo disiplinë, ndoshta është e re krahasuar me fusha dhe disiplina të tjera, por rrënjët e saj mund t'i kërkojmë shumë herët, që në antikitetin e lashtë, kohë në të cilën ka nisur dhe interesimi i njerëzve për shpjegimin apo lidhjen e shenjave të ndryshme me dukuri të jetës së përditshme.

Njohuritë e para mbi mjekësinë nga grekët e lashtë lidhen me semiotikën, sepse kishin të bënin me studimin e shenjave në këtë këndvështrim. Hipokrati (460-377 p.e.s) e përcakton semiotikën (σημειωτικός) si një degë të mjekësisë. Në traktatet e lashta të Hipokratit dhe Galenit, mund të kërkojmë zanafillën, për të kuptuar lidhjet ndërmjet trupit dhe mendjes, simptomave dhe sëmundjeve etj. Hipokrati vendosi një lidhje të ngushtë të semiotikës me simptomatologjinë, edhe pse ai e mori këtë ide nga mjekët që kishin qenë para tij (Sebeok, 2001).

Me kalimin e kohës interesimi për shenjat e ndryshme nuk mbeti vetëm brenda këtij kuadri, por filloi të zgjerohej për shkak të ndërliqësisë që kanë shenjat në botën ku jetojmë. Gjurmët e kësaj disipline apo fushe dijeje, mund t'i hetojmë që nga Herakliti, Platoni, Aristoteli, për të ardhur në Mesjetë te Gotfrid Leibnici e Xhon Loku dhe për të mbërritur në atë periudhë kur zhvillimi i saj mori një rrugë të re.

Ashtu si edhe për shumë shkenca të tjera, edhe për semiotikën, gjysma e dytë e shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX ishte periudha në të cilën do të niste rruga dhe zhvillimi i saj.

Filozofi i drejtimit pragmatik, amerikani Çarls Sanders Pirs (1839-1914), të cilin disa studiues e kanë quajtur "babai i semiotikës moderne" dhe gjuhëtari zviceran Ferdinand de Sosyr (1857-1913) me veprën e tij postume *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, e bënë semiotikën një shkencë të mirëfilltë e moderne.

Studiues të tjerë si Luis Hjelmslevi (1975), Çarls W. Morisi (1938), Roman Jakobsoni (1960) etj., megjithëse nga këndvështrime të ndryshme, e vunë semiotikën në qendër të interesave të tyre shkencore. Në shekullin XX , sidomos në gjysmën e dytë e tij, jo vetëm do të shënoheshin disa arritje në fushën e semiotikës, por do të hapeshin mundësi e hapësira të reja që shtrihen në të gjitha fushat e dijes njerëzore, duke e kthyer kështu semiotikën në një shkencë me anë të studimeve të bëra nga Klod Levi Strosi, Zhak Lakani, Emil Benvenisti, Roland Barti, Juri Lotmani etj. dhe më pas, deri në ditët tona, nga Julia Kristeva, Umberto Eko etj.

Përcaktimet rreth termit semiotikë janë të ndryshme. Etimologjikisht, termi lidhet me fjalën greke "***semeîon***", (**σημιωτική**) "shenjë", dhe "***semeiotikós***", "që lidhet me shenjat" (Saussure, 2002, p. 43). Një reflektim teorik mbi shenjat e gjejmë të dhënë të paktën që nga filozofët klasikë grekë, si: Platoni, Aristoteli, stoikët dhe epikurianët.

Në kohët moderne, filozofët gjermanë dhe britanike, si Johan H. Lamberti dhe Xhon Loku, e rimarrin termin në greqisht, për t'iu referuar një dege dijesh të njohur edhe si "logjikë". Henri Stabs (H. Stubbes) ishte i pari që përdori termin në anglisht, në vitin 1670, duke e specifikuar si degë të veçantë të shkencës mjekësore që merrej me interpretimin e shenjave. Disa vite më vonë, më 1690, Xhon Loku në botimin e tij "***An Essay Concerning Human Understanding***" e identifikon semiotikën si një ndër tri degët e shkencës, duke e shpjeguar atë si "doktrina e shenjave", themeluar mbi vëzhgime dhe jo mbi parime (Manis, 1999;2013). Këtë term e gjejmë në format "**semiotikë"** apo " **semiologji**" sipas shkollës gjuhësore amerikane me përfaqësues Çarls Sanders

Pirsin e Çarls W. Morisin dhe shkollës gjuhësore evropiane, me përfaqësues Ferdinand de Sosyrin. Termi modern "*semiotikë"* në shkrime më të hershme të studiuesve klasikë (të periudhës klasike), në formën "**semeion**" është përdorur si sinonim i termit "**takmerion**", në kuptimin "prova, dëshmi a simptoma të asaj që ishte të paktën përkohësisht e fshehur në dukje". Përgjithësisht termi përqendrohet rreth këtyre dy përcaktimeve që kanë të bëjnë me semiotikën dhe semiologjinë, por gjenden edhe terma të tjerë si "**translinguistikë**", term i përdorur nga Roland Barti, i cili sistemet e shenjave i sheh të gjitha si aspekte gjuhësore apo ligje të gjuhës ( Allen, 2003).

Në veprën "*Shumësia e tekstit*" të Rexhep Ismajlit (1980), në vërejtjet e bëra mbi termin "semiotikë" autori u referohet pikërisht këtyre dy studiuesve të semiologjisë dhe përcaktimeve të tyre mbi termin në fjalë, duke vërejtur se në traditën amerikane vazhdon edhe sot të përdoret vetëm termi **semiotikë** (semiotics), ndërsa në Evropë vazhdojnë të përdoren të dy termat, pa ndonjë dallim të qartë. Ai vëren gjithashtu, se dallimi midis termave është një çështje tradite shkencore në frymën e Ferdinand de Sosyrit apo Çarls Sanders Pirsit.

Pirsi e shikonte semiotikën si teori të njohjes njerëzore, si aftësi për të interpretuar përvojën dhe çdo shfaqje të saj empirike. Nga ky pikëvështrim, fjalët, mendimet, ndjenjat etj., mund të quhen "interpretues" të ndryshëm të të njëjtit objekt, në një proces të ndërtimit të kuptimit, i cili virtualisht nuk rreshtet kurrë(Peirce, 1931-1958; Ismajli, 1980, p. 11-32). Ferdinand de Sosyri, i cili parapëlqente të fliste për semiologji, mendonte më shumë për një disiplinë-kuadër, që të përvijonte një territor të përbashkët për të gjitha dukuritë e komunikimit (gjuhët, para së gjithash, por dhe gjuhët e shurdhmemecëve, formulat e mirësjelljes, sjelljet njerëzore të riteve etj.), nga e cila mund të lëvizej për të studiuar çka është e veçantë për çdo mënyrë komunikimi ( Ismajli, 1980, p. 11-32).

Siç shihet, Çarls Sanders Pirsi dhe Ferdinand de Sosyri kanë pikëpamje të ndryshme për shenjën, pavarësisht faktit se flasin për të njëjtën doktrinë. Kështu Sosyri, duke e parë sistemin e shenjave në gji të shoqërisë, u përqendrua më tepër në funksionin dhe rolin e tyre në komunikim, ndërsa Çarls Sanders Pirsi i kushtoi rëndësi interpretimit të shenjës, aspektit logjik të saj.

Semioticieni Sebeok citon shpesh thënien e Medit (Margaret Mead) në konferencën e parë semiotike, organizuar në maj 1962, në Blumington (Bloomington) të SHBA-së për të diskutuar për paralinguistikën (për dukuri jo ngushtësisht gjuhësore që shoqërojnë të folurit: gjestet, ndryshimi i zërit) dhe kinezikën (ose për domethënie komunikative në qëndrimet dhe lëvizjet e trupit). Përballë një publiku shumë të ndryshëm (gjuhëtarë, antropologë, psikologë, biologë, psikiatër, pedagogjistë etj.) Medi e përmbyllte ligjëratën e saj me këto fjalë:

*Do të ishte bukur të largoheshim prej këtej me të paktën një marrëveshje paraprake për përdorimin e ndonjë shprehjeje që të mund ta përdorim në të gjithë fushën.(...)Unë besoj se, me aq sa mund ta përfytyrojmë, po punojmë në një fushë që me kohë do të përfshijë studimin e të gjitha formave të komunikimit të pajisura me një strukturë, nga të cilat gjuhësia është teknikisht më e përparuara. Do të ishte e dobishme një fjalë për të gjitha format e komunikimit të çdo mënyre shqisore, e pajisur me një strukturë (...). Shumë njerëz këtu që të jepnin përshtypjen se ishin në anën e kundërt të barrikadës, përdorën fjalën semiotikë . Më duket fjala e*

*vetme që, në një formë ose në një tjetër, u përdor nga njerëz që arsyetojnë nga pozicione kryekëput të ndryshëm* (Sebeok, 1991,p. 21-23).

**Përkufizime rreth semiotikës**

Nuk ka një përkufizim të vetëm të "semiotikës". Në përgjithësi, mund të themi se ajo përbën një reflektim sistematik (p.sh. një "teori") mbi shenjat, klasifikimin e tyre, ligjet që udhëheqin ato, apo përdorimet e tyre në komunikim.

Sipas **Cambridge Dictionares Online,** semiotika është studimi i shenjave dhe simboleve, i asaj se çfarë duan të thonë dhe se si janë përdorur ato.

**Roland Barti** në një artikull të botuar në vitin 1964, me titull "Elemente të semiologjisë" e konsideron semiologjinë si shkencë e të gjitha sistemeve të shenjave (Ismajli,1980, p.21).

**Xhon Lajënsi** e përkufizon semiotikën si shkenca e shenjave të sjelljes simbolike apo të sistemit të komunikimit" duke e lidhur me "kuptimin" dhe "përdorimin" gjuhësor (Lyons,2010,p.374:382) .

Sipas **Daniel Çandlerit**, përkufizimi më i thjeshtë e më i shkurtër që mund të bëhet është: *semiotika si studim i shenjave* (Chandler, 1999). Për Çandlerin, semiotika mund të jetë kudo. Llojet e shenjave, të cilat kanë gjasa të shfaqen menjëherë në mendje, janë ato të cilat ne zakonisht i referohemi si "shenja" në jetën e përditshme: të tilla si shenjat e rrugëve, shenjat në vende publike, shenjat e yjësive etj.

Sipas **Fjalorit të Semiotikës** (Dictionary of Semiotics), semiotika është teoria e shenjimit, që ka të bëjë apo gjeneron prodhimin e kuptimit. Semiotika "shqetësohet" për atë se si prodhohet kuptimi. Teoria semiotike është e bazuar në besimin se kuptimi nuk është i qenësishëm tek objektet, se ata nuk shenjojnë veten e tyre, por kuptimi është ndërtuar nga një vëzhgues kompetent - një subjekt , i aftë për t'u dhënë "formë" objekteve (Martin & Ringham, 2000).

Po sipas këtij fjalori, në kontrast me semiotikën, e cila ka të bëjë me teorinë dhe analizën e prodhimit të kuptimit, semiologjia i referohet studimit të sistemeve të shenjave në operacione të tilla si kodet, duke përfshirë edhe ato të shenjave gjuhësore. Kuptimet e qarta që hetohen, rezultojnë nga lidhjet e një shenjuesi me të shenjuarin e tij.

Tradicionalisht dhe historikisht, dega më e formalizuar e semiotikës ka qenë ajo që shqyrton dhe merret me dukuri njerëzore në nivel qëndror, d.m.th, gjuhësia apo studime që mund të kategorizohen përgjithësisht si filozofi e gjuhës.

Edhe këndvështrimet e tjera kanë pasur në fokus të tyre komunikimin e njeriut me anë shenjave joverbale, duke përfshirë studimet e shprehjes së fytyrës, shikimin e ndërsjelltë, gjestet dhe sjelljen, si edhe gjuhën e shenjave të shurdhmemecëve, gjuhën e fiseve a të popujve vendës ose të murgjve, semiotika është parë edhe si një pjesë e sjelljes dhe komunikimit të kafshëve.

Në veprën "***Basics of Semiotics***" ( Deely, 1990), jepen disa nocione të tjera rreth semiosis (procesit të shenjimit). Dilei përpiqet të argumentojë në këtë punim zgjerimin e bazës së studimit semiotik, duke përfshirë në këtë mënyrë terma të tilla si "zoosemiotika," "antroposemiotika," "fitosemiotika," dhe "fiziosemiotika". Dilei mëton se objekti i procesit semiotik ka të bëjë me zgjedhjen e elementeve të përbashkëta të sistemit të shenjave në të gjithë jetën e gjallë apo realitetin e gjallë, nga kafshët te qenia njerëzore.

Mënyra të ndryshme të përkufizimit të semiotikës duke u përqendruar edhe në në fusha të pastra përshkruese dhe të zbatueshme, nuk kanë dhënë një numër të saktë të përcaktimeve rreth saj, në varësi

të traditës së veçantë të krijuar dhe nuancave të veçanta, që i janë dhënë kuptimit mbi nocionin e semiotikës (Nöth, 1990). Nga tërësia e pikëpamjeve të ndryshme për semiotikën si teori, si shkencë apo edhe si lëvizje në modë, tipari më i përgjithshëm që i përmbledh është se ajo ka të bëjë me studimin e shenjës. Disa nga përkufizimet më tipike që pasqyrojnë këtë pikëpamje, e përcaktojnë semiotikën si "doktrina antike e shenjave" (Sebeok, 2001), "shkenca e përgjithshme e shenjave dhe kuptimeve", shkenca ose doktrina që studion shenjat (Danesi and Santeramo, 1992), studimi i shenjave dhe simboleve si elemente të komunikimit në sjellje (Random House Electronic Dictionary,1992) etj.

Sipas Nöth (Nöth, 1990), kontributet dhe autorët kryesorë të semiotikës përqendrohen te Pirsi, për filozofinë e klasifikimit të shenjave; Morisi, për objektin e teorisë semiotike; Sosyri, për lidhjen mes semiologjisë dhe gjuhësisë; Hjelmslevi, për teorinë e glosematikës dhe Jakobsoni, për lidhjen mes poetikës dhe gjuhësisë. Nga këto, është pranuar në përgjithësi, se, si Çarls Sanders Pirsi, i cili është studiues i rëndësishëm në filozofi, ashtu edhe Ferdinand de
Sosyri, të cilit zakonisht i referohen si themelues i gjuhësisë moderne, janë studiuesit më të spikatur në zhvillimin e teorisë semiotike të shekullit të kaluar.

Mbështetur edhe në këto vlerësime, pavarësisht përcaktimeve të shumta që janë dhënë mbi përkufizimin e semiotikës, dy janë përcaktimet apo përkufizimet më mbizotëruese që sot mbahen parasysh: përkufizimi i Ferdinand de Sosyrit dhe ai i Çarls Sanders Pirsit bazuar në atë se çka kuptohet me shenjë.

Ferdinand de Sosyri, themelues i gjuhësisë moderne, e sheh semiotikën si shkencë shoqërore që studion shenjat në gji të shoqërisë, duke përbërë një pjesë të psikologjisë shoqërore e, për pasojë, të psikologjisë së përgjithshme. Duke e quajtur semiologji, ai e lidh atë me dy elemente të rëndësishme: shenjuesin dhe të shenjuarin (Saussure, 2002, p.43)

Çarls Sanders Pirsi, e sheh semiotikën si teori të shenjës, ashtu sikurse Sosyri, por zgjeron objektin e saj, duke futur konceptin e semiozës si karakteristikë thelbësore të shenjës, që lidhet me tre aspekte të rëndësishme: shenja, objekti që përfaqëson shenjën dhe interpretuesi i shenjës. Rëndësia e semiotikës sipas Pirsit është e spektrit të gjerë. Siç e ka theksuar ai vetë, "(...) *nuk ka qenë kurrë në mundësitë e mia për të studiuar çdo gjë,- matematikën, etikën, metafizikën, gravitacionin, termodinamikën, optikën, kiminë, anatominë krahasuese, astronominë, psikologjinë, fonetikën, ekonominë, historinë e shkencës* ,(...) *përveçse duke i parë të gjitha këto si një studim i semiotik* " ( Atkin, 2013).

Nga pikëpamje relativisht të ngushta të komunikimit njerëzor, semiotika apo semiologjia, është në thelb studimi i shenjave dhe simboleve që njerëzit përdorin për të përfaqësuar realitetin, se si këto shenja dhe simbole janë kuptuar gjatë përvojës në botë dhe se si qeniet njerëzore i përdorin ato në realitetin dhe përvojën shoqërore.

Mbështetur dhe në dy përcaktimet e theksuara më sipër nga Sosyri dhe Pirsi, në literaturën e sotme, semiotikës i bëhet ky përkufizim : *Shkencë e komunikimit dhe e studimit të sistemit të shenjave; me pak fjalë një nga mënyrat me të cilat njerëzit kuptojnë fenomenet dhe i organizojnë ato mendërisht.* Ne mund të përcaktojmë semiologjinë ose semiotikën si studimin e shenjave. Ne mund të zbatojmë qëndrimin semiotik (semiologjik) për të gjitha llojet e veprimtarisë së njeriut, duke përfshirë kinemanë, teatrin, vallëzimin, arkitekturën, pikturën, politikën, mjekësinë, median,

fenë etj. Këtë gjë ne e përdorim nëpërmjet një shumëllojshmërie të gjesteve (shenjave) në jetën e përditshme për të përcjellë mesazhe për njerëzit rreth nesh. Sipas këtyre saktësimeve, semiotika dhe studimet e saj orientohen drejt asaj analize që ka të bëjë me klasifikimin e shenjave dhe hetimin e proceseve të komunikimit.

Në një përfundim të përgjithshëm mund të thuhet se: *Semiotika është shkenca e shenjave, pra e gjithckaje, që pavarësisht lëndës që përdor, mesazhit që përcjell, kontekstit në të cilin ndodhet, mund të përdoret si shenjë* (Memushaj, 2004).

**Vështrim mbi ndihmesat teorike në fushën e semiotikës**

**Herakliti (Heraclitus)**

Mendohet se teoricieni i parë për identitetin e gjuhës ka qenë Herakliti i Efesit (rreth 550-480 p.e.s). Problemi kryesor që tërhoqi vëmendjen e filozofëve që në lashtësi, ishte ai i marrëdhënieve midis sistemit të gjuhës (i cili përbëhet nga shenjat dhe është bashkim i shprehjes dhe përmbajtjes) dhe realitetit, bota që ne shohim dhe prekim. Një nga shpjegimet më të hershme të këtij raporti është ai që dha Herakliti. Ai shpalli "Fjalën e Përjetshme" (Logos) sipas së cilës, të gjitha gjërat janë një, në një kuptim. Të kundërtat janë të domosdoshme për jetën, por ato janë të bashkuara në një sistem të këmbimeve të ekuilibruara. Bota në vetvete përbëhet nga një ligj : ai i shkëmbimit të elementeve, të simbolizuara nga zjarri. Për këtë arsye, bota nuk duhet njëjtësuar me ndonjë substancë të veçantë, por më tepër me një proces të vazhdueshëm, i cili rregullohet nga një ligj i ndryshimit ( Graham, 2011).

Për Heraklitin gjuha ekziston "nga natyra" dhe korrespondon me faktin se ajo është bërë për lëvizje dhe shumëllojshmëri. Gjuha pasqyron këtë shumëllojshmëri si një pasqyrë, pikërisht se ajo është "nga natyra" dhe, për këtë arsye, ka edhe disa vlera njohëse. Pra, shenja përcakton fuqishëm gjuhën në vetvete, sepse shenjat janë më të natyrshme në lidhje me gjërat ( Eco, 1984/2012).

**Platoni (Plato)**

Shumë njerëz e lidhin emrin e Platonit me disa doktrina të rëndësishme që janë dhënë në shkrimet e tij. Doktrina e tij më e rëndësishme është ajo e ideve. Ideja, e cila sipas tij më saktë përkthehet me "formë", është objekti i vërtetë i dijes, por kjo nuk është vetëm themeli njohës i realitetit, i cili është shkaku që na lejon të mendojmë për botën, por edhe përbën themelin njohës të faktit që, arsyeja është ajo që shkakton qenien e botës. Idetë janë të vërteta të përjetshme dhe objektive. Vetëm idetë janë objektive. Edhe njerëzit, sendet e gjithça tjetër, nuk janë gjë tjetër veçse shfaqje të ideve te të cilat arrihet nëpërmjet analizës së disa njësive të gjuhës "onoma" (Rrokaj, 2010). Platoni, në dialogun me Kratillin (Cratylus), nëpërmjet gojës së Sokratit (Socrates), luan me fjalët **sh^ma** ( "shenjë", por, dhe në kuptimin "yll" e "varr") dhe fjalës ***sw^ma*** ("trup"), duke shfaqur dyshime për metodat materialiste dhe induktive. Dhe në fakt, disa e quajnë atë (trupin,) sema (varr) të shpirtit, në qoftë se ai do të varroset në këtë jetë. Nga ana tjetër, nëpërmjet shpirtit (*semaìnei*) do të kuptojmë atë që ai ka për qëllim të shprehë *(semaine)* dhe për këtë është quajtur saktësisht sema *(shenjë)* ( Eco, 1978).

**Aristoteli ( Aristotle)**

Aristoteli është ai që e rivendos çështjen e gjuhës në një kontekst më të plotë se bashkëkohësit e tij. Ai përdori për herë të parë konceptin "shenjë" (në dallim nga "emër"). Shenja është "diçka që ka të bëjë me diçka tjetër", diçka e natyrshme ose konvencionale: *stat aliquid aliquo pro*.

Një aspekt i rëndësishëm në këtë arsyetimin të Aristotelit është raporti "dysh" midis fjalëve dhe sendeve. Aristoteli paraqet edhe një element të tretë, konceptin, i cili në këtë mënyrë mund të zgjidhë problemin e mundësisë së komunikimit në mesin e njerëzve me anë të gjuhës, pavarësisht arbitraritetit të saj ( Whitaker, 2003).

Aristoteli i rikthehet teorisë së shenjave te vepra e tij *Retorika,* ku ndan mjaft qartazi konceptin mbi **shmei^on** (semeion; shenjë) nga ai i **teknh'rion** (teknérion), që do të thotë "shenjë simptomë", "provë". Shenjat mund të jenë dy llojesh: ose "prova", "simptoma", "shenja të domosdoshme", ose shenja që quhen "shenja të dobëta" e për të cilat Aristoteli nuk jep një term specifik. ( Këtë lloj ndarjeje të shenjave e bën U. Ekoja, por vetë Aristoteli në veprën e tij nuk specifikon konkretisht llojin e dytë të shenjave).

**Xhon Loku (John Locke)**

Xhon Loku në historinë e re të semiotikës, ka meritën e fillimeve moderne të kësaj disipline. Termat ***semeiotikë*** dhe ***semeioticos*** i gjejmë të përdorura prej tij në një ese mbi të kuptuarit njerëzor, në të cilën ai shpjegon se si shkenca mund të ndahet në tri pjesë. Së pari, ai thekson natyrën e gjërave, si ato janë në vetvete, me marrëdhëniet e tyre, si dhe mënyrën e tyre të veprimit (fizika apo filozofia natyrore); së dyti, atë çka njeriu duhet të bëjë, në mënyrë racionale dhe vullnetare për të arritur në një përfundim të caktuar në mënyrë praktike (morali) . Duke qenë se në mënyrë fizike sendet nuk mund të jenë në mendje, atëherë krijohen idetë për t'i përfaqësuar ato. Nga ana tjetër, idetë mund të shprehen me fjalë. Pikërisht, duke u mbështetur në këtë pikëpamje, Loku flet ose përcakton pjesën e tretë të shkencës si doktrinë të shenjave, duke e kuptuar si lëndë me të cilin njeriu e kupton botën dhe e përshkruan atë në pëlqim të tij (semiotika apo njohja e shenjave). Për të çdo gjë është një shenjë dhe asgjë nuk është realisht e vërtetë. Në pikëpamjet e tij kjo mbështetet në atë se realiteti është asgjë më shumë se një kthim i pafund i shenjave të krijuara nga bashkësia njerëzore për kuptuar (Clarke, 1990).

**Johan Lamberti (Johan Heinrich Lambert)**

Semiotika e Lambertit është disi e veçantë përsa i përket rrafshit studimor, sepse ajo përfshin një tërësi disiplinash brenda këtij kuadri, ndoshta e përligjur edhe me figurën dhe formimin e vetë Lambertit si filozof, fizikan, astronom, matematikan etj. Doktrina e shenjave, sipas Lambertit, përfshin një fushë të gjerë, e cila lidhet sa me doktrinën e ligjeve të të menduarit (*Dianoiologjia*), doktrinën e së vërtetës (*Alethiologjia*), doktrinën e paraqitjes (*Fenomenologjia*) , si një sistem shenjash të paraqitura nën idealin e algjebrës. Sipas pikëpamjeve të tij, semiotika duhet të rindërtojë "shenjat, duke u bërë baza e dijes dhe logjikës dhe kjo mund të zbatohet pa asnjë dallim si për filologjinë, kritikën, gjuhësinë dhe filozofinë. Konceptet duhet të jenë të lidhura pikërisht me fjalët, përcaktimet e të cilave nuk do të jenë të kundërtat e tyre. Ai i dallon shenjat sipas asaj çka përfaqësojnë drejtpërdrejt dhe asaj që funksionojnë si një imitim i thjeshtë i ndjesive dhe imazheve të ndjenjave. Lamberti vë në dukje një shumësi sistemesh të shenjave, të cilat ai i lidh me kiminë, me muzikën, me gjestet etj. ( Nöth, 1990).

**Vilhelm von Humboldi (Wilhelm von Humboldt)**

Me emrin e Humboldit lidhet pikëpamja e gjuhës si një prodhim shpirtëror, rezultat i energjisë krijuese dhe si proces i pafund. Ai futi në gjuhësi konceptin ***érgon*** dhe ***enérgheia*** për

përcaktimin e gjuhës. Sipas tij, gjuhët janë një prodhim shpirtëror, rezultat i energjisë krijuese (***enérgheia***), një proces i pafund dhe jo diçka e ngurtë, e palëvizshme (***érgon)*** (Humboldt, 2000, p.36). Ai vë në dukje formën dhe lëndën, materien, të cilat nuk janë të njëjta në gjuhë të ndryshme. Humboldi thekson se gjuha nuk tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë mendimin, por ajo është një botë e ndërmjetme, një botë e brendshme midis mendimit dhe realitetit që qeveriset nga ligjet e veta. Gjuhët, gjithashtu, janë mutacione të përjetshme dhe kjo është arsyeja, që ato mund të studiohen në mënyrë diakronike (Calabrese, 2001).

**Martin Hajdegeri (Martin Heidegger** )

Me emrin e Martin Hajdegerit shpeshherë nënkuptohet teoria hermeneutike si teori e të kuptuarit, pasi ai mbetet ndër përfaqësuesit kryesorë të saj. Hermeneutika e Hajdegerit nuk i referohet as shkencës, as rregullave të interpretimit të tekstit, as metodologjisë, por analizës fenomenologjike. Një aspekt i rëndësishëm i këndvështrimit semiotik në teoritë e Hajdegerit, është lidhja që ai bën midis shenjave dhe realitetit. Kështu, ai flet për indeksikalitet të shenjës, duke e lidhur këtë të fundit me atë që i referohet shenja. Shenja është diçka që shenjon, kurse fenomeni të cilit i referohet, është diçka e përgjithshme. Shenja mund të qëndrojë për diçka që mund të mos jetë shenjë, por mund ta kuptojmë si shenjë të drejtpërdrejtë. Kjo shenjë ose mund të kuptohet drejtpërdrejt, ose duhet të sqarohet kuptimi i saj. Në këtë mënyrë, ai lidh konceptin e shenjës me realitetin si diçka të pandarë nga njëri-tjetri (Carman, 2003).

**Roman Jakobsoni (Roman Jakobson)**

Emri i Roman Jakobsonit mbetet si sinonim me përcaktimin e komunikimit si shkencë humane. Roman Jakobsoni shtjellon një teori të komunikimit mbi baza gjuhësore dhe semiotike, duke u mbështetur në studimin e gjuhës njerëzore, si një praktike e përfshirjes së mendimit, fjalës dhe mbishkrimit, pra, logjikës, retorikës dhe gramatikës, të cilat shpjegohen nga kuptimi semiotik.

Analiza e modelit të Jakobsonit, mbi komunikimin, tregon se ajo është një analizë karakteristike me origjinë semiotike, më shumë se gjuhësore, siç e beson ai vetë ( Eco, 1987). Vetë semiotika është një disiplinë e përfshirë brenda një rrafshi më të gjerë studimi, siç është teoria e komunikimit dhe, në këtë mënyrë, konteksti semiotik përfshihet brenda atij të teorisë së komunikimit.

Një aspekt i rëndësishëm i studimit semiotik sipas Jakobsonit, është ai që merret me konceptin e shenjës. Mund të theksohen në këtë pikë, të paktën, dy aspekte të qasjes "informative" që bën ai. E para është koncepti i kodit, që Jakobsoni e përdor për të karakterizuar funksionin e shenjave, duke e tërhequr nga teoria e komunikimit. Një anë e veçantë e kodit, sipas Jakobsonit, është se ai strukturohet vetëm në bazë të tipareve binare. Në modelin e Jakobsonit, jepet edhe shpjegimi i kanalit, të cilin ai e trajton si "fjalë" (Sebeok, 1998).

**Valentin Voloshinovi (Valentin Vološinov)**

Ndihmesa e Voloshinovit tij në fushën e gjuhësisë,
sidomos në semiotikë, lidhet me teorinë dhe analizën mbi diskursin, me ndryshueshmërinë si karakteristikë themelore e fjalës etj. Problemi i lidhjeve midis fjalës së dikujt dhe fjalës së tjetrit, trajtohet, pothuaj në në të gjitha shkrimet e tij (Cobley, 2010).

Voloshinovi shtjellon shenjën ideologjike dhe lidhjen e saj me ndërgjegjen. Konkretisht, fjala shihet prej tij si një shenjë ideologjike “par excellence”, duke përcaktuar asnjanësinë

ideologjike të saj dhe kapacitetin si një shenjë e brendshme. Voloshinovi thekson se çdo gjë ideologjike ka kuptim dhe paraqet ose përshkruan diçka që shtrihet jashtë vetvetes. Me fjalë të tjera, kjo për Voloshinovin është një shenjë dhe pa shenja nuk ka ideologji. Brenda këtij kuadri semiotik, çdo trup fizik mund të perceptohet si një imazh dhe domosdoshmëri e mishëruar në diçka të veçantë. Çdo imazh artistik a simbolik për një objekt të veçantë fizik çon në një produkt ideologjik. Në këtë rast, objekti fizik konvertohet në një shenjë. Një shenjë ekziston jo thjesht si pjesë e realitetit, por ajo pasqyron një tjetër realitet. Gjithashtu, çdo shenjë ideologjike nuk është vetëm një pasqyrim i realitetit, por është edhe vetvetja, një aspekt material i realitetit (Vološinov, 1976).

**Luis Hjelmslevi ( Louis Hjelmslev**)

Mendimi gjuhësor i Hjelmslevit mund të thuhet se është një vazhdimësi e mendimit të Sosyrit, duke e përcaktuar gjuhën si një tërësi të vetëmjaftueshme dhe të organizuar në brendësi, duke përmirësuar aspektet formale dhe abstrakte të analizës gjuhësore, nevojën për të bërë dallimin midis kuptimit gjuhësor të çdo lloj koncepti psikologjik. Në veprën e tij rimerr teorinë e Sosyrit të *formës* dhe *substancës* së shenjës dhe flet për plan të shprehjes dhe plan të përmbajtjes.

Sipas tij, nga gërshetimi i planit të shprehjes dhe i planit të përmbajtjes, me substancën dhe formën, arrihet në një ndarje katërshe, duke dalluar te çdonjëra prej tyre plane që lidhen me substancën dhe formën.

Hjelmslevi, përmend katër koncepte: *substancë e shprehjes, formë e shprehjes*, *substancë e përmbajtjes* dhe *formë e përmbajtjes* (Memushaj, 2006). Gjuhët karakterizohen nga lidhja mes këtyre dy niveleve. Për Sosyrin, shenjuesi dhe i shenjuari janë dy subjektet që përbëjnë një shenjë. Për Hjelmslevin shenjuesi bëhet *shprehje* dhe i shenjuari bëhet *përmbajtje.* Sipas tij, nuk mund të ketë shprehje pa përmbajtje dhe përmbajtje pa shprehje (Taverniers, 2008).

**Emil Benvenisti (Emile Benveniste)**

Emil Benvenisti në teorinë e tij i kushton rëndësi aspektit ligjërimor të gjuhës, por në një këndvështrim paksa të ndryshëm nga Sosyri. Ai përcakton tre terma, të cilat teorikisht janë të pandashme: gjuha, diskursi dhe subjektiviteti. Në dy termat e parë ka një përputhje të plotë në atë çka Sosyri e përcakton si *Langue* dhe *Parole*, por Benvenisti përcakton dhe një term të tretë, që përfshin në një të vetëm entitetin gramatikor dhe folësin.

Benvenisti shkruan për pamundësinë e izolimit të gjuhës nga ligjërimi apo ligjërimit nga subjektiviteti. Benvenisti përfshin në ligjërim aktin e të folurit, duke supozuar për këtë një folës dhe një dëgjues. Tek folësi sheh qëllimin për të ndikuar në një farë mënyre te tjetri.

Benvenisti thekson se realiteti të cilit i referohemi, është ai që lidhet me diskursin. Në këtë rast, gjuha si sistem shenjash në vetvete dhe për vetvete, jo vetëm na lidh me realitetin, por shërben si shtrat ku vendoset gjuha e një ligjëruesi të caktuar në një situatë, kohë e vend të caktuar, fakt të cilin Benvenisti e përmbledh me formulën: *Unë-këtu-tani* ose në një formë më të plotë skematike: ***Kush? Kujt? Çfarë? Ku? Kur? Si?*** (Duro, 2010; Silverman,1983).

**Vitgenjshtajni (Ludwig Wittgenstein)**

Ludvig Vitgenshtajni ndihmesën e tij në fushën e semiotikës e lidh me teorinë e kuptimit. Si filozof, ai i shpreh meditimet e tij të bazuara në arsyetim logjik dhe jo në citate ose referenca të autorëve të tjerë. Ai i vë rëndësi çështjes së gjuhës dhe kuptimit. Vitgenshtajni heton mbi natyrën

e fjalëve dhe, në përpjekje për të kuptuar se si mund të përcaktohet një fjalë, ai bën dallimin midis fjalëve që përdoren për të shenjuar diçka dhe fjalëve që përdoren për të shenjuar vetë fjalët. Sipas tij, gjuha është një pjesë e formës së jetës, në kuptimin që ajo është në lidhje me një situatë të veçantë pragmatike, jeton dhe ndryshon në kontekstin, zakonet, simbolet dhe besimet e njeriut.

Fjalët e përveçme të gjuhës emërtojnë objektet, kurse fjalitë janë ndërlidhje të emërtimeve të tilla. Në këtë pikturë të gjuhës gjejmë rrënjët e kësaj ideje: çdo fjalë e ka një domethënie. Kjo domethënie është e lidhur me fjalën. Ajo është objekti për të cilin qëndron fjala. Kërkesa për shenja të thjeshta, është kërkesa për përcaktimin e kuptimit. Në gjuhën e përditshme ndodh shumë shpesh që e njëjta fjalë të përshkruajë në mënyra të ndryshme, pra u përket simboleve të ndryshme ose, dy fjalë, që përshkruajnë në mënyra të ndryshme, të përdoren nga ana e jashtme në pohim, në të njëjtën mënyrë (Vitgenshtajn, 2002, 2004; Rrokaj, 2010).

**Çarls Morisi (Charles W. Morris)**

Semiotika e Morisit jep një përshkrim të përgjithshëm të shenjës, duke përfshirë si të tilla gjithçka që gjendet në botën e gjallë. Ai synon zhvillimin e një qasjeje të tillë për semiotikën, që mund të merret me të gjitha llojet e shenjave.

Morisi e përcakton semiotikën si fushë ndërdisiplinore, e cila ka si objekt shenjat në të gjitha format dhe shfaqjet e tyre, njerëzore dhe jonjerëzore, të kafshëve, shenjat normale dhe patologjike, shenjat gjuhësore dhe jogjuhësore, shenjat personale, shoqërore etj., duke ndërtuar për këtë qëllim terminologjinë përkatëse, brenda një kornize të qartë biologjike.

Semiotika përshkruhet prej tij si "shkencë e sjelljes". Me këtë përcaktim, Morisi nuk i referohej biheviorizmit, por më tepër i referohej një "shkence" apo një disipline që kishte ende për t'u zhvilluar; një fushe që duhej të përdorte terminologjinë e saj. Nga njëra anë Morisi i sheh proceset shenjore si një klasë të gjerë të proceseve të ndërmjetësimit dhe nga ana tjetër, ai është i bindur se proceset e ndërmjetësimit nuk përfshijnë gjithmonë shenja. Ai e formuloi këtë përkufizim, në bazë të kërkesës, që proceset shenjuese janë procese ndërmjetësimi, ku faktori ndërmjetësues është një interpretues, por interpretuesi nuk është gjithmonë i pranishëm. Një shenjë përkufizohet si diçka që gjeneron një shenjë, e cila, nga ana e saj gjeneron një shenjë tjetër.

Moris, në ndryshim nga Pirsi, përcakton më qartë termin "interpretant", duke bërë dallimin mes "*interpretant i menjëhershëm*", "*interpretant dinamik*" dhe *'interpretant logjik*" (Petrilli, 2004).

**Erik Fromi (Erich Fromm)**

Fromi dallohet për ndihmesat e tij në doktrinën psikanalitike, si për psikikën individuale, për të pandërgjegjshmen shoqërore etj. Brenda këtij kuadri psikanalitik, ajo çka paraqet interes për fushën e semiotikës, është trajtimi i aspektit simbolik të gjuhës.

Në shtjellimet që bën për gjuhën e ëndrrave, ai i kushton rëndësi edhe natyrës së gjuhës së simboleve. Simboli përkufizohet prej tij si "diçka që zë vendin e diçkaje tjetër". Ky përcaktim bëhet më interesant, po të kihen parasysh ato simbole, në të cilat shprehjet shqisore, si: të parët, të dëgjuarit, të nuhaturit dhe të prekurit, zënë vendin e një "diçkaje tjetër", që është një përvojë e brendshme, një mendim. Një simbol i këtij lloji është diçka që qëndron jashtë nesh dhe ajo që simbolizon ai është diçka brenda nesh. Në gjuhën e simboleve përvojat e brendshme shprehen si të ishin përvoja shqisore, domethënë, si diçka që kemi bërë apo kemi pasur në botën e jashtme. Në këtë gjuhë bota e jashtme është simbol i botës

së brendshme, simbol për shpirtrat dhe mendjet tona **(**Fromm, 1998).

Për të përcaktuar lidhjen e saktë midis simbolit dhe asaj që simbolizon ai, Fromi e drejton vëmendjen te ndryshimet midis tre tipeve të simboleve: simbol i pranuar (*konvencional*), simbol i rastit (*aksidental*) dhe simbol i përgjithshëm (*universal)*. Në analizën e secilit prej tyre, ai vëren se dy tipet e fundit të simboleve i shprehin përvojat e brendshme sikur të ishin përvoja shqisore dhe vetëm këta kanë elemente të gjuhës simbolike. Ndër këto simbole, ai konvencional, është më i njohuri, sepse përdoret më së shumti në jetën e përditshme.

**Klod Levi Strausi (Claude Lévi- Strauss)**

Klod Levi - Strausi mund të quhet themeluesi i strukturalizmit. Ai mbetet një nga intelektualët më të rëndësishëm të kulturës evropiane të kohës sonë.

Pyetjet themelore që nxitën reflektimet e tij, kanë të bëjnë me strukturat e mendimit. Autori shpreh bindjen se ka struktura që janë të përbashkëta për të gjithë njerëzimin, edhe pse ato janë të mbushura me përmbajtje të ndryshme. Strausi thekson se gjuha është mënyra e parë për vendosur rendin në botë.

Midis formave diakronike dhe versioneve sinkronike të formave kulturore, shtrihet harmonia transformuese e logjikës, duke u mbështetur në të njëjtat teknika intelektuale të analogjisë, homologjisë, inversionit, simetrisë dhe redonancës. Klod Levi -Strausi pohon se mentaliteti i njeriut dhe kultura njerëzore janë të lidhura, universale, janë procese simbolike (Cobley, 2010).

**Roland Barti (Roland Barthes**)

Roland Barti është vazhdues i teorisë semiologjike të Sosyrit. Ai u bë i njohur për ndihmesat e tij në studimet semiotike të teksteve, miteve, teologjisë, letërsisë dhe narracionit, semiotikën e llojeve të ndryshme të komunikimit pamor dhe për modelin e tij sistematik të kuptimit, një term që e lidh me Sosyrin, por që Barti e përcakton si "një proces, një akt i cili lidh shenjuesin dhe shenjuarin, një akt që ka si produkt shenjën ".

Ndryshe nga Sosyri, Barti e sheh semiologjinë si pjesë të gjuhësisë, sepse, sipas tij, çdo sistem semiologjik përzihet në gjuhë. Çdo tërësi semiologjike e rëndësishme, kërkon të interpretohet nëpërmjet gjuhës. Në të vërtetë, thekson ai, gjuha është i vetmi sistem shenjash me anën e të cilit mund të interpretohen të gjitha sistemet e tjera shenjore (Rrokaj, 2000). Fusha e kërkimeve të tij semiotike përfshiu një sërë disiplinash, te të cilat u zbatua teoria semiotike, sidomos semiotika e tekstit. Ai përdor konceptin e gjuhës si një praktikë që modelon dhe organizon fushat e ligjërimit.

Semiotika e tij e tekstit shkon përtej semiotikës së komunikimit, ku si bazë është mesazhi. Në këtë aspekt, për Bartin rëndësi semiotike ka teksti ose shkrimi, që është hapja maksimale e kuptimit, i cili karakterizon shkrimin, veçanërisht shkrimin letrar (Cobley, 2010).

Barti shkruan për dy rrafshe: rrafshin e shprehjes dhe atë të përmbajtjes. Sipas tij, shumica e shenjave ndërmjetësohen nga gjuha. Ai zakonisht lexon shenjat jogjuhësore (p.sh. ato të modës) përmes shenjave gjuhësore (si një gazetar i modës). Shenjat jogjuhësore shihen si bartëse të kuptimeve gjuhësore. Barthes ishte i interesuar për të zbatuar metodën e semiotikës në leximin e dukurive nga jeta e përditshme dhe, në veçanti, për kulturën. Ai ishte i bindur se objektet dhe ngjarjet gjithmonë thonë më shumë se vetja e tyre. Kur përshkruan potencialin e semiotikës, Barti shkon përtej nocionit klasik të semiologjisë (Guimarães, 2012).

**Alzhidras Grimasi (Algidras J. Greimas)**

Vepra e Grimasit lidhet me semiotikën e tekstit, sidomos me gjuhësinë tekstore.

Grimasi krijoi apo propozoi një metodë origjinale që lidhej me analizën e diskursit. Ai nuk ishte dakord me gjuhësinë strukturore që u përqendrua vetëm te fonemat si njësi minimale të çdo gjuhe dhe te morfemat, si njësi gramatikore që lindin nga kombinimi i fonemave. Sipas tij, këto njësi gramatikore mund të gjenerojnë një numër të pafund fjalish, por, analiza shkon deri tek fjalia, jo më larg, dhe nuk lejon analizën e njësive përtej fjalisë. Ai përligj nocionin e mikrouniversit semantik dhe universit të diskursit, siç aktualizohet në të shkruar, në të folur apo tekste ikonike.

Për të arritur në prodhimin e kuptimit, teksti duhet zhvendosur nga niveli i gjuhës, në një tjetër nivel tjetër të gjuhës, metagjuhës (Cobley, 2010). Semiotika e tekstit e Grimasit mbështetet në ripunimin që ai i bën teorisë së Vladimir Propit për morfologjinë e përrallës. Ai mbështetet në kategori strukturore që i përkasin semantikës dhe sintaksës, mbi bazën e të cilave bëhet interpretimi i tekstit.

Autori dallon interpretimin semiotiko-narrativ, interpretimin diskursiv dhe interpretimin tekstor. Duke i ndarë në rrafshet përkatëse, mund të arrihet në përfundimin se vetëm interpretimi tekstor i përket rrafshit të shprehjes, ndërsa dy llojet e tjera i përkasin rrafshit të përmbajtjes (Nöth, 1990; Pozzato,2001).

**Tomas Sebeoku (Thomas A. Sebeok**)

Sebeoku mbahet një ndër autorët kryesorë që ka dhënë ndihmesën e tij për të institucionalizuar ndërkombëtarisht semiotikën dhe për konfigurimin e saj si "semiotika e jetës" ose "semiotika globale". Semiotika globale, sipas Sebeokut siguron një pikë takimi dhe vëzhgimi për studimin e jetës së shenjave dhe shenjave të jetës.

Me emrin e tij lidhen pikërisht disiplina të tilla, si: zoosemiotika, biosemiotika etj. Detyra e semiotikës është të studiojë sjelljen e shenjave kudo që ato ndodhen; në mënyrë të veçantë, gjuha njerëzore është një *semiozis*. (Semiozis ka të bëjë me veprimin e shenjave). Sipas Sebeokut, detyra e semiotikës nuk është vetëm vëzhgimi dhe përshkrimi i shenjave, por duhet të merren parasysh edhe kushtet e mundësitë që karakterizojnë dhe specifikojnë shenjat; për çfarë janë ato dhe për çfarë duhet të jenë (Cobley, 2010; Sebeok, 2001).

Semiotika përcaktohet nga Sebeoku si diçka që ndan perspektivën dialogjike nga ajo polifonike. Semiotika shihet si mundësi njësimi në tre nivele: në nivelin shpjegues, në nivelin metodologjik dhe në nivel etik. Për Sebeokun, një fushë hulumtimi më vete, në këndvështrimin semiotik, përbën edhe biosemiotica.

Në këtë aspekt, semiotika nuk është vetëm antroposemiotika, por edhe zoosemiotika dhe endosemiotika. Brenda këtij kuadri, Sebeok trajton edhe problemin e gjuhës. Fjala "gjuhë" përdoret për shprehjen e "gjuhës muzikore", shprehjen e "gjuhës filozofike" dhe të tjera të ngjashme me këto. Sipas tij, me këtë fjalë duhet t'i referohemi gjuhës verbale dhe joverbale të njeriut. "Gjuha" që ka të bëjë me kodin gjenetik apo "gjuha" e kafshëve nuk mund të kenë kuptimin e duhur "gjuhë"(Ponzio&Petrilli, 2003).

**Juri Lotmani** (**Yuri Lotman)**

Lotmani vuri në qendër të studimeve të tij semitokën kulturore, e cila sipas tij, merret me studimin e lidhjeve funksionale të sistemeve të ndryshme shenjore. Brenda kësaj filozofie, sistemi kryesor i modelimit formohet nga gjuha natyrore, ndërsa sistemet dytësore të modelimit janë analoge me gjuhën ose përdorin gjuhë si lëndë bazë. Ndër këto sisteme ai përmend letërsinë, artet e bukura, muzikën, filmin, mitin, fenë etj. Në aspektin e kulturës, këto sisteme funksionojnë së bashku, por aspirojnë për

të qenë të pavarura. Koncepti i tij për kulturën mund të përkufizohet si një sistem i bazuar në marrëdhëniet midis njeriut dhe botës (Cobley, 2010).

Sipas Lotmanit kultura është si kujtesë, është si regjistrim apo kujtim i asaj që tashmë është përjetuar nga bashkësia. Kultura mund të përkufizohet si "kujtim i patrashëguar te bashkësia". Kultura shfaqet si një mekanizëm i fuqishëm për ruajtjen e informacionit. Ajo mund të përfshijë tekste të shkruara, imazhe, struktura arkitektonike, objekte të llojeve të ndryshme, hapësira urbane etj. (Lotman e Uspenskij, 2006).

Nga ky këndvështrim, duket se kultura është një hapësirë e gjerë në të cilën bashkekzistojnë të gjitha këto sisteme kuptimi.

**Julia Kristeva (Julia Kristeva)**

Julia Kristeva përpiqet të vërë në dukje kufijtë e teorisë mbi gjuhën, duke zbuluar përmasën semiotike të saj. Kristeva përshkruan simbolikën si hapësirë në të cilën zhvillimi i gjuhës lejon fëmijën të bëhet një "subjekt që flet", për të zhvilluar një ndjenjë identiteti të veçantë nga nëna, ku fëmija duhet të refuzojë dhe të lëvizë larg nga nëna në mënyrë që të hyjë në botën e gjuhës, kulturës, kuptimit dhe socializmit.

Ky proces i ndarjes është i njohur si "***abjection***" dhe në thelb është refuzimi i asaj çka është ndryshe te vetvetja. Kristeva argumentoi se potenciali semiotik i gjuhës është shkatërrues, sepse mund të kthejë përmbys ato çka janë pranuar në gjuhë. Me këtë përfundim, semiotika përshkruhet prej saj si një praktikë gjuhësore poetike e lindur, e cila pengon simbolikën, që është kuptuar si diçka kulturore në bazë të rregullave të të folurit.

Kristeva propozoi një "semanalisis", një analizë semiotike, duke u përpjekur të krijojë një lloj qarku të shkurtër për të lidhur gjuhësinë dhe qasjen semiotike me psikanalitikën. Në këtë mënyrë, Kristeva bëri dallimin midis semiotikës dhe simbolikës në një kuadër psikanalitik, duke analizuar heterogjenitetin e kuptimit, të cilin e provon drejtpërdrejt në praktikën analitike. Kjo manifestohet më së miri në shkrimet letrare.

Duke i realizuar këto, Kristeva arriti në dallimin ndërmjet simbolikës dhe semiotikës. (McAfee, 2004; Cobley, 2010).

**Umberto Ekoja (Umberto Eco)**

Umberto Ekoja është filozof, kritik letrar dhe novelist i shquar i kulturës italiane dhe ndër-kombëtare. Ai mbahet si një ndër studiuesit më të rëndësishëm në fushën e studimeve semiotike. Ekoja themeloi dhe zhvilloi një nga qasjet më të rëndësishme në semiotikën bashkëkohore, atë që njihet si semiotikë interpretuese. Ai bën një dallim të qenësishëm ndërmjet filozofisë së gjuhës dhe semiotikës. Duke hetuar mbi këto raporte, ai thekson faktin, se duhet bërë dallimi mes një semiotike të përgjithshme dhe një semiotike të veçantë.

Semiotika e veçantë, sipas Ekos, është një lloj gramatike e një sistemi shenjor të veçantë. Në këtë aspekt, ka gramatikë të gjuhëve gjestuale të shurdhmemecëve, gramatikë të anglishtes a të një gjuhe tjetër, gramatikë të sinjalistikës rrugore etj. Përsa i takon semiotikës së zbatuar, ajo përfaqëson një zonë me kufij të pacaktuar qartë, ku mund të përfshihen praktikat interpretuese-përshkruese, siç ndodh në realizimin e kritikës letrare ose frymëzimin semiotik (Eco, 2012).

Semiotika interpretuese zë një vend qendror në veprimtarinë letrare e kritike të Umberto Ekos. Semiotika gjeneruese dhe ajo interpretuese mbajnë parasysh edhe autonominë, edhe imanencën e tekstit, pavarësisht nga synimet e autorit dhe efektin që mund të ketë te lexuesi.

Ekoja problemin e interpretimit e ndan: *Intentio auctoris, Intentio lectoris, Intentio*

*operis*. (Qëllimi i autorit, Qëllimi i lexuesit, Qëllimi i punës). Shpesh, teksti nuk përputhet me qëllimet e atyre që e prodhojnë (intentio auctoris). Për një interpretim të duhur të tekstit, nuk duhet mbështetur në deklarime ose biografi empirike të autorit. Shpesh lexuesi projekton diçka që nuk ekziston, pasi ai mund ta bazojë në dëshirat, impulset dhe arbitraritetin krejtësisht personal (intentio lectoris). Është i njëjti tekst që duhet të mbahet parasysh, në referimet e koherencës kontekstuale dhe sistemeve të kuptimit të cilit i referohet (intentio operis) ( Eco, 1990/2011)

**Rexhep Ismajli**

Akademik Rexhep Ismajli është një ndër studiuesit më në zë të gjuhësisë bashkëkohore shqiptare. Përsa i takon më ngushtësisht, fushës së studimeve semiotike, mbështetur në veprën e tij, Rexhep Ismajli mund të cilësohet si studiuesi i parë i gjuhësisë shqiptare, që ka hulumtuar në fushën e semiotikës me veprat dhe studimet e tij, si: "Shumësia e tekstit" (1972), "Shenjë dhe ide" (1974), "Tingulli, fjala e lidhur, ligjërimi" (1972), "Fillimet e historisë së semiologjisë" (1975), "Ligjërim/ gjuhë/ të folur" (1976), "Semiotika e braktisur" (1975), "Teksti, Fjala" (1975), "Gjuha, forma, substanca" (1971), e një sërë studimesh mbi gjuhën e Sosyrit, Martinesë, Hjelmslevit, Balisë etj.

Ndihmesa e Rexhep Ismajlit u parapriu studimeve semiotike në gjuhën shqipe. Ai është i pari që përktheu në gjuhën shqipe Sosyrin dhe veprën e tij, nga ku gjejmë edhe përpjekjet e para për të sjellë në gjuhën shqipe njohuritë për semiologjinë në aspektin e përgjithshëm dhe, në veçanti, ndihmesat e Sosyrit, Morisit, Bartit etj., për semiotikën sosyriane, semiologjinë e shenjëzimit dhe komunikimit etj. Rexhep Ismajli me ndihmesat e tij në këtë fushë, krijoi mundësi që semiotika të bëhet një lëmë studimi edhe për gjuhësinë shqiptare.

**Përfundime**

Si përfundim mund të themi se hulumtimet rreth semiotikës, si një fushë e veçantë dijesh, paraqesin interes të veçantë. Studimi i shenjave, në përgjithësi, është i ndërliqur, për vetë natyrën që ato kanë. Nga historiku i shkurtër që kemi bërë për semiotikën, del se deri tani janë dhënë mjaft përkufizime rreth semiotikës si disiplinë dhe janë bërë dallimet mes termave **"semiotikë**" e "**semiologji**".

Gjurmët e semiotikës ndeshen shumë herët , që në antikitetin e lashtë grek. Në fushën e semiotikës, që prej antikitetit deri në ditët tona, janë dhënë ndihmesa të rëndësishme teorike nga autorë të tillë, si: Herakliti, Platoni, Aristoteli, Xhon Loku, Johan Lamberti, Vilhelm von Humboldi, Martin Hajdegeri, Roman Jakobsoni,Valentin Voloshilovi, Luis Hjelmslevi, Emil Benvenisti, Ludvig Vitgenshtajni, Çarls Morisi, Erik Fromi, Klod Levi Strausi, Roland Barti, Alzhidras Grimasi, Tomas Sebeoku, Juri Lotmani, Julia Kristeva, Umberto Ekoja etj.

Me kalimin e shekujve semiotika do të konfigurohej si një fushë studimi e dijeje në mënyrë graduale, duke u shfaqur plotësisht si një disiplinë moderne në fillim të shekullit XX, me ndihmesa të emrave të tillë si Sosyri e Pirsi që u bënë dhe themeluesit e saj.

Studiues të tjerë, të cilët në teoritë e tyre mbi trajtimin e shenjës gjuhësore në veçanti a semiotikën në përgjithësi, në një mënyrë a në një tjetër, kanë sjellë ndihmesat përkatëse duke zgjeruar objektin e kësaj dijeje.

Me arritjet e deritanishme, sot mund të flitet për një disiplinë teorike të semiologjisë dhe sistem semiotik, ngaqë janë studiuar të gjithë llojet e shenjave dhe veçoritë tyre, të vështruara në lidhje me komunikimin gjuhësor, shenjor e joshenjor, në të gjitha format e realizimit të tij.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Allen, Graham (2003). *(Translinguistik). Roland Barthes* – By Routledge Critical Thinkers, London.

Atkin, Albert (2013). *Peirce's Theory of Signs* , *The Stanford Encyclopedia of Philosophy* (Summer 2013 Edition).

Calabrese, Omar. (2001). *Breve storia della semiotica. Dai Presocratici a Hegel*. Milano, Feltrinelli.

Carman, Taylor (2003). *Heidegger's Analytic: Interpretation, Discourse and Authenticity* në *Being and Time*, Cambridge University Press.

Chandler, Daniel (1999). *Semiotics for Beginners* në: *http://www.aber.ac.uk/media /Documents/S4B/semiotic.html*.

Clarke, David S. (1990).*Sources of Semiotic*: *Readings with Commentary from Antiquity to the Present*, Southern Illinois University,USA.

Cobley, Paul ( 2010) .*The Routledge Companion to Semiotics.* Simultaneously published in the USA and Canada by Routledge.

Deely, John (1990). *Basics of semiotics*. Bloomington and Indianapolis: Indiana University Press.

Duro, Agron (2010). *Leksione të Teorisë së komunikimit*, QSA, Tiranë.

Eco, Umberto (2012). *Semiotica e filosofia del linguaggio*, G. Einaudi, Torino Editore s.p.a, Torino (1984), ristampa 2012.

Eco, Umberto (1978) . *Il segno*, Milano, ISEDI.

Eco, Umberto (1987). *The influence of Roman Jacobson on the Development of Semiotics*, në *Classics of Semiotics,* Springer Science+Business Media, Originally published by Plenum Press, New York in 1987.

Eco, Umberto (1990). *I limiti dell'interpretazione*, Prima edizione digitale, 2011, da IV edizione Studi Bompiani novembre 2004.

Fromm, Eric (1998). *Gjuha e harruar*, Tiranë, p. 10-17, përkth. Kujtim Ymeri.

Graham, Daniel W. (2011). *Heraclitus*, *The Stanford Encyclopedia of Philosophy* (Summer Edition, 2011).

Guimarães, Paulo Emanuel Novais (2012). *What did Barthes mean by 'semiotics'? How useful is his account for shoqëror theory and for accounts of ideology?*, Volume 8, Summer 2012, University of Essex.

Humboldt, Wilhelm von (2000). *La diversità delle lingue*, Laterza, Roma-Bari 2000, p. 36.

Ismajli, Rexhep (1980). *Shumësia e tekstit,* Rilindja, Prishtinë.

Lotman e Uspenskij (2006). *Ricerche semiotiche* në Tesi per una semiotica delle culture, Meltemi editore, Roma.

Lyons John (2010). *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë.

Manis, Jim (1999 – 2013) . *The Electronic Classics Series*, PSU-Hazleton.

Martin, Bronwen and Ringham, Felizitas (2003), *Dictionary of Semiotics*, Cassell Wellington House, London.

McAfee, Nowlle (2004). *Julia Kristeva*, Simultaneously published in the UK, USA and Canada by Routledge, Taylor w Francis Group

Memushaj, Rami ( 2006). *Hyrje në gjuhësi*, Botime Toena, Tiranë.

Memushaj, Rami( 2004). *Hyrje në gjuhësi*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë.

Nöth, Winfried (1990). *Handbook of semiotic*,Indiana University Press, Bloomington, USA.

Peirce, Sanders Ch. (1931). *Peirce, Collected Papers, Cambridge* (Mass.), Harvard University Press 1931-1958, 8 vols. Edited by (1931).
Petrilli, Susan (2004). *From pragmatic philosophy to behavioral semiotics: Charles W. Moris after Charles S. Peirce* në Semiotica 01/2004; 2004 (148):277-315.
Ponzio, Augusto; Petrilli Susan (2003). *Semioetica, Ricerche*, Meltemi editore srl, Roma.
Pozzato, Maria Pia (2001). *Semiotika del testo*, Carocci editore, S.P.A Roma.
Random House Electronic Dictionary ( 1992). College Edition, San Francisco, CA.
Rrokaj, Shezai (2010). *Filozofia e gjuhës nga antikiteti deri në kohën e sotme*, Shtëpia Botuese Arbëria, Tiranë.
Saussure, Ferdinand de (2002). *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme (1917),* Dituria, Tiranë, përkth. R. Ismajli, 2002.
Sebeok, Thomas Albert (1991). *Semiotics in the United States*, Indiana University Press, p.22.
Sebeok, Thomas Albert (1998). *Sign is just a sign. La semiotica globale*, Spirali, Milano.
Sebeok, Thomas Albert. (2001). *Signs- An introduction to semiotics*, Second Edition, University of Toronto, Press Incorporated.
Silverman, Kaja (1983). *From sign to subject, A short history*, në *The subject of semiotics*, Oxford University Press, Inc, New York.
Taverniers, Miriam (2008). *Hjelmslev's semiotic model of language: An exegesis*.
To appear in Semiotica.
Vitgenshtajn, Ludvig ( 2004). *Traktat logjik-filozofik*, Tiranë, përkthyes Ledian Rusta.
Vitgenshtajn, Ludvig (2002). *Hulumtime filozofike*, Tiranë, përkthyes Kristë K. Shtufi.
Volosinov, Valentin Nikolaevic (1976). *Marxismo e filosofia del linguaggio*, introduzione di Augusto Ponzio, Edizioni Dedalo.
Whitaker, C. W. A. (2003). *Aristotle's De Interpretatione: Contradiction and Dialectic*, Published to Oxford Scholarship Online: November 2003.

# PËRKTHIM I TOGFJALËSHAVE TË QËNDRUESHËM IDIOMATIKË NGA ANGLISHTJA NË SHQIPE

**SUELA KOÇA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Në këtë punim do të analizojmë përkthimin e togfjalëshave të qëndrueshëm idiomatikë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe si dhe vështirësitë që hasen gjatë këtij procesi.

Qëllimi i punimit është që të krahasojë këta togfjalësha në të dyja gjuhët, në përgjithësi, për të parë konkretisht ngjashmëritë dhe dallimet si në kuptim dhe në formë, të paraqesë problemin e mungesës së formave gjegjëse në gjuhën mikpritëse, të parashtrojë strategjitë e përdorura në përkthimin e tyre si edhe të hulumtojë zgjedhjen e përkthyesit në strategjitë e përdorura.

Pjesa teorike mbështetet kryesisht në teoritë e Mona Beikërit (Mona Baker), Rozamund Munit (Rosamund Moon), Çitra Fernandos (Chitra Fernando), si edhe Jani Thomait. Pjesa analitike për vjeljen e materialit dhe shembujve mbështetet në romanin e Xhorxh Oruellit (George Orwell) *Animal Farm* (1946) dhe versionin e përkthyer të tij *Ferma e Kafshëve* nga Arben Kallamata (2006) nga anglishtja në shqipe.

Duke krahasuar shembujt konkretë kemi vënë re mungesën e formave të njëjta në të dyja gjuhët. Gjithashtu, mund të themi se strategjitë më të përdorura janë ajo e përkthimit me idioma të ngjashme në formë e kuptim, ajo e perifrazimit, rastet e formave të ndryshme dhe kuptimeve të njëjta si edhe kur njësi të caktuara nuk janë përkthyer fare ose janë mënjanuar. Por, kemi edhe shumë raste kur fjalë të veçanta përkthyesi zgjedh t'i përkthejë me togfjalësha idiomatikë.

**Fjalë çelës:** *togfjalësha të qëndrueshëm idiomatikë, strategji të përkthimit, krahasim, anglisht, shqip*

**Abstract**

The translation of English idiomatic phrases is a difficult process. In this article, we will analyze the difficulties of their translation into Albanian.

The aim of this modest study is to compare and contrast these types of set phrases in both languages in order to draw their similarities and differences, either in structure, or meaning, to present the problem of no equivalence in the target language, to look through main translation strategies and examine the choice of the translator.

The theoretical part is mainly based on the theories of M. Baker, R. Moon, C. Fernando and J. Thomai. The analytical part is based on the novel of George Orwell *Animal Farm* (1946) and its translation made by Arben Kallamata *Ferma e Kafshëve* (2006) from English into Albanian.

The research has shown that there is a lack of equivalence from one language into the other. Moreover, the most prevailing strategy turned out to be that of translation with idoms similar in form and meaning, also there were examples of idioms with similar

meaning, but different in form, paraphrasing and omission. But, there were also several examples of translation of single words with idiomatic phrases.

**Key words:** idiomatic set phrases**,** translation strategies, comparison, English, Albanian

Në përkthimin e togfjalëshave idiomatikë, përkthyesi gjithmonë has vështirësi të ndryshme që nuk janë aspak të lehta për t'u kapërcyer. Problemi kryesor është mungesa e ekuivalencës në nivelin e këtyre togfjalëshave. Nëse një përkthyes do të mund të gjente një idomë në gjuhën e vet, e cila do të ishte e njëjtë në formë dhe kuptim ashtu si në gjuhën burimore, gjërat do të ishin më të thjeshta. Megjithatë, edhe pse çdo gjuhë ka togfjalëshat e vet idiomatikë, është e vështirë të gjesh gjegjësen identike.

Idiomat gjithmonë janë trajtuar si një nga aspektet më të vështira dhe interesante, njëkohësisht, në gjuhën angleze. Nga njëra anë, ato konsiderohen si një nga pjesët më të veçanta të gjuhës; dhe nga ana tjetër, ato janë të vështira për shkak të kuptimit dhe formës së tyre gramatikore, që në shumicën e rasteve, janë të paparashikueshme. Për më tepër, ato janë me bazë kulturore dhe kjo mund të sjellë probleme të mëtejshme për përkthyesin.

Laura Pinavaja (Laura Pinnavaia) shprehet: "Togfjalëshat idiomatikë janë trashëgimia e një kulture dhe tradite; ata përfaqësojnë shekuj jete në një kontekst të mirëfilltë sociolinguistik të një territori gjeografik dhe që janë shpirti i një komuniteti gjuhësor" (2002, p. 54-55). Prandaj edhe për të sjellë një idiomë në gjuhën e synuar, përkthyesi duhet të zgjedhë strategjinë më të përshtatshme.

Përkthyesi duhet të përvetësojë njohuri të mjaftueshme për funksionin e togfjalëshave idiomatikë si në gjuhën burimore dhe atë mikpritëse, duhet të njohë mirë karakteristikat e tyre në të dyja gjuhët. Për më tepër, gjatë procesit të përkthimit të tyre, përkthyesit përdorin strategji të ndryshme në mënyrë që të zgjidhin sa më drejt problemet që dalin.

Qëllimi i këtij punimi është të sjellë një panoramë të përgjithshme të strategjive më shumë të përdorura në përkthimin e togfjalëshave të qëndrueshëm idiomatikë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe, njëkohësisht, të shohë konkretisht (nëpërmjet shembujve të hulumtuar) çështje që lidhen me kuptimin dhe ndërtimin e tyre .

**Një vështrim teorik**

Gjuha angleze është shumë e pasur, jo vetëm me idioma, por edhe me njësi të tjera që njihen si "togfjalësha të qëndrueshëm". Ato përdoren si në gjuhën e folur edhe në atë të shkruar edhe më formale. Ato mund të gjenden dhe përdoren në poezi, letërsi, në gjuhën e Shekspirit dhe madje edhe në Bibël. Për këtë arsye, ne mendojmë së është shumë e nevojshme të përkufizojmë dhe krahasojmë këto njësi me natyrë idiomatike si në anglishte edhe në shqipe. Duke iu referuar botimeve mbi idomat është vënë re se përkufizimi i tyre shpesh ndryshon nga një studiues te tjetri. Për disa prej tyre, dhe në një spektër më të gjerë, ky term është gjithëpërfshirës, duke përmbledhur, ndër të tjera të gjithë togfjalëshat e qëndrueshëm, klishetë, formula në ligjërim, proverbat, dhe madje edhe fjalë të veçanta shumëkuptimshme (Liu, 2008, p. 3). Në librin e saj "Idiomat e anglishtes dhe përdorimi" (*English Idioms and How to Use Them)* (1979) Xhenifer Zaidëll MakMordju (Jennifer Seidl McMordiew) jep këtë përkufizim për idiomat: "Mund të themi se idioma është një numër fjalësh që, të marra së bashku, kanë kuptim të ndryshëm nga fjalët përbërëse të saj kur ato përdoren më vete.

Mënyra si janë vendosur fjalët shpesh është e pazakontë, jologjike dhe madje e pasaktë gramatikisht. Idioma të tjera janë plotësisht të sakta dhe logjike nga ana gramatikore dhe kuptimi." (p.4).

R. Muni në librin e saj "Togfjalëshat e qëndrueshëm dhe idiomat në anglisht: një përqasje e bazuar në korpus" (*Fixed Expressions and Idioms in English: a Corpus-Based Approach)* (1998) e përkufizon një idiomë si: "Një term me dy kuptime, i përdorur në mënyra të ndryshme. Në përdorimin e përgjithshëm, idioma ka dy kuptime kryesore. E para, idioma është një mënyrë e veçantë për të shprehur diçka në gjuhë, muzikë, art, e të tjera, që karakterizon një individ ose grup. Së dyti (dhe shumë më pak i gjendshëm në anglishte), një idiomë është një grupim i veçantë leksikor ose leksemë frazale, specifike për një gjuhë" (p. 3).

M. Beikëri në librin e saj "Me fjalë të tjera" (*In Other Words)* (1992) bën dallimin midis idiomave dhe togfalëshave të tjerë të qëndrueshëm për nga transparenca e kuptimit dhe eptimit në ndërtimin e tyre. Sipas Beikërit, idiomat janë: "Ndërtime të ngurtësuara të gjuhës që lejojnë pak ose aspak ndryshim në formë dhe shpesh japin kuptime që nuk mund të nxirren nga pjesët e tyre përbërëse të veçanta" (p. 63). Beikëri përjashton pesë gjëra që normalisht nuk mund të bëjmë me një idiomë për të mos humbur kuptimin: përkthyesi nuk mund të ndryshojë rendin e fjalëve në një idiomë; nuk mund të heqë një fjalë prej saj, nuk mund të shtojë një fjalë në të; të zëvendësojë një fjalë me një tjetër dhe të ndryshojë strukturën e saj gramatikore (po aty).

Në gjuhën shqipe, nga ana tjetër, tradicionalisht, idiomat janë quajtur njësi frazeologjike. Frazeologjia del si një fushë studimi, që ka objekt të vetin njësitë frazeologjike gjuhësore (Thomai, 1999, p. 211). Në librin e tij "Leksikologjia e Gjuhës Shqipe" (1999) J. Thomai bën dallimin midis njësive frazeologjike dhe togjeve të lira të fjalve: a) njësitë frazeologjike nuk krijohen në çastin e të folurit, por *hyjnë në ligjërim si njësi të gatshme*, të formuara më parë (*vë buzën në gaz, më mbetet qejfi, mbledh mendjen*, etj) (Thomai, 199, p. 183); b) njësitë frazeologjike *janë të qëndrueshme* si nga pjesët përbërëse edhe nga ndërtimi i tyre. Numri dhe rendi i gjymtyrëve janë pothuaj të pandryshueshëm (*shkel e shko, qesh e ngjesh, të zitë e ullirit, me duar kryq, për pesë para spec, si macja me miun*, etj) (Po aty, p.184); c) te njësia frazeologjike, sikurse te fjala e përbërë ose e përngjitur, *nuk duket lidhja e brendshme e gjymtyrëve*, sepse gjithë togu frazeologjik *shënon një koncept të vetëm (kokë e madhe (njeri i shquar, i zoti dhe i zgjuar), i jap dorën (ndihmoj), hap gojën (flas), shuaj nga faqja e dheut (zhduk), etj)* (Po aty,pp. 186-187); ç) fjalët që përbëjnë një njësi frazeologjike *e kanë humbur përgjithësisht pavarësinë kuptimore (i jap dum, këngën e Mukës, m'u bë koka daulle, etj.)* (Po aty, p.187); d) megjithëse çdo togfjalësh frazeologjik ndërtohet sipas ligjeve të gjuhës… *gjedhe strukturore nuk krijohen* (sipas *kodra pas bregut* nuk formohen njësi frazeologjike të tjera, *fshati pas malit, lumi pas pyllit,* etj., janë togfjalësha të lirë) (Po aty, p.188).

Përkufizimi i J. Thomait për njësitë frazeologjike është i plotë dhe shumë i qartë. Ai shprehet: *"Njësia frazeolofjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme* (Thomai, 1999, pp. 210-211).

Duke parë të gjitha këto tipare, pa frikë, mund të themi se njësitë

frazeologjike në gjuhën shqipe janë të ngjashme me idiomat në gjuhën angleze. Për të kuptuar më tepër më tepër, do të shohim se si klasifikohen ato në të dyja gjuhët. Muni (1998, p. 4) pretendon se idioma përfaqëson një term të përgjithshëm për shumë lloje togje fjalësh "pavarësisht se janë të paqarta semantikisht ose jo". Për ta kuptuar këtë më mirë duhet t'i referohemi tipologjisë së propozuar nga Fernandoja, që dallon tri nënkategori të idiomave:

**1.**Togfjalësha të qëndrueshëm idiomatikë (pure idioms). Sipas saj, këta togfjalësha janë gjithmonë të pamotivueshëm pavarësisht se mund të jenë të pandryshueshëm në formë ose mund të ndryshojnë shumë pak. Po kështu, këto idioma janë të paqarta nga ana kuptimore. P.sh. *smell a rat (kuptoj, nuhas diçka që s'shkon)* dhe *get cold feet (më dridhen leqet e këmbëve)* janë të tilla për shkak të kuptimeve të tyre të pazbërthyeshme, por ndërkohë që *smell a rat* është e pandryshueshme në formë, *get cold feet,* nga ana tjetër, mund të lejojë zëvendësimin e 'get' me 'have' (Dilin Liu; 2008, p.10).

**2.**Togfjalësha idomatikë gjysmë të motivueshëm (semi-idioms). Këta janë më të motivueshëm se grupi i parë sepse përbëhen nga pjesë me kuptim të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë njëkohësisht (ose nënkuptim). Prandaj ajo i quan edhe gjysmë-idioma. Këto konsiderohen si pjesërisht të motivueshme. P.sh. *fat chance (nuk ka shanse të ndodhë diçka)* dhe *blue film* janë të dyja shembuj të këtij tipi. *Fat chance* është e pandryshueshme, kurse te *blue film* fjala 'film' mund të zëvendësohet me emra të tjerë si 'joke' dhe 'story' me të njëjtin kuptim, domethënë 'obscene' (imoral, i neveritshëm) (Liu, 2008, 11).

**3**.Togfjalësha të qëndrueshëm joidiomatikë ose lehtësisht të motivueshëm (literal idioms). Edhe ky nëngrup është ose i pandryshueshëm ose lejon sumë pak ndryshime. Këto togje konsiderohen si transparente sepse mund të interpretohen nga kuptimi i pjesëve përbërëse të tyre. P.sh. *of course (siguristh), in any case (në çdo rast), for certain (me siguri)* (cituar nga Margarita Strakšienė, 2009, p. 14).

Kurse në librin e tyre "Idioma të anglishtes në përdorim" (*English Idioms in Use)* (2008), Majkëll MekKarthi (Michael McCarthy) dhe Felisiti Odelli (Felicity O'Dell) sjellin këtë klasifikim duke u bazuar në strukturën e tyre gramatikore/ sintaksore (p. 6):

**Folje + Kundrinë/plotës (dhe/ose rrethanor)**; *kill two birds with one stone.*

**Togfjalësh me parafjalë**; *in the blink of an eye.*

**Krahasim**; (as + mbiemër + as, ose like + emër); *as dry as a bone.*

**Me përbërje**; *a bone of contention.*

**Togfjalësha me dy gjymtyrë (fjalë + and + fjalë)**; *rough and ready.*

**Togfjalësha me tri gjymtyrë (fjalë + fjalë + and + fjalë)**; *cool, calm and collected).*

**Fjali ose pjesë fjalie**; *to cut a long story short.*

Edhe në gjuhën shqipe kemi pothuajse klasifikime të përcaktuara mbi të njëjtat baza: klasifikimi sipas shkallës së motivimit (që lidhet me kuptimin) dhe klasifikimi sipas ndërtimit. Për të dhënë këtë klasifikim në vija të përgjithshme po i referohemi librit "Leksikologjia e Gjuhës Shqipe" (1999) të J. Thomait. Njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe sipas shkallës së motivimit ndahen në:

**1-**Njësi frazeologjike të pamotivueshme.

Karakteristikë themelore e tyre është pamundësia për t'u zbërthyer kuptimisht, për të nxjerrë kuptimin e së tërës nga gjymtyrë si: *vë re, bëj pallë, i jap dum, e humbi toruan,* etj (Thomai, 1999, pp. 200-201). Këto ndahen në disa nëngrupe, por nuk po i shtjellojmë më tej.

**2-**Njësitë frazeologjike të motivueshme.

Këto janë më të shumta në gjuhën shqipe. Këtu përfshihen njësitë që kanë dalë nga shndërrimi i figurshëm i togfjalëshave të lirë si: *rri mbi gjemba, e zgjidhi qesen, teneqe e shpuar, viç i palëpirë,* etj. (Po aty, pp. 201-202). Edhe më të motivueshme janë ato njësi që ndërtohen nga një gjymtyrë me kuptim të figurshëm (zakonisht folje) dhe një gjymtyrë me kuptim të drejtpërdrejtë (zakonisht emër) si: *bëj durim, i zë besë, i dal për zot, hedh sytë,* etj. (Po aty, pp. 202-203).

Sipas ndërtimit njësitë frazeologjike në gjuhën shqipe mund të kenë strukturën e një togfjalëshi ose strukturën e një fjalie.

a) Njësitë frazeologjike me strukturë togfjalëshi janë të llojeve të ndryshme:

**Emër + emër**; *si mishi me thuan, me mish e me shpirt* etj.

**Emër + mbiemër**; *me zemër të hapur, me mendje të ngritur, për faqe të zezë* etj.

**Folje + emër (+ emër**); *i bie këmbës, e bën qimen tra* etj.

**Folje + emër + mbiemër**; *nuk shkel në dërrasë të kalbur, e nxori në udhë të madhe* etj.

**Folje + folje**; *ec e jak, qesh e ngjesh, fol e qesh* etj.

**Folje + ndajfolje**; *s'ha shqip, e la prapa, s'bie poshtë* etj.

Kuptimi leksiko-gramatikor i njësive frazeologjike nuk varet krejt nga natyra e gjymtyrëve; p.sh., megjithëse *brez pas brezi, shkel e shko* etj. përbëhen nga emra ose folje, janë njësi frazeologjike me vlerë ndajfoljore.

b) Njësitë frazeologjike me strukturë fjalie janë më të pakta. Këto ruajnë, me pak përjashtime, gjedhen ndërtimore të atyre fjalive nga kanë lindur si: *sa për të shkuar radhën, ku ha pula gurë* etj. Afërsisht të kësaj natyre janë edhe disa njësi frazeologjike në trajtën e fjalëve të urta ose të disa përgjigjeve tip, si: *ashtu i do mushka drutë, qeni qepën të hajë, mos i bjer murit me kokë, s'e vlen barra qiranë* etj. (Thomai, 1999, p. 198-199).

Njësitë frazeologjike klasifikohen edhe duke i përqasur me pjesët e ligjëratës, me emrat, mbiemrat, foljet etj. (Po aty, pp. 204-210), por nuk do ta shtjellojmë më tej sepse nuk është ky qëllimi i punimit tonë.

**Problemet dhe vështirësitë kryesore në përkthimin e togfjalëshave idomatikë**

Kur përkthejnë togfjalësha dhe shprehje idiomatike nga gjuha angleze në një gjuhë tjetër, përkthyesit gjithmonë hasin vështirësi që nuk janë të lehta për t'u kapërcyer. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të nxjerrim në pah disa nga këto vështirësi dhe mundësisht të shprehim ndonjë zgjidhje të mundshme për kapërcimin e tyre, veçanërisht në gjuhën shqipe.

Sipas M. Beikërit (1992), tri janë vështirësitë kryesore që ndesh një përkthyes. Një nga vështirësitë kryesore mund të jetë mungesa e formës gjegjëse në gjuhën e synuar. Ashtu si shprehet edhe M. Beikëri (p. 68), gjuhë të ndryshme shprehin kuptime të ndryshme duke përdorur mjete gjuhësore si togfjalësha të qëndrueshëm, idioma, fjalë etj., dhe është shumë e vështirë të gjesh gjegjësen përkatëse me kuptim dhe formë të njëjtë në gjuhën e përkthyer. Vështirësia kryesore, që shkakton probleme, lidhet me idiomat apo shprehjet që janë të veçanta nga pikëpamja kulturore. Ato nuk janë domosdoshmërisht të papërkthyeshme pavarësisht se mund t'u referohen çështjeve apo ngjarjeve të veçanta që janë të përbashkëta për një kulturë të caktuar. Për këtë arsye, edhe është e vështirë t'i përkthesh ato.

Një tjetër vështirësi që thekson M. Beikëri (p. 69) është përdorimi i një idiome të ngjashme në formë dhe kuptim në një kontekst të ndryshëm në gjuhën e synuar. Shumë idioma përdoren në tekste të

ndryshme në anglishte dhe në shqipe. Kryesisht, ato shfaqen në dialogje, i takojnë regjistrit joformal dhe mund të përdoren edhe me kuptim të drejtpërdrejtë edhe me kuptim të figurshëm. Gjithashtu, ajo shkruan se idiomat mund të përdoren edhe me kuptim të drejtpërdrejtë edhe me kuptim të figurshëm në të njëjtën kohë (p. 69). Në këtë rast, idioma në gjuhën e synuar nuk përkon me idiomën në gjuhën burimoe si në formë e kuptim, atëherë është shumë e vështirë të bësh lojë fjalësh dhe të përcjellësh kuptimin e duhur. P.sh: *He had sufficient influence to be able to poke his nose into the private affairs of others where less aristocratic noses might have been speedily bloodied.* (p. 70)

Në këtë shembull, Beikëri sjell idiomën "to poke your nose" që përdoret edhe me kuptim të drejtpërdrejtë, edhe me kuptim të figurshëm. Për të përkthyer një idiomë të tillë, përkthyesi duhet të sjellë gjegjësen e saj në gjuhën e synuar. Fatmirësisht, në gjuhën shqipe egziston një njësi e tillë "të futësh hundët" që i jep mundësi përkthyesit të bëjë një përkthim të mirë dhe të përcjellë mesazhin e duhur.

**Strategjitë e përdorura në përkthimin e idiomave**

M. Beikëri, në librin e saj *In Other Words* (1992), jep strategjitë e mëposhtme për përkthimin e togfjalëshave dhe shprehjeve idiomatike:

1) përdorimi i një idiome me kuptim dhe formë të njëjtë, 2) përdorim i një idiome me kuptim të përafërt, por formë të ndryshme, 3) me perifrazim, dhe 4) mënjanim.

***Përkthim me anë të përdorimit të një idiome me formë dhe kuptim të ngjashëm në gjuhën e synuar.***

Strategjia e parë, sipas M. Beikërit, është përdorimi i një idiome shumë të ngjashme në formë dhe kuptim me idiomën në gjuhën burimore. Ajo duhet të shprehë kuptim të njëjtë dhe duhet të përbëhet nga të njëjtat njësi leksikore. Për shembull, idiomat e anglishtes *the brains of the farm* apo *to tell the truth* kanë gjegjëset e tyre identike në shqip *truri i fermës* dhe *t'ju them të vërtetën:*

*1.Ai u tha atyre … që derrat, të cilët ishin truri i fermës, të kishin një vend më të qetë pune (Kallamata, 2006, p. 59).*

*2.… he said, that the pigs, who were the brains of the farm, should have a quiet place to work in (Oruell, 1946, p. 69).*

*3.T'ju them të vërtetën, kohët e fundit mezi po e prisja pensionin (Kallamata, 2006, p. 99).*

*4.To tell you the truth, I had been looking forward to my retirement (Oruell, 1946, p. 111).*

Për më tepër, siç shihet edhe në shembujt e mësipërm, idioma duhet të jetë e ngjashme jo vetëm në formë (përkatësisht emër + emër dhe folje + emër), por edhe në kuptim, sepse, ndonjëherë, një idiomë që ka të njëjtën formë mund të mbartë një kuptim krejt të ndryshëm.

***Përkthim me anë të përdorimit të një idiome me kuptim të ngjashëm, por të ndryshme në formë***

Një strategji tjetër e propozuar nga M. Beikëri është përkthimi me anë të një idiome me kuptim të ngjashëm, por me formë të ndryshme në gjuhën e synuar. Në këtë rast njësitë leksikore të idiomës nuk ruhen, por përkthehet si një gjegjëse semantike (domethënë shpreh të njëtin kuptim):

*1.On it was penciled the words: "Serves you right."(Oruell, 1946, p. 97).*

*2.Aty shkruhej me laps: "Paçi veten në qafë!" (Kallamata, 2006, p. 85).*

*3."Is it not crystal clear, then, comrades, that all the evils of this life of ours spring from the tyranny of human beings?" (Oruell, 1946, p. 20).*

*4.A s'e keni të qartë tani, shokë, si drita e diellit se të gjitha të këqijat e kësaj bote na vijnë nga tirania e qënieve njerëzore? (Kallamata, 2006, p. 12).*

Idioma në anglisht *serves you right* do të thotë "mirë t'i bëhet, sipas kokës festen" (FFASh, 1981, p. 327). Megjithëse shprehja në shqipe ka një strukturë të ndryshme leksikore, sipas përkufizimit të saj "e ke vetë fajin për diçka të keqe që mund të të ndodhë" (FFGjSh, 1999, p. 811), ajo mbart të njëjtin kuptim si idioma në anglishte. Po kështu, *crystal clear* "very easy to undertand" (i thjeshtë për t'u kuptuar) (CIDE, 1995, p. 332) ka të njëjtin kuptim me *si drita e diellit* "shumë qartë, si të jetë sheshit" (FFGjSh, 2010, p. 93).

***Përkthim me anë të perifrazimit***

Duhet përmendur se ka shumë terma që i referohen kësaj strategjie: 'metaforë brenda jometaforës', 'perifrazim komunikativ', 'tkurrja e metaforës në kuptim' (cit. Strakšiené; 2009, p. 16). Perifrazimi është një nga strategjitë më të zbatuara në përkthimin e idiomave. Meqenëse, ndonjëherë është e pamundur të sjellësh gjegjësen identike ose edhe ndonjë idiomë tjetër në gjuhën mikpritëse, atëherë përkthyesi mund të përdorë perifrazimin. Duke përdorur këtë strategji, përkthyesi përcjell kuptimin e një idiome me anë të një fjale të vetme ose një grup fjalësh për të sjellë të njëjtin kuptim, por që nuk është vetë idiomë. Siç mund të shihet edhe në këta shembuj:

*By and large the animals enjoyed these celebrations (Oruell, 1946, p. 108).*

*Por në përgjithësi kafshët kënaqeshin me këtë ceremoni (Kallamata, 2006, p. 96).*

*"I warn every animal on this farm to keep his eyes wide open" (Oruell, 1946, p. 81).*

*"Dua të paralajmëroj të gjitha kafshët e kësaj ferme që të jenë vigjilente" (Kallamata, 2006, p. 71).*

Idiomat në anglishte *by and large (*në fakt, kjo idiomë trajtohet si jo e saktë gramatikisht në anglishte sepse kemi ndërtimin parafjalë + mbiemër) dhe *keep one's eyes wide open* janë përkthyer në shqipe me grupe fjalësh që nuk janë idioma dhe madje nuk kanë as kuptim të figurshëm *në përgjithësi* dhe *të jenë vigjilente.* Kjo strategji ka disa të meta, siç mund të jenë humbja e cilësisë dhe shijes stilistikore. Duke përdorur këtë strategji jo vetëm përbërës të kuptimit mund të humbasin ose të shtohen, por edhe ndikimi emocional apo pragmatik mund të zvogëlohet ose të humbasë fare. Megjithatë, duhet përmendur që perifrazimi zakonisht është përshkrues dhe shpjegues dhe ndonjëherë e ruan stilin e idiomës origjinale.

***Përkthim me anë të të mënjanimit***

Kjo strategji nënkupton që ndonjëherë një togfjalësh idiomatik mund të hiqet duke mos lënë asnjë gjurmë në gjuhën synuese. Sipas Beikërit (1992, p. 77) ky mënjanim lejohet vetëm në disa raste: si fillim, kur nuk ka një gjegjëse të afërt në gjuhën mikpritëse; së dyti, kur është e vështirë të perifrazosh; dhe së treti, një idiomë mund të hiqet për arsye stilistikore. Kjo strategji nuk përdoret shpesh. Në fakt, ajo nuk pranohet nga shumë studiues dhe madje disa prej tyre nuk e trajtojnë fare si të tillë. Megjithatë, në rastin më të keq, përkthyesi mund ta heqë idiomën nëse është e pamundur ta përkthejë duke përdorur strategjinë e kompensimit. Po kështu, edhe kur ai mund ta vendosë idiomën diku tjetër në fjali për të ruajtur efektin stilistikor të përdorimit të idiomës në gjuhën burimore. Për shembull,

*1.It was as though the world had turned upside-down. (Oruell, 1946, p. 122),* përkthyesi ka zgjedhur ta mënjanojë këtë idomë, në fakt, ai ka hequr të gjithë fjalinë. Po kështu, edhe *on his lips* "kur thua diçka ose kur je gati për të thënë diçka" (LID, 1998, p. 215) nuk është përkthyer fare.

*2…. and had charged into battle with the words "Long live Humanity!" on his lips. (Oruell, 1946, p. 109)*
*3…. dhe ishte sulur në ballë me parullën "Rroftë njerëzimi!" (Kallamata, 2006, p. 97)*

Për ta mbyllur, mund të themi se, nëse do të ishte e mundur që për çdo idiomë të gjuhës burimore të kishim një formë gjegjëse në gjuhën e përkthyer, do të ishte ideale. Por ne e dimë që jo gjithmonë ndodh kështu. Në të tilla raste, përkthyesi duhet të zgjedhë strategjinë e duhur. Kjo zgjedhje varet nga një sërë faktorësh, që përfshijnë jo vetëm rëndësinë e njësive leksikore të veçanta që janë pjesë e idiomës, por edhe përdorimin me vend të togjeve idiomatike në një regjistër të caktuar në gjuhën mikpritëse (Beikër, p. 72).

**Analiza e strategjive të përdorura në përkthim**

Pjesa analitike është bazuar në romanin e Xhorxh Oruellit *Animal Farm (1946)* dhe variantin e përkthyer të tij nga Arben Kallamata, *Ferma e Kafshëve (2006)* nga anglishtja në shqipe.

Duke u bazuar te përkufizimet e cituara më lart për idiomat (apo togfjalëshat e qëndrueshëm dhe njësitë frazeologjike) si në gjuhën angleze dhe shqipe, mund të themi se kemi gjetur 87 të tilla. Megjithatë, duhet përmendur se ky nuk është një numër i saktë, pasi ka togje si: *take place (zuri vend/realizohej), from now onwards (tani e tutje), to drink (give) a toast (për të ngitur ndonjë dolli), in a body (të gjitha bashkë/si një trup i vetëm), with one accord (si me komandë/sikur ta kishin bërë me fjalë), get rid of (tëheqim qafe/ t'i nxirrte të palarat në shesh), by heart (përmendësh), fall short of (u ndje mungesa),* etj., që janë përdorur më shumë se një herë në romanin e analizuar dhe që ndonjëherë përkthehen ndryshe nga përkthyesi (ne mendojmë se fakti që ato nuk përkthehen gjithmonë njëlloj, ndër të tjera, varet edhe nga fakti se ato përdoren në kontekste të ndryshme dhe hyjnë në lidhje me fjalë të ndryshme). Për më tepër, ndonjë prej tyre mund edhe të jetë lënë mënjanë pa qëllim. Krahas tyre, si lloje të togfjalëshave të qëndrueshëm në anglishte janë edhe foljet frazale (phrasal verbs) dhe ato janë të shumta në roman. Ne nuk i kemi numëruar sepse në gjuhën shqipe nuk kemi të tilla dhe ato gjithmonë përkthehen me një folje të vetme ose edhe perifrazohen.

Nga pikëpamja tipologjike të gjitha togjet e grumbulluara nga romani i Oruellit mund të klasifikohen në tipa të ndryshëm. Sipas klasifikimit të propozuar nga Fernandoja, togfjalëshat idiomatikë në roman mund të ndahen në tri kategori: togfjalësha të qëndrueshëm idiomatikë të pamotivueshëm (pure idioms) (28), togfjalësha të qëndrueshëm gjysmë të motivueshëm (semi-idioms) (30), dhe togfjalësha të qëndrueshëm lehtësisht të motivueshëm (literal idioms) (29) (shihni shtojcën). Megjithatë, është e nevojshme të vërejmë se kjo ndarje mund të jetë disi subjektive pasi disa prej togfjalëshave idiomatikë mund të përfshihen në më shumë se një kategori.

Analiza e përkthimit të *Animal Farm* (1946) nga Arben Kallamata përfshin këto strategji bazë: përkthim me idiomë të ngjashme në kuptim dhe formë, përkthim me idomë të ngjashme në kuptim, por të ndryshme në formë, me perifrazim dhe me mënjanim.

**Tabela 1.** Strategjitë e përdorura për përkthimin e togfjalëshve idomatikë në *Animal Farm (1946).*

| STRATEGJITË | **Gjuha e synuar (Ferma e Kafshëve)** | | | | % |
|---|---|---|---|---|---|
| | t.q.id.pamot | t.q.mot | t.q.leh.mot | No. | |
| Idiomë e ngjashme në kuptim dhe formë | 8 | 15 | 17 | 40 | 46 |
| Idiomë e ngjashme në kuptim, e ndryshme në formë | 9 | 8 | 6 | 23 | 26 |
| Perifrazim | 10 | 6 | 4 | 20 | 23 |
| Mënjanim | 1 | 1 | 2 | 4 | 5 |
| GJITHSEJ | 28 | 30 | 29 | 87 | 100 |

Tabela e mësipërme tregon numrin e togfjalëshave të qëndrueshëm idiomatikë të grumbulluar në gjuhën burimore dhe njëkohësisht tregon edhe sa togfjalësha idiomatikë janë përkthyer duke përdorur strategjitë kryesore si edhe përqindjen e tyre. Pavarësisht se përkthyesi ka përdorur strategjinë e përkthimit me idiomë të ngjashme në kuptim dhe formë, kemi edhe shumë shembuj të tjerë, ku autori përdor strategji të tjera.

Nga të dhënat e grumbulluara dhe paraqitura në tabelë mund të themi se është e dukshme që pjesa më e madhe e togfjalëshave idiomatikë janë përkthyer po me idioma madje të ngjashme në kuptim edhe në formë (46%). Për më tepër, është e dukshme që Kallamata është përpjekur të shmangë mënjanimin dhe të përdorë strategji të tjera. Përkthimi me mënjanim përbën vetëm 5% të të gjitha strategjive të tjera. Gjithashtu, ai ka përdorur edhe përkthimin me idioma të ngjashme në kuptim, por të ndryshme në formë (26%) dhe me perifrazim (23%). Kështu, mund të theksojmë se Kallamata është përpjekur t'i qëndrojë sa më afër tekstit origjinal. Me anë të strategjive të përdorura, ai kërkon të jetë sa më pranë lexuesit për të përcjellë kuptimin burimor të tekstit. Kjo analizë nënkupton që Kallamata ka përdorur gjegjëset përkatëse nga anglishtja në shqipe dhe ka shmagur mënjanimin e togjeve idiomatike në gjuhën mikpritëse.

Gjithashtu, kemi vërejtur dhe na duket shumë interesant edhe fakti që përkthyesi ka zgjedhur të përkthejë me togfjalësha idiomatikë edhe fjalë të veçanta ose togje të lira. Këta shembuj janë të shumtë, por ne po japim vetëm disa prej tyre:

*Contentedly – për shtatë palë qejfe*
*Wthout listening – pa vrarë mendjen*
*Saved their lives – të shpëtonin kokën*
*Dislike – nuk i vëmë në gojë*
*Complaining – duke i qarë hallin*
*Sympathized – i mbanin ison*
*Neglected – lënë pas dore*
*Recapture – të shtinin në dorë*
*Never mentioned – nuk e zuri më kush në gojë*
*Nonsense – budallallëk me okë*
*Stupefied – ngelën pa gojë nga habia*
*Boldly enough – pa ua bërë syri tërr*
*Face – t'i bënin ballë*
*I thought so – ma preu mendja*
*If we feel we like it – po të na vijë pas oreksit*
*0 – sa gjerë e gjatë*
*If anything – që ç'ke me të*

**Përfundime**

Qëllimi i këtij punimi ishte të analizonte përkthimin e togfjalëshave idiomatikë (si të pamotivueshëm edhe të motivueshëm) të mbledhur nga romani i Xhorxh Oruellit, *Animal Farm (1946)* të përkthyer në gjuhën shqipe nga Arben Kallamata në vitin 2006.

Fokusi kryesor ishte të analizonim preferencat e përkthyesit për strategjitë e përdorura në përkthimin e togjeve idiomatike, gjë që na ndihmon të kuptojmë ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre (konkretisht me anë të shembujve) në gjuhën angleze dhe shqipe. Këto ngjashmëri dhe dallime lidhen si me strukturën edhe me kuptimin.

Hulumtimi i kujdesshëm dhe i hollësishëm i të dy romaneve na tregoi se Kallamata ka përdorur katër strategji bazë në përkthimin e idiomave: *përkthimin me idioma të ngjashme në kuptim dhe formë, me idioma të ngjashme në kuptim, por të ndryshme në formë, me perifrazim* dhe *mënjanim.*

Shembujt e idiomave të përkthyera me anë të të këtyre strategjive u përzgjodhën veç e veç nga secili libër për të treguar edhe shumëllojshmërinë e tyre. Analiza e shembujve të veçantë dhe të cituar në punim u bë me qëllim për të treguar preferencat e përkthyesit në përzgjedhjen e strategjive. Vumë re se idioma si *changed their tune (e ndërruan pllakën), fled with their tails between their legs (ia mbathën me bisht ndër shalë), to break his rule (të shkelte zakonin e vet), to drink (give) a toast (për të ngritur ndonjë dolli), the brains of the farm (truri i fermës), to tell you the truth (t'ju them të vërtetën)* , e shumë të tjera, kanë gjegjëset e tyre (si në strukturë dhe kuptim) në gjuhën shqipe dhe janë përkthyer si të tilla nga autori. Kjo analizë e romanit të Xh. Oruellit na ka dhënë mjaft prirje që lidhen drejtpërdrejt me ekuivalentimin në përkthim. Kallamata, në përkthimin e tij, shumë shpesh, është përpjekur t'i qëndrojë sa më afër tekstit original duke u përpjekur të sjellë format sa më të afërta të togfjalëshave idiomatikë dhe, pa nguruar, do të thoshim se kemi shumë pika takimi si në strukturën e togfjalëshave idiomatikë, po ashtu edhe në kuptimin e tyre.

Si përfundim, ky mbetet një studim modest, sepse ne analizuam vetëm një roman dhe, për të patur një panoramë më të gjerë, duhet të analizojmë edhe vepra të tjera nga shkrimtarë të ndryshëm dhe të përkthyera nga autorë të ndryshëm. Shumë natyrshëm, lind pyetja: a përdoren të njëjtat strategji në përkthimin e togfjalëshave idiomatikë në stile të tjera funksionale? Ç'mund të thuhet për përdorimet e tyre në stile të ndryshme ligjëmore? Nuk ka dyshim që përgjigjja e këtyre pyetjeve do të kërkonte një studim më të thelluar.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Baker, M, (1992). *In other Words; a Coursebook on Translation*, London and New York, Routledge.

Cambridge International Dictionary of English (1995). Cambridge and London; Cambridge University Press.

Kallamata, A. (2006). *Ferma e Kafshëve*, Shtëpia Botuese 'Onufri', Tiranë.

Liu, D. (2008). *Idioms; Description, Comprehension, Acquisition and Pedagogy*, ESL & Applied Linguistics Professional Series, London and New York; Routledge

LONGMAN Idioms Dictionary (1998). *Pearson Education Limited England*, Printed in Malaysia, PJB.

McCarthy, M. & O'Dell, P. (2008). *English idioms in Use*, Cambridge, Cambridge University Press.
McMordiew, J. S. (1979). *English idioms and How to Use Them*, third ed. Oxford University Press.
Moon, R. (1998). *Fixed Expressions and Idioms in English: a Corpus Based Approach*, Oxford, Clarendon Press.
Orwell, G. (1946). *Animal Farm*, New York, Harcourt Brace Jovanovich, Inc.
Pannavaia, L. (2002). *The grammaticalization of English idioms: a hypothesis for teaching purposes*, Mots Palabras Words 1; 53-60.
Stefanllari, I., & Dheri, V. (1981). *Fjalor frazeologjik Anglisht-Shqip*, Shtëpia Botuese '8 Nëntori', Tiranë.
Strakšiené, M., (2009). *Analysis of idiom translation strategies from English into Lithuanian*, Studies about Languages, 14, 13-19.
Thomai, J. (1999). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
Thomaj, J. (1999). *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, Shtëpia Botuese 'Shkenca', Tiranë.
Thomaj, J. (2010). *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, Shtëpia Botuese EDFA, Tiranë.

**Shtojcë:** Klasifikimi i togfjalëshave të qëndrueshëm idiomatikë bazuar në tipologjinë e Fernandos (1996) dhe përkthimi i tyre sipas Kallamtës (2006).

| **Tog.qënd.idiom.pamotivueshëm *(pure idioms)*** | **Tog.qënd.motivueshëm *(semi idioms)*** | **Tog.qënd.leht të motivueshëm *(literal idioms)*** |
|---|---|---|
| By heart (përmendësh) | Take (a) place (zuri vend/realizohej) | Word has gone around (ishte hapur fjala) |
| Out of their wits (ua futi frikën në palcë) | Come to/put an end to the discussion) (nuk japim dot më/ i vuri pikë muhabetit)) | Out of the way (me t'u hequr sysh) |
| In full flight (ia mbathën me të katra) | Crystal clear (si drita e diellit) | Draw/pay (no) attention (po tërhiqte vëmendjen/nuk ua vari) |
| Lost heart ((nuk) e lëshuan veten) | Get rid of (të heqim qafe/t'i nxirrte të palarat në shesh) | The plain truth (e vërteta e thënë copë) |
| Fell short of (u ndje mungesa) | Catch sight/a glimpse of (mund t'i hidhte një sy) | Sooner or later (herët a vonë) |
| On the point of (sa herë bëhej gati) | Turn black into white (edhe e zeza është e bardhë) | Pass on the message (përcilljani edhe brezave) |
| Sent shivers down all the animals spines (që iu fusnin dridhma kafshëve) | Starvation seemed to stare them in the face (uria po shfaqej me pamjen e saj të vërtetë) | Above all (mbi të gjitha) |
| With one accord (si me komandë/sikur ta kishin bërë me fjalë) | To rest on his mighty shoulders (binte mbi shpatullat e tij) | Took advantage of (të përfitonin nga rasti) |
| Crept away in a body (u larguan të gjitha bashkë/si një trup i vetëm) | On (bad/better) terms (armiqësi e vazhdueshme/kishte rregulluar marrëdhëniet) | As for the pigs (dogs) (sa për derrat (qentë)) |
| Speak his mind (t'i shprehte haptazi mendimet) | With a name of (i kishte dalë nami për) | Not growing tired of it (pa u lodhur) |
| With the air of (kishte pamjen e dikujt që) | Out of the corner of his eye (me bisht të syrit) | From now onwards (tani e tutje) |
| All the same (thuhej, ç'thuhej) | Make up their minds (vendosnin) | To come to an agreement (të binin në ujdi) |
| Were struck dumb with surprise (u shastisën fare nga habia) | Lay (get) hold of (të kapte/për ta shtënë në dorë) | Give me your word (of honour)<br>(A më betohesh?) |
| In the teeth of every difficulty (dhëmb për dhëmb) | Had given up hope of (i kishte humbur të gjitha shpresat) | In between times (0) |
| Be/get under way (duke | The fruit of all their struggles | On the other hand |

| | | |
|---|---|---|
| punuar) | (fryti i të gjitha përpjekjeve) | (nga ana e tij) |
| By and large (në përgjithësi) | Had fallen on evil days (ia kishte varur fare punës) | Having changed his mind (kishte ndërruar mendje) |
| At the very last (sa dha shpirt) | To spread a (contrary) impression (për t'u hedhur hi syve) | Made a determined effort (bënë një përpjekje të vendosur) |
| On the spot (në vend) | Sank his teeth in John's leg (duke ngulur dhëmbët në këmbët e Xhonit) | At any rate (të paktën) |
| By word of mouth (gojë pas goje) | That is the true spirit (kjo kërkohet nga ju) | As the case might be (sipas rastit) |
| Upside-down (0) | Cast a very ugly look at (hodhi një vështrim tepër dëshpërues) | Tears rolling down their cheeks (me lot që i rridhnin nëpër faqe) |
| To the dregs (me fund) | Keep his eyes wide open (të jenë vigjilente) | At a loss (nuk dinte ç'të bënte) |
| Serves you right (paçi veten në qafë) | The brains of the farm (truri i fermës) | A (terrible) piece of news (lajm i tmerrshëm) |
| Took to their heels (kthyen majrat nga thembrat) | Be in touch with (kishin pasur lidhje me) | To tell you truth (truth to tell) (t'ju them të vërtetën) |
| Changed their tune (e ndërruan pllakën) | To give Napoleon the credit for (t'i përkushtohej Napoleonit çdo arritje) | They were their own masters (zot të fateve të tyre) |
| Running for (dear) life (për të shpëtuar kokën) | Every stroke of good fortune (çdo e mirë që u sillte fati) | Improve his mind (të ushtronte mendjen) |
| In the same strain (i binte fyellit po te vrima) | On his lips (0) | As far as they knew (me sa dinin) |
| To set foot (të shkelnin) | Kept him on his feet ((nuk) po e mbante më në këmbë) | Which was which (çfarë ishte njëri dhe çfarë tjetri) |
| Fled with their tails between their legs (ia mbathën me bisht ndër shalë) | To kick his way out (të çante rrugën për të dalë) | Out of spite (megjithatë) |
| | To break his rule (të shkelte zakonin e vet) | From side to side (0) |
| | To drink (give) a toast (për të ngritur ndonjë dolli) | |
| | | |
| Total: 28 | Total: 30 | Total: 29 |

# LETËRSI

# ROLI I RRËFIMTARIT NË VEPRAT E SHKRIMTARIT XHONATAN SUIFT

**ALMA KARASALIU**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Ky punim fokusohet në figurën dhe rëndësinë që ka rrëfimtari në dy prej satirave më të studiuara të shkrimtarit Xhonatan Suift. Nisur nga fakti se prania e tij është një nga hallkat kryesore në kuptimin dhe analizën e një vepre letrare, vëmendja do të përqëndrohet jo vetëm në karakterizimin dhe individualizimin gjuhësor të tij, por edhe në lidhjen ndërmjet tij dhe autorit të veprave.

Me anë të hulumtimit dhe analizës së detajuar do të përcillen shembuj të ndryshëm ilustrues të tipareve si të 'autorit modern', në veprën "*Përralla e Fuçisë*" dhe të 'Guliverit' në veprën "*A Tale of a Tub*", si dy prej rrëfimtarëve më intrigues të Suiftit. Pyetja kërkimore që shtrohet në këtë punim është: Cilat janë tiparet thelbësore të rrëfimtarit në vetën e parë në veprat e sipërpërmendura? Në ndihmë të pyetjes kërkimore shtrohen edhe pyetje të tjera ndihmëse si: Cila është lidhja e rrëfimtarit me shkrimtarin, në rastin tonë Xhonatan Suift? Si realizohet kjo lidhje e dyzuar mes tyre? Sa ndikon kjo marrëdhënie në kuptimin dhe vlerësimin e veprave?

Punimi synon t'u japë përgjigje pyetjeve të mësipërme nëpërmjet analizës së shembujve konkretë të marra nga veprat e mësipërme.

Në përfundim, do të vihet në dukje ekzistenca e një zhvendosjeje të vazhdueshme ndërmjet Suiftit dhe rrëfimtarëve të tij. Po në këtë kontekst, do të theksohet se në vlerësimin e ideve dhe mesazheve të përcjella në vepër duhet t'i kushtohet vëmendje e theksuar përcaktimit të identitetit të folësit.

Në këtë kontekst, do të evidentohet se në rastet kur ata përfaqësojnë fjalët dhe idetë e autorit, rrëfimtarët e vetës së parë tek Suifti, shpesh arrijnë deri në parodizimin e vetvetes. Një tjetër tipar karakteristik për shkrimtarin Xhonatan Suift është fakti se formati i shkrimit të tij ka tendencën të jetë formal, përgjithësues dhe tërësisht objektiv, kur ai shkruan rreth një çështjeje të caktuar në vetën e parë, pa vënë në përdorim një folës të ndërmjetëm.

**Fjalë çelës:** *roli i rrëfimtarit, autor, vepër letrare, analizë*

**Abstract**

This paper focuses on the image and on the importance of the narrator in two of the most studied satires of Jonathan Swift. Given the fact that he is one of the key links in understanding and analyzing a literary work, the attention will be drawn not only on the linguistic characterization and individualization, but also on the relationship between him and the author of the books.

By means of detailed research and analysis, various examples will be provided, illustrating the features of the 'modern author', in the "A Tale of a Tub" and of 'Gulliver' in "Gulliver's Travels", as two of Swift's most intriguing narrators. The research question raised in this paper is: What are the essential features of the first person narrator in the above mentioned satires? Secondary to the main research question, several other supporting

questions like: What is the relationship between the narrator and the writer, in our case Jonathan Swift? How is this ambiguous relationship carried out between them? How does this kind of relationship affect the satires' understanding and evaluation?

This article aims at providing answers to the former questions by means of analyzing various examples taken from the previously mentioned works. In conclusion, it will be noted that there is a constant shift between Swift and his narrators and that while evaluating the ideas and the messages conveyed in these two books, special attention should be paid to the establishment of the speakers' identities.

In this context, it will be highlighted that Swift's first person narrators, often becomes part of the parody and satire, when they represent the words and ideas of the author. Another characteristic feature of Jonathan Swift is the fact that when he writes about something in the first person without employing an intermediate speaker, the format of the writing tends to be formal, generalized and totally objective.

**Keyword:** *the role of narrator, author, literary work, analysis*

Përpos mjeteve të tjera stilistikore e figurave letrare, një element me vlerë, i cili shfrytëzohet rëndom nga autorët e veprave letrare është edhe figura e rrëfimtarit. Këndvështrimi nga i cili ai i vlerëson ndodhitë në vepër dhe mënyra se si ai i përcjell ato, janë të një rëndësie të madhe, për vetë ndikimin që ato kanë tek lexuesi. Në këtë kontekst, mund të theksohet se rrëfimtari përbën, deri diku, sytë me anë të të cilëve lexuesi i sheh ngjarjet dhe i gjykon ato.

Një ngjarje mund të rrëfehet në vetën e parë, në vetën e dytë ose në të tretën. Rrëfimtari i vetës së parë, konsiderohet si përcjellës i ngjarjeve në mënyrë subjektive. Ai përgjithësisht është një prej personazheve në histori, i cili bashkëvepron me personazhet e tjera në vepër. Lexuesi i sheh të gjitha këto bashkëveprime përmes syve të tij dhe nuk mund të jetë në dijeni të asnjë elementi tjetër, përveç atyre të përcjella prej tij. Rrëfimtari i vetës së dytë është më pak i përdorur, për vetë problematikat që ngërthen përdorimi i tij. Ndërsa rrëfimtari i vetës së tretë, nuk është një figurë e historisë, por një vëzhgues jashtë ngjarjes që përcillet. Ai mund të jetë në gjendje të përcjellë tek lexuesi gjithçka që personazhet e tjera mendojnë ose mund të jetë i përqendruar tek njëri prej personazheve të veprës dhe të transmetojë vetëm ndjenjat dhe mendimet e tij, pa u përfshirë tek të tjerët. Gjithsesi, përcaktimi i rolit të rrëfimtarit mbetet në dorën e shkrimtarit.

Duhet theksuar fakti se sa më shumë të dimë rreth rrëfimtarit të një vepre, aq më shumë jemi në gjendje ta kuptojmë atë. Kështu, është me vlerë të theksohet se vlerësimi i rrëfimtarit është një proces tejet i rëndësishëm, i cili mund të kryhet duke nisur nga analiza e vendndodhjes dhe rrethanave. Në vazhdim të këtij procesi është më vend bërja e një vlerësimi, përsa i përket saktësisë dhe objektivizmit me të cilin përcillen veprimet prej tij. E gjithë kjo do të rezultojë në formimin e një imazhi të plotë në mendjen tonë dhe do të shërbejë si një udhëzues në vlerësimin e informacionit të përcjellë prej tij.

Xhonatan Suift është një shkrimtar satirik, i cili shfrytëzon më së miri një mori mjetesh stilistikore për të përcjellë mesazhe nga më mbreslënëset tek lexuesi. Vlen për t'u theksuar fakti se ky shkrimtar është i aftë të përcjellë mesazhe të ndryshme për lexues me aftësi kritike të ndryshme. Gjithçka e aftë për të

simbolizuar dykuptimësinë apo shumë-kuptimësinë përbën një mjet stilistikor të përshtatshëm për këtë shkrimtar. Përpos simboleve, fushave leksikore, pikësimit, satires, lojërave të fjalëve dhe parodisë, një tjetër element, tejet i shfrytëzuar nga ky autor është edhe figura e rrëfimtarit.

**Veçori të rrëfimtarit të Suiftit në veprat kryesore të tij.**

Rrëfimtari i vetës së parë në punimet e shkrimtarit Xhonatan Suift është pothuajse gjithnjë një individ me probleme të shëndetit mendor, i cili vazhdimisht shmang nga diskutimi çdo formë përjashtimi, si të mos ekzistonte fare, ose e sheh si një element të zakonshëm, të njëjtë me të tjerët.

Qëllimi i këtij autori në shfrytëzimin e këtyre rrëfimtarëve nuk është përcjellja e ideve të njerëzve të paaftë mendërisht, por kamuflimi i ideve të tij tepër kontradiktore për kohën. Në një sasi të konsiderueshme rastesh, përemri vetor 'unë' del jashtë vorbullës së frazave objektive sipërfaqësore të llojit: "Unë jam i sigurt …" ose "Unë kam menduar ndonjëherë …" forca shprehëse mendohet të jetë tejet e fortë por pothuajse gjithnjë pa ndonjë ndikim të madh tek lexuesi, si rrjedhojë e mungesës së orientimit.

Vlen të theksohet fakti se kur Xhonatan Suifti shkruan rreth diçkaje në vetën e parë pa vënë në përdorim një folës të ndërmjetëm, formati i shkrimit ka prirjen të jetë formal, përgjithësues dhe tërësisht objektiv. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se rrëfimtarët e vetës së parë tek Suifti shpesh arrijnë deri në parodizimin e vetvetes, në rastet kur ata përfaqësojnë fjalët dhe idetë e autorit. Si ilustrim, mund të sillen terma nga zhargoni i fushës ligjore, shkencore, asaj fetare e latinizmave tilla si: "**abortion**" (dështim i një qëllimi, "A Tale of a Tub", p.206), "**physico-logical**" (fiziko-logjik, "A Tale of a Tub", p.61), "**separate Maintenance**" (shërbim i veçantë, "A Tale of a Tub", p. 2), "**gravity**" ("A Tale of a Tub", p.60), "**topography**" (topografi, "A Tale of a Tub", p.35), "**viahumida**" (nëpërmjet lagështirës, "A Tale of a Tub", p.68), të cilat, autori modern i shfrytëzon tek vepra "Përralla e Fuçisë".

Ndonëse këto tipe të ndryshme zhargonesh futen hera-herës nëpër të dyja veprat e këtij autori, funksioni i tyre nuk është tjetër veçse ai i ilustrimit të parodisë së stilit të secilit prej këtyre profesioneve. Janë pikërisht këto forma ndërthurjesh, të cilat shprehin ndjeshmërinë e theksuar të autorit ndaj gjuhës. Duke patur parasysh se hyrja mbart 'rishqyrtimet' e autorit dhe vetëm 'parathënie' drejtuar lexuesit, si dhe se ekziston mundësia e një marrëdhënieje reciproke ndërmjet ligjërimit bisedor dhe mënyrës se si autori e ka hartuar veprën, mund të thuhet se pjesa më e madhe e hyrjeve të shkruara në këtë lloj ligjërimi nuk përfaqësojnë idetë e drejtpërdrejta të Suiftit.

Rrjedhimisht, shprehje të tilla si: "**I was the third of five sons…**" (Unë isha i treti nga pesë djemtë…, "Gulliver's Travels", Part 1, Chapter 1, p. 19), "…, I **might have saved myself** …" (unë mund tia kisha kursyer vetes …, "A Tale of a Tub", p. 2) nuk mund të konsiderohen si thënie të drejtpërdrejta nëse konsiderojmë si të shprehura nga autori i veprës, Suifti, e jo nga rrëfimtari, i cili në veprat në fjalë është nën emërtimin e "Autorit modern" tek vepra "Përralla e Fuçisë" dhe me atë të "Guliverit" tek "Udhëtimet e Guliverit". Abstraktet si ai në hyrjen e veprës "Përralla e Fuçisë", në të cilin 'rrëfehet' se punimi i vetë autorit është abstrakt, kur në të vërtetë nuk është dhe shfrytëzimi i këyre trillimeve përgjatë satirës bëhen subjekt i aluzioneve të ndryshme.

**Roli i 'autorit modern' në veprën "Përralla e Fuçisë"**

Në veprën e tij të parë, "Përralla e Fuçisë" rrëfimtari i veprës është autori modern, një personazh ky që është bërë pre e studiuesve të ndryshëm për vetë problematikat që ngërthen figura dhe roli i tij në këtë vepër. Që në krye të saj, lexuesi njihet me faktin se autori modern është objekt i satirës, pasi kjo ide përcillet me anë të parodisë dhe me anë të fjalëve me të cilat ai i drejtohet "princit Pasardhës" dhe i premton atij se pena e tij "nuk do të lëvizë derisa të ndiejë pulsin e botës" dhe atë të tijin, "se do të jetë e pashmangshme për të dy, ta rimarrë atë." ("A Tale of a Tub", p. 29)

Po ashtu, është më vlerë të theksohet se figura e modernit, veç 'sqarimeve', të cilat, në thelb nuk janë gjë tjetër veç se një mënyrë çorientimi për lexuesin, duhet të luajë edhe një rol tjetër: atë të udhëzuesit. Gjithsesi, vepra "Përralla e Fuçisë" ngërthen përdorimin e një sërë imazhesh, idesh, metaforash, numrash, aluzionesh, talljesh, citatesh e sidomos fjalësh polisemantike, të cilat në një farë mënyre, dalin kundër asaj zbrazëtie absolute të cilës autori i referohet vazhdimisht.

Po në këtë kontekst, mund të themi se marrëdhënia ndërmjet Suiftit dhe autorit modern është ajo e një eprori me vartësin e tij, i cili, pasi e le autorin modern të hallakatet nëpër mendime pa lidhje e fjalë pa vend, herë pas here ndërhyn, për të sjellë më hapur idenë e tij rreth një çështjeje të caktuar. Kështu, ndërkohë që lexuesi ndjek me vëmendje lumin e fjalëve pedante të autorit modern, i gjithë imazhi që ai ka ndërtuar, rrëzohet dhe lexuesit i duhet ta rindërtojë atë nga e para, me qëllim që të kuptojë se ndonëse fjalët mund të përdoren për të folur rreth realitetit, ato nuk arrijnë ta zëvendësojnë atë (Smith, 1979).

Përgjatë veprës, lexuesi përballet me diskutimin e rrëfyesit modern rreth "kufijve të mendjes dhe, për ironi, i tejkalon ato", (Smith, 1979)e në këtë rast, ne përballemi me atë çka vetë autori dëshiron të na përcjellë. Sipas tij, mendja njerëzore synon të arrijë shumë më tepër nga sa mundet, beson se mundet t'i ndajë elementët e botës në pjesë të qarta si: dritë dhe errësirë, të mirë dhe të keqe dhe gënjehet duke besuar se në këtë mënyrë, mund të arrijë rregullsi dhe përsosmëri. Ajo çka autori synon të na vërë në dukje, konsiston në faktin se bota është përtej një skematizimi të thjeshtë dhe se ajo është e prirur të jetë tërësisht paradoksale, ndërsa arsyetimet, "të cilat vërtiten brenda një rrethi vicioz, i cili sugjeron njëkohësisht gjithçka dhe asgjë, (Nicolson, 1960) nuk rreshtin së ekzistuari" (Davis, 1966). Ai kritikon besimin jo empirik tek gjërat e padukshme ("A Tale of a Tub", p. 169) dhe na paralajmëron kundër atyre të cilat me shumë zell e këmbëngulje përkrahin sistemet e reja, për gjëra për të cilat është rënë dakord unanimisht se janë të pamundura për t'u mësuar ("A Tale of a Tub", p. 166).

Në veprën "Përralla e Fuçisë", të gjitha idetë e hedhura para lexuesit duken si pa kuptim dhe shprehen nën të njëjtin stil fantastik. Vetë autori modern, në të vërtetë, luan më tepër funksionin e një mjeti stilistikor sesa atë të një rrëfimtari. Prania e tij në vepër bën të mundur vënien në dukje të ekzistencës së mashtrimit në jetën e njeriut dhe më tej, të idesë se individi mundet të çlirohet prej tij, ide e cila "përbën edhe mashtrimin më të madh me të cilin idividi përballet dhe prej të cilit nuk arrin të çlirohet ndonjëherë" (Williams, 1973).

Figura dhe roli i autorit modern bëhen edhe më të vështira për t'u kuptuar nëse lexuesi i veprës përqendrohet vetëm në terminologjinë që ai përdor apo edhe në

idetë që ai hedh, duke e konsideruar atë si të vetmin objekt të satirës së tij. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se moria e fjalëve të përdorura prej tij, kombinimi i ligjërimit bisedor me atë të ulët, moria e ideve, të cilat kundërshtojnë njëra-tjetrën, të hedhura njëherazi para lexuesit dhe mungesa e një qëndrimi të pandryshueshëm të autorit modern kundrejt një çështjeje të caktuar, i bëjnë të pashmangshme keqkuptimet për lexuesin ndërmjet asaj çka shprehet dhe asaj çka synohet të kuptohet. Ndonëse, në pothuajse asnjërën prej veprave të tij, Xhonatan Suifti nuk i shpreh hapur idetë e tij, në veprën në fjalë, vlerat pozitive janë tepër të vështira për t'u kuptuar, për shkak edhe të strukturës gjithëpërfshirëse të satirës së tij.

E parë nga një këndvështrim kritik, shfrytëzimi i një sërë personazheve për të shprehur idetë personale të tij nga ana e Suiftit, përbën një nga mjetet më të fuqishme të tij, si një autor, i cili preferon t'i shprehë mendimet e tij, kryesisht të komplikuara, në mënyrë të tërthortë. Funksioni i autorit të supozuar në veprën në fjalë, nga ana tjetër, është orientimi i lexuesit drejt kaosit, pështjellimit, vetëmashtrimit dhe drejt një bote të trazuar e të shkatërruar, copëzat e shpërndara të së cilës duhet të mblidhen e të bashkohen nga lexuesi kritik, i cili, bazuar në to, presupozohet të ndërtojë qëndrimin e tij ndaj realitetit.

Lexuesi, ndonëse jo i gjithi, njihet me lirshmërinë krijuese të autorit të vërtetë të librit, i cili qëndron shumë më lart sesa kaosi në të cilin autori modern përpërlitet. Prej këtej mund të theksohet se jo vetëm që autori i veprës bëhet një nga objektet satirike të saj, por edhe se kjo mënyrë të shprehuri përbën edhe arsyen për të cilën vepra ka një përhapje kaq të theksuar të sulmit satirik krahasuar me atë tek vepra "Udhëtimet e Guliverit".

Krahasuar me veprën "Përralla e Fuçisë", tek "Udhëtimet e Guliverit", lexuesi përballet me një boshllëk i cili e shtyn imagjinatën e tij që ta plotësojë atë, ndërkohë që tek vepra e parë, lexuesit i ofrohet kënaqësia e të kuptuarit të forcës së mendjes. Ndonëse të gjitha shkrimet e Xhonatan Suiftit përmbajnë vështirësi në nxjerrjen e mesazheve të nënkuptuara nga autori, tek vepra "Përralla e Fuçisë", kjo vështirësi bëhet edhe më e madhe për shkak të pranisë së autorit modern dhe opinioneve të tij të shtrembëruara.

Tek kjo vepër, qëndrimi që mban Suifti, në të vërtetë është tejet i kamufluar. Ndërsa tek satira tjetër e tij lexuesi kritik pothuajse gjithnjë është i aftë të kuptojë se cilat nga deklarimet e autorit të marrë si të mirëqëna e cilat jo, tek vepra a parë, ai endet mes një grumbulli fjalësh e mendimesh të stërgjatura e pa ndonjë lidhje logjike mes tyre. Prania e kreut me titull "Apologji", ku autori kërkon falje për disa prej sugjerimeve të tij, në këtë vepër, ndonëse tejet e pavend, në pamje të parë, lë të nënkuptohet aprovimi i asaj që shprehet në vijim të veprës.

Gjithsesi, tek vepra "Përralla e Fuçisë", e gjithë moria e ideve të shprehura reflekton nivel të njëjtë përqeshjeje dhe stili me të cilin ato janë përçuar tek lexuesi është i njëjtë. Po tek kjo vepër, vërejmë praninë e një sërë nënkuptimesh të mbivendosura. Një rast tipik është edhe prania e rrëfimtarit, autorit modern, funksioni i të cilit është vënia në dukje e çmendurisë së mashtrimit, më e madhja prej së cilave është bindja se njeriu mund t'i bëjë bisht atij.

Bazuar në qëndrimin që shkrimtari mban kundrejt "materializimit dhe kërkimit të verbër të kauzave dytësore" (Williams, 1973) mund të theksohet se tek vepra "Përralla e Fuçisë", por edhe tek ajo "Udhëtimet e Guliverit", ai shfaqet kundër sistematizimit të botës fizike dhe le pas

dore themelet shpirtërore të saj. Të dyja këto veprime, konsiderohen prej tij si të gabuara nga pikëpamja morale dhe nga ajo intelektuale.

Gjithsesi, qëllimi parësor i veprës "Përralla e fuçisë" nuk është thjesht kundërshtimi i materializmit modern, apo i filozofive të ndryshme, qofshin këto të hershme apo moderne. Të parat, në të vërtetë, shfrytëzohen si ilustrime të një forme arsyetimi e cila duke lënë mënjanë parimet bazë të moralit, traditës dhe përvojës i jep përparësi imagjinatës. Kjo formë të menduari, e shtyn mendjen të endet drejt një bote të humbur, të privuar nga e vërteta, e cila mund të zbulohet vetëm nga arsyeja, nga pranimi i arsyeshëm i të vërtetës së zbuluar dhe nga morali.

Përgjatë veprës, lexuesi bëhet dëshmitar i shkatërrimit të të vërtetave dhe hallakatjes së vëmendjes në drejtime te ndryshme, prej të cilave do t'i duhet një arsye tejet e hollë për t'u larguar e për të ndërtuar të vërtetën e paprekshme. Krahasuar me shkatërrimim e qëllimshëm nga ana e autorit të çdo të vërtete të pranuar gjerësisht nga populli i asaj kohe, siç është ajo e alegorisë mes tre kishave dhe tre vëllezërve, të cilët funksionojnë si një çelës për  të kuptuar mënyrën dhe qëllimin e ekzistencës së një sërë kapitujve tejet të çorientuar, mbartës të kuptimeve, të cilët e drejtojnë lexuesin qëllimisht në udhë pa krye dhe që, normalisht, përshkruhen si 'devijime', pjeset e tjera të veprës mund të konsiderohen si disi më të lehta për t'u kuptuar.

Rrëfyesi modern, nga ana tjetër, nën përpjekjen e stisur për të na servirur gjithë të vërtetat e mundshme mbi Zotin dhe arsyen, 'rastësisht' e lejon lexuesin të kuptojë se ai e kish parë të arsyeshme që me fjalën 'Zot' të nënkuptonte 'shpikjen' ndërsa me termat 'arsye dhe shpikje' të nënkuptonte instancat e zbukurimit të saj. ("A Tale of a Tub", p. 209) Vetë autori, e ka organizuar tekstin në përgjithësi si një tërësi elementesh tepër të rregullta e të thjeshta, të cilat hidhen para lexuesit, në formën e një sërë hyrjesh e devijimesh.

I shtyrë nga dëshira për të shfaqur të gjithë fodullëkun e pavend, Suifti shfrytëzon dyshet e fjalëve sinonimike për të përcjellë mesazhet e tij tek lexuesi. Vepra "Përralla e Fuçisë" gëlon nga përdorimi i këtyre palëve, një tipar ky karakteristik për shkrimtarët e shekullit të shtatëmbëdhjetë" (Locke, 1961). I  parë në tërësi, përdorimi i këtyre fjalëve luan rolin e një fjalori brenda vetë tekstit (Locke, 1961), por, veç tyre ekzistojnë edhe plot raste, ku përdorimi i tyre del jashtë këtij roli. Kështu, me qëllim përcjelljen e mesazheve, autori modern, i bindur se moria e fjalëve është ajo që ka më shumë vlerë sesa kuptimi që ato mbartin, shpesh, i shoqëron fjalë të caktuara me të tjera, sinonimike me to. Në dyshen "**Painsand Proceedings**" (dhimbjet dhe etapat, "A Tale of a Tub", p. 365) fjala etapë është përdorur për të plotësuar kuptimin e fjalës 'dhimbje' dhe për ta intensifikuar atë. E njëjta gjë vlen edhe për fjalën 'pisllëk' në shprehjen "**Dryness and Dirt**" (thatësirë dhe pisllëk, "A Tale of a Tub", p. 370)

Nisur nga sa u tha më sipër, vlen të theksohet fakti se veç ironisë, shkrimtari Xhonatan Suift synon të udhëzojë lexuesin ta lexojë veprën "Përralla e fuçisë" si një parodi të mënyrës së të shkruarit të autorëve të shekullit të shtatëmbëdhjetë (Howell, 1946) ku përdorimi i dysheve sinonimike, i shkronjave kursive, i poshtëshënimeve dhe i shënimeve në anë të faqes, ndër të tjera, shërbejnë si tregues të magjepsjes së Suiftit me fjalën në vetvete. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se, funksioni i autorit të supozuar në vepër është më shumë çorientues sesa drejtues për lexuesin. E gjithë kjo, pasi përgjatë veprës, ai

kundërshton idetë e hedhura prej tij, i keqinterpreton ato dhe në fund, nuk del me ndonjë opinion të formuar e të plotë, me anë të të cilit, lexuesi të arrijë të bëjë dallimin mes tij dhe autorit të vërtetë të veprës, Xhonatan Suiftit.

**Figura e Guliverit në veprën "Udhëtimet e Guliverit"**

Vepra "Udhëtimet e Guliverit" është një libër i ndërlikuar. Siç edhe është përmendur më sipër, kjo vepër është një satirë mbi katër aspektet e njerëzimit, mbi aspektin fizik, politik, intelektual dhe atë moral. Nisur nga mënyra se si Suifti i trajton këto aspekte, mund të theksojmë se kur Suifti shkruan për njërin prej tyre ai nënkupton edhe të tjerët. Shkrimtari i ofron lexuesit njëherazi një vepër fantastiko-shkencore dhe një parodi mbi fantashkencën. Ajo është një pasqyrim i indinjatës së madhe të autorit kundrejt "mungesës së maturisë", veseve dhe marrëzisë njerëzore dhe të vërtetës së dhimbshme mbi paaftësinë e njeriut për t'i kuptuar ato. Në të njëjtin kontekst, kjo vepër është një kryevepër komike, e cila jo gjithnjë është konsideruar si e tillë.

Personazhi i parë i cili meriton vëmendjen e lexuesit është Guliveri. Ai është rrëfimtari e njëkohësisht, edhe personazhi kryesor i veprës. Lexuesi sheh gjithçka përmes syve të tij, ndien ato që ai ndien dhe ndan të njëjtat mendime me të. Nisur nga fakti se lexuesi mbetet nën ndikimin e tij gjatë gjithë kohës, është thelbësore që ai ta njohë atë dhe qëllimet e tij sa më mirë, që në krye të herës.

Ndonëse në pamje të parë, Guliveri duket i mërzitshëm, për shkak se ai shfaqet si një individ me një imagjinatë tejet të cunguar, lexuesi tërhiqet prej tij dhe prej sinqeritetit me të cilin ai i paraqitet atij. Nisur nga përshkrimet e shumta, ne njihemi me faktin se ai është një vëzhgues i mirë, inteligjent, i aftë në drejtimin e situatave të vështira dhe mbi të gjitha, i mbushur me shpresë. Përsa i përket mungesës së imagjinatës, mund të theksohet se ky element, e bën lexuesin t'i marrë të mirëqena faktet e paraqitura prej tij.

Është me vend të theksohet se, me gjithë kritikën që rrëfimtari u bën fenomeneve e çështjeve të ndryshme me të cilat ai njihet në tri udhëtimet e tij të para, ai nuk mund të përfaqësojë Xhonatan Suiftin (Monk, 1973). Identifikimi i figurës së Suiftit me atë të rrëfimtarit, veçanërisht me atë të udhëtimit të katërt, do të çonte në çoroditjen e plotë të të gjitha mesazheve të përcjella prej tij përgjatë tri udhëtimeve të para, duke patur parasysh shndërrimin që pëson rrëfyesi nga një individ i mbushur me shpresë në një mizantrop të vërtetë, cilësi kjo që do t'i përcillej me pa të drejtë autorit. Po në këtë kontekst, vlen të theksohet se identifikimi i shpeshtë i figurës së rrëfimtarit në veprën "Udhëtimet e Guliverit" dhe i mizantropisë që e karakterizon atë me vetë autorin e saj, Suiftin, është rezultat kryesisht i vlerësimit të veprës, duke u bazuar vetëm në udhëtimin e katërt.

"I dwell the longer upon this Subject from the Desire I have to make the society of *an English Yahoo* by any Means not insupportable; and therefore I here intreat those who have any Tincture of this absurd Vice, that they will not presume to appear in my Sight." ("Gulliver's Travels", Part IV, Chap. XII, p. 326)

"U zgjata një çikëz në këtë çështje, se më qan zemra t'i ndreq e t'i lëmoj Jahutë anglezë, që të mos m'i vrasin shumë sytë; prandaj ju lutem atyre që kanë marrë pak njollën e këtij vesi të pangjarë, të mos guxojnë të më dalin përpara."("Udhëtimet e Guliverit", Pjesa IV, Kreu XII, p. 344)

Siç edhe mund të shihet nga shembujt e mësipërm, ndonëse Guliveri shprehet nën furinë e mizantropisë që i vlon në mendjen e tij në faqet e fundit të veprës, ai

nuk përfaqëson autorin e saj, por, përkundrazi, ai vetë, bëhet pre e ironisë së Suiftit, pasi ai arrin të urrejë 'racën njerëzore', duke i kthyer fjalët e tij në përligjje komike.

Po kështu, përsa u përket simboleve kryesore të përdorura në vepër, mund të thuhet se mënyra se si ato përcillen tek lexuesi i le vend keqinterpretimit të tyre. Një shembull i tillë është cilësimi i Huihnhnmëve si "njeriu ideal i Suiftit dhe i Yahuve si përfaqësues të njeriut të asaj kohe" (Monk, 1973). Këta të fundit, në të vërtetë, janë simboli më me vlerë në veprën "Udhëtimet e Guliverit". Ata nuk përfaqësojnë këndvështrimin e Suiftit për njeriun, por atë të elementit të egër që ekziston tek natyra njerëzore, të cilin ne shpesh mundohemi ta mohojmë, por prej të cilit nuk mund të shmanget.

**Përfundime**

Kombinimi i fushave leksikore, shfrytëzimi i neologjizmave, i simboleve dhe i shumë elementeve të tjera luajnë role specifike dhe marrin një rëndësi të veçantë në veprat e tij.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë analizës së punimeve të këtij autori, vëmendja nuk duhet të përqëndrohet vetëm në zhvendosjen e vazhdueshme që ekziston ndërmjet pranisë së autorit dhe rrëfimtarit, por edhe në ndërveprimin e pashmangshëm që ekziston ndërmjet kuptimit sipërfaqësor dhe atij të brendshëm, i cili është i vetmi që i përket autorit të vërtetë të veprave. Ky lloj këndvështrimi bën të mundur drejtimin e vëmendjes më tepër në mesazhin që autori synon të përcjellë, sesa në vetë personazhin që e përcjell atë.

Në kuadrin e analizës së figurës së rrëfimtarit në dy prej veprave më të vlerësuara të shkrimtarit Xhonatan Suift, mund të theksojmë se si 'autori modern' ashtu edhe 'Guliveri' paraqiten tek lexuesi si individë të ndryshëm dhe pa ndonjë lidhje me autorin e vërtetë të veprave, ndërkohë që edhe vetë satirat, deri diku, mbështeten në këtë lloj marrëdhënieje për të krijuar ndikime dhe për të përcjellë mesazhe tek lexuesi. Është më se i dukshëm fakti se rrëfimtari i Suiftit nuk është elementi i vetëm me rëndësi.

Vlen të theksohet fakti se me anë të personalitetit të tij, autori mendjemprehtë përcjell një sërë problematikash e ideologjish, të cilat nuk do të mund t'i shprehte në mënyrë të drejtpërdrejtë. E vetmja zgjidhje do të ishte maskimi pas çmendurisë së rrëfimtarit modern e, më pas, si për ironi, shfrytëzimi i pikërisht kësaj çmendurie për të arritur tek lexuesi kritik.

Karakteristikë për shkrimtarin Xhonatan Suift është fakti se kur ai shkruan rreth diçkaje në vetën e parë pa vënë në përdorim një folës të ndërmjetëm, formati i shkrimit ka prirjen të jetë formal, përgjithësues dhe tërësisht objektiv. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se rrëfimtarët e vetës së parë tek Suifti shpesh arrijnë deri në parodizimin e vetvetes, në rastet kur ata përfaqësojnë fjalët dhe idetë e autorit.

Përsa i përket 'autorit modern', si rrëfimtar i veprës "Përralla e Fuçisë", mund të theksohet se prania e tij në vepër është sa udhëzuese aq edhe çorientuese. Një pjesë e mirë e satirës gjithëpërfshirëse në këtë vepër realizohet me anë të figurës së këtij personazhi. Gjuha e përdorur prej tij, kombinimi i ligjërimit libror me atë bisedor si dhe përzierja e zhargoneve nga fusha të ndryshme mbartin qëllime të shumta në vetvete dhe formojnë sulme satirike të vështira për t'u kuptuar nga një lexues i përciptë. Ekzistenca e tyre del në pah vetëm nën vështrimin e lexuesit kritik, si i vetmi individ i aftë për të bërë dallimin ndërmjet të thënave e të pathënave të kësaj vepre.

'Guliveri', nga ana tjetër, një personazh i thjeshtë për t'u kuptuar në pjesën e parë të udhëtimeve, vjen gjithnjë duke u tjetërsuar në veprën "Udhëtimet e Guliverit", derisa kthehet në një mizantrop te vërtetë në fund të udhëtimit të katërt. Prania e tij në vepër është deri diku orientuese, për sa kohë që lexuesi kritik arrin të dallojë se kur fjalët e tij shprehin opinione përgjithësuese të autorit dhe kur ato mbartin thjesht mesazhe të përcipta, tejet të gjetura dhe të përshtatura sipas kontekstit dhe rrjedhës së ngjarjeve.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


A. C. Howell, (1946). *Res et Verba: Words and Things*, *ELH* 13, no. 2 131-42.

John Locke, (1960/1961). *An Essay Concerning Human Understanding,* ed. John W. Yolton, 2 vols. (1690; rpt. New York, 1961), 3. 2. 7.

Monk, Samuel H. (1973). *The pride of Lemuel Gulliver,* The Writings of Jonathan Swift, W.W.Norton & Company, Inc., p.637-644

Nicolson, Majorie H., (1960). *The Breaking of the Circle: Studies in the Effect of the "New Science" on Seventeenth-Century Poetry,* rev**.** ed. New York.

Smith, Frederik N. (1979) . *Language and Reality in Swift's A Tale of a Tub* , Ohio State University Press: Columbus, p. 140

Walter R. Davis (1966). *The Imagery of Bacon's LateWork***,** *Modern LanguageQuarterly,* June 27: 165-67

Williams, K. (1973). *The writings of Jonathan Suift*, W.W.Norton & Company, Inc., New York, p. 697

# SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT GJATË VITEVE 1921-1939 NË SHKRIMET E AUTORËVE ANGLEZË

**BENITA STAVRE**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Në fokusin e këtij punimi qëndron përshkrimi i imazhit që ka krijuar Shqipëria gjatë viteve 1921-1939 në përjetimet dhe dëshmitë e autorëve britanikë dhe amerikanë gjatë kësaj periudhe.

Ai hedh dritë mbi mënyrën se si vizitorët, udhëtarët, misionarët, historianët, diplomatët, dhe studiuesit e huaj i kanë përshkruar aspektet e ndryshme të realitetit shqiptar. Lexuesit i ofrohen analiza rreth mënyrës se si historia ndikoi në formimin e karakterit dhe personalitetit të gegëve dhe toskëve; rreth arsyeve pse vendasit vazhdonin të ruanin me fanatizëm shumë prej tipareve kulturore që në Evropë dhe gjetkë konsideroheshin të prapambetura; si dhe rreth mënyrës se si ndikonte përkatësia gjeografike dhe besimi fetar në pozitën shoqërore dhe ekonomike të një personi në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë.

Punimi paraqet informacion në lidhje me mundësitë që kishte Shqipëria për të ndërmarrë nisma ekonomike dhe politike që kishin për qëllim të ndiqnin rritmet e zhvillimit evropian. Së fundmi, studimi analizon edhe mënyrën se si janë gjykuar prej shkrimtarëve të huaj zhvillimet politike brenda vendit dhe lidhjet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Të dhënat, përshkrimet dhe analizat janë marrë nga libra udhëtimesh, ditare, shënime personale, dokumente të arkivuara, studime si dhe artikuj të botuar në Britani dhe Amerikë gjatë viteve 1921-1939.

**Fjalë çelës**: *vizitorë britanikë dhe amerikanë, fanatizmi kulturor; hogjenitet, lidhje gjinore, bashkëjetesa fetare, premisa ekonomike dhe zhvillime politike.*

**Abstract**

The aim of this paper is to highlight one of the periods of the history of Albania, that of the years between 1921 and 1939, whose said and unsaid facts have very frequently been misjudged. Its focus is to bring evidence of the way British and American visitors, writers, missionaries, researchers in the fields of economics and sociology, diplomats as well as journalists of the time have perceived many of the aspects of the Albanian reality.

The reader will find there information about the way the colorful history of this nation had shaped the character and the personality of the Albanians; the reason why many traditional features were fanatically preserved even though they were considered old-fashioned and backward in other countries; and the way the geographical features and the religious faith affected the shoqëror and economic status of the people. It also describes the opportunities that there were for the Albanians to undertake economic and political enterprises that would help them approach the European development pace.

In the end the paper analyses the national and international relations in which the political circles in Albania found themselves involved during this period.

The data, the descriptions and analysis have been mainly withdrawn by travel books, diaries, personal notes, archival documents and articles written by British and American travellers of the time as well as later researchers of the Albanian life during this period.

**Key words:** *British and American travellers, traditional fanaticism, homogeneity, gender relations, religious tolerance, economic enterprises and political developments.*

*"Ja tek ishin shqiptarët, një popull që s'kishe si të mos i doje; të pasur me bukuri të egër natyrore dhe me guximin që i karakterizonte si burrat edhe gratë. (…) Ata kishin fituar mjaft dhe ende po përpiqeshin të fitonin– pavarësinë, shkollimin, rrugë të reja që do t'i ndihmonin t'i jepnin fund varfërisë së tyre(…)*

*Por ka shumë pak të ngjarë që Shqipëria të ndërmarrë hapa edhe më të mëdhenj, më të domosdoshëm; nëse e bën do të vërë në rrezik atë që shqiptarët kanë fituar në të shkuarën dhe atë që ndoshtakanë programuar për të ardhmen."*

**(Ronald Mathius 1937 : 295-296)**

Historikisht Shqipëria dhe shqiptarët nuk kanë mundur të qëndrojnë jashtë fokusit të vëmendjes së huaj. Pozita gjeografike e këtij vendi, si një rrugë e lehtë kalimi nga lindja, me një dalje në një bregdet perëndimor, relievi që në mënyrë krejt origjinale ndërthur ashpërsinë malore me butësinë bregdetare, historia e saj shumëngjyrëshe dhe, mbi të gjitha, shqiptarët që me krenari e identifikuan veten me më të lartin e shpendëve "shqiponjën", e kanë përligjur kuriozitetin e vazhdueshëm që të huajt kanë pasur për këtë vend. Kanë qenë të shumtë udhëtarët që e kanë vizituar, që kanë zgjedhur të jetojnë në të për pak kohë, që kanë shkruar për të në ditare, libra udhëtimesh, artikuj gazetash, buletine gjeografike dhe shkencore, dokumente politike dhe më vonë edhe përsiatje analizash politike në lidhje me zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare të këtij vendi të vogël në sipërfaqe, por me famë të madhe për pozicionin strategjik që natyra i kishte falur.

Në periudha të ndryshme kjo prani e huaj jo vetëm që ka qenë e ndryshme në pikëpamje kombësie, por edhe ka ndikuar në aspekte të caktuara të jetës shqiptare. Herë i ka dhënë jetë bëmave të shqiptarëve në vargje të shkruara nga pena jo të parëndësishme evropiane, herë u ka dhënë emër shqiptarëve falë historive të shkruara për ta, herë e ka hedhur në letër atë që syri e ka parë në këtë qoshe evropiane të fshehur mes malesh.

Në të tjera raste ka qenë ajo që ka ngritur zërin për të ndërgjegjësuar opinionin publik të përtej kufijve shqiptare se aty, në breg të Adriatikut dhe Jonit, jeton një komb që mundi t'u mbijetojë sfidave historike dhe që ruan një thesar vlerash kulturore të padiskutueshme.

Ka mjaft aspekte jetike të cilat në vetevete mbartin thelbin e kulturës shqiptare gjatë periudhës së viteve 1921 - 1939. Si të tilla, shkrimet ku ky thelb gjen veten të përshkruar me hollësi, përbëjnë një provë e cila ia vlen të merret parasysh në studimin e kësaj pjese të historisë shqiptare. Duke dashur të kapim ndihmesën e atyre shkrimtarëve që u përpoqën ta pasqyronin realitetin shqiptar ashtu siç e përjetuan ata vetë, ky punim do të plotësojë atë periudhë të historisë sonë, për të cilën ne jemi aktualisht ende të paaftë të flasim qartë. Pavarësisht se nuk bën një analizë të drejtpërdrejtë të jetës shqiptare, kjo e fundit bëhet e mundur me anë të informacionit të marrë nga mënyra

se si kanë reaguar në periudha të caktuara shkrimtarë anglezë ndaj realitetit shqiptar të viteve 1921-1939. Një histori e treguar nga njerëz që e jetuan realitetin shqiptar të viteve 1921-1939 dhe që nuk kishin lidhje të drejtpërdrejta me personat që e bënin politikën shqiptare, është një vlerësim që nuk duhet anashkaluar. Ai paraqet, në pjesën më të madhe të rasteve, një fokus të qartë të qëndrimit që duhet mbajtur për ngjarje të caktuara historike apo për zhvillime shoqërore që i përkasin kësaj periudhe.

Shqyrtimi i materialeve mbi të cilat bazohet ky punim paraqet një fond më të gjerë njohurish rreth kësaj periudhe duke qenë se pjesa më e madhe e materialeve janë botuar në Britaninë e Madhe dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ato janë të shkruara në anglisht dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre është përkthyer deri më sot në gjuhën shqipe. Shkrimet i përkasin një periudhe të hershme të shekullit të kaluar dhe librat e udhëtimit janë të gjithë të botuar në dekadën e tretë dhe të katërt dhe nuk janë ribotuar më vonë në asnjërin prej shteteve. Përshkrimet janë të shoqëruar me foto, skica dhe harta të bëra nga vetë autorët gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri në periudhën në fjalë. Në këtë këndvështrim ato përbëjnë një burim informacioni ende të patrajtuar nga historiografia shqiptare dhe shërben për të thelluar njohuritë dhe për të shtuar numrin e të dhënave faktike e objektive rreth zhvillimeve historike të viteve 1920-1939, për të zgjeruar fokusin e gjykimit rreth kësaj periudhe kaq shumë të përfolur të historisë shqiptare dhe për të rritur interesin për studime të mëtejshme në fushat e sociologjisë historike, etnografisë, antropologjisë, historisë dhe shkencës së ekonomisë.

Personat që shkruan për Shqipërinë e viteve 1921-1939, i përkisnin dy kombësive krejt të ndryshme nga ajo e shqiptarëve; ata e njihnin pak për këtë vend të Adriatikut dhe erdhën në Shqipëri me dëshirën për të mësuar më shumë, për të përjetuar diçka nga bota imagjinare me të cilën rrethohej jeta e shqiptarëve në shkrimet me karakter publicitar që ishin shkruar deri atëherë në shtypin dhe letërsinë britanike dhe amerikane. Kurioziteti për të gjetur domethënien e thesareve kulturore të fshehura nën varfërinë dhe prapambetjen e skajshme shqiptare i nxiti të vizitonin Shqipërinë dhe të përjetonin ndjenja që qytetërimi i zhvilluar perëndimor dhe ai përtej oqeanit kishte kohë që i kishte lënë pas.

Këto shkrime i përkasin kategorisë së shkrimtarëve romantikë që ndoqën rrugën e Bajronit një shekull më parë  në mënyrën se si e lartësuan karakterin e shqiptarëve dhe e përshkruan me penelata pozitive traditën e ngulitur prej shekujsh në veri të Shqipërisë. Emrat që përmenden aty janë të shumtë. Disa prej tyre, si Edit Durham (Edith Durham) dhe Obrei Herbert (Aubrey Herbert), janë të përmendur edhe më parë falë ndihmesës që kishin dhënë për Shqipërinë më herët në historinë e saj. Një pjesë tjetër, si Hari Fulc (Harry Fultz), Xhozef Suaiër (Joseph Swire), Edvin Xhaks (Edwin Jacques), gjeneral Ualter Stirling (Walter P. Stirling), Margaret Heslak (Margaret Hasluck), Roz Lein (Rose Lane), janë emra të njohur falë ndihmesës që i dhanë jetës shqiptare në këtë periudhë. Shumica përmenden për herë të parë duke qenë se i përkasin kategorisë së udhëtarëve dhe gazetarëve që e vizituan Shqipërinë gjatë këtyre dy dekadave për të shuar kuriozitetin e tyre dhe atë të publikut britanik dhe amerikan. Këtu lista zgjatet dhe në të mund të përmenden dhe Ian dhe Kora Gordon (Jan- Cora Gordon)-1927 , Pol Edmonds (Paul Edmonds) -1927, kolonel P.H.H. Mesi (Colonel P.H.H. Massy) – 1928, P.T. Etherton dhe Alen Danskombe (P.T.Etherton – Allen A. Dunscombe)-1928,

Izabel Anderson (Isabel Anderson)-1931, Baron M.D.A.R. von Redlish (Baron M.D.A.R von Redlich) -1935, Theodora Benson -1935, Roland Methjus (Roland Matthews) -1937, Henri Berlain (Henry Baerlein) -1941), Albert H. Laibaiër (Albert H. Lybyer), Melvail Çartër (Melville Charter), Xheims A. Mills (James A. Mills), Xhei Franklin (Jay Franklin). Librat e tjerë të shkruara i përkasin kategorisë së personave që nuk kanë dashur thjesht të përshkruanin realitetin shqiptar, por edhe ta analizonin atë dhe të shprehin përsiatje historike dhe studime në rang akademik dhe diplomatik për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare, artikuj mediatikë dhe përmbledhje dokumentacioni politik të arkivuar. Këtu mund të përmenden: Xhosef S. Rousek, Xheims Streçei Barns, Isaiah Bouman, Dadli Hethcot, Karleton Kun (Carleton Coon), Bernard Njuman, Vandelëur Robinson (Vandeleur Robinson), Nigel Hezeltain (Nigel Heseltine), Darell Okli-Hill (Dayrell Oakley- Hill), Eduard A. Akerman (Edward A. Ackerman) dhe Maksuel Bleik (Maxwell Blake).

Në këtë këndvështrim mendimet që Edvin Xhaks, Xhozef Suaiër, Vandelër Robinson, Baroni von Redlik, Karleton Kun, Isaiah Boumen, Roland Metius, Xheims S. Barns dhe Xhozef Rousek hodhën në veprat e tyre për Shqipërinë, marrin karakter më të pjekur, më afër një gjykimi të ftohtë të çështjes shqiptare. Ata shkruan paraprakisht faqe të tëra për historinë e kaluar të popullit shqiptar, në mënyrë që lexuesit e librave të tyre të krijonin idenë e duhur për mënyrën sesi historia kishte ndikuar në formimin e karakterit shqiptar.

Nga ana tjetër, lartësimi i fakteve dhe provave për origjinën e hershme të popullit dhe gjuhës shqipe, i periudhave të arta në drejtimin e Skënderbeut dhe famës së Ali Pashë Tepelenës, përshkrimi i detajuar i përçapjeve të Ismail Qemalit dhe i Luftës së Vlorës në vitin 1920, krijojnë një tablo plot ngjyra. Së pari, kjo i jep lexuesit të huaj mundësinë të kuptojë se Shqipëria në të vërtetë kishte pasur edhe momentet e veta në të cilat kishte shfaqur vlerat të qenësishme. Së dyti, ky album figurash të larmishme dhe ngjarjesh të lavdishme duhej t'i nxiste shqiptarët e viteve 1920 të gjenin forcën të zgjoheshin dhe të kuptonin se atë për të cilën breza të tërë para tyre kishin luftuar me aq zell, *lirinë*, ata e kishin fituar tashmë. Nga shqiptarët e atyre viteve kërkohej të kapnin ritmin me të cilin qytetërimi evropian dhe më gjerë po ecte prej shekujsh dhe të kuptonin se krenaria për të kaluarën historike nuk duhej t'i kalonte caqet e të qenit një burim frymëzimi për të ecur përpara. Kjo sepse nuk kishte më kohë që shqiptarët të sakrifikonin të tashmen dhe të vinin në rrezik të ardhmen e tyre thjesht sepse nuk hiqnin dot dorë nga disa prej elementeve të traditës, të cilave edhe në Shqipëri dukej se u kishte kaluar koha.

Shtjellimet e ndikimit që elemente të caktuara të traditës kishin në jetën e popullit shqiptar paraqiten më pranë realitetit në librat e udhëtimeve të shkruara nga Nigel Hezeltain, Bernard Njuman, Darrel Okli-Hill, Teodora Benson, P. Ethërton, D. Allen dhe Henri Barlein. Autorët e vlerësuan traditën dhe vlerat me të cilat ajo e ndihmonte një komb të ruante tiparet bazë të identitetit të tij nga brezi në brez, megjithatë ata nuk ndruhen të theksojnë se disa elemente të ngulitura të traditës shqiptare duheshin ndryshuar për hir të ecjes përpara dhe zhvillimit. Hezëltain, për shembull, nuk ngurron të fajësojë hapur gjakmarrjen si një ndër elementet bazë të prapambetjes ekonomike të Shqipërisë të Veriut. Duke e ulur atë nga piedestali i vlerave që e bënin malësorin të ndihej krenar, autori e analizoi gjakmarrjen jo si një ligj që rregullonte marrëdhëniet mes palëve të përfshira për të shpëtuar nderin, por si një

mënyrë që e privonte malësorin nga mundësia për të zhvilluar ekonominë e tij familjare. Malësorët e ngujuar nuk kishin mundësi të punonin tokat e tyre, të dilnin për të tregëtuar mallrat e konsumit të përditshëm dhe as të bënin përçapje për të krijuar ekonomi të vogla private. Kuadri i Ligjit të Lekës mundësonte në mënyrë të prerë dhe të çuditshme bashkërendimin e marrëdhënieve ekonomike midis familjeve, mëhallëve, fshatrave dhe fiseve aty ku mungonte çdo ligj tjetër unifikues. Megjithatë ai nuk përkrahte ndryshimet ekonomike që Shqipëria po përjetonte në vitet 1930; ai vazhdoi të ishte një mburojë e ngurrtë që izolonte jetën malësore edhe që u priste rrugën sipërmarrjeve private në këtë pjesë të Shqipërisë. Kjo krijonte një zinxhir hallkash të karakterit shoqëror dhe ekonomik që mbeteshin pjesë e prapambetjes në statusin e femrës në shoqërinë shqiptare, të elementëve të pazakontë në trajtimin fizik dhe shoqëror të virgjëreshave të betuara dhe të fejesave në djep - një mekanizëm rregullator për krijimin e lidhjeve shoqërore të cilat i mungonin shoqërisë gege për shkak të tipareve gjeografike, mungesës së infrastrukturës së nevojshme dhe cakut të vogël brenda të cilit malësori organizonte jetën e tij familjare.

Tipare si këto janë karakterizuese dhe përdoren nga studiuesit si përfaqësues domethënës të identitetit kombëtar shqiptar. Pikëpamjet e tyre në këtë fushë bashkohen në një pikë, në atë që pavarësisht homogjenitetit të lartë të popullsisë shqiptare, në jetën reale Shqipëria paraqitej si një vend kontrastesh. Në shkrimet e viteve 1920, vëmendja më e madhe u kushtohet tipareve të karakterit të shqiptarëve, mjeteve me të cilat siguronin jetesën dhe ligjeve me të cilat menaxhonin marrëdhëniet e tyre shoqërore. Por për shkak të mungesës së vazhdueshme të strukturave kombëtare që duhej të rregullonin jetën politike dhe shoqërore të një kombi, jetët e gegëve dhe të toskëve ishin vendosur në trase të ndryshme zhvillimi (i cili deri në mes të viteve 1920 nuk i kishte kaluar caqet e prapambetjes për të dy grupet). Shkaku kryesor i kësaj ndarjeje është gjykuar strategjia e ndjekur nga sundimi turk që izoloi tiparet fetare duke u dhënë poste prestigji atyre që pranonin fenë myslimane. Së bashku me dallimet fetare që shoqëronin elementin geg dhe tosk, kjo përbënte këndvështrimin kryesor nën të cilin marrëdhëniet midis Veriut dhe Jugut të Shqipërisë u analizuan nga studiuesit, sociologët dhe historianët anglezë gjatë dekadës së tretë të shekullit XX.

Në shkrimet e mëvonshme, të cilat i përkasin botimeve dhe analizave të viteve 1930, termat e mësipërm krahinorë ia lënë vendin një këndvështrimi më përgjithësues dhe më njësues në aspektin kombëtar. Dallimet dialektore të diktuara nga relievi dhe fanatizmi me të cilin shqiptarët e zonave të ndryshme e ruanin trashëgiminë kulturore ia lënë vendin pak nga pak politikave më gjithëpërfshirëse që ndërmori qeveria shqiptare gjatë periudhës së monarkisë.

Ngjarjet politike, zhvillimet ekonomike, ndryshimet fizike të qyteteve kryesore dhe shtrirja e ndikimit italian zënë vendin kryesor në shkrimet e kësaj periudhe. Këndvështrimet e realiteve gege dhe toske, deri atëherë të skalitura nga zhvillimet historike dhe ato gjeografike, njësohen në një karakter më të nënshtruar ndaj qeverisjes qëndrore. Shqiptari i shkrimeve të kësaj periudhe përpiqet ta njësojë veshjen e vet me tipare më evropiane; pavarësisht përkatësisë dialektore preferon të shkollojë fëmijët në shkolla të huaja dhe shqiptare në qendër të Shqipërisë dhe, megjithëse kishte jetuar prej vitesh në Amerikë nuk ngurroi të kthehej si një shqiptar me mendje të

ndriçuar në Shqipëri. Në këto përshkrime shqiptarët paraqiten me tipare më kombëtare, jetesa e tyre përshkruhet më pranë elementëve të qytetërimit evropian dhe dallimet fetare ia lënë vendin shpjegimit të masave që qeveria e Mbretit Zog ndërmori sidomos në institucionalizimin e fesë dhe njësimin e sistemit arsimor mbi bazat e identitetit kombëtar.

Kjo ishte mesa duket arritje e qeverisjes shqiptare dhe e ndërmarrjes më serioze për të kuptuar thelbin e asaj historie që u përshkrua më sipër të cilën vetëm një komb si shqiptarët mund ta kenë jetuar. Prandaj dhe në fund të përshkrimeve të tyre të gjithë shkrimtarët e gjejnë pak vend për të shkruar dy apo disa rreshta të ngjashëm si këta që shkroi Darell Oakli-Hill, në librin e tij:

"*Pavarësisht gjithë ndryshimeve, shqiptarët janë një popull. Në daç cucat e veriut dhe gratë në sallat e ballove në jug; në daç fshatarët e veshur me rrobat e tyre më të mira në rrugët e Tiranës gjatë një feste kombëtare; në daç xhandarët dhe zyrtarët. Ata të gjithë flasin shqip dhe janë krenarë për këtë gjë. (….) Unë kam njohur shumë shqiptarë; kam punuar me shumë të tjerë dhe kam bërë mjaft miq midis tyre. Nuk ka qoftë edhe një që nuk do të thoshte "Unë jam shqiptar; më lehtë më merr jetën se vendin tim*." (Oakley-Hill, 2002, p.101)

Në këtë kuadër mund të bëhet edhe një përqasje sociolinguistike e gjuhës shqipe, funksionit të saj komunikues brenda vendit, dallimet dialektore dhe përshtatjet fonetike, gramatikore dhe leksikore të fjalëve shqipe të përdorura në tekstet e shkruara në anglisht si një përpjekje për t'i përcjellë lexuesit të huaj një realitet sa më afër realitetit shqiptar. Burimet e literaturës për materialet e sipërpërmendura, përbëjnë një provë shumë të mirë e asaj përpjekje ndërkulturore që kanë qeniet njerëzore për të kuptuar.

Në rastin e përplasjes së realiteteve shumë të ndryshme si ai i Shqipërisë dhe pjesës tjetër të kontinentit në fillimin e shekullit XX, nevoja për të bërë të ditur atë copëz kulture që i jep një kombi qenësinë, bëhet edhe më interesante. Fjalët dhe shprehjet e mësipërme mund të përbëjnë një bazë të mirë për studime gjuhësore, etnolinguistike, historike madje dhe antropologjike për të kuptuar atë lidhje të veçantë që bashkon shoqërinë, kulturën dhe gjuhën. Kjo, sepse ndryshimi në kohë dhe hapësirë i dy të parave pasqyrohet drejtpërdrejt tek gjuha dhe janë lidhjet gjuhësore si ato që u përmendën më sipër, ato që bëhen shprehje e drejtpërdrejtë e të kuptuarit shoqëror të një kombi.

Këndvështrimet e shkrimtarëve anglezë bashkohen edhe në lidhje me dy prej pjesëve përbërëse të shoqërisë shqiptare përkatësisht, familjen dhe bashkëjetesën e besimeve fetare, si dy elemente të qenësishme të lidhjeve midis brezave dhe besimeve në Shqipëri. Koncepti i familjes zbërthehet më tej në bashkëjetesën e brezave dhe parimet që rregullonin marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, bashkëshortëve dhe pozicionin e femrës në to. Aty paraqiten karakteristika të veçanta të marrëveshjeve mes krushqive dhe asaj që qëndronte në bazë të mblesërive si kontrata që i tejkalonin caqet e lidhjeve sentimentale brenda kurorës.

Pa bërë paragjykime a shprehur hapur qëndrimet e tyre në këtë aspekt ata u përpoqën të qëndronin asnjanës, por nuk i shpëtuan dot tundimit për të shprehur habinë ndaj tipareve të veçanta që reflektoheshin në mënyrën se si gruaja e çonte jetën e saj në Shqipëri, se si burri ushtronte pushtetin e tij shekullor mbi gruan si subjekt të vetin, dhe se si tiparet e

një shoqërie patriarkale pasqyroheshin qartë në ritet e gëzimeve dhe hidhërimeve tek shqiptarët si dhe ç'kuptim merrnin poligamia dhe levirati në Shqipëri. Nigel Heseltain e komentoi si vijon gjendjen e femrës në familjen dhe shoqërinë shqipare : "*Ishte lloji i shoqërisë ku gratë nuk gëzonin asnjë lloj pushteti, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë; ato nuk kishin pushtet mbi burrat, ligjërisht dhe as politikisht, dhe as mund t'u afroheshin institucioneve që kishin për detyrë ta ngrinin lart zërin në ndihmë të tyre. (…) Ndoshta, si të burgosura që ishin, gratë nuk do t'i ishin përkulur kaq gjatë pushtetit të burrave. Ajo që i mbante kokëulur ishin tabutë e forta fetare. Edhe në rast se femrat mund t'u bënin rezistencë meshkujve, ato nuk do të guxonin në asnjë rast t'i kundërviheshin Zotit*." (Heseltine, 1938, pp.158-159)

Në fillim të shekullit XX Shqipëria vazhdonte të ruante ende lidhje familjare të vendosura nga shekuj të tëra patriarkalizmi. Marrëdhëniet midis anëtarëve të një familjeje shqiptare ishin të ndryshme nga veriu në jug të vendit. Në këtë këndvështrim përshkrimi që u bëhet familjeve shqiptare nuk përgjithësohet si një model i vetëm shqiptar. Pavarësisht se toskët përshkruhen më pak dhe afritë e gjakut midis tyre bien në sy vetëm pas reformave për ndryshim që ndërmori qeverisja e Ahmet Zogut pas vitit 1929, lidhjet në familjet toske përshkruhen si të ndryshme nga ato të gegëve. Në faqe të tëra shkrimesh modeli i jetesës së këtyre të fundit përshkruhet me hollësi dhe detajet mbi mënyrën e ndarjes së punëve në familje e rolit që i kushtohej nderit të femrës nuk mungojnë asnjëherë.

Në këtë kuadër, qeveria e tij finalizoi përpjeket që kishin filluar në fillim të viteve '20 për krijimin e institucioneve fetare që do të funksiononin pavarësisht ndikimit të simotrave të tyre në shtetet fqinje. Në historinë e Shqipërisë feja ishte përdorur për një kohë të gjatë si mjet për të dëmtuar bashkimin dhe kombësinë mes shqiptarëve. Këtë e kishte bërë perandoria turke gjatë gjithë periudhës së sundimit të saj , sepse duke e lidhur përkatësinë fetare me pozitat shoqërore dhe ekonomike të shqiptarëve, ajo kishte mundur të krijonte një varësi të drejtpërdrejtë mes besimit fetar dhe statusit shoqëror dhe ekonomik të një individi.

Në vitin 1930 parlamenti e shpalli Shqipërinë vend josektar "gjë e cila i jepte shtetit të drejtën e kontrollit mbi komunitetet fetare dhe (...) kërkonte që drejtuesit fetarë, vartësit e tyre të drejtpërdrejtë ipeshkvijtë dhe famullitarët e tyre, të ishin me prejardhje shqiptare dhe të flisnin gjuhën shqipe." (Fisher, 2004, p.169) Në këtë kuadër në Shqipëri u krijua një atmosferë e favorshme për rimëkëmbjen e komunitetit bektashi, iu dha një miratim i heshtur ekzistencës së një komuniteti uniatësh në Elbasan dhe u lejuan predikimet dhe botimet e shkrimeve të shenjta të përkthyera në shqip nga misionarët protestantë. Megjithatë këto të fundit nuk mundën të fitonin status të plotë ligjor në Shqipëri që do t'u siguronte edhe përkrahjen e qeverisë.

Mendimi që i bashkon autorët që shkruan për fenë është se feja dhe kombi nuk ishin sinonime të njëra-tjetrës në Shqipëri. Përçarja fetare ndihej vetëm në personat që dëshironin të ruanin pozita të trashëguara në administratën shqiptare. Në jetën e përditshme shqiptari i cilitdo besim nuk e kishte zakon t'i mohonte mikpritjen një tjetër shqiptari dhe, megjithëse i trembej fjalës së zotit në predikimet e kishës së tij, nuk mund ta vinte atë para nderit dhe besës. Ai kishte ditur t'i ndërthurte elementët e besimit pagan të parardhësve të largët me simbolikën e tij fetare dhe në përgjithësi besonte në një zot më shqiptar.

Kabinetet qeveritare të viteve 1930 morën disa nisma për rimëkëmbjen e vendit dhe për luftën kundër prapambetjes. Gjykimet rreth rezultateve pozitive apo pasojave negative me të cilat ato u shoqëruan janë të ndryshme. Në këtë pikë kritikët e mënyrës se si Ahmet Zogu ia doli të organizonte jetën politike dhe shoqërore të Shqipërisë ndryshojnë në varësi të lidhjes që hartuesit e tyre patën me institucionet qeveritare në Shqipëri në atë kohë dhe përkatësisht me vetë Mbretin Zog. Megjithatë të gjithë janë të mendimit se nëse kishte një mendim qeveritar në Shqipëri, ai projektohej në zyrat e Pallatit Mbretëror. Qeveria ishte e centralizuar në duart e Mbretit dhe lëvizjet e administratës, vendimet e parlamentit apo hartimi i strategjive ekonomike dhe legjislative viheshin në jetë vetëm pas miratimit të tij. Në këtë aspekt, mënyra e qeverisjes pati të mirat e veta sipas disa autorëve, duke qenë se parashtroi të njëjtat dispozita rregullatore në të gjithë vendin dhe kërkoi nga të gjithë shtetasit që t'i bindeshin të njëjtit ligj në Shqipëri, pavarësisht përkatësisë së tyre gjeografike.

Sipas këtij këndvështrimi gjatë viteve '30 në Shqipëri kishte një Qeveri të Tiranës që menaxhonte jetën politike të të gjithë Shqipërisë dhe që, pavarësisht mjeteve të përdorura, krijoi tek shtetasit shqiptarë idenë e të qenin subjekte të të njëjtës qeveri qëndrore. Ai e ngriti idenë e shtetit mbi kufijtë krahinorë, i dha fund disa prej shqetësimeve të jetës shqiptare që vinin si pasojë e pavarësisë së tepruar të fiseve malësore; u përpoq të çarmatoste popullsinë në veri të Shqipërisë në një kohë kur kjo ende rrezikohej nga kërcënimet aneksioniste të shteteve fqinjë dhe uli në këtë mënyrë shifrat e krimeve që kryeshin për kusari, rebelimin dhe numrin e vrasjeve për gjakmarrje. Pak nga pak ideja e të qenit anëtar i një fisi ia la vendin ndërgjegjësimit se shteti shqiptar nuk ishte një ishull i vogël i menaxhuar nga bajraktari apo beu i krahinës. Për këtë arsye kritikat rreth faktit që Ahmet Zogu përdori mjete të vjetra për të venë në jetë reforma të reja, i zbuti këndvështrimi i disa historianëve të cilët arritën në përfundimin se vetëm në këtë mënyrë shteti do të mund të largonte vëmendjen nga grindjet individuale mes krahinave, feve dhe shtresëzimeve shoqërore dhe do ta hidhte shikimin në hartimin e strategjive të zhvillimit ekonomik. Administrata e Zogut ia doli deri në një farë mase të unifikonte shtetin shqiptar dhe t'i mbante kufijtë shqiptarë larg pikësynimeve gjithpërfshirëse të fqinjëve të saj. (Vickers, 2001, p.136)

Ahmet Zogu donte të mbretëronte në monarki të qytetëruar, perëndimore dhe të pavarur, megjithatë nuk ia doli të largonte dritëshkurtësinë dhe egoizmin që karakterizonte politikën shqiptare prej vitesh. Reformat shumë të nevojshme për ekonominë shqiptare kërkonin një përmbysje të rendit shoqëror në Shqipëri, por ai nuk guxoi ta prekte këtë të fundit, për sa kohë që ai përbënte faktorin që e kishte mbështetur të vinte në pushtet dhe që e ndihmoi të qëndronte në krye të shtetit shqiptar për më shumë se 10 vjet. Ai hartoi një Reformë Agrare e cila synonte të krijonte hapësirat e punës private dhe iniciativën vetjake në bujqësi, si një ndër premisat kryesore të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Megjithëse reforma u nis dhe gjeti përkrahje në shtresat e ulta të popullsisë vendase, ajo nuk mundi kurrë të vihej plotësisht në jetë. Botëkuptimi i pronarëve të mëdhenj të tokave, të ngulitur prej shekujsh në pronat e tyre, kishte çmim të lartë dhe qeveria shqiptare nuk kishte as mjetet financiare dhe as pushtetin e duhur administrativ për ta ndryshuar këtë. Për më tepër asaj i munguan vazhdimisht njerëzit e duhur për t'i vënë në jetë reformat e domosdoshme

për zhvillimin ekonomik të vendit. Mbreti fajësonte shpesh, nëpër intervista apo biseda private me diplomatët britanikë dhe amerikanë, faktin që ai ishte i rrethuar nga njerëz me mentalitet të vjetër, me botëkuptim të ngushtë dhe pa arsimin e duhur. Ai justifikohej se i ishte dashur t'i mbante në detyrë sepse ishin të vetmit që mund të menaxhonin situatën shoqërore në fushat përkatëse të zhvillimit duke qenë se njihnin mentalitetin e nënshtetasve të tyre. Me një fjalë, kritikët anglezë janë të mendimit se varësia ekonomike nga Italia, korrupsioni (të cilit A.Zogu nuk mundi t'i jepte fund asnjëherë), shmangia e individëve të shkolluar dhe inteligjentë nga kabinetet e qeverisë dhe mosdashja për të vënë dorë në rendin shoqëror shqiptar ishin faktorët që krijuan një rreth vicioz vetëkënaqësie në rang politik. Kjo e shndërroi pak nga pak monarkinë në një diktaturë të moderuar si një mjet për të ruajtur pozita të qëndrueshme, në një vend ku lëkundjet politike kishin shkaktuar tërmete të fuqishme. Vetë A.Zogu ia doli të qeveriste për një periudhë jo të shkurtër dhe njëkohësisht u krijoi mundësinë sistemeve të mëvonshme qeveritare të vepronin në një truall me identitet kombëtar tashmë të kalitur.

Vitet që pasuan për Shqipërinë ishin po aq të vështira sa edhe historia e këtij populli të vogël. Kjo tërhoqi vëmendjen e botës me unikalitetin me të cilin e zhvillonte ngjarjet brenda territorit shqiptar dhe mënyrës se si ajo ndikonte në lidhjet ndërkombëtare që vendoste me shtetet e tjera.

Gjithsesi periudha e viteve 1921-1939 mbetet një prej periudhave më të diskutuara të historiografisë shqiptare, gjykimi mbi të cilën është bërë në këtë dekadën e fundit objekt studimi për shumë historianë të mirëfilltë shqiptarë dhe të huaj. Ajo nuk është lehtësisht e analizueshme dhe personat, apo ngjarjet në të cilat ata vendosen, nuk mund të gjykohen në mënyrë të prerë dhe as të pavarur nga situata kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilën ato u zhvilluan. Shumë prej dukurive historike erdhën si pasojë e një mendësie shekullore që ishte e pamundur të ndryshohej brenda dy dekadash. Megjithëse ajo që në përgjithësi klasifikohet si element i traditës së një populli, kulturës dhe mentalitetit të tij, në Shqipëri vazhdoi të kishte po atë domethënie botëkuptimi që kishte pasur të paktën gjatë gjithë shekullit pararendës, të tjerë elementë u lindën dhe u gjallëruan dhe ndoshta nëse do të kishin pasur kohën e mjaftueshme edhe do ta kishin ripërtërië jetën shoqërore shqiptare.

Shqipëria e viteve 1921-1939 nuk ka qenë gjithmonë e përbaltur, e pluhurosur, e zhytur në padituri dhe mjerim, ashtu siç mund të kenë krijuar idenë shumë prej brezave të shkolluar në Shqipëri gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Shumë pak prej tyre mund të kenë ditur që në vitet '30 në Shqipëri funksiononte një linjë ajrore që lidhte qytetet kryesore të vendit dhe që Reforma Agrare synonte një ndryshim të koncepteve "pronar toke" dhe "bujk" duke i shkëputur kufizimet e varësisë që i kishin mbajtur këta të fundit të lidhur me konceptin "argat"; që projektet për tharjen e kënetës së Maliqit filluan që në vitet '30; që të rinjtë shqiptarë trajnoheshin dhe zhvillonin botëkuptimin për të ardhmen e tyre në shkolla shumë të mira profesionale në disa rrethe të Shqipërisë dhe organizonin veprimtari bojskautësh për djem dhe vajza; që Shqipëria kishte një shoqëri për mbrojtjen e kafshëve, një klub modest tenisi dhe organizonte një ligë kombëtare futbolli; që Shqipëria ishte vendi që hapi dyert dhe u bë strehë për çifutët e dëbuar nga Gjermania, kishte një komunitet uniatësh dhe mirëpriti edhe një tjetër protestantësh; që figurat politike si Faik Konica, Mehdi Frashëri dhe Pandeli

Vangjeli e dalluan veten nga mediokriteti i pjesës tjetër të politikanëve të kohës; që diplomacia politike e Fan Nolit nuk shkëlqeu si erudicioni i tij letrar, fetar dhe muzikor dhe së fundmi, që Pallati Mbretëror shqiptar paraqeste me modesti luksin e mobiljeve, veshjeve dhe bizhuve të firmave të njohura evropiane nëpër ballot e shpeshta plot dritë dhe pije të shtrenjta që organizonte.

Këto, dhe fakte të tjera gjenden nëpër faqet e librave të shumtë të shkruar gjatë këtyre viteve dhe për këto vite nga ata që e vizituan, që u përpoqën ta kuptonin dhe kur ia arritën dëshiruan të ndanin atë që mësuan me botën mbarë. Në këtë këndvështrim ky punim synon të sjellë gjykimet e tyre të pastra në lidhje me zhvillimet shqiptare të kohës, sa të përshtatshme ishin ato me situatën mbi të cilën u ndërtuan dhe si të tilla, çfarë gjasa kishin për të qenë të suksesshme.

Punimi synon gjithashtu të japë kontributin e vet modest në rindërtimin e imazhit që shtetasit shqiptarë të sotëm kanë për Shqipërinë e viteve 1920-1939, për personat që ndikuan në jetën e saj politike dhe ecuritë të saj ekonomike. Kjo e bën më të qartë vizionin që një komb krijon rreth vetes. Ne mund ta kuptojmë më mirë të qenin tonë shqiptarë falë mënyrës se si na shohin të tjerët (Misha, 2008, p.158). Kjo na jep atë lloj objektiviteti i cili është shumë i vështirë të arrihet në përshkrime që nuk i shpëtojnë subjektivitetit. Kjo ndoshta do të na ndihmojë ta njohim veten, të kuptojmë mbrujtjen tonë historike dhe në këtë mënyrë, të mund të krijojmë një vizion për të ardhmen.

Informacioni që u paraqit në këtë studim pikturon një tablo më me ngjyra për këtë periudhë të historisë shqiptare dhe meqenëse penelat që hodhën dritë në të nuk i përkisnin së njëjtës dorë dhe as të njëjtës kombësi me ata që e kishin pikturuar më parë, imazhi i saj nuk është më thjesht një shëmbylltyrë e së vërtetës, por një pasqyrim që ngjall ndjesi, perceptime dhe gjykime reale në lidhje me atë që ka ndodhur në të vërtetë në Shqipëri gjatë viteve 1921-1939.

**BIBLIOGRAFI**


Anderson, Isabell (1931). *A Yacht in Mediterranean Seas.* London: Joiner & Steel LTD

Baerlein, Henry (1941). *Travels without a Passport*. London: Frederic Muller. LTD

Benson, Theodora ( 1935). *The Unambitious Journey*. London: Chapman and Hall

Bercovici, Konrad (1932). *The Incredible Balkans*. New York: G.P. Putnam's Sons

Bernstein, Herman. & Grant, Hugh G. (1994). *Dy Diplomatë Amerikanë për Mbretin Zog.* Tiranë: Dardania

Bowman, Isaiah ( 1928). *The New World: Problems in Political Geography*. New York: Yonkers-on-Hudson

Coon, Carleton S. (1950). *The Mountains of Giants: A Racial and Cultural Study of the North Albanian Ghegs*. Massachusetts: Cambridge

Edmonds, Paul (1927). *To the Land of the Eagle*. London, George Routledge & Sons LTD.

Fischer, Bernd J. (2004). *Mbreti Zog dhe Perpjekja për Stabilitet në Shqipëri*. Tiranë:Çabej

10. Fodor, Marcel W. (1937). *Plot and Counterplot in central Europe*. Boston: Houghton – Mifflin

Gordon, Jan; Gordon, Cora (1927). *Two Vagabonds in Albania*. London: John Lane

Harvey, Oliver., Harvey, John (1970). *The Diplomatic Diaries of Oliver Harvey, 1937 -1940*. London: Collins
Hasluck, Margaret ( 2005). *Kanuni: Ligji i Pashkruar Shqiptar*. Tiranë: Lisitan
Heathcote, Dudley (1925). *My Wanderings in the Balkans.* London: Hutchinson & Co.
Heseltine, Nigel (1938). *Scarred background: A Journey through Albania*. London: Lovat Dickson Limited.
Lane, R.W., Boylston, H.D. & Holtz, W. (1983). *Travels with Zenobia: Paris to Albania by Model T Ford*. Columbia: University of Missouri Press
Lane, Rose W. (2004). *Majat e Shalës*. Tiranë: Argeta
Matthews, Ronald ( 1937). *Sons of the Eagle; Wanderings in Albania*. London: Methuen & Co.LTD.
Newman, Bernard. 1936. *Albanian back-door*. The University of California: H. Jenkins, limited
Oakley-Hill, Dayrell R. (2002). *An Englishman in Albania: Memories of a British Officer 1929-1955,* London: The Center for Albanian Studies
Ryan, Andrew (1951). *The Last of Dragomans*. London: Geoffrey Bles
Swire, Joseph ( 1937). *King Zog's Albania*. New York: Liveright Publishing Corporation
Vickers, Miranda ( 2001).*The Albanians: A Modern History,* London-New York: I.B. Tauris Publishers
Von Redlich, Marcellus D.A.R. (1935).*The Unconquered Albania*. U.S.A.: International Courier Publishing Company
Von Redlich, Marcellus D.A.R. (1936). *Albania Yesterday and Today*.Worcester: The Albanian Messenger

**Artikuj të botuar në gazeta dhe buletine shkencore**

Ackerman. Edward A.( 1938 ,October) "Albania- A Balkan Switzerland". *The Journal of Geography*, Vol. XXXVII, No.7, p. 253-262
Chater, Melville (1931). "Europe's Newest Kingdom: After Centuries of Struggle Albania at Last Enjoys an Era of Peace and Stability". *The National Geographic Magazine*, Vol. LIX, No 2,
Durham, Edith (1938, May 22)."The Albanian Language", *The Observer*.
Golding, Gauld (1938, 8 tetor). "Shqipëria e Mbretit Zog". *Gazeta e Korçës*, - përkthyer nga *Evening Standard*, 2 shtator 1938
Hasluck, Margaret (April, 1938). "The Gypsies of Albania", *Journal of the Gypsy Lore Society*, Vol. XVII, No.2, , p. 49-61.

# PSIKOLOGJIA E GRUAS NË PROCESIN E PLAKJES – NJË NGA SHQETËSIMET E VAZHDUESHME TË DORIS LESINGUT

**ERINDA PAPA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Në shoqërinë perëndimore, ku vëmendja sot është përqendruar kryesisht tek rëndësia e të qenit i ri, mosha e thyer shihet si "Tjetri", duke u harruar se është një fazë së cilës askush nuk mund t'i shpëtojë.

Qëllimi i këtij punimi është të shpalosë një nga temat më të diskutuara në prozën shoqërorpsikologjike të Doris Lesingut, si dhe një nga çështjet e para si "mollë e ndaluar" në kulturën perëndimore – pleqërinë.

Në punim tregohet se Lesingu beson që shoqëria e sheh këtë moshë si një sekret të turpshëm që nuk duhet të dalë në shesh. Vëmendja përqendrohet tek "Ditaret e Xhein Somersit", një vëllim në të cilin lexuesi përballet me semiotikën e moshës së tretë nga këndvështrimi i të riut dhe plakut. Shkrimtarja e bën shoqërinë fajtore për keqtrajtimin dhe shpërfilljen që i bën kësaj moshe.

Në besimin e Lesingut, përgjegjësia që secili prej nesh duhet të marrë për veten dhe të tjerët do të ndihmojë në vendosjen e drejtpeshimit shoqëror dhe vetjak aq shumë të nevojshëm dhe të dëshirueshëm për jetesën e shëndetshme të individëve.

**Fjalë çelës**: Doris *Lesingu, mosha e tretë, Xhein Somersi, përgjegjësi, drejtpeshim*

**Abstract**

In Western society, obsessed with youth and youthfulness, old age is considered to be *Other* – but it is also that which we must become.

It is the aim of this paper to present one of the most frequently encountered themes in Doris Lessing's fiction, but at the same time one of the issues considered to be a "forbidden subject" in Western culture, that of old age. We tend to show that D.Lessing believes the society looks upon old age as a kind of shameful secret that it is unseemly to mention. The arguments provided are supported by evidence taken from *The Diaries of Jane Sommers*, where the reader is faced with the semiotics of old age from the perspective of the young as well as the old. What the author is trying to emphasise is to make the society responsible for the maltreatment and the indifference shown to this age.

The responsabilities each of us must bear will undoubtedly contribute, according to Lessing's judment, to a shoqëror and personal life balance needed for the healthy existence of the individuals.

**Key words**: *Doris Lessing, old age, Jane Sommers, responsibility, balance*

Në mënyrën se si veprohet me ndërtimin e situatës shpirtërore të personazheve, proza e Lesingut doemos që ka shfrytëzuar elementet e pështjellimit, kaosit, shpërbërjes, apo turbullirës shpirtërore e mendore. Duke i këqyrur veprat e kësaj shkrimtareje, nuk mund të mos vëresh shkapërcimin nga e rregullta, koherentja, e plota, harmonikja tek gjendjet kaotike, rrëmuja, pështjellimi, ku e logjikshmja dhe e arsyeshmja zbehen apo mbulohen. E nën këtë vështrim, me të drejtë themi se kalimi nga një fazë tek tjetra në jetën e gruas përcillet me tensione dhe probleme. Të tilla janë kalimet nga mosha e pubertetit, në përvojat e para seksuale dhe më pas në menopauzë. Lesingu përcjell në prozën e saj edhe përjetimet e burrave gjatë procesit të plakjes, por në karahasim me ta, këto kapërcime tek gratë janë më vendimtare. Simon de Buvuar shprehet se "ndërkohë që mplakja tek meshkujt vjen gradualisht, gratë privohen menjëherë nga feminiteti i tyre" (De Beauvoir, 1989, p. 575)

***Semiotika e moshës tek "Ditaret e Xhein Somersit"***

Lesingu tek "Ditaret e Xhejn Somersit" (*The Diaries of Jane Somers*), zbulon revoltën e saj drejtuar mënyrës se si shoqëria e trajton gruan e moshuar. Këtë qëllim shkrimtarja nuk e shprehu hapur qysh në fillim të librit. Kjo është edhe një ndër arsyet pse vëllimi u botua nën pseudonimin e Xhejn Somersit, por i ndarë në dy romane të veçanta: "Ditari i një fqinji të mirë" (*The Diary of a Good Neighbour*) dhe "Nëse të moshuarit do të mund…" (*If the Old Could*…). Të dy romanet i paraqesin lexuesit mundësinë për të parë thellë në procesin e plakjes dhe në marrëdhëniet që vendosen me identitetin, feminitetin dhe trupin.

Rrëfimi bëhet në vetën e parë prej Xhejn Somersit, (Xhenës), "një vejushë e bukur, rreth të pesëdhjetave, me një punë të mirë në botën e revistave" (Lessing, 1985,p.17). Xhena detyrohet ta rishikojë edhe një herë jetën e saj kur takohet rastësisht me Moudi Follerin, një grua e moshuar, rreth të nëntëdhjetave. I shkruar në formën e ditarit, si një rrëfim shumë personal, vëllimi hedh dritë mbi varfërinë dhe vetminë e moshës së tretë. Tërbimi i Xhenës pas vdekjes së mikes së saj, ("Po pëlcas nga inati" (Lessing, 1985,p. 261), shprehet ajo) nxjerr në pah një sërë problemesh që lidhen me psikologjinë e gruas në procesin e plakjes. Shkrimtarja vë përballë dy gra të ndryshme, por me shqetësime të përbashkëta. Në prozën e Lesingut procesi i plakjes projektohet nga dy kënde të ndryshme vëzhgimi. Moudi shprehet se gruaja është relativisht e re kur humbet tërheqjen seksuale dhe aftësinë riprodhuese. Këta janë dy faktorë përcaktues për vlerën e gruas në shoqëri. Shoqëria tradicionale, mendon shkrimtarja, e vlerëson gruan për vlerën që mbart piktura e bukur, pra si objekt seksual, dhe nga ana tjetër për rolin që ajo përmbush brenda një kornize të paracktuar, si grua, bashkëshorte apo nënë. (Lessing, 1998, p.153) Sipas këtyre dy roleve, gratë tek Lesingu ndahen në dy grupe: në gra të bukura, për të cilat bukuria dhe kujdesi për të është qëllim në vetvete; dhe në gra të cilat kanë mohuar veten, janë vetësakrifikuar për t'u bërë bashkëshorte, shtëpiake apo nëna të mira.

Nën këtë këndvështrim, shpërthimi i Xhenës është shprehje e zemërimit moral përballë dështimit të qytetërimit për t'u kujdesur për moshën e tretë. Dorëshkrimi i Lesingut, fillimisht, nuk u mirëprit prej botuesve. Granada, një shtëpi botuese me emër në Londrën e viteve '70, refuzoi botimin e dorëshkrimit me shënimin: "një libër shumë i trishtë për t'u botuar". (Lessing, 1985, p.7) Ky shënim i përgjigjet jehonës që bëri botimi i S. De

Buvuarit "Seksi i dytë", ku ajo shpreh bindjen se mosha e pleqërisë është "një çështje e ndaluar" (De Beauvoir, 1989, p. 575). Libri i Lesingut është "i trishtë" sepse jo vetëm që e detyron lexuesin të hedhë sytë tek kjo moshë, por edhe i kujton se një ditë ai vetë (lexuesi) do ta përjetojë këtë periudhë.

"Ditaret e Xhejn Somersit" nxjerrin në pah të vërteta shqetësuese në lidhje me atë se si shoqëria i trajton njerëzit e moshuar. Shkrimtarja i mëshon idesë se në kultura të ndryshme mosha e tretë trajtohet ndryshe. I tillë është rasti i shitësit aziatik i cili i tregon Xhenës se njerëzit e tij nuk do ta braktisnin kurrë një të moshuar siç e braktisi Moudin familja e saj. I dukshëm është në këtë vëllim shqetësimi i shkrimtares për atë sesi faktorët shoqërorë dhe ekonomikë lënë gjurmë edhe tek kjo moshë. Tradicionalisht, gruaja në romanin e Lesingut është e varur materialisht dhe e vlerësuar fizikisht dhe shpirtërisht për rolin e saj si objekt admirimi apo brenda kornizës së paracaktuar shoqërore. E në këtë rol nuk mund të mos vëresh sesa e varur është ajo prej burrit. Pikërisht kjo varësi bën që kur gruaja t'i afrohet të pesëdhjetave, ta gjejë veten të rrethuar nga frika dhe ankthi se çfarë do të ndodhë me të tani që ajo po humb aftësinë fizike për të përmbushur rolin e saj. Xhena fillon dhe mendohet mbi pasojat që koha po lë dhe do të lerë tek ajo vetëm kur përballet me fqinjën e saj nëntëdhjetëvjeçare. Frika është e madhe kur Xhena përballet me stereotipinë e moshës së thyer: një grua e rrudhur, e kërrusur, e përçudnuar:

*"Sytë më zunë një shtrigë plakë. Po e shihja me ngulm këtë krijesë plakë dhe mendova: shtrigë. Kjo ndodhte sepse gjithë ditën e kalova duke menduar vetëm për një tipar, "Stereotipia e Grave, Atëherë dhe Tani".... Duhet të zgjidhja mes rreth dyzet fotografish. Ndërmjet tyre ishte edhe shtriga, por e anashkalova. Por ja tek është në farmaci, këtu pranë meje. Një grua thatanike, e kërrusur, me një hundë që thuajse i arrinte mjekrën, me rroba, më mirë një kapotë, të zezë e tërë pluhur."(Lessing, 1985, p.20)*

Mënyra si Xhena e fshin imazhin e gruas së moshuar nga kujtesa të sjell ndër mend përshkrimin që S. de Buvuari i bën moshës së tretë si "një lloj sekreti i turpshëm i cili nuk ka gjasa të përmendet".(De Beauvoir, 1989, p.575) Duke shëtitur rrugëve krah për krah me Moudin, Xhena fillon të kthjellohet: "Ishte si një lloj epifanie. Papritur vështroj rreth e rrotull dhe shoh – gra të moshuara. Edhe burra të moshuar, por kryesisht gra. *Nuk i kisha parë më parë*. Kjo për faktin *se frikësohesha mos ndoshta do të isha si ato*." (Lessing, 1985,p. 21)

Në shpërfilljen që Xhena u bën grave të moshuara fshihet qasja e një shoqërie indiferente ndaj këtij brezi. Në një artikull që ajo boton, Xhena thekson se "gruaja është e dukshme për sa kohë që ka aftësinë të riprodhojë. Vetëm disa javë më parë nuk më binte fare ndër mend për pleqtë"(Lessing, 1985, p.29). Indiferentizmi i shoqërisë ndaj moshës së thyer është në qendër të këtij vëllimi. Përdorimi i vetës së parë në rrëfim tregon dëshirën e Lesingut për ta "detyruar" lexuesin, ashtu siç ndodhi edhe me Xhenën, për t'i hedhur sytë tek kjo moshë, duke shpalosur në këtë mënyrë vizionin humanist të shkrimtares. Njerëzit i kthehen moshës së tretë vetëm kur fillojnë të vërejnë rrudhat në fytyrë, kurrizin e kërrusur, apo flokët e thinjur. Studiuesja Dajena Uollis arsyeton se janë pikërisht këto shenja që në mënyrë paradoksale e bëjnë sa të dukshme aq edhe të padukshme gruan e moshuar (Wallace, 2006, p.50). Njerëzit i kthejnë sytë tek gratë e moshuara kur vërejnë trupin e saj të vyshkur, vetëm prej frikës se koha do të lërë po këto gjurmë, në mënyrë të

pashmangshme edhe tek ata vetë. Nga ana tjetër një grua e tillë është një grua "pa vlerë", sepse nuk mund të plotësojë më rolin e saj. Kjo është edhe arsyeja pse shoqëria tregohet indiferente dhe shpërfillëse ndaj grave të moshës së tretë.

D. Lesingu e hap librin duke sfiduar mitin e kahershëm të lidhjes që ekziston mes moshës së thyer dhe vdekjes. Krahas përshkrimit që i bëhet Xhenës, lexuesi njihet edhe me vdekjen e të shoqit, i ravijëzuar jo shumë më i vjetër se Xhena vetë. Me mesazhin se vdekja mund të vijë në çdo kohë, shkrimtarja çel diskutimet në lidhje me semiotikën e moshës duke i mëshuar idesë se të gjitha moshat kanë diçka të përbashkët me pleqërinë. Për Lesingun shoqërimi që i bëhet moshës së tretë me konotacione negative si sëmundja, paaftësia fizike, dobësia, apo vdekja, është i gabuar. Në të vërtetë, për të, mitizimi që i bëhet pleqërisë si në aspektin pozitiv, edhe në atë negativ, nuk është i drejtë. (Marshall, 2007, p.100) Këtu ajo bashkohet me Bakhtinin i cili argumenton se stereotipitë e moshës, qofshin ato pozitive (pleqëria është e barabartë me mençurinë, urtësinë dhe përkushtimin), apo negative janë të njëanshme, sepse nënvlerësojnë aspekte të tjera të kësaj moshe (Berg, 1996, pp.15-26). E. R. Marshall argumenton se "Ditaret e Xhejn Somersit" duhet të lexohen "duke i kushtuar vëmendje individualitetit të çdo personi të moshuar, me qëllim që të vlerësohet mosha e tretë në tërësi". (Marshall, 2007, p.101)

Me qëllim, shkrimtarja te "Ditaret e Xhejn Somersit", u mëshon përjetimeve të tri grave të moshuara: Moudit, Enit dhe Elizës, si për të na treguar tri zgjedhje të ndryshme drejt njësimit psikologjik të moshës së tretë. Sa të ndryshme aq edhe të ngjashme, të tria gratë kanë bërë zgjedhje të ndryshme në periudhën kritike të pleqërisë. Që të tria e ndiejnë nevojën e kujdesjes dhe shoqërisë. Megjithatë, bazuar në kushtet shoqërore dhe fizike ato shpërfaqen si projektime të ndryshme të të njëjtit imazh. Eni ka zgjedhur ta lerë veten nën kujdesin dhe mëshirën e të tjerëve duke parapëlqyer këtë formë komunikimi dhe shoqërizimi të kushtëzuar prej mundësive fizike. Ndryshe nga ajo, Moudi, për shkak të rrethanave jetësore, nuk u beson njerëzve. Kjo është edhe arsyeja që vuajtjet e pleqërisë kanë lënë gjurmë të dukshme tek ajo. Nga ana tjetër, Eliza, pavarësisht se ka thuajse të njëjtën moshë me Moudin, zgjedh të kalojë mëngjeset me ndonjë mik, drekën në shoqatat e njerëzve të moshuar, zemrën me miq të tjerë, të dielat në kishë, psonisjet me gra të moshës së saj. Lesingu përdor termin "e shoqërueshmja" për të përshkruar këtë grua. Ngjyrat e ndezuara në përshkrimin e Elizës nxjerrin në pah dëshirën e shkrimtares për të treguar gruan e moshuar ideale, e cila, pavarësisht nga kufizimet fizike, ka arritur të fitojë paqen shpirtërore dhe mendore që u mungon dy grave të tjera.

Tek "Ditaret e Xhejn Somersit" lexuesi nuk mund të mos e vërejë dëshirën e shkrimtares për të vendosur në qendër jo gruan nëntëdhjetëvjeçare, por Xhejn Somersin, me qëllim që të kritikojë, por njëherazi edhe të shpalosë vizionin e saj mbi atë se si duhet të funksionojnë marrëdhëniet harmonike mes brezave në shoqërinë moderne perëndimore. Nëpërmjet përshkrimit që Xhena i bën "Ditës së Moudit" dhe përpjekjeve të saj për të mbajtur të pastër dhomën e apartamentit, për të mos ndotur rrobat apo duke treguar kujdes me pirjen e çajit për të mos lagur shtratin (Lessing, 1985, p. 135,215), vihet re një gjuhë e ashpër, tronditëse, apo, siç e quan botuesi i Granadës, "dëshpëruese".

Në të vërtetë, nëse themi se Lesingu theu tabutë në lidhje me seksin dhe lirinë

seksuale tek “Blloku i artë”, me “Ditaret e Xhejn Somersit” ajo theu tabutë rreth trupit të gruas së moshuar, të cilin e krahason me “një enë me zorrë të mbushura me pisllëqe” (Lessing, 1985, p.497). Janë shqetësuese frazat e përdorura për të përshkruar ankthin, shqetësimin, turpin dhe zemërimin e Moudi Follerit kur sheh se është “tradhëtuar prej trupit të saj” (Wallace, 2006, p.52). Pamundësia për t’u kujdesur për veten e kthen Moudin në një objekt. Ajo e lë veten, porsi fëmija, në duart e Xhenës, e cila e lan, i vë përparësen, i fshin buzët dhe e kreh. (Lessing, 1985, p.137)

Përpjekja e Moudit për ta mbajtur trupin “brenda kufijve të pastërtisë dhe hijeshisë” (Lessing, 1985, p.22), përballet me maninë e Xhenës për t’u kujdesur për “stilin” e saj – “këmishë të shtrenjta, klasike... të mëndafshta, çorape të mëndafshta, jo të najlonta...” (Lessing, 1985, p.73). Duke parapëlqyer kundërshtinë semantike, nëpërmjet përballjes së Xhenës dhe Moudit, Lesingu gjykon se tipologjia e gruas bën që edhe përjetimi i ankthit dhe i frikës për kohën që po kalon të jetë i ndryshëm. Shkrimtarja ngre pyetjen se a do të përjetohej plakja njëlloj në këto dy tipa të ndryshme grash?

Për Xhenën kujdesi për veten ka bërë që ajo të mos i anashkalojë pasojat që koha le në trupin e saj. E thënë ndryshe, ajo e parapërgatit veten për ndryshimin. Frikësohet kur e sheh Moudin një ditë të projektuar tek vetja, por tronditja është më e madhe tek Moudi dhe gratë si ajo, të cilat e kanë mohuar veten dhe janë sakrifikuar duke iu përkushtuar rolit të tyre brenda kategorisë. Ato, tashmë, e shohin veten “të pastreha; ...të përjashtuara nga streha e tyre profesionale” (Lessing, 1985, p.20). Me plane të papërmbushura, pa mbështetje, Xhena gjendet ballë për ballë me vetveten.

***Mosha e tretë dhe dashuria***

E njohur për rebelizmin e saj, D. Lesingu zbulon në prozën e vet të vërteta rrënqethëse ekzistenciale në lidhje me zgjedhjet që bën gruaja në krizën e menopauzës, a më vonë, me qëllim që “të ndalë të pandalshmen” (kohën). Shkrimtarja i të lexuesit përballë një grua e cila mbyllet në vetvete me të fshehtën e saj dhe fillon të shqyrtojë mundësitë që nuk i ka shfrytëzuar. E tillë është edhe Kati Brauni tek “Vera para errësirës”. Rubinstaini beson se “... një çerek shekulli që ajo investoi në kujdesjen dhe mirëqenien e familjes së saj – bashkëshortit, një neurolog i suksesshëm, dhe të katër fëmijëve, tani në fund të adoleshencës – i ka dhënë formë personalitetit të saj, krahas roleve si një bashkëshorte mbështetëse dhe një nënë edukuese.” (Rubenstein, 1979, p.201) Në të vërtetë, këto role e kanë përpirë aq shumë saqë “vera para errësirës” është mundësia e saj e parë për të ndarë veten nga familja dhe për t’u përballur me dytëshorin e saj, të shpërfaqur përtej këtyre roleve. Në çastin kur bën zgjedhjen e martesës dhe pranon reaksionin zinxhir të pasojave, Kati Brauni, sikurse Moudi Foulleri, por ndryshe nga Martha Kuesti tek “Fëmijët e dhunës”, nuk rreh më me veten idenë se kush është, apo cili është roli i saj në jetë. Ky është edhe momenti kur këto gra hedhin sytë nga e kaluara dhe fillojnë të bëjnë llogaritë me veten.

Xheloze për arritjet e të shoqit. Kati Brauni pranon punën si përkthyese për një mikun e të shoqit duke dashur të sfidojë vendimet e saj të deriatëhershme. Kati përballet me atë që kishte qenë tipari i saj i përhershëm – “pasiviteti, përshtatja me të tjerët” (Lessing, 2010, p. 34). Dorëzimi përballë kësaj të vërtete nuk shënon dobësi, përkundërazi, është tregues i marrjes në dorë të kontrollit të saj. Ky proces duhet vlerësuar si fillesa e një

rrugëtimi që me kohë do të vendosë ekuilibrat në një det të trazuar.

Rrugëtimi i Katit fillon me punën si përkthyese e portugalishtes në një konferencë ndërkombëtare për kafenë, e cila i jep mundësinë ta shohë veten nga një këndvështrim i ri. S. de Buvuar argumenton se gruaja në këtë moshë ndien nevojën e një "rifillimi, të një nisjeje nga e para. Kjo nevojë lind nga interesi i ri që mbart, nga dëshira për t'u shkulur nga rutinat e vjetra, për të filluar rishtas." (De Beauvoir, 1989, p.575) Në të vërtetë këtu nuk bëhet fjalë për një nisje të vërtetë, të programuar sipas qëllimeve dhe planeve të mirorganizuara. Në përpjekjen për "të ndrequr" gabimet dhe dështimet e saj, Kati Braun kërkon të përmbushë, para se të jetë shumë vonë, gjithçka që ia kishte mohuar vetes deri atëherë.

*"Nëse nuk do të ishte martuar, ajo ndoshta do të ishte bërë diçka e veçantë në fushën e saj? Ndoshta një lektore? Nuk ndodhte shpesh që gratë të bëheshin mësuese. ...Nganjëherë ajo përkthente për të (Majkëllin) dhe për kolegët e tij. Madje njëherë ajo kishte përkthyer një roman në portugalisht nga i cili fitoi pak para, por shumë lëvdata. ...Po të mos ishte martuar – Zoti i mirë, ajo do të kishte qenë e marrë po të mos martohej, e marrë për të zgjedhur letërsinë dhe gjuhët romane." (*Lessing, 2010, p.20)

Në të njëjtën kohë ajo ngre pyetje në lidhje me seksualitetin. Ndonëse udhëtimi me një djalosh të ri mund të përkthehet prej lexuesit si "çoroditje seksuale" (Rubenstein, 1979, p.207), për Katin, domethënia e saj e vërtetë shtrihet në mundësinë që i jepet për të reflektuar në lidhje me seksualitetin e saj.

*"...Sepse ajo i duhej asaj gjithnjë e më shumë (për shkak të seksualizmit të saj, diçka e zhvendosur, si një organ i nxjerrë prej trupit të saj dhe i lënë në anë për t'u vështruar, si një fëmijë i deformuar pa destinacion, të ardhme apo qëllim) sikur ajo thjesht vinte rrotull nga një fjalë magjike e marrëzisë që kishte zgjatur gjithë këta vite që në atë çast në adoleshencën e hershme kur qenia e saj kishte kërkuar që ajo të gjente një burrë për vete (sigurisht që ajo e kishte bërë atë në mënyrë romantike) deri kohët e fundit kur "drogës" kishte filluar t'i dilte efekti. Gjithë këto vite dukeshin tani si një tradhti e asaj që ajo ishte në të vërtetë. Ndërsa trupi i saj, nevojat, emocionet, gjithçka nga vetja e saj, kishte qenë kthyer si një luledielli pas një burri; gjatë gjithë asaj kohe Kati kishte në duart e saj diçka tjetër, diçka të çmuar, duke e ofruar atë më kot tek i shoqi, fëmijët e saj, tek çdo njeri që ajo njihte, por ajo nuk ishte kuptuar kurrë, nuk ishte vënë re kurrë. Por kjo gjë që ajo kishte ofruar pa e ditur, që po e bënte, që kishte qenë shpërfillur nga vetë ajo, dhe nga çdo njeri tjetër, ishte ajo që Kati kishte në të vërtetë brenda saj." (Lessing, 2010, p.142)*

Në afrimin e Katit me djemtë e rinj vihet re se ajo është bërë më agresive, më sunduese. Në përkujdesjen që tregon ndaj Xhejmsit, Kati i kthehet edhe një herë rolit të nënës, të mësuar aq mirë gjatë gjithë viteve bashkëshortore. Kthimi tek mëmësia i jep mundësi të fitojë epërsi në "vjeshtën para errësirës".

Ndryshimi i kësaj gruaje nuk shënon pavarësinë e saj nga familja, pasi ajo nuk i braktis bashkëshortin dhe fëmijët, por njësimin delikat të unit brenda kornizës shoqërore. Shndërrimi që pëson Kati gjatë këtij rrugëtimi është i nevojshëm për të kuptuar dhe vlerësuar rolin dhe vendin e saj në jetë. Humbja e peshës, thinjat që fillojnë të duken, rrudhat në fytyrë janë çmimi që ajo duhet të paguajë për të dalë nga roli i nënës dhe i bashkëshortes dhe për të vlerësuar mundësitë e reja në jetë. Ajo vuan në përpjekjet për të përkufizuar veten nën një këndvështrim të ri. Ashtu siç është shprehur edhe vetë shkrimtarja, një

grua e re, e bukur "e ka të vështirë të ndajë veten nga pamja e saj e jashtme. Gruaja arrin të zbulojë dallimin mes asaj që është në të vërtetë dhe pamjes së jashtme vetëm kur arrin njëfarë pjekurie dhe kjo është përvoja më magjepsëse. Kjo ka qenë një nga përvojat e mia më të çmuara. Një jetë e tërë të rrëshqet dhe papritur ti e kupton se pamja e jashtme ishte përdorur vetëm për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve" (Henden, 1973, p.85). Ndryshimi i Kati Braunit të godet me veçantinë e tij, sepse është një ndryshim fizik në radhë të parë dhe më pas psikologjik. Rrugëtimi i Katit si në sferën e pavetëdijes, edhe në botën reale shënon procesin e metamorfozës nëpër të cilin kalon ajo. Ndryshe nga të gjitha gratë e tjera të moshës së saj, të përshkruara në veprën e Lesingut, Kati Braun arrin të kuptojë pozicionin e saj në jetë dhe rëndësinë e moshës së vet. Duke pranuar anën e errët të vetes, jetën e saj të brendshme, bëhet e mundur që ajo të përballet me errësirën e pashmangshme të moshës së tretë, dhe rrjedhimisht edhe me vdekjen.

Një tjetër pamje e përjetimeve seksuale në moshën e pleqërisë të shpaloset teksa lexon "Sërish dashuri" (*Love, Again*). I vetmi roman në krijimtarinë e D. Lesingut që trajton vuajtjet e dashurisë së një gruaje gjashtëdhjetepesëvjeçare, "Sërish dashuri" të magjeps me trajtimin që i bëhet mundësisë së dashurisë edhe në këtë moshë. Edhe pse ky është një roman për dashurinë, veçanërisht për dashurinë romantike për të cilën poetët kanë shkruar për shekuj me rradhë, ai është antiteza e një historie dashurie sentimentale. Në të vërtetë, ky roman është një lloj analize e dinamikës së dashurisë dhe e vuajtjeve të saj, shkruar nga këndvështrimi ironik dhe ndonjëherë edhe me humor, i një gruaje gjashtëdhjetepesë vjeçare, e cila një ditë zbulon e tmerruar se ka rënë në dashuri me një burrë njëzetetetëvjeçar. "Trupi i saj vlonte nga një dëshirë e tmerrshme .... Ajo do ta detyronte veten të shërohej nga kjo sëmundje. Sepse kjo ishte. Ajo ishte e sëmurë." (Lessing, 2007, p.42).

Natyrisht që kjo marrëdhënie është e dënuar qysh në fillim të dështojë për shkak të paragjykimeve shoqërore, megjithatë ky fakt nuk e pengon Sara Durhamin të përjetojë agonitë dhe kënaqësitë e dashurisë, sikur të mos ishte gjashtëdhjetë e pesë vjeç, por një vajzë e re tetëmbëdhjetëvjeçare. Në të vërtetë, "Sërish dashuri" i mëshon paradoksit të plakjes: faktit se pasionet dhe shpresat e të rinjve mund të jetojnë si një flakë e përjetshme, edhe në një trup që dalëngadalë po vyshket. Kjo është edhe arsyeja pse Lesingu shpërthen: "mishi thahet rreth një bërthame të pandryshuar." (Lessing, 2007, p.7).

Fatkeqësisht, kufizimet shoqërore nuk lejojnë shprehjen e lirë të pasioneve romantike të një gruaje të moshuar për një djalë të ri. Sara me dëshpërim e përkthen gjendjen e saj si një situatë pothuajse qesharake: "Shumica e burrave dhe grave më shumë – nga frika për veten e tyre – i dënojnë gratë e moshuara me tallje, i dënojnë ato me mizori, kur tregojnë shenja të papërshtatshme të seksualitetit të tyre" (Lessing, 2007, p.51).

Dilema e Sarës e ka burimin edhe tek problemet gjinore. Bashkëpunëtori i saj i ngushtë Stiven Ellington-Smith, një burrë në të pesëdhjetat, tërhiqet nga një aktore tridhjetë vjet më të vogël dhe nuk frenohet nga krijimi i një marrëdhënieje me të. Marrëdhënie të tilla priten dhe gati kalohen pa komente, ndërsa Sara e di se në qoftë se ajo përfshihet në një marrëdhënie seksuale me Billin, mund të bëhet objekt i talljeve apo përbuzjeve. Edhe pse romani nuk është, në thelb, një roman feminist, ai, megjithatë, në mënyrë të qartë na njeh me pabarazinë midis dy situatave, të cilat

vetëm thellojnë dhimbjet dhe ankthet e Sarës.

Kështu, "Sërish dashuri" analizon një nga tabutë më të fundit - kufizimet shoqërore dhe seksuale për gratë e moshuara. Sara bie jo një herë, por dy herë në dashuri gjatë rrjedhës së romanit dhe kjo nuk është një sprovë si e Kati Braunit tek "Vera para errësirës". Në roman zgjedhjet e Sarës tregojnë sesa të forta janë kufizimet shoqërore për gruan e moshuar. Kjo duket edhe në ndjenjën e fajësisë dhe të përgjegjësisë familjare të Henrit kur ai shprehet:

"- Sara, po të them se asgjë, asgjë tjetër nuk ka më shumë rëndësi për mua se djali im i vogël.

- Dhe ç'lidhje ka kjo me ...

- Çdo gjë, tha ai fatkeq." (Lessing, 2007, p.86).

Vendosja e drejtpeshimit ndërmjet përgjegjësisë shoqërore dhe dëshirave të brendshme qëndron në themel të ndryshimit që pësojnë personazhet e D. Lesingut. Pamundësia për të gjetur vendin e duhur mes këtyre ekuilibrave bën që një pjesë e personazheve të shkrimtares të shkojnë përtej, drejt përvojave të skajshme. Kriza e moshës së mesme nuk kapërcehet prej Suzën Rollingsit tek "Në dhomën nëntëmbëdhjetë". Dëshpërimi, ankthi për të ardhmen dhe vuajtjet e kohës që kaloi janë kaq të forta tek kjo grua, saqë e çojnë atë drejt vetëvrasjes.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Beauvoir, S. (1989). *The Second Sex*. USA: Vintage Books Edition.

Berg, M.A. (1996). "Toward a Creative Understanding: Bakhtin and the Study of Old Age in Literature". *Journal of Aging Studies* 10.1.

Henden, J. (June 1973). "D. Lessing: The Phoenix 'Midst Her Fires". *Harper's Magazine*.

Lessing, D. (1985). *The Diaries of Jane Somers*. Harmondsworth: Penguin.

Lessing, D. (1998). *Walking in the Shade: Volume Two of my Autobiography*. London: Flamingo.

Lessing, D. (2007). *Love, Again*. Adobe Digital Edition. HarperCollins e-books.

Lessing, D. (2010). *Vera para errësirës*. Tiranë: Skanderbeg Books.

Marshall, E.R. (2007). *All Over: The Identities of Old Age*. UMI. ProQuest Central.

Rubenstein, R. (1979). *The Novelistic Vision of Doris Lessing: Breaking the Forms of Consciousness*. Urbana/Chicago/London: University of Illinois Press.

Wallace, D. (2006). Women's Time: Women, Age, and Intergenerational Relationships. Studies in the Literary Imagination 39.*2.* USA: Georgia State University.

# PËRKTHIMI I LETËRSISË PËR FËMIJË NË ASPEKTIN TEORIK DHE PRAKTIK.

**ERIOLA BONJA -QAFZEZI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Në qendër të punimit tonë është vendosur përkthimi i letërsisë për fëmijë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Dukuri të ndryshme të letërsisë për fëmijë janë shqyrtuar nga pikëpamja teorike, duke e pasuruar studimin me raste studimore që janë pjesë e korpusit tonë. Janë përzgjedhur aspekte me interest ë letërsisë për fëmijë, duke iu ardhur në ndihmë përkthyesve, studiuesve e më gjerë.

Pasi është bërë një përshkrim teorik rreth dukurisë së përkthimit dhe zhvillimit të përkthimit të letërsisë për fëmijë brenda studimeve përkthimore, jemi ndalur teorikisht dhe praktikisht në dukuri të tilla si prirjet e huajëzimit dhe amtarëzimit, ndërtekstualiteti dhe aludimet, përkthimi i lojrave të fjalëve dhe emrave të përveçëm, standardet e përkthimit të letërsisë për fëmijë, duke pasqyruar secilën prej dukurive me shembuj të vjelë nga veprat konkrete të marra në shqyrtim.

Në përfundim punimi nxjerr në pah anë problematike të përkthimit të letërsisë për fëmijë, të vërejtura gjatë krahasimit të vazhdueshëm të varianteve në gjuhën shqipe dhe në gjuhët origjinale. Në përfundim dilet në disa konkluzione në kuadërin e këtij punimi të gjerë.

**Fjalë çelës**: *përkthim, letërsi për fëmijë, amëtarizim, huajëzim, lojëra fjalësh, emra të përveçëm, aludime, përshtatje kulturore-kontekstuale, thjeshtësim*.

**Abstract**

This paper focuses on the translation of children's literature from English into Albanian language, viewed both theoretically and practically. Several phenomena os children's literature in translation are touched upon and analyzed theoretically, enriching the current study with examples extracted from case studies included in our present corpus.

The aims of selecting the genre of children's literature are multifod: firstly and most importantly, it represents are interesting area of research in Albania, an area iun wich little research had been carried out actually and wich, it is hoped,will gain considerably from this study.

Scholars and practitioners alike can find the present study of particular importance , both theoretically and practically. In the beginnings of this thesis, there are introduced some general considerations about translation, followed by arguments wich support the development of translation of children's literature as a separate area of research within the interdiscipline of Translation Studies. The main theoreticall and practicall phenomena observed in our study include: tendencies of domestication and foreignization, intertextuality and allusions, translation of puns and proper nouns and standards of translation of children's literature.

By the end of thesis, there are also presented certain problematic issues observed during constant comparison of the source texts with their variants in Albanian language. The thesis is completed by outlining some conclusions of the present study, wich can be of relevance to translators of children's literature and literary translators in general.

**Key words.** *Translation, children's literature, domestication, foreignization, puns, proper nouns, allusions, cultural context adaption, simplification*.

Interesi kritik në rang botëror për përkthimin e letërsisë për fëmijë është zhvilluar me hapa të shpejtë gjatë tridhjetë viteve të fundit. Një kthesë vendimtare në këtë drejtim shënoi simpoziumi i tretë i Shoqërisë Ndërkombëtare Studimore për Letërsinë për Fëmijë (International Research Society for Children's Literature (IRSCL)) në vitin 1976: ishte konferenca e parë për letërsinë për fëmijë (dhe për shumë vjet e vetmja) që i kushtohej tërësisht përkthimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të librave për fëmijë. Megjithatë, shenjat e para të një interesi rreth çështjeve më të përgjithshme të ndikimeve ndërkulturore dhe shpërndarjes ndërkombëtare të letërsisë për fëmijë ishin shfaqur që më parë, që brenda disiplinës së Letërsisë Krahasuese – një degë studimi letrar të përkufizuar nga Suzan Basneti (Susan Bassnett) si një degë që merret me llojet e lidhjeve në letërsitë përtej kufijve kohorë dhë hapësinorë (Bassnett, 1993, p.1).

Meqenëse studiuesit dhe kritikët kanë filluar ta vlerësojnë letërsinë për fëmijë si një mjet dinamik nga ana estetike dhe ideologjike, studimet mbi përkthimin e kësaj letërsie kanë fituar më shumë terren. Kështu, duke e parë transmetimin e tekstit për fëmijë nga një gjuhë ose kulturë në një gjuhë ose kulturë tjetër nëpërmjet këndvështrimit të përkthimit, mund të vërejmë pritshmëri dhe interpretime të ndryshme për fëmijërinë (Lathey, 2006, p. 2). Vetëm gjatë viteve 1960 dhe 1970 vëmendja e kritikëve u drejtua nga ndikimet ndërkulturore në letërsinë për fëmijë, duke lënë mënjanë mendimet e vjetëruara se përkthimi i letërsisë për fëmijë duhet të ketë të bëjë thjesht me transmetimin sa më të afërt të origjinalit, dhe duke u orientuar drejt një qëndrimi që i kushtonte vëmendje kalimit të një teksti për fëmijë nga një gjuhë dhe kulturë në një një gjuhë dhe kulturë tjetër, gjë që do të pasqyrojë edhe pritshmëri dhe interpretime të ndryshme mbi fëmijërinë (E.O'Connell, 2005; P. Pinsent, 2006).

Gjatë kësaj periudhe filloi t'i kushtohej vëmendje në rritje studimit të përkthimit të kësaj letërsie, shoqëruar edhe me vlerësimin më të madh të kësaj gjinie. Në ditët e sotme pranohet gjerësisht fakti se përkthimi i letërsisë për fëmijë është një fushë e re studimi brenda studimeve përkthimore, megjithatë, janë dashur një sërë punimesh dhe studimesh për të arritur deri në këtë fazë të zhvillimit.

Pavarësisht vështirësive të përkufizimit të letërsisë për fëmijë, mund të përmendim disa nga cilësitë e saj të cilat duhen patur parasysh gjatë përkthimit të kësaj gjinie në dallim nga gjinitë e tjera. Librat për fëmijë u drejtohen edhe fëmijëve edhe të rriturve, mund të interpretohen në nivele të ndryshme për shkak të natyrës ambivalente dhe, gjithashtu kanë karakter të dyfishtë dhe veprojnë brenda kufizimeve kulturore. Shpeshherë kjo lloj gjinie është lënë në hije për shkak të pozicionit periferik që ajo zë brenda sistemit letrar tradicional, akoma më në periferi është e pozicionuar letërsia për fëmijë e përkthyer. Megjithatë, zhvillime të tjera në kuadër të studimeve përkthimore, si kthesa kulturore dhe teoria e polisistemit kanë hedhur më shumë dritë

në përkthimin e lëtërsisë për fëmijë, duke na bërë të kuptojmë se përkthimi i letërsisë për fëmijë është vazhdimisht nën ndikimin e faktorëve kulturorë, shoqërorë, ekonomikë e politikë dhe nuk është asnjëherë një çështje thjesht gjuhësore, por një proces i vazhdueshëm negociimi.

Në qendër të këtij punimi është vendosur përkthimi i letërsisë për fëmijë, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Në mbarë botën studimet mbi përkthimin e letërsisë për fëmijë kanë fituar një shtrirje të gjerë këto tridhjetë-dyzet vitet e fundit, duke e kthyer përkthimin e letërsisë për fëmijë në një nga fushat me interes më të lartë studimi brenda studimeve përkthimore.

Në hapësirën shqiptare, megjithatë, vërehet lehtësisht se studime të tilla mungojnë, madje, pak rëndësi i kushtohet në përgjithësi përkthimit të librave për fëmijë, duke e lënë në hije një gjini të tillë, aq të rëndësishme për formimin dhe argëtimin e brezave të rinj.

Megjithatë, një punim i tillë që rendit kontributet teorike të dhëna nga studiues të ndryshëm nuk do të kishte qenë i plotë pa u mbështetur në shembuj konkretë, të cilët i japin frymën e vërtetë një studimi krahasues. Për këtë arsye, problematika apo dukuri të përshkruara nga ana teorike mbështeten nga shembuj dhe analiza konkrete që bëjnë të mundur nxjerrjen më në pah të problematikës apo dukurisë në fjalë. Një gjë e tillë është mundësuar edhe nëpërmjet zgjerimit të korpusit studimor me qëllim që edhe analizat e bëra të jenë më domethënëse.

Ashtu siç u përmend, në punimin e plotë renditen një sërë aspektesh teorike dhe praktike të përkthimit të letërsisë për fëmijë, me qëllim zgjimin e interesit të lexuesve dhe studiuesve për këtë fushë kaq interesante, që paraqet edhe më shumë interes gjatë kalimit nga njëra gjuhë në tjetrën. Gjithashtu, duke qenë një punim i cili hap shtigje të reja diskutimi dhe studimi, duhet përmendur mungesa e natyrës gjithëpërfshirëse dhe shteruese të tij.

Ajo çka shpresojmë të arrijmë nëpërmjet këtij studimi, mes të tjerash, është informimi dhe rritja e interesit rreth përkthimit të letërsisë për fëmijë si dhe çelja e shtigjeve të reja të studimit në të ardhmen, duke dashur të rrisim kontributet në një fushë sa tërheqëse aq edhe delikate, sa të thjeshtë në dukje, por po aq të fshehtë në thellësi, sa të përhapur, por, njëkohësisht, shumë pak të studiuar – përkthimin e letërsisë për fëmijë.

Objekti kryesor i këtij punimi është që të hedhë dritë e të sjellë informacion sa më të dobishëm në lidhje me përkthimin e letërsisë për fëmijë të shpalosur në dy plane: plani teorik dhe plani praktik. Pjesa teorike zë një vend të konsiderueshëm të studimit, fillimisht duke ndërtuar një kuadër teorik rreth vetë studimeve përkthimore dhe më tej duke përshkruar karakteristikat kryesore të letërsisë për fëmijë dhe përkthimit të saj, të cilat e dallojnë atë nga përkthimi i letërsisë për të rritur. Aspekte të tjera teorike të përshkruara në studimin tonë mbështeten nëpërmjet shembujve konkretë, gjë që na fton drejt një të kuptuari edhe më konkret të aspekteve të përshkruara në punimin e plotë. Dukuritë e përshkruara teorikisht pasurohen edhe bëhen më konkrete nëpërmjet rasteve studimore.

Nëpërmjet këtij punimi synojmë gjithashtu të nxjerrim në pah mënyra të ndryshme se si të rriturit mund të ushtrojnë pushtetin e tyre mbi fëmijët, duke analizuar rolin e përkthyesit dhe faktorëve të tjerë në këtë drejtim. Gjithashtu, dy ndër prirjet kryesore të vërejtura në analizën e përkthimeve në ditët e sotme – huajëzimi dhe amëtarizimi – janë përshkruar në këtë punim në

aspektin teorik si dhe në atë praktik nëpërmjet shembujve konkretë të korpusit tonë, duke synuar kështu analizimin e shfaqjes së këtyre dy prirjeve në letërsinë për fëmijë.

Objekt i punimit tonë ka qenë gjithashtu përshkrimi i dukurisë së ndërtekstualitetit si një nga dukuritë e studiuara më gjerësisht në studimet përkthimore në ditët e sotme. Në këtë studim, jemi përqëndruar në veçanti në dy shfaqje të ndërtekstualitetit që ia vlejnë t'iu kushtojmë vëmendje të posaçme në përkthimin e letërsisë për fëmijë – lojërat e fjalëve dhe emrat e përveçëm. Kështu, ne synojmë të hedhim dritë mbi analizën e lojërave të fjalëve, llojeve të tyre si dhe strategjitë e ndryshme që janë përdorur për t'i sjellë ato në gjuhën shqipe. Gjithashtu, synojmë t'u vijmë në ndihmë studiuesve dhe përkthyesve të ndryshëm, duke sjellë një sërë pikëpamjesh teorike mbi përkthimin e emrave të përveçëm dhe duke analizuar mënyrat e ndryshme të përkthimit të tyre në korpusin nën shqyrtim.

Një ndër synimet më të rëndësishme të këtij studimi është edhe pasqyrimi konkret i standardeve në përkthimin e letërsisë për fëmijë, duke u përqendruar në përshtatjen në nivele të ndryshme dhe duke u përqendruar në shfaqjen e përshtatjes në forma të ndryshme në nivelin kulturor si dhe në ndryshimet e vërejtura në nivelin sintaksor. Shembuj të ndryshëm vjelë nga i gjithë korpusi na kanë ndihmuar që ta përmbushim këtë synim në mënyrë sa më të plotë dhe praktike. Gjithashtu, nuk mund të lemë pa përmendur edhe një sërë dukurish problematike që kemi vërejtur gjatë krahasimeve që kemi bërë me origjinalin, të cilat i sjellim konkretisht të pasqyruara në këtë punim me qëllim që të hedhim dritë edhe mbi shfaqje të tilla, të cilat nuk duhet të ndodhin gjatë përkthimit.

Meqenëse ky punim është ndër hapat e para që hidhen në fushën e studimit të përkthimit të letërsisë për fëmijë, gjatë hartimit të studimit dhe analizimit të dukurive dhe nxjerrjes së përfundimeve në bazë të analizave përkatëse, pavarësisht fazës sonë të punimit, gjithmonë kemi pasur parasysh zgjimin e interesit të gjerë në lidhje me një fushë pak të studiuar në hapësirën shqiptare. Gjithashtu, paralelisht, kemi synuar t'iu vijmë në ndihmë përkthyesve të letërsisë për fëmijë duke i njohur ata më konkretisht dhe më thellësisht me dukuritë dhe problemet me të cilat mund të përballen në punën e tyre si dhe prezantimin e strategjive të mundshme për t'u përdorur si dhe me mënyrat për të shmangur disa anë problematike që shpesh mund të kalojnë pa u vënë re.

Njëkohësisht, duke qenë se pjesë e studimit tonë krahasues janë vepra të përkthyera në një hark kohor që mbulon shtatëdhjetë vitet e fundit, dhe duke vërejtur gjendjen e përkthimeve në ditët e sotme, dëshirojmë që, nëpërmjet këtij punimi, të tërheqim vëmendjen e përkthyesve, redaktorëve, shtëpive botuese, ilustruesve dhe pjesëmarrësve të tjerë në përkthimin dhe botimin e letërsisë për fëmijë, duke nxjerrë më në pah faktin se përkthimi i letërsisë për fëmijë nuk duhet të shikohet si një punë më pak e rëndësishme dhe me më pak përgjegjësi se përkthimi i letërsisë për të rritur.

Studimi i ndërmarrë është ndërtuar mbi bazën e hulumtimit të kujdesshëm të materialeve të ndryshme të cilat përqendrohen në disiplinën e studimeve përkthimore në përgjithësi, dhe përkthimit të letërsisë për fëmijë në veçanti. Kemi shfletuar një sërë librash të botuara, studimesh dhe disertacionesh, si dhe artikuj me natyrë krahasimore të botuar në organe ndërkombëtare. Të gjitha këto materiale na kanë ndihmuar për të

hartuar në mënyrë përshkruese pjesën teorike të punimit tonë si dhe për të organizuar më pas pjesën praktike.

Në ditët e sotme, ekzistojnë shumë mënyra përkufizimi dhe perceptimi të përkthimit si dhe këndvështrime të ndryshme rreth çështjeve të tilla që ndodhen në qendër të studimeve përkthimore, si, çështja e ekuivalencës, pozicionimi i përkthyesit, pikpamjet funksionaliste mbi përkthimin si dhe prirjet e huajëzimit dhe amëtarizimit.

Në mënyrë të përmbledhur, theksojmë një nga këndvështrimet më bashkëkohore mbi përkthimin dhe procesin e të përkthyerit, i cili konsiderohet të jetë një proces komunikimi dhe negociimi ndërmjet teksteve dhe kulturave, një proces gjatë së cilit ndodhin një sërë shkëmbimesh të ndërmjetësuara nga përkthyesi, brenda një konteksti shoqëror. Një gjë e tillë na bën të kuptojmë se përkthimi dhe studimi i tij nuk paraqet vetëm interes gjuhësor, por përfshin gjithashtu një ndërthurje mes kulturave të ndryshme. Theksojmë, gjithashtu, se gjatë përcjelljes së tekstit nga origjinali drejt gjuhës së përkthimit asnjëherë nuk duhet të jemi në kërkim të ekuivalencës së plotë, diçka e paarritshme edhe brenda së njëjtës gjuhë. Kështu, përkthyesi vendoset fillimisht në rolin e një lexuesi dhe interpretuesi të kujdesshëm të tekstit origjinal dhe synimeve të drejtpërdrejta apo të fshehta të shkrimtarit, duke synuar të përcjellë të njëjtat ide e mesazhe ashtu si edhe të njëjtin funksion të origjinalit, nëpërmjet një teksti që krijon një efekt sa më të përafërt për lexuesit e tekstit të përkthyer ashtu si edhe teksti origjinal. Pikëpamje të tilla të përmendura janë parë në dritën e përkthimit të letërsisë për fëmijë.

Studime të ndryshme nxjerrin në pah se shenjat e para të shfaqjes së një interesi rreth letërsisë për fëmijë janë vënë re brenda disiplinës së Letërsisë Krahasuese, ndërkohë që studimet mbi përkthimin e kësaj letërsie kanë fituar më shumë terren pasi studiuesit dhe filluan ta vlerësojnë letërsinë për fëmijë si një mjet të fuqishëm si nga ana ideologjike, ashtu edhe nga ana estetike.

Duhet theksuar se nuk është e lehtë të japet një përkufizim vendimtar në lidhje me gjininë e letërsisë për fëmijë, por renditen një sërë cilësish të kësaj gjinie të cilat marrin edhe më shumë rëndësi në përkthimin e kësaj letërsie, dhe, rrjedhimisht, edhe në punimin konkret. Ndër këto cilësi përmendim faktin se gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë duhen marrë gjithmonë në konsideratë aftësitë e lexuesve për të kuptuar elementët e kulturës së huaj.

Niveli i përshtatjes së këtyre elementeve shpesh çon në manipulim të tekstit origjinal, pavarësisht shqetësimit të shumë studiuesve rreth nivelit të transformimit të tekstit. Një tjetër faktor që sërish çon drejt manipulimit të origjinalit, dhe, shpeshherë, edhe nënvlerësimit të përkthimit të letërsisë për fëmijë, është pozicioni periferik që ze letërsia e përkthyer për fëmijë brenda polisistemit letrar. Faktorë të tillë na bëjnë të kuptojmë se përkthimi i letërsisë për fëmijë është gjithmonë nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm si faktorë kulturorë, ideologjikë, shoqërorë, ekonomikë, politikë, etj.

Ka qenë një sfidë e vërtetë përzgjedhja e korpusit tonë studimor. Ashtu siç e kemi theksuar, kemi përzgjedhur vepra të tilla të cilat nxjerrin më në pah qëllimet e studimit tonë, pra, qartësimin dhe shtjellimin e analizimin e atyre dukurive domethënëse të parashtruara teorikisht dhe të aktualizuara nëpërmjet shembujve konkretë nga korpusi ynë. Këto vepra përfshijnë *Alice's Adventures in Wonderland, Harry Potter and the Philosopher's Stone, Robinson Crusoe* dhe

*Gulliver's Travels* dhe variantet e tyre në gjuhën shqipe. Secila prej veprave në fjalë ka paraqitur interes të veçantë për studimin tonë, duke u kthyer kështu, për pjesët përkatëse të këtij punimi, në raste studimore për vërejtjen e dukurive të veçanta si përkthimi i emrave të përveçëm, përcjellja e nënkuptimeve, përkthimi i lojërave të fjalëve, prirja e varianteve në gjuhën shqipe ndaj amëtarizimit apo huajëzimit, niveli i përcjelljes së elementëve specifikë kulturorë, konkretizimi i shkallëve të ndryshme të përshtatjes si një nga standardet e përdorura në variantet në gjuhën shqipe, etj. Për shembull, *Alice's Adventures in Wonderland* dhe krahasimi i saj me variantet në gjuhën shqipe ka qenë me të vërtetë frytdhënës për studimin e strategjive për përkthimin e lojërave të fjalëve si dhe përcjelljen e nënkuptimeve të shprehura nëpërmjet emrave të përveçëm. Po kështu, krahas veprës së sipërpërmendur, edhe *Robinson Crusoe* dhe *Gulliver's Travels* dhe krahasimi i tyre me variantet në gjuhën shqipe na kanë ndihmuar për të vërejtur nivelin e transmetimit të elementëve specifikë kulturorë në gjuhën shqipe dhe për të analizuar të dhënat krahasuese drejt nxjerrjes së përfundimeve mjaft domethënëse në këtë drejtim.

Krahas të dhënave të tjera si ilustrimet, kopertina, etj., jemi ndalur edhe në analizimin e qëllimeve të parathënies. Shkurtimisht përmendim se funksionet e parathënies në korpusin tonë janë: informimi i lexuesve të tekstit të përkthyer rreth shkrimtarit dhe veprës së shkruar në origjinal, shtjellimi i arsyeve se pse është përkthyer vepra në gjuhën shqipe (skoposi i përkthimit), informimi rreth përkthimeve ekzistuese të mëparshme (nëse ka), identifikimi i publikut marrës, parashtrimi i vështirësive me të cilat është përballuar përkthyesi, përcaktimi i pozicionit të veprës brenda letërsisë shqipe si dhe kërkesë për mirënjohje për punën e bërë nga ana e përkthyesir shoqëruar me shfajësimin për gabime të mundshme.

Në një këndvështrim diakronik kemi vënë re se parathënia fillon të mungojë në variantet në gjuhën shqipe ose është e pranishme, por nuk është shkruar nga vetë përkthyesi. Për këtë arsye dëshirojmë të theksojmë se është shumë e rëndësishme që vepra të shoqërohet me parathënie, si për qëllime studimore, ashtu edhe për qëllime informuese të publikut marrës. Prania e parathënies do të mundësojë një nivel më të thellë të të kuptuarit të veprës, dhe, njëkohësisht, ndërgjegjësim të rolit të përkthyesit si dhe rritje të përgjegjësisë së tij.

Ka një sërë argumentesh që tregojnë ekzistencën e një marrëdhënieje të pabarabartë mes të rriturve dhe fëmijëve në përkthimin e letërsisë për fëmijë si dhe mënyrën e përdorimit të pushtetit nga të rriturit në këtë drejtim. Këtu mund të përmenden faktorë të ndryshëm që luajnë rol në këtë proces, si, për shembull, shtëpitë botuese, mësuesit, prindërit, librashitësit, shkrimtarët dhe përkthyesit, të cilët i "filtrojnë" librat e botuar për fëmijë shtresë pas shtrese, duke lënë kështu në fund të procesit të përzgjedhjes ata të cilëve iu drejtohen librat në të vërtetë – vetë fëmijët. Kjo është edhe arsyeja se pse, shpesh, gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë, ndodh që një sërë elementesh kulturore t'u nënshtrohen tjetërsimeve nga ana e përkthyesit, i cili mundohet të sjellë në duart e fëmijëve një libër sa më "të përshtatshëm" për moshën dhe nivelin e njohurive dhe të kuptuarit të tyre.

Kjo prirje ndaj "përshtatshmërisë" në përkthimin e librave për fëmijë mund të shfaqet në aspekte nga më të ndryshmet. Kemi analizuar shkallën e përcjelljes së elementëve kulturorë nga gjuha angleze në

gjuhën shqipe për veprat *Alice's Adventures in Wonderland, Robinson Crusoe* dhe *Guliver's Travels.* Për veprat në fjalë kemi identifikuar në veprat origjinale elemente të tilla kulturore si njësitë matëse, njësitë monetare si dhe ushqimet dhe pijet, dhe, një fazë të dytë, kemi gjetur njësitë përkatëse në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe. Të gjithë elementët përkatës janë krahasuar me njëri-tjetrin dhe janë klasifikuar sipas prirjeve të amëtarizimit dhe huajëzimit, pra, më pak fjalë, nëse përkthyesi ka vendosur që t'i asimilojë elementet e huaja brenda kulturës shqiptare, apo, në të kundërt, t'i mbartë elementët e huaj në gjuhën dhe kulturën e përkthimit. Jemi mbështetur jo vetëm në këtë dikotomi të prezantuar nga Venuti, por, brenda kësaj dikotomie kemi klasifikuar raste të veçanta të shprehjes së amëtarizimit dhe huajëzimit duke prezantuar modelin dhënë nga Vladimir Ivir rreth procedurave dhe strategjive për përthimin e kulturës. Brenda këtij modeli përmendim strategji të tilla si: huazimi, përkufizimi, përkthimi fjalë për fjalë, zëvendësimi, krijimi leksikor, mospërfshirja dhe shtimi.

Në *Gulliver's Travels* kemi gjetur 342 njësi specifike kulturore, nga të cilat janë amëtarizuar 29%, dhe i janë nënshtruar huajëzimit 71% të njësive kulturore në tërësi, ku pjesa më e madhe (brenda huajëzimit) janë përkthyer fjalë për fjalë (42%), ndjekur nga procedura e huazimit (26%). Përkufiimi dhe shtimi janë përdorur në shumë pak raste (përkatësisht 1% dhe 2%). Brenda prirjes së amëtarizimit, më shumë se gjysma e njësive të sjella në gjuhën shqipe janë zëvendësuar (17%), ndjekur nga procedurat e krijimit leksikor (7%) dhe mospërfshirja në një numër të vogël rastesh (4%). Edhe një herë theksojmë se në përkthimin e kësaj vepre mbizotëron dukshëm huajëzimi, pra, një pjesë e konsiderueshme e elemenëve të huaj kulturorë janë sjellë si të tillë në gjuhën shqipe.

Në *Alice's Adventures in Wonderland* kemi identifikuar gjithsej 43 njësi specifike kulturore. Krahasimi i secilit prej varianteve me origjinalin tregon se prirjet shpërndahen pothuajse në të njëjtën përqindje në të gjitha variantet, vetëm me disa dallime të lehta. Kështu, në variantin e parë, të tretë dhe të pestë mbizotëron huajëzimi, ndërsa në variantin e dytë dhe të katërt amëtarizimi. Shkalla e amëtarizimit është më e lartë në variantin e sjellë në gjuhën shqipe nga vëllezërit *Tafa* (varianti i katërt), gjë që tregon se, me kalimin e viteve, më pak elemente të huaja janë përcjellë në gjuhën dhe kulturën shqipe.

Megjithatë, nuk mund të mos përmendim se brenda secilit variant shfaqen raste të një mungese të qëndrueshmërisë në prirjet e vërejtura, për shembull, e njëjta njësi mund të përkthehet nëpërmjet procedurave të ndryshme brenda të njëjtit variant, duke shfaqur kështu herë prirjen e amëtarizimit dhe herë të tjera prirjen e huajëzimit. Për arsye të tilla, nuk është shumë i qartë pozicionimi i lexuesit në veprën e përkthyer: një mjedis shqiptar që përdor para të huaja, një kontekst britanik që përdor para dhe njësi matëse shqiptare, etj. Gjithashtu mendojmë se kalimi nga një prirje në tjetra brenda së njëjtit variant shkakton pështjellim në të kuptuarin e përgjithshëm të tekstit nga ana e lexuesve, perceptimin e kulturës së huaj, si dhe, më përgjithësisht, një cilësi më të ulët përkthimi.

Në *Robinson Crusoe* kemi identifikuar gjithsej 505 njësi specifike kulturore të shpërndara në të gjithë veprën origjinale. Edhe në përkthimin e kësaj vepre mbizotëron prirja e huajëzimit (67%) me procedurat kryesore përkthim fjalë për fjalë (38%) dhe huazim (26%), ndjekur nga

shfaqje të rralla të shtimit (2%) dhe përkufizimit (1%). Thuajse një e treta e elementëve kulturorë sillen në gjuhën shqipe nëpërmjet amëtarizimit (33%), kryesisht nëpërmjet procedurës së zëvendësimit (21%) dhe pjesërisht nëpërmjet mospërfshirjes apo krijimeve leksikore (secila 6%). Mendojmë se prirja mbizotëruese e përkthyesit është pikërisht e orientuar ndaj huajëzimit, nisur nga një portretizim me shumë vërtetësi i një personazhin dhe aventurave të tij ashtu si ai shfaqet në veprën origjinale, tipik anglez, si dhe, njëkohësisht, duke mos iu drejtuar ekskluzivisht një publiku të përbërë nga fëmijë, por, një publik i përbërë nga të rritur e të vegjël njëkohësisht.

Duke iu referuar të tri rasteve studimore nëpërmjet të cilave kemi shqyrtuar prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit, themi se huajëzimi mbizotëron dukshëm në variantet e përkthyera të GT dhe RC. Ndërsa në lidhje me AAiW, vërejmë se huajëzimi mbizotëron në variantin e parë, të tretë dhe të pestë, ndërsa në variantin e dytë dhe të katërt shfaqet më shumë amëtarizimi. Megjithatë, nëse iu referohemi të pesë varianteve në tërësi mund të themi se të dyja prirjet shpërndahen në mënyrë thuajse të njëtrajtshme në secilin prej varianteve, përveç variantit të katërt ku shfaqet qartë mbizotërimi i amëtarizimit. Kjo edhe për arsye se ky variant iu drejtohet haptazi fëmijëve, ndërsa GT dhe RC janë përkthyer fillimisht për një publik të rritur, pavarësisht se sot lexohen gjerësisht nga fëmijët. Procesi i leximit dhe interpretimit nga ana e tyre mund të lehtësohet dukshëm nga shënimet në fund të faqes dhe në fund të veprës, pavarësisht shkallës së lartë të elementeve kulturore të huajëzuara. Ia vlen të theksojmë edhe një herë se ka paqedrueshmëri në lidhje me procedurën e përdorur për përkthimin e së njëjtës njësie brenda variantit në gjuhën shqipe, gjë që shoqërohet me vështirësi për kuptimin e origjinalit apo qëllimeve të shkrimtarit nga ana e lexuesve.

Do t'u rekomandonim përkthyesve që, nëse përballen me elementë specifikë kulturorë gjatë procesit të përkthimit, të ndalen fillimisht në përcaktimin e funksionit të synuar të përdorimit të elementëve të tillë, dhe, më tej, të përpiqen të përcjellin jo elementët në vetvete, por funksionin e tyre në gjuhën shqipe në mënyrë që edhe efekti i përcjellë nëpërmjet elementeve kulturore në origjinal të jetë sa më i ngjashëm edhe në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe.

Studimet përkthimore, duke përfaqësuar një ndërdisiplinë, ruajnë lidhje me shumë disiplina njëkohësisht dhe bëjnë subjekt studimi koncepte të ndryshme të përfshira në këto disiplina. Në punim jemi përqendruar në përshkrimin teorik të dukurisë së ndërtekstualitetit, veçanërisht studimin e aludimeve: identifikimin dhe analizimin e nënkuptimeve të shprehur nëpërmjet lojërave të fjalëve dhe emrave të përveçëm nëpërmjet shembujve konretë. Për përkthimin e lojërave të fjalëve kemi marrë si rast studimor veprën origjinale *Alice's Adventures in Wonderland* si një nga veprat ku ndërthuren bukur nënkuptimet e fshehura me kuptimet sipërfaqësore si pasojë e krijimit të një sërë lojërash fjalësh të qëllimshme nga shkrimtari. Pasi janë identifikuar lojërat e fjalëve në origjinal, janë krahasuar ato me praninë ose mungesën e tyre në secilin prej varianteve në gjuhën shqipe. Për secilin prej varianteve, kemi grupuar ato lojëra fjalësh që shfaqin prirje të njëjta të qëndrimit të përkthyesit dhe, pas këtij grupimi, kemi emërtuar strategjitë përkatëse që janë përdorur nga përkthyesi për t'i përcjellë lojërat e fjalëve në gjuhën shqipe. Këto strategji janë: rikrijimi i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer, përkthimi i përbërësve të lojës

së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer, mospërfshirje e lojës së fjalëve në tekstin e përkthyer si dhe transferim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer. Me mjaft interes kanë qenë edhe disa raste të vërejtura që shfaqin një tjetër prirje të përkthyesit – krijimi i një loje fjalësh në tekstin e përkthyer edhe pse një lojë fjalësh e tillë përkatëse nuk shfaqet në tekstin origjinal. Nga interpretimi i të dhënave të studimit tonë krahasimor, vërejmë se në mënyrë kronologjike, duke kaluar nga varianti i parë (1944) deri në variantin e pestë (2008) të përkthyer në gjuhën shqipe ka një rënie të rasteve ku loja e fjalëve është ruajtur.

Duke iu referuar gjithë korpusit nën shqyrtim, mund të themi se strategjia kryesore që mbizotëron është përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve, por pa rikrijuar nënkuptimin e origjinalit (strategjia e dytë – 46%). Në raste të rralla kemi vërejtur që nuk është përkthyer fare ajo pjesë teksti që përmban lojë fjalësh (2% në të gjithë korpusin), gjë që tregon se përkthyesit janë përpjekur t'i qëndrojnë besnikë cilësisë dalluese të tekstit origjinal, duke mos e anashkaluar rëndësinë që kishin për Kerrëlin lojërat e fjalëve dhe nënkuptimet. Në këtë drejtim, me mjaft rëndësi janë raste të tilla që flasin për një rikrijim të lojërave të fjalëve (në më shumë se një të tretën e gjithë korpusit – 37%) si dhe për një përpjekje për të transferuar lojërat e fjalëve nëpërmjet teknikave të ndryshme editoriale që i hyjnë në ndihmë lexuesve për të vendosur lidhje me synimet e shkrimtarit në tekstin origjinal (15% të gjithë korpusit). Fakte të tilla na bëjnë të mendojmë se lojërat e fjalëve mund dhe duhet të përkthehen, pavarësisht vështirësive me të cilat përballet përkthyesi sa herë që identifikon një lojë fjalësh në tekstin origjinal.

Do t'u rekomandonim sërish përkthyesve që të mos synojnë drejt një përkthimi të menjëhershëm të lojës së fjalëve, por të përfshihen fillimisht në një proces leximi dhe interpretimi të kujdesshëm, gjatë së cilit duhet të nxjerrin në pah edhe nënkuptimet e synimet e fshehura të shkrimtarit, dhe, pas një procesi tjetër kërkimi, të përcjellin pikërisht synimet e origjinalit, pa rënë në grackën e "besnikërisë" ndaj fjalëve të sipërfaqshme, por në kërkim të vazhdueshëm të transmetimit të efektit të përcjellë në origjinal.

Një çështje që shfaq shumë rëndësi dhe ngre shumë debate brenda studimeve përkthimore është dhe ajo që ka të bëjë me marrëdhënien mes formës dhe përmbajtjes. Jemi mbështetur në një shembull mjaft domethënës në këtë drejtim që shfaqet në AAiW – loja e fjalëve *tail – tale,* e cila gjen shprehje edhe në mënyrë grafike në origjinal. Ne kemi analizuar pikërisht format e ndryshme në të cilat është sjellë "bishti i miut" në gjuhën shqipe dhe, njëkohësisht, nëse përmbajtja apo kuptimi i shprehur në origjinal është ruajtur apo është sakrifikuar në dëshirën për të ruajtur formën.

Kemi arritur në përfundimin se përkthyesit duhet të kuptojnë që në fillim se marrëdhënia mes gjuhës dhe përmbajtjes është e ndryshme në origjinal dhe do të duhet të rikrijohet në gjuhën e përkthimit. Shkalla e vështirësisë që paraqet një gjë e tillë nuk duhet të shërbejë si pengesë për përkthyesit por si një sfidë për t'u përfshirë në horizonte të reja kërkimi. Edhe në këtë rast është me shumë rëndësi përcjellja e nënkuptimeve dhe synimeve të origjinalit, në përpjekje për të përcjellë efekt sa më të ngjashëm për lexuesit e tekstit të përkthyer.

Pjesë e diskutimit tonë ka qenë edhe studimi i emrave të përveçëm në dy prej veprave të korpusit tonë: *Harry Potter and*

*the Philosopher's Stone* dhe *Alice's Adventures in Wonderland.* Mendojmë se kjo pjesë e punimit është gjithashtu me mjaft interes meqenëse qëndrimet e mbajtura ndaj emrave të përveçëm të huaj janë të ndryshme. Jo vetëm kaq, por kemi vërejtur se përkthyesit nuk zbatojnë as parimet fonetike e fonologjike dhe nuk ua nënshtrojnë emrat e huaj kategorisë së shquarësisë, gjë që është e domosdoshme për gjuhën shqipe. Akoma më me rëndësi shfaqet ky problem në përkthimin e atyre emrave të cilat fshehin nënkuptime të qëllimshme nga ana e shkrimtarit. Për këto arsye, e kemi parë të nevojshme të prezantojmë një sfond teorik rreth përkthimit të emrave të përveçëm që më pas na ka ndihmuar në analizmimin e shembujve. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se janë katër teknika kryesore për përcjelljen e emrave të përveçëm: transferimi (ruajtja e formës origjinale), zëvendësimi (përdorimi i një emri korrespondues në gjuhën e përkthimit), përkthimi (gjetja e një forme ekuivalente në gjuhën e përkthimit) dhe përshtatja (modifikimi i formës së origjinalit sipas funksionit).

Vendimi i përkthyesit për përdorimin e njërës apo tjetrës teknikë është në varësi të (nën)kuptimit që bart emri në gjuhën origjinale. Përzgjedhja e emrave zakonisht është një proces i qëllimshëm nga shkrimtari dhe përkthyesi duhet t'i identifikojë më së miri rastet e emërtimeve të qëllimshme dhe funksionin e synuar të shkrimtarit, duke i dalluar ato nga emrat që nuk kanë ngarkesë semantike dhe konotative. Dukuritë e vërejtura në korpusin tonë në lidhje me përkthimin e emrave të përveçëm kanë qenë: përshtatja e emrave që emërtojnë personazhe historikë dhe referenca gjeografike, përkthim i emrit (duke e ruajtur ose jo paraqitjen grafike të tij), transferimi i emrit të personazhit (duke e shoqëruar ose jo me shpjegime ose shënime në fund të faqes), mospërkthimi i emrit të personazhit në raste të rralla, shtimi i ngjyrimeve konotative si rrjedhojë e transferimit apo zëvendësimit të emrit, etj.

Edhe një herë e gjejmë me vend të theksojmë se sa e rëndësishme është faza e lexim-interpretimit të origjinalit për të nxjerrë në pah synimet e fshehta të shkrimtarit në mënyrë që ato të përcillen me sa më shumë vërtetësi në gjuhën shqipe. Në fund të fundit, lexuesit e tekstit të përkthyer kanë në duart e tyre veprën e përkthyer dhe, për ta, e vetmja mënyrë për t'u afruar me shkrimtarin dhe synimet e tij (të qarta apo të fshehta) është pikërisht nëpërmjet kësaj vepre, gjë që vendos edhe më shumë përgjegjësi mbi përkthyesin dhe misionin e tij si ndërmjetës mes shkrimtarit, veprës origjinale, publikut marrës dhe veprës së përkthyer.

Pas analizimit të shembujve konkretë sipas shfaqjes së tyre brenda standardeve dhe shkallëve të ndryshme të përshtatjes, mendojmë se është me rëndësi që përkthyesit të njihen me dukuritë e përshkruara në fazën pregatitore të përkthimit të tekstit me qëllim që të njohin mënyra të ndryshme se si mund të përballen me elementë kulturorë të tekstit, dhe jo vetëm. Është e rëndësishme gjithashtu që përkthyesi të analizojë thellësisht origjinalin përpara se të përfshihet në procesin konkret të përkthimit. Standardet e ndryshme të përshkruara në këtë kapitull mund t'i hyjnë në ndihmë përkthyesit të letërsisë për fëmijë në veçanti, por edhe përkthyesit letrar në përgjithësi, duke e ndihmuar atë të tregohet sa më i kujdesshëm në përcjelljen e domethënies së origjinalit, por, njëkohësisht edhe në shmangien e dukurive të tjera, si, për shembull, keqpërkthimet serioze. Kjo na bën të reflektojmë edhe për shkallën e lartë të rëndësisë që ka publiku marrës në

përzgjedhjen e strategjive të përkthimit nga ana e përkthyesit, veçanërisht mosha e lexuesve si dhe njohuritë e tyre paraprake.

Një nga dukuritë më shpesh të vërejtura në përkthimin e letërsisë për fëmijë është thjeshtëzimi i origjinalit në nivele të ndryshme të përbërjes së tij. Qëllimi ynë ka qenë ta vështrojmë dukurinë e thjeshtëzimit në nivelin sintaksor. Për këtë arsye kemi marrë në shqyrtim variantin e tretë të përkthyer në gjuhën shqipe të *Alice's Adventures in Wonderland* dhe kemi shqyrtuar ndryshimet sintaksore që ndodhin gjatë përkthimit të fjalisë së përbërë. Kemi përzgjedhur pikërisht këtë variant sepse jemi të sigurt që ky variant u drejtohet fëmijëve dhe, për më tepër, është përkthimi i dytë që i bëhet origjinalit nga i njëjti përkthyes. Kemi marrë në analizë 655 fjali të përbëra të veprës origjinale dhe i kemi krahasuar ato me fjalitë përkatëse të gjetura në variantin në gjuhën shqipe. Ato fjali që kanë shfaqur dukuri të njëjta janë grupuar së bashku. Në përfundim të krahasimit, kemi vërejtur se gjatë përkthimit të fjalive të përbëra shfaqen këto dukuri: ruajtja e strukturës së fjalisë së përbërë, copëzimi i fjalisë së përbërë, thjeshtëzimi i strukturës së origjinalit, ndryshimi i llojit të pjesës së nënrenditur si dhe përdorimi ose jo i lidhëzës kundrejt origjinalit. Në 28% të gjithë rasteve të studiuara struktura e fjalisë është thjeshtëzuar ose nëpërmjet copëzimit të saj ose nëpërmjet reduktimit të numrit të pjesëve të nënrenditura ose të bashkërenditura, ndërsa në 17% të rasteve struktura e fjalisë paraqitet më e ndërlikuar se në origjinal si pasojë e shtimit të një pjese të nënrenditur ose të bashkërenditur ose shndërrimit të një fjalie të thjeshtë në një fjali të përbërë. Raste të tjera shfaqin mospërputhje të strukturës me origjininalin si dhe ndryshimin e llojit të pjesës së nënrenditur si dhe përdorim të lidhëzave edhe në rastet kur ato mungojnë në origjinal. Krahasimi i rezulatateve të studimit tonë na bën të mendojmë se prirja e përgjithshme e përkthyesit ka qenë vërtet thjeshtëzimi i strukturës së origjinalit, supozojmë nën ndikimin e faktit se përkthimi iu drejtohet haptazi fëmijëve. Edhe përdorimi i lidhëzave mendojmë se është një tjetër mënyrë për të qartësuar origjinalin.

Qëllimi është që të nxjerrim në pah disa anë problematike që i kemi vërejtur gjatë krahasimit të vazhdueshëm të veprave origjinale me përkthimet e tyre në gjuhën shqipe. Ndër këto probleme përmendim mungesën e koherencës (si ndaj tekstit origjinal, ashtu edhe në brendësi të vetë tekstit të përkthyer), gabime drejtshkrimore dhe përdorim të gabuar të presjes, shtrembërimin e strukturave morfo-sintaksore të gjuhës shqipe nën ndikimin e gjuhës së huaj, si dhe përdorimin e një sërë fjalësh e shprehjesh të huaja kundrejt atyre karakteristike shqiptare. Duhet të theksojmë se aspektet problematike të përshkruara shfaqen në përkthimet e pas viteve '90, gjë që na bën të reflektojmë edhe më shumë rreth gjendjes së përkthimeve së letërsisë për fëmijë në ditët e sotme, të cilat nuk i nënshtrohen një procesi të kujdesshëm analize dhe krahasimi qoftë nga ana e përkthyesve, qoftë nga ana e redaktorëve apo shtëpive botuese në përgjithësi. Tërheqim vëmendjen për ndërgjegjësimin e të gjithë faktorëve pjesëmarrës në përkthimin e letërsisë për fëmijë se letërsia për fëmijë nuk paraqet një gjini inferiore dhe se përkthimit të letërsisë për fëmijë nuk i duhet kushtuar më pak rëndësi se përkthimit të një gjinie tjetër, duke mos e lënë atë në mëshirë të një profesionalizmi të ulët dhe një procesi të pakujdesshëm redaktimi. Në fund të fundit, përkthimi i një libri për fëmijë paraqet probleme të ngjashme me përkthimin e çfarëdo lloj libri

tjetër, madje përfaqëson në vetvetë një sfidë edhe më gjithëpërfshirëse se gjinitë e tjera, nisur edhe nga mosha dhe formimi i lexuesve.

Shumë pyetje janë ngritur gjatë fazës analizuese të këtij punimi dhe shumë syresh vazhdojnë të kërkojnë përgjigje më të hollësishme. Shumë vepra të tjera, të papërfshira në studimin tonë, presin për t'u analizuar praktikisht sipas aspekteve teorike të përmendura në këtë punim.

Mundësitë që shfaqen për ta shtrirë këtë studim në të ardhmen, pasi kemi hedhur vetëm hapat e para nëpërmjet këtij studimi, janë edhe më interesante se në fillim dhe presin shtigje të reja që në fillim nuk kishim menduar të ishin pjesë e studimit tonë. Sa më shumë pyetje na dalin përpara, aq më shumë mendojmë se punimi aktual paraqet interes, sepse, mbi të gjitha, një studim ka për detyrë të ecë fillimisht në rrugë të reja, ndoshta edhe të pashkelura më parë, por, njëkohësisht, në faza të mëvonshme, të ftojë studiues të tjerë të bëhen pjesë e një rrugëtimi të përbashkët, në përballje të sfidave të reja.

## Bibliografi e shfrytëzuar


Aixelá, J. P. (1996). *Culture-specific Items in Translation.* Në *Translation, Power, Subversion.* (ed.) Roman, A.; Vidal, M. Carmen-Africa, Multilinugal Matters Ltd.

Allen, G. (2000). *Intertextuality.* London and New York, Routledge.

Carrol, L. (2001). *The Complete Stories and Poems of Lewis Carroll*. Midpoint Press: New Lanark, Scotland.

Carroll, L. (1944). *Liza në Botën e Çudinavet.* (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani, Tiranë.

Defo, D. (1982). *Robinson Kruzo.* (përkth.) H. Selfo; B. Doko,"Naim Frashëri", Tiranë.

Defo, D. (2007). *Robinson Kruzo* (përkth.) A. Bishqemi; L. Skëndo. Dy Lindje dhe Dy Perëndime, Tiranë.

Defoe, D. (2007). *Robinson Crusoe* .OUP, New York.

E. O'Connell (2005). *Translating for Children*. Në G. Lathey (ed.)

Gardener, M. (2000). *The Annotated Alice – the Definitive Edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA.

Karoll, L. (1961). *Liza në Botën e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Mihal Duri, Tiranë.

Kerël, L. (1998). *Liza në Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Shtëpia Botuese 'Mësonjëtorja': Tiranë.

Kerël, L. (2008). *Liza në Botën e Çudirave* (përkth.) Taulant dhe Eri Tafa, Shtëpia botuese: Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë.

Kerol, L. (2008). *Liza në Botën e Çudirave*. (përkth.) P. Shuraja, Redona: Tiranë.

Lathey G. (2006). *The Translation of Children's Literature. A Reader.* Clevedon: Multilingual Matters Ltd.

Pinsent P. (ed.) (2006). *The Translation of Children's Literature: A Reader*, Toronto: Multilingual Matters.

Rowling, J. K. (2002). *Harry Potter dhe Guri Filozofal.* (përkth.) A. Kasoruho. Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë.

Rowling, J.K. (1997). *Harry Potter and the Philosopher's Stone*. London: Bloomsbury.

S. Bassnett (1993). *Comparative Literature: A Critical Introduction*. Oxford: Blackwell.

Suift, Xh. (1974). *Udhëtimet e Guliverit ndër vise të largëta të dheut.* (përkth.) H. Selfo. Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.
Suift, Xh. (2007). *Udhëtimet e Guliverit.* (përkth.) A. Bishqemi. Dy Lindje dhe Dy Perëndime, Tiranë.
Swift, J. (1961). *Gulliver's Travels,* London J. M. Dent & Sons Ltd. Aldine House, Bedfort Street, London.

# DIMENSIONET E FANTASTIKES NË LETËRSINË SHQIPE TË SHEKULLIT XX

**ERIS RUSI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Objekt hetimi i këtij punimi do të jetë fantastikja në letërsinë shqipe, ku nga gjurmët e hedhura do të skicohet kalimi apo shtegtimet e autorëve të ndryshëm në hartën letrare të modernitetit shqiptar.

*Faza e parë* do të shënohet nga një punë intensive kërkimore e teksteve, që do të mundësojnë një konturim historik të dimensioneve të fantastikes në letërsi.

*Faza e dytë*, që do të përfshijë pjesën qëndrore të punës, ka të bëjë me studimin analitik të literaturës së përzgjedhur, që përmban tekste ku strukturohen dimensionet e fantastikes në letërsinë shqipe.

*Faza e tretë* do të cilësohet nga rishikimi përfundimtar i materialit të plotë të studiuar.

Në tërësi, zgjedhja e teksteve do të bëhet bazën e disa cilësimeve të përgjithshme, ku do të skicohen kufijtë e llojit, pasi të jetë propozuar një definicion paraprak, që të justifikojë kriteret e përfshirjes dhe të përjashtimit.

Nga pikëpamja metodologjike, identiteti i fantastikes mund të gjendet, në realizimin e saj konkret tekstual, në bashkëpraninë dhe ndërveprimin e dy përbërësve: njëri i rendit tematik dhe njëri i rendit stilistik-formal.

Si përfundim do të konturohen dimensionet e fantastikes në letërsinë shqipe, duke verifikuar shembuj në letërsinë shqipare, ku fantastikja duket se lind me forcë e furi më të madhe dhe jep rezultatet me të mira (posaçërisht) në periudhat e represionit politik kulturor dhe joliberal.

**Fjalë çelës:** *fantastikja në letërsi, tiparet e fantastikes, konturim historik, studim analitik, realizim tekstual, kriter*.

**Abstract**

The research object of this paper will be fantastic in Albanian literature, where from the traces cast, will be designed the transition or migration of various authors on the literary map of the Albanian modernity.

*The first phase* will be marked by an intense research work of texts, which will enable a historical outline of fantastic'sdimensions in literature .

*The second phase*, which will involve the central part of the work, deals with the analytical study of selected literature, and contains texts, where the dimensions of fantastic are structured in Albanian literature.

*The third phase* will be characterized by the final review of the full study material.

In general, the selection of texts will be made on the basis of some general settings, where it will be drafted the type limits, after it is proposed a preliminary definition, which justifies the criteria of inclusion and exclusion.

From the methodological point of view, the identity of fantastic can be found in its concrete literalrealization, in co-existence and interaction of the two components: one of the thematic order and the other one of stylistic - formal order .

Finally, it will be framed the fantastic's dimensions in Albanian literature, verifying examples in Albanian literature, where fantastic bear strongly resembles of the greater frenzy and gives better results (especially) in periods of political,cultural and illiberal repression.

**Key word**: *fantastic element in literature, features of fiction, historical outline, analytical study, textual realization, criterion.*

Punimi me temë "Dimensionet e fantastikes në letërsinë shqipe të shekullit XX" mbështetet mbi studimin e fenomenit të fantastikes në letërsinë shqipe, duke analizuar autorët që kanë hedhur hapin "e papërfillshëm" në këtë dimension, me thjeshtësinë e kalimit nga njëra anë (universi botësor) tek ana tjetër, duke fshirë natyrshëm terrenin e hollë të kufirit. Debati rreth përcaktimit dhe kufijve të fantastikes, ka lindur që me manifestimet e para të kësaj gjinie, por gjatë harkut të shekullit XX nxiti vendosmërisht kritikët të ndërgjegjësohen për dukurinë e ta bëjnë objekt të hetimit specifik.

Në këtë fazë, veç të tjerash, si referime udhëzuese mund të shërbejnë hyrjet në letërsinë fantastike nga autorë dhe kritikë ndërkombëtarë, si Tzvetan Todorov, Italo Calvino, Roger Caillos, etj. Ky i fundit , jep njërën nga kordinatat përcaktuese në këtë hulumtim, kur thotë:

*"Fantastikja manifeston një skandal, një prerje, një ndërhyrje të pazakontë, gati të padurueshme, në botën*
*e realitetit: pra është prishja e rendit të njohur, një sulm për depërtim i të papranueshmes, brenda legalitetit të pandryshueshëm përditësor".* (Caillos, pp. 150-152)

Objekt hetimi i këtij punimi është fantastikja në letërsinë shqipe, ku nga gjurmët e hedhura do të skicohen kalimi apo shtegtimet e autorëve të ndryshëm në hartën letrare të modernitetit shqiptar. Për të bërë këtë, synohet të jepet një reflektim kritik, për të identifikuar dhe sjellë modelin ndërkombëtar të fantastikes. E gjithë kjo duke marrë përsipër për të gjetur në këtë evokim artistik, gjurmët e transgresionit dhe një ngarkesë domethënëse agresive ndaj aspekteve të realitetit që shformësohen dhe bëjnë luhatjen e pamjes panoramike të ekzistencës.

Kjo nuk do të thotë që ka një limitim vetëm ndaj varianteve të sjella deri më sot nga kritika mbi këtë çështje, por listimi dhe trajtimi i zërave mbi argumentin, do të bëjë më të dukshëm dallimin dhe veçimin e elementeve që na interesojnë, për të përfytyruar dimensionet e fantastikes në letërsinë shqiptare.

Kështu, objektivi i studimit do të fokusohet në veprat e autorëve shqiptarë si Ismail Kadare, Anton Pashku, Ernest Koliqi, Kasëm Trebeshina, Martin Camaj, Mitrush Kuteli, Petro Marko, Fatos Kongoli, Vath Koreshi, ku nga këta autorë veç të tjerash do të analizohen veprat "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kronikë në gur", "Kështjella", "Pallati i ëndrrave", "Koha e shkrimeve", "Spiritus", "Vajza e Agamemnonit", "Tregime fantastike", "Oh", "Hija e maleve", "Tregtar flamujsh", "Pasqyrat e Narcizit", "Odin Mondvalsen", "Rrathë", "Rinë Katerinëza", "E madhe është gjëma e mëkatit", "I humburi", "Kufoma" ,"Lëkura e qenit" etj. Kërkimi mbi tekstet e autorëve do të bëhet duke ndjekur motive çelës si:

a- ndërprerja e koherencës universale

b- bota reale dhe bota e mundshme si simetri e jetës dhe e vdekjes;

c- kushtëzimi sensorial, emotiv dhe intelektual përballë dukurive të pashpjegueshme;

d- përkohësia dhe përjetësia nën petkun e fatit dhe fatalitetit;

e- dinamizmi dhe intensiteti për të zhveshur misterin e çiftëzimit eros – thanatos;

f- çkodimi i domethënieve tokësore dhe hyjnore në marrëdhëniet afektive.

g- hezitimi ndërmjet një shpjegimi racional e realist dhe pranimit të të mbinatyrshmes.

Në tërësi, zgjedhja e teksteve është kryer mbi bazën e disa cilësimeve të përgjithshme, ku skicohen kufijtë e llojit, pasi propozohet një definicion paraprak, që justifikon kriteret e përfshirjes dhe të përjashtimit. Kjo ngjan e domosdoshme, aq më tepër kundrejt një kategorie problematike si ajo e fantastikes, ndaj së cilës grindjet dhe mëritë e përcaktimit u janë imponuar kritikëve me më shumë intensitet se në raste të tjera.

**Tiparet e fantastikes dhe veçoritë e shkrimtarit të letërsisë fantastike**

Gjatë shqyrtimit të reflektimeve më domethënëse teorike që janë përqendruar mbi letërsinë fantastike bashkëkohore, shpaloset një çështje që ka angazhuar jo pak kritikët: bëhet fjalë për fantastiken dhe për patentën e saj si gjini apo si mënyrë letrare. Disa studime të fundit, synojnë në fakt të konsiderojnë fantastiken më tepër sesa si një gjini historikisht dhe gjeografikisht të përcaktuar, si "një mënyrë letrare, që ka patur rrënjë historike precize dhe ka gjetur zbatim historikisht në disa gjini dhe nëngjini, e që ka mundur e vazhdon të përdoret edhe sot në vepra që i përkasin gjinive të ndryshme letrare.

Elemente dhe sjellje të mënyrës fantastike, gjenden me lehtësi të madhe në vepra me strukturë mimetike-realiste, patetike-sentimentale, përrallore, komike-karnevaleske e të tjera akoma, por ka një traditë precize tekstuale, e gjallë gjatë shekullit XIX, e që vijoi rregullisht gjatë shekullit XX, ku mënyra fantastike përdoret për të organizuar strukturën themelore të përfaqësimit, dhe për të transmetuar në mënyrë të fortë dhe origjinale, përvoja turbulluese për mendjen e lexuesit". Këto konsiderime, do të hiqen si filtra vlerësues në krahasimin dhe përcaktimin e dimensioneve të fantastikes në letërsinë shqiptare, duke mundësuar përballjen e vazhdueshme të saj me letërsinë botërore. Rregullat dhe modeli i ngjashëm, e çlirojnë nga mjaft vështirësi këtë konfront.

Çështja tjetër është: nëse shkrimtari është i prirë të lëvrojë fantastiken në temat e veprave të veta, atëherë si është e mundur që vepra e tij të jetë e kuptueshme për lexuesin? Është e qartë se shkrimtari jep në vepër jo rrjedhën e fantazisë së ndarë nga realiteti, por diçka më tepër.

Interesante është të trajtohet në këtë kontekst, pikëpamja e Frojdit për natyrën e shkrimtarit si model përgjithësues i artistit.

*"Artisti", -thotë Frojdi, " është në themel një njeri që nuk e pranon realitetin, sepse nuk mund të pajtohet me kërkesën për të hequr dorë nga plotësimi i kënaqësive instinktive. Prandaj ai lidhet me botën e fantazisë dhe u lë dorë të gjitha dëshirave erotike e ambicioze të tij. Por ai e gjen rrugën për t'u kthyer nga bota e fantazisë tek realiteti. Me dhuntinë e veçantë që ka, ai gatuan një realitet të ri dhe njerëzit rreth e rrotull pranojnë ta njohin atë si pasqyrim të realitetit të vërtetë. Në këtë mënyrë ai bëhet heroi, mbreti, krijuesi, favoriti."*( Freud , pp. 458-459)

Pra shkrimtari i letërsisë fantastike është një ëndërrimtar, ekzistenca e të cilit

lidhet me shoqërinë. Pa e ndryshuar karakterin e vet, ai mbetet i përjetshëm dhe boton fantazitë e tij.

Teoria që e quan artin neurozë shtron çështjen e marrëdhënieve midis imagjinatës dhe bindjeve. Romancieri i letërsisë fantastike i ngjan sadopak fëmijës që "rrëfen historia", domethënë që rikrijon realitetin sipas dëshirave dhe përfytyrimeve të veta, por i ngjan edhe atij të rrituri që vuan nga haluçinacione dhe që nuk është në gjendje të dallojë botën reale nga bota e fantazisë, e shpresave dhe e frikërave të tij.

Edhe në letërsisë me konotacione të forta realiste, mund të përqafohet ky lloj interpretimi.

Disa romancierë, p.sh. Dikensi, kanë thënë se i kanë parë të gjalla personazhet e veta, se ka ndodhur madje që personazhet kanë marrë vetë në dorë subjektin dhe e kanë çuar atë deri në fund, ndryshe nga ç'kishte menduar romancieri në fillim.

Nga gjithë kjo, duhet pranuar se *homo scriptor*, shkrimtari, nuk mund të jetë vetëm i një tipi. Psikologu frances Ribo i ndante artistët e fjalës në dy tipa kryesorë të imagjinatës.

Tipi i parë, imagjinata plastike karakterizon vrojtuesin e mprehtë vizualizues, i cili frymëzohet në radhë të parë nga vëzhgimi i botës së jashtme me anë të perceptimit; përkundrazi imagjinata pa formë (dëgjimore dhe simbolike) është imagjinata e poetit simbolist ose e shkrimtarit romantik, i cili frymëzohet nga emocionet dhe nga ndjenjat e veta. Nuk ka dyshim se nga mendimi i Ribosë nisej edhe T. S. Eliot, kur kundërvinte imagjinatën pamore të Dantes me imagjinatën dëgjimore të Miltonit.

**Kërkimi i fantastikes si arratisje nga realiteti në letërsinë shqipe**

Kërkimi i fantastikes do të bëhet duke impenjuar si kriter të njohjes së "fantastikes" në një tekst, kriterin e problematizimit dhe të vënies në krizë të konceptit të reales dhe për pasojë, të nocionit të së mundshmes: tregimet pa këtë lloj kriticiteti – në rastin kur realitetet e përshkruara manifestohen që në incipit si të dallueshme në mënyrë radikale nga bota e lexuesit, ose sepse teksti është mbi këtë pikë i shifruar sa t'i mungojë një funksion i vërtetë referencial dhe të luajë ekskluzivisht rolin e adresimit në një sens të dytë, ose kur e pamundura gjen në këto një justifikim esplicit psikologjik, fetar, pseudo-shkencor etj., pa dyshim komunikojnë, në anë, me botën fantastike, por nuk zënë qendrën e saj.

Binomi letërsi fantastike –heshtje/ konsensus, i ka dhënë rrugë (edhe) në letërsinë shqiptare, kritikave dhe keqkuptimeve në interpretim dhe debat. Sa në imagjinatën e publikut, po aq edhe në ambientet akademike, fantastikja është konsideruar për një kohë të gjatë si gjinia e arratisë së përsosur nga realiteti. Në mënyrë të veçantë, ka patur dyshime apo antipati, ndaj fantastikes, si gjini e papërgjegjësisë etike, shoqërore e politike, që janë markuar e kanë patur rritje sidomos në kohën e "emergjencave" historike, ku heshtja e letërsisë mbi realen ka barazvlerë si miratim i gjendjes reale.

Në letërsinë shqipare, fantastikja duket se lind me forcë e furi më të madhe e jep rezultatet me të mira (posaçërisht) në periudhat e represionit politik kulturor dhe joliberal.

Fenomeni i analizuar verifikohet simetrikisht njëlloj edhe në letërsinë e huaj, qoftë edhe nëse kjo i atribuohet vlerës simptomatike të fantastikes, kundrejt gjendeve të krizës dhe mospërshtatjes së individit në termat e shoqërisë dhe në konfigurimet historike; qoftë kur ekziston, e regjistruar në vetë dinamikat e represionit, një prirje për të investuar energji të kundërta në përmbysjen e kodeve dhe të rendit; qoftë

edhe akoma për mundësinë që ofron fantastikja, për t'i adresuar shoqërisë represive kritika të nëndheshme, që janë në gjendje të kalojnë, të maskuara nën petkun e ireales, nëpërmjet rrjetave të censurës.

Përmasat e fantastikes në letërsinë shqipe, bëhen transparente nëpërmjet mekanizmit të "zgjedhjes" së karaktereve "përtej valëve të kohës", të cilat dalëngadalë ndeshen me botën irreale, me atë tragjike misterioze të jetës ku projektohet bota e fantastikes.

Në këtë terren, ku procedohet "bota e përtejme" dhe mpleksen elementet konkrete me ato abstrakte, tematizohen motivet e vullnetit dhe motivet e arsyes apo dëshira dhe mundësia gjatë thurrjes së intrigës, tipari i fantastikes, shpalos misterin, në sfumatura të ndryshme dhe si element transformist ndryshon nga situata në situatë.

Mund të sjellim, përveç kësaj, edhe paraqitjen e së bukurës dhe të magjikes në veprën e Kadaresë, Kongolit, Pashkut, Kutelit, në dhënien e forcës së teksteve ku lindin përplasjet e kontaktet metafizike kundër qenies gllabëruese të kohës. Kështu, mund të listohen tema dhe motive të tilla si:

a) T'i besosh misterit;

b) E dashur imagjinatë, ajo që dua më tepër se ty është se nuk fal;

c) Ankthi i mistershëm i vdekjes;

d) Ngritja dhe rënia në konceptimin artistik të fantastikes;

e) Fantastikja dhe realiteti; në zbulim të Botës së Re;

f) Përtej portës së mbyllur: zbulimi i sekreteve;

g) Gjykimi i lirë dhe sensi i religjiozitetit;

h) Miti i "të izoluarit" të madh; etj.

**Fantastikja në letërsinë shqipe**

Rrëfimi fantastik merr origjinën e vet me lindjen e gjuhës tek njeriu. Banorët primordialë, të mbledhur rreth njëri-tjetrit kur errësira mbulonte botën e re, tregonin ngjarje që transformoheshin, merrnin jetë dhe si hije njerëzish, rriteshin rrotull zjarrit të ndezur, për të mbajtur larg frikën dhe egërsirat.

Sipas teorisë së Evemerit (filozof grek që ka jetuar në shek. III p.K), perënditë s'ishin tjetër veç njerëzit e kohërave antike, të hyjnizuar nga pasardhësit e tyre për forcën e jashtëzakonshme dhe për aventurat e tyre mbinjerëzore.

Nga kjo atmosferë mitike, Shqipëria komuniste përkonte shumë me errësirën e zgjeruar të regjimit që donte të njehsonte rregullat dhe diktatin mbi ekzistencën e përbashkët të njerëzve.

Tek "Letërsia sot", Roland Barthes shkruan: *"Shkrimtari mund ta vendosë thellësisht veprën e tij në botën që e rrethon, në problemet e saj, por në të njëjtën kohë mund të pezullojë këtë vendosje pikërisht aty ku doktrinat, partitë, grupet dhe kulturat i sugjerojnë një përgjigje." (*Barthes*,* 2002, pp.*55-57)*

Pra me gjithë sistemin represiv që kërkonte formimin e njeriut të ri, shkrimtarët kishin mundësi t'i shmangeshin boshtin të përcaktuar të rregullave; të pezullonin kontaktin me realitetin, duke krijuar një lidhje të re.

Në botën paralele të krijuar, imagjinata dhe elementët fantastikë mund t'i gjallëronin, t'i mpaknin apo t'i transformonin edhe fytyrat e pandryshueshme, të muzgëta dhe të ngurta të librave të kohës.

Për t'u përmendur në këtë drejtim, erdhën me botimet e tyre autorë si Kasëm Trebeshina, Ernest Koliqi, Vath Koreshi, Anton Pashku, Mitrush Kuteli, Petro Marko, Ismail Kadare, Fatos Kongoli etj., që me krijimet e tyre iu përvodhën mureve estetike të realizmit të ngushtë. Por kjo letërsi e tyre, a mund të konsiderohet për imagjinatën e publikut si "letërsi e arratisë" *par exellence*?

Në perëndim, ka gjetur përkrahje dyshimi dhe kundërshtia ndaj fantastikes, e cilësuar si papërgjegjshmëri shoqërore, etike dhe politike. Kjo veçanërisht në kohët e "emergjencave historike", kur heshtja e letërsisë ndaj reales është konsideruar si një lloj strehimi i sigurt i shkrimtarit në kullën e fildishtë, por ekuacioni heshtje-konsensus ndaj regjimit humbet vlerë në territorin e letrave shqipe. Arratisja e autorëve shqiptarë mund të shihet si kërkesë shpirtërore e njerëzve që vit pas viti gjatë një gjysmë shekulli, kultivuan ëndrrën për të thyer barrierat e gjembta të izolimit.

Fantastikja tek këta autorë paraqet një tjetër-botë shpirtërore, ku ngre krye vetmia dhe ankthi i njeriut, tensionet e kohës dhe kyçet e përdredhura të ëndrrave. Me afirmimin e njeriut të ri dhe të shoqërisë së masave, njerëzit humbën njëra pas tjetrës liritë e tyre, ndaj perceptimi i reales u fut në krizë dhe vetëm fantazia mund të shërbente si gjuhë e përkthimit të njerëzve-numra, në individë me shpirtra të lirë.

E tillë është fantastikja në letërsinë shqipe: një ndërhyrje e padurueshme në rregullat socrealiste të krijimtarisë; një kapërcim temash dhe përmbajtjesh që dilnin nga izolimi i bunkerit dhe njehsoheshin me letërsinë e lirë perëndimore; një sulm ndaj panoramës së zymtë shqiptare, të zbehtë si çehre prej të sëmuri.

Fantastikja në Shqipëri pasqyronte një mit prometean, por të kthyer për mbrapsht, ku atdheu i gozhduar në kryqet e malit, kafshohej nga kthetrat e lira të shpendit letrar, për ta zgjuar nga letargjia e padurueshme e vdekjes.

**PËRTEJ KUFIRIT: ËNDRRAT QË LËKUNDIN BOTËN**

*"...gjithçka është e kotë, e kotë është ëndrra;*
*...gjithçka është e kotë, gjithçka është ëndërr"*

"Këngët orfike", Dino Kampana

Elementi i fantastikes del në pah më dukshëm në raportin që bashkon ëndrrat me realitetin. Momenti kur projektohen dhe dalin të shtrira në kohë fate individësh realë, apo kur bota e gjumit varet në dritaret e njerëzve dhe u hap atyre kanatat e mistershme të jetës, ka qenë përherë zgjedhje e autorëve që luajnë me realen dhe irealen në vepër.

Faktikisht vetë shkrimtari është një ëndërrimtar i lindur. Përmes krijimeve të tij ai ëndërron të krijojë një botë, të gjallërojë nga balta e kujtesës hije njerëzish që mbushen me vitalitet, bëhen të prekshëm dhe gjejnë vendin përkatës në vepër. Për të ilustruar këtë mendim, vjen në ndihmë qëndrimi i regjisorit Federiko Felini i cili thotë:

*"Në të njëjtën mënyrë që individi përmes ëndrrave të tij shpreh atë pjesë të vetes që ka më sekrete, më misterioze, më të pazbuluar, po ashtu kolektiviteti, njerëzimi e bën të njëjtën gjë përmes krijimit të artistëve. Krijimtaria artistike, atëherë, s'është gjë tjetër veçse aktiviteti ëndërrimtar i njerëzimit"* (Fellini, 1983, pp.159-160).

Ismail Kadare është udhëkryqi ku përthyhen këto qëndrime teorike, ku ëndrrat dhe bota e trazuar reale shkrihen dhe nxjerrin në pah dritëhijet misterioze të ekzistencës.

Elementët e fantastikes tek vepra e tij përfshijnë gati tërësinë e botimeve, duke filluar që nga "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kronikë në gur", "Ura me tre harqe", "Kush e solli Doruntinën", 'Pallati i ëndrrave" e të tjera më radhë.

Meqenëse mbi këto vepra është shkruar dhe trajtuar gjerësisht, në dritën e këtij punimi do të përqendrohemi mbi

përmbledhjen me tregime dhe novela "Ëndrra mashtruese".

Tregimi nga merr titullin dhe libri, është një përzierje e mitit, e fantastikes dhe imagjinatës së autorit; një miniaturë domethënëse që qartëson procesin krijues të tij.

Kadare e merr thelbin e ngjarjes nga mitologjia greke, ku ëndrrat konsideroheshin fëmijë të Gjumit dhe të Natës. Përveç Morfeut që parathoshte të vërtetën, ai që përçonte iluzionet e marra, ekstravagancat fantastike dhe mashtrimet në gjumin e njerëzve, quhej *Fantaso*.

Nga ky mit i origjinës ne mund të depërtojmë në leximin e tregimit duke njohur nga afër personazhin kryesor që kryen shtirjen e iluzioneve mashtruese mbi qerpikët e mbyllur. Nëse Kadare e fillon me një citim nga "Iliada" e Homerit, po ashtu shohim që dhe tek "Odiseja"përçimi i ëndrrave këndohet në vargje si më poshtë:

*Nga porta e fildishit dalin*
*Falsët dhe fantazmat,*
*Me vete shpresa*
*Të kota e të dështuara çojnë...*
*"Odisea", Libri XIX*

Ka një truk tinëzar në misionin e rrëfyer nga Kadare. Me gjithë ëndrrat mashtruese dhe procesin e shpërndarjes, një pjesë e njerëzve që depërtohen prej tyre janë figura qëndrore botërore, emra realë dhe konkretë që lexuesi i njeh mirë. Mes tyre është dhe vetë emri i Kadaresë, krahas Konfucit, Borgesit, Gorbaçovit etj. por kemi dhe emra personazhesh si Makbeth dhe Ana K.

Shtirja e fantastikes pështjell njëkohësisht botën reale me atë ireale, njerëz të gjallë dhe personazhe librash, të vdekur të famshëm dhe Perëndi.

Ngatërresat e vogla bëjnë që projekti i Dantes të ngatërrohet me atë të Dedalusit, pra të këmbehet miti me letërsinë, ose projekti i Hitlerit të ndërrohet me atë të Xhenxhis Khanit, pra lashtësia me historinë.

Në gjithë këtë proces, shpjegimi i detajuar dhe mënyra bindëse e rrëfimit të ngjarjeve, bën që teksti të pranohet pa kushte si diçka që nuk ngjall çudi tek lexuesi.

Kjo është një veçori tipike e fantastikes në letërsi dhe e realizmit magjik në veçanti. Bota e fiksionit nuk ndahet nga realiteti dhe anasjelltas. Kadare ka një largësi ironike nga pikëpamja e rrëfimit fantastik të ngjarjes, aq sa të mos komprometohet realiteti. Njëkohësisht ai e respekton "të pazakontën" e rrëfimit, pasi përndryshe miti i treguar rrezikon të shndërrohet në një fantazi totale, të shkrihet në një përrallë të thjeshtë, në vend që të sinkronizohet me realitetin.

Në rrjedhën e këtij tregimi vjen trilogjia mitologjike që përmban: "Prometeun", "Natën e Sfinksit" dhe "Murit Kinez", ku veç ndërthurjes së reales me irealen, ajo çka dallon është koha e ngërthyer pezull, pa fillim e mbarim, ku nga kaosi i botës dalin përgjigje mbi jetën në vijim.

Në novelën "Ndërtimi i piramidës së Keopsit", kemi të njëjtën atmosferë ku puhia e kohës pështjellon përjetimet dhe ndjesitë e lexuesit. Kadare ofron një ëndërr të rastësishme, parashikuese ndjesish të këqija, që sa më ireale ngjante në rrëfim, aq më shumë ndillte pasiguri dhe panik:

*"Një mëngjes përpara faraonit sollën një njeri që kishte parë një ëndërr të rëndësishme: piramidën e Keopsit të mbuluar me borë! Askush nuk guxonte t'i jepte shpjegim. Trembeshin nga dëbora...Që piramida jepte e merrte me gjithë botën, kjo ishte e qartë. Gjersa kishte mundur të tërhiqte dëborën që nga viset e frikshme veriore, do të thoshte se kishte kohë që edhe vetë të shkonte gjer atje, në mendime, në ëndrra, në udhë të tjera ndoshta"(* Kadare, 1991).

Analogjia dhe alegoritë e përdora nga Kadare, duke afruar krijimin me aktualitetin e ditëve moderne, nxjerr në plan të parë sofistikimin e artit të tij.

Ai e përplas realitetin kundrejt simboleve të së hershmes antike dhe përpiqet ta çlirojë atë, të zbulojë çfarë fshihet pas misterit të gjërave, pas misterit të jetës, në sjelljet e njerëzve.

Ngjan sikur misioni i krijuesit atëherë nuk është ripërpunimi i realitetit mbizotërues, por një tentativë e tronditjes së atij realiteti, duke matur me kujdes misterin që fshihet pas gjithçkaje.

**Memoria dhe identiteti përmes metaforës së njohjes në letërsinë fantastike**

Në librin "Gjin Bardhela i arbëresh"; "Etja e gurëzuar", i autorit Anton Nikë Berisha shfaqen tre elemente që lidhen me identifikimin dhe identitetin etnik të personazhit të librit, me përthyerjen e metaforës së kërkimit si një dëshirë e njeriut të etur për njohje, deri sa vjen gurëzimi, përjetësia në kohë. E gjithë kjo, ndiqet nga hyrja e veprës, ku jepet mendimi i Lessing mbi konceptin e njohjes:

*"Vlera e njeriut nuk qëndron tek e vërteta që zotëron ai, apo që pandeh se e zotëron, por te përpjekjet e çiltra që bën duke e kërkuar atë"*.

Vëmendja e Berishës është sa ndaj asaj çka është krijuar në të shkuarën, aq edhe ndaj bashkëkohores. Kjo karakteristikë, shndërrohet në gurin themeltar të veprës "*Etja e Gurëzuar*", ku beteja e errësirës kundër dritës, ndiqet nga përpjekja e mundimshme e jetës, t'i mbijetojë vdekjes. Në kapitullin e dytë "Gruaja me yje në sy", kemi tentativën e rindërtimit të së shkuarës. Metafora që hapet dhe zë gjithë hapësirën e ndijimit, lidhet me mitin e "Mbjelljes së dheut":

*""...Kur të Parët tanë braktisën vendin e tyre, morën me vete nga një grusht dhe' dhe kushdo që vdiste ia hidhnin në varr disa dërrudhëza.Më vonë, kur dheu zuri të pakësohej, ato pak dërrudhëza që u kishin mbetur, që të mos mbeteshin pa to, i mbillnin në oborrin e shtëpive ose në arat e tyre. Tamam, e mbillnin dheun si mbillej fara në arë..."* (Berisha, 2002, p. 27).

Ky ilustrim, me një peshë dhe forcë të jashtëzakonshme metaforike, ngjason me tentativën e rimëkëmbjes të jetës së një kombi, të traditës së tij, në kushtet e një shpërnguljeje që s'është vetëm fizike, por edhe bartje e vendosur e vlerave dhe tipareve dalluese. Në ditët e sotme komunikimi është i mbushur me mite pothuaj irracionale, të pabesueshme, që janë më arkaike se mitet më të vjetra. Mjaft të mendohet për prirjet e grupeve të veçanta, që kryejnë rituale mistike me rite që ngjajnë më të vjetër dhe më të largët në kohë se çdo përfytyrim i mundshëm.

Kësaj prirjeje për të shkatërruar ekuilibrin, i kundërvihet qëndrimi i Gjin Bardhelës, i cili nuk dëshiron të shkatërrojë por të lidhë dhe të harmonizojë, të rindërtojë me kujdes fijet e së shkuarës, njëlloj siç e tregon tradita.

Kështu, ndërsa tradita e Nëntëqindës, kultura perëndimore sidomos, synonte të ishte një traditë e demistifikimit, e çmontimit të miteve, të vlerave fetare dhe të traditave, dëshmia e autorit Berisha është në drejtim krejt të kundërt, me prirjen për të rimëkëmbur botën e folklorit dhe simbolikën identitare të një kombi, brenda kornizës së një kombi tjetër.

Ky proces është veçanërisht i dukshëm në fenomenin e kondensimit onirik, që Matte Blanko e sqaron nëpërmjet modelit të shumë-dimensionalitetit të hapësirës psikike; nëse mund të ndodhë që, gjatë një ëndrre, të perceptojmë që një hapësirë (për shembull një sallon) është i tillë dhe njëkohësisht diçka tjetër ( ta zëmë një kopsht), ose që një individ mund të marrë në vetvete identitetin e tij dhe atë të një personi tjetër, kjo vjen pasi në rrethana të

caktuara "ëndërrimtari 'sheh' një botë me shumë-dimensionale me sy të krijuar vetëm për një botë tredimensionale, duke reduktuar domosdoshmërisht ngjarjet e konceptuara në një hapësirë me shumë dimensione, brenda një modeli të pamjaftueshëm për t'i kuptuar ato."

Brenda letërsisë fantastike, thyerjet logjike të rendit hapësinor mund të japin rezultate që ndryshojnë në mënyrë radikale, në varësi të strategjive tekstuale që ofrojnë përfaqësimin e tyre.

Kjo duke u përpjekur të ndiqet një lloj harmonizimi i së kaluarës, me ngjyrimet e reja të botës sot, duke marrë mbështetje dhe referim edhe nga materiali fetar, biblik, ku përligjen të gjitha metaforat e përhershme, që kanë mundur të mbeten të pandryshuara që nga shkrimi i parë i Biblës. Ndodh atëherë, që brenda një personazhi të vetëm të kemi ngjyrimet plotësuese dhe kundërthënëse të botës, mitin, folklorin, religjionin, erosin dhe botën njerëzore të mbushur me dobësitë dhe ndijimet metafizike.

**PËRFUNDIME**

Nga pikëpamja metodologjike, ky punim do të vlerësojë edhe supozimin që fantastikja, në rezultatet e saj më të arrira dhe inovatore, përbën një mënyrë narrative specifike, johomogjene në brendinë e saj, por e prekshme dhe e dallueshme nga disa konstante, që ia vlejnë të hetohen. Fantastikja implikon internacionalitetin, pra lidh e komunikon me autorë që bëjnë pjesë në periferi të dallueshme kombëtare, e kështu duke rezultuar e paimagjinueshme ekzistenca e një Borghesi pa fantastiken anglosaksone, të një Buxati pa Kafkën, e në përgjithësi të një letërsie fantastike bashkëkohore pa paraardhësit e saj romantikë.

Në vija të përgjithshme, identiteti i fantastikes mund të gjendet, në realizimin e saj konkret tekstual, në bashkëpraninë dhe ndërveprimin e dy përbërësve: njëri i rendit tematik ( prania e elementit të mbinatyrshëm e në sens të gjerë të papranueshëm) dhe njëri i rendit stilistik-formal ( trajtimi i veçantë narrativ, të cilit i nështrohet ajo lloj tematike). Nëse është e vërtetë se një ndërveprim i tillë analog çon në përcaktimin e pjesës më të madhe të gjinive letrare, ky shfaqet tej mase i prerë e kategorik në rastin e fantastikes, ku për të krijuar fantastiken nuk mund të vlejë asnjë arsye ekskluzivisht tematike (përfaqësimi i të mbinatyrshmes, sipas kodeve të tjera, çon lehtësisht, drejt së mrekullueshmes), asnjë arsye ekskluzivisht formale.

Duke hedhur dritë mbi këto konsiderime, analiza në fjalë do të jetë e detyruar të lërë pas çdo lloj ambicieje ndarëse dhe dalluese, por do të sulmojë objektin e saj nga shumë fronte, duke bërë të ndërveprojnë në mënyrë konstante aspekte formale dhe tematike, në tentativën për të dalluar në kryqëzimin ndërmjet niveleve dhe në tensionin e brendshëm me shtresëzimin, logjikën e veçantë dhe karakteristike të fantastikes.

Trajtimi i elementeve fantastike në letërsinë shqiptare, mundëson futjen e konceptit të "alegorisë kohore" dhe të "tjetërvendit letrar". Bëhet fjalë për tekste ku shkrimtarët i ambientojnë veprat e tyre diku "tjetër", e në vend që të skicojnë një figurë gjeometrike dydimensionale, vijëzojnë një sipërfaqe me më shumë fytyra, mbi të cilat thyhen, si kone drite, domethënie të ndryshme. Zgjedhja e "tjetërvendit", nuk është asnjëherë rastësore apo e pamotivuar.

Të shkruaje një libër nën diktaturë nënkuptonte të kryeje një gjest që ndikonte mbi sfondin shoqëror të jetuar, duke nënkuptuar një mesazh që priste të deshifrohej. "Tjetërvendi" kryente një funksion njohës dhe polemik kundrejt shoqërisë ku lindte, duke i dhënë letërsisë lirinë dhe autenticitetin e nevojshëm, për t'u orientuar në dritëhijet e regjimit. Duke

denoncuar në mënyrë të tërthortë absurdin e përditshëm të një gjendjeje njerëzore gjithmonë e më të shtypur dhe të burgosur, hapësirat e "tjera" kryenin një denoncim dhe sugjeronin një perspektivë të re.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Aliu, Ali (1990). *Kërkime*, "Shtypshkronja 8 Nëntori", Tiranë.

Barthes, Roland.(2002). *Saggi critici*, Einaudi.

Berisha, Anton Nikë (2002). *Gjin Bardhela i arbresh : Etja e gurëzuar* .Prishtinë : Faik Konica.

Borghes, J., Silvina, L., Ocampo, Casares, B., Adolfo (1980). *Antologia della letteratura fantastica*, Editori Riuniti.

Caillois, Roger. (x).*Nel cuore del fantastico*, cit. P. 150-152

Çaushi, Tefik (1993). *Universi letrar i Kadaresë*, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë.

Di Gesu, M. (2005). *Palinsesti del moderno. Canoni, feneri, forme nella postmodernita italiana,* Milano.

Di Gesù, M. (2007). *Palinsesti del moderno. Canoni, generi, forme nella postmodernità letteraria*, Milano 2005

Ecco, Umberto (2003). *Sulla letteratura*, Milano.

Fellini, Federico (1983). *Intervista sul cinema*, kuruar nga Giovanni Grazzini, Laterza, Bari.

Freud, S., (x). *Precizazioni su due principi dell'accadere psichico*, në Opere, cit., v. VI, p. 458-459

Ginzburg, Alessandra, Lombardi, Riccardo, *L'emozione come esperienza infinita. Matte Blanco e la psicoanalisi contemporanea*, FrancoAngeli Editore.

Kadare, Ismail (1991). *Ëndërr mashtruese*, tregime dhe novela, shtëpia botuese "Naim Frashëri".

Kongoli, Fatos (2010). *Iluzione në sirtar*, Shtëpia botuese "Toena", Tiranë.

Kuteli, Mitrush (1996). *E madhe është gjëma e mëkatit*, Shtëpia Botuese "Apollonia", Tiranë.

# POEZIA FETARE FRANCEZE GJATË EPOKËS MODERNE

**FABIOLA KADI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Besohet se letërsitë profane rrjedhin nga poezitë e shenjta antike. Kështu, vargu në kishë, në ritualet e ndryshme, u bën të mundur besimtarëve të mbajnë mend më lehtë tekstet e shenjta. Por pak e nga pak, poezia, gjatë Mesjetës, u çlirua nga origjina e saj fetare. Përgjatë shekujve, kjo ndarje mes poetikes dhe të shenjtës bëhet gjithnjë e më e thellë. Rilindja ishte periudha e ndryshimeve të mëdha dhe shekulli XVIII theksoi edhe më tepër ndarjen e artit me fenë. Thuhet se Romantizmi karakterizohej nga një rikthim tek poezia e shenjtë, tek burimet e emocionit, me etjen dhe simpatinë për gjithçka të sinqertë dhe të thellë. Çfarë po ndodh me poezinë në epokën tonë? Si erdhëm deri në këtë pikë sa poezia është kthyer në një poezi të irracionales dhe agresionit verbal? Duhet të kemi parasysh se mediokriteti i vetë botës, sjell pamjaftueshmëri të gjuhës. Ajo që kemi humbur pa e ndierë, ajo që aq shpesh kërkohet në errësirë me dëshpërim, është thelbi i së shenjtës. Është karakteristike e shpirtit njerëzor që kur është i dobët, sëmur edhe gjuhën. Shpirti i poezisë, kozmik dhe metafizik është kjo forcë bashkuese dhe e ngrohtë, e aftë për të kthyer tek gjuha atë çka është thelbësore. Çfarë ka ndodhur në të vërtetë në thelb?

Në periudha të ndryshme të historisë, qëndrimet shpirtërore të njeriut kanë ndryshuar sipas nevojave dhe shqetësimeve të tij. Koncepti i së shenjtës ka ndryshuar shumë në ditët tona. Krishterimi është më sipërfaqësor në poezinë e shekullit XIX dhe XX , e megjithatë ka shumë poetë të cilët frymëzohen nga tematika fetare, siç ishin Pol Klodeli dhe Sharl Pegi në Francë, të cilët panë tek tema fetare një burim frymëzimi të përjetshëm.

Punimi ynë synon të vërë në dukje, përmes shembujve se Modernizmi nuk mund ta shkëputë poezinë nga tema fetare. Fetarja dhe poetikja janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën.

**Fjalët çelës**: *fetare, modernizëm, shpirt, poezi, e shenjtë*.

**Abstract**

It is widely maintained that profane literatures derived from the ancient sacred poems. Thus, the verse in church, in various rituals enables believers to remember the sacred texts more easily. But little by little, during the Middle Ages, verse was liberated from its religious origins. The Renaissance was the period of big changes and the eighteenth century emphasized the separation between art and religion. It is often said that Romanticism is characterized by a return to the sacred poetry, to the sources of emotion, stemming from a sympathy for all that is sincere and deep. Whereas, in our age, it seems like poetry has turned into poetry of irrational and verbal aggression. We should note that the mediocrity of the world itself brings inadequacy of language. It is characteristic of the human spirit that when it is weak, it infects language also. The soul of poetry, cosmic and metaphysical, is its unifying force and warmth, able to return to what is essential in language. At various times in history, human spiritual attitudes change by reflecting people's needs and concerns. It

has to be admitted that the concept of the sacred has changed. Christianity is more superficial in the nineteenth and twentieth century poetry, however there are a lot of poets who continue to be inspired by religious themes, like Paul Claudel and Charles Péguy in France, who saw religious theme a source of eternal inspiration.

Our aim is to emphasize through examples that Modernism can not disown religious theme in poetry.

**Keywords:** *religious, modernism, soul, poetry, sacred*.

*Feja ka qenë gjithmonë një dimension themelor i jetës dhe gjendjes njerëzore, në Parahistori, në Antikitet, në Mesjetë dhe në Epokën moderne dhe postmoderne. Kjo e fundit është koha e rindërtimit të një fetareje më intime dhe personale, epoka e një religjioziteti të ri. Përvoja e së shenjtës nuk zhduket, por zhvendoset jashtë fesë si institucion, në prodhimet në dukje jofetare si në artet. Në to gjendet fetarja, edhe pse është e ndryshme, latente*." (Jeffrey, 1998).

Ka shumë studime të kryera në lidhje me tema të ndryshme të pranishme në poezi, por shumë pak mbi poezitë që trajtojnë tematikën fetare, që lidhen me të shenjtën. Përkundrazi, jemi prirur të harrojmë këtë pamje të poezisë, ta lëmë mënjanë, të bëjmë sikur nuk e shohim. Mendojmë se është koha të bien paragjykimet nëpërmjet të cilave, studiuesi apo kritiku letrar pretendon se po merret me letërsinë në tërësi, por nga ana tjetër injoron dhe lë pas temën fetare në poezi, nën pretekstin se është një temë së cilës i ka shkuar koha. Për të kuptuar thelbin e poezisë me tematikë fetare, nevojitet t'i afrohemi asaj pa paragjykime dhe të përpiqemi të lexojmë përtej vargjeve, për të rrokur pikëpamjen e autorit, sipas kritereve thjesht letrare, pa parashenja vlerësuese negative.

Tematika fetare dhe pozicioni që ajo zë në poezi, është e ndryshme në epoka të ndryshme. Në frymëzimin e poetit ndikojnë fuqishëm edhe rrethanat historike të kohës në të cilën jeton e krijon, pasi letërsia mbetet gjithnjë krijimtari individësh të ndryshëm që kërkojnë të komunikojnë me individë të tjerë, edhe më të ndryshëm. Poeti apo shkrimtari është një individ i cili ka një vizion të caktuar për botën, e megjithatë, ai nuk mund të mos ndikohet nga epoka në të cilën ka jetuar e krijuar.

Nëse shohim panoramën e krijimtarisë poetike në Francë ndër shekuj, do të dilnim në përfundimin se letërsia frënge që në fillimet e saj e deri në fund të Mesjetës, mbizotërohet nga poezi me tematikë fetare. Më pas vjen periudha e Rilindjes me Humanizmin dhe Reformën Protestante.

Hygo Fridrish (Hugo Friedrich) shpreh idenë se Rilindja e laicizon letërsinë dhe bota hapet pak e nga pak ndaj pasurive të mendjes. Humanizmi u njohu intelektualëve dhe krijuesve një autoritet më të madh se më parë, ndryshoi mendësinë në lidhje me pozicionin e njeriut në univers. Poezia e Rilindjes shfaq dukshëm shqetësimin për të vërtetën. Humanizmi tregon shumë interes për njeriun, një ndjenjë të re të personalitetit individual, një kulturë të re, e cila mbështetet më tepër tek mendimi antik grek sesa tek fryma e krishterë mesjetare. Distancimi nga krishterimi dhe feja në përgjithësi, thellohet edhe më tepër gjatë shekullit XVII, për të pësuar ndarjen thuajse të plotë në shekullin 'iluminist' me

teorinë mbizotëruese të deizmit dhe të përqendrimit tek shkenca dhe filozofia, pa u mbështetur tek fetarja dhe e shenjta në përgjithësi. Por çfarë do të ndodhë në shekujt në vazhdim? A do të rimëkëmbet tematika fetare në poezi apo rënia e saj është e pakthyeshme?

**Romantikët francezë dhe qëndrimi i tyre ndaj fetares**

Kritikë të ndryshëm pranojnë se gjatë shekullit XIX ndodh një ndryshim në marrëdhënien e letërsisë me fetaren. Ka një ripërtëritje të nevojës për shpirtëroren, për hyjnoren. Shumë mendimtarë e poetë i kthehen çështjes fetare në shkrimet e tyre në këtë periudhë. Shoqëria franceze e shekullit XIX nuk është shkëputur nga teoritë iluministe të shekullit të mëparshëm dhe Revolucionit Francez, të cilët kishin lënë gjurmë në mendësinë dhe qëndrimin e tyre ndaj jetës, por megjithatë nuk është më homogjene për sa i përket qëndrimit në lidhje me fenë. Nga njëra anë ka mbështetës të fuqishëm të fesë dhe nga ana tjetër, një grup i madh njerëzish mbështesin filozofinë iluministe e cila e përjashton thuajse fare fenë.

Megjithatë kritikë të ndryshëm pranojnë se Romantizmi karakterizohet nga një rikthim i poezisë tek e shenjta, tek burimet e emocionit, nga një simpati për gjithçka që është e sinqertë dhe e thellë. Viti 1802 është pranuar historikisht si viti i lindjes së romantizmit, me botimin e veprës *Gjeniu i Krishterimit* (*Génie du Christianisme)* të Shatobrianit (Chateau-briand). Por a do të jetë romantizmi manifestim i një ripërtëritjeje shpirtërore dhe fetare, pas triumfit të filozofëve në shekullin XVIII ? Në të vërtetë letërsia romantike frymëzohet nga mendimi i krishterë. Poeti romantik Viktor Hygo shprehet: "*Pika e fillimit të fesë është gjithnjë pika fillestare e poezisë.*" (Hugo,1985, p. 9). Megjithatë koncepti i së shenjtës ka ndryshuar. Krishterimi i poetëve të shekullit XIX është më shumë sipërfaqësor. Kritiku letrar Pol Benishu (Paul Bénichou), e ndan romantizmin francez në dy rryma: rryma e brezit të Hygosë që i përket romantizmit të poetëve mendimtarë, veprues, me ambicien për të bërë mirë, poetë besimtarë, apo mbështetës të besimit, me optimizmin dhe shpresën se njerëzimi mund të bëhet më i mirë dhe romantikët e tjerë me Bodlerin në krye, të cilët karakterizohen nga pesimizmi dhe një përqendrim tek vetvetja, të 'përgjunjur' nga lëngata e shekullit (*le mal du siècle*). Rryma e dytë e poetëve do të ndiqet nga poetët pasardhës. Ka një pesimizëm të thellë që karakterizon poetët, dhe një dëshpërim të madh, një mungesë besimi tek e ardhmja e njerëzimit dhe tek roli i privilegjiuar i poetit në botë. Me modernizmin, problemet thellohen gjithnjë e më tepër. Karakteristika më e dukshme e qytetërimit modern duket shmangia e vrullshme e së shenjtës, dëshira për t'u materializuar gjithnjë e më shumë dhe me shpejtësi, kënaqësia në arritjen e një mentaliteti gjithnjë e më tepër profan. Njeriu përpiqet të gjejë mbështetje tek teknikat e reja, tek zhvillimi ekonomik dhe përparimi shkencor. Ky tjetërsim i shpirtit njerëzor e privon qenien nga ajo vatra sekrete që gjendet thellë brenda tij, nga bota shpirtërore e paprekur. Përballë kaosit mekanik, shpirti i njeriut do të fluturojë nëpër hapësirë pa gjetur një vend ku të mbështetet; siguria dhe paqja shpirtërore e tij i lënë vendin zbrazëtisë dhe absurdit. Kështu, i hutuar nga absurdi i një jete së cilës nuk ia njeh as fillimin, as fundin, njeriu braktis përjetimet shpirtërore. Ndërkohë, poeti përpiqet që me pushtetin dhe magjinë e fjalëve, të maskojë ankthin e boshllëkut, të zbrazëtisë që ndjen përbrenda.

Por a ka arti dhe poezia aftësinë për t'i propozuar diçka thelbësore njeriut të

ngopur me 'risi', por njëkohësisht të boshatisur nga ana emocionale?

**Modernizmi dhe filozofia pesimiste**

Njeriu modern ndihet i thyer në vetvete, i pasigurt për vendin që i takon, i ndrydhur përbrenda, i kërcënuar nga jashtë. Ai nuk është krijuar për të qenë i vetmuar. Ka një thirrje brenda qenies së tij, e cila është tripalëshe: pranë tij është shoqëria e njerëzve, nën të, është materia mbi të, është tërësia e shpirtit e cila e tërheq përtej kufijve të tij njerëzorë. Në këtë kuptim, njeriu është një qenie e shoqërueshme së pari, i bërë për të jetuar në miqësi me njerëzit e tjerë, por edhe të krijuesit të tij, Zotit.

Ndërkohë që besimi fetar dhe Krishtërimi në veçanti, duke u marrë me mbarë botën, përgjatë historisë së tij ka vendosur një lloj miqësie mes njeriut dhe natyrës, Marksi e ndau materien nga shpirti, i fshiu të gjitha jehonat që e lidhnin njeriun me shpirtëroren. Universi u kthye në një llogari të thjeshtë matematikore. Sipas Marksit, tashmë e gjithë natyra ndahet në dy sektorë: "sektori i dominuar" të cilin njeriu e humanizon, dhe "sektori i padominuar" i cili është rastësi e pastër, forcë e verbër. Por ta reduktosh dialogun e njeriut me sendet dhe frymorët në raportin e zotërimit dhe të dominimit, është si ta kristalizosh qenien njerëzore në botë si një udhëkryq mes botës së të qenit dhe botës së të paturit.

Që prej shekullit XVIII e më pas, njeriu besoi me naivitet se ai vetë mund të vendoste një rregull të përgjithshëm dhe të siguronte lumturinë universale nëpërmjet vendosjes së barazisë mes njerëzve. Mendohej se duke zgjidhur problemet praktike të jetës materiale falë shkencës dhe zhvillimit teknik, do të zgjidheshin njëkohësisht edhe problemet shpirtërore, por ky ishte thjesht një iluzion dritëshkurtër, sepse në thellësi të ndërgjegjes së tij, njeriu e ndiente se përderisa ekziston lufta kundër njëri-tjetrit dhe konkurrenca, njeriu nuk është për asnjë moment tërësisht zot i fatit të tij. Dhe u kuptua që herët se në këtë botë të re kishte forca të reja që e udhëhiqnin dhe drejtonin njeriun. Para kësaj tabloje të frikshme, njerëzit përsëri i kthehen besimit. Por pas një periudhe shkëputjeje, edhe feja nuk do të jetë e njëjtë si para se të ndodhnin gjithë këto ndryshime.

Një nga karakteristikat kryesore të poetëve modernë është lufta e tyre kundër çdo lloj ideologjie: Familja (Bodleri, Remboja, Lotreamon) Atdheu, (Rembo, Malarme), Kisha (Rembo, Lotreamon, Malarme), Klasa etj. Remboja e krahasonte aktivitetin poetik me *shpërthimin e një bombe*, me një lloj *atentati anarkist* kundër çdo lloj dogme, edhe asaj më të fortës. Sipas tij, poezia duhet të jetë burim i lirisë, i një lirie 'të lirë', të çliruar nga dogmat fetare të çfarëdo lloji.

Remboja përmend shumë shpesh vargje nga Bibla në veprat e tij poetike. Ai përpiqet të demistifikojë pretendimet e krishtera. Sipas tij, besimi është vetëm një marrëdhënie fjalësh dhe nuk është i aftë të shpëtojë lebrozin, apo të ndryshojë gjendjen e botës. Lutja është e kotë dhe gjithë ritet, apo zakonet fetare të cilat i ka kryer në fëmijëri, gjithë fijet që e mbajnë poetin të lidhur me botën, duhen shkëputur.

*"Ah! Edhe diçka: unë kërcej të shtunën në një lirishtë me plaka e fëmijë.*
*Nuk më kujtohet asgjë veç kjo tokë dhe kristianizmi.*
*Nuk do të rresht së rishikuari veten në këtë vendkalim.*
*Por gjithnjë vetëm; pa familje;*
*madje, ç'gjuhë flisja?"* (Rimbaud, 2001, p.76)

Kështu shkruan poeti tek poezia "Brezi i keq" ("*Mauvais sang*"), e cila vlerësohet si një projekt anti i krishterë dhe një lloj "*ekzekutimi i katekizmit*" (Rimbaud, 1969).

Revolta tek ai lidhet ngushtë me modernitetin poetik. Pretendimet e poetit hyjnë në konkurencë të drejtpërdrejtë me 'Autorin e Krijimit'. Në fund të fundit, ashtu si Ai ka krijuar gjithësinë, poeti e rikrijon atë përmes fjalës poetike.

Duket sikur njeriu i ashtuquajtur 'modern' ka një lloj acarimi të çuditshëm teksa dëgjon të shqiptohet termi fetar, apo *i shenjtë*. Feja shfaqet si diçka e ndaluar, e dalë mode, së cilës i ka shkuar koha. A duhet me patjetër të dëbojmë fenë për t'u dukur se vërtet i përkasim progresit dhe zhvillimit? Si mund ta shpjegojmë këtë lloj kundërshtimi të hapur mes fesë dhe modernitetit?

Poetët modernë, Rembo (Rimbaud) dhe Malarme (Mallarmé) ecin me parimin e vetëm : të lënë pas kohën kur:

"*njeriu në delirin e tij ende nuk e kishte, turbulluar këtë pasqyrë të madhe në të cilën Zoti e kishte lejuar të lexonte"*

dhe, *" duke hedhur ngado mbeturinat e tij e vendosi fjalën e tij mbi fjalën e Perëndisë*." (Lamartine, 1838, p. 764)

Rruga nga Rilindja përmes Iluminizmit, deri tek botëkuptimi ynë pasmodern, ka qenë një rrugë e parashikueshme. "*Nën një breshëri të pandërprerë sulmesh "të shkolluara"* (është punuar me qëllimin e vetëm) *që Perëndia të mos jetë më një qenie e besueshme në qarqet skolastike. Kjo mësymje kundër besimit fetar, u krye në emër të lirisë politike apo akademike ndërsa qëllimi i vërtetë ka qenë mposhtja filozofike e çdo gjëje që mbante erë kufizimi moral.*" (Zakaria, 1999, viii)

Kjo bastisje përfshin pothuajse çdo fushë: "*Pena u bë shpatë dhe katedra profesionale zëvendësoi foltoren e predikuesit. (...) Gjithsesi, koha ka treguar se shpata ka prerë dorën që e vërtiti dhe se dituria vetë ka humbur autoritetin e saj*." (Zakaria, 1999, ix)

Cilat do të jenë pasojat e lënies pas të së shenjtës?

**Fjala poetike dhe ndikimi i saj në jetën e njeriut**

Filozofi indiano-amerikan Ravi Zakaria (Ravi Zacharias), teksa analizon pasojat e braktisjes së të shenjtës në shoqërinë njerëzore, citon Pol Shererin, i cili studion problemet e shumta mes kishës dhe kundërshtarëve të saj dhe shprehet:

"*Një nga një, brezi që nuk pranoi të kufizohej nga Papa, e as të kufizohej nga kisha, vendosi në një ekstazë lirie se nuk do të kufizohej nga asgjë – as nga Bibla, as nga ndërgjegjja, as nga vetë Perëndia. Nga të besuarit e tepërt për gjëra të cilat nuk ishte e thënë të besoheshin aspak, ata filluan të besojnë aq pak, sa për mijëra e mijëra njerëz, ekzistenca njerëzore dhe vetë bota dukeshin sikur nuk kishin më kuptim.*" (Zakaria: 1999, x)

Poetët fillojnë të flasin për "tokën e shkretuar" me "jetë si hije", të rrethuar nga rrënojat e shkaktuara nga vetë njeriu. Hiçi bëhet një çështje për bisedë, nihilizmi një motiv, zhgënjimi dhe dëshpërimi një temë për romancierët dhe dramaturgët.

"*Më jepni krijimtarinë e këngëve të një kombi*", shprehet Andre Fleçeri (Andre Fletcher), mendimtari politik skocez i shek. XVIII, "*dhe nuk dua t'ia di se kush i shkruan ligjet e tij*" (Zakaria, 1999, p.3), duke vënë në pah ndikimin e jashtëzakonshëm që kanë artet, poezitë, këngët në gjendjen shpirtërore të njerëzve, për mirë, apo për keq. Ja si shprehet poeti francez, Viktor Hygo për gjendjen e njeriut në shoqëri, për pasigurinë e shpirtit njerëzor, për errësirën që e rrethon njeriun e të gjitha kohëve, por mbi të gjitha njeriun modern, i cili ka mohuar çdo mundësi shprese, ka hedhur pas krahëve "spirancën" e besimit.

*Njeriu është i mjegullt, bota është e zezë, qielli është i errët ; Format e natës shkojnë e vijnë në hije ; (…) Dhe ne të zbehtë, soditim.*

*Ne soditim errësirën, të panjohurën, të padukshmen.*

*Ne shohim se si dridhet hija e pashpjegueshme. {…)*
*Ne përgjojmë zhurmat e këtyre zbrazëtive mortore ;*
*Dëgjojmë frymën, që endet nëpër natë,*
*Prej së cilës edhe vetë errësia dridhet.* (Hugo, 1856)

Zbrazëtia shpirtërore karakterizon njeriun modern në pothuajse të gjitha shoqëritë njerëzore. Vargjet e një kënge amerikane shprehin pasojat e qëndrimit pa besim, mungesën e shpresës në breza të tërë njerëzish:

*Prej honeve të mendjes sonë ne çohemi*
*Të endemi vazhdojmë e të verbër pengohemi,*
*Çapitemi mes labirinthit të ngatërruar*
*Të natës pa yje dhe ditës ku dielli nuk ka ndriçuar*
*Të gjejmë ndonjëfarë shenje shpresojmë –*
*Një rrugë që tek e vërteta të mund të shkojmë.*
*Por kush vallë përgjigjet? ...*

Refreni i këngës përfundon me shprehjen e konfliktit që ndodh thellë brenda vetëdijes njerëzore.

*Nëse shpirti errësohet*
*Prej frikës që as vetë nuk e njeh,*
*Nëse mendja hutohet*
*kur lojën jashtë rregullave e sheh,*
*Kush vallë përgjigjet?*
*Kush vallë përgjigjet?*
*Kush vallë përgjigjet?*

Fatalizmi, nihilizmi, filozofia që thotë "rroke jetën për fyti" bashkë me traumën ekzistenciale janë të qenësishme për periudhën në të cilën jetojmë (Zakaria, 1999, p. 7).

Megjithë progresin shkencor, përparimin e teknikës dhe zhvillimin ekonomik, te të cilat pretendohej gjatë shekullit XVIII se do të siguronin lumturinë njerëzore, e vërteta është që këngët popullore shprehin të kundërtën, përcjellin mesazhin e pesimizmit, ankthit, zbrazëtisë dhe mungesës së kuptimit të jetës. Edhe pse arsimimi ka zgjeruar horizontin e njohurisë deri atje sa nuk ishte imagjinuar ndonjëherë më parë, mesazhet e poezive dhe këngëve tona nuk rreshtin së shprehuri përleshjet brenda zemrës njerëzore, përkundrazi, ato bëhen më të shpeshta dhe më therrëse me kalimin e kohës.

**A është modernizmi fundi i poezisë me tematikë fetare?**

Pavarësisht nga përpjekjet e shumëllojshme dhe të qëllimshme që janë bërë për të minuar shpirtëroren dhe për ta hedhur atë tej duke e konsideruar si joracionale, *etja për të mbinatyrshmen mbetet e pashuar*. (Zakaria, 1999, x)

Në një intervistë të dhënë gazetës franceze *Le point*, poeti i mirënjohur francez i shekullit XXI, Zhan Grozhani (Jean Grosjean), shprehet në lidhje me prirjen e tij për t'u marrë me fenë. Kur i bëhet pyetja se si arriti në pikën kur vendosi të përkthente Biblën dhe Kuranin, ai shprehet se "*libri i Jobit dhe Isaias, tekstet e shenjta i ishin dukur gjithnjë bashkëkohorë, ndërkohë që shumë ligje dhe pjesë të Kushtetutës, i dukeshin aq të largëta dhe jobashkëkohore.*" (Grosjean, 2007, http://www.lepoint.fr/actualites-chroniques /2007-01-17/jean-grosjean-le-poete-du-sacre/989/0/35182).

Është fakt që e shenjta gjendet kudo. Me gjithë përpjekjet për t'i dhënë fund njëherë e mirë, dëshira e flaktë për shpirtëroren nuk mund të shuhet.

Madje edhe në rastin e poetit, babait të modernizmit, Bodlerit, megjithë dualitetin që shfaqet në veprën dhe jetën e tij në lidhje me shpirtëroren, në vitet e fundit të jetës, ai shprehet: *« Perëndia është i vetmi rezervuar force dhe drejtësie.»* (Emmanuel, 1982, p. 147). Po ky poet, i cili merret si shembull për të luftuar dhe rrëzuar shpirtëroren, shprehet tek poezia « Bénédiction » :

"*Qofsh i bekuar Perëndi që sjell vuajtjen Si një mjekim hyjnor për fajet tona.*" (Baudelaire, 1857)

Një pjesë e rëndësishme e letërsisë frënge të kësaj periudhe është plot domethënie fetare. Një nga tiparet karakteristike të shekullit XIX-të është ky burim dhe rikthim përsa i përket fesë. Megjithatë, në këtë periudhë, duket se kemi të bëjmë vetëm me një fjalor fetar, më shumë sesa me trajtimin e shpirtërores. Zhvendosja, kalimi i elementëve të së shenjtës në sferën profane duket kudo, qoftë në fenomene të përgjithshme, qoftë në veçanti: në shenjtërimin e shkrimtarit dhe në "profetizmin" e poetëve dhe ideologëve. Bibla, ungjijtë, Perëndia, perënditë, feja janë fjalë, kuptimi i të cilave do të zgjerohet mjaft në shekullin XIX. Bëhemi gjithnjë e më tolerantë në lidhje me fenë dhe të shenjtën në përgjithësi. Po hyjmë gjithnjë e më shumë në 'epokën e dyshimit'. Shumë romantikë si Nerval, Gotje (Gautier), Banvil (Banville), u dhanë një përmbajtje fetare miteve, ose u interesuan për fetë pagane antike, në veçanti për perënditë greke. E shenjta dhe shpirtërorja sot kanë fituar kuptime të reja. Arti dhe letërsia në përgjithësi përqendrohen tek njeriu dhe zhvillimi i tij. Përgjatë shekullit XIX fillon të përdoret fjala *shekullarizim*, por ajo fiton përmasa reale gjatë shekullit XX .

Çfarë ka mbetur nga fetarja në shekullin XIX e më pas?

Pjesa më e madhe e poetëve të shekullit XIX kanë ndërtuar veprat e tyre duke u nisur nga problematika fetare dhe jehona e fjalës së tyre u përhap edhe në shekullin pasardhës.

Fillimi i shekullit XX është i larmishëm, por mbizotërohet nga poetët e quajtur "poetë të Perëndisë": Sharl Pegi (Charles Péguy) me frymëzimin e tij patriotik dhe fetar dhe fuqinë e një poezie të thjeshtë dhe Pol Klodeli (Paul Claudel) me kërkimin e tij shpirtëror të shprehur përmes vargut të tij karakteristik, versetit. Sharl Pegi e sheh veten si "*shërbëtor dhe dëshmitar* (të Perëndisë)". Tek ai, i krishteri dhe militanti janë një. Poeti nuk rresht së kërkuari thellë brenda vetes, së vëzhguari në labirinthin e botës së brendshme. Ai bën kalimin drejt një bote të pafund, me dëshirën për të ndalur kohën, për një çast apo përjetësisht dhe për të mbushur mungesën e shpresës. Poeti është ai që "*përçon Zjarrin e fillimit*" sipas Klod Vizhesë (Claude Vigée). Gjithëfuqia e poezisë, kudondodhja e saj, njëkohësisht në ndjenja dhe në arsye, a ka forcë për të ndryshuar jetën. Gjuha poetike sjell fjalë për fjalë grumbullimin e së mrekullueshmes në kujtesë, dhe ka gjithnjë një lavdërim, i gëzueshëm apo i dhimbshëm, që ajo përmban dhe mishëron. Sipas Aristotelit, poeti është '*thesarmbajtës i teologjisë*', apo i kujtesës së perë-ndive.

Përkrah këtyre krijimeve, gjatë shekullit XX, zhvillohet edhe një art i ri. Gijom Apolineri (Guillaume Apollinaire), Blez Sandrari (Blaise Cendrars), krijojnë një poezi e cila është trashëgimtare e shekujve të mëparshëm dhe njëkohësisht e re në temat dhe në formën e saj me një preferencë për vargun e lirë. Letërsia afrohet me artet plastike, tema të reja dalin nga qytetërimi modern, provohen forma të reja të të shkruarit, kërkohet vazhdimisht efekti i surprizës duke sjellë në këtë mënyrë krijimin e poezisë surrealiste. Poezia përkufizohet ndryshe. Tashmë bëhet fjalë për një poezi moderne e cila përkufizohet ndryshe edhe si "*poezia pa perënditë*" dhe gjithë hapësira moderne zhvillohet "*nën qiellin e vdekur*".

Në këtë periudhë ka një dyshim që ngrihet në pothuajse të gjitha fushat: A mund të ekzistojë një Perëndi apo *perëndi* i cili shikon gjithçka ndodh në botë dhe nuk bën asgjë?

Letërsia frënge e shekullit XX, do të përshkohet nga goditjet e historisë. Lufta është e pranishme në poezi dhe në roman. Poezia preket nga lëvizjet që tronditin shekullin.

Fillimi i shekullit XX pati etje për siguri dhe ngushëllim. Poetët hodhën në letër aspiratat e mbarë njerëzimit. Pas Luftës së Parë Botërore, letërsia ndjen traumat e konfliktit dhe njëkohësisht një gjallërim për sa i përket krijimeve letrare. Krijuesit letrarë janë më shumë të shqetësuar për vendin e njeriut në univers, ndërsa gjithçka duket se ecën drejt absurdit.

Moderniteti krijon një mjedis të ri për shkrimtarët. Çdo poet priret të zhvillojë një shkrim të tijin karakteristik, pa u bërë pjesë e ndonjë drejtimi të caktuar letrar.

Poetët janë në kërkim të një autonomie absolute në krijimet e tyre; ata duan të braktisin rregullat e shoqërisë, moralit dhe "barrën" e ndërgje-gjes; këtë bëjnë surrealistët me "automatizmin" e tyre. Por, a do të lirohen vërtet nga gjithçka poetët?

Poetët e shekullit XX në Francë ishin në kërkim të mistikes, një epokë në kërkim të vertikalitetit. Megjithë vështirësitë dhe problemet e shekullit, megjithë furinë e tij, e shenjta nuk u braktis. Poetët e këtij shekulli kanë gjetur gjithnjë rastin për t'u përballur me Krijuesin e tyre.

Ky është shekulli i Klodelit, Patris dë la Tur dy Penit (Patrice de la Tour du Pin), Zhan Grozhanit (Jean Grosjean), Mari Noelit (Marie Noel), Pjer Emanyelit (Pierre Emmanuel), Zhan-Klod Rënarit (Jean-Claude Renard), Arman Goduasë (Armand Godoy), Rëne Sharit (René Char), Zhan Koktosë (Jean Cocteau), Blez Sandrarit (Blaise Cendrars), në vargjet e të cilëve takojmë shpesh elementin fetar. Ka një rizgjim të përgjithshëm të së shenjtës, një ngjitje të ndërgjegjes drejt hyjnores. Është e dukshme tashmë se kur mohohet shpirtërorja, metafizikja, njeriu bëhet i ngjashëm me kafshën. Ai vendos veten në fronin për të cilin është i ndërgjegjshëm që nuk i takon, pasi, megjithë vullnetin për të luajtur rolin e heroit, njeriu nuk ka besim tek vetvetja, për shkak ai është krijuar në mënyrë të tillë që të ketë nevojë për diçka që ta tejkalojë atë. Forca shtytëse që fshihet prapa industrisë së lulëzuar, të zhvillimit të vrullshëm teknik dhe shkencor është "*krijimi i urive të reja për të na ndihmuar t'i harrojmë të vjetrat. E megjithatë, kërkimi për plotësim nuk mbaron kurrë sepse kurimi për mërzinë kërkon diçka më të lartë"* (Zakaria, 1999, p.67). Poeti është njeriu që priret të flasë përmes ndjenjave të tij më të thella, dhe nëse ai beson tek e ardhmja, nëse është optimist, ai mund të ndikojë në përparimin e shoqërisë dhe ringritjen shpirtërore të njeriut.

Zhan Lyk Maksans (Jean-Luc Maxence), në *Antologjinë e tij të poezisë mistike bashkëkohore franceze*, shprehet: "*Nëse hedhim një vështrim thjesht panoramik mbi shekullin XX, mund të konstatojmë se syrealizmi ka dështuar në projektin e tij për vrasjen e Perëndisë,* (...), *projekt i ndërmarrë në emër të "revoltës absolute"*(Maxence, 1999, p.17). Surealizmi është cilësuar ndryshe edhe si "*ungjilli i mungesës së rregullit*", me nihilizmin e tij, me kultin e absurdit dhe teorinë e automatizmit. Maksansi citon Zhorzh Batajin (Georges Bataille), i cili nuk resht së përmenduri etjen e thellë dhe të egër për Absoluten: "*Një gjë është e qartë: flaka e triumfit të surealizmit ishte e shkurtër. Kur përpiqemi të çlirohemi nga Perëndia duke e nxjerrë nga dritarja, ai kthehet në një formë tjetër, nëpërmjet derës*" (Maxence,1999, p.18) dhe vazhdon: "*Bretoni dhe miqtë e tij nuk ia dolën mbanë të vrisnin Perëndinë në poezi dhe kufoma e tij lëviz ende, madje më mirë të themi, është ringjallur*."(Po aty)

Maksansi në Antologjinë e tij, bën fjalë për një galaksi poetësh fetarë të shpallur hapur në shekullin XX pro besimit të tyre.

Me fjalë, me shenja dhe me tinguj, njeriu poet gjithnjë ka shprehur konfliktin e përhershëm mes Animusit dhe Animës çka paraqitet më qartë te Klodeli. Zhan-Klod Rënari flet për një "*kërkim pa fund të kuptimit të së shenjtës*". Poetja franceze Mari Noel e ka shprehur shumë mirë këtë nevojë të brendshme të njeriut për qielloren dhe për hyjnoren:

"*Zoti shikonte më larg se unë. Ai nuk më lejoi të gjeja vendin tim në tokë. Ai më ka "detyruar" të kem nevojë për qiellin*" (http://www.marie-noel.asso.fr).

**Përfundime**

Kudo, në çdo kohë, hija dhe drita përballen me njëra-tjetrën. Kështu ndodh edhe në vështrimin e poetit, shiu dhe dielli, drita dhe errësira janë në një përballje të përhershme e kështu, njeriu shpesh gjendet para situatave të cilat duken pa zgjidhje. Sa herë, epoka jonë, shoqëria jonë hedh sytë drejt qiellit për të kërkuar domethënie për jetën? Etja për absoluten mbetet e lidhur thellë me zemrën e njeriut.

Gjendja e njerëzimit, e keqja, sëmundja, humbja, vdekja, e pafundmja, përparimi, relativja, absolutja, të gjitha këto e shqetësojnë poetin si gjithë njerëzit e tjerë, por tek ai, si krijues, marrin një tjetër kuptim dhe domethënie përmes fjalës poetike. Dëshira e poetit është ecja përpara e të tijve, ecja drejt labirinthit të progresit, por kjo nuk është e lehtë sepse e mira luftohet në një përballje të përjetshme nga e keqja. Poeti është njeriu që përpiqet të ngjitet nga errësira drejt idealit, të shndërrojë ferrin tokësor në parajsë, të sjellë të drejtën për të jetuar dhe përgjegjësinë për tjetrin.

Nëse që herët poetët janë parë si pasardhës të Orfeut, vizionarë që i nxitin bashkëkohësit të shkojnë drejt lidhjeve misterioze mes unit dhe universit, ata janë gjithashtu udhëheqës që dinë t'u japin formë shqetësimeve të tyre, vështirësive dhe shpresave të bashkëkohësve.

Bashkimi i fjalës poetike me të shenjtën ka sjellë lindjen e shumë veprave të artit të cilat vazhdojnë të zgjojnë ndjenja të forta tek lexuesit. Mohimi i mundësisë së pajtimit mes të shenjtës dhe poetikes është një varfërim dhe jo pasurim i fjalës poetike. Poeti ka nevojë për një frymëzim që e tejkalon, që qëndron mbi të dukshmen, që vjen prej së larti. Profet për veten dhe për të tjerët, poeti zotëron fjalën hyjnore dhe ndihet i tërhequr në dualitetin e mistershëm Krijues-Krijim. Poeti ndërgjegjësohet për praninë e hyjnores brenda tij në momente të caktuara dhe ashtu si Shën Augustini, shprehet:

*"Të desha shumë vonë, Bukuri e vjetër dhe e re, të desha shumë vonë! Por, ja: ti ishe brenda meje kur unë isha jashtë duke të kërkuar..."*

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Baudelaire, C. (2002),. *Les fleurs du mal*, Magnard, Paris.

Baudelaire, C. *Fusées*. h t t p : // b a u d e l a i r e . l i t t e r a t u r a . c o m.

Emmanuel, P. (1982). *Baudelaire, la femme et Dieu,* Éditions du Seuil, Paris.

http://www.lepoint.fr/actualites-chroniques/2007-01-17/jean-grosjean-le-poete-du-sacre/989/0/35182

http://www.marie-noel.asso.fr

Hugo, (1856). *Les Contemplations,* Paris.

Hugo, V. (1985). *Oeuvres complètes. Critique, présentation de Jean-Pierre Reynaud*, Robert Laffont, Paris.
Jeffrey, D. (1998). *Jouissance du sacré*, *Religion et postmodernité*, Armand Colin, Paris.
Lamartine, A. (1838).*Oeuvres de Lamartine*, La Chute d'un ange.
Maxence, J-L. (1999). *Anthologie de la poésie mystique contemporaine*, Presses de la Renaissance, Paris
Rimbaud , A. (1969). *Une saison en enfer*, "Mauvais sang", Paris.
Rimbaud , A. (2001). *Arthur Rimbaud*, "Nuit de l'enfer", La Renaissance du livre, Bruksel.
Rimbaud, A. (1969). *Une saison en enfer*, "Mauvais sang", Paris.
Zakaria, R. (1999). Përkth. *A mund të jetojë njeriu pa Perëndinë,* Shigjeta, Ersekë.

# TEORITË RECEPTIVE NË VEPRËN E LASGUSH PORADECIT. RECEPTIM PËRMES NJË PYETËSORI

**ILIR SHYTA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Ky punim, konkretisht prezanton rezultatet e një pyetësori me 22 pyetje, i ndërtuar mbi jetën dhe veprën letrare të poetit pogradecar Lasgush Poradec. Nga 200 të anketuar, të ftuar për t'iu përgjigjur pyetsorit në mënyrë anonime me shkrim, kemi marrë 200 përgjigje. Nga një masë përgjigjesh pak më e lartë se 52%, mund të konstatojmë se këto opinione përfaqësojnë një shumicë të grupmoshave të ndryshme popullsisë shqiptare.

Ideja ishte që të përfshiheshin në pyetësor grupmosha të ndryshme njërëzish, por edhe të kishte një shpërndarje gjeografike sa më të gjerë duke përdorur si metodë kampionin empirik "top-dëborë". Zgjedhja e shumëfishtë "top-dëborë" përfshin përdorimin e metodave probabilitare për një përzgjedhje fillestare të elementëve të kampionit dhe pastaj shtimin e shumëfishtë të njësive të zgjedhjes nëpërmjet përdorimit të informacionit të siguruar nga elementët fillestarë.

Përgjithësisht jeta dhe vepra letrare e poetit liqenor të Poradecit njihet nga receptuesi i saj, ç'ka tregon se ky autor mbetet ndikues ndër lexues të grupmoshave të ndryshme në vendin tonë. Pyetësori shoqërohet edhe me interpretime tabelash dhe grafikësh të ndryshëm, të cilët e bëjnë më të lexueshëm llogaritjen e të dhënave të shprehura me fjalë.

**Fjalët çelës***: Lasgush; teori receptim; pyetësor; anketim; grupmoshë;*

**Abstract**

The aims of this paper is to give the results of a questionnaire consisting of 22 questions regarding the life and literary work of the Albanian lake poet, Lasgush Poradeci. This analysis is based on the fundamental responses provided by the respondents, compared with the general interpretation and the report that emerges from their study. Some of the questions made direct sense to the respondents. Of 200 interviewees, invited to respond to the questionnaire anonymously, there are received 200 replies. Based on an average of 52% answers noticed that these opinions represent a multitude of different age groups of the Albanian population.

Requests sent: 200; Answers collected: 200; Total received written responses: 200.

Our intention in this study was not only to include different age groups, but also to have a wide geographical distribution by implying methodologically the empirical sample of the "snow – ball". By and large, the life and the literary career of the Poradeci lake poet are clearly recognized by its target; this is a fact which shows that this author remains influential among readers of different age groups in our country.

**Key words:** *Lasgush; receptive theory; questionnaire; survey; age group.*

Bart thekson se lexuesi është gjyqtari bazë i domethënies së një teksti. Ndërkohë, mund të supozojmë, padyshim se mund të gabojmë ose jo, që letërsia ndikon mbi njerëzit, veçanësisht mbi të rinjtë drejtpërdrejt, më fuqishëm, sesa mbi brezin e vjetër. Brezi i ri mund ta lexojë krejt ndryshe në rastin konkret Lagsush Poradecin dhe mund ta receptojë poezinë e tij të dashurisë po ndryshe, por sado ndryshe ta përjetojë atë, prapëseprapë robërohet nga magjia e artit lasgushian. Në qoftë se dashuria së jashtmi është bërë në ditët tona më praktike, thelbin i saj romantik i brendshëm nuk mund të ndryshojë asnjëherë nëpër kohëra. Njerëzit kur dashurojnë edhe pse mund ta "zbulojnë" veten a jo, gjithësesi dashurojnë në formatin e tyre. Në çdo pamje gjithçka është dhe mbetet pjesë e jetës në dashuri. Sigurisht edhe në poezinë e Lasgush Poradecit dashuria është një pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme, që receptohet ndryshe në çdo kohë.

Brenda këtij argumenti mund të themi, se lexuesit pa përvojë e marrin letërsinë në mënyrën më naive të tyre, e kuptojnë si kalk të jetës, e jo si interpretim të saj. Ndërkaq, ata lexues që kanë lexuar më pak libra e marrin leximin me më seriozitet, sesa lexuesit që e kanë bërë leximin profesion dhe ritual të përditshëmrisë së tyre. A mund të shkohet përtej këtyre hamendjeve, -shtrohet pyetja? A mund të përdorim mbi këtë pyetësor mënyra të tjera "hetimi" mbi lexuesit e çdo grupmoshe? Duhet theksuar se çdo rast i veçantë varet tërësisht nga kujtesa dhe aftësitë analitike të atyre që u pyetën, kurse përgjigjet e tyre u kodifikuan dhe u vlerësuan më tej në materialin e mëposhtëm të përpunuar dhe argumentuar mbi to.

Duhet të theksojmë se në përpunimin e çdo pyetjeje të këtij pyetësori, përfshihet dhe shtjellohet informacion aktual, i cili, sigurisht, përfshin ose jo marrëdhënien e lexuesit në një kontekst të caktuar të ngjarjes se përfshirë në të.

Pyetja e shumëdiskutuar se sa ndikon letërsia te publiku, është një pyetje empirike e, nëse do të gjejë përgjigje, ajo gjen terrenin e saj duke iu drejtuar përvojës dhe meqë flasim për letërsinë dhe për elementin sociologjik brenda saj, atëherë duhet t'i drejtohemi jo përvojës së njohësit të "djallëzuar", por përvojës së racës njerëzore. Kur vjen fjala te raportet mbi lexueshmërinë e gjigandëve të poezisë shqipe, që kanë epërsi me tekstet letrare, Lasgush Poradeci (1899-1987), krahas Naim Frashërit, Çajupit ... mbetet më i preferuari dhe nga më të lexuarit, po aq sa poetët botërorë si Esenin, Neruda, Pushkin etj.

Botimi i veprës poetike të Poradecit është bazuar në botimet e dy librave poetikë që u shtypën së pari në Bukuresht, duke mbajtur parasysh shënimet dhe korrigjimet që vetë ai ka bërë në anë të faqeve të tyre, përfshirë dhe shpjegimet e fjalëve në fund të poezive të cilat i bën gjithashtu vetë ai.

Me këto dy libra që i shkroi sa në Pogradec e Athinë aq edhe në Bukuresht, deri në vitet '30, Lasgushi mbeti i parapëlqyer te lexuesi i tij i preferuar, në grupmosha të ndryshme. Poezinë lasgushiane, e njohim fillimisht nëpërmjet teksteve me poezi që kanë qarkulluar. Poezia është një dimension që në moment të jep një emocion të madh, të jep gjithë botën brenda vargjeve. Në këtë kuptim Lasgushi është prijësi i poezisë së dashurisë. Poezitë e tij, pa asnjë frikë të ndërtojnë mes vargjesh, biografinë e poetit edhe madje, pa e njohur atë më parë. P.sh. "*Ti po vjen që prej së largu"* është poezia që i bën autopsinë vetë poetit. "*Prandaj"* është një tjetër poezi që përfshin dhe bën njësh brenda saj, gjithë mentalitetin njerëzor. Brenda vargjesh, ai

flet fillimisht për një vashë, pastaj për një grua, të cilat, autori i do të dyja, edhe vajzë, edhe grua, por në ndonjë rast edhe duke guxuar më tej. Kjo tregon që Lasgushi mbetet poet i guximshëm në letërsinë shqipe. Gjoli (liqer) ka qenë frymëzimi i tij, natyra ka qenë dashuria e tij, vasha ka qenë fshehtësia e tij, ambienti në përgjithësi ka qenë liria dashurore… Dhe kjo e bën atë poet të veçantë dhe të dhembshur, por edhe tepër të dashur për lexuesin. Rileximi i poezisë së Lasgush Poradecit nëpër kohë fiton dimensione më të plota, gjithëherë që e lexon atë në rritjen tënde.

Vetë Lasgushi thekson që *"Kur shkruan poezi duhet ta kesh shpirtin e shenjtëruar. Çdo poezi duhet të jetë një xhevahir dhe xhevahir duhet të jetë çdo varg i saj dhe çdo fjalë e saj duhet të jetë xhevahir. Prandaj poezi mund të shkruash vetëm pak, se ku t'i gjesh gjithë ata xhevahirë? Poezia duhet të jetë cilësi jo shumësi. Mos ki frikë se ke shkrojtur gjatë jetës tënde vetëm dhjetë poezi"* .

Në këtë punim do të japim rezultatet e një studimi në të cilin janë parashtruar 22 pyetje, lidhur me jetën dhe veprën letrare të poetit, bazuar në përgjigjet themeltare të shprehura nga të anketuarit, të krahasuara me interpretimin e përgjithshëm dhe raportin që del po prej analizës së tyre. Nga 200 të anketuar, të ftuar për t'iu përgjigjur pyetësorit të realizuar deri në korrik 2010, në mënyrë anonime me shkrim, na erdhën po 200 përgjigje. Nga një masë përgjigjesh pak më e lartë se 52%, mund të konstatojmë se këto opinione përfaqësojnë një shumicë të grupmoshave të ndryshme të popullsisë shqiptare.

Kampioni mbetet përfaqësues dhe është bërë në mënyrë rastësore. Në të janë përfshirë jo vetëm studentë por edhe njerëz me shkollë dhe pa shkollë. Kategoritë e përfshira në këtë pyetësor ishin: pensionistë 10%, punonjës në administratë 20%, studentë 25%, nxënës me arsim 9-vjeçar dhe të mesëm 20%, popullsi e zonave rurale 15% dhe popullsi në zonat urbane e paarsimuar (analfabetë ose vetëm me arsim fillor) 10%.

Vërehet se të gjithë janë dakord (100 %) që Lasgush Poradeci është poet pogradecar. Ndonjëherë të duket sikur të njëjtat pyetje dhe të njëjtat përgjigje krijojnë një rreth të mbyllur raportesh të ndryshme. Për një seri pyetjesh opininionet e të anketuarëve ishin të përziera. Zona e anketimit përfshinte në pyetësor pothuajse gjithë vendin tonë. U përfshinë studentë nga Jugu dhe Veriu i Shqipërisë bashkë me familjet e tyre. Në këtë kuadër pyetësori përfshiu në vetvete grupmosha të ndryshme të anketuarish.

Vlen të theksohet se prindërit e studentëve veriorë të anketuar, që studionin në Universitetin e Korçës e dinin që Lasgushi ishte poet pogradecar, mbase duke u nisur nga mbiemri i personalizuar i qytetit, që në këtë rast është pjesë e pseudonimit letrar të tij.

Në gjithë periudhën e viteve '30, në Shqipëri ,shkrimtarët të cilët krijuan dhe jetuan brenda dhe jashtë vendit stisën pseudonimet e tyre letrare. Llazar Sotir Gusho alias Lasgush Poradeci do të përjetësohet i tillë, jo vetëm atëherë, por edhe pas vdekjes së tij, madje edhe në ditët tona. Shumë shkrime të viteve '30 vijnë të nënshkruara me pseudonime letrare. Disa autorë erdhën edhe me dy apo tre pseudonime. Gusho përdori vetëm një, atë të Lasgush Poradecit, ndryshe nga kumbari i tij i poezisë Dhimitër Pasko, që krijoi tre të tillë. Dhimitër Pasko prezantohet me (Mitrush Kuteli, Izedin Jashar Kutrulia dhe Dr. Pas). *Me sa duket poetit të liqerit i mjaftoi një i tillë, i cili jo vetëm i ngjiti, por edhe i solli shumë fat, ndërsa e futi atë në pavdekësi*. (Daka, 1998, p. 100)

**Pyetja 1. Mosha juaj ?**

Në hartimin paraprak të pyetësorit ishin përfshirë grupmosha të ndryshme të cilat do të testoheshin për përgjigjet e pyetjeve që ata do të jepnin. Konkretisht: 8-12 vjeç; 13-17 vjeç; 18-24 vjeç; 25-29 vjeç; 30-34 vjeç; 35-39 vjeç; 40-44 vjeç; 45-49 vjeç; 50-54 vjeç; 55-59 vjeç; 60-64 vjeç; 65-69 vjeç; 70-74 vjeç; 75-79 vjeç; 80 vjeç e në vazhdim. Duke pasur të tilla mosha në përgjigjet e pyetësorit ai do të ishte më i vërtetë dhe më bindës. Në këtë kuadër u porositën studentët në shpërndarjen e tij të ishin sa më gjithëpërfshirës me njerëzit e afërm të tyre. Pjesën më të madhe të të anketuarvë e përbënte mosha 25-29 vjeç, të cilët ishin 100 vetë, pra saktësisht 50%. Moshës 18-24 vjeçare i përkisnin 25 vetë ose 12,5% dhe moshës 13-17 vjeçare i përkisnin 15 vetë ose 7,5%. Brenda këtij përpunimi të dhënash duhet thënë se anketues të moshave 8-12 vjeçare; 45-49 vjeçare; 55-59 vjeçare; 60-64 vjeçare; 70-74 vjeçare dhe 80 vjeç e në vazhdim nuk u përfshinë fare në plotësimin e pyetësorit. Ndërkohë kategoritë e grupmoshave të tjera përfshinë 60 vetë, saktësisht 30% e tyre, të cilët u bënë pjesë e mbushjes së tij.

Qëllimi i këtij pyetësori ishte të mblidhte të dhëna në lidhje me perceptimin e jetës dhe veprës së Lasgush Poradecit ndër lexues. Informacioni që do të jepej, do të ishte i gjithi anonim. U sqarua që pyetësori do përdorej vetëm për arsye studimi në përpilimin dhe analizimin e të dhënave përfundimtare. Gjithsecili duhet të vendoste shenjat +; –; apo X; brenda kuadratit përkatës të alternativës së përzgjedhur.

**Pyetja 2. Cili është niveli juaj arsimor ?**

Në pyetësor u pa e udhës që studentëve të largët që vinin kryesisht nga Veriu i Shqipërisë, madje nga zona të thella si Hasi, Kukësi dhe Puka t'u jepej edhe një pyetësor tjetër, i cili do të mbushej nga të afërmit, miqtë dhe shokët e tyre. Ideja ishte që të përfshiheshin në pyetësor grupmosha të ndryshme njërëzish, por edhe të kishte një shpërndarje gjeografike sa më të gjerë, duke përdorur kampionin empirik "top-dëborë". *Zgjedhja e shumëfishtë "top-dëborë" përfshin përdorimin e metodave probabilitare për një përzgjedhje fillestare të elementëve të kampionit dhe pastaj shtimin e shumëfishtë të njësive të zgjedhjes nëpërmjet përdorimit të informacionit të siguruar nga elementët fillestarë. Reduktimi i madhësisë së zgjedhjes dhe kostot e ulëta janë përparësitë e kësaj metode zgjedhjeje.*

**Pyetja 3.Gjinia që i përkisni ?**

Femrat janë më të tërhequra pas poezisë lirike, pasi e receptojë atë në mënyrë mjaft të brishtë. Mbase lirizmi i poezisë u fal konotacion pozitiv më tepër receptueseve femra, sesa receptuesve meshkuj. Grupmosha të ndryshme, të tilla, janë ndjerë mirë nën emocionin që të fal leximi i poezive të Lasgushit.

Ky raport me një fjalë nuk është i njëjtë mes femrës lexuese dhe mashkullit po lexues. Gjithçka statistikisht është shprehur me 20% më shumë për gjininë femërore. Femra duke qenë nga natyra e saj edhe më e hedhur apo më çapkëne, në këtë lloj poezie më së shumti ndihet më mirë se meshkujt. Lexuese femra kemi 120 ose (60%) dhe lexues meshkuj kemi 80 ose (40%). Vargu soft i Lasgushit, i përshtat figurës femërore një fjalor tipik personal. Ai shpesh vjen imponues në tërësinë e poezive. Studentet e degës gjuhë-letërsi shqipe në Universitetin e Korçës kishin njohje më të hershme me fjalën dhe poezinë e Lasgushit, ndaj mund të themi që mes poetit dhe lexuesit femëror, krijohet një lidhje shpirtërore e brendshme më e fortë. Nën këtë vështrim, Lasgushi e ka mbajtur pranë lexuesin femëror me fjalën e tij të zgjedhur, vargun muzikal dhe ritmin e saj. Duke e lexuar dhe duke e

njohur peshën e fjalës lasgushiane, ato e pëlqejnë këtë poezi.

Vasha e Lasgushit është një krijim i imagjinatës së tij, që më së miri i përket realitetit të kohës kur poeti vargëzoi. Janë thjesht koncepti i femrës, objektit të adhurimit dhe dashurisë së skajshme për të në poezi, momente që prangojnë gjininë femërore. Kjo duket prej tipareve të saj të kudogjendura në poezi. Veç bukurisë, pastërtisë, përskuqjes, s'ka asnjë të dhënë në poezi për emrin, profesionin, intelektin, interesat e saj. Prania e grave mbetet në vetvete një tjetër studim i imët për rolin e familjes dhe të femrës, si publik dhe si lexues në shekullin e XXI, në letërsinë shqiptare. Gjithsesi, në këtë pikë femrat rezultuan si lexueset më të zellshme të poezisë së Poradecit, duke përbërë 60% të të anketuarve.

**Pyetja 4. Cili është vendbanimi juaj ?**

Personat e përfshirë në pyetësor ishin studentë kryesisht nga Qarku i Korçës. Ndërkaq, duhet theksuar se dhjetë ishin studentë nga zonat e thella të Veriut që studiojnë në universitetin "Fan S. Noli" të Korçës, të cilët morën më shumë se një pyetësor me vete, për ta plotësuar edhe prindërrit apo të afërmit e tyre. (konkretisht nga Kukësi, Puka dhe Hasi).

Gjashtë prej tyre ishin vajza dhe katër prej tyre djem. (Rreth 20%). Njëqind e dhjetë ishin studentë nga qyteti i Korçës dhe fshatrat përreth (55%). Këtu një pjesë studentësh kanë qenë të grupmoshave të ndryshme pasi u përfshinë edhe nga studimi me kohë të pjesshme të këtij universiteti. Njëzet e pesë nga Pogradeci dhe fshatrat (13%), njëzet e katër nga Bilishti e fshatrat (12%) si edhe njëzet e një nga Erseka dhe fshatrat përreth (11%). Pyetësorët e shpërndarë mes tyre kërkonin kohën e mjaftueshme për t'u menduar dhe më tej për t'u mbushur drejt, kohë e cila supozohet se nuk ju ka munguar, që përgjigjet e tyre të ishin sa më të personalizuara dhe të sakta. Në një pyetësor vendbanimi është kusht kryesor, sepse të adreson më saktë dhe më drejt në hapësirën gjeografike që ti kërkon ta sjellësh në analizë, si pjesë e një interpretimi gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër ky "mision" quhet i përfunduar me sukses, pasi prania e tyre e dëshmon angazhimin në mbushjen e tij.

**Pyetja 5. Ju mund të thoni se Lasgush Poradeci është: (**Piktor; Shkrimtar; Aktor; Këngëtar; Arkitekt; Politikan**?**

Shumica e të anketuarve lidhur me pyetjen e pestë, shprehen të sigurtë se Lasgush Poradeci është shkrimtar 150 (75%), madje një pjesë e mirë e tyre janë të informuar që Lasgushi ishte edhe piktor 50 (25%). Shumica e opinioneve të tyre jepen me më tepër se një alternativë të qarkuar, ç'ka të linte të kuptoje që krahas poetit kombëtar Poradeci ishte për ta edhe piktor. Zhurma piktorike ndërkohë vijon të trandë mediat shqiptare. "Një poet është vetvetiu piktor, aq më tepër kur poezia e tij mbetet një pikturë e ngrirë në bojëra vaji. Lasgushi mori kulturën e duhur përmes studimeve në Akademinë e Arteve të Bukura në Rumani. Kështu, Poradeci do të pikturojë portretin nudo, të një vajze rumune. Fakte e kujtime të tilla e lidhin poetin tonë me pikturën, madje edhe punët e pikturuara të Androniqi Xengos. Piktura dhe vizatimet e realizuara nga Lasgushi janë plot 54. Ndër to përmendim: *"Dy cicat që tronditën botën", telajo, përmasa 70x50cm; "Portret i Stanisllavës" me mbishkrimin "Stanisllava kur e putha në llërë", me laps, përmasa 54x64cm; Eqrem Çabej duke pirë cigare" me laps, përmasa 14.5x10cm; "Mitrush Kuteli ulur mbi arkë", me laps, përmasa 38x14cm etj. Pra, më 1 tetor 1922 Lasgushi është anëtar i Shoqërisë së Studentëve të Shkollës së Arteve të Bukura në Rumani. Pikturat me ngjyra vaji Lasgushi i ka në këtë periudhë të jetës së tij. Në konkursin e provës, vizatoi*

*skulpturën e perëndeshës Afërdita. Madje, kur u dhanë rezultatet Lasgushi doli i pari. Më 1 dhjetor 1934, Lasgushi emërohet profesor vizatimit dhe bukurshkrimit në Liceun Shtetëror të Tiranës. Tërë poezitë e tij kanë fjalë të pavdekshme që ftillëzojnë imazhe të pabesueshme. Një poet është vetvetiu edhe piktor edhe nëse nuk bën kurrë pikturë. Punimet te Lasgushi shpalosin mrekullitë fabuleske te liqerit, lëvizjen në shtërnagatë, urinë botiçeliane të të dashurave, sakrificat biblike të pelikanëve, që poeti i mbiquan peliaknë." (Zeqo, 2003, p.5)*

Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve kishin shënuar që ai ishte politikan, 5 vetë ose 2,5%, kishin bindjen e tyre se Lasgushi ka qenë pjesë politikës që bëhej në vitet '30 të shekullit të kaluar në Shqipërinë e mbretit Zog. Një pjesë kishin mendimin që Lasgushi ka qenë pjesë përbërëse e deputetëve shqiptarë, pasi veç shenjimit të bërë te fjala poet, ata kishin shenjuar edhe fjalën politikan. Mesa duket klima politike e viteve '30 prekte për ta edhe intelektualin e rikthyer në atdhe për të jetuar dhe kontribuar për Shqipërinë si shumë të rinj të atyre viteve, të cilët gjendeshin mes alternativës, të qëndronin larg atdheut apo të riktheheshin e t'i shërbenin atdheut. Gabimi i anketuesve është fare i vogël në kontekst të pyetjes së gjashtë. Gjithashtu, duhet thënë se opinionet e tyre janë të bashkuara në dualitetin e përgjigjeve që ata japin se Lasgushi ishte edhe aktor, edhe këngëtar. 180 (90%) e tyre justifikojnë përgjigjen e saktë. Të anketuarit kanë menduar se poeti poradecar ka qenë edhe artist i filmit dhe këngës, duke u nisur nga shumë figura të asaj kohe, të cilët u angazhuan me këto gjini brenda dhe jashtë Shqipërisë. Mbase të menduarit gabim vjen edhe prej faktit që mjaft poezi të Lasgushit, janë muzikuar në vite, nga kompozitorë të ndryshëm shqiptarë.

Shkrimtari dhe piktori u gërshetuan më së miri në alternativat e atë anketuarve, duke justifikuar njohuritë e tyre të fituara apo të mësuara përmes leximit apo orës së mësimit, qoftë kjo akademike apo edhe në nivele të të tjera të arsimit parauniversitar shqiptar. Theksoj piktura mbetet njëra anë e medalies së shkrimtarit që realisht ka pikturuar me ngjyra dhe "fjalë" apo ka vargëzuar me fjalë dhe "ngjyra", që sigurisht të anketuarit e kanë pasur parasysh në pjesën më të madhe të tyre në përgjigjet që dhanë për këtë pyetje.

**Pyetja 6. Në cilin ambient, ju keni dëgjuar për emrin ose veprën e tij?(** Në shkollë; Në familje; Në bibliotekë; Nga shokët; Në tv; Në radio)

Të dëgjosh për një poet ndodh shpesh në jetë. Ai, një ditë të bëhet prangim i kënaqësisë shpirtërore që të fal vepra e tij. Është interesante të shohësh sesi të anketuarit vetë, e perceptojnë idenë që për Lasgushin kanë dëgjuar për herë të parë në shkollë, konkretish në vitet e sistemit arsimor parauniversitar. Ata janë 155 të anketuar, ose 77%. Poezia lasgushiane ka tërhequr vëmendjen e lexuesve më tepër mbase me ndonjë varg erotik. Ndjeshmëria e publikut drejt këtij parapëlqimi mbetet e pritshme. Pjesa e madhe e të anketuarve kanë dëgjuar për veprën letrare dhe jetën e poetit veçanërisht në masmedia. Janë 150 të tillë ose 75% që kanë dëgjuar përmes mjeteve të informimit ekzistencën e poetit poradecar. Më së shumti rolin kryesor e zënë televizioni dhe radio, që e kanë trajtuar figurën e poetit mes kronikash dhe emisionesh të ndryshme. Mbase në familjen shqiptare flitet pak ose aspak për një poet. Familja shqiptare mund ta ketë ose jo një libër artistik në bibliotekën personale. Shkak për mungesën e një libri poetik të Lasgush Poradecit, në bibliotekën personale është edhe tirazhi i vogël i veprës letrare të poetit ndër vite.

Receptuesit e kanë kërkuar nëpër librari dhe nuk e kanë gjetur. Një shkak më vete ka qenë edhe çmimi i lartë i veprës poetike nr. 1 (poezia) edhe pse ajo mbetej një financim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Vetëm 50 vetë ose 25 për qind e të anketuarve kishin dëgjuar të flitej në familjen e tyre për veprën letrare të poetit, apo të kishin një libër poetik të Poradecit.

Dihet që biblioteka kudo dhe gjithkund mbetet një oaz dijesh të padiskutuara për rëndësinë e madhe që ajo mbart ndër njerëz, të cilët kërkojnë të afirmojnë vetveten në koherencën tonë. Por çuditërisht 22 të anketuar ose 11% kishin dhënë një përgjigje e cila do të ishte mirë të ishte alternativa 100% e të gjithë të anketuarëve. Por fakti mbetet kokëfortë, ç'ka nënkupton se bibliotekat frekuetohen pak ose aspak nga lexuesi. Pjesa më e madhe e numrit në total të anketuesve me 0% kishin shmangur opsionin shokët. Askush nuk e kishte marrë informacionin për krijimtarinë lasgushiane nga shokët apo shoqet e tij. Kjo të bën të besosh se libri zë shumë pak vend, në jetën e përditshmërisë së të anketuarëve. Mbase këngët, hite botërore apo filmat zënë një vend më të rëndësishmëm ndër ta për diskutime. Eshtë për të ardhur keq, që libri nuk zë vend në këto diskutime, që ata bëjnë në përditshmëri. 170 vetë ose 85% e tyre kishin dhënë më shumë se një alternativë në përgjigje. Kjo shkallë e lartë përgjigjesh tregon se ata në një farë mënyre kanë informacion për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit. Madje dinë edhe vargje të ndryshme të poezive të poetit. "Poetët në teatër" është një serial që sjell poezinë shqipe të interpretuar në skenën "Shekspir" të Teatrit të Metropolitan, Tiranë. Një episod i është kushtuar poezisë së Lasgush Poradecit. Ka lexues që kjo mikroklimë i duket e ngrohtë për poezinë, ka të tjerë dhe këta nuk janë vetëm nostalgjikë, që nuk janë kundër poezisë vizuale. Ata e shohin me kënaqësi një spektakël të tillë në sallë, apo në radiotelevizon të shfaqur. Mjafton të kujtojmë këtu ritransmetin e hërëpashershëm të ciklit, apo dokumentarët që janë realizuar për poetin e dashurisë, nga kineastë adhurues të poezisë së Poradecit.

**Pyetja 7. Cili nga vargjet e mëposhtme i takon Lasgushit ?(** Gush-e-gji-stolisura; Mbi varrin tim do të rrijë i heshtur; Do vajtoj pa fund, pa shpresë; Nuk e di)

Në këtë pyetje ishin përfshirë vargje të Lasgushit, Dritëro Agollit dhe të Fan Nolit. Vargjet nuk kishin identitet të autorësisë. Vargu *Gush-e-gji-stolisura* ishte shkëputur nga poezia *"Vallja e luleve"* të Lasgush Poradecit. Vetëm 160 studentë ose 80% kishin dhënë përgjigjen e saktë në pyetësor. Njëzet prej tyre ose 10%, kishin vendosur përgjigjen e gabuar duke shenjuar vargun e poezisë "Kur të jesh mërzitur shumë..." të Dritëro Agollit. Dhjetë ose 5% kishin dhënë sërish përgjigje të gabuar, duke cilësuar si vargje të Lasgushit, ato të Fan S. Nolit. Ndërkaq, përqindja më e madhe e të anketuarve, kanë dhënë përgjigjen e saktë të pyetjes numër tetë, duke qarkuar alternativën e saktë. Mbajtja mend e vargjeve të Lasgushit, nga personat e anketuar ka ardhur si rezultat i rubrikës mësoni vjershën përmendësh që gjendet në fund të teksteve shkollore, kërkesë që rrit kreativitetin e të menduarit dhe të arsyetuarit në jetë, rrit shprehësinë e gjithkujt për të qenë i sukseshëm në shoqëri. Ky "minikonkurs" i formës me shkrim, tregoi se të anketuarit kishin dijeni për ekzistencën e vargut lasgushian. Këtë e provon dhënia e përgjigjes së saktë në anketim, për gjetjen e vargut të Lasgushit. Dhjetë prej tyre ose 5% kishin shenjuar alternativën nuk e di. Ndoshta vërtet ata nuk kanë ditur vargje përmendësh të poetit. Mbase nuk kanë dashur të

"dokumentojnë" mos njohjen e poezisë së *"shtërgut të fundit"*. Ky fakt ka treguar se ata nuk kanë ditur as vargje të Dritëro Agollit apo Fan Nolit. Mungesa e një informacioni të gjithëdijshëm prej tyre tregon se ata nuk kanë ditur se cilit poeti i përkisnin vargjet e përzgjedhura.

**Pyetja 8. Cila është vepra e parë poetike e Lasgush Poradecit ?(** Vallja e yjve; Ylli i zemrës; Nuk e di)

Kësaj pyetjeje të pyetësorit i janë përgjigjur saktë 140 persona ose 70%. Libri i parë poetik i Lasgush Poradecit "Vallja e yjve" përmban 51 poezi. Duhet të theksohet këtu gabimi që bëhet në shkrimin e titullit të këtij vëllimi poetik apo vetë titullit të poezisë në fjalë, nëpër tekste shkollore të sistemit parauniversitar shqiptar dhe atyre universitare. Pra, shkruhet "Vallja e yjeve" dhe jo "Vallja e yjve" si në origjinal. Aq më tepër kur bëhet fjalë për një vëllim poetik, të një autori të rëndësishëm në letërsinë shqiptare. Pesëdhjetë e pesë ose 27%, kishin listuar vëllim e dytë poetik të Lasgushit, si vëllim të parë poetik të autorit. Për ta villimi i dytë, ishte libri i parë i Lasgush Poradecit, libër që ka ka në përmbajtjen e tij 70 poezi. Ndërkohë 5 veta ose 2,5% e tyre nuk e dinin fare titullin e librave poetikë të Lasgushit. Kjo mungesë informacioni krijohet për ta, nga mosfrekuentimi në shkollë apo boshllëqe në lëndën e letërsisë.

**Pyetja 9. Në strofat e mëposhtme, vendos fjalën e munguar ?(** Strofa e parë; Strofa e dytë; Nuk e di)

Njëqind e nëntëdhjetë pjesëmarrës ose 95% e tyre në pyetësor, kishin plotësuar fjalët e munguara në vargjet e mëposhtme. Një pjesë e mirë kishin gjetur drejt fjalët e munguara në të dyja strofat e poezive të përzgjedhura nga krijimtaria lasgushiane. Strofa e parë dhe strofa e poezisë së dytë e patën mundësinë më të madhe, të plotësoheshin me fjalët e munguara, pasi ato mbeten poezi shumë të njohura për lexuesin. Strofa e parë i përkiste poezisë *"Ku shtrohet vala..."*, ndërsa strofa e dytë ishte pjesë e poezisë *"Testamenti"* . Në poezinë e parë, në vargun e dytë fjala e munguar ishte *dashuria*, dhe në vargun e katërt, fjala e munguar ishte *fshehtësia*. Ky varg mbahet lehtësisht përmendësh nga lexuesit, pasi rezulton si i shumë përdorur në tekste mësimore apo emisione mediatike. Në poezinë e dytë, fjala e munguar ishte *punë*, fjalë e cila përsëritet në vargun origjinal të poetit, tri herë. Njëqind të anketuar kishin gjetur drejt fjalët e munguara të vjershës së parë. Ndërkohë 90 persona ose 45% e të anketuarve kishin plotësuar drejt fjalët e munguara në poezinë e dytë. Përgjigjen *nuk e di* e kishin përzgjedhur 10 ose 5%, studentë, ç'ka lë për të nënkuptuar se ata nuk ishin në gjendje të dallonin vargjet e shkruara nga Lasgush Poradeci. Shumica e të anketuarëve kishin një orientim të drejtë për të zëvendësuar me shkrim tekstin e munguar. Pra, në përqindje më të madhe kishin dhënë përgjigje të sakta, ata njerëz që njihin mirë poezinë lasgushiane, mbase ata që kishin mësuar përmendësh vargje të poetit liqenor. Për hir të së vërtetës, duhet të merret në konsideratë ideja së të dyja poezitë e krijuara nga Poradeci, janë shumë të njohura në opinionin publik. Andaj, poezitë justifikojnë përpjekjen e madhe të njeriut për të përvetësuar shprehi në vargje poetësh të ndryshëm në përgjithsi, konkretisht, në veçanti të Lasgush Poradecit. Të binte në sy fakti jo normal, që pjesa më e madhe e të anketuarve nuk e kishin idenë fare se çfarë titulli kishin poezitë që ishin përzgjedhur për t'u përdorur në pyetësor. Poezitë janë të ndjera dhe adhurohen vazhdimisht nga lexuesit e poetit.

*Hija ime nuk di dhunë*
*Di veç frymëzim lirije*
*Dhe di ....., ....., .....,*

*Mund pa fund për art magjije*
*Se s'dashuronja-as un' as ti*
*Por dashuronte ..... :*
*Një dashuri-një fshehtësi*
*M'e fshehur sesa .....*

**Pyetja 10. Cili është mendimi juaj për moshën e Lasgushit ? (**60 vjecar; 70 vjecar; 80 vjecar;Nuk e di; Rron akoma)

Një pjesë e mirë lexuesish dhe adhuruesish të poezisë lasgushiane nuk e kanë ditur saktë vitin e lindjes së poetit. Rrjedhimisht ata kanë gabuar në përcaktimin e moshës së tij. Një pjesë e tyre duke dhënë shumë alternativa mbi pyetjen e 10-të kanë thelluar edhe më tepër idenë që çelet nga debati për moshën e vërtetë të Lasgushit. Lidhur me pyetjen ...është gjallë apo ka vdekur Lasgushi, 145 ose 72 % e tyre mendonin që poeti kishte vdekur dhe vetëm një pakicë e vogël njerëzish e dinin që ai frymonte akoma nëpër rrugët e lagjes së vjetër të Pogradecit, qytetin e lindjes së Lasgushit, pse jo edhe në Tiranë.

Ditëlindja e Lasgushit, më saktë mossaktësia e saj ka bërë që edhe studiuesit e veprës së tij të ngatërronin moshën e vërtetë të poetit. Pjesa e më e madhe e lexuesve e dinin të vdekur qyshkur dhe jo të gjallë poetin liqenor. Heshtnaja e tij nën diktaturë, mesa duket e thelloi edhe më tepër misterin rreth rrojtjes apo mosrrojtjes, rrjedhimisht edhe mossaktësinë e moshës. Një pjesë e vogël anketuesish janë përgjigjur nuk e di. Saktësisht 10 prej 200 të anketuarve ose 5% e tyre, ndërsa pjesa tjetër prej 10 vetësh (5%) mendojnë se ai rron ende. Pesëmbëdhjetë persona të anketuar në pyetësor, (7,5%) kanë dhënë përgjigjen se Lasgushi është 70 vjeçar. 20 persona ose 10%, shprehen përmes shënjimit të tyre që Lasgushi është 80 vjeç. Nuk ka asnjë shenjim te alternativa Lasgushi 60 vjeçar. Sipas datëlindjes së tij (1899), më 27 dhjetor 1979, Lasgushi mbushi 80 vjeç. Po sipas kësaj datëlindjeje, më 27 dhjetor 1999, Shqipëria festoi 100- vjetorin e lindjes së tij. Te pllaka e varrit të poetit, që ndodhet në Pogradec, në varrezat e publike, shkruhet vitlindja dhe vitvdekja e Lasgushit (1899-1987). Lasgushi vdiq më 12 nëntor 1987. Gjithashtu ka hamendësime që liriku i shqipes ka lindur më 27 dhjetor të vitit 1900 në Pogradec. Me ç'duket vitlindja e poetit lëviz me një vit. Në shënime të kohës del edhe kjo pasaktësi. Shkrimi mbi varrin e tij në Pogradec, ndërkaq mbetet një dëshmi e saktë dhe publike e lindjes dhe vdekjes së Lasgush Poradecit, përllogaritja e të cilit jep edhe moshën e Lasgushit, 88 vjeç. Duhet thënë se shumë pak të anketuar se dinin që Lasgush Poradeci nuk kishte vdekur ende. Pjesa tjetër, 72% e dinin që shtërgu i fundëm kishte mbyllur sytë përgjithmonë me vdekjen e tij një ditë të ftohtë në moshën 88-vjeçare në Pogradec.

**Pyetja 11."Shqiponjë-e arratisur" është frazë e bukur, e shkëputur nga një poezi e autorit... Ju mendoni se ajo i takon asaj me titull?(** Vdekja e shtërgut; Poradeci; Bjenë telat; Kamadeva)

Pjesa më e madhe e të anketuarve pyetjes 12 i janë përgjigjur saktë. 175 ose (87%) e dinin që fraza ishte shkëputur nga poezia antologjike *"Poradeci"*. Shtatëdhjetë prej tyre kanë dhënë përgjigjen e duhur për vargun e marrë nga poezia *"Poradeci"*. Madje duhet theksuar se ishte marrë nga të dyja variantet e kësaj poezie. 10 veta ose 5% janë shprehur gabim se fraza i përket poezisë *"Vdekja e shtërgut"* dhe 15 persona (7,5%) mendojnë se fraza është shkëputur nga poema e dashurisë *"Kamadeva"*). Nuk ka asnjë shënjim që fraza i përket poezisë *"Kamadeva".*

Një ndihmë e madhe në formimin e nxënësit është aparati pedagogjik i librave shkollorë të Gjuhës amtare apo mirëfilli teksteve shkollore të letërsisë (sikurse

lënda emërtohej dikur) ku kërkohet të mësuarit përmendësh i poezisë. Kjo ka bërë që ata t'i përgjigjen pa problemin më të vogël, versionit të drejtë të pyetjes. Kanë dhënë përgjigjet e tyre të gabuara 70 studentë duke përfshirë mes tyre poezitë *"Vdekja e Shtërgut"*, *"Bjenë telat"* dhe poemën *"Kamadeva"* . Përgjigja e saktë ishte që ky varg i përket dy variantave të poezisë "Poradeci". Duhet theksuar se poezia në fjalë është ndër poezitë e përzgjedhura nga hartuesit e teksteve mësimorë në arsimin parauniversitar shqiptar, qoftë edhe në altertekstet e mëvonshme, madje edhe në botimet antologjike. Duke fituar këtë "popullaritet", si një ndër poezitë e përzgjedhura në programin mësimor, poezia ka mbetuar sigurisht ndër më të lexuarat, komentuarat dhe analizuarat nga lexuesi i "detyruar" i saj nëpër shkollat tona. Mbase një pjesë e mirë e të anketuarave mund ta kenë ditur përmendësh poezinë *"Poradeci"*. Atgumentet e mësipërme e justifikojnë faktin që 87% e të anketuarëve e kanë ditur që *"shqiponja e arratisur"* ishte shkëputur nga kjo poezi që shijon mrekullisht në dy variantat e saj.

**Pyetja 12. Sa botime të Lasgush Poradecit gjenden në bibliotekën tënde ?(**1; 2; 3; Më shumë; Asnjë)

Pjesa më e madhe e të anketurve nuk kishin asnjë vepër letrare të Lasgush Poradecit në bibliotekat e tyre familjare apo personale. Konkretisht, 158 prej tyre ose 79% nuk kishin në biblioteka asnjë botim të veprës letrare të Lasgushit. Asnjëri prej tyre nuk kishte tre botimet e edituarara ndër vite. Mungesa e veprës së Poradecit në tregun shqiptar pas çlirimit të vendit, shpjegohet me tirazhin e vogël por edhe të paribotuar të saj. Diktatura e boton veprën e poetit në vitet 1960, 1974 dhe 1990. Në Kosovë Lasgushi botohet më '68-ën, '78-ën, '86-ën dhe '90-ën. Më 1999, shtëpia botuese *Onufri*, boton tri veprat e Lasgushit (poezia, poemat; publicistika; ditare personalë). Dy botime modeste me poezi të zgjedhura kemi në 2002-in dhe 2005-ën. Ndërkaq, në vitin 2009 edhe në vijim shtëpia botuese private albPAPER bën ribotimin e veprës së poetit. Deri tani botimi i saj ka shkuar te vepra nr. 5, (*Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdren)* si dhe botimi i librit me piktura të poetit. *(Të ritë e viteve të mi. Koleksion i pikturave të Lasgush Poradecit)*.

Horizonti pritës për veprën e Lasgushit ka qenë gjithmonë në interes për veprën letrare, por për hir të së vërtetës ajo mungon në treg ende, madje edhe në panairet e librit brenda dhe jashtë vendit tonë. 15 veta ose 7,5% kishin vetëm dy vepra, më shumë se tri botime nuk kishte asnjë i anketuar. Njerëzit duan ta kenë të paktën në bibliotekat e tyre, ribotimin me poezi të Lasgushit, por ata stepen për shkak të çmimit të lartë të saj. Vepra letrare, nr.1, që ka poezinë dhe poemat e Lasgushit kushton 1500 lekë.

Gjithsesi duhet thënë që poezitë e Poradecit sërish lexohen dhe mësohen përmendësh, pasi vepra e tij qarkullon në biblioteka shtetërore dhe private, apo dorë më dorë, pasi e ka blerë njëherë atë, dikush ose nëpërmjet internetit. Ky numër është jo i pakët. Janë 27 të anketuar që e kanë veprën e Lasgushit. Ata, të shprehur në përqindje, saktësisht sipas këtij anketimi janë 13,5%.

**Pyetja 13. Ju mendoni që Lasgush Poradeci ka mbiemrin e tillë se...?(** Ai ka lindur në Pogradec; Babai i tij ka lindur në Pogradec; Nëna e tij ka lindur në Pogradec)

Për këtë pyetje, 190 persona ose 95% kanë dhënë opinionin se Lasgush Poradeci, ka lindur në Pogradec. Të gjithë pothuajse kanë dhënë këtë përgjigje, po të shtojmë edhe 10 të anketuar ose 5%, që kanë zgjedhur se poeti lindi në Pogradec, meqë babai i tij ka lindur në Pogradec. Pra, të

gjithë e dinë që Lasgushi ka lindur në Pogradec. Dihet që emri i poetit është Llazar Gusho dhe pseudonimi letrar Lasgush është formuar nga bashkimi shkurt i tyre plus emrin e qytetit në trajtën e tij të vjetër Poradec. Asnjë person i anketuar nuk ka mbështetur opsionin që Lasgushi ka mbiemrin e tillë meqë nëna e tij ka lindur në Pogradec.

Emri i qytetit Pogradec, gjithkënd e sqaron, adreson dhe e informon se poeti i liqerit është nga qyteti i Pogradecit. Sipas përgjigjeve të mbledhura nga anketimi ata mendojnë se Lasgushi nuk ka lindur në një tjetër qytet të Shqipërisë, veçse Pogradecit të tij frymëzues për vargjet e tij. Kështu vendlindja bëhet për Lasgushin një lloj pasaporte, a emblemë që e identifikon poetin më qytetin, në të cilin jetoi, krijoi vargje poetikë dhe u shua për t'u përjetësuar...

**Pyetja 14. Kritika letrare ka bërë një cilësim të qartë për Lasgushin si: ? (**Novelist; Lirik; Piktor; Botues; Përkthyes; Autor tekste këngësh; Asnjë prej tyre; Tjetër**)**

Duke u nisur nga vlerësimet që i janë bërë figurës së Lasgushit, ai mbetet një figurë shumëdimensionale. Të anketuarit duke dhënë më shumë se një alternativë pothuajse kanë prekur të gjitha cilësimet që figura e tij mbart. Poeti lirik, piktori, përkthyesi me normë i shëpisë botuese "Naim Frashëri", autori i teksteve këngë në gjallje dhe pas vdekjes. Lasgushi, tashmë arrin të perceptohet ndër lexues si një vlerë disafishe. Theksojmë këtu se përkthimet e Lasgushit në vetvete janë shqipërime të rikrijuara në variantin e tyre të botimit allalasgushian. Pushkini, Hajnia, Hygoi, Lermontovi, Miçkeviçi, Gëtja, Brehti, tingëllojnë lasgushianë. Edhe sot e kësaj dite përkthimet e Poradecit mbeten shembuj të arrirë të përkthimit shqip. Këtë e dëshmojnë me përgjigjet e tyre shënjuese 90 vetë ose 45%. Në alternativat e tjera të pyetësorit 155 anketuesit ose 77%, janë ndalur dhe kanë shënjuar më shumë se një të tillë. Përgjigja e munguar 0%, Lasgushi novelist, tregon se të anketuarit e dinë që L. Poradeci nuk është i tillë. 110 prej tyre ose 55% e dinë që Lasgushi është poet lirik. 20 të anketuar (10%) e dinë që poeti liqenor është piktor jo vetëm me vargje, por me ngjyra konkrete vaji. 20 anketues apo 10% japin përgjigjen se Poradeci është autor tekste këngësh të muzikës së lehtë shqiptare. Nuk kanë shënjuar asnjë nga alternativat e mësipërme 10 vetë ose 5%. Asnjë përgjigje nuk ka pasur për alternativën Lasgushi editor. Dorës së lirë të anketimit, në këtë pyetje i kanë thënë jo pothuajse të 200 personat e anketuar. Askush nuk ka dhënë një obsion për të shtuar diçka që e kishte dëgjuar nga jeta dhe vepra letrare e L. Poradecit. Duhet thënë se poeti i dashurisë njihet nga pjesa më e madhe e të anketuarve edhe si shumë dimensional, duke mbrujtur me mençuri cilësimin real që i ka bërë kritika shqiptare. Autori i lirikave me sa duket është ngulitur thellë në mendjet e tyre dhe s'mund të harrohet as si përkthyes, piktor, ose autor tekste këngësh të muzikës së lehtë shqiptare. Novelisti dhe botuesi nuk kanë marrë asnjë shenjim në fletët e anketave të shpërndara.

**Pyetja 15. Lasgush Poradeci ka marrë çmime të llojit (**Nobel" në letërsi; "Nderi i Kombit"; Mësues i merituar; Naim Frashëri i Klasit të Parë"**)**

Çështja e informimit ka rëndësi të madhe në jetën e gjithsecilit nga ne. Duhet theksuar së Poradeci nuk ka fituar asnjëherë Nobel në letërsi edhe pse do ishte nder dhe krenari kombëtare për ne shqiptarët. Madje një çmim i tillë, për të, nuk është dhënë asnjëherë. Anketuesit në këtë pikë janë të mirinformuar. Që Lasgushi është nder i kombit, ky fakt dihet nga 50 vetë ose 25% e të anketuarëve.

Konkretisht, me rastin e 100-vjetorit të lindjes në 27 dhjetor 1999, presidenti i Republikës i jep L. Poradecit, titullin "Nderi i Kombit" dhe Pogradeci, qyteti i lindjes i akordon titullin "Qytetar Nderi i Pogradecit". Titulli qytetar nderi mbetet një vlerë më tepër për mjeshtrin e letrave shqipe. Dhjetë veta ose 5% e panë të udhës të shënjonin Lasgushin si mësues të merituar. Mbase ata niseshin nga fakti që Lasgushi dha lëndën e vizatimit në gjimnazin e Tiranës. Medalja "Naim Frashëri" i klasit të parë, grupoi në shënjimin e tyre 40 persona (20%). Duhet thënë se Lasgush Poradeci ka marrë çmimin më të madh, atë të lexuesit, që vjen nga pëlqimi i poezive të tij nëpër kohë, madje edhe nga tekstet e muzikuara për këngë në festivalet e këngës së lehtë në RTSH dhe jo vetëm. Anonimati i anketimit ka motivuar një numër të madh përgjigjesh nga studentë dhe të afërm të tyre, të cilët kanë shprehur mendimin personal dhe të sinqertë. Edhe këtu duhet theksuar se të anketuarit kanë dhënë më shumë se një alternativë të vetme si përgjigje. Një gjë të tillë e kanë bërë 62 persona ose 31% e tyre. Çmimet mbeten vlerësim në përjetësi edhe pse Lasgushi i fitoi ato me pavdekësinë e veprës. Ndodh, që vlerat e mëdha, njërëzve tanë të realizuar në fusha të ndryshme të jetës, veçanërisht artit dhe letërsisë ua japim apo ua njohim pas vdekjes. Kështu ka ndodhur edhe me Lasgush Poradecin... Ndërsa madhështia e poetit ekziston ndër breza lexuesish, heshtimi personal përballë diktaturës, "harrimi" me dashje prej saj, nuk ulën dëshirën e leximit të poezive të tij. Madje ndonjëherë edhe e shtuan më shumë kërshërinë e lexuesve për receptimin e saj në mënyrë individuale, sipas shijes preferenciale të gjithsecilit.

**Pyetja 16. Librin e Lasgush Poradecit e keni blerë...? (**Në qytetin tuaj **;** Në një qytet tjetër **;** Panair libri **;** Kosovë; Maqedoni**;** Shtet tjetër **;** Ta dhuroi dikush **;** Bukinist **;** Në internet **;** Nuk kam blerë asnjë **;** vendosni më shumë se një alternativë)

Të blesh libra gjithëherë është ushqim shpirtëror ose investim kulturor personal. Vlera e librit mbetet një vlerë e çmuar dhe e pazëvendësueshme. 10% e të anketuarve nuk kanë asnjë dyshim që librin e Lasgushit, e kanë blerë në qytetin e tyre. Në qytete të tjera e kanë blerë veprën e poetit 10 vetë ose 5%. Në Kosovë e ka blerë librin 1 person i vetëm, 0,05%. Në Maqedoni e ka blerë gjithashtu librin e Lasgush Poradecit përsëri 1 person 0,01%. Në shtete të tjera nuk e ka blerë librin askush nga të anketuarit. Pesë persona të anketuar e kanë blerë librin në një nga panairet e librit të mbajtura në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, në vitin 2000 (i vetmi panair ku është tregtuar vepra e Lasgushit). Pranë stendës së poetit, librat janë dhënë me autografë nga dy bijat e tij. Duhet sqaruar se dikur, një libër të Lasgushit nuk e gjeje në librari pasi tirazhi i tregtimit ishte shumë i vogël. Ndërkaq sot libri i Lasgushit nuk mungon në libraritë e Shqipërisë, madje as në zonat e thella malore të vendit tonë. Botime të Lasgushit gjenden edhe në Kosovë dhe Maqedoni falë një distribuimi të mirë të tirazhit të veprës letrare. Në librari të veçanta bëhet tregtimi i serisë së veprës të L. Poradecit. Poezia e Poradecit është e parapëlqyer për çdo grupmoshë, ndaj libri i tij përzgjidhet për t'u dhuruar në raste festash personale familjare. Pesë persona ose 2,5% janë ndjerë mirë me këtë dhuratë. Personat që e tregëtojnë librin në rrugë apo bukinistët sikurse kanë emrin e tyre "zyrtar", në këtë pyetësor nuk janë pjesë e tregtimit të librit të Lasgushit, (botime të hershme këto, të realizuara ndër vite). Sjellim ndërmend për shembull botime të shtëpisë botuese "Naim Frashëri". Ndërkaq, interneti mbetet një botë lundrimi pa kufij, madje edhe blerjet mund t'i bëjë gjithkush përmes shërbimit

on line, por përmes internetit askush nga të anketuarit tanë nuk e ka blerë atë. Dikur nuk gjendej në raftet e librarive asnjë vepër letrare të Poradecit, ndërsa sot falë botimeve të ndryshme të poezisë, vepra e lirikut gjendet nëpër librari. Ka edhe të anketuar, që nuk kanë pasur mundësi të blejnë një libër të Lasgush Poradecit. 158 persona ose 79% nuk kanë blerë asnjë libër të poetit, ndërsa e kanë gjetur atë në ambientet e bibliotekës së qytetit apo shkollave të mesme. Përgjigjet e kësaj pyetje kanë qenë të larmishme sikurse vërehet edhe nga ky anketim. Më shumë se një alternativë kanë dhënë 42 të anketuar ose 21% e tyre. Në ditët tona mundësitë për ta blerë një vepër të lirikut është më e mëdhe, pasi edhe gjeografia e shpërndarjes së tirazhit të librit, por edhe shitja e tij bëhet në të gjitha trojet shqipfolëse.

**Pyetja 17. Në sa prej gjuhëve të botës janë përkthyer poezitë e Lasgushit ...? (**Gjermanisht**;** Anglisht **;** Rusisht **;** Frëngjisht **;** Spanjisht **;** Tjetër vendosni më shumë se një alternativë**)**

Opinionet e qytetarëve nëpër Shqipëri, lidhur me përkthimin e poezive të Lasgushit në gjuhë të huaja është i dyzuar, sepse një pjesë mendojnë që Lasgushi flet edhe në gjuhë të huaja me artin poetik. Një pjesë pohojnë se Lasgushi ende nuk ka filluar të komunikojë në gjuhët kryesore të globit. Nëse ju pranëvëmë këtyre mendimeve edhe thënien e famshme të Çabejit, *"...kur Lasgushin do ia falim botës",* mund të themi që ky rrugëtim është në rrugë të mbarë. Lasgushi është përkthyer në të gjitha gjuhët e huaja të renditura si alternativa në pyetësor. Në gjermanisht, anglisht, rusisht, frëngjisht, spanjisht dhe më gjerë vijon të përkthehet në gjuhë të tjera të huaja. Ka kohë që lexuesi i huaj shijon poezinë e Lasgush Poradecit në disa gjuhë. Numrin më të madh të të anketuarve të cilët e dinin se poeti liqenor ishte përkthyer në gjuhë të huaja, e zinte gjuha angleze. Ishin 60 të tillë ose 30% që ishin pozicionuar tek alternativa anglisht. Alternativa poezi në gjuhën frënge ishte përzgjedhur në pyetësor nga 35 anketues ose 17,5% dhe pasohej nga 15 anketues ose 7,5% e tyre që kishin përzgjedhur spanjishten si gjuhë të huaj, ku ishin përkthyer poezitë lasgushiane. 10 persona ose 5% mendonin që poezia e Lasgushit është përkthyer edhe në gjuhën gjermane. Alternativat poezi të përkthyera në rusisht apo në gjuhë të tjera të huaja nuk kishin asnjë përzgjedhje nga anketuesit. Mungesa e informacionit se poezitë e Lasgush Poradecit janë përkthyer në gjuhën ruse, ka bërë që mos kishte asnjë shënjim në pyetësor. Po kështu mungesa e informacionit për të anketuarit shpjegonte se ata nuk e dinin se poezia lasgushiane bënte jetën e saj në gjuhë të tjera të huaja. Në këtë pyetje, të anketuarit kanë dhënë më shumë se një alternativë, ç'ka tregon se poezia e Lasgush Poradecit për ta shijohet jo vetëm në shqip. Janë 145 të anketuar ose 72%, të cilët e kanë ditur se në gjuhët e mësipërme Lasgushi e kishte krijuar lexuesin e tij me kohë. Një poet kombëtar rrit vlerën nacionale në botë kur përkthimet e poezive të tij shijohen nga shumë shtetas të huaj, posaçërisht në gjuhët e tyre respektive. Një fat të tillë mesa duket e ka edhe krijimtaria e Lasgushit, poetit që shpesh e më shpesh është thënë se mbetet ndër më të vështirët për t'u përkthyer prej të vetmit shkak, leksikut tipik lasgushian.

**Pyetja 18. Motivi mbizotërues i poezive te Lasgushit është ai ...? (**Patriotik**;** I natyrës ; Erotik ; I dashurisë;Tjetër; vendosni më shumë se një alternativë)

Tema dhe motivet në një vëllim poetik janë të rëndësishme për çdo grupmoshë lexuesish. Motivet e poezisë lasgushiane mbeten gjithmonë interesante për larminë që sjellin. Rreth 140 të anketuar ose 70%

thonë se motivet me të dashura në poezinë e Lasgush Poradecit janë ato të erosit dhe dashurisë, megjithatë, një pjesë tjetër mendojnë se motivet, ai patriotik dhe ai i natyrës, zënë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Poradecit. Kjo përllogaritje qëndron për të dya motivet, në numër dhe përqindje të barabartë (140 ose 70%). Motivi patriotik shënjohet nga 20 veta ose 10%, ndërsa motivi i natyrës përzgjidhej nga 30 veta ose 15% e tyre. Motivet e tjera janë përmbledhur në pikën e fundit të tabelës së kësaj pyetje në pyetësor. Rreth 20 persona ose 10% kishin shtuar motive të tjera si ai patriotik, filozofik por edhe atdhetar tek alternativa tjetër. Në krijimtarinë e Poradecit, të gjitha këto motive ndeshen në poezi të ndryshme dhe i bëjnë ato të veçanta dhe mbresëlënëse për lexuesit e veprës letrare të Lasgush Poradecit. Ndërkaq, kanë dhënë më shumë se një alternativë 160 të anketuar ose 80%, që kanë ditur më së miri motivet mbizotëruese të poezive të *"zogut të qiejve"*. Motivi erotik dhe motivi i dashurisë mbeten më të parapëlqyer nga lexuesit anketues. Në këtë alternativë, aspak emotivë, ata kanë bërë siç duket një parapëlqim dallues të vetë poezisë lasgushiane. Motivet për ta mbeten një lloj treguesi përfaqësues për kategori të ndryshme leximi.

**Pyetja 19. Cili nga autorët e mëposhtëm ka bërë studim mbi veprën letrare të Lasgushit ? (**Fan S. Noli **;** Mitrush Kuteli **;** Millosh Gjergj Nikolla **;** Ismail Kadare **;** Krist Maloki **;** Anastas Kapurani **;**vendosni më shumë se një alternativë**)**

Të anketuarit në këtë pyetje, kanë dhënë alternativa të mirëmenduara. Ata e kanë ditur saktësisht, se cilët autorë kanë bërë një studim mbi veprën letrare të Lasgush Poradecit. Të anketuarit, konkretisht 80 prej tyre ose 40%, kanë realizuar shënjimin e duhur, duke veçuar studimin e Mitrush Kutelit, si të vetmin studim më të mirë dhe më të rëndësishmin nëpër kohë, për poetikën e Lasgushit, lirikut të madh të letrave shqipe. Kjo përgjigje masive, vjen edhe si rezultat i faktit se ata janë njohur dhe mbase kanë punuar në orët mësimore me studimin kritik të Dhimitër Paskos. Jo vetëm botimi, por edhe promovimi dhe mbrojtja e shkëlqyer e veprës së Lasgush Poradecit është bërë plot gjykim dhe talent nga Kuteli. Duke dhënë më shumë se një alternativë, një numër i madh pohimesh janë bërë edhe për Ismail Kadarenë, i cili herë pas herë në shënime, prek jetën dhe veprën letrare të Lasgushit. Janë 115 anketues ose 57, 5%, të cilët e dinin që Kadare ka shkruar për jetën dhe veprën e Poradecit. Nuk ka mundur të marrë nga të anketuarit, asnjë përgjigje Migjeni. Sipas tyre Migjeni nuk ka bërë një studim letrar për Lasgushin. Fan Noli pozicionon rreth vetes 5 shënjues ose 2,5%. Në fakt kjo përzgjedhje rezulton e gabuar, sepse as Noli nuk ka një studim për poezinë e Lasgush Poradecit. Edhe pse (2,5%), ato mbeten pozicionim i gabuar për anketuesit. Krist Maloki dhe Anastas Kapurani janë shënjuar nga të anketuarit, me shenjën përkatëse si studiues të veprës letrare të Poradecit. Njëri e qorton artin krijues të Poradecit, tjetri e madhështon atë. 30 të anketuar ose 15% pozicionohen te emri i Krist Malokit dhe 45 veta ose 22,5% pozicionohen te emri i Anastas Kapuranit. Ky fakt rezulton i dijshëm prej tyre. Edhe në këtë pyetje 110 të anketuar saktësisht 55%, zotëronin informacion të saktë rreth studiuesve të veprës së Lasgushit. Ata kishin dhënë më shumë se një alternativë të mundshme për emrat e studiuesve që kishin shkruar për bardin shqiptar.

**Pyetja 20. Autorin, autorët që zgjodhët i keni:**(Lexuar? Dëgjuar? Përdorur? Cituar?)

Pyetja njëzet e pyetësorit duhet parë në lidhje me atë paraardhëse. Autorët, studiues të veprës së Lasgushit janë përdorur nga të anketuarit në orët akademike të mësimit, konkretisht të diskutimit të jetës dhe veprës së poetit. Kjo gjë ndodh edhe gjatë orëve të mësimit në sistemin parauniversitar shqiptar. Dhjetë prej tyre ose 5% i kanë lexuar këto studime, ndërsa 130 ose 65% të anketuar i kanë përdorur këto punime shkencore, në procesin mësimor. Kanë cituar studimin e veprës letrare të Lasgushit, studentë dhe jo vetëm, pra, 20 të anketuar ose 10%. Ky citim mund të jetë realizuar në shkollë, universitet, në projekte dhe detyra shtëpie, në radio dhe televizion, gazeta, revsita apo rrjete shoqërore. Duhet theksuar që 65% e të anketuarve kanë qenë në kontakt me studimet e ndryshme për veprën letrare të poetit. Sigurisht, leximi i pavaruar mbetet shije individuale, por ai i detyruar e bën përdorimin e studimeve të ndryshme mjaft efikas në rritjen e dijes individuale. Përdorimi i tyre mund të ketë qene i pjesshëm, jo i plotë, çka nxjerr në pah leximin tërësor. Por mund të ketë qenë edhe lexim i plotë, i detajuar gjë që mund ta ketë bërë përdorimin e tyre një sukses më vete, në realizimin e çdo njërit prej të anketuarëve. Prakticiteti i çdokujt në gjetjen e librit të duhur, si pjesë e literaturës së dhënë apo informacionit të kërkuar, e çon përdorimin e tyre në një domosdoshmëri për të gjithë.

**Pyetja 21. Për nder të Lasgush Poradecit shteti shqiptar ka vendosur apo ka ndërtuar:** (Një emër shkolle; Një emër rruge; Një emër qëndre kulturore; Një monument; Një shtëpi muze në Pogradec; Një shtëpi muze në Tiranë; Më shumë se një alternativë**)**

Lidhur me këtë pyetje, që në renditjen e gjithë pyetsorit mban numrin 21, të anketuarit, kanë dhënë përgjigje të alternuara, pra duke mos u përgjigjur vetëm për një alternativë. Pesëdhjetë të anketuar ose 25% e tyre mendojnë se për Lasgushin ka një emër shkolle në qytetin e Tiranës. Një tjetër shkollë që mban emrin e lirikut të shqipes L. Poradecit ndodhet në Pogradec. Ajo është shkolla jopublike Lasgush Poradeci (shkolla është edhe 9-vjeçare edhe e mesme).

Nuk ka pasur asnjë prononcim në alternativën nëse ka një emër rruge me emrin e lirikut të madh të letrave shqipe. Një rrugë e tillë nuk ekziston as në vendlindjen e tij në Pogradec, por realisht ka një emër rruge në kryeqytet. Ajo është rruga te diga pranë liqenit artificial të Tiranës, e cila mban emrin Lasgush Poradeci. Duke qenë se të anketuarit i përkasin një universiteti që ndodhet në qarkun e Korçës, me sa duket kanë informacion se Qendra Kulturore në Pogradec, mban emrin Lasgush Poradeci. Këtë e pohojnë 70 të anketuar, ose 35% e tyre. Emri i saj është vendosur në ceremoninë e mbajtur më 19 dhjetor, 1988. Atëherë nga zyrtarët e regjimit komunist u vendos që inaugurimi i emrit të institucionit kulturor të mbahej më 17 dhjetor 1988 (dy ditë më pas). Një monument i Lasgushit, vepër e skulptorit të popullit Mumtaz Dhrami ka jetësuar në pavdeksi veprën e Lasgushit në Pogradec. Njëqind e tetëdhjetë të anketuar ose 90% e tyre japin përgjigjen se për nder të tij është ndërtuar një monument në Pogradec, një monument i shumëpritur vite më parë, që u bë realitet falë këmbënguljes së kryebashkiakut të Pogradecit, Artan Shkëmbi. Në Pogradec në 27 dhjetor 2006 vendoset shtatorja e tij në breg të liqenit, në qendër të qytetit. Monumenti i Lasgush Poradecit është i lartë 3 m e 40 cm. Dyzet të anketuar ose 20%, e dinë që në Pogradec ekziston shtëpia muze e Lasgushit, falë altruizmit të pronarit të saj Koço Krëste, i cili e ringriti nga themelet dhe e mirëmban atë.

Ndërkaq 30 të anketuar ose 15% kanë votuar se në Tiranë ka një shtëpi muze të poetit. Përgjigja e kësaj pyetje është dhënë e gabuar, pasi shtëpia muze në Tiranë u prish nga vajzat e poetit, për të ndërtuar aty më pas një pallat banimi. Informacioni i 15% të anketuarve në këtë pyetje nuk është i saktë. Pranë pallatit ndodhet vetëm një pllakë përkujtimore që sqaron se aty ka qenë shtëpia në të cilën ka banuar Lasgush Poradeci. Kështu, rreth 186 anketues kanë dhënë më shumë se një përgjigje për alternativat e pyetjes 21 të këtij pyetësori. 93% e të anketuarve kanë pasur informacion të saktë për përjetësimin e emrit të Lasgush Poradecit nga shteti shqiptar. Në interpretimin e të dhënave të pyetjes 21 të pyetësorit mbetet fakt domethënës që, 93% e të anketuarve kanë pasur informacione për përjetësimin e lirikut. Panteoni letrar ka vend për talentet rrezatues nëpër kohëra, sikurse me meritë qëndron në të Lasgushi, tashmë poet jo vetëm i Pogradecit, por i gjithë Shqipërisë.

**Pyetja 22. Nëse takoni Lasgushin cilat ishin vargjet e poezisë së tij, që do t'i drejtoheshit për t'i shprehur nderimin si lexues? (Shkruani vargjet që mbani mend...)**

Në pikën e fundit të pyetësorit njëqind të anketuar, pra (50%) të anketuar nuk kanë shkruar asnjë varg të Lasgushit. Mesa duket ata nuk kanë ditur përmendësh vargje të tij ose më saktë nuk u janë kujtuar ato për momentin. Mund të thuhet se një pjesë e të anketuarve janë treguar të papërgjegjeshëm në pikën e fundit të pyetësorit, duke e anashkaluar të shkruarit e vargjeve përmendësh, duke mos shkruar asnjë varg të autorit të pavdekshëm të poezisë së dashurisë. Ndërsa, njëqind të tjerë, (50%) të anketuar kishin përzgjedhur strofën e poezisë romancë "Ku shtrohet vala...":

*...Se s'dashuronja-as un' as ti*
*Por dashuronte dashurija:*
*Një dashuri-një fshehtësi*
*M'e fshehur sesa fshehtësija*.

Duhet theksuar se kjo strofë e përzgjedhur në mënyrë masive nga të anketuarit, në njëqind herët e saj të shkruara në fletët e pyetësorit asnjëherë nuk ishte e shkruar saktësisht në trajtën që e ka botuar poeti. Njëjësi i poezisë, ishte bërë shumës, ndërsa ishin shtuar lidhëza, nyje, mbaresa dhe prapashtesa sipas dëshirës së të anketuarve. Madje vërehet se ata nuk dinin të përdornin as shenjat e pikësimit në poezi. Me përjashtim të disa syrresh që kanë përdorur apostrofin për të theksuar formën mohore të vargut, pjesa tjetër nuk dinin të përdornin fare apostrofin, sikundër në rastin e zëvendësimit të *ë-së* fundore; nuk dinin të saktësonin përdorimin e vizës ndarëse në një varg të vetëm apo në total brenda strofës së përmendur. Theksojmë që ky varg mbahet mend, mbase është përdorur më shpesh në shkollë apo gjatë orës së mësimit. Ndoshta e kanë të dëgjuar më së shumti në radio-televizion ose të deklamuar në shoqëri apo rrethe familjare. Mbase është lehtësia e vargut për ta mbajtur mend atë ose bukurtingëllimi i tij, që e bën gjithkënd, të madh e të vogël, të prangohet pas shprehësisë së tij.

Ky pyetësor ka sigurisht shkallën e caktuar të saktësisë ose të gabimit. Duhet theksuar se gabimi varet edhe nga çiltërsia e përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit. Nuk duhet harruar, s'e gjithçka varet me klimën që vendoset mes studiuesit dhe të anketuarve, sikurse edhe me vetë natyrën e pyetjeve që përmban pyetësori.

**Bibliografi e shfrytëzuar**

Daniel, W. W. (1991). *Biostatistics:* A foundation for analysis in the health sciences, 5 ed., New York: John Wiley and sons;
Pendavinji, Gjergj (2008). *Nga mbledhja tek analiza statistike e të dhënave*, Shtëpia botuese Plejad, Tiranë;
Daka, Palok (1998). *Fjalor pseudonimesh* (1743-1944), Botim i Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia botuese Shkenca, Tiranë.
Zeqo, Mikom (2003). *Lasgushi dhe engjëjt e pikturës*. Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë;
*Të ritë e viteve të mi* (2012). Koleksion i pikturave të Lasgush Poradecit. Shtëpia botuese albPAPER, Tiranë.

**Shtojcë.**

**Shembuj të modelit të përpunimit të të dhënave të pyetësorit sipas pyetjeve.**

**Pyetja 8**

| **Cila është vepra e parë poetike e Lasgush Poradecit ?** | Nr. i personave | % |
|---|---|---|
| Vallja e yjve | 140 | 70 |
| Ylli i zemrës | 55 | 27 |
| Nuk e di | 5 | 2.5 |




**Pyetja 19.**

| **Cili nga autorët e mëposhtëm ka bërë studim mbi veprën letrare të Lasgushit ? (vendosni më shumë se një alternativë)** | Nr. i personave | % |
|---|---|---|
| Fan S. Noli | 5 | 2.5 |
| Mitrush Kuteli | 80 | 40 |
| Millosh Gjergj Nikolla | 0 | 0 |
| Ismail Kadare | 115 | 57.5 |
| Krist Maloki | 30 | 15 |
| Anastas Kapurani | 45 | 22.5 |
| Më shumë se një alternativë | 110 | 55 |




**Pyetja 3**

| **Gjinia që i përkisni ?** | Nr. i personave | % |
|---|---|---|
| Femra lexuese | 120 | 60 |
| Meshkuj lexues | 80 | 40 |



# MESIANIZMI NË RRËFIMET E MITRUSH KUTELIT

**NELI NAÇO**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë**

**Përmbledhje**

Letërsia shqipe është një letërsi e cila vazhdimisht ka reflektuar në vetvete një lloj mesianizmi që është shfaqur në periudha të ndryshme historike. Sipas studiuesit Kristaq Jorgo "E gjithë letërsia shqiptare nga De Rada (Naimi, Fishta, Noli, Koliqi, Kuteli, Migjeni, etj.) te Kadare, Camaj, Trebeshina dhe deri më sot mund të konceptohet si një paradigmë për dekodifikimin e kësaj shenje (të fshehur) me emrin "Shqipëri"."

Ne jemi të interesuar për tipare që bien në sy kryesisht në veprën e Mitrush Kutelit si të tipit mesianik. Qëllimi i punimit  është që të kërkojë dhe hulumtojë këtë tipar të tijin në krijimtarinë e tij, nga buron dhe ç'lidhje gjenetike përfaqëson ky tipar. Kuteli dhe rrëfimi i tij është bartës i këtij tipari i cili është nën rrjedhën e Letërsisë së Rilindjes Kombëtare, por bart edhe tiparet e veta origjinale në rrëfime të ndryshme. E vërejtëm këtë tipar në rrëfime të ndryshme të Kutelit, në rrëfime përmbajtësisht të ndryshme, por që duket se kanë këtë element strukturor të përbashkët. Rrëfimet "Vjeshta e Xheladin Beut", "Xha Brahua i Shkumbanores", "Gjonomadhë dhe Gjatollinj", "Si u takua Ndoni me Zallorët", "Lumi i Madh" e të tjerë e kanë mesianizmin një element përbërës në strukturën e tyre.

Lidhur me këtë është parë tipari mesianik si një element strukturor i rrëfimit dhe i qenësisë së tij. Është analizuar kështu secili rrëfim me një metodë strukturore e cila zbulon praninë e elementit mesianik në rrëfim dhe organizimin e tij. Lidhja e këtij elementi strukturor është analizuar edhe në një plan më të gjerë antropologjik, pjesë e këtij plani më të gjerë është edhe ky punim. Është përdorur gjithashtu edhe metoda krahasimtare për të realizuar krahasimin e këtij fenomeni (ose përbërësve të tij) nga rrëfimi në rrëfim, ose për të krahasuar dukuri të ngjashme dhe të ndryshme me autorë të tjerë.

Në rrëfimin Kutelian ekziston mesianizmi në hipostaza të ndryshme nga ato të Rilindjes Kombëtare. Tipari mesianik më tepër është i shfaqur si një model autentik dhe individual sesa si një tipar kolektiv. Zbulesat e autorit janë rrjedhime të zbulesave antropologjike sipas dëshmive autoriale dhe kritike të prozës së Mitrush Kutelit dhe një përbërës i rëndësishëm i strukturës rrëfimtare. Vetë rrëfimi është rruga drejt kësaj zbulese nga ana e personazhit ose është zbulesa përfaqëson përfundimin e arritur prej personazhit, prej rrëfimtarit ose lexuesit.

Struktura narrative është e ndikuar drejtpërsëdrejti nga faktori i evoluimit mesianik dhe ky evoluim përfaqëson njëkohësisht edhe qëllimin antropologjik të rrëfimit. Qëllimi për të realizuar rrjedhshmërinë e rrëfimit është i markuar gjithmonë, prej një qëllimi të tillë. Letërsia e Kutelit nuk i ka humbur rrjedhimisht lidhjet e ngushta me letërsinë romantike dhe folklorike, por gjithashtu përpiqet të bëjë një evoluim modern të lirshmërisë orale të rrëfimit.

**Fjalët kyç:** *Mesianizmi, rrëfimi, antropologji, bota shqiptare.*

**Abstract**

Albanian Literature is the kind of literature which has continually reflected in itself a kind of messianism demonstrated in its different historical periods. According to the scholar Kristaq Jorgo "The whole Albanaian literature from De Rada (Naimi, Fishta, Noli, Koliqi, Kuteli, Migjeni, etj.) to Kadare, Camaj, Trebeshina and reaching as far as today, can be conceptualized as a paradigm to decode this sign (hidden) named "Albania"." (Jorgo Kristaq 2000, page 76).

We are interested in apparent features especially Mitrush Kuteli's work as of a messianic type. The goal of the study is to research and search this feature of his in his creation, its source, and what genetical relations this feature represents. Kuteli and his narration is the carrier of this feature, which flows in the stream of National Renaissance Literature, but it also carries its original features in different narrations. We noticed this feature in different narrations written by Kuteli, in narrations of different contents, but which seem to have this common structural element. The following narrations "Vjeshta e Xheladin Beut", "Xha Brahua i Shkumbanores", "Gjonomadhë dhe Gjatollinj", "Si u takua Ndoni me Zallorët", "Lumi i Madh" and other narrations have messianism a composing elemnt in their structure.

In relation to this, the messianic element has been treated as a structural element of narration and its being. Thus, each narration has been analyzed based on a structural method which reveals the presence of the messianic element in the narration and its organization.

The relation of this structural element has been analyzed in an even broader anthropological plan; this study is part of an even broader plan. Comparative Method has also been used to enable comparing this phenomenon (or its ingredients) from narration to narration, or to compare similar and different phenomena with other authors.

In Kuteli's narration there ewxists messianism in different hypostasis compared to those of the National Renaissance. The messianic feature has been apparent more as an authentic and individual model than a collective feature. The author's revelations derive from the anthropological revelations according to authorial and critical evidence of Mitrush Kuteli's prose and an essential ingredient of the narrating struture. Narration itself is the way towards this revelation on the part of the character or it is the revelation; it represents the the final conclusion come to by the character, the narrator or the reader.

The narrative structure is directly affected by the factor of messianic evolution and this evolution represents in mean time the anthropological goal of the narration. The goal to enable the fluency of the narration has always been marked by such a goal. Kuteli's Literature has not as a result lost the close ties with the romantic and folk literature, but it also tries to lead to a modern evolution of the oral freedom of narration.

**Keyw ords**: *Messianism, narration, anthropology, Albanian world*.

Mesianizmi në letërsinë shqiptare është një faktor i pranishëm dhe do të quanim edhe faktor i rëndësishëm në zhvillimet letrare sidomos që nga letërsia e Rilindjes Kombëtare dhe këtej. Por nuk duket të jetë një faktor shumë i rëndësishëm në lëvizjet reale të qenësishme që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen dhe mirëqenien e kombit. Lidhur me këtë çështje Kristaq Jorgo shprehet: "Nuk ekzistojnë ndoshta fjalë më të pabashkueshme në ligjërimin e

sotëm sesa "Shqipëri" dhe "mesianizëm"" (Jorgo,2000, p. 76). Por sidoqoftë nisur prej traditës letrare shqiptare ne mund të flasim për një dukuri të tillë. Pa dyshim në këtë traditë do të hynte edhe Mitrush Kuteli i cili mund të quhet një prej autorëve të rëndësishëm të letërsisë shqipe që krijon një lloj mesianizmi.

Le të shohim përkufizimin që ka dhënë Kristaq Jorgo për mesianizmin. Ai thotë: "*Do të kuptojmë me këtë term bindjen në aftësinë e parathënë të një entiteti për të katalizuar ndryshime pozitive përtej vetvetes*" (Jorgo, 2000, p. 76). Nëse bota reale e truallit shqiptar është e varfër me "ndryshime pozitive përtej vetvetes", bota shqiptare që është produkt i letërsisë artistike përkundrazi është e mbushur me raste të tilla. Një rast unikal dhe të patjetërsueshëm përfaqëson në këtë rast edhe Mitrush Kuteli.

Kuteli si qëndrim vetjak artikulon një lloj qëndrimi letrar dhe njëkohësisht me misionin mesianik të projektimit (ëndërronja), rindërtimit (punonja) dhe çlirimit dhe realizimit (lëftonja). Ja si shprehet Kuteli në Shpjegim i botimit të parë të shkruar më 29 Qershor 1938 në Bukuresht: "*Kjo librë lipsej të përmbante, si pas dëshirës s'aherëshme, dymbëdhjetë rrëfime dhe rrëfenja të cilat të pasqyrojnë pak a shumë vijat e para të jetës shqipëtare në vise e kohra të ndryshme.... Dyke shtypur këtë librë nuk po ndjek tjatër qëllim përveç se përmbushjen e një pjese të një dëshire djaloshare kur ëndërronja, punonja e lëftonja për vendin t'im..."* (Kuteli, 1944, p.157). Artikulimi i qëllimit mesianik është shprehur me foljet *ëndërronja, punonja* dhe *luftonja* që shprehin një qëndrim të plotë që fillon me projektimin dhe vazhdon me rindërtim, çlirim dhe realizim.

Idetë e Kutelit në këtë drejtim janë një riprojektim i ideve që gjallonin në kohën e Rilindjes Kombëtare dhe që ai i ka ripunuar duke u përngjitur atyre edhe formimin e tij artistik dhe kulturor që ishte kryer në vise të huaja, kryesisht në Rumani, dhe që i shkonte për shtat shkrimtarit tonë. Edhe në Rumani në ato vite kemi një prirje drejt një letërsie, autoktonizimit, drejtimit për kah kultura rurale dhe orale si dhe një shtyrje drejt modeleve etnocentrike të kulturës.

Rilindja Kombëtare artikulon fort idetë mesianike në një kohë kur shtroheshin ide dhe praktika të rëndësishme për kombin, ndërsa Mitrush Kuteli i artikulon ato në një kohë tjetër, jo më si praktika, por si ide që vetëgjenerohen nga trualli antropologjik.

Për ne Mitrush Kuteli nëpërmjet mikro-kozmosit lokal që ai e njeh më mirë ka farkëtuar gjithë botën shqiptare njëkohësisht si realitet dhe si mit, si pozitivitet dhe si negativitet, si harmoni dhe si dis-harmoni, si sipërfaqe dhe si thellësi, si vlerë dhe si antivlerë dhe të gjitha këto me synimin mesianik të përmirësimit të kësaj bote brenda karekterologjisë së saj. Janë shumë të holla problemet që trajton Kuteli në rrëfimet e tij si: *Më kot, Gjonomadhë dhe Gjatollinj*, *Si u takua Ndoni me Zallorët*, *Xha Brahua i Shkumbanores*, *Qetësi përpara fërtyme, Vjeshta e Xheladin Beut*, *Lumi i madh*. Ajo problematikë e jetës lokale është njëkohësisht problematikë e jetës kombëtare, ajo vlerë e jetës lokale është automatikisht vlerë e jetës kombëtare, veshja lokale gjuhësore është vetëm materia gjuhësore që shkrimtari zotëron më mirë për të krijuar veprën a artit por në veprën e Kutelit ne, fare natyrshëm, kalojmë nga një topografi materiale lokale në një topografi shpirtërore shqiptare me të gjitha detajet e saj.

**Mesianizmi si një ideologji letrare edhe për Kutelin**

Edhe Mitrush Kuteli ka si qëllim të realizojë një vepër letrare që përmban një ideologji të tillë. Mesianizmi i tij nuk është i

shprehur në mënyrë kombëtare, personazhe të fuqishme me ideologji të mëdha, por është shprehur nëpërmjet rrugës që njeh ai, pasqyrimin e etnisë në qelizën dhe bërthamën e vet, e cila është po aq shqiptare sa edhe idealet e mëdha që bëjnë kombin. Vëllimi i tij është titulluar "Netë shqipëtare" dhe synimi i tij i artikuluar është: "të pasqyrojë pak a shumë vijat e para të *jetës shqipëtare* në vise dhe kohra të ndryshme" (Kuteli , 1944, p.157). Mesianizmi na shfaqet i lidhur drejtpërsëdrejti me faktin nacional. *Jeta shqiptare* dhe *Netët shqiptare* janë qendra të një kuptimi të pastër ideologjik të autorit. Ideologjia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare nuk ka humbur në atë që shpeshherë është quajtur rrëfimi modern i Mitrush Kutelit. Ajo është transformuar duke ruajtur shqiptaren si një vlerë dhe shkrimi i Mitrush Kutelit ngelet me këtë ideologji.

Duke folur për romanin e Sterjo Spasses ai pohon: "Sepse njeriu shqiptar rron pa pyetur përse, vret tjatrin po jo veten, nuk ësht pesimist, nuk ësht misogjin (kaq pakë murgesha e murgë nxjerr ky popull...) e shumë të tjera" (Kuteli , 2007, p. 490). Duket sikur Mitrush Kuteli e pranon një mungesë mesianizmi me këtë frazë. Por rrëfimi i tij, le të kujtojmë prozat e tij më të rëndësishme, rrëfimet "Vjeshta e Xheladin Beut", "Xha Brahua i Shkumbanores", "Gjonomadhë dhe Gjatollinj", "Si u takua Ndoni me Zallorët", "Lumi i Madh" e të tjerë e kanë mesianizmin një element përbërës në strukturën e tyre. Ai thotë "kaq pakë murgesha e murgë nxjerr ky popull...", por a nuk realizon një rrëfim si "E madhe është gjëma e mëkatit" ku individi kapërcen karakterin (ilirian) e kryeneçësinë për të gjetur përkryerjen shpirtërore. Kemi të bëjmë me një kontradiktë autoriale, lajthim të autorit, apo një qëndrim të vetin ku arti rrëfimtar është në shërbim të idesë mesianike dhe e kthen këtë ide në pjesë të strukturës së vet. Shpjegimin e gjejmë pjesërisht në "mesianizmin pasiv, të të thënit, të verbum-it dhe jo të veprimit" (Jorgo, 2000, p.77), por pjesërisht edhe në faktin se tipari mesianik më tepër është i shfaqur si një model autentik antropologjik dhe individual sesa si një tipar kolektiv. Vijmë kështu në pyetjen: A mund ta quajmë mesianizmin individual në rrëfimin kutelian me një natyrë antropologjike?

**Karakteri mesianik i rrëfimit Kutelian ka një natyrë antropologjike**

Kuteli në rrëfimet e tij është i përkushtuar ndaj një gjetjeje letrare e cila në bazën e saj ka një zbulim antropologjik të dallueshëm. Ngjarja e vërtetë antropologjike (po e quajmë kështu sepse jo vetëm është burimisht e vërtetë, por parë në dritën e autorit shqiptar) ajo bart vlera interpretative antropologjike, sepse autori nuk është vetëm në rolin e vendasit, por edhe të antropologut që e sheh ngjarjen me sy të ftohtë dhe zbulon në të vlerat që ajo bart.

Kuteli i zbulon ngjarjet folklorike gati – gati si folklor dhe dëshmon për to në një mënyrë sa artistike aq dhe antropologjike, ai dëshmon njëkohësisht edhe për ngjarjen edhe për karakterin mesianik të saj. Le të shohim disa raste.

Në vëllimin "Shënime letrare" ai flet për veprën e vet "Ago Jakupi". Ja si shprehet konkretisht për rrëfimin *Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit*: "Sa për temën autori përdori tipe dhe ngjarje nga fshati i tij. Ngjarja me zaptimin e disa sërë kërcunjsh vreshte është ajo e Hajdarit të Upes që nuk dha shpirt përveç se pasi i ktheu tokën të birt të Silkës. Vdekje e qetë ajo e Ago Myrselit. Në pjesën që i takon ndërtimit të çezmave del fytyra e Paput – si i thesh bota xha Tirës" (Kuteli, 2007, p. 468).

Dhe më poshtë: *Fshati im e pi rakinë* u fillua të shkruhet në Dhjetor 1942.

Frazeologjija dhe episodet janë mbledhur në Pogradec, dyke u dhënë, kuptohet, me transfigurimin e artit" (Kuteli, 2007, p. 470).

Këto aspekte antropologjike me një dimension mesianik janë të vlefshme për Kutelin. Me to ai krijon figurat që bartin dimensionin mesianik dhe e transmetojnë atë. Ashtu si mund të themi në përgjithësi që rrëfimi kutelian ka një bazë folklorike dhe antropologjike, po ashtu mund të themi se rrëfimi kutelian ka në të njëjtën kohë edhe këtë dimension humanistik mesianik brenda vetes.

E ka vërejtur këtë edhe Lasgush Poradeci kur shprehet për botimin e "Netëve shqipëtare" duke dëshmuar së pari për natyrën antropologjike dhe origjinën e krijimit artistik: "*prej kësaj bote së mbrujtur në kalimin e vjetëve dhe të qindvjeteve Mitrush Kuteli merr subjektet e tija hijerënda. Dhe në qoftë se këto sillen rreth kujtimeve legjendare të humbura në mjegull siç është rrëfimi Përtej Valëve të Kohës ose mi një akt burrërije historike si Bendo Shapërdani, ose thjeshtërisht në ngjarjen e kufizuar të fshatit si Xha Brahua i Shkumbanicës, që të gjitha mbajnë me vetëçquarje shënjën e përbashkët që i karakterizon: iluzionin e mjeshtëruar të jetës shqiptare*" (Poradeci, 1999,p.31).Ka folur qartazi kështu për karakterologjinë antropologjike të rrëfimit. Por ai nuk harron që të përmendë edhe karakterin mesianik të rrëfimit më tepër si një formë katarsisi që vepra ushtron mbi lexuesin. Gjithë kjo antropologji shqiptare sjell sipas Lasgush Poradecit "gjithë manifestimet e jashtë kohëshme, ato, që në udhën e jetës bëjnë procesin e spastrimit dyke u ngritur prej dherit në lartësi..." (Poradeci ,1999, pp. 33 – 34).

Rrëfimet e Mitrush Kutelit i sjellin edhe njëherë ato ndryshime pozitive përtej vetvetes që i përmendëm më lart, por është shumë e dukshme që shpeshherë këto ndryshime pozitive janë produkt i një individi që bëhet burim i ndryshimeve përtej vetvetes dhe shumë më rrallë ato janë produkt i kolektivitetit. Kolektiviteti përfiton shpeshherë nga ky mesianizëm individual i vetjeve letraro – antropologjike.

**Mesianizmi si një element struktural i rrëfimit**

Nëse do të flisnim për rrëfimin kutelian ekzistojnë disa pikëpyetje të cilat duhet të kthehen në çështje të rëndësishme të vlerësimit të veprës së tij. Për shembull: "Si mundet të sigurojë një vepër e shkruar kryesisht në një nëndialekt të toskërishtes, një receptim shumë të gjerë në të gjithë hapësirën shqipfolëse?" ose "Si mundet që një vepër të jetë kaq e larmishme dhe kaq unike njëkohësisht, kur kemi të bëjmë me një "jetë shqiptare në vise dhe kohra të ndryshme?" (Kuteli, 1944, p.157). Këto "vise dhe kohëra të ndryshme" përfaqësojnë një larushí të madhe të rrëfimit dhe kjo larushí është e dukshme në rrëfim, sepse nuk ka një unitet të dukshëm të vendit dhe kohëve kur zhvillohet rrëfimi. Kemi arritur në përfundimin se rrëfimet e Kutelit dhe ky shqyrtim i botës që i bën ai nëpërmjet rrëfimit kanë një unitet strukturor, ku një nga elementët më të rëndësishëm në krijimin e kësaj ngrehine strukturore luan edhe mesianizmi si një qëllim antropologjik i rrëfimit ose i rrëfenjës.

Mesianizmin si element struktural të rrëfimit e kemi verifikuar të shfaqet në rrëfime dhe rrëfenja të ndryshme ku do të bënin pjesë: *Natë gushti: Përtej Valëve të Kohës*, *Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit*, *Natë qershori*, *Natë prilli*, *Natë vjeshte të tretë*, *Papu Tira*, *Rinë Katerinëza*, *I pasuri që ish i varfër fort*, *Natë muaji maj*, *Vjeshta e Xheladin Beut*, *Më kot*, *Natë muaji shëmbitër*, *Xha Brahua i shkumbanores*, *Gjonomadhë dhe Gjatollinj*, *Natë kollozheku*, *Natë marsi*, *Qetësi*

*përpara fërtyme*, *Si u takua Ndoni me zallorët*, *Lumi i madh*.

Edhe rrëfimet dhe rrëfenjat e tjera të Kutelit që i lamë jashtë kësaj renditjeje (kryesisht ato që kanë të bëjnë me kujtimet e botës së fëmijërisë) janë pjesë e një mesianizmi të fshehur, sepse rrahin të të çojnë drejt një bote ose reale – ideale, ku kthimi mental i njeriut përfaqëson vetvetiu një lloj purifikimi.

Rrëfimet e Kutelit në një pikëpamje strukturore janë gjetje dhe zbulesa antropologjike të mirëfillta që kanë zotëruar në mënyrë të njëmendët dimensionin antropologjik dhe ky dimension është kthyer në një dimension struktural të rrëfimit.

Më së shumti dhe qëllimisht Kuteli rreh të dalë në një përfundim mesianik si zbulesë e individit për vetveten (Ago Jakupi), si ndihmesë e autorit për të tjerët, si zbulesë e vonuar e individit (Xhezari).

Në këtë trajtesë të shkurtër një rrëfim nga më të hershmit e Mitrush Kutelit, ai mban si datë fillestare shkrimi vitin 1926, shërben për të na pajisur dhe ndërgjegjësuar me ndërtimin struktural të rrëfimit. Është rrëfimi *Natë Gushti* me nëntitull *Përtej valëve të kohës*.

Në të vërtetë përtej valëve të kohës është ajo çka përpiqet të realizojë Kuteli në përgjithësi me prozën e tij. Rrëfimet e tij bartin në fshehtësi mesazhin që këto rrëfime të shpien përtej valëve të kohës ose këto rrëfenja vijnë që përtej valëve të kohës.

Nëse do t'i shihnim nga pikëpamja e ndërtimit strukturor kemi një strukturë të hapur ose të dukshme të shpalosur prej Kutelit shumë qartë sepse kjo strukturë është ndërtuar si një unitet i tri pjesëve të rrëfimit dhe autori na e shpërfaq këtë në ndërtimin e rrëfimit me tri minirrëfime.

Le t'i shohim të tri minirrëfimet e *Natë gushti* në këtë plan struktural.

Pjesa e parë e rrëfimit shpalos idenë se miti ekziston, miti ka ekzistuar dhe do tentojë të ekzistojë në të ardhmen. "Edhe thonë se këtij Kol Branës i paskan humbur në luftat e asaj kohe, kur hyri turku në Shqipëri, të pesë djemtë dhe gjithë nipërija. Edhe si iu sosnë këta të gjithë edhe turqit iu afruan Katjelit, Kol Brana ngjiti shkallët e gurta të qytezës, mbylli dyerët edhe priti të afrohet rrebeshi. E atëhere kur erdhi armiku as këmba, as dora nuk iu drodh nga pleqërija. Shumë kohë gryka buçiti si buçet kur luftojnë trimat e ballit" (Kuteli ,1944, p. 8). Forma e rrëfimit "edhe thonë" tregon për të shkuarën dhe të tashmen e kësaj strukture mitike.

Pjesa e parë e rrëfimit mbyllet me idenë se miti i luftëtarit do të jetojë edhe më pas. Është e rëndësishme të flasim për mbijetesë pasi del në pah forma simbolike e gurit e cila përjashton mundësinë e zhdukjes. Minirrëfimi i parë përfundon në këtë mënyrë: "Që asaj kohe muret e kështjellës u gremisnë e mbretërija e dëllinjave mori vendin. Vetëm guri i Kol Branës, si i thonë edhe sot, ka mbetur i patundur prej valëve të kohës e prej valëve të turkut" (Kuteli, 1994, p.8).

Minirrëfimi i dytë tregon për gjendjen ekzistuese të vendit, e njëjta hapësirë, por e paraqitur në kohën e rrëfimtarit, e cila ka humbur domethënien e parë për banorët, por e ruan atë të paprekur nën koren e vet. Ky minirrëfim tregon për disa gjuetarë thesaresh që shkojnë të gërmojnë për të gjetur sende të vjetra dhe që zbulojnë këtë kore e cila nëpërmjet ëndrrës do të rizbulojë pavdekshmërinë e mitit në pjesën e tretë.

Minirrëfimi i tretë është një "realizim i fenomenit metafizik të rrojtjes së tanishme të ngjarjes historike" (Poradeci, 1999, p. 33) çka do të thotë se miti është rivitalizuar dhe është më i freskët se kurrë. Ai ka dalë prej kores dhe tregon se është pjesë e

rëndësishme e nënndërgjegjes së personazhit, ky i fundit e ka zbuluar dhe nuk ka mundësi që ta rihumbë atë.

Rishfaqja e mitit të humbur është një pjesë që na kthen në atë që nisëm, ndërgjegjja mesianike e personazhit të rrëfimit është tashmë e formuar dhe riformuar. E shkuara historike është diçka që nuk mund të zhbëhet. A nuk mund ta quanim ndryshe mesianizmin edhe si një lëvizje që kërkon të aktualizojë mitin në mënyrë përfundimtare?

**BIBLIOGRAFIA**


Jorgo, Kristaq (2000). *Identiteti i Qendrës së Panjohur: Rasti Shqipëria*, në Tempulli, Nr. 2, Korçë, faqe 75.

Kuteli ,Mitrush (1944). *Netë shqipëtare*, Tiranë.

Kuteli, Mitrush (2007.*) Shënime letrare*, Shtëpia Botuese GrandPrind, Tiranë.

Kuteli, Mitrush (1990*). Vepra letrare 1*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.

Kuteli, Mitrush (1990*). Vepra letrare 2*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.

Poradeci, Lasgush (1999). *Vepra letrare* 2, Onufri, Tiranë.

# HISTORI-GJEOGRAFI

# POLARIZIMI POLITIK DHE KRIZAT POLITIKE NË SHQIPËRI

**ADELINA NEXHIPI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Tranzicioni shqiptar drejt demokracisë ka qenë i dhunshëm, konfliktual dhe i tejzgjatur. Në vitet '90, kur shqiptarët "u ngritën në këmbë" për demokracinë, askush nuk mendonte se pas 24 vitesh Shqipëria do të vazhdonte të kishte probleme serioze.

Mungesa e kulturës demokratike, prapambetja ekonomike dhe polarizimi i skajshëm politik kanë ndikuar negativisht në transformimet demokratike në vend. Momentet më kritike të tranzicionit shqiptar kanë qenë: kriza financiaro - politike e vitit 1997; krizat politike të viteve 1998, 2004 dhe 2009-2011.

Në këtë punim, të tipit përshkrues-analitik, këto ngjarje do të trajtohen në një tjetër këndvështrim. Cilat janë shkaqet e këtyre krizave të thella e të përsëritura? Cili ka qenë roli dhe ndikimi i elitave politike shqiptare gjatë këtyre periudhave?

Nga studimi i bërë arrihet në përfundimin se: krizat politike në vend janë së pari pasojë e polarizimit të thellë politik dhe mungesës së vullnetit të forcave politike në vend për të bërë kompromis mes tyre.

**Fjalët kyçe:** *Shqipëria, tranzicion, kriza politike, polarizim politik.*

**Abstract**

The Albanian transition towards the democracy has been violent, conflictual and long. In the '90s when the Albanians "raised on feet" for the democracy, no one thought that after 24 years Albania would continue to have serious problems.

The lack of democratic culture, the economical delay and the severe political polarization have reacted negatively in the democratic transformations in the country. The most critical moments of the Albanian transition have been: the political-financial crisis of the 1997, the political crises of the years 1998, 2004 and 2009-2011.

In this descriptive - analytical study this events will be analysed with a different perspective. What are the causes of these deep and repeated political crises? What has been the role of Albanian political elite in these crises? To give the answers to these questions there are taken primary and secondary sources.

From the study it is concluded that the political crisis are at first a consequence of the deep political polarization in the country and the lack of political will to do compromise.

**Key words**: *Albania, transition, political crisis, political polarisation*

Tranzicioni shqiptar drejt demokracisë ka qenë i shumëfishtë; tranzicion politik nga parti shtet në pluralizëm partiak, pluralizëm ekonomik nga ekonomi e centralizuar në ekonomi të tregut, tranzicion shoqëror nga një shoqëri e mbyllur, e kontrolluar në një shoqëri të lirë. Tranzicioni drejt demokracisë ka qenë i gjatë, i dhunshëm, problematik. Arritjet kanë qenë të shoqëruara me probleme të shumta si, kriza të përsëritura parlamentare, paqëndrueshmëri politike,

polarizim politik, korrupsion, kriminalitet i lartë, papunësi, zhvillim i ngadaltë ekonomik. Raporte të përvitshme të institucioneve shqiptare dhe ndërkombëtare bëjnë analizë të treguesve të ndryshëm të zhvillimit politik, ekonomik, shoqëror të Shqipërisë; studime të shumta janë bërë nga studiues vendas e të huaj; shtypi viziv dhe i shkruar janë të mbushura me analiza të përditshme në lidhje me problematikat e tranzicionit shqiptar. Në këtë studim nuk do të bëjë thjesht një fotografi e krizave dhe problemeve të viteve të tranzicionit, por do të analizojë lidhjen që ekziston mes polarizimit politik dhe krizave politike në Shqipëri. Cila prej tyre është shkaku dhe cila pasoja; janë krizat që kanë polarizuar sistemin politik apo është polarizimi politik që shkakton krizat politike në Shqipëri? Për të kuptuar lidhjen shkak – pasojë mes polarizimit politik dhe krizave politike, janë analizuar krizat më të thella të këtyre 23 viteve tranzicion; kriza e vitit 1997, 1998, 2004, 2009 – 2011. Analiza është trajtuar duke vënë në qendër klasën politike shqiptare dhe sjelljen e saj. Nga analiza e bërë arrihet në përfundimin se krizat më të thella të tranzicionit shqiptar janë shkaktuar nga paaftësia e klasës politike shqiptare për të bërë lëshime dhe kompromise, e mungesës së kulturës demokratike, që kanë çuar në një polarizim të skajshëm të jetës politike në vend.

**Kriza shqiptare e 1997-ës**

Situata politike në vend ishte tensionuar që gjatë fushatës elektorale të vitit 1996. Demokratët në pushtet, dukej se nuk ishin të gatshëm të pranonin një humbje të mundshme, ndaj përdorën mjete dhe mënyra të ndryshme për të mbajtur pushtetin. Gjatë fushatës elektorale u vunë re parregullsi të shumta, përdorim i dhunës fizike dhe verbale kundër drejtuesve, anëtarëve dhe simpatizantëve të partive opozitare. Opozita shpesh u pengua të zhvillojë fushatë të lirë, qenë të shpeshta rastet e mosdhënies së lejeve për të zhvilluar mitingje apo takime elektorale. Raporti i OSBE-së jep shembuj të pengimit të organizimit të mitingjeve nga PS-ja në qytetet e Vlorës, Shkodrës, Rrëshenit, prani të madhe të forcave të rendit, që frikësonin pjesëmarrësit në mitingjet e PS-së. Në Tiranë PS-së nuk i ishte dhënë leje për të organizuar miting në sheshin Skenderbe me justifikimin se PS-ja nuk kishte mjaftueshëm përkrahës sa për të justifikuar mbylljen e sheshit qendror të kryeqytetit.(OSBE/ODIHR, Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare te vitit 1991, 1996, pp. 7-8)

Edhe dita e zgjedhjeve u karakterizua nga një klimë me tension të lartë.

*Sapo hyra në qendrën e votimit, pashë se ishin dhe dy vëzhgues të Institutit Demokratik Amerikan dhe të Shoqatës për Kulturë Demokratike...Një anëtar i bëshëm i komisionit, që dukej së më njhte, u gëzua që unë po flisja me ta dhe me pyeti se kush ishin ata vëzhguesit.*

*Janë të Institutit Demokratik të SHBA-së, - i thashë.*

*Ama, demokratë qenkan, se na ngrinë gjakun, ngaqë s'po merrnim vesh! – tha. – Hajt, të rrojë Sali Berisha! – shtoi dhe duke ngritur dy gishta, futi një tufë me fletë votimi në kuti.* (Baze, 2010, p. 13)

Ngjarje si kjo, sa qesharake dhe të dhimbshme, përderisa ndodhnin në praninë e vëzhguesve ndërkombëtarë, nuk është e vështirë të besosh se ndodhnin në çdo qendër votimi. E këtë e konfirmon dhe raporti i OSCE-ODIHR, që raporton një numër të madh parregullsish, shkeljesh të Ligjit Elektoral dhe manipulim të votës. "*Përshtypja e përgjithshme e pjesës më të madhe të vëzhguesve ishte se procesi i numërimit nuk u zhvillua në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, apo në përputhje me*

*Ligjin Elektoral. Në disa instanca vëzhguesit vunë re manipulim të rezultateve"*-shkruhej në raportin e OSBE-së.(OSBE/ODIHR, Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare te vitit 1991, 1996, p. 12) Kështu në raport përmendet shembulli, i një qendre votimi në Berat ku pjesëmarrja në votim ishte 105%. Një shembull tjetër vjen nga qyteti i Fierit, për zgjedhjet e të njëjtit vit, ku në një qendër votimi u raportua pjesëmarrje 100% në votime, ndërkohë që vëzhguesit dëshmonin se kur votimi u mbyll, jashtë qendrës së votimit kishte njerëz që prisnin të votonin. *"Konkluzioni i misionit vëzhgues ishte se në shumë instanca dështoi zbatimi i Ligjit Elektoral. Në mënyrë më specifike, në periudhën parazgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve u shkelën 32 nene nga 79 nenet e Ligjit"*.(OSBE/ODIHR, Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare te vitit 1991, 1996, p. 12) Zgjedhjet morën një vlerësim negativ nga edhe nga institucione të tjera ndërkombëtare, sidomos nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Megjithëse vërejtën që parregullsitë ishin të shumta, institucionet evropiane i cilësuan zgjedhjet të pranueshme dhe e njohën rezultatin e zgjedhjeve, që ishte një fitore e thellë për PD-në. Sipas analizës që Miranda Vicker bën në librin e saj "Çështja shqiptare, riformimi i Ballkanit", bashkësia ndërkombëtare, pas zgjidhjes së çështjes së Bosnjës me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit, shpresonte që Ballkani të binte në qetësi. Tek ata ekzistonte bindja se problemet në Ballkan mund të zgjidheshin në mënyrë paqësore nëpërmjet "presidentëve të fortë" dhe Sali Berisha konsiderohej si i tillë. Për këtë arsye ndërkombëtarët e kishin mbështetur pa kushte Berishën (Vickers M, 2007, p. 4).

PS-ja që ditën e zgjedhjeve, akuzoi PD-në se po vidhte votat, po denigronte procesin zgjedhor dhe po pengonte shprehjen e lirë të vullnetit popullor. Për këto arsye ajo bojkotoi procesin zgjedhor duke u bërë thirrje komisionerëve të saj të largoheshin nga komisionet zgjedhore ende pa vajtur orari zyrtar i mbylljes së qendrave të votimit. Pas ditës së zgjedhjeve tensioni dhe konflikti politik u ashpërsua dhe më tepër. Me 28 maj partitë opozitare organizuan një miting proteste, që u shpërnda me dhunë nga forcat e rendit, me justifikimin se mitingu ishte i paligjshëm. Pas kësaj, më 31 maj grupi parlamentar socialist hyri në grevë urie në godinën e Partisë Socialiste, "*një veprim ekstrem, por njëkohësisht dhe një gjest i fortë për të kërkuar vëmendje*" (Baze, 2010, p. 59). PS-ja dhe aleatët e saj i quajtën zgjedhjet të manipuluara dhe nuk e njohën rezultatin e tyre, duke bojkotuar punimet e kuvendit.

Gjatë pjesës tjetër të vitit 1996, situata politike vazhdoi të rëndohej. Dialogu politik mes mazhorancës dhe opozitës dukej i pamundur, autoritarizmi shtetëror bëhej përditë dhe më i egër, dhuna e ushtruar nga forcat e SHIK-ut, në emër të luftës kundër krimit të organizuar kishte rritur frikën dhe ankthin në rradhët e popullsisë. Edhe gjendja ekonomike vinte duke u rënduar. Veç kësaj prej disa vitesh në Shqipëri zhvillonin veprimtarinë e tyre një numër i madh firmash piramidale. Ato kishin gjetur përhapje të gjerë në gjithë vendin dhe ofronin interesa marramendëse për depozitat, interesa që shkonin 30 deri në 50%. Shqiptarët të varfër, me paga të ulta, me një papunësi të lartë, pa burime të ardhurash dhe të painformuar për zhvillimin e institucioneve financiare private, u joshën nga interesat e larta të fitimit dhe nga pasurimi i shpejtë. Besimi i popullsisë ushqehej dhe nga sloganet dhe reklamat e shumta të këtyre firmave piramidale në shtypin e shkruar dhe audioviziv të kohës. Veç kësaj as institucionet shtetërore nuk u distancuan

nga këto firma, madje as opozita nuk mbajti qëndrim kundër tyre edhe pse ato mund t'i përdorte për të goditur qeverinë.

SHBA-ja dhe FMN-ja i bënë thirrje qeverisë, në vjeshtë të atij viti, të ndalonte veprimtarinë e firmave piramidale dhe të vinte nën kontroll depozitat e tyre, duke e paralajmëruar për atë që mund të ndodhte. Qeveria nuk reagoi menjëhere, ndoshta se Berisha nuk donte të krijonte probleme dhe pakënaqësi para zgjedhjeve lokale të tetorit të atij viti. Kur qeveria vendosi të reagojë, ishte shume vonë. "Sudja", një nga firmat piramidale, që në nëntor kishte ndërprerë dhënien e kësteve për depozituesit dhe në janar deklaroi se kishte falimentuar, pranoi se ishte firmë piramidale. Fatin e saj patën dhe firmat e tjera, që falimentuan njëra pas tjetrës. Drejtuesit e firmave piramidale, së pari të "Popullit" dhe "Xhaferrit" u burgosën me akuzën e mashtrimit. Qeveria vuri nën kontroll depozitat e tyre dhe deklaroi se do të bënte shpërndarjen e tyre depozituesve.

Ndërkohë në vend, që në janar, kishin shpërthyer revolta popullore që fajësonin qeverinë për humbjen e parave të tyre. Së pari ajo filloi në Lushnjë, Berat, Vlorë e më pas në gjithë Shqipërinë e Jugut, që kishte humbur shuma të mëdha në firmat piramidale. Nuk ka ndonjë shifër zyrtare në lidhje me sasinë e parave të humbura në firmat piramidale, por mendohet që shuma të ketë arritur deri në 2 miliardë dollarë (Vickers, 2007, p. 7). Revoltat u bënë të dhunshme dhe dhuna filloi të marrë përmasa të frikshme. Shqipëria e jugut doli jashtë kontrollit shtetëror. Shteti filloi "të shkërmoqej" brenda pak ditëve. Populli i revoltuar i vuri zjarrin godinave të institucioneve shtetërore, bllokoi rrugët nacionale, hapi depot e rezervave ushqimore, u hapën burgjet dhe depot e armatimeve. Me hapjen e burgjeve elementë kriminalë e të rrezikshëm lëviznin lirisht nëpër Shqipëri dhe për më tepër të armatosur. Krimi mori përmasa të frikshme, dhuna u bë e pakontrolluar, frika për jetën u kthye në mankthin më të madh për qytetarët e thjeshtë, aktiviteti ekonomik u paralizua. Numri i vrasjeve rritej dita ditës, Miranda Vicker flet për më shumë se 1700 të vrarë gjatë revoltave të vitit 1997(Vickers, 2007, p. 129), kurse burime zyrtare për një numër të saktë të vrarësh nuk pati. Kaosi dhe anarkia mbizotëronin në gjithë vendin.

Në Shqipërinë e Jugut u krijuan "Komitete të Shpëtimit", me përfaqësues nga qytetarë dhe shpesh dhe të grupeve "të të fortëve" (grupe që zhvillonin veprimtari antiligjore dhe kriminale edhe para shpërthimit të revoltave popullore), me qëllim kontrollin e situates në mungesë të institucioneve lokale të qeverisjes. Kryengitja popullore nuk pati ndonjë filozofi të vetën, as strategji veprimi, por qëllimi i vetëm ishte largimi i Berishës nga pushteti.

Nga ana tjetër, në Tiranë mbizotëronte një gjendje apatie. Popullariteti i qeverisë kishte rënë. Institucionet qeverisëse ndiheshin të pazotë për të ndërmarrë veprime që mund  të qetësonin zemërimin popullor. Në momentet e para të protestës u përdorën forcat e SHIK-ut për të mbrojtur rendin dhe sigurinë.

Opozita u përpoq ta shfrytëzojë zemërimin popullor për qëllimet e saj politike. Edhe shtypi opozitar ishte i mbushur me tituj bombastikë që legjitimonin zemërimin popullor dhe nxitnin lëvizjet antiberisha. Shumë përfaqësues të partive opozitare morën pjesë në protestat qytetare në Jug të vendit. Qeveria e  akuzoi opozitën si nxitëse të dhunës dhe bashkëpunëtore në aktet kriminale të protestuesve. Në 30 janar, partitë opozitare së bashku me shoqatën e ish të burgosurve politike formuan Forumin për Demokraci, një aleancë antiqeveritare që u përpoq të

kanalizonte lëvizjen në rrugë institucionale. Por në fakt tani u krijuan tri pole; qeveria, që kërkonte të mbante pushtetin me çdo kusht, opozita që donte të merrte pushtetin me çdo kusht dhe turma popullore, që donte të shfrynte zemërimin e saj dhe që nuk donte t'ia dinte se ç'ndodhte me elitën politike të Tiranës.

Presidenti Berisha dhe qeveria vendosën në plan të parë ruajtjen e rendit dhe kur kjo u bë e pamundur, kryeministri Aleksandër Meksi, kërkoi në parlament shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Në fjalën e tij në kuvend, kryeministri u shpreh se në kushtet që ndodhej vendi, kur shteti nuk mund ta kontrollonte situatën me mjete paqësore, kjo ishte e vetmja mënyrë për të garantuar jetët e qytetarëve dhe veprimtarinë e tyre ekonomike dhe shoqërore. Me 2 mars u shpall gjendja e jashtëzakonshme. Ligji për gjendjen e jashtëzakoshme u kritikua nga faktori ndërkombëtar. Nga ana tjetër ligji i jepte qeverisë të drejtën të qeveriste me dekrete dhe të përdorte ushtrinë ndaj kundërshtarëve të saj. Kjo bëri që të ndihen të kërcënuar dhe figura aktive të opozitës që i trembeshin veprimeve që mund të merreshin kundër tyre. Pas kësaj bashkëpunimi mes turmës popullore dhe opozitës politike u intensifikua.

Më 3 mars, në këtë gjendje pështjellimi politik dhe shoqëror, Berisha rikonfirmohet president nga Kuvendi. Kjo shtoi dhe më shumë zemërimin popullor, që kërkonte largimin e Berishës nga pushteti. Forcat opozitare i kërkuan presidentit arritjen e një marrëveshjeje politike. Më 6 mars u mbajt një takim mes presidentit dhe përfaqësuesve të Forumit për Demokraci, por takimi dështoi.

Pak ditë më pas, vetëm me ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare u arrit të nënshkruhej një marrëveshje. Faktori ndërkombëtar filloi të shqetësohej gjithmonë e më shumë për ngjarjet në Shqipëri dhe për rrjedhën që ato po merrnin. Institucionet ndërkombëtare i bënë thirrje klasës politike shqiptare për maturi dhe për bashkëpunim, për gjetjen e një zgjidhjeje në të mirë të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, Marisa Lino, në një deklaratë të saj në RTSH i drejtohej shqiptarëve me fjalët: "*Demokracia nuk ndërtohet me dhunë*"(Times, 1997). OSBE vendosi të dërgojë në Tiranë përfaqësuesin e saj, Franc Vranickin (Franz Vranitzky), për të ndërmjetësuar bisedimet mes forcave politike në vend. Me ndërmjetësinë e tij, forcat politike shqiptare arritën të nënshkruanin një marrëveshje më 9 mars. Në bazë të marrëveshjes së arritur, qeveria Meksi do të jepte dorëheqjen dhe do të krijohej një qeveri koalicioni me një spektër të gjerë politik, që do të qeveriste vendin deri në formimin e qeverisë së re, që do të dilte nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare, që u vendos të mbaheshin më 29 qershor të atij viti.

Për të kryesuar Qeverinë e Pajtimit Kombëtar, u zgjodh Bashkim Fino. Detyra kryesore e qeverisë ishte vendosja e rendit dhe qetësisë dhe mbajtja e zgjedhjeve. Në kushtet që ndodhej Shqipëria, këto dy detyra dukeshin "mision i pamundur". Në librin e tij Humnerë '97, kryeministri Fino shkruan për ditët e para të marrjes së detyrës: "*Mediator mes ëngjëllit dhe djallit, kjo është ndjesia që kam tani kur sjell në mendje ato kohë. Të gjithë kërkonin të afirmonin idetë e tyre, identifikonin pozicionet e tyre personale dhe politike, kërkonin më të mirën ndonjëherë në mënyrë shumë egoiste".*(Fino, 2007, p. 35)

Megjithëse situata vazhdoi të mbetej e nderë dhe kaotike, pas formimit të qeverisë filluan të vihen re disa përmirësime. Komitetet e Shpëtimit filluan të njohin autoritetin e qeverisë, filloi një fushatë për të hyrë në bisedime me popullsinë. Shqipëria kërkoi ndihmë nga

bashkësia ndërkombëtare, *"për të mbrojtur të tjerët nga vetvetja"* (Buxhovi, 2009, p. 391). Në Shqipëri mbërriti Operacioni Alba, i drejtuar nga italianët, që do të ndihmonte në vendosjen e rendit dhe do të shpërndante ndihma humanitare për popullsinë.

Organizimi i zgjedhjeve të parakohshme u pa si një mundësi për ta nxjerrë vendin nga kriza, por të gjithë ishin të vetëdijshëm se mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, në një kohë kur popullsia ishte e armatosur, do të ishte e vështirë. Fushata elektorale u zhvillua në një frymë armiqësore. Të dyja palët akuzonin njëra-tjetrën për krizën ku ndodhej vendi. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe pjesëmarrja në to ishte e lartë duke marrë parasysh situatën. Megjithatë tensioni ishte i lartë dhe incidentet qenë të shumta. Pavarësisht problematikave që u vunë re, OSCE-ODIHR, i vlerësoi zgjedhjet si të pranueshme, për kushtet në të cilat ndodhej vendi. Rezultati i zgjedhjeve ishte një goditje e rëndë për Partinë Demokratike, që pësoi humbjen e saj më të madhe. Socialistët erdhën në pushtet dhe krijuan një qeveri të kryesuar nga Fatos Nano. Qeveria duhej të restauronte shtetin, të rikthente besimin në popull, të vendoste rendin dhe qetësinë, të çarmatoste popullsinë.

Ngjarjeve të '97 analistë, studiues apo aktorë të tyre politikë, i kanë vënë emra të ndryshëm si; "*humnerë '97"*,(Fino, 2007) "*pranverë e armatosur"*, (Vickers,2007, p. xxiv) *"dështim i demokracisë*", (Biberaj, , 2011, p. 423), por pavarësisht nga epitetet që i janë vënë, një gjë është e sigurt; anarkia e vitit 1997 në Shqipëri erdhi si rrjedhojë e paaftësisë apo mungesës së vullnetit të klasës politike shqiptare për të bashkëpunuar dhe për t'i zgjidhur problemet në rrugë ligjore dhe parlamentare.

Rënia e firmave piramidale ishte vetëm një katalizator për ngjarjet që do të ndodhnin më pas në vend, sepse shkaku i vërtetë i këtyre ngjarjeve ishte pakënaqësia e popullore ndaj korrupsionit, autoritarizmit, luftës jo të ndershme për pushtet të partive politike. Ngjarjet e vitit 1997 i dhanë popullit mundësinë të shfrynte zemërimin e akumuluar nga politika në këto vite të tranzicionit. Mero Baze shprehet se "*skemat piramidale nuk ishin arsye, por pasojë*" (Baze, 2010, p. 353). Sipas tij viti '97 ishte krizë e demokracisë shqiptare. Miranda Vickers shkruan: "*përkeqësimi i krizës ishte pjesë e krizës së përgjithshme të elitës politike në Shqipëri*"(Vickers M, 2007, p. 23).

Elez Biberaj përshkruan: *"Ndërkohë që retorika lëkundej nga deklarata të ashpra arrogance tek shprehjet e dëshirës për kompromis, socialistët dhe demokratët nuk tregonin vullnet për të marrë përsipër së bashku përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve të vendit*"(Biberaj, 2011, p. 470), ndërsa Valentina Duka për këtë periudhë shkruan: "*partitë politike shqiptare tregonin se nuk kishin kuptuar asgjë nga kriza e madhe në të cilën kishte rënë dhe po kalonte vendi. Ato vazhdonin të mos hiqnin dorë nga interesat e tyre të ngushta dhe mënyra ballkanike e politikëbërjes, duke mos bashkëpunuar, madje duke penguar punën e njëra-tjetrës*"(Duka, 2007, p. 359).

Pra klasa politike shqiptare, e zgjedhur nga populli për ta qeverisur, në vitin 1997 i la shqiptarët të vetëvriten. Kjo klasë politike tregoi se ideologjia e saj e vetme është marrja dhe mbajtja e pushtetit, me çdo kusht. Kjo dëshirë e pakontrolluar e klasës politike shqiptare pati pasoja të rënda për Shqipërinë dhe shqiptarët.

**Protestat antiqeveritare te vitit 1998**

"*Pas ngjarjeve të 1997-ës PS-ja dhe PD-ja ushqenin një armiqësi dhe më të*

*fortë ndaj njëra tjetrës. Si rrjedhim, nuk u arrit të konkretizohej asnjë lloj bashkëpunimi, i cili ishte aq i nevojshëm."*(Duka, 2007, p. 362)

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 29 qeshorit 1997 i siguruan një fitore të thellë PS-së, 101 deputetë në parlament. Që në ditët e para të veprimtarisë së parlamentit të ri u duk qartë se mosmarrëveshjet dhe grindjet politike do të ishin tipar i tij i vazhdueshëm.

Konfiktet filluan që në 19 gusht me ndryshimet në Komisionin e Verifikimit të Figurës së Zyrtarit dhe më pas ndryshimet në Ligjin Antigenocid.

Më 20 gusht Pjetër Arbnori, deputet i PD-së hyri në grevë urie në një zyrë të Kryesisë së Kuvendit duke kërkuar ndryshime në Ligjin për Radiotelevizionin. Ai kërkonte përcaktimin me ligj të minutazhit të opozitës në televizionin shtetëror.

Më 18 shtator u plagos me armë zjarri, në mjediset e Kuvendit Popullor, Azem Hajdari, deputet dhe njëkohësisht zëvendëskryetar i Partisë Demokratike, nga deputeti socialist, Gafur Mazreku.

Pas plagosjes së Azem Hajdarit, PD-ja organizoi mitingje në Tiranë dhe në disa qytete, ku kërkonte rrëzimin e qeverisë Nano. Pjesëmarrja në mitingje nuk ishte ajo që prisnin organizatorët. Me 22 shtator PD-ja braktisi pa afat atë që e quajti "kuvendi i krimit".

Nga fundi i muajit tetor, u krijua Komisioni Parlamentar për Hetimin e Ngjarjeve të Periudhës Janar-Qershor 1997, nën drejtimin e Spartak Brahos i PS-së dhe Spartak Ngjelës i Partisë së Legalitetit,(parti opozitare). Tensionet dhe konfliktet mes palëve u vunë re dhe në këtë komision. Në fund të hetimeve, secila palë doli me raporte të ndryshme, duke mos arritur të dilnin në një përfundim të përbashkët.

Më 22 gusht 1998 u arrestuan ish-ministri i Mbrojtjes Safet Zhulali dhe 5 ish-zyrtarë të lartë të qeverisë së mëparshme me akuzën "krime kundër njerëzimit" para dhe pas rebelimit të 1997-ës. Pas arrestimit të ish-zyrtarëve të saj, PD-ja bojkotoi sërish parlamentin dhe filloi protestat në rrugë kundër qeverisë, duke e cilësuar kryeministrin Nano "kryekriminel". Protesta në kryeqytet u shoqërua dhe me veprime të dhunshme në disa qytete të tjera të vendit. Duke i konsideruar arrestimet si politike dhe duke e cilësuar politikën e Nanos si hapat e parë të rivendosjes së diktaturës në vend, PD-ja i përshkallëzoi protestat.

Ajo që i dha goditjen përfundimtare çdo shprese për bashkëpunim mes pozitës dhe opozitës, dhe që bëri që situata të dalë jashtë kontrollit, ishte vrasja e Azem Hajdarit, mbrëmjen e 12 shtatorit 1998, nga persona të paidentifikuar ndërsa dilte nga selia e Partisë Demokratike. Lajmi i vrasjes së tij krijoi tension dhe frikë. Azem Hajdari ishte një nga studentët e lëvizjes së dhjetorit të vitit 1990, një nga themeluesit e Partisë Demokratike, figurë aktive dhe veprimtar i shquar i saj në këto vite tranzicioni. Por nga ana tjetër ai ishte dhe një person gjaknxehtë, shpesh i përfshirë në konflikte dhe veprime të dhunshme. Vdekja e tij krijoi sa dhimbje edhe frikë për atë që mund të ndodhte pas kësaj. Menjëherë pas përhapjes së lajmit, turma simpatizantësh u mblodhën në selinë e PD-së. Të nesërmen në mëngjes, Sali Berisha fajësoi qeverinë për vrasjen e Hajdarit dhe kërkoi dorëheqjen e saj të menjëhershme. Pas kësaj turma u nis drejt selisë së kryeministrisë me thirrje kundër Nanos, duke qëlluar në ajër me armë, duke i vënë flakën disa makinave, u shkëmbyen të shtëna me rojet e kryeministrisë dhe iu vu zjarrin katit të parë të godinës. Nga kjo rrëmujë gjeti vdekjen një protestues, dhe u plagos komandanti i Gardës. Në rrëmujë e

sipër, protestuesit u shpërndanë duke lënë pas zjarr e tym. Atë mbrëmje partitë e opozitës i dërguan një deklaratë të përbashkët presidentit të vendit ku kërkonin dorëheqjen e qeverisë Nano, thirrjen e një tryeze të partive politike, gjetjen e fajtorëve për vrasjen e A. Hajdarit dhe vënien e tyre para drejtësisë (Zogaj, 2009, p. 457) .

Të nesërmen, më 14 shtator, dita e varrimit të A. Hajdarit u shndërrua në një protestë edhe më të dhunshme me pjesëmarrje dhe më të gjerë. Kortezhi që mbante arkivolin e të ndjerit u nis nga sheshi Skënderbej, ku Berisha mbajti një fjalim plot dhimbje për humbjen që kish pësuar familja, Partia Demokratike, demokracia shqiptare dhe Shqipëria me vrasjen e Azemit. Fjalimi ishte i mbushur plot akuza dhe mllef për qeverinë dhe kryeministrin. Kortezhi me arkivolin e Hajdarit eci gjatë bulevardit "Dëshmorët e Kombit", drejt Kryeministrisë. Preç Zogaj, në atë kohë këshilltar i presidentit, në librin e tij "Intuicionet e tranzicionit 1" shkruan: "*Mes asaj turme të pafund, që përkundte një det pikëllimi, kishte individë dhe grupe të armatosura, disa prej të cilëve mbështetnin lidershipin e PD-së. Disa të tjerë ishin hajna të rëndomtë nga ata që kërkojnë rrëmujë për të plaçkitur dhe nuk përjashtohej mundësia e infiltrimit të agjenturave anti-shqiptare"*(Zogaj, 2009, p. 458). Turma e armatosur filloi të godasë me breshëri drejt godinës së kryeministrisë duke përdorur edhe granada, kurse gardistët shtinin në ajër për të trembur turmën. Beteja për marrjen e kryemistrisë vazhdonte, ndërkohë kryeministri nuk dihej se ku ndodhej. Arkivoli me trupin e të ndjerit Azem Hajdari u përdor për të goditur dyert e jashtme të godinës.

Ministria e Punëve të Brendshme nxorri në rrugë tanket për të kontrolluar turmën e papërmbajtur, por shumë shpejt dy prej tankeve ranë në duart e protestuesve. Një pjesë e protestuesve filluan të shkatërrojnë dhe të plaçkisin institucionet e braktisura, dyqanet dhe i vunë zjarrin disa prej tyre, kurse të tjerë hynë në godinën e Radiotelevizionit shtetëror duke vënë kontrollin mbi këtë institucion. Me pamje dhe me zë ata deklaruan në lidhje direkte nga televizioni, se kishin marrë pushtetin. Kjo e rëndoi situatën dhe e shtoi ankthin në popullsinë e thjeshtë, pasi u kuptua se qeveria e kishte humbur kontrollin e kryeqytetit. Shqiptarët që ende i kishin të hapura plagët e '97-ës, ndiheshin të përhumbur dhe të frikësuar nga përsëritja e kaosit të një viti më parë.

Pasdite vonë televizioni u lirua dhe rrugët filluan të boshatisen nga protestuesit, ndërsa nëpër rrugë qarkullonin makinat e policisë dhe të reparteve "Shqiponja". Në mbrëmje, presidenti bëri një deklaratë ku bënte thirrje për qetësi dhe vetëpërmbajtje si dhe kërkoi gjetjen e vrasësve të Azem Hajdarit.

Miranda Vicker, në librin e saj, ia atribuon vendosjen e qetësisë ndërhyrjes së ambasadorit të OSBE-së në Shqipëri, Everts, i cili organizoi një takim me krerët më të lartë të politikës dhe në formë të prerë i kërkoi përfaqësuesve të PD-së të sprapsnin protestuesit nga godina dhe të ndalnin konfrontimin e armatosur (Vickers M, 2007, p. 260).

Në ditët në vazhdim qeveria dukej se kishte vendosur disi kontrollin në kryeqytet. Ajo i konsideroi ngjarjet e 14 shtatorit si grusht shteti dhe Berisha u akuzua si organizatori i tij. Berisha dhe partia e tij nga ana tjetër justifikonin dhunën popullore me pretendimin se ata i ishin përgjigjur të shtënave që erdhën nga kryeministria dhe vazhdonin të ngulnin këmbë në dorëheqjen e Nanos dhe krijimin e një qeverie teknike.

Këto ngjarje e zhyten Shqipërinë përsëri në krizë. Kryeministri Nano dha dorëheqjen dhe u krijua një qeveri e re, e kryesuar nga Pandeli Majko. Parlamenti vazhdoi punën për hartimin dhe miratimin e kushtetutës por kjo u bë pa pjesëmarrjen e Partisë Demokratike, e cila e bojkotoi procesin dhe nuk e njohu kushtetutën edhe pas miratimit popullor me referendumin e 22 nëntorit. Partia Demokratike iu kthye protestave dhe formave joparlamentare të paraqitjes së kërkesave të saj.

Arrijmë në të njëjtin konkluzion: Vrasja e Azem Hajdarit ishte pasojë dhe jo shkak i krizës në Shqipëri. Ajo u përdor nga Partia Demokratike për të balancuar paaftësinë dhe pamundësinë e saj për të gjetur rrugë parlamentare në dobi të zgjidhjes së kërkesave të saj. Faktori ndërkombëtar vazhdoi të përsëriste se zgjidhja e problemeve duhet të bëhej në rrugë parlamentare, se protestat, dhuna, grevat, bojkotimet nuk janë forma demokratike të zgjidhjes së problemeve. Debati i ashpër politik dhe mosgjetja e një gjuhe të përbashkët mes palëve shkaktuan protestat antiqeveritare të vitit 1998, të cilat degjeneruan në përleshje mes protestuesve dhe forcave të rendit. PS-ja kishte siguruar në parlament numrin e nevojshëm të mandateve për të miratuar edhe ligjet që kërkonin shumicë të cilësuar prej 2/3. Kështu si për t'i thënë opozitës së nuk ia kishin nevojën dhe se vota e tyre s'bënte ndryshim, mazhoranca u tregua e ashpër dhe arrogante me opozitën. Partia Demokratike nga ana tjetër mbante qendrime të ashpra si opozitë, bojkotonte vazhdimisht parlamentin dhe përdorte taktikat e rrugës për të mbrojtur interesat e saj politike.

**Protestat "Nano ik"**

Në periudhën 2001-2005 Shqipëria u qeveris nga koalicioni i majtë, ku rolin dominues e luajti Partia Socialiste. Në këto vite brenda Partisë Socialiste u zhvillua një luftë e ashpër për pushtet që shkaktoi paqëndrueshmëri qeveritare. Si rrjedhojë e kësaj lufte, nga PS-ja u shkëputën një grup anëtarësh dhe krijuan Lëvizjen Socialiste për Integrim, nën drejtimin e Ilir Metës.

Në periudhën tetor - dhjetor 2003, u zhvilluan zgjedhjet për pushtetin lokal. Pavarësisht përmirësimeve që u vunë re, zgjedhjet u shoqëruan me probleme të shumta. Partia Demokratike nuk njohu rezultatin e zgjedhjeve për Tiranën. Në bazë të vendimeve të KQZ-së zgjedhjet u përsëritën në 30% të qendrave të votimit në Tiranë, por kjo nuk e ndryshoi rezultatin. Procesi zgjedhor rriti tensionin në jetën politike, rriti mosbesimin mes palëve, acaroi debatin politik.

Në bazë të progres-raportit të Komisionit Evropian të vitit 2004, gjatë vitit 2003 inflacioni në Shqipëri ishte 3.3%, kurse rritja reale e GDP-së ishte 6.0% nga 4.7% në 2002-shin. Në aspektin ekonomik gjatë vitit 2004 reformat qenë të kufizuara, ekonomia mbetej informale. Veprimet e qeverisë shqiptare, jo gjithmonë mbështetën përparimin e Shqipërisë në Procesin e Stabilizim Asociimit, edhe pse e kishte vendosur këtë si përparësi të saj. Investimet në vend qenë të ulta për shkak të barrierave që krijoheshin nga korrupsioni, krimi i organizuar, zbatimi i mangët i ligjit, administrata joefektive(KE, Progres raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2004, p. Përmbledhja). Qeveria bëri pak investime publike, u rritën çmimet e produkteve jetësore, si çmimi i bukës, energjisë dhe tarifat telefonike, ndërkohë që papunësia ishte e lartë dhe standardi i jetesës i ulët.

Më 9 janar të vitit 2004 shoqëria shqiptare u trondit nga tragjedia e Karaburunit, ku humbën jetën 21 persona në përpjekje për të emigruar ilegalisht për në Italì. Opozita akuzoi për këtë qeverinë e kryesuar nga Fatos Nano, sepse e kishte

futur vendin në krizë të thellë ekonomike, që i detyronte shqiptarët të largoheshin nga Shqipëria në mënyrë ilegale. Kjo dhe problemet ekonomike shërbyen si shtysë për opozitën për t'i bërë thirrje popullit të ngrihej në protesta antiqeveritare.

Protestat kundër qeverisë së Fatos Nanos u udhëhoqën nga motoja "Nano ik". Partia Demokratike, bashkë me partitë e vogla opozitare, krijuan një front antiqeveritar ku morën pjesë 10 parti opozitare dhe u bashkuan republikanë e monarkistë. Ata kërkonin rrëzimin e qeverisë Nano, krijimin e një qeverie të përkohshme deri në zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme. Opozita akuzonte qeverinë për vjedhje të votave, për politikën e gabuar ekonomike, për rritjen e çmimeve, për korrupsionin që kishte përfshirë gjithë administratën shtetërore, për ngadalësimin e procesit të integrimit të vendit. Ata përdorën shprehje të tilla si *"malavita", "turp i kombit", "armik i shqiptarëve", "klika e antivlerave"* për kryeministrin Nano dhe ministrat e qeverisë së tij.

Deviza e demokratëve në mbrojtje të qytetarëve dhe kërkesat e tyre me karakter shoqëror, bënë që thirrjet e tyre antiqeveritare të gjejnë mbështetje të gjerë popullore. Shtresa të ndryshme të popullsisë, të lodhur dhe të zhgënjyer nga qeverisja socialiste, për ditë e muaj me rradhë morrën pjesë në protestat antiqeveritare "Nano ik", që kërkonin një fillim të ri.

Protesta u zhvilluan në Tiranë dhe në qytete të tjera si Laç, Kavajë, Kamëz dhe madje dhe në qytete që njiheshin si bastione të së majtës si Vlorë dhe Berat. Kjo përkrahje dhe pjesëmarrje e gjerë e popullsisë, i dha zemër opozitës të përshkallëzojë protestat e saj. Sipas asaj që Sali Berisha shprehej në fjalimet e tij, kjo nuk ishte lëvizje e një partie të vetme por një lëvizje që vinte nga zemra e shqiptarëve.

Më 7 shkurt, protesta para kryeministrisë mori forma të dhunshme. Protestuesit përdorën dhunë kundër Gardës së Shtetit që ruante godinën e kryeministrisë, goditën me gurë kryeministrinë dhe u përpoqën të hyjnë me dhunë brenda ndërtesës. Garda përdori tela me gjemba për të rrethuar ndërtesën dhe qëlloi në ajër për të sprapsur protestuesit e revoltuar, disa prej të cilëve ishin dhe të armatosur. Opozita iu përgjigj akuzave për përdorimin e dhunës ndaj institucioneve shtetërore se ata që kishin përdorur dhunë nuk ishin protestuesit, por forca të shërbimit sekret që ishin infiltruar brenda protestës për të fajësuar opozitën për përdorim të dhunës.

Bashkësia ndërkombëtare, që i shihte këto ngjarje të përsëriteshin për të disatën herë në Shqipëri, dënonte protestën e dhunshme dhe bënte thirrje që lufta politike të realizohej në rrugë institucionale. Megjithatë, pati dhe nga ata që e mbështesnin protestën, pasi kjo ishte e vetmja rrugë që i kishte mbetur opozitës. Eurodeputetja Doris Pack, në një intervistë dhënë një televizioni shqiptar, (AL-SAT) shprehej se opozitës nuk i kishte mbetur tashmë asnjë rrugë tjetër për të rrëzuar regjimin e një kryeministri, i cili nuk ka punuar aspak për ecjen e reformave në vend.

Qeveria nuk "u tund" para protestave opozitare. Kryeministri refuzoi të jepte dorëheqjen. Ai mohoi akuzat e bëra ndaj tij nga opozita dhe shprehej se qëllimi i protestave ishte që të kthente Berishën në pushtet. Protestat u shuan nga lodhja popullore dhe nga presioni ndërkombëtar, por ato penguan ndërmarrjen e reformave në vend duke qenë se iu kushtua më tepër vëmendje krizës politike sesa asaj ekonomike.

**Protestat opozitare 2009-2011**

Situata politike në Shqipëri u rëndua pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2009. Rezultati i zgjedhjeve rikonfirmoi qendrimin në pushtet të Partise Demokratike, por fitorja e saj qe e ngushtë. Koalicioni "Aleanca për ndryshim", i kryesuar nga PD-ja fitoi 70 mandate, koalicioni "Bashkimi për Ndryshim", i kryesuar nga PS-ja, fitoi 66 mandate, kurse koalicioni "Aleanca Socialiste për Integrim", i kryesuar nga LSI-ja fitoi 4 mandate. Me një marrëveshje paszgjedhore PD-ja dhe LSI-ja krijuan qeverinë e re me një koalicion të gjerë. Në këtë qeveri, të kryesuar nga Sali Berisha, LSI-ja mori postin e zëvendëskryeministrit dhe tri poste ministrore; ministrinë e jashtme, të ekonomisë dhe të shëndetësisë.

Sipas raportit të OSCE-ODIHR-it, "*Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009 shënuan një progres të prekshëm për sa i përket regjistrimit të votuesve procesit të identifikimit, kuadrit ligjor të miratuar në mënyrë konsensuale nga dy partitë kryesore në vend, për sa i përket votimit, numërimit dhe gjykimit të konflikteve zgjedhore. Këto përmirësime të konsiderueshme u zbehën nga politizimi i aspekteve teknike të procesit lidhur me numërimin e votave dhe hartimin e tabelave të rezultateve"*(OSBE/ODIHR, Parlamentary Election, 28 June 2009, p. 1) Vëzhguesit e OSCE-së vlerësuan negativisht numërimin e votave në 22 nga 66 VNV (OSBE/ODIHR, Parlamentary Election, 28 June 2009, p. 24) .

Duke pretenduar për parregullsi në mbarë vendin, PS-ja depozitoi ankesa në KQZ në lidhje me vendimet e saj për rezultatit në qarqet e Tiranës, Beratit dhe Shkodrës dhe kërkoi një rinumërim të plotë të fletëve të votimit të numëruara në disa VNV. Përfaqësues të PD-së argumentuan që PS-ja nuk kishte bërë vërejtje të logjikshme për keqmenaxhim apo parregullsi gjatë votimit dhe procesit të numërimit dhe nuk kishte paraqitur prova faktike në mbështetje të pretendimeve të saj, por nuk mori mbështetjen e KQZ-së me anë të votimit.

PS-ja i ankimoi këto vendime të KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor. Gjatë kundërshtimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve në Berat, Tiranë dhe Shkodër, PS-ja argumentoi se vendimet e KQZ-së ishin të pavlefshme sepse KQZ-ja kishte shkelur nenin 138.3 të Kodit Zgjedhor, kur refuzoi kërkesat për rinumërim nga dy anëtarë të KQZ-së. Kolegji Zgjedhor vendosi që termi "vota të caktuara", që mund të duhet të rinumërohen, do të thotë vetëm fletë votimi që janë kundërshtuar më parë dhe prandaj vetëm këto vota mund të pranohen si provë gjatë hetimit administrativ në KQZ.

Sipas raportit vlerësues të OSCE-ODIHR-it "*Kolegji Zgjedhor nuk përmbushi detyrimin ligjor për të dhënë vendimet e zbardhura me arsyetimin, përfshirë edhe mendimin e pakicës, brenda tri ditëve nga dita e marrjes së vendimit"*(OSBE/ODIHR, Parlamentary Election, 28 June 2009, p. 31).

PS-ja i konsideroi zgjedhjet të manipuluara dhe votat të vjedhura nuk e njohu rezultatin e tyre dhe bojkotoi kuvendin me kusht hapjen e kutive të votimit për transparencën e zgjedhjeve. Asambleja Kombëtare e PS-së vendosi të bojkotoi edhe zgjedhjet e pjesshme të 15 nëntorit me arsyetimin se deformimi i votave reale të 28 qershorit e bënte të pakuptimtë pjesëmarrjen në këto zgjedhje. PS-ja kërkoi ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për zbardhjen e zgjedhjeve.

Pasi ezauroi gjithë rrugët ligjore për kërkesën për rinumërim të kutive të votimit, PS-ja dhe aleatët e saj filluan

protestat për të kërkuar hapjen e kutive dhe, sipas tyre, për të mbrojtur votën e lirë të shqiptarëve. Protestat filluan të bëhen në mënyrë të vazhdueshme e sistematike nga nëntori 2009-ës deri në maj të vitit 2010. Protesta u zhvilluan në kryeqytet dhe në shumë qytete të tjera të vendit. Protestat u shoqëruan me bllokim të rrugëve nacionale, me mitingje dhe nuk munguan dhe përplasjet me forcat e rendit. Kryeministri Berisha përballë protestave të opozitës shprehej se ai njihte dhe respektonte të drejtën e tyre për të protestuar, por sipas tij, këto protesta ishin përpjekje për të përmbysur vendimet e gjykatave me rrugë politike dhe në një vend demokratik vendimet e gjykatave mund të ndryshohen vetëm me vendime gjykatash.

Më 25 shkurt deputetët socialistë hynë në parlament, pas 6 muajsh bojkot dhe bënë betimin. Ata e kushtëzuan praninë e tyre në parlament me miratimin e dy projektligjeve të hartuara për të realizuar transparencën e zgjedhjeve të qershorit. Parlamenti miratoi një projekt për ngritjen e një komisioni parlamentar hetimor, por nuk u arrit në një marrëveshje në lidhje me mandatin e tij, ndaj këto përpjekje dështuan.

Situata vazhdonte të ishte e nderë dhe secila palë qëndronte stoike në bindjet e veta. Në 16 mars kryetari i PS-së, Edi Rama nëpërmjet një letre të hapur, i bënte thirrje për dialog kryeministrit Berisha. Në letër Rama shprehej për rëndësinë që ka ndërmarrja e një hetimi të plotë dhe të pakushtëzuar i zgjedhjeve, për të shkëputur zgjedhjet e ardhshme nga korrupsioni, për të rikthyer besimin e qytetarëve te procesi zgjedhor. Ai shkruante: "*Bojkoti ynë nuk e futi në krizë demokracinë, kriza e demokracisë e çoi opozitën deri në bojkot...*"(Call for consensus, 2010)

Pas disa muajsh protestash dhe mosarritjes së asnjë rezultati, më 30 prill, 22 deputetë të PS-së dhe rreth 180 aktivistë dhe simpatizantë të saj hynë në grevë urie në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", në çadra të ngritura para kryeministrisë. Ata kërkonin hapjen e kutive të votimit, rinumërimin e votave dhe transparencën e zgjedhjeve të 28 qershorit të vitit 2009. Paralelisht me grevën opozita vazhdoi protestat, që tani u bënë të përditshme. Një ditë pas fillimit të grevës, me rastin e 1 Majit, qeveria organizoi një miting pak metra larg vendit ku organizohej greva.

I dërguari i BE-së Miroslav Lajçek (Miroslav Lajcak) u bënte thirrje palëve që të ulnin tensionet. *"E ardhmja evropiane e Shqipërisë varet nga ajo që do të bëjnë liderët shqiptar. Kjo nuk është rruga evropiane e zgjidhjes së problemeve politike*"- shprehej Lajçek.

Greva e opozitës, më masivja në vend që pas ndryshimeve të "90-ës, zgjati 19 ditë. Me ndërhyrjen e BE-së u organizua një takim midis dy liderëve politike, Berisha dhe Rama. Takimi u zhvillua në Strasburg si një darkë pune, me praninë e Stefan Fules, komisionerit për zgjerim të Komisionit Evropian dhe deputetë të Parlamentit Evropian të grupeve parlamentare të djathta dhe të majta. Të dy liderët shqiptarë deklaruan se ishin gati për bashkëpunim për të zgjidhur krizën politike. Ramës iu kërkua të kthehej në parlament, të hiqte dorë nga greva dhe të ulej për bisedime, kurse Berishës iu kërkua të hapë rrugën e hapjes së kutive të materialeve zgjedhore. Megjithatë negociatat dështuan në arritjen e një kompromisi. Në parim të dyja palët ranë dakord për të filluar procesin për transparencen e zgjedhjeve, por filloi nje debat i ashpër përsa u përket fletëve të votimit nëse përfshiheshin apo jo ato në materialet zgjedhore? U propozua qe t'i

kërkohej interpretimi i kësaj çështje, në bazë të legjislacionit shqiptar, Komisionit të Venecias.

Pas protestave e greves, PS-ja nisi denoncimet për korrupsion në qeveri. Në seancat parlametare, në konferencat për shtyp dhe në mediat e ndryshme u paraqitën raste konkrete, shembuj të përfitimeve të të mirave publike, shpërndarje pronash, pasurish, koncesionesh e tenderash në fushata të ndryshme si shpërblesa të ministrave, deputeteve të PD-së dhe të afërmve të tyre. PD-ja nisi një serial padish për shpifje ndaj deputetëve akuzues socialistë.

Gjatë gjithë vitit 2010 situata politike mbeti e rënduar, plot akuza të ndërsjellta, gjuhë të ashpër, fyerje dhe përplasje fizike në seancat parlamentare. Në korrik 2010 u bënë disa takime mes përfaqësuesve të PD-së dhe PS-së por nuk dhanë asnjë rezultat. PS-ja vazhdonte të këmbëngulte në formimin e komisionit hetimor për zgjedhjet si dhe arritjen e një marrëveshjeje për zgjidhjen e krizës politike. PD-ja nga ana e saj shprehej se i kishte ofruar disa herë marrëveshje dhe lëshime PS-së, në përputhje me kushtetutën, por ajo nuk kishte pranuar. Ndërkohë që nuk u arrit në një marrëveshje për komisionin hetimor, në dhjetor të 2010-ës, KQZ-ja vendosi, me votat e përfaqësuesve të mazhorancës, djegien e fletëve të votimit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009, me pretendimin se kutitë duheshin boshatisur dhe përgatitur për zgjedhjet lokale të 2011. Kjo e tensionoi përsëri situatën, që dukej se ishte qetësuar disi, pas vendimit të Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për shqiptarët.

Kulmin e vet tensioni politik e arriti në janar të vitit 2011. Me 12 janar, një emision televiziv investigativ, publikon një video të regjistruar, më 1 mars 2010 në zyrat e ministrisë së ekonomisë, nga deputeti i LSI-së dhe ish- ministër i ekonomisë, Dritan Prifti. Në video shfaqej Ilir Meta, në atë kohë zëvendëskryeministër dhe ministër i jashtëm, gjatë një bisede me Priftin, ku Meta i kërkonte të ndërhynte në tenderin për një hidrocentral (në favor të një personi emri i të cilit përmendej në video e si shpërblim të dy do të kishin përfitime të majme), në privatizimin e ARMO-s dhe në punësimin e një aktivisti të LSI-së. Qeveria Berisha, që gjatë fushatës elektorale kishte propaganduar me forcë luftën kundër korrupsionit, mori një goditje të rëndë. Berisha u shpreh se videoja ishte falso dhe e montuar. Këtë qëndrim mbajti dhe Ilir Meta, megjithatë më 14 janar ai dha dorëheqjen nga ministër i ekonomisë ,me qëllim që të përballej me drejtësinë si një qytetar i zakonshëm.

Videoja, që përfshinte zëvendës kryeministrin në afera korruptive, i dha shkak opozitës për të organizuar protesta të reja antiqeveritare. Lider të opozitës i bënë thirrje qytetarëve për të marrë pjesë në protestën e 21 janarit kundër korrupsionit që kishte përfshirë administratën e shtetit dhe mungesës së demokracisë dhe transparencës në vend. Faktori ndërkombëtar, përfaqësuesit në Shqipëri të SHBA-së, BE-së dhe OSBE-së tërhoqën vëmendjen që protesta të ishte paqësore dhe të shmangej dhuna.

Më 21 janar, në bulevardin para kryeministrisë, u mblodhën mijëra qytetarë, qeveria foli për rreth 20 mijë protestues, kurse opozita deklaroi se numri i protestuesve shkonte në 200 mijë. Protestuesit mbanin pankarta me sloganet “Berisha ik”, “Meta hajdut”, “Poshtë qeveria e mostrave”etj. Protesta tërhoqi vëmendjen e mediave të huaja dhe shqiptare që e shfaqen atë drejtëpërdrejt. Protesta zgjati disa orë, nuk pati fjalime të përfaqësuesve politikë dhe ra në sy mungesa në të e liderëve kryesore të

opozites. Ishin të pranishëm vetëm një numër i vogël deputetësh socialistë. Pas rreth gjysmë ore nga fillimi i protestës, ajo degjeneroi në dhunë. Nga ana tjetër forcat e rendit përdorën bomba me gazlotsjellës dhe makina ujëhedhëse. Dukej se me kalimin e minutave zemërimi i protestuesve bëhej më i madh.

Kontrollin e situatës e morën Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe Garda e Shtetit. Mes rrëmujës dhe kaosit u dëgjuan të shtëna armësh zjarri, që shkaktuan panik dhe konfuzion në radhët e protestuesve. Mes tyre pati të vrarë dhe të lënduar. Të lënduar pati dhe në radhët e forcave të rendit. Pas shpërndarjes së protestës bilanci ishte tragjik. Sipas deklaratave të bëra në media nga mjekët e Spitalit Ushtarak, numri i të plagosurve, që kishin marrë ndihmë mjekësore pranë këtij institucioni shkonte në 58, ndër ta 31 civilë dhe 27 policë, veç kësaj 3 protestues kishin humbur jetën kurse një tjetër ishte në gjendje kome. Pas disa ditësh dhe ai ndërroi jetë.

Lideri i PS-së në deklaratat e bëra për shtyp akuzonte qeverinë për vrasjen e protestuesve kurse Berisha deklaroi fillimisht se viktimat ishin qëlluar nga vetë demostruesit, pasi ata sipas ekspertizës mjeko – ligjore ishin goditur nga armë që nuk gjenden në radhët e gardës së shtetit. Ai akuzonte liderin e opozitës se kishte nxitur dhunën e protestuesve dhe ishte përpjekur të organizonte grusht shteti. Përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri shprehën keqardhje për përdorimin e dhunës dhe zemërim që thirrjet e tyre për protestë paqësore nuk ishin dëgjuar. Megjithatë në ditët në vazhdim ata vazhdonin të këmbëngulnin dhe të bënin thirrje se mënyra e vetme për të dalë nga ngërçi politik ishte zhvillimi i dialogut konstruktiv brenda kufirit kushtetues dhe ligjor.

Ambasadori amerikan në Shqipëri shprehej se ngjarjet që ndodhën nuk patën fitues, por vetëm të humbur, dhuna në rrugë nuk do t'i zgjidhë problemet e korrupsionit në Shqipëri, Shqipëria ka nevojë për lidership politik, që të gjejë gjuhën e kompromisit, beteja në rrugë nuk është kompromis dhe nuk reflekton aspiratat për demokraci të shqiptarëve(Press Conference of US Ambassador A. Arvizu, 2011).

Edhe presidenti i vendit i bëri thirrje faktorëve politike t'u rikthehen urgjentisht dialogut dhe të marrin përgjegjësitë politike për ruajtjen e stabilitetit të vendit.

Faktet e bëra publike në ditët në vazhdim e bënin të pamundur dialogun mes palëve. Në ditët pasuese pamjet e shfaqura nga media të ndryshme, jepnin fakte të pakontestueshme se protestuesit e vrarë ishin qëlluar nga ushtarë të Gardës, ndërkohë që qëndronin jashtë kangjellave të kryeministrisë në mënyrë aspak kërcënuese për sigurinë e institucionit shtetëror. Retorika u bë me konfrontuese. Liderët e opozitës e quanin Berishën vrasës, kërkonin dorëheqjen e tij, dhënien fund dhunës dhe vënien e fajtorëve para drejtësisë. Ndërsa mazhoranca deklaronte se garda kishte bërë detyrën e saj dhe se goditja e shtetit ligjor nuk falet. Sipas zëvendësdrejtorit për Evropën dhe Azinë Qendrore të Amnesty International "*Policia ka të drejtë të mbajë rregull dhe të mbrojë publikun, por ajo nuk duhet të përdorë forcë të tepruar kundër atyre që ushtrojnë të drejtën e tyre legjitime për të protestuar"*(AI investigation urged into Albania protest, 2011).

Proceset hetimore për videon Meta – Prifti dhe për ngjarjet e 21 janarit, e ashpërsuan më shumë debatin politik. Parlamenti ngriti një komision hetimor për ngjarjet e 21 janarit, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme hapi një hetim më vete për të shtënat me armë. PS-ja nuk pranoi të

marrë pjesë në komisionin hetimor duke e cilësuar atë si një pengesë në hetimin e prokurorisë për të zbardhur vrasjet e 21 janarit. Prokuroria vendosi të hapë çështje penale ndaj disa demostruesve me akuzën për – *kundërshtim të punonjësit të policisë, - goditje/kanosje/fyerje për shkak të detyrës.* U hap çështje penale ndaj komandantit të Gardës së Republikës dhe një gardisti me akuzën – *vrasje në rrethana të tjera cilësuese dhe shpërdorim të detyrës*, kurse shoferi i shefit të gardës dhe shefi i IT-së në kryeministri u akuzuan për *prishje të provave të një vepre penale*. Pas një procesi gjyqësor, që u cilësua i ndikuar politikisht, të gjithë u shpallën të pafajshëm, në Gjykatën e shkallës së parë të Rrethit Tiranë.

Viti 2011 solli debate të ashpra dhe në lidhje me heqjen e imunitetit deputetit Ilir Meta, kërkesë e cila u bë nga Prokuroria e Përgjithshme për t'i hapur rrugën hetimeve për korrupsion, për heqjen e imunitetit deputetëve socialistë Besnik Baraj, Taulant Balla, Tom Doshi, për shkak të dyshimit se kishin organizuar dhe kishin marrë pjesë në tubime të paligjshme. Hetimi ndaj tyre u ndërpre në nëntor, me amnistinë e Kuvendit me rastin e 100 - vjetorit të Pavarësisë.

Debati u bë edhe me i ashpër gjatë numërimit të votave për kryetarin e bashkisë së Tiranës në zgjedhjet lokale të 8 majit 2011. Rezultatet paraprake shpallnin fitues, me një diferencë të vogël Edi Ramën, por më pas KQZ-ja merr vendimin t'i cilësojë të vlefshme fletët e votimit të hedhura në kutitë e gabuara, që ishin cilësuar të pavlefshme nga grupet e numërimit, dhe kjo përmbysi rezultatin e zgjedhjeve. Përfaqësuesit e PS-së e cilësuan këtë vendim të KQZ-së antiligjor. *"Përcaktimi i rezultatit të zgjedhjeve për kryetarin e bashkisë së Tiranës ishte një proces shumë i diskutueshëm dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u morën në frymë partizane, u mungonte arsyetimi dhe kishin mospërputhje*"(KE, Progres raporti i Komisionit Evropian per Shqipërinë, 2011) - thuhet në progres raportin Komisionit Evropian të vitit 2011. Veç kësaj rezultatet e shpallura nga KQZ-ja për garën për kryetar bashkie të Tiranës përmbanin 870 vota më shumë se firma në LPZ(listat paraprake të zgjedhësve).

Pas kësaj PS akuzoi për manipulim të rezultatit të zgjedhjeve dhe bojkotoi përsëri kuvendin.

**Përfundime**

Në mënyrë të përsëritur politika shqiptare nuk i ka shpëtuar ngërçit në të cilin futet, për hir të mosmarrëveshjeve dhe debateve që përfshijnë forcat kryesore politike në vend. Partitë politike shqiptare nuk janë të afta t'i zgjidhin problemet në rrugë parlamentare dhe demokratike, por përdorin çdo mjet, çdo formë, çdo paqartësi apo mangësi ligjore për të luftuar njëra tjetrën dhe nuk janë të gatshme të bëjnë kompromise edhe kur vihet në pikëpyetje e ardhmja e vendit apo kur rrezikohet jeta e qytetarëve shqiptarë. Ngjarjet e përshkruara në këtë punim dëshmojnë qartë se krizat më të thella të tranzicionit shqiptar janë shkaktuar nga paaftësia e klasës politike shqiptare për të bërë lëshime dhe kompromise, e mungesës së kulturës demokratike, që kanë çuar në një polarizim të skajshëm të jetës politike në vend. Mes partive politike ka munguar vullneti për të bërë kompromise, dëshira për të bashkëpunuar dhe gadishmëria për të vënë interesat kombëtare mbi ato partiake.

Në momentet e ashpra të debatit politik, tundimi për të përdorur bojkotin ka qenë i vazhdueshëm. Bojkoti është përdorur nga të dyja palët si formë e mospajtimit me situatën politike në vend, si kundërshtim ndaj veprimeve apo vendimeve të palës tjetër, si refuzim për të mbështetur nismat e palës kundërshtare.

Partitë politike shqiptare, kur janë në opozitë, gjithmonë kanë zgjedhur vijën e ashpër, taktikat e rrugës, format e dhunshme për të plotësuar kërkesat e tyre, kurse kur janë në qeverisje, ato "pushtojnë" shtetin dhe politikat publike, mënjanojnë opozitën nga vendimmarrja dhe tregohen arrogante me të.

Polarizimi i skajshëm politik është duke dëmtuar funksionimin e demokracisë në Shqipëri dhe po pengon reforma të rëndësishme të cilat janë të domosdoshme për përparimin e vendit në rrugën drejt integrimit në BE dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Klasa politike shqiptare me grindjet e saj të vazhdueshme ka vështirësuar ndërmarrjen e reformave ekonomike në vend. Krizat politike shpesh kanë marrë gjithë energjitë dhe vëmendjen e shtetit duke lënë në plan të dytë ndërmarrjen e reformave. Herë të tjera konsensusi i munguar ka bërë të pamundur marrjen e vendimeve apo sigurimin e bazës së nevojshme ligjore për të ndërmarrë reforma të rëndësishme për vendin.

Kështu ngjarjet e vitit 1997 dëmtuan imazhin e shqiptarëve në opinionin ndërkombëtar, ngrinë marrëdhëniet Shqipëri – BE, goditën mjaft rëndë ekonominë shqiptare, tregtia u paralizua, GDP-ja ra me 10%, inflacioni arriti në 14%.

Ngërçi politik i krijuar në vitin 1998 pengoi konsensusin për hartimin dhe miratimin e kushtetutës shqiptare. Kriza e tejzgjatur parlamentare e viteve 2009 – 2011 ndikoi ngativisht në plotësimin e prioriteteve të përcaktuara nga Komisioni Evropian dhe Shqipërisë iu refuzua disa herë marrja e statusit të shtetit kandidat.

Klasa politike shqiptare duhet të arrijë një konsensus të gjerë politik dhe të vendos interesat kombëtare përmbi axhendat e ngushta dhe përkatësitë partiake apo ato individuale, si dhe të gjejë një qasje pragmatiste, ku mundësitë dhe sfidat e vendit të diskutohen në mënyrë të balancuar dhe neutrale. Kjo kërkon një përgjegjësi dhe përgjegjshmëri të plotë nga ana e të gjitha forcave politike në vend.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Baze, M. (2010). *Viti '97.* Tiranë: Botimet Toena.
Biberaj, E. (2011). *Shqipëria në tranzicion.* Tiranë: AIIS.
Buxhovi, J. (2009). *Kthesa historike* (Vol. 3). Prishtinë: Faik Konica.
Duka, V. (2007). *Historia e Shqipërisë.* Tiranë: Kristalina-KH.
Fino, B. (2007). *Humnerë '97.* Tiranë: Edisud.
*http://www.facebook.com/note_note.php?note*. (2010, 3 16).
*http://www.lajme.gen.al*. (2011, 01 21).
*Http://www.lajme.gen.al*. (2011, 01 21).
*http://www.lajme.gen.al/*. (2011, 01 21).
*http://www.nikollëlesi.com/index.php?* (2013, 12 24). (N. Lesi, Producer)
*http://www.tirana.usembassy.gov/.* (2011, 01 22).
KE. (2004). *http://www.mie.gov.al.*
KE. (2011). *http://www.mie.gov.al.*
OSBE/ODIHR. (1996). *http://www.osce.org/albania/election.*
OSBE/ODIHR. (n.d.). *http://www.osce.org/odihr/election/albania.*
Times, N. Y. (1997, 3 13). Revolt spreads to Albanian Capital's outskirts. *New York Times* .
Vickers M, P. J. (2007). *Çështja shqiptare, riformësimi i Ballkanit.* Tiranë: Bota shqiptare.
Zogaj, P. (2009). *Intuicionet e tranzicionit* (Vol. 1). Tiranë: UET Press.

# NDIKIMI I REVOLUCIONIT KULTUROR KINEZ NË SHOQËRINË SHQIPTARE

**ALBA KREKA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Me instalimin e komunizmit në Shqipëri, vendi iu nënshtrua një politike të udhëhequr nga partia në pushtet. Historia e politikës së jashtme të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore karakterizohet nga një lloj varësie e një vendi të vogël kundrejt një fuqie më të madhe. Ardhja e Partisë Komuniste në pushtet i atribuohet ndihmës së përftuar nga Partia Komuniste Jugosllave, çka e detyroi liderin komunist shqiptar që të vendoste marrëdhënie varësie me Jugosllavinë për aq kohë sa Shqipëria ia arriti qëllimit që t'i bintë në sy Bashkimit Sovjetik, fuqisë më të madhe brenda Bllokut Komunist të kohës. Kjo u favorizua edhe nga rrethanat e përgjithshme në kuadrin e konfliktit Tito-Stalin.

Bashkëpunimi shqiptaro – sovjet dha frutet e tij qoftë në çështje të politikës, por edhe të ekonomisë shqiptare. Tashmë Shqipëria renditej në ato vende, të cilat po fitonin një status të ri brenda Bllokut. Vdekja e Stalinit solli një periudhë të vështirë për liderin komunist shqiptar, i cili nuk mund të vazhdonte të ndiqte kursin e ri politik të Hrushovit, pasardhësit të Stalinit. Në qoftë se e bënte këtë, atëherë ai ishte i detyruar të shembte një diktaturë të ngritur me aq mund dhe sakrificë, në kurriz të demokracisë.

Konflikti sovjeto – kinez hapi një dritare të re për Shqipërinë, e cila u pozicionua në krah të Kinës duke nisur në këtë mënyrë një aleancë që do t'i vinte në ndihmë për gati 10 vjet. Të dy vendet ndanin të njëjtat pikëpamje në lidhje me ideologjinë, ekonominë, çështjet politike dhe kulturore të kohës.

Një nga objektivat kryesore të këtij punimi është njohja me dy shoqëritë, atë shqiptare dhe kineze gjatë kohës së aleancës të vendosur mes tyre. Shqipëria dhe Kina patën një bashkëpunim të ngushtë që filloi gjatë viteve '60, duke u zhvilluar edhe më shume gjatë Revolucionit Kulturor. A u zbatua ky Revolucion edhe në Shqipëri? Cilat ishin format dhe metodat e përdorura, ishin kopje të nismave kineze apo iu përshtatën shoqërisë shqiptare? Këto pyetje dhe shumë të tjera do të marrin përgjigje gjatë analizës së burimeve, fakteve, ndodhive dhe ballafaqimeve të mendimeve të studiuesve të ndryshëm.

Duke përdorur metodën krahasuese, analitike dhe sintetizuese jemi përpjekur të nxjerrim në pah ndryshimet që prekën shoqërinë shqiptare të viteve '70 në kuadër të një fryme revolucionare. Siguristh që nismat e ndërmarra në Shqipëri ishin pothuajse të njëjta me ato të Revolucionit Kulturor Kinez sepse si Mao ashtu edhe E. Hoxha kërkonin konsolidimin e pozitave të tyre. Gjatë viteve të bashkëpunimit shqiptaro – kinez, shoqëria shqiptare pati përfitime të konsiderueshme.

Ky Revolucion e tronditi shoqërinë shqiptare, e cila përjetoi një periudhë ndryshimesh të mëdha dhune, persekutimesh, ngjarjesh, të cilat shtypën liritë dhe të drejtat e individit, por forcuan edhe më tepër rolin e diktatorit. Me ndryshimin e politikës së jashtme kineze, ndryshoi edhe aleanca dypalëshe, e cila pushoi së qëni e tillë në vitin 1978. Pas këtyre ngjarjeve fillon periudha e vëtëizolimit për Shqipërinë.

**Fjalët kyce**: *Revolucion Kulturor, analogji, reforma, të drejtat e individit, politika e jashtme*.

**Abstract**

The installation of the communism influenced the policy to be pursued in Albania for a long time. History of Albania's foreign policy after World War II is characterized by a kind of dependence of a small country towards a greater power. Albanian Communist Party came to power with the support of Yugoslav Communist Party, what forced E. Hoxha to establish a relationship with Yugoslavia.

These relationships lasted as long as Albania achieved its goal to make up with Soviet Union, the greatest power within the Communist Bloc. Sino - Albanian cooperation had a great importance to Albanian policy and economy because of the new role of Albania within the block. Stalin's death led to a difficult period for Albanian communist leader because he could not continue to follow the new political course of Khrushchev, known as Stalin's successor.

If he would do this than he would be obligated to undermine his personal power. Sino - Soviet conflict was used by Albanian government, which was positioned next to China starting a new alliance that lasted about 10 years. Some of the reasons of this cooperation were the common view about ideology, economy, political and cultural issues.

Albania and China had a close collaboration since in the 60s but it was developed during the years of Cultural Revolution. One of the main objectives of this work is to know more about Albanian and Chinese society during Chinese Cultural Revolution; Was this Revolution implemented in Albania? Which were the forms and methods used, were they Chinese copies or Albanian initiatives? These and many other questions will receive an answer during the facts and events analysis.

Using comparative method I'm trying to point out the changes that affected the Albanian society during '70s as part of a “general revolutionary spirit”. Initiatives in Albania were almost identical to those of the Chinese Cultural Revolution because Mao as Hoxha also sought to consolidate their positions. The use of analytical and synthesis method helped me to analyze the archival information and the opinions of different authors. During Sino - Albanian cooperation, it was implemented Chinese Cultural Revolution in Albania.

This revolution led to a period of changes, violence, persecutions, events that limited the human rights but reinforced the role of dictator in Albanian society. The change of Chinese foreign policy changed the bilateral alliance too, which officially ended in 1976. A new period began to Albania because of the self-isolation policy.

**Keywords**: Cultural Revolution, analogy, reforms, human rights, foreign policy.

Politika e jashtme e Shqipërisë karakterizohet nga ngjarje të shumta politike, të cilat e kanë detyruar vendin të jetë gjithmonë në kërkim të një aleati. Për shkak të orientimit të saj komunist, Shqipëria kërkonte të lidhte aleanca me vendet më të fuqishme komuniste të kohës. Vështirësia e saj më e madhe pas Luftës së Dytë Botërore ishte njohja në arenën ndërkombëtare. Roli i Shqipërisë filloi të rritej gjatë konfliktit sovjeto – kinez sepse ajo u pozicionua kundër Bashkimit Sovjetik dhe në mbështetje të politikës kineze.

Një aleancë e mundshme me Kinën komuniste sigurisht që do të ishte fitimprurëse për një vend të vogël si Shqipëria. Në vitet ’60 a jo rrezikohej jo

vetëm nga politikat e vendeve fqinje, por edhe kundërshtari më i madh i kohës, BRSS-ja. Mbështetja politike dhe ekonomike që morri nga Kina, e qetësuan deri diku liderin komunist shqiptar, i cili hapi një dritare të re në politikën komuniste shqiptare.

Rritja e rolit të Kinës në arenën ndërkombëtare rriti sigurinë politike të Shqipërisë, sepse Kina u bë dukshëm një fuqi e re dhe një vend potencial. Lidhja e një aleancë të tillë i siguroi Shqipërisë status dhe ndihmë ekonomike të konsiderueshme nga Kina, pavarësisht pozicionit gjeografik të dy vendeve.

Revolucioni Kulturor Kinez filloi si një lëvizje kundër frymës liberale që po zhvillohej brenda Partisë Komuniste Kineze. Në 28 maj të vitit 1966, Mao Ce Duni dhe Komiteti Qendror i Kinës shpallën zyrtarisht grupin kryesues të Revolucionit Kulturor, i cili do të nxiste të gjitha trazirat e ndodhura në Kinë.

Në të njëjtat pozita ishte edhe E. Hoxha, i cili nuk mund të lejonte kurrsesi frymën liberale brenda Partisë së Punës në Shqipëri. Prishja e marrëdhënieve me BRSS-në i kishte sjellë liderit komunist shqiptar vështirësi të mëdha politike. Pas viteve ’60 shqiptarët filluan të besonin në një orientim dhe ndryshim të ri politik në vend. Në këto kushte filloi të ndihej një frymë liberale jo vetëm brenda partisë, por edhe në popull. E. Hoxha nuk mund ta lejonte një gjë të tillë dhe hapi i parë që ndërmori ishte spastrimi i elementëve prorusë, të cilët i cilësoi si “armiqtë” më të rrezikshëm të sistemit. Gjetja e një aleati të ri sanksionoi edhe njëherë pozitat e një diktatori që nuk kishte ndërmend të ndryshonte rrjedhën politike në Shqipëri.

Revolucioni Kulturor në Kinë i shërbeu si një model për ta ndjekur atë edhe në Shqipëri. Në qoftë se bëjmë një analogji mes ngjarjeve të ndodhura në Kinë dhe atyre të ndodhura në Shqipëri, do të vërejmë një ngjashmëri të madhe sidomos në format dhe metodat e përdorura. Ndoshta Mao e kishte më të vështirë që të ruante pozitat e tij në një vend të madh si Kina, e cila kishte një popullsi prej 800 milion banorësh dhe në një farë mënyre u justifikua ndërmarrjen e Revolucionit Kulturor Kinez. Ndërsa E. Hoxha ishte diktator i një vendi të vogël,por që nuk pretendoi asnjëherë që ta lëshonte pushtetin deri sa ishte gjallë. Profilet e të dy dikatorëve (ose të shumë diktatorëve të pas Luftës së Dytë Botërore) janë shumë të ngjashme; kjo shpjegon edhe rrjedhën e ngjarjeve si në Shqipëri ashtu edhe në Kinë gjatë Revolucionit Kulturor Kinez.

**Analiza e materialit**

Revolucioni Kulturor në Kinë filloi si një lëvizje ideologjike që zgjati nga viti 1966 deri në 1976. Ai shpërtheu në 16 maj 1966 si rezultat i një qarkoreje të shpallur nga Byroja Politike Kineze. Ndryshimet politike dhe shoqërore të Kinës ndikuan dukshëm në rritjen e fuqisë së komunistëve, të cilët pasi erdhën në pushtet rritën ndikimin e tyre politik dhe ideologjik në masën e gjerë të popullit. Mao u përpoq që ta paraqiste Revolucionin Kulturor si një lëvizje popullore, e cila synonte reformimin e Partisë Komuniste Kineze (PKK), ekonomisë, institucioneve lokale, kulturës etj. Ka disa mendime se Revolucioni ishte pasojë e një vetëkënaqjeje të PKK-së si rezultat i arritjeve të shumta dhe dëshirës për të përshpejtuar progresin drejt komunizmit.Ten Rong, vajza e Ten Ciao Pinit, Sekretarit të Përgjithshëm (1956 – 1967) në kujtimet e saj shpreh një keqardhje për ndryshimet që ndodhën brenda Byrosë Politike Kineze; “pjesa më e madhe e liderëve të Partisë as që e kishin idenë se çfarë furtunë e tmerrshme do të vijonte” (T. Rong, 2012, p.18). “Qarkorja e 16 Majit” përfaqësonte në vetvete ndëshkim ndaj çdo “mendimi reaksionar borgjez” në akademi, media, letërsi, art etj.

Përqafuesit e këtij mendimi, në një moment të caktuar, mund të zotëronin pushtetin politik duke sunduar mbi komunistët. Kjo qarkore lajmëroi ardhjen e një stuhie politike, e cila do të prekte jetën e brendshme dhe të jashtme politike të Kinës.

Në shtypin e kohës kishte filluar propaganda ndaj ndryshimeve që po prekin shoqërinë kineze. Në një editorial të kohës, titulluar "Të shkatërrojmë të gjithë demonët dhe shpirtrat e helmatisur, u bëhej thirrje masave të eleminonin të gjithë demonët dhe shpirtrat e helmatisur që po i merrnin frymën ideologjisë dhe kulturës, të godisnin të ashtuquajturit ekspertë, akademikë, zyrtarë e përkrahës të borgjezisë." (T. Rong, 2012, p. 26).

Pavarësisht se këto reforma propogandoheshin në mbrojtje të komunizmit, ato synonin të godisnin inteligjencën e vendit. Mao Ce Duni i trembej goditjes së kultit të individit dhe për këtë arsye iu dha fuqi dhe pushtet të madh disa figurave politike, të cilat kishin si armë të fortë vetëm besnikërinë ndaj tij.

Shoqëria kineze në prag të Revolucionit pasqyronte nje mentalitet feudal, i cili reflektohej në arsim, zakone, tradita, art si dhe brenda Partisë Komuniste. "Influencat borgjeze ishin të pakta; duke i pëqëndruar kritikat mbi borgjezinë, Mao devijoi vëmendjen nga rreziku kryesor që ishte mentaliteti feudal". (T.Rong, 2012, p.21)

E gjithë vëmendja e Kinës ishte përqendruar në realizimin e Revolucionit të Madh, i cili u konsiderua nga Komiteti Qendror i Kinës si "vazhdim i luftës së brendshme civile, sepse ata me pikëpamje të djathta oportuniste u zbuluan si tradhtarë dhe spiunë të fshehur në gjirin e Partisë". (AQSH, 1968, D. 319) Fryma liberale brenda Partisë Komuniste Kineze nuk mund të tolerohej nga Mao dhe përkrahësit e tij. Për këtë arsye u goditën një sërë figurash me peshë në Parti dhe filloi fryma revolucionare në të gjithë vendin.

Pavarësisht pajtueshmërisë ose jo me disa aspekte të Revolucionit Kulturor, udhëheqja shqiptare tregoi solidaritet me të gjitha veprimet e ndërmarra në Kinë. Shtypi shqiptar e reflektonte më së miri qëndrimin e PPSH-së në mbrojtje të politikës së brendshme dhe të jashtme të ndjekur në Kinë. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, Kina kishte hyrë në politikën e izolimit dhe prestigji i saj në arenën ndërkombëtare kishte rënë.

Vendi që përfitoi më shumë nga kjo situatë ishte Shqipëria, e cila duke miratuar këtë Revolucion mori vlerë të madhe në sytë e udhëheqjes kineze. Edhe pse Kina u përqendrua në punët e brendshme politike të saj, vazhdoi mbështetjen ekonomike dhe politike kundrejt Shqipërisë. Të dy vendet ndanin të njëjtin mendim dhe perceptim të rrezikut që u kanosej, sidomos nga SHBA-ja dhe BRSS-ja. Sipas tyre, këto vende bashkëpunonin për të ndarë botën në zona influence, por edhe për të minuar aleancën Shqipëri – Kinë. Megjithatë, ngjarjet e ndodhura gjatë Revolucionit Kulturor ndikuan edhe në zhvillimet e politikës së jashtme kineze, sidomos në vitet '70. Marrëdhëniet Shqipëri – Kinë, deri në këtë kohë kishin ecur në një terren të sigurt, por me ndryshimin e prioriteve që Kina i vuri vetes, ato pësuan ulje-ngritje. Ramiz Alia pranon në kujtimet e tij të mëvonshme, se "ndryshimet mes palëve u shtuan dhe mosmarrëveshjet kishin të bënin si me qëndrimet për ngjarje politike ndërkombëtare, ashtu edhe për taktikat që duheshin ndjekur në luftën tonë të përbashkët në gjirin e Lëvizjes Komuniste"(Alia, 2010, p.247).

Duke krahasuar politikën e jashtme të ndjekur në Kinë me politikën e jashtme të Shqipërisë vihet re një diferencim. Kina ndoqi politikën e izolimit ndërkombëtar

gjatë pjesës së parë të Revolucionit Kulturor Kinez, ndërsa Shqipëria mbajti qëndrime diplomatike, të cilat nuk ishin më të tilla pas viteve ’70 sepse asaj iu desh të pozicionohej në lidhje me ndryshimet që po ndodhnin në politikën e jashtme të Kinës.

Lufta ndaj “shfaqjeve borgjeze” ishte një tjetër kauzë e përbashkët që i bashkoi këto dy vende në kuadrin e Revolucionit Kulturor. Të dyja lëvizjet ideologjike nuk u implementuan njëlloj, kjo për arsye se drejtuesit politikë u motivuan nga çështje dhe shqetësime të ndryshme. Në një letër të hapur të Komitetit Qëndror të PPSH-së, mbajtur në mars 1966, u propogandua lufta ndaj burokracisë, ku u zëvendësua një numër i madh kuadrosh, ndërsa një pjesë e mirë e zyrtarëve u detyruan të pranonin uljen e pagës në kuadër të luftës së klasave. Në këto kushte, gazeta “Zëri i Popullit” botoi në 7 shkurt 1967 fjalimin e E. Hoxhës *Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i pushtetit*, në të cilin shpalosej e njëjta frymë që po ndiqej në Kinë gjatë Revolucionit.

Lufta kundër “shfaqjeve borgjeze”, kapitalizmit apo burokracisë gjatë viteve të komunizmit ishin ngjarje të zakonshme. Në kuadër të fushatës së “edukimit komunist”* u propogandua një lëvizje që synonte emancipimin e shoqërisë nga zakonet dhe praktikat e prapambetura, të trashëguara nga e kaluara.

Qëllimi themelor i edukimit komunist ishte prodhimi i një mase të gjerë njerëzish, qofshin këta punëtorë apo intelektualë që do të shfrytëzoheshin për ndërtimin e socializmit. Gjatë gjithë këtij procesi, duke qenë të indoktrinuar thellësisht, këtë shfrytëzim do ta shihnin si një sakrificë për të mirën e shoqërisë. Pavarësisht se shumë masa të marra nuk ishin kopje identike kineze, rrugët nëpërmjet të cilave ato u realizuan ishin imitim i praktikave kineze. Lufta kundër burokratizimit në Shqipëri u realizua me të njëjtat metoda si në Kinë. Pothuajse në të gjitha institucionet dërgoheshin grupe pune apo kuadro, të cilët duhet të komunikonin me masat dhe të njiheshin sa më mirë me shqetësimet e njerëzve. Në Kinë këto takime realizoheshin nëpërmjet grupeve të punës dhe kjo ishte një çështje që nxiti polemika të shumta sepse Ten Ciao Pini nuk ishte dakord, ndërsa në Shqipëri kjo praktikë u realizua nëpërmjet “qarkullimit të kuadrove”* Në rastet kur qëllimi nuk arrihej plotësisht ose viheshin re “devijime” të kuadrove, përdoreshin fletë – rrufetë, të cilat ishin kopje të “dacibao-ve” kineze. Të njëjtat forma diskutimi apo autokritike që përdoreshin në Kinë filluan të përdoren edhe në Shqipëri. Mendohej se kritika publike ishte më efektive jo vetëm për atë që e realizonte, por edhe për masën, sepse nënkuptonte pjesëmarrjen e gjerë të kolektivit të punës. Realizimi i nismave të tilla solli veprime të dhunshme si në shoqërinë shqiptare, por më shumë në atë kineze. Revolucioni Kulturor propogandohej në Kinë si një arritje e madhe historike, pavarësisht se vetë Mao nuk ishte i qartë për kohën që i duhej këtij revolucioni për të arritur qëllimet e tij. Në Pleniumin XII të Komitetit të Tetë Qëndror, Mao kishte deklaruar “ka ca gjëra që nuk i kemi përfunduar ende si p.sh. lufta e klasave, kritikat, reformat. Për këtë arsye

* Ishte një fushatë masive e iniciuar nga regjimi Hoxha dhe kishte disa objektiva kryesore si emancipimi i gruas, lufta kundër fesë, e cila rezultoi me shpalljen e Shqipërisë në 1967 si i vetmi shtet ateist në botë, reforma për zhdukjen e cdo lloj influence sovjetike etj.

* Kuadrot e niveleve të qendrës shkonin dhe punonin në bazë për një kohë të caktuar. Kuadro të Byrosë Politike të KQ të PPSH. anëtarë qeverie, kuadro të institucioneve të ndryshme, shkrimtarë, artistë etj dërgoheshin në fshatra dhe në vepra të mëdha ndërtimi për të dhënë kontributin e tyre.

duhet të vazhdojmë përpara. Pas disa vitesh mund të na nevojitet një tjetër revolucion." (T. Rong, 2012, p.145) Dhe ashtu ndodhi, Revolucioni Kulturor vazhdoi për dhjetë vjet. Mao mendonte se kjo ishte periudha më e lavdishme në historinë e Kinës dhe për këtë arsye masat vinin duke u radikalizuar edhe më tepër. Ai nisi një fushatë mbarëkombëtare kundër konfucianizmit, duke përbaltur në këtë mënyrë filozofinë dymijë vjeçare të Konfucit. Sipas shpjegimeve të kohës, Konfuci kritikohej sepse sistemi feudal në Kinë e kishte burimin ideologjik te Konfuci. Në çdo etapë të shoqërisë kineze, çdo dinasti në fillim zbatonte formën e saj të luftës dhe më pas, kur kishte forcuar pozitat e saj, përdorte filozofinë e Konfucit duke e çuar shoqërinë në regres. "Pikëpamjet e Konfucit janë kundër marksizëm – leninizmit, nuk janë materialiste, por idealiste. Marksizëm – leninizmi dhe idetë e Maos thonë se është populli ai që e bën historinë. Konfuci kërkonte të restauronte kapitalizmin në Kinë" (AQSH, 1974, D.11) .

Si kundërpërgjigje u mendua krijimi i një kulture socialiste e cila konistonte në daljen e literaturave të reja, të cilat duhet t'i përgjigjeshin shoqërisë socialiste. "Citatet e Maos" u konisderuan si "Bibla" e Revolucionit Kulturor duke shërbyer si edukimi më i mirë për masat.

Politika të njëjta u ndoqën edhe në Shqipëri. Propaganda antifetare e Partisë Komuniste akuzonte klerin si e keqja e popullit shqiptar, si bashkëpunëtore me pushtuesit nazi-fashistë, si shkatërrues të rendit të ri dhe si kundërshtarë të reformave të kohës. Propaganda antifetare ishte mjeti kryesor që përgatiti opinionin publik dhe legjitimoi sulmin, propagandimin dhe asgjësimin institucional dhe fizik të fesë në Shqipërinë komuniste. Ideologjia fetare u zëvendësua me ideologjinë komuniste ku në qendër të vëmendjes ishin masat, lufta ndaj klasave dhe individi i ri i shoqërisë socialiste. Lufta ndaj klerit justifikohej në një farë mënyre me frikën për ndikim në shoqëri. Njerëzit ishin të ndjeshëm ndaj fesë dhe për më tepër ndikimi që kishte patur kleri në Shqipëri historikisht kishte qenë i madh.

Propaganda antifetare e zhvilluar në Shqipërinë komuniste shërbeu për të përgatitur një brez të tërë të rinjsh antifetarë, të cilët në vitin 1967 do të ndërmerrnin një superaksion kombëtar që çoi në prishjen dhe shkatërrimin fizik dhe institucional të klerit dhe institucioneve fetare në Shqipëri. Kjo lindi si një iniciativë e rinisë së Durrësit, e cila i kishte drejtuar një letër Komitetit Qëndror për "ndalimin e fesë dhe mbylljen e institucioneve fetare. Me porosi të E. Hoxhës, u vendos që rezoluta të botohej, të shihej si do të pritej dhe më pas do diskutohej në Byro për të vepruar më tej" (Alia, 2010, p.257). Kjo nismë radikale u justifikua me prapambetjen që karakterizonte shoqërinë shqiptare, sidomos për çështjen e emancipimit të gruas.

Por në fakt, si në Shqipëri ashtu edhe në Kinë, liderët politikë ndanin të njëjta arsye, frikën e një ndikimi më të madh të Konfucit në Kinë dhe klerit në Shqipëri kundrejt pushtetit të diktatorit. Spartak Ngjela pohon në kujtimet e ti se "jetojmë në një kohë kur qe bërë e ditur nga Shopenhaueri, se frika e vdekjes është fillimi i filozofisë dhe martiri i fundit i religjionit. Pra ti mund të ushtrosh terror për të ngjallur frikën e vdekjes, por kjo edhe mund të strehohet ose në filozofi, ose në praktikimin e fesë" (Ngjela, 2011, p. 315) Lufta kundër filozofisë dhe fesë ecën paralel me njëra - tjetrën.

Shqiptarët dhe kinezët duket se kishin shpallur hapur ndryshimin e pikëpamjeve të tyre për çështjet e politikës së jashtme që në fillim të viteve '70, megjithatë mosmarrëveshjet mes Tiranës dhe Pekinit

dolën në pah pas vdekjes së Mao Ce Dunit, në shtator 1976. Byroja Politike shqiptare nuk ishte dakord me zgjerimin e marrëdhënieve diplomatike dhe tregtare të Kinës me Perëndimin, një politikë e ndryshme nga ajo që ishte ndjekur deri në atë kohë në Kinë. Meqenëse vinte në kuadrin e Revolucionit Kulturor, E. Hoxha i frikësohej një kërkese të tillë edhe në Shqipëri, pasi në shoqërinë shqiptare kishte elementë të cilët kërkonin "masa më zbutëse brenda vendit dhe kontakte më të gjera me botën e jashtme." (AQSH, 1978, D.330).

Në këtë kuadër shoqëria shqiptare përjetoi një politikë të shkurtër liberale si në ekonomi, kulturë apo art. Regjimi zbuti kontrollin ndaj rinisë dhe kundërshtarëve duke iu dhënë burokratëve më tepër liri në administrimin e ekonomisë. Hoxha e shihte Maon në të njëjtat pozita që ishte edhe vetë. Ata të dy ishin "dy vullnete të sëmurë që e kishin gjetur në beh shoqërinë që drejtonin, kishin qenë të detyruar të merrnin pjesë në një luftë kundër karakterit mesjetar që dominonte në të dy vendet por nuk kishin garantuar pushtetin personal" (Ngjela, 2011, p. 303). Kjo ishte dilema, e cila u zgjidh për të dy liderët komunistë në 1966, kohë kur në Kinë filloi Revolucioni Kulturor, i cili u pasqyrua edhe në shoqërinë shqiptare.

Masa të ashpra u morën edhe në ushtri duke hequr grada ushtarake dhe duke i detyruar ushtarakët të kontribuonin në ndërtimin e socializmit, por këtë herë me punë të rëndë fizike. Qëllimi i këtyre nismave konsistonte në forcimin e rolit të PPSH-së në ushtri duke zvogëluar rolin e forcave ushtarake në politikën shqiptare në kurriz të profesionalizmit të tyre. Për të kuptuar më mirë ndryshimet e ndodhura si në shoqërinë kineze dhe atë shqiptare , le t'i referohemi E. Biberajt i cili pohon se këto nisma nuk ishin identike, por relative. "Edhe pse qeveria shqiptare dukej sikur adaptoi nismat kineze në ushtri, qeveria kineze nuk ushtroi ndonjë presion të drejtpërdrejtë mbi forcat e armatosura shqiptare" (Biberaj, 1986, p. 66). Duket se udhëheqja shqiptare u shqetësua nga kërkesat e oficerëve të lartë me në krye ministrin e mbrojtjes B. Ballukun, të cilët kërkuan anullimin e reformave që u morën në fushën ushtarake gjatë Revolucionit Kulturor në Shqipëri. Ndër të tjera, ministri i mbrojtjes kërkoi kufizimin e pushtetit të komisarëve politikë që ishin caktuar për përgatitjen ideologjike dhe për aktivitetet jo ushtarake. "Kuadrot e Partisë e panë me dyshim pakësimin e kontrollit në shumë reparte, mungesën e programit të përgatitjes ideologjike dhe përpjekjet e një numri të madh oficerësh, veçanërisht të rangjeve të larta, për të dobësuar rolin e partisë në planet dhe operacionet ushtarake" (AQSH, 1978, D. 330).

Konflikti konsistonte në faktin se vetë E. Hoxha kishte vënë theksin në konceptin e një lufte popullore, e cila, sipas kuadrove ushtarake, mund të realizohej në qoftë se krijohej një ushtri profesioniste, e organizuar dhe e armatosur me mjete moderne. "Hoxha dhe shokët e tij e kundërshtuan një pikëpamje të tillë sepse kishin frikë se një ushtri profesioniste do të shndërrohej në një korpus politik aktiv, i vështirë për t'u kontrolluar nga Partia" (AQSH, 1978, D. 330). Revolucioni solli vështirësi në menaxhimin e ngjarjeve në shoqërinë shqiptare dhe atë kineze. Në mendimin e disa autorëve të huaj, Mao me kalimin e viteve duket se e humbi kontrollin mbi Revolucionin për shkak të përmasave që ai mori, situatave që nuk i kishte parashikuar dhe kaosin e madh që përfshiu shoqërinë kineze. Madje udhëheqja shqiptare deklaroi në vitin 1977 se "Revolucioni Kulturor nuk ia arriti qëllimit; Mao u tërhoq sepse ose nuk qe i aftë, ose u tremb nga pasojat e thella" (AQSH, 1977, D. 3). Në këtë kuadër

fajësohet edhe Cu En Lai, i cili akuzohet si i djathtë dhe njeri i kompromiseve. Të gjitha këto deklarata vijnë pas sulmit që iu bë Partisë Komuniste Kineze në Kongresin e Shtatë të PPSH-së. Megjithatë Revolucioni Kulturor ishte i mbushur me kritika, sulme dhe anarki politike duke ndikuar në përshkallëzimin e dhunës në Kinë. "Mao kishte hapur kutinë e Pandorës. Disa kanë pohuar se pas ca kohësh ai u pendua për llahtarin që kishte ndërsyer, por atëherë ishte shumë vonë." (T. Rong, 2012, p. 21)

Si Mao ashtu edhe E. Hoxha ishin dy tiranë, të cilët përdorën çdo lloj mjeti për të garantuar pushtetin e tyre. Duke parë në profilet e tyre mund të kuptojmë që kishin histori të ngjashme. Mao ishte një njeri i ditur, filozof dhe kishte udhëhequr vendin në luftë për çlirim duke i veshur vetes një emër të njohur në mbarë botën. Ndërsa E. Hoxha ishte udhëheqësi i një vendi të vogël, i cili kishte ardhur në pushtet me ndihmën e Jugosllavisë, kishte krijuar një parti të bindur ndaj tij dhe kishte organizuar një shtet stalinist nën pushtetin e plotë të urdhrave të tij. Në qoftë se në Byronë Politike shqiptare nënshtrimi ishte një kriter përzgjedhës, duket se kjo nuk funksiononte në Kinë, sepse bashkëpunëtorët e Maos kishin patur më tepër liri individuale. Madje vetë Hoxha ishte shprehurse "Maoja ka gabuar që u ka dhënë kompetenca individuale bashkëpunëtorëve" (Ngjela, 2011, p. 339).

Të dy vendet ishin vende ideologjike dhe totalitare dhe dominoheshin nga kultet e dy njerëzve të cilët kishin ardhur në pushtet nga dhuna e kryengritjeve dhe kërkonin të vazhdonin të qeverisnin në një kohë kur revolucioni ishte ëndërr e ideologjive dominuese të kohës. Në Shqipëri u praktikua një lloj komunizmi kombëtar por në këtë rast "nacionalizmi u përdor për të forcuar komunizmin" (Prifti, 1999, p.19) dhe kjo u duk në rëndësinë që i kushtoi udhëheqja shqiptare nacionalizmit. Gjatë viteve 1965 – 1970 qeveria shqiptare inkurajoi tema kombëtare të cilat u reflektuan në letërsi, art, folklor etj. duke shpalosur heroizmin, vetësakrifikimin dhe lirinë. Me të njëjtin intensitet u trajtua edhe epoka skënderbegiane, duke bërë analogji mes luftës kundër turqve dhe luftës kundër "revizionizmit dhe imperializmit".

Të dy sistemet kishin nevojë për liberalizim, por si Mao ashtu edhe E. Hoxha kërkonin të kundërtën. Mao krijoi një revolucion invers sepse donte të ruante kultin e tij të individit dhe për këtë i duhej misticizmi mesjetar. Për 10 vitet e Revolucionit Kulturor Kinez ai ia arriti qëllimit. Edhe pse E. Hoxha nuk e quajti Revolucion Kulturor lëvizjen që përfshiu Shqipërinë, padyshim që ishte pothuajse e njëjta situatë. Duke i justifikuar të gjitha veprimet e tij me luftën ndaj ideologjisë borgjeze dhe zakoneve prapanike të kohës, E. Hoxha nënkuptoi se fryma liberale dhe kultura perëndimore nuk ishin të mirëpritura në Shqipëri. Revolucioni Kulturor Kinez dhe fitorja e Maos e bindën liderin shqiptar se pushteti duhej të mbahej me anë të forcës, dhunës dhe spastrimeve të shumta.

**Përfundime**

Pas prishjes me BRSS-në, Shqipëria përjetoi një periudhë të shkurtër "liberalizimi" dhe kjo erdhi si rezultat i pamundësisë dhe indiferentizmit të Hoxhës për të ndërhyrë. Jeta aktive në rrethet artistike, në TOB, në Teatrin Popullor, në Kinostudion "Shqipëria e Re" dhe nëpër të gjitha rrethet intelektuale tregonin për një dukje deri në gjetjen e rrugës së duhur. Dukej sikur lideri komunist shqiptar i lejoi të gjitha këto shfaqje deri sa të gjente një shtyllë ku të mbështetej, por tashmë më fuqishëm se më parë. Kina ishte një aleat i fuqishëm dhe përfaqësonte të njëjtat pikëpamje ideologjike dhe politike me Shqipërinë. Të

dy vendet përjetuan një përvojë revolucionare gjatë viteve të Revolucionit Kulturor. Sipas ideologjisë së kohës dhe elitës politike, kjo lëvizje revolucionare ishte e domosdoshme sepse në këtë mënyrë parandalohej "revizionizmi" dhe kapitalizmi. Në qoftë se bëjmë analizimin e situatave të ndodhura në vitet '70 në Shqipëri, del në pah e njëjta situatë që kishte përfshirë edhe Kinën komuniste. Shumë studiues shqiptarë dhe të huaj janë të bindur se "lëvizjet revolucionare" të ndërmarra në Shqipëri u frymëzuan nga Revolucioni Kulturor Kinez dhe në shumë raste ato ishin kopje të tij. Të njëjtin mendim ndajmë edhe ne kur i referohemi luftës ndaj burokracisë, borgjezisë, luftës së klasave apo luftës ndaj titullarëve.

Duke eleminuar barrierat ndërmjet intelektualëve dhe masës, Revolucioni Kulturor synonte "barazitizmin", një nismë e cila ndikoi negativisht në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë duke sjellë mungesë të iniciativës në punë. Spastrimet përfaqësonin një fushatë të egër si në shoqërinë kineze edhe në atë shqiptare. Viktimat kryesore ishin në radhët e titullarëve si Beqir Balluku, Petrit Dume, shefi i shtabit të ushtrisë dhe Hito Cako, shef i Drejtorisë Politike të Ministrisë së Mbrojtjes, "grupi armiqësor i ekonomisë" në krye të të cilit ishte Koço Theodhosi dhe Abdyl Këllezi dhe shumë figura të tjera. Këmbëngulja dhe forca me të cilën Hoxha dhe Mao bënë spastrimet e Partisë, shtetit dhe udhëheqësve të organizatave shoqërore, dëshmuan për seriozitetin me të cilin ata panë dhe vlerësuan kundështarët e tyre. Të dy liderët provuan se politika dhe regjimet e tyre mbetën të pandryshuara.

Si përfundim, të gjithë ata që u hoqën nga organet e larta të Partisë kishin poste me përgjegjësi në fushën e kulturës, ushtrisë dhe ekonomisë. Në tetor të 1975 në Shqipëri u mendua për një reformim të Kushtetutës. Teksi përfundimtar nuk ishte gjë tjetër veçse testament politik i E.Hoxhës që garantonte rrugën e komunizmit në vend. Në bazë të këtij testamenti përcaktohej vija politike, zhvillimi i ekonomisë me "forcat tona" duke i prerë rrugën çdo lëvizjeje liberale në vend. Pas vdekjes së Maos, situata politike në Pekin mori rrjedhë të re. E. Hoxha ose duhej të përshtatej me ndryshimet që nisi Hua Kuo Feni (pasardhësi i Maos), duke e futur vendin në një epokë të re demokratizimi, ose të vazhdonte politikën e ndjekur deri në atë kohë. Kongresi i Shtatë i Partisë e zgjidhi dilemën e Hoxhës, i cili vazhdoi spastrimet brenda Partisë, por njëkohësisht doli hapur kundër Kinës komuniste. Ai e akuzoi për "devijim të marksizëm – leninizmit", por mbi të gjitha nuk e miratoi politikën e brendshme dhe të jashtme që po ndiqej në Kinë. Hapja kino – amerikane e shqetësoi Hoxhën, i cili kritikoi njëkohësisht edhe bashkëpunimin ekonomik të Kinës me firmat kapitaliste amerikane, duke ndaluar në këtë mënyrë çdo lloj nisme kapitaliste edhe në Shqipëri. Shkëputja zyrtare u njoftua nga diplomatët në Pekin, të cilët në korrik të 1978 lajmëruan ndërprejen e të gjitha ndihmave ekonomike dhe teknike ndaj Shqipërisë.

**Bibliografi e shfrytëzuar**

***Burime arkivore:***

AQSH, F 14, V 1968, D 319
AQSH, F 14, V 1974, D 11
AQSH, F 14, V 1977, D 3
AQSH, F 14, V 1978, D 330

***Literaturë***

Alia, R. (2010). *Jeta ime*, Kujtime, Tiranë, Botimet Toena.

Biberaj, E. (1986) . *Albania and China, A study of an Unequal Alliance*, USA: Westview Press/ Boulder and London.

Ngjela, S. (2011). *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare 1957 – 2010*, Tiranë, UET press.

Prifti, P. (1999). *Remote Albania, The politic of isolation*, Tiranë, Onufri

Rong, T. (2012). *Ten Ciao Pin dhe Revolucioni Kulturor*, Tiranë, Shtëpia Botuese 55.

# BESIMI NË NEOLIT NË SHQIPËRI

**DORIAN KALLANXHI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Në grupin e artefakteve të epokës neolitike krahas kategorisë të objekteve si vegla pune, sende luksi, stoli, qeramikë etj, një rëndësi të veçantë kanë një kategori gjetjesh të cilësuara si objekte kulti. Në Ballkan ky fenomen është ekskluziv për neolitin ( 6500-3500 ) ku figurinat shfaqen nga vendbanimi më i hershëm në shoqëritë e punuesve të qeramikës dhe fermerëve dhe zhduket pa e kuptuar në fundin e mënyrës neolitike të jetesës, për të rifilluar në epokën e bronzit.

Në territorin e Ballkanit janë bërë studime për këto figurina nga arkeologë si D.Bailey, Milojkoviç mbi figurinat e neolitit të vonë në kulturën e Vinçës në Opovo Serbi, Vajsov mbi figurinat e kulturës Hamangia në veri të Bullgarisë dhe në jug të Rumanisë, Peter Biehl mbi figurat antropomorfe të kulturës Gradeshnitsa në veriperëndim të Bullgarisë.

Në Shqipëri nuk ekziston një studim apo një monografi mbi ato që konsiderohen deri më sot si objekte kulti. Arkeologët shqiptarë vetëm sa i kanë përmendur ato si objekte me funksion religjoz , u kanë bërë një përshkrim, por kurrë një studim të thelluar për të kategorizuar ose krijuar një tipologji, të hedhin dritë mbi funksionet e tyre dhe marrëdhëniet që ekzistonin në shoqërinë neolitike. Pra, krijimi i një tipologjie mbi objektet e kultit dhe përcaktimi i funksioneve të tyre do të jetë në fokus të këtij punimi.

Një tjetër objektiv që synon të arrijë ky punim, është të zbulojë se pse ato gjenden të thyera; pse skeletet e gjetura kanë karakter religjioz; ndryshimet që kanë ato nga homologet e tyre në Ballkan, por edhe ngjashmëritë; krijimi i figurinave zoomorfe dhe vendi i kafshëve në panteonin e perëndive neolitike.

Metodat e përdorura janë metodat e marrjes, matjes, analizimit të kontekstit nga vijnë, vizatimit dhe çdo gjë që mund të kryhet në laborator për arritjen e qëllimeve të këtij studimi. Metoda e dytë është shfrytëzimi i literaturës ekzistuese mbi këtë kategori objektesh, vendase dhe të huaj. Metoda të tjera janë ato të induksionit, deduksionit, analogjisë.

Në përfundim të këtij puynimi do të arrijmë të krijojmë tipologji mbi objektet e kultit të epokës neolitike, të arrijmë në disa përfundime të prekshme rreth funksioneve të tyre, nëse janë vërtet objekte apo figurina me karakter religjioz.

Sipas mendimit tonë, çdo objekt antroporf dhe zoomorf duhet studiuar dhe analizuar në bazë të kontekstit nga vjen, nëse vjen nga një kontekst funerar apo nga territori i banesave. Këto figurina mund të kenë luajtur funksionin e kukullave, lodrave për fëmijë, aksesorëve magjikë, aksesorëve për në botën e përtejme, figura mbi fertilitetin, talizmanë ose hajmali, figurina rituale, konkubina, skllave ose objekte për të sjellë fat dhe shëndet.

**Fjalë çelës:** *besim , neolit, artefakt, objekt kulti, tipologji*

**Abstract**

The group of Neolithic artifacts category alongside objects as tools, luxury items , jewelry, pottery , etc. , special attention findings have a category defined as cult objects .

In the Balkans , this phenomenon is exclusive to the Neolithic (6500-3500) where smileys appear from early settlement to the societies of working people and farmers ceramic and disappear without realizing at the end of the Neolithic lifestyle manner, to resume the Bronze Age .

Balkan territory for these figurines studies have been conducted by archaeologists as D.Bailey , Milojkovic on the Late Neolithic culture in Opovo Serbia Vinces , Vajsov on smileys Hamangia culture in northern Bulgaria and southern Romania , Peter Biehl on anthropomorphic figures Gradeshnitsa culture in northwest Bulgaria .

In Albania there isn't a study or a monograph on what are considered to date as cult objects . Albanian archaeologists have only mentioned them as objects of function by religion , they have made a description but never an in-depth study to categorize or create a typology , to shed light on their functions and relations that exist in the Neolithic society . So,the creation of a typology on the cult objects and determine their functions ëill be the focus of this study .

Another objective that aims to achieve this study is to find out why they are bent . Why have found skeletons of a religious character ? Changes that have them from their counterparts in the Balkans but also similarities . Creating zoomorphic figurines and place in the pantheon of gods, animals Neolithic .

Methods used are methods of making, measuring , analyzing the context of origin , drawing , and anything that can be performed in the laboratory to achieve the aims of this study . The second method is the exploitation of the existing literature on this category of objects , domestic and foreign. Other methods are those of induction , deduction , analogy .

At the conclusion of this paper can achieve to create objects of cult typology on the Neolithic era , to achieve some tangible conclusions about their functions , or facilities or smileys are really religious character .

In our opinion every object antroporf and zoomorphic have studied and analyzed on the basis of context comes from, whether it comes from a Funerar context , or from the territory of flats . These figurines may have played puppet function , toys for children , magic accessories , accessories for the hereafter , figures on fertility , talizmane or talisman, ritual figurines , concubines , slaves or objects to bring luck and health .

**Keywords**: *belief, Neolithic, artifact, object of worship, typology*

Gjatë fillimit të punës së tij në Shqipëri, arkeologu francez Leon Rey, do të theksonte se nuk do të bëjmë kurrë në këtë vend korrje dokumentesh kaq me bollëk sa në Maqedoni... dhe se materialet para kohës së bronzit do të jenë gjithnjë të pamjaftueshme ( Rey, 1937). Në fakt në këtë kohë konstatimet e Leon Rey ishin të sakta. Situata do të ndryshonte pas çlirimit të vendit, ngritjes së Institutit të Arkeologjisë dhe ndërmarjes së fushatave të gërmimit sistematik në të gjithë hapsirën e vendit tonë. Kështu në periudhën nga vitet '50 të shekullit XX e deri më sot harta arkeologjike e vendit tonë është pasuruar me shumë vendbanime neolitike në pothuajse të gjithë hapësiren e vendit.

Në grupin e artefakteve të kësaj epoke krahas kategorisë së objekteve si vegla pune, sende luksi, stoli, qeramikë etj., një

rëndësi të veçantë kanë një kategori gjetjesh të cilësuara si objekte kulti. Por në Ballkan ky fenomen është ekskluziv për neolitin ( 6500-3500 ) ku figurinat shfaqen nga vendbanimi më i hershëm në shoqëritë e punuesve të qeramikës dhe fermerëve dhe zhduken pa e kuptuar në fundin e mënyrës neolitike të jetesës, për të rifilluar në epokën e bronzit (Bailey , 2005).

Në territorin e Ballkanit janë bërë studime për këto figurina nga arkeologë si D.Bailey, Milojkoviç mbi figurinat e neolitit të vonë në kulturën e Vinçës në Opovo Serbi, Vajsov mbi figurinat e kulturës Hamangia në veri të Bullgarisë dhe në jug të Rumanisë, Peter Biehl mbi figurat antropomorfe të kulturës Gradeshnitsa në veriperëndim të Bullgarisë. (Bailey , 2005, pp. 13-14).

Në Shqipëri nuk ekziston një studim apo një monografi mbi ato që konsiderohen deri më sot si objekte kulti. Arkeologët shqiptarë vetëm sa i kanë përmendur ato si objekte me funksion religjoz , u kanë bërë një përshkrim, por kurrë një studim të thelluar për të kategorizuar ose krijuar një tipologji, të hedhin dritë mbi funksionet e tyre dhe marrëdhëniet që ekzistonin në shoqërinë neolitike. Pra, krijimi i një tipologjie mbi objektet e kultit dhe përcaktimi i funksioneve të tyre do të jetë në fokus të këtij punimi.

Duhet theksuar se në të tri periudhat e epokës neolitike, janë të pranishme objektet e quajtura si objekte kulti. Në periudhën e neolitit të hershëm në kategorinë e objekteve të kultit futen figurinat antropomorfe steatopigjike, tavolinat e kultit, figurinat zoomorfe, 3 skelete, 1 pintaderë dhe 3 gozhdë prej balte.

Në periudhën e neolitit të mesëm objektet me karakter religjoz shtohen në numër, por edhe në lloje. Në këtë periudhë në këtë kategori futen figurinat antropomorfe, enët antropomorfe, ritonet, terrakotat zoomorfe dhe 2 skelete.

Në periudhën e neolitit të vonë në objektet me karakter fetar bëjnë pjesë enët antropomorfe, vazo kulti, figurina antropomorfe, tavolina kulti, ritone. Në këtë periudhë nuk kemi gjetjen e ndonjë skeleti që të ketë karakter religjoz.

Duhet theksuar se këto objekte nuk janë gjetur në të gjitha vendbanimet e epokës neolitike. Kështu në periudhën e neolitit të hershëm nuk janë gjetur objekte kulti në sitet e Vlushës, Cetushi I, Blazi I, Nezirit, Katundas I. Në periudhën e neolitit të mesëm kemi disa vendbanime, ku nuk janë gjetur objekte kulti që janë : Katundas II, Treni I, Blazi II, Neziri II. Blazi III, Barçi II, Maliq I, Katundas III, Velça, Konispol IIIC ,që janë edhe vendbanime të periudhës së neolitit të vonë pa gjetje të kategorisë së objekteve të quajtura objekte kulti.

Në periudhën e neolitit të hershëm figurinat antropomorfe steatopigjike na vijnë nga sitet e Podgories, Vashtëmisë dhe Barçit. Figurinat steatopigjike të Podgories ndodhen në pozicion vertikal, me kokë e qafë cilindrike, tors plloçak, pa krahë dhe me vithe të zmadhuara (Korkuti, 2002). Në Vashtëmi janë zbuluar 15 figurina antropomorfe. Nga këto figurina asnjëra nuk është e plotë por janë të thyera. Ato janë bërë me argjilë me përzierje rëre të imët dhe janë të pjekura mirë. Figurinat e Vashtëmisë janë në këmbë, torsi është petashuq, i shkurtër e në porcione më të vogla se këmbët, gjiri është paraqitur nga thimtha konike, supet janë të ngushta e të varura, qafa cilindrike ose konike me bazë të gjerë poshtë, koka ka formë cilindrike, ku në kokë jepen sytë dhe hunda. Kofshët dhe vithet janë të zmadhuara, kurse këmbët e ngjitura (Korkuti, 2002). Figurinat antropomorfe të gjetura në vendbanimin e Barçit janë në pozicion vertikal dhe kanë qafë e kokë cilindrike, ku në kokë paraqitet hunda në formë sqepi (Iliria, 1983, p.244).

Dy figurina steatopigjike të periudhës së neolitit të hershëm janë zbuluar në Rrajcë të Librazhdit. Nga ato sa thamë më sipër, mund të konkludojmë se figurinat antropomorfe të neolitit të hershëm janë në pozicion vertikal, me qafë e kokë cilindrike ose konike në disa raste, torsi është plloçak ose petashuq, pa krahë dhe gjinjtë jepen me dy thimtha konike në tors. Vithet janë të zmadhuara dhe këmbët janë të bashkuara më njëra-tjetrën. Në kokë paraqiten sytë dhe hunda. Pra paraqitja e trupit në periudhën e neolitit të hershëm është jo shumë ekspresive. Trupi paraqitet në pozicion vertikal dhe pa duar, këmbë të bashkuara, pra shumë i ngurtë.

Një kategori tjetër objektesh janë ato që quhen figurina zoomorfe dhe paraqesin figura kafshësh. Objekte të tilla janë gjetur në Podgori, Vashtëmi, Kolsh, Rrajcë. Figurinat zoomorfe të Podgories janë mjaft të dëmtuara gjë që nuk na mundëson rindërtimin e tyre. Ndër dy terrakotat zoomorfe të zbuluara në Vashtëmi njëra paraqet kokën e një bagëtie të imët, kurse tjetra paraqet kokën dhe qafën e një qeni (Korkuti, 2002). Në Kolsh të Kukësit janë zbuluar 2 terrakota zoomorfe të papërcaktura, pra nuk dihet çfarë kafshe përfaqësojnë. Tre figurina zoomorfe janë zbuluar në Rrajcë të Librazhdit (Gjipali, 1987).

Siç e shohim në të gjitha vendbanimet jepen figurina kafshësh prej balte që paraqesin kryesisht kafshë shtëpiake. Pra ato janë figura që bashkëjetojnë me banorët neolitikë, por në vendbanime të ndryshme vlerësohen kafshë të ndryshme.

Kategoria e objekteve që janë gjetur me shumicë në vendbanimet e kësaj periudhe janë objektet e quajtura tavolina kulti ose altarë. Të tilla janë zbuluar pothuajse në të gjitha vendbanimet e kësaj periudhe, ku janë gjetur objekte kulti. Vendbanimet ku janë gjetur tavolina kulti janë Podgoria, Barç, Vashtëmi, Kolsh, Burim, Rrajcë. Duhet theksuar se tavolinat e kultit të Vashtëmisë, Barçit, Podgories, janë të ngjashme me njëra-tjetrën, kurse tavolinat e gjetura në Burim, janë të ngjashme me tavolinat e Kolshit në Kukës. Pra siç e shohim kemi edhe diferencime rajonale në mënyrën e bërjes së tavolinave të kultit ose altarëve. Shumica e tavolinave janë të fragmentuara gjë që nuk na jep mundësinë e rindërtimit të plotë të tyre. Format kryesore të tavolinave janë rrumbullake, sferike ose katër-këndëshe, me sipërfaqe të sheshtë ose të ngritur. Disa tavolina janë të hapura në qendër ose kanë një ngritje në formë cilindrike në qendër. Përsa u përket këmbëve të tryezave ato janë të shkurtra, të thjeshta e pa zbukurime, me forma konike ose prizmatike. Tavolinat zbukurohen me incizim.

Ndër objektet e kultit futen edhe tre skelete të zbuluara në Podgorie. Ato janë gjetur në truallin e banimit. Pozicioni i vendosjes së tyre, është pozicion fjetjeje me këmbë të mbledhura. Varri është me gropë të thjeshtë dhe në të nuk është zbuluar asnjë objekt, pra varri është pa inventar. Sipas Muzafer Korkutit flijimi në truallin e banesës i kushtohet mbarësisë së jetës së vetë banorëve neolitikë (Korkuti, 2002). Ky zakon i vendosjes a flijimit të fëmijëve apo të rriturve në ambientin e banimit është i njohur edhe nga kulturat e tjera bashkëkohëse në Ballkan (Garasanin,1937, pp.30-74).

Ndër objektet e kultit të periudhës së neolitit të hershëm bëjnë pjesë dhe një pintaderë dhe tre gozhdë prej balte. Pintadera ka trup konik të shkurtër, bazë të rrumbullakët, dhe motiv zbukurimi me rozeta dhe dy rrathë koncentrike (Korkuti, 2002). Përsa i përket pintaderës mendohet se ajo mund të ketë shërbyer edhe si një lodër për fëmijët.

Në neolitin e mesëm krahas objekteve të përdorura në periudhën e hershme,

shfaqen një kategori objektesh që janë karakteristike vetëm për këtë periudhë, dhe quhen ritone. Ritonet na vijnë nga pothuajse të gjitha sitet e periudhës së neolitit të mesëm. Ritonet e fazës Dunavec I janë me shumicë, por nga ato nuk kemi asnjë fragment të plotë por vetëm pjesë të ritonit të fragmentuara. Më i ploti ndër ta është i përbërë nga një qeramikë e punuar mirë, me parete mesatare, e ngjyrë të zezë. Ritoni ruhet në lartësi 15.5 cm. Përsa i përket formës së tij, ai ka një formë sferike jo shumë të rregullt, me diametër 1.4 cm. Përsa u përket këmbëve, ato janë të shkurtra e të trasha, me përkulje të lehtë në pjesën e gjunjëve, dhe mbaron me shputë të drejtë. Në pjesën e sipërme ritoni ka një vegjë unazore (Korkuti, 2002). Edhe ritonet e fazës Dunavec II janë të ngjashme me ato të fazës Dunavec I. Trupi i ritoneve të fazës Dunavec II është i ngjashëm me ato të fazës paraardhëse. Këmbët e ritoneve janë të trasha e të shkurtra, me forma konike ose cilindrike. Këmbët përfundojnë me shputë të sheshtë ose me majë. Ritonet që vijnë nga shtresa stratigrafike Podgorie II janë të pakta në numër dhe kanë të njejtat karakteristika si ato të Dunavec I dhe II. Duhet thënë se këmbët e ritoneve të Podgories II kanë më së shumti formë konike. Karakteristike për ritonet e Cakranit është forma pak a shumë sferike e trupit, gryka anësore e prerë pjerrtas. Në pjesën e sipërme ritonet kanë një vegjë unazore. Këmbët e ritoneve janë të trasha, me forma konike masive ose në formë shishe të përmbysur, me trashësi më të madhe në pjesën e sipërme. Ato përfundojnë me fund të sheshtë ose me majë. Përsa u takon ritoneve të vendbanimit të Kolshit, me shtresën stratigrafike Kolsh II, ato janë të ngjashme me ritonet e Dunavecit dhe Cakranit. Këmbët janë me forme konike të zgjatur vetëm se mbarojnë me fund të rrumbullakosur përgjithësisht (Korkuti, 2002).

Përsa i përket kategorisë së objekteve të quajtura tavolina kulti ose altarë, ato janë shumë të pakta në këtë periudhë. Ato janë zbuluar vetëm në vendbanimet e neolitit të mesëm të Shqipërisë Lindore, që janë Cetushi dhe Blazi, me shtresat kulturore Cetush II dhe Blaz III. Fragmentet janë shumë të dëmtuara dhe vetëm një fragment është i ruajtur më mirë së bashku më një pjesë të syprinës. Qeramika është ngjyrë kafe dhe e zbukuruar me incizim me motivin e brazave të trekëndshave të mbushur me vija ( Po aty,p.186).

Ashtu si edhe në periudhën e neolitit të hershëm, në vendbanimin e Podgories, edhe në periudhën e neolitit të mesëm, në vendbanimin e Cakranit, kemi zbulimin e dy skeleteve të kategorizuara si objekte kulti. Kjo për arsye se ato nuk janë zbuluar në ndonjë nekropol por në ambientin e banimit. Skeleti i parë është në pozicion fjetjeje, mbështetet në krah të majtë me njërën dorë të shtrirë e tjetrën mbi bark. Këmbët janë plotësisht të mbledhura. Skeleti i dytë ndodhet në të njëjtën thellësi me skeletin e parë, edhe ky në pozicion fjetjeje me këmbë të mbledhura (Korkuti, 2002).

Në grupin e objekteve të kultit bëjnë pjesë edhe enët antropomorfe. Nga vendbanimi i Dunavecit na vijnë tre fragmente enësh të tilla, ku një është fragment gryke dhe dy janë fragmente buze. Enët antropomorfe të Kolshit na paraqiten me buzë me profile të thjeshta ku poshtë buzëve paraqiten fytyra njeriu në plastik, në reliev janë vetullat, poshtë tyre jepen gropëzat e syve dhe hunda në reliev e theksuar.

Terrakotat antropomorfe të neolitit të mesëm paraqiten të shumta në numër, në forma, në pozicion, ornamentet plastike dhe motivet e zbukurimit. Në vendbanimin e Dunavecit janë zbuluar një

numër i madh terrakotash,që dallohen për format, pozicionin dhe motivet e zbukurimit. Kështu terrakotat paraqiten në këmbë, këmbëkryq ose ulur. Torsi paraqitet plloçak ose tors i thjeshtë petashuq dhe në disa raste na jepet vetëm gjysma e torsit. Supet janë të varura në të gjitha rastet. Krahët herë nuk jepen fare, herë jepen thjesht me dy zgjatime konike, por ka raste kur krahët jepen në pozicione të ndryshme të trupit si mbi bark, poshtë gjirit etj. Në gjoks, me dy thimtha konikë ose cilindrikë paraqiten gjinjtë. Vithet e figurinave janë shumë të zhvilluara. Qafa është cilindrike dhe koka po ashtu. Hera-herës koka nuk veçohet nga qafa. Në kokë jepen sytë, hunda dhe goja, por kjo jo në të gjitha rastet, pasi ka raste kur nuk jepen këto të fundit. Sytë dhe goja paraqiten të bëra me incizim mbi sipërfaqen e kokës, kurse hunda me forma të ndryshme zhvillohet në kokë. Lartësia e këtyre figurinave ndryshon nga njëra-tjetra, ku ajo fillon nga 3.4 cm deri në 8.5 cm më e madhja. Zbukurimi kryhet me incizim, i cili kryhet në pjesë të ndryshme të trupit , si në gjoks, kofshë, kokë. Motivet e zbukurimit janë telat me gjemba, vija vertikale, pikëza, kurorë etj.

Edhe terrakotat e shtresës Dunavec II paraqiten të pasura përsa i takon formave, pozi-cioneve dhe motiveve. Ato jepen në pozicione të ndryshme, si: në pozicion vertikal në këmbë, ulur këmbëkryq, ulur në gjunjë ose në stol. Torsi paraqitet i sheshtë, petashuq, plloçak, në disa raste pak i zgavruar nga brenda dhe në formë kolone cilindrike. Krahët nuk janë aq të zhvilluara sa në fazën Dunavec I dhe në rastet kur figurinat kanë krahë ato janë të thjeshta e paraqiten nga dy thimtha konike. Gjoksi paraqitet me dy thimtha konike. Në disa nga këto figurina, me disa thimtha paraqitet organi gjenital ose kërthiza. Vithet janë mjaft të zhvilluara mbrapa sa hera-herës kur figurina është ulur formojnë një bazë të sheshtë, së bashku me këmbët. Në kokë paraqiten sytë, hunda dhe goja e terrakotës. Në disa raste jepen edhe vetullat.

Edhe në shtresën Podgorie II të neolitit të mesëm, kemi disa terrakota antropomorfe të thjeshta, me kokë cilindrike e hundë në formë sqepi. Zbukurimi kryhet me incizim.

Një tjetër vendbanim me antropomorfikë të pasur është Cakrani në Ultësirën Perëndimore. Figurinat antropomorfe të Cakranit janë të fragmentuara dhe hera-herës paraqitet vetëm koka, herë vetëm trupi me qafën. Një nga figurinat paraqet një grua këmbëkryq me tors plloçak, supe horizontale me një rrumbullakim në pjesën e sipërme të krahut, ku krahu i majtë është i përthyer në bërryl e është i vendosur mbi gjoks. Figurina tjetër paraqet torsin plloçak, supet e varura dhe gjinjtë me dy thimtha konikë. Një tjetër figurinë përfaqësuese e Cakranit është një kokë gruaje në formë shtyllëze në të cilën paraqiten sytë, hunda dhe mjekra dhe me një vijë horizontale goja. Flokët paraqiten me vija të incizuara. Themi se kemi të bëjmë me një figurë femërore, pasi poshtë mjekrës jepet njëri nga gjinjtë. Një tjetër figurinë është në pozicion ulur këmbëkryq, këmbët janë të hedhura mbi njëra-tjetrën, ku e majta është mbi të djathtën e vithet e gjera anash formojnë një bazamet të sheshtë katror 6 cm të gjerë.

Për Shqipërinë Verilindore, në ndihmë na vjen antropomorfika e Kolshit, me shtresën Kolsh II për periudhën e neolitit të mesëm. Argjila me të cilën ato janë punuar është e pastër dhe e përzierë me pak rërë të imët. Midis figurinave ka të tilla që janë steatopigjike dhe të tjera josteatopigjike. Një nga figurinat paraqet vetëm gjysmën e majtë dhe është tipike steatopigjike me tors cilindrik të shtypur dhe të shkurtër, thithma të vegjël për të treguar gjinjtë,

vithet mjaft të zhvilluara, këmbë cilindrike që mbarojnë me një bazament të vogël. Ka figurina të tjera që jepet vetëm koka.

Përveç terrakotave antropomorfe, në periudhën e neolitit të mesëm, tipike janë edhe terrakotat zoomorfe. Dy të tilla janë zbuluar edhe në Dunavec. Të dyja janë të fragmentuara, pra asnjëra nuk është e plotë. E para paraqet kokën e një gjedhi të trashë, me mundësi në dem, së bashku me një fragment të shputës së këmbës së po kësaj terrakote. Fragmenti tjetër paraqet kokën e një demi. Edhe në shtresën Kolsh II janë gjetur 6 fragmente figurinash zoomorfe. Pjesa më e madhe paraqet fragmente kokash derri.

Në periudhën e fundit të neolitit, atë të neolitit të vonë, objektet të cilat cilësohen si objekte kulti, pakësohen shumë, për të mos thënë zhduken. Në Dërsnik kemi disa kategori objektesh si tryeza me katër këmbë, me syprinë të thjeshtë të zbukuruar me vija zigzake e të lyer me bojë të kuqe.

Një figurinë antropomorfe është një tjetër objekt që na vjen nga Dërsniku. Ajo paraqitet me tors plloçak të shkurtër e pa krahë.

Vendbanimi i Kamnikut është një tjetër vendbanim ku kemi gjetjen e disa objekteve të kultit. Më kryesoret janë një enë antropomorfe, një vazo kulti dhe një tavolinë kulti me syprine jo të sheshtë. Kategori tjetër janë terrakotat antropomorfe.

Vazoja e kultit ka formën e një këmbaneje me lartësi 30 cm, ajo mbyllet me një pjesë të sheshtë ku të dyja anët dalin anash lart. Ena antropormfe paraqet një tors gruaje, është e lartë 16 cm, ka qafë cilindrike e kokë në formë çallme, me dy thimtha të tejshpuara për varjen e enës, krahë të cunguar e dy thimtha për paraqitjen e gjirit të gruas.

Përsa u takon funksioneve të këtyre objekteve të kulturës material, ka mendime të ndryshme. Në historinë e arkeologjisë sonë ekziston mendimi se këto figurina të shumta grash janë shprehje e kultit të Magna Mater (Korkuti, 2002). Kjo mund të thuhet edhe për figurinat zoomorfe. Në fakt shume analiza të përqendruara në interpretimin e zotave kanë marrë jetë nga Marija Gimbutas (Gimbutas, x,p. 13).

Leroy McDermott dhe Catherine McCoid kanë vënë re ngjashmëri mes formës së figurinave antropomorfe dhe përmasave që një femër duhet të ketë, por ato janë shfaqje figurinash në miniaturë. (McCoid &McDermott, 1996, p.100).

Sipas Morris dhe Paetfield figurinat e neolitit luanin rolin e ndërmjetësit me paraardhësit për të shkuar në botën e përtejme (Morris & Peatfield,2002, p. 110). Pra ato lehtësojnë kalimin e shpirtit nga bota reale në atë të përtejme, sipas besimit të banorëve neolitike për një jetë që ekzistonte përtej asaj tokësore.

Sipas Miodrag Pavloviç, figurinat janë krijime të banorëve që lidhen me diçka që kënaq imagjinatën dhe syrin e banorëve mbi femrat (Pavloviç, x, p. 35).

Sipas mendimit tonë, çdo objekt antroporf dhe zoomorf duhet studiuar dhe analizuar në bazë të kontekstit nga vjen; nëse vjen nga një kontekst funerar, apo nga territori i banesave. Këto figurina mund të kenë luajtur funksionin e kukullave, lodrave për fëmijë, aksesorëve magjikë, aksesorëve për në botën e përtejme, figura mbi fertilitetin, talizmanë ose hajmali, figurina rituale, konkubina, skllave ose objekte për të sjellë fat dhe shëndet.

**Shtojcë**



**Fig.1. Objekte kulti të neolitit të hershëm të Podgories, Vashtëmisë, Barç, Kolsh, Burim, Rrajcë**.

**Fig.2. Objekte kulti të neolitit të mesëm të Dunaveci I, Dunavec II,Podgori II, Cakran, Kolsh II, Cetushi II**



**Fig.3. Objekte të neolitit të vonë të Dërsnikut dhe Kamnikut.**



**Fig.4. Skelet i zbuluar në Podgori, me karakter religjoz, i periudhës së neolitit të hershëm.**



**Fig.5. Skelet i zbuluar në Cakran, me karakter religjoz, i periudhës së neolitit të mesëm**

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Bailey.W. D. (2005). *Prehistoric figurines, Representation and corporeality in the neolithic,* Routledge, Taylor and Founds Group.

Galis, K. (1980). Kansis nekrov apo tin Arhaioteri Neolithki epohi Thesalia, Athinë.

Garasanin ,M. (1979). *Centralnobalkanska Zona, PJZ* II, Neolitsko Doba, Beograd.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1983, "Iliria", 1983, 2.

Gimbutas, M. (X). *The Goddeses and Gods of old Europe 6500-3500 BC, Myths and cult images,* Berkley CA: University of California

Gjipali, I. (1987). Gërmimet e vitit 1987 në Rrajcë, Iliria, 2.

Korkuti, M. (2012). *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri,* ASH, Tiranë.

McCoid, C.H. & McDermott. (1996) *Towards decolonozing gender:female vision in the European upper Paleolithic,* American anthropologist.

Morris, C, & Peatfield (2002). *Feeling through the body: gesture in Cretan Bronze age religion,* I.Hamilakis.
Pavlovic, M. (x). *The aeshtetic of neolithic figurines,* Belgrade: Serbian Academy of sciences.
Rey, L. (1937). *Lettre d'Albanie, Revue international des Etudes Balcaniques III-ene anne,* Tome I.

# INTEGRIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË ZHVILLIMIN SHOQËROR-EKONOMIK RAJONAL DHE LOKAL
# (RASTI I QARKUT TË KORÇËS)

**EDLIRA MENKSHI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Kohët e fundit ndryshimet globale po ndodhin me ritme të shpejta, ndërkohë që ideja e integrimit të kulturës dhe trashëgimisë në zhvillimin shoqëror-ekonomik ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe politikëbërësve.

Deri më tani ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, ka qenë e lidhur me ruajtjen e identitetit, krenarisë dhe pasurisë kombëtare, ndërkohë që integrimi në politika zhvillimi rajonale dhe lokale, shihet si një mundësi mjaft e mirë jo vetëm për ruajtjen e saj, por edhe për kontributin e saj real në zhvillimin e shumë vendeve të botës.

Qarku i Korçës ka një potencial të lartë të trashëgimisë kulturore, që konsiderohet një element i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit kulturor. *Larmia e monumenteve të kulturës, qytetaria dhe mikpritja tradicionale, përbëjnë një tërheqje të fortë për turistët vendas dhe të huaj. Turistët dhe studiuesit e huaj janë mjaft të interesuar për objektet e monumenteve të kulturës së qarkut siç janë: rrënojat e vendbanimeve arkeologjike, tumat (tuma e Kamenicës) dhe kulturën tumulare, varret monumentale, muzetë, banesat dhe objektet e kultit (kishat), pikturat murale, ashtu sikurse për folklorin e pasur, veshjet tradicionale, gastronominë, festat dhe traditat lokale etj.*

Ndonëse zhvillimi i turizmit është në fillesat e tij, është për t'u vlerësuar fakti dhe mundësia, se rritja e turizmit në drejtim të trashëgimisë kulturore, mund të sjellë përfitime të shumta ekonomike dhe shoqërore si rritje e punësimit, rritje e të ardhurave, zbutje e problemeve shoqërore dhe rritje e interestit për mbrojtjen e mjedisit. Bazuar në këtë prirje, u pa e nevojshme që në kuadër të trajtimit të këtij artikulli, të zhvillohen disa anketime për të parë konkretisht se si vlerësohet kjo, nga tri grupet e interesit të lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin e turizmit kulturor.

*Tashmë integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin shoqëror-ekonomik të qarkut, përbën një mundësi reale për zhvillimin e tij, çka duhet të vlerësohet nga hartuesit e politikave të zhvillimit kombëtar, rajonal dhe lokal. Promovimi i saj, si dhe ngritja e infrastrukturës turistike përkatëse, do të ndikojë fuqishëm në rritjen e interesit të turistëve për të vizituar qarkun dhe për rrjedhojë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Duke marrë në konsideratë trashëgiminë kulturore, të ardhurat ekonomike që vijnë nga zhvillimi i turizmit kulturor, rritjen e interesit të turistëve të huaj për zonën, si edhe interesin e popullsisë lokale për ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike, u pa e nevojshme ndërmarrja e një studimi, mbi mundësitë që ofron trashëgimia kulturore në zhvillimin shoqëror-ekonomik të qarkut të Korçës.*

Realizimin e këtij punimi është origjinal, i mundësuar nga hulumtimi dhe grumbullimi i një sërë të dhënash gjeografike, historike, kulturore, shoqëror-ekonomike etj. të siguruara

nëpërmjet metodave të hulumtimit, statistikore, hartografike, anketime dhe intervista, vëzhgime në terren etj.

**Fjalë çelës:** *trashëgimi kulturore, integrim, zhvillim, rajon, turizëm kulturor,turizëm i trashëgimisë*

***Abstract***

Recently global changes are occurring rapidly, meanwhile the idea of integrating culture and heritage in socio- economic development has attracted the attention of researchers and policymakers.

Up to now the preservation of cultural heritage, has been associated with preservation of identity, pride and national wealth, while integration in regional and local development policies, seen as a good opportunity not only to preserve it but also its real contribution to the development of many countries of the world. Korca district has a high potential of cultural heritage, which is considered an important element in the development of cultural tourism. Variety of cultural monuments, citizenship and traditional hospitality, represent a strong attraction for local and foreign tourists.

Tourists and foreign scholars are very interested in objects of cultural monuments of the district such as archaeological ruins of the settlements, tumuli (tombs of Kamenica) and culture Tombs, monumental tombs, museums, flats and objects of the cult (churches), wall paintings, as well as the rich folklore, traditional clothing, food, festivals and local traditions etc..

Should be noted is the possibility that the growth of tourism in terms of cultural heritage, can bring many economic benefits and shoqëror destination as employment growth, income growth, alleviate shoqëror problems and to increase interestin environmental protection.

Based on this trend, it was necessary that the treatment under this article, to develop some surveys to see specifically how it assessed, the three interest groups directly linked to the development of cultural tourism.

Realization of this work is original, powered by research and collection of a range of geographical data, historical, cultural, socio-economic, etc.. obtained through research methods, statistics, maps, surveys and interviews, field observations, etc..

**Key words:** *cultural heritage, integration, development, region, cultural tourism, heritage tourism*

Interesi i popullsisë për të vizituar vende të reja me oferta të pasura natyrore dhe kulturore, e ka shndërruar sot turizmin në një ndër sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik në botë. Të ardhurat që sigurohen nga turizmi janë të konsiderueshme dhe për këtë arsye i është kushtuar një vëmendje e veçantë zhvillimit të tij. Sipas të dhënave të WTO-së, që nga viti 2001 numri i turistëve në Shqipëri, veçanërisht atyre ndërkombëtarë, ka ardhur duke u rritur nga viti në vit( UNWTO, 2013, p.7). Qarku i Korçës, si një ndër hapësirat gjeografike me zhvillim të hershëm shoqëror-ekonomik dhe kulturor në Shqipëri, është dalluar gjithashtu, për frekuentim të hershëm turistik.

Në zhvillimin e turizmit, krahas elementeve të tjera të rëndësishme, ka ndikuar edhe pozicioni gjeografik dhe komunikimi i hershëm dhe i vazhdueshëm me dy shtetet kufitare, Greqinë dhe

Maqedoninë. Interesi i vizitorëve dhe turistëve ndaj potencialeve natyrore, tashmë është fokusuar në njohjen e trashëgimisë kulturore të trevave përbërëse të qarkut, çka ka rritur promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit.

***Koncepte të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit***

Trashëgimia kulturore është themeli i identitetit të një kombi dhe një burim i rëndësishëm për turizmin në botë, por ekzistojnë pyetje të ndryshme mbi kulturën, trashëgiminë kulturore, lidhjen e kulturës me zhvillimin dhe turizmin kulturor. Për përkufizimin dhe shpjegimin e këtyre koncepteve, i jemi referuar disa studiuesve të huaj dhe studimeve nga literatura botërore. I trajtuar gjërësisht nga antropologu britanik Edwart Burnett Tylor në Primitive Culture (1871), "kultura është një tërësi komplekse që përfshin njohuritë, besimin, artin, parimet, ligjin, zakonet, dhe gjithçka tjetër të krijuar nga aftësitë e njeriut si anëtar i shoqërisë" (Jokilehto, 2005, p.4). Dy autorë të tjerë kanë dhënë një përkufizim më krahasues të kulturës duke kombinuar një sërë elementesh kyç: "kultura është një trashëgimi e mësuar, shoqërisht e transmetuar e objekteve, njohurive, besimit, vlerave dhe pritshmërive normative, që i mbartin anëtarët e një shoqërie për t'u përballur me probleme të përsëritura" (Goodman& Marx, 1978, p.79*)*. Sipas Konventës së UNESCO-s (Neni 1), trashëgimi kulturore konsiderohen monumentet; veprat arkitekturore, veprat skulpturore dhe të pikturuara, elementet apo strukturat me natyrë arkeologjike etj., të cilët kanë vlera universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës; grupe ndërtesash të ndara ose të bashkuara, të cilat për shkak të arkitekturës së tyre, homogjenitetit apo vendit që zënë në mjedis, kanë vlera të jashtëzakonshme universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës; sitet, veprat e njeriut ose veprat e kombinuara të njeriut dhe natyrës, zonat që përfshijnë vende arkeologjike, të cilat janë me vlera universale nga këndvështrimi historik, estetik, etnologjik dhe antropologjik" (Yahaya, 2006, p.295).

Në fund të shekullit XX (1999) koncepti i trashëgimisë kulturore i dhënë nga UNESCO dhe i pranuar ndërkombëtarisht, përfshin trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale ashtu sikurse edhe mjedisin.

Në Konventën e UNESCO-s në vitin 2003, trashëgimia jomateriale u përcaktua si *praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, zotësitë, ashtu sikurse instrumentet, objektet, zonat kulturore së bashku me komunitetet, grupet dhe individët si pjesë e trashëgimisë kulturore të tyre*. Kjo trashëgimi kulturore jo materiale e trasmetuar brez pas brezi është krijuar nga komunitetet përgjegjëse për mjedisin e tyre, si lidhje e natyrës me historinë. Një përkufizim të plotë për trashëgiminë kulturore ka dhënë studiuesja japoneze Tolina Loulanski, sipas së cilës *trashëgimia kulturore përfshin aspekte të kulturës materiale –site, ndërtesa, peizazhe, monumente dhe objekte ashtu sikurse kulturën jomateriale (shpirtërore) aspekte të të cilës janë mishëruar në praktikat shoqërore, jetën e komunitetit, vlerat, besimet dhe format shprehëse si gjuha, artet, zejtaritë, muzika dhe vallet* (*Loulanski, 2006*, pp.54-55). Ajo thekson se *koncepti i trashëgimisë kulturore po evoluon, si rezultat dhe në përputhje me qëndrimet, nevojat dhe kërkesat e njerëzve drejt saj*. Elementet më karakteristike të trashëgimisë janë elasticiteti dhe dinamizmi. Ajo që e bën trashëgiminë elastike është fakti që në kuptimin e gjerë të saj përfshin "çdo gjë që

trashëgohet nga e kaluara" dhe në kuptimin e ngushtë përfshin atë çka ka domethënie historike dhe kulturore (Po aty, p.210*).*

Përkufizime të tjera e përcaktojnë kulturën si "qëllime bashkëkohore të së kaluarës" ose "ajo pjesë e së kaluarës të cilën ne e kemi përzgjedhur në të tashmen për qëllime bashkëkohore, qofshin këto ekonomike, kulturore, politike apo shoqërore" (*Brian, Ashworth and Tunbridge, 2000, p. 2)*. Sipas Colin Michael Hall & McArthur, identifikohen katër vlera kryesore të trashëgimisë (*Hall, & McArthur , 1996, pp.21-22)*; vlera ekonomike të cilat lidhen me gjenerimin e të ardhurave që i vijnë një vendi si rezultat i shfrytëzimit të kësaj trashëgimie për qëllime turizmi dhe rekreacioni; vlera shoqërore dhe kulturore të cilat shprehen në lidhjen e fortë shpirtërore të njeriut me vendin dhe identitetin e tij në nivel lokal dhe kombëtar; vlera shkencore dhe edukative, të cilat shprehen në transmetimin e vlerave kulturore nga njëri brez tek tjetri, për të kuptuar më mirë nivelin e lartë kulturor që e karakterizon periudhën e ndërtimit të tyre; vlera politike që shprehen nëpërmjet përdorimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerave që ajo përmban nga ana e politikanëve, për të promovuar vlerat historike dhe identitetin e tyre kombëtar.

***Kultura dhe zhvillimi***

Zhvillimi mund të konceptohet në shumë mënyra. Që në fillesat e tij deri në vitin 1940, zhvillimi ishte i lidhur ngushtë me evoluimin e teknologjisë, modernizimin dhe rritjen ekonomike (Richtscheid, 2011, p.7). Shoqëritë e prapambetura dhe të zhytura në varfëri e kanë kërkuar zhvillimin nëpërmjet industrializimit, zhvillimit të teknologjisë bujqësore, përhapjes së arsimit modern dhe vlerave kulturore (Escobar ,1995). Në dekadat e fundit të shekullit të kaluar zhvillimi u konceptua më gjerë, veçanërisht në vitet 1980-1990. Në një koncept të dhënë nga UNDP (1994), thuhet se *është bërë e nevojshme që zhvillimi ekonomik së bashku me atë mjedisor, shoqëror dhe zhvillimin kulturor të konsiderohen si një zhvillim i tërë, zhvillim i qëndrueshëm* (Loulanski, 2006, p.52). Tashmë trashëgimia në mënyrë të përsëritur është identifikuar si një burim i fuqishëm ekonomik dhe shoqëror, "një aset zhvillimi, që mund të përdoret si katalizator për zhvillim në nivel lokal, që të sigurojë punësim, të gjenerojë të ardhura, të rivitalizojë hapësirat urbane dhe rurale, mbrojtjen e mjedisit dhe forcimin e komuniteteve shoqërore" (World Bank/UNESCO, 1998). Megjithëse trashëgimia dhe ruajtja e saj janë konsideruar prej kohësh si kundravënëse të zhvillimit ekonomik (si ruajtje historike ose rritje ekonomike), ato sot po shihen gjithnjë e më shumë si partnerë efektivë në zhvillim. Ky partneritet është në përputhje me pesë parimet e zhvillimit shoqëror-ekonomik të shekullit XXI, "*globalizimin, lokalizimin, diversitetin, qëndrueshmërinë, përgjegjshmërinë dhe përforcon gjithashtu pesë ndjenjat e cilësisë së komuniteteve: ndjenjën e vendit, të identitetit, evolucionit, pronësisë ose ndarjes dhe ndjenjën e komunitetit*" (Rypkema, 1999).

Parashikimet tregojnë se investimet në trashëgiminë kulturore do të rriten edhe më tej me bërjen e saj "produkti më i rëndësishëm i shekullit XXI, përcaktues i të ardhmes së komuniteteve" (Ogino, Masahiro, 2002). Trashëgimia kulturore është pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm, së bashku me tre komponentët e tjerë, ekonominë, shoqërinë dhe mjedisin. Përfitime të shumta shoqërore dhe ekonomike mund të arrihen nga vlerësimi dhe mbrojtja e saj. Sipas studiueses japoneze Loulanski, vëmendja dhe debatet midis teoricienëve dhe praktikantëve

duhet të përqendrohen jo shumë në pyetjen "nëse", por në pyetjen "se si" trashëgimia kulturore dhe zhvillimi mund të integrohen me sukses në mënyrë të qëndrueshme (Loulanski, 2006, p. 65).

Referuar praktikave ndërkombëtare ekzistojnë mjaft shembuj të integrimit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin shoqëror-ekonomik. Shembujt përfshijnë hapësira urbane dhe rurale, kombëtare dhe lokale nga vendet e industralizuara dhe ato në zhvillim (Angli, vendet e Bashkimit Europian, Kanada, Australi, Japoni, vendet e Lindjes së Mesme, vendet e Afrikës Veriore, etj).

***Turizmi kulturor / turizëm i trashëgimisë***

Në literaturën e sotme, në artikuj dhe studime shkencore, si dhe në përcaktimet e bëra nga organizmat ndërkombëtare të fushës së turizmit dhe trashëgimisë, përdoren termat *turizëm kulturor* dhe *turizëm i trashëgimisë* (culture/heritage tourism).Nga këto përcaktime në pamje të parë të krijohet ideja e trajtimit të tyre si dy fusha të ndryshme, kjo për faktin se sipas koncepteve të trashëgimisë kulturore, ajo është e përcaktuar si e tillë, ndërkohë që kultura si koncept është më gjithëpërfshirëse. Megjithatë qëllimet aktuale të politikave zhvillimore në fushën e turizmit synojnë zhvillimin e turizmit kulturor duke shfrytëzuar gjithë burimet kulturore të disponueshme. Organizata Botërore e Turizmit (WTO) e përkufizon turizmin si "*aktivitetet e individëve gjatë udhëtimit dhe qëndrimit të tyre në një vend jashtë vendit të zakonshëm të banimit, në një periudhë më pak se një vit, për kalimin e kohës së lirë, biznes apo qëllime të tjera*" (Richards, 1996, p.22). Studiuesja Catherine Trautmann (1994) thekson se *turizmi kulturor nuk është vetëm turizmi i trashëgimisë kulturore. Turizmi kulturor punon si një rrjet. Në të vërtetë ai përfshin lloje të artit, siç janë vallja, muzika, teatri…* (Trautmann , 1994). Kështu turizmi kulturor mund të përkufizohet si *vizita njerëzish nga jashtë të motivuar plotësisht apo pjesërisht nga mikpritja e komunitetit, me interes në trashëgiminë historike, artistike, shkencore apo stilin e jetesës së ofruar nga një komunitet, një rajon, një grup apo një institucion* (Silberberg, 1995, pp. 361-365).

Ideja se njohja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore mund të jetë ekonomikisht përfituese shkon prapa në 1970, kur PNUD-i dhe Banka Botërore, filluan të japin fonde për mbrojtjen e mjediseve të ndërtesave dhe zhvillimin e artizanatit, duke i justifikuar në terma thjesht ekonomike (*UNESKO, 1995*). Trashëgimia kulturore gjithnjë e më shumë po njihet si e mirë publike dhe përfitimet e saj shihen si ndërkombëtare (Cernea, 2008). Mirëmenaxhimi është çelësi për përdorimin e saj për qëllime të zhvillimit. Larg nga të qenurit vetëm një detyrim për buxhetet kombëtare, trashëgimia është dhe po bëhet gjithnjë e më shumë një "vlerë e shtuar" (World Bank. 2001). Kështu ruajtja nuk shihet si një pengesë për zhvillimin, siç ishte dikur, por gjithmonë e më shumë po shihet se mund të jetë partner në zhvillim (Loulanski,2006, p.56). Në një vlerësim që studiuesi Randall Mason, bën për konservimin e trashëgimisë kulturore dhe vlerat ekonomike që lidhen me të, përmend thënien e Neville Agnew: "Ne të gjithë duhet të kujtojmë se përfitimet ekonomike të trashëgimisë kulturore avullojnë, në qoftë se vlerat e tjera kulturore, shoqërore, estetike të saj, nuk respektohen apo humbasin" (Mason, 1998, p.11).

Përcaktimet e koncepteve të trashëgimisë dhe turizmit kulturor në Shqipëri janë bërë në përputhje me përcaktimet e dhëna nga UNESCO-ja dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë të trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

***Raste të përdorimit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin shoqëror-ekonomik rajonal dhe lokal.***

Sot, në shumë vende në botë, investimet në ruajtjen e trashëgimisë kulturore janë të lidhura me promovimin e saj për zhvillimin e turizmit. Duke e konsideruar integrimin e trashëgimisë kulturore si një element të rëndësishëm për zhvillimin shoqëror-ekonomik rajonal dhe lokal, po evidentojmë disa raste të përdorimit të suksesshëm në praktikat ndërkombëtare urbane dhe rurale. Kështu në Europë, Italia me Romën, Firencën, Venecian; Franca me Parisin, Marsejën, Lionin, Spanja me Madridin, Barcelonën, Gjermania me Mynihun, Frankfurtin, Nurenbergun, Greqia me Athinën, Selanikun tërheqin çdo vit dhjetëra e qindra milionë turistë. Analizat e studiuesve të huaj, evidentojnë qasje të ndryshme, të përdorimit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin rajonal dhe lokal, për vende të ndryshme. Rastet e trajtuara më poshtë janë përzgjedhur duke iu referuar disa karakteristikave të ngjashme me hapësirën tonë të studimit.

Për t'u evidentuar është rasti i qyteteve të Gjermanisë Lindore pas viteve 1990, ku mbrojtja e trashëgimisë dhe përdorimi i saj në zhvillimin e turizmit, u bë në përputhje me ruajtjen dhe rehabilitimin e strukturave historike urbane. Nëpërmjet një investimi të Ministrisë Federale të Transportit, Ndërtimit dhe Zhvillimit Urban dhe Zyrës Federale për Ndërtimin dhe Planifikimin Rajonal, programi i investimeve përfshiu 10 qytete të Gjermanisë Lindore (Programm Städtebaulicher Denkmalschutz) (Dumcke & Gnedovski, 2013, p.92) Qytetet e përzgjedhura në pesë shtetet federale ishin Stralsund, Wismar dhe Malchow në Mecklenburg-Vorpommern; Neuruppin dhe Potsdam në Brandenburg; Tangermünde dhe Quedlinburg in Saxony-Anhalt; Görlitz dhe Zittau in Saxony; dhe Mühlhausen in Thuringia.

Efektet pozitive të programit u identifikuan gjatë viteve nëpërmjet survejimit të turistëve, të cilët vlerësuan pozitivisht zhvillimin urban, nëpërmjet vendimit të tyre për të udhëtuar në ato vende. Në vitin 2005 nga qarkullimi i përgjithshëm i turizmit u gjeneruan rreth 1 miliard € nga vizitorët vendas dhe ata me mbi një natë qëndrimi në qendrat e akomodimit të ngritura në dhjetë qytetet. Rreth 13% ose 130 milion € ishin të lidhura me mbrojtjen e strukturave historike urbane. Megjithatë rizhvillimi nuk do të mund të konsiderohej pa elementet kyçe të ofertës së turizmit si: atë të akomodimit, tregtisë me pakicë, ofertës së mirë të gastronomisë, kulturës dhe ofertës argëtuese etj. Për më shumë kjo u vlerësua edhe nëpërmjet rritjes së interesit të turistëve për hotelet dhe qendrat e tjera historike të akomodimit.

Efektet pozitive të programit për mbrojtjen e strukturave historike urbane në zhvillimin e turizmit mund të konsiderohen të padiskutueshme në studimin e këtij rasti edhe nëpërmjet rezultateve të tjera që u evidentuan.

*Në Angli* projektet kërkimore janë fokusuar në qëndrimin e publikut në drejtim të trashëgimisë kulturore, duke ndier realisht përfitimet shoqërore dhe ekonomike që vijnë prej saj. Aktivitetet kulturore janë konsideruar si një impakt pozitiv në mirëqenie, falë mundësive nëpërmjet projekteve kolektive apo vullnetare duke i bërë njerëzit të ndihen që ata "luajnë një rol të dobishëm në gjërat". Nëpërmjet krijimit të fondit të trashëgimisë (Heritage Lottery Fund's Strategy) u kryen investime të reja në një gamë të gjerë të trashëgimisë kulturore me ndikim të përhershëm në vende dhe njerëz. Një prej rasteve ku u zbatua ky model, ishte Barnsley një qytet i vogël në

një një zonë metropolitane në Yorkshirin jugor, që mbulon një sipërfaqe prej 320 km², me popullsi 218 mijë banorë (82 000 në qytet) *(*Dumcke &Gnedovski, 2013*).* Pas mbylljes së industrive në mesin e viteve 1990, ekonomia lokale krijoi shumë vështirësi për jetën e banorëve. Qeverisja vendore në vitin 2002 nëpërmjet një programi të rigjenerimit "remaking Barnsley" mobilizoi 400 000 000 £ investime publike dhe private për rijetëzimin e mjedisit urban. Një sërë qendrash inovative ofruan mbështetje për sipërmarrësit dhe mundësuan krijimin e teknologjive inovative. Në mbështetje të zhvillimit të hapësirës u krijuan infrastuktura dhe objekte si inkubacionet (hapësira pune që inkurajojnë punën krijuese) galeri, studio etj.

*Modeli i Japonisë* lidhur me përdorimin e trashëgimisë kulturore në zhvillimin shoqëror-ekonomik lokal dhe rajonal, në qytetet e vogla dhe të mesme, bazohet kryesisht të bashkëpunimin e sektorit publik me atë privat.

Në Japoni, sipas studiueses japoneze Tolina Loulanski, përmenden disa shembuj të sukseshëm ku ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe rizhvillimi urban, janë integruar suksesshëm në zhvillimin lokal, në veçanti në rastet e qyteteve të vogla dhe të mesme (Loulanski,2006, p.57). Qyteti i Nagahamës i ndërtuar që në shekullin XVI, ndodhet në Prefekturën e Shigës, me një popullsi prej 50 000 banorë. Gjatë viteve 1980 qyteti u përfshi nga rënia ekonomike. Në vitin 1988 nëpërmjet një projekti bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat u tentua rimëkëmbja ekonomike përmes rehabilitimit të trashëgimisë kulturore dhe inkurajimit të krijimit të një industrie kulturore. Ruajtja e një ndërtese tradicionale të periudhës Meji (1868-1912) e miratuar për prishje në vitin 1987 shënoi nisjen e një projekti ambicioz. Këshilli i qytetit së bashku me kompanitë private krijuan një sektor të ri të tretë sipërmarrës me një kapital prej 40 milion jen të dhënë nga qeverisja lokale dhe 90 milion jen të dhënë nga 8 kompani rajonale. Qëllimi ishte të inkurajohej aktiviteti ekonomik i biznesit në promovimin e qytetit, më tepër se në aktivitetet të mëparshme. Vepra artizanale tradicionale dhe moderne u përdorën në bazën e strategjisë së zhvillimit të qytetit. Shtëpitë e vjetra në qytet u rinovuan dhe u bënë dyqane, restorante dhe muze apo galeri. Tashmë në qendrën e qytetit ndodhen 30 ndërtesa të konvertuara nga strukturat e vjetra banesa, magazina etj. Projekti u kthye në një katalizator për zhvillimin e mëtejshëm kulturor të qytetit, duke tërhequr më shumë njerëz të përfshirë në performimin e arteve dhe eventeve. Ai u bë gjithashtu një bazë për projektet e mëtejshme investuese publik–privat. Për më tepër, iniciativa çoi në krijimin e një qendre për rigjenerimin rajonal në vitin 1998, e cila tashmë operon në mënyrë të pavarur. Qendra funksionon si një urë veprimi midis qeverisjes lokale, dyqaneve (biznesit) dhe qytetarëve duke siguruar informacion dhe koordinuar shërbimet në shumë evente. Mbi të gjitha projekti është bërë i njohur si shembull domethënës i mënyrës në të cilën, restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe ripërdorimi mund të kombinohen në një krijimin e një industrie të veçantë kulturore për promovimin e rigjenerimit dhe rijetëzimin urban. Përpjekjet për rigjenerimin urban në Nagahama u ndërmorën për një periudhë 15 vjeçare. Që nga 1998, pra vetëm një dekadë pas fillimit të projektit, të ardhurat nga shitjet shënuan 900 milion yen dhe vizitorët numëruan 1.8 milion në vit, duke dëshmuar një zgjerim të balancuar të një industrie të rëndësishme kulturore (Loulanski,2006, pp.57-58). Opinioni publik lokal është mjaft pozitiv për imazhin

e ri rajonal, standardin kulturor, krijimin e zonave të reja turistike, mbrojtjen e mjedisit dhe kontributin në ekonominë lokale. Rajoni i Kurokabesë është kthyer në një zonë të gjallë që vizitohen nga 2 milion turistë [2]. Shembuj të tjerë analogë studiuesja përmend Kanazawa, Otaru dhe ishullin Hokajdo me një peizazh unik, histori dhe trashëgimi kulturore, duke kombinuar restaurimin dhe ripërdorimin me zhvillimin e industrisë tradicionale të zejeve dhe artizanatit.

Po kështu raste të tjera të suksesshme mund të përmendim raste të integrimit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin rural në Irlandën e Veriut, Spanjë, Francë, Portugali etj., duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës, shmangien e braktisjes së zonave rurale dhe zhvillimin e integruar rural të tyre.

***Zona e studimit***

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore, në të cilat ndodhet qarku i Korçës, ofrojnë mundësi të shumta natyrore për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të tij. Prania në afërsi të vijës kufitare me Maqedoninë dhe Greqinë, i kanë ofruar mundësi komunikimi dhe shkëmbimi me botën e jashtme që në periudhat e hershme kohore. Prania e përbërjes së larmishme gjeologjike (gëlqeror, magmatik, terrigjen, etj.) ka favorizuar ekzistencën e burimeve të shumta minerare. Relievi i shumëllojshëm (gropa, fushëgropa, lugina, male, vargmale, etj.), ndikimi i klimës mesdhetare me tipare të dukshme kontinentale, si edhe pasuritë e shumta ujore kanë mundësuar zhvillimin e një biodiversiteti të pasur.

Nisur nga kjo, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë shpallur zona të mbrojtura, duke e bërë hapësirën gjeografike të qarkut të Korçës tërheqëse në aspektin turistik. Evolucioni hapësinor dhe territorial është karakterizuar gjatë periudhave historike nga vazhdimësia e jetës dhe vendbanimeve në të.

Vendodhja stategjike dhe kushtet e favorshme gjeoklimatike kanë mundësuar një zhvillim të dukshëm shoqëror-ekonomik të komunitetit që ka jetuar këtu. Dinamika e zhvillimit të popullsisë është ndikuar nga faktorë të ndryshëm historikë dhe politikë. Para vitit 1990, popullsia ka qenë përgjithësisht e stabilizuar dhe numri i saj është rritur nga viti në vit (veçanërisht gjatë periudhës 1945-1990 si rezultat i politikave të ndjekura nga shteti). Pas vitit 1990 numri i popullsisë në të gjitha zonat e qarkut ka pësuar rënie, si rezultat i migrimit të banorëve dhe uljes së nivelit të shtimit natyror.

Zhvillimi shoqëror dhe ekonomik i qarkut të Korçës është i lidhur ngushtë me potencialin natyror dhe human të saj. Gjatë gjithë periudhave historike zhvillimi ekonomik ka qenë i bazuar në zhvillimin e bujqësisë, artizanatit, zejeve si dhe funksionimit të ndërmarrjeve të vogla të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Gjatë periudhës 1945-1990 zhvillimi ekonomik u bazua në zhvillimin e industrisë së rëndë, industrisë së lehtë dhe ushqimore, ashtu sikurse edhe në zhvillimin e bujqësisë. Me ndryshimet politike që ndodhën në vitin 1990 ndryshoi dhe struktura e zhvillimit ekonomik, duke kaluar nga një zonë industriale komplekse, në një zonë me bujqësi të zhvilluar. Në ditët e sotme zhvillimi ekonomik është i bazuar në prodhimet bujqësore dhe blegtorale, zhvillimin e industrisë së lehtë dhe ushqimore si dhe në zhvillimin e turizmit.

Trashëgimia e pasur shpirtërore me folklorin, traditat, zakonet, qytetarinë, pjesë e identitetit dhe origjinalitetit të komunitetit të zonës, së bashku me

[2] Ky rast dhe raste të tjera të suksesshme të aplikuara në qytetet e vegjël të Japonisë, përbëjnë një model të mire për t'u aplikuar në qytetin e Korçës.

kulturën materiale përbëjnë një mundësi reale për zhvillimin e turizmit kulturor. Kjo pasuri meriton të evidentohet, inventarizohet, vlerësohet dhe mbi të gjitha të mbrohet, në mënyrë që të transmetohet e sigurt dhe origjinale në brezat e ardhshëm. Kombinimi i këtyre potencialeve me mjedisin natyror të veçantë, e favorizon edhe më shumë zhvillimin e turizmit, çka sjell nevojën e hartimit të politikave konkrete institucionale e vendore në këtë drejtim.

Integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin e turizmit, si një nga sektorët me zhvillim të shpejtë në Shqipëri, është një mundësi mjaft e mirë për gjenerimin e zhvillimit rajonal dhe lokal. Nëpërmjet atraksioneve të larmishme, festimeve dhe gastronomisë tradicionale, qarku i Korçës mund të sigurojë përfitime të dukshme ekonomike, shoqërore dhe kulturore, nga tërheqja e turistëve në destinacion. Lidhur me këtë është e rëndësishme që çdo njësi vendore që administron territorin e vet, të hartojë plane për mirorganizimin dhe mirëmenaxhimin e tyre.

Për një turizëm të suksesshëm krahas ofertës primare, është i rëndësishëm zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse si: njësitë e akomodimit, sektori i ushqimit, infrastruktura rrugore, e transportit dhe shërbime të tjera plotësuese që lidhen indirekt me turizmin. Zonat kulturore (qyteti i Korçës dhe fshatrat përreth) janë tashmë pjesë e marketingut të produktit kulturor. Ato janë të përfshira në itineraret turistike të vizitorëve vendas dhe turistëve ndërkombëtarë. Si të tilla duhet t'i kushtojnë rëndësi ruajtjes së mjedisit tradicional, origjinalitetit të produkteve që ofrojnë dhe njësive të akomodimit në përputhje me kërkesat e turistëve.

**Metodat**

Për analizimin e zhvillimit të turizmit kulturor në qarkun e Korçës janë realizuar anketime me turistët që vizitojnë zonën si dhe komunitetin lokal të saj.Në sektorin turistik përdorimi i anketimeve është një metodë efikase e përdorur për përfitimin e të dhënave primare sasiore dhe cilësore si edhe për të testuar vërtetësinë e çështjeve të ngritura në lidhje me zhvillimin e këtij sektori.

Ajo është realizuar nëpërmjet hartimit dhe realizimit të anketimeve 200 (dyqind) pyetësorë për tri target grupe: turistët e huaj 80 (tetëdhjetë), komunitetin lokal 100 (njëqind) dhe njësitë turistike 20 (njëzet) pyetësorë. Nëpërmjet përdorimit të kësaj metode është synuar që të dalë në pah rëndësia që ka zhvillimi i turizmit kulturor në zhvillimin shoqëror-ekonomik të komunitetit lokal. Gjithashtu pyetjet që përmbanin pyetësorët synonin të nxirrnin opinionin e turistëve mbi ofertën kulturore dhe shërbimet turistike në hapësirën e vizituar. Po kështu anketimi nxori në pah, problematikat me të cilat përballen objektet kulturore në këndvështrimin turistik.

Tipet e pyetjeve të përfshira në pyetësor janë pyetje të mbyllura ose të koduara, pyetje të hapura dhe kombinim i të dyjave .

Për realizimin e anketimeve është zgjedhur periudha Qershor-Gusht (viti 2013), e cila përkon me kulmin e sezonit turistik, periudhën e pushimeve dhe prurjet e mëdha turistike, veçanërisht të turistëve të huaj, që janë objekt i kërkimit. Përzgjedhja e të anketuarve është bërë në mënyrë të rastësishme si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale.

Pyetësori i turistit është përkthyer në gjuhën angleze, i njëjtë me versionin origjinal të hartimit të pyetësorit në gjuhën shqipe. Numri i turistëve të anketuar është 80 turistë, mbi moshën 18 vjeç. Përzgjedhja ose kampioni i turistëve është gjetur në mënyrë të rastësishme, pa ndjekur ndonjë rregull të caktuar, kjo edhe për faktin se, numri i turistëve

ndërkombëtarë në destinacion nuk është i madh dhe gjatë gjithë ditëve. Jemi përpjekur që të mos bëhet dallime në përzgjedhjen e kampionit burrë apo grua, të rinj apo të vjetër duke synuar një gjithëpërfshirje të të anketuarëve.

Përveç anketimit, një nga metodat e përzgjedhura gjithashtu për vjeljen e informacionit ishin edhe diskutimet jo formale të bëra me banorë, turistë dhe drejtues të njësive të biznesit (hotele). Procesi i kërkimit u shoqërua me foto të shumta në hapësirat e përfshira në anketim, me qëllim demostrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe aktiviteteve kulturore që lidhen me to.

**Rezultatet**

Rezultatet e anketimeve kanë nxjerrë në pah interesin që paraqet hapësira e studimit në aspektin e turizmit kulturor, si motivacioni kryesor i tërheqjes turistike dhe nevojën e përmirësimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore, në funksion të zhvillimit të këtij lloj turizmi.

**Analiza e anketimit me turistët e huaj.**

Sipas treguesve të të anketuarëve, grupi i turistëve të huaj që vizitojnë destinacionin paraqitet i larmishëm, ku përqindjen më të madhe e zënë turistët me kombësi italiane (16%), të ndjekur nga ata me kombësi gjermane (14%), kombësi greke (13%), kombësi angleze (8%) dhe kombësi franceze (8%).Gjithashtu me përqindje më të vogël janë turistët me kombësi amerikane, maqedonase, çeke, etj.

Për sa i përket pyetjes se sa herë e kanë vizituar qarkun, 75% e të anketuarëve janë turistë që vijnë për herë të parë, 19% e vizitojnë atë për herë të dytë, 2% për herë të tretë, ndërkohë që 4% nuk kanë dhënë përgjigje. Turistët e rikthyer për herë të dytë dhe të tretë shprehen se rikthimi i tyre lidhet me çështje pune dhe takim me miq të tyre (të huaj), që jetojnë prej disa vjetësh në Korçë.




**Grafiku 1– Përqindja e frekuentimit të zonës.** *Burimi: Anketime të realizuara në terren, 2013 (E. Menkshi)*

Turistët e ardhur në Korçë qëndrojnë për një kohë të caktuar. Nga pyetja drejtuar atyre, se sa ditë do të qëndrojnë në destinacion, rreth 53% e tyre janë përgjigjur se do të qëndrojnë 1 natë, 37% do të qëndrojnë 2-5 ditë dhe 2 % më shumë ditë. Rëndësia e kësaj pyetje qëndron në faktin se sa më e madhe të jetë koha e qëndrimit të tyre, aq më të mëdha do të jenë shpenzimet e bëra nga turistët dhe aq më të mëdha do të jenë dhe përfitimet që vijnë nga qëndrimi i tyre. Në funksion të qëndrimit të turistëve të huaj në zonën e studimit, funksionojnë disa lloje të njësive të akomodimit, ndërkohë që 58% e tyre janë akomoduar në hotele, 26% në shtëpi fshati, dhe 11% në dhoma private. Nga të anketuarit 2% e tyre nuk

kanë qëndruar në destinacion gjatë natës (kanë qenë turistë 1 ditorë).
Lidhur me qëllimin primar të vizitës në qarkun e Korçës, sipas alternativave të propozuara turistët paraqitën disa zgjedhje. Kështu alternativa e lidhjes së kulturës dhe traditave lokale është zgjedhur nga 51.9% e tyre (40 të intervistuar), ndërkohë që monumentet dhe objektet kulturore kanë përbërë qëllimin e vizitës për 48.1% (37 të intervistuar); 33 persona ose 42,9% kanë zgjedhur krahas alternativave të tjera edhe lidhjen me natyrën dhe 21 persona ose 27.3% kanë patur qëllim edhe festimet e ndryshme.




**Grafiku 2- Qëllim primar i vizitës në qarkun e Korçës** *Burimi: Anketime të realizuara në terren, 2013(E.Menkshi)*

Siç vihet re nga grafiku i mësipërm rezulton se turistët e huaj vlerësojnë më shumë lidhjen me kulturën dhe traditat lokale si dhe monumentet dhe objektet e kulturës sesa lidhjen me natyrën, festimet apo jetën e natës. Kjo tregon se tërheqja dhe interesi i tyre ndaj vlerave të objekteve kultore dhe historike është i lartë. Po të shikojmë më të specifikuara zgjedhjet për të vizituar destinacionin 64 prej të intervistuarve ose 81% e tyre kanë pohuar se e kanë zgjedhur për të parë fshatrat tradicionale turistike (Voskopojë, Dardhë etj.). Po ky grup prej 79.7% ka pohuar mundësinë për të vizituar objektet historike dhe kulturore dhe për të parë qytetin (Korçën). Një nga zgjedhjet që vlen për t'u konsideruar krahas të tjerave është ushqimi special lokal dhe vende të mira për të ngrënë, e zgjedhur në masën 62% (49). Gastronomia dhe ushqimet tradicionale janë një element tjerër i rëndësishëm kulturor, që vlerësohet nga vizitorët vendas, por në këtë rast edhe nga ata të huaj. Nga sa mund të shihet nga të dy grafikët e mësipërm, mund të shprehemi se *motivacioni kulturor,* përbën motivacionin kryesor të vizitës së turistëve të huaj dhe zgjedhjes së destinacionit të qarkut të Korçës. Lidhur me gjetjen e informacionit për të zgjedhur destinacionin 35 prej tyre ose 45.5% kanë pohuar nga guidat dhe broshurat, 31 ose 40.3 % nga interneti, 16 ose 20.8% nga agjensitë turistike dhe miqtë dhe vetëm 14 prej tyre ose 18.2% nga mbresat apo përshtypjet e mëparshme. (Këta i përkasin grupit të vizitorëve, që e vizitojnë për herë të dytë destinacionin.)Po të analizojmë aksesin e udhëtimit 30% janë shprehur se kanë udhëtuar me transport publik, 22% me aeroplan dhe autobus, 20% me transport tour operator dhe 18% me makinat e tyre. Të pyetur se me cilët kanë qenë të shoqëruar në udhëtim, përgjigja dominuese ka qenë me shokë dhe miq 28% kanë udhëtuar me bashkëshortin ose

bashkëshorten, 15% vetëm dhe 13% kanë pohuar se janë shoqëruar nga fëmijë.

Përsa i përket shpenzimeve 34% e të anketuarëve kanë pohuar se shpenzimet e tyre gjatë qëndrimit ishin 100-300 €/$, ndërkohë që vetëm 3% e tyre kanë pohuar se kanë shpenzuar mbi 1000 €/$. Në shpenzimet e tyre gjatë qëndrimit në destinacion, 57% e të intervistuarëve kanë përfshirë vetëm veten, 29% kanë përfshirë 2 persona (ky është grupi që ka udhëtuar në çift) dhe vetëm 5% kanë përfshirë 4persona.




**Grafiku 3- Shpenzimet e bëra në destinacion**

***Analiza e opinionit të turistëve rreth pushimeve,*** konsiston në vënien përballë të opinioneve të turistëve rreth komponentëve të ofertës turistike të krahasuar me vlerësimin e bërë nga këndvështimi i kënaqësisë së turistëve për elementët konkretë në destinacion. Të pyetur se sa të kënaqur janë ata me pushimet, 89% e tyre shprehen të kënaqur për gjithë pushimet që kanë kaluar dhe vetëm 9% janë shprehur mesatarisht të kënaqur. Për sa i përket analizës së vendndodhjes së destinacionit (distancës nga vendi prejardhjes drejt vendit turistik) 43% e konsiderojnë të rëndësishme, ndërkohë që 44% të tjerë e konsiderojnë mesatarisht të rëndësishme. Po të shikojmë vlerësimin e këtij komponenti për zonën tonë të studimit 51% janë mesatarisht të kënaqur (në këtë rast kjo nuk është pozitive) ndërkohë që 42% shprehen të kënaqur. Lidhur me këtë, mund të komentojmë se kohëzgjatja e udhëtimit dhe gjendja jo e mirë e infrastrukturës në disa pjesë të saj ka ndikuar në vlerësimin e bërë.







**Grafiku 4/5- Vendodhja/distanca e destinacionit (nga aeroporti)**

Lidhur me mundësitë e transportit dhe gjendjen e mirë të rrugëve 85% e vlerësojnë të rëndësishëm dhe 5% aspak të rëndësishëm, ndërkohë që për destinacionin konkret 65% janë mesatarisht të kënaqur me këtë tregues dhe vetëm 15% janë të kënaqur. Këto të dhëna tregojnë se kohëzgjatja e udhëtimit dhe gjendja jo e mirë e infrastrukturës në disa pjesë të saj ka ndikuar negativisht në opinionin e turistëve, mbi vlerësimin e transportit dhe gjendjes së tij.

***Analiza e vlerësimit të trashëgimisë kulturore të qarkut (destinacionit) nga turistët*** është bërë nëpërmjet krahasimit të dy komponentëve të rëndësishëm, pritshmërisë dhe kënaqësisë së turistëve në lidhje me vizitën e tyre në qarkun e Korçës. Kështu pritshmëria për ndërtesat historike apo muzetë për 49% të anketuarëve ka qenë e lartë ndërkohë që 47% e tyre janë shprehur të kënaqur me këtë element kulturor. Në këtë rast është specifikuar kënaqësia për Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, ashtu sikurse është pohuar e kundërta për të tjerë të vizituar.

**Grafiku 6/ 7 –Pritshmëria/ kënaqësia për ndërtesat historike/muzetë**







Lidhur me eventet dhe festimet pritshmëria ka qenë e lartë për 43% të turistëve dhe 36% janë shprehur të kënaqur, me arritjen e këtij elementi. Një përqindje të lartë (46%) e zënë personat mesatarisht të kënaqur, ndërkohë që 42% kishin këtë pritshmëri.

Ndonëse qyteti njihet si qyteti i festimeve të shumta, përqindjet e ulëta të kënaqësisë së realizuar mbi këtë komponent, mund të shpjegohen me rastisjen e një pjese të të anketuarve në ditët pa evente apo festime konkrete (përjashtuar festën e birrës gjatë së cilës ka patur anketime në qytetin e Korçës). Këtu shprehja e kënaqësisë nuk jepet vetëm për festimet e shumta por edhe për kënaqësisë që realizohet nga organizimi i tyre. Pritshmëria për objektet fetare, në veçanti për kishat, është e lartë për 57% të turistëve ndërkohë që kënaqësia është arritur për 76% të atyre që i kanë vizituar ato. Këtu vlen për t'u theksuar prania e shumtë e kishave dhe vlerave që mbartin, ashtu sikurse dalin në pah edhe nuanca pakënaqësie për një pjesë të turistëve që vlerësojnë edhe gjendjen e tyre (vlerësohet Katedralja Ringjallja e Krishtit në qytetin e Korçës dhe kishat e Voskopojës)

Lidhur me ushqimin 48% e të anketuarve kanë patur një pritshmëri të lartë, (këtu mund të përfshihen ata që e kanë vizituar zonën më parë dhe të tjerë). Po kështu 46% nuk rezultojnë të kenë patur pritshmëri pozitive (mesatarisht). Kënaqësia për ushqimin është shprehur nga 84% e të tyre. Kjo është për t'u vlerësuar. Ka nga ata që nuk e kanë shijuar kënaqësinë për këtë element (11%).

Pritshmëria për qendrat e informacionit turistik nuk është shprehur në sensin pozitiv, 40% e të anketuarve

kanë pasur një pritshmëri mesatare dhe pa ndonjë ndryshim të dukshëm shprehet edhe në kënaqësinë e të anketuarëve lidhur me këtë komponent të rëndësishëm turistik. Prej tyre vetëm 26% janë shprehur të kënaqur. Në qytetin e Korçës funksionon vetëm një zyrë informacioni turistik, po kështu edhe në qytetin e Pogradecit dhe në Voskopojë.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Cernea, M. (2008) . *The Developmental Potential of Cultural Heritage Environments* in Cultural Heritage in the Arab World, edited by Fekri Hassan, Aloisia de Trafford & Mohsen Youssef, p.126 Alexandria, Egypt *(*cit. Richtscheid K., *The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia,* (master thesis) 2011, p.11.

Dumcke, C. &Gnedovski, M., (2013), Creative-based strategies, Some European Case Studies: Comparison, The shoqëror and economic value of cultural heritage, Literature review, EENC Paper, July

Dumcke, C.,&Gnedovski, M.(2013). *The shoqëror and economic value of cultural heritage, Literature review*, EENC Paper, July, p.92 Michaelis-Winter, A. and Ruland, R. (eds.) (2007): Städtebaulicher Denkmalschutz und Tourismusentwicklung unter besonderer Berücksichtigung der UNESCO – Welterbestädte.

Escobar, A. (1995). *Encountering Development: The Making and Unmaking of the Third World. Princeton, New Jersey: Princeton University Press, fq 4. (cit. Richtscheid, K., The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development……. p. 7)*

Goodman, N. and G.T Marx. (1978). *Society Today.* 3-rd edition, New York: CRM Roundam House; p. 79,(cit.Colin J.V.Zyl, The role of tourism in the conservation of cultural heritage with particular relevance for South Africa, PhD dissertation, 2005, p.4.)

Graham, B., Ashworth G., and Tunbridge J. ( 2000)*. Geography of Heritage –Power, Culture and Economy; Arnold, London, p.2, 157 (cit.në Loulanski 2006, Cultural Heritage in Socio-Economic, .p.54).*

Hall, M., & McArthur S. (1996). *The Human Dimension of Heritage Management: Different Values, Different Interests, Different Issues; p. 2-21 (cit.Duhil K. Sustainable World Heritage Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg, master thesis, 2005, p.8 )*

Jokilehto, J. ( 2005). *Definition of culture heritage (Originally for ICCROM, 1990); Revised for CIF: 15 January; ICCROM Working Group 'Heritage and Society' , JJ; p.4*

Loulanski T. (2006). *United Nations Development Program (UNDP). 1994. Human Development Report 1994. Oxford University Press. p.52.*

Loulanski, T. (2006). *Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives Environments, IDEAS, Journal Volume 34(2) .*

Mason, R. (1998). *Economics and Heritage Conservation, A Meeting Organized by the Getty Conservation Institute, December, Getty Center, Los Angeles, p.11.*

*Ogino, Masahiro*, (2002).*ed. The Sociology of Cultural Heritage, From the Louvre to Hiroshima Dome. Tokyo. Shin-Yo-Sha. p. 277 (cit. Loulanski 2006, p.56)*

Richards, G. (1996*). (ATLAS) Cultural Tourism in Europe, published by CAB international, Wallingford, UK, p.22*

Richtscheid, K. (2011). *The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia, (master thesis)*
Rypkema, D. (1999). *Culture, Historic Preservation and Economic Development in the 21st Century. Paper for the Leadership Conference on Conservancy and Development, Yunnan Province, China*
Silberberg, T. (1995). *Cultural tourism and business opportunities for museums and heritage sites, Tourism Management, 16 (5), 361-365 (cit.Karine, D., 2005, p.12)*
Trautmann, C. (1994*). Strasbourg mise sur la Culture, Cahiers espaces Nr. 37, Paris, Espaces (cit.Karine, D., Sustainable World Heritage Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg, 2005, p.11*
UNESCO ( 1995). *Report of the World Commission on Culture and Development. Our Creative Diversity, Paris, p.182*
UNWTO,(2013), Tourism Hightlight 2013 edition.
World Bank ( 2001). *Cultural Heritage &Development : A Framework for Action in the Middle East & North Africa, Washington D.C, World Bank, P.44.*
World Bank/UNESCO (1998). *Culture in Sustainable Development: Investing in Cultural and Natura Environments. Proceedings of the Conference sponsoredby the World Bank and UNESCO, Washington.*
www.eukn.org/dsresource?objectid=218283
Yahaya , A.(2006).*The Scope and Definitions of Heritage: From Tangible to Intangible, International Journal of Heritage Studies (Routledge)Vol. 12, No. 3, p.295.*

# ELEMENTE DEKORATIVO-ARKITEKTONIKE TË BANESAVE NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XX NË QYTETIN E KORÇËS

**EFTIOLA THANAS**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Shekulli XX, e në mënyrë të veçantë, gjysma e parë e këtij shekulli shënon për Korçën një rritje të theksuar të fuqisë ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Qyteti merr një zhvillim të madh dhe nga ana ndërtimore, që shfaqet në zmadhimin e ndjeshëm të territorit dhe në futjen e koncepteve të përparuara urbanistike dhe arkitektonike.

Kristalizimi qysh herët i një tipologjie të përshtatshme, shtimi i potencialit teknik të ndërtimit dhe formimi i një shijeje të re artisitke e ndikuar nga përmirësimi i mëtejshëm i mënyrës së të jetuarit, u bënë faktor nxitës që vëmendja e mjeshtrave të drejtohej dhe të përqëndrohej edhe në gjetjen e mjeteve të reja shprehëse arkitektonike e dekorative.

Kështu duke vazhduar në analizën e teknikave në këtë punim, do të flasim jo vetëm për atë, por dhe për dukuritë e reja, si ato të ndërtimit, por edhe ato arkitektonike si: teknika e ndërtimit, elementet prej guri të gdhendur, elementet dekoratie në suva, elementet prej hekuri, dukuritë e reja arkitektonike të ndodhura në qytet në vitet '30-'40 etj.

**Fjalët kyçe:** *Element, gur i gdhendur,suva, hekur, dekorim, dukuri arkitektonike*

**Abstract**

The 20th century, and in particular, the first half of this century marks a significant increase of Korca's economic, social and cultural strength. The city takes a great development in construction, displayed by significantly increasing the territory and the introduction of advanced architectural and urban concepts.

Early crystallization of an appropriate typology, adding technical potential of construction and the formation of a new artistic taste by further improving the way of living, became a stimulus in directing and focusing masters' attention to find new means of decorative architectural expression.

Continuing the techniques analysis, we will talk not only about it but also, for the new phenomena of construction and architecture as: construction technique , carved stone elements, decorative elements in plaster, elements of iron, the new architectural phenomena occurring in the city in the '30-'40s etc.

**Key words**: *elements, carved stone, plaster, iron ,decoration, architectural phenomena*

Korça të impresionon që në pamje të parë dhe të bën ta shëtisësh thjesht dhe vetëm për peisazhin që të ofron, por duke mos u ndalur thjesht dhe vetëm në bukurinë e saj, ajo është dhe një qytet që ka çfarë t'i tregojë vizituesit të thjeshtë, por dhe atij kureshtar. Kështu duke vazhduar dhe folur për Korçën dhe gjërat që mund të shohësh, mund të ndalemi në disa nga karakteristikat e saj, siç janë arkitektura dhe urbanistika e qytetit, e cila mund të shijohet edhe vetëm me një shëtitje të thjeshtë nëpër qytet.

Të dyja këto, arkitektura dhe urbanistika, janë të gërshetuara aq mirë saqë asnjëra nuk bën dot pa tjetrën. Dihet që në ditët tona kanë mundur të realizohen shumë variante të ndryshme ndërtimesh shtëpish, të cilat me karakteristikat e veta i japin vlera si vetë ndërtesës, po ashtu edhe arkitekturës së qytetit në tërësi, pasi këto ndërtime kaq të shumëllojshme lënë vend për studime të mëtejshme dhe për përmirësime, qoftë edhe në mënyrën e ndërtimit në ditët e sotme, siç është edhe rasti i këtij punimi që ka të bëjë me "Elementet dekorativo-arkitektonike" që janë të shumta dhe dalluese për vetë banesën korçare në dallim me atë të qyteteve të tjera të Shqipërisë.

Gjithashtu në këtë punim nuk bëhet thjesh vetëm një panoramë e këryre elementëve, por është edhe një shtysë që të na ndihmojë sadopak në kuptimin, vlerësimin dhe admirimin e arkitekturës dhe urbanistikës korçare.

Ky punim është pjesë e punës kërkimore në fushën e trashëgimisë kulturore, që ka të bëjë me urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit, por edhe elementët arkitektoniko-dekorativë të cilët janë pjesë integrale e këtij studimi.

Metodat e përdorura për realizimin e kësaj pune janë bibliografike dhe praktike, sepse kërkimet në terren janë më të rëndësishme sesa literaturat e ndryshme që mund të jenë shkruar lidhur me çështje të tilla.

Materiali bazë për realizimin e kësaj pune janë vetë banesat e qytetit, sidomos ato të gjysmës së parë të shekullit XX, të cilat në qytetin tonë janë të shumta dhe përbëjnë bazën e jetës në të. Pra me një ekspertim të thjeshtë të qytetit mjafton për t'i identifikuar këto elemente dhe pë të bërë me to një material të bollshëm analize dhe gjykimi.

Shekulli XX, e në mënyrë të veçantë, gjysma e parë e këtij shekulli shënon për Korçën një rritje të theksuar të fuqisë ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Qyteti merr një zhvillim të madh dhe nga ana ndërtimore, që shfaqet në zmadhimin e ndjeshëm të territorit dhe në futjen e koncepteve të përparuara urbanistike dhe arkitektonike (Thomo, 1978,p.3).

Kristalizimi qysh herët i një tipologjie të përshtatshme, shtimi i potencialit teknik të ndërtimit dhe formimi i një shijeje të re artistike e ndikuar nga përmirësimi i mëtejshëm i mënyrës së të jetuarit, u bënë faktor nxitës që vëmendja e mjeshtrave të drejtohej dhe të përqendrohej edhe në gjetjen e mjeteve të reja shprehëse arkitektonike e dekorative.

Trajtimi i pamjeve të jashtme të banesave korçare tregon qartë për karakterin qytetar të saj. Pamja kryesore theksohet në qendër, ku vendoset gjithmonë erkeri i mbajtur zakonisht nga kolona të mëdha. Dritaret e mëdha, strehët e mbyllura dhe të vogla, përdorimi i gjerë i elementeve neoklasike, janë tipare të pamjes kryesore të banesës korçare, por as pjesët e tjera nuk lihen pas dore, sidomos në rastet kur janë buzë rrugëve, ato trajtohem me kujdes të veçantë(Riza, Strazimiri, 1972,p. 119).

Kështu duke vazhduar në analizën e teknikave do të flasim për ato, por dhe për dukuritë e reja si të ndërtimit, por edhe ato arkitektonike.

***Teknika e ndërtimit.*** Dihet që materialet kryesore të ndërtimit mbetën guri dhe tulla; me gurë ndërtohej kati përdhe ose bodrumi, muratura sidomos faqja e jashtme e saj punohej me rreshta të rregullt, me blloqe gurësh të skuadruar dhe të punuar në mënyra të ndryshme, duke luajtur kështu edhe rolin e një veshjeje dekorative. Kati ose katet e sipërme përgjithësisht ndërtoheshin me tulla. Si material lidhës shërbente llaçi gëlqeror.

Balta dhe brezat e drurit thuajse nuk përdoreshin.

Ndërtimet filluan të suvatoheshin dhe nga jashtë, gjë që e bënte shtëpinë dhe me të hijshme, por dhe e mbronte atë nga kushtet atmosferike të qytetit, nga temperaturat e ulta dhe nga reshjet. Duke patur parasysh kushtet e vështira klimaterike, ndryshimet e temperaturës gjatë stinëve dhe ngricat e shpeshta, teknologjisë së llaçit për suvatimet e jashtme u kushtohej një kujdes i veçantë. Përdorej rërë e larë mirë, gëlqere e stazhionuar dhe një raport i drejtë ndërmjet përbërësve të llaçit. Më vonë në suvatimet e jashme u përdor dhe çimentoja. (Thomo, 1981, p.168). Ndër materialet e tjera të reja mund të përmendim brezat betonarme antisizmikë, që u përdorën gjërësisht nga fundi i viteve ’20, si dhe futja e tjegullave marselieze dhe llamarinës për mbulesat e çative. Siç e përmendëm, katet sipër bodrumit ndërtoheshin me tulla, si ajo e mureve mbajtëse ashtu dhe e mureve ndarëse, duke krijuar një strukturë më të lidhur dhe të qëndrueshme.

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur dhe specialistët e shkolluar, të cilët jo vetëm që ndikuan drejtpërdrejt në ndërtimet e kohës, por problemet e ndërtimit të saktë i bënë çështje të opinionit publik. Kështu në “Gazetën e Korçës” më 19 shkurt 1931 në artikullin “Ç’na mësoi tërmeti” ( në atë kohë Korçën e tronditi një tërmet i fuqishëm në janar 1931), autori konsideron shkaktarë të dëmtimeve në Lagjen e Re, mes të tjerash, edhe teknikën jo të mirë të ndërtimit, muret me gurë të rrumbullakët e të lidhur me baltë, themelet e thatë etj. Në këtë artikull shtrohet nevoja e përdorimit të betonarmesë, por njëkohësisht tërhiqet vëmendja se edhe materialet e vendit si guri, gëlqerja, rëra e tulla janë të mira, në qoftë se punohen si duhen.

***Elementet prej guri të gdhendur.*** Këto elemente nuk është se ishin të panjohur si për ndërtuesit, po ashtu dhe për mjeshtrat e thjeshtë korçarë, të cilët me punën e tyre bënin që aspekti dekorativ i shtëpisë të përmirësohej. Këto,në periudhën pararendëse, përbënin elementet e rëndësishme të trajtimin arkitektonik e dekorativ të ndërtesave. Shtrirja e gjerë e përdorimit të tyre, shtimi i elementeve të punuara në gur si dhe mënyra e përpunimit të tyre, e pasuruan së tepërmi trashëgiminë në këtë fushë dhe u dhanë tiparet e veta dalluese kësaj tradite në Korçë.

Guri më i përdorshëm për realizimin e elementeve arkitektonike dhe dekorative ishte ai gëlqeror me ngjyrë gri dhe të zezë dhe shtufi, që nxirreshin në kodrat e qytetit, si dhe guri i kuq i Polenës. Sipas formacionit shkëmbor, guri nxirrej në blloqe të mëdha, nga të cilat përpunoheshin detajet me përmasa sa më të mëdha. Sipërfaqet e detajeve prej guri zakonisht përpunoheshin imët dhe konturoheshin nga një bordurë e lëmuar.

Elementet prej guri të gdhendur janë përdorur në ato vende ku kërkohej një theksim arkitektonik ose paraqitës për ndërtesën. Ato kanë zënë vend në portikët, portat e banesës e të oborrit, rrethimet e oborrit me kangjella hekuri etj. dhe më pak në elementet e tjera, si korniza dritaresh e strehësh, konsola ballkoni, dhe në interierët.

Por, periudhën që po flasim, punimi i gurit nuk u përqendrua vetëm në portikë dhe kolona, por ai ndihmoi në dekorimin e gjithë pjesës së jashme të shtëpisë, *portikut, shkallëve, oborrit*, të cilat së bashku formonin një pamje më tërheqëse për shtëpinë, ku pjesa qëndrore e oborrit shtrohej me plloça të rregullta dhe kufizohej me bordura ose parapetë me gurë të gdhendur, shpesh të shoqëruar me kangjella të ulëta prej hekuri. Në këtë

shesh hapen shkallët ballore prej guri, të mbrojtura nga një parapetë hekuri, që përfundojnë në portikun e hyrjes. Të gjitha elementet e tjera dekorative si *kolonat, kapitelet, arkitrarët* etj., punoheshin dhe zbukuroheshin me motive të ndryshme floreale ose klasike, për t'i dhënë ambientit të hyrjes së shtëpisë një pamje të mirë kuruar. Element i rëndësishëm i portikut është edhe porta, e cila vendosej ndërmjet dy dritareve të ngushta, nga merr dritë salloni. Hapësira e portës qarkohet me elemente guri të gdhendur, me shpatulla në formën e pilastrave që ruajnë të njëjtin përpunim si të kolonave, të cilat mbajnë arkitraun monolit prej guri, sipërfaqja e të cilit shpesh zbukurohet me gdhendje të ndryshme në reliev. Porta e rëndë prej druri me detaje të gdhendura dhe me kanatet prej xhami të mbrojtura me skara hekuri dekorative, harmonizohet me elementet e tjera të portikut dhe pasuron vlerat e tij. Një zhvillim të ndjeshëm patën portat e jashtme. Dallohen dy lloj portash; të hapura në muret rrethuese të plota dhe portat prej hekuri në rrethimet me kangjella. Të vendosura nga ana e realizimeve artistike, këto lloje paraqesin shkallë të ndryshme arritjesh, ndërsa nga ana shoqërore shprehin më së miri diferencimet klasore të popullsisë.

Në një përshkrim të thjeshtë të të dyja llojeve mund të themi se lloji i parë, nuk ndyshon shumë nga portat e periudhës pararendëse, veçse është një zhvillim i mëtejshëm i tyre, nëpërmjet përpunimit më mjeshtëror të elementeve përbërëse. Shpatullat e portës të punuara zakonisht me gurë shtufi në periudhën e parë, tani zëvendësohen me pilastra monolite prej guri gëlqeror, ndërsa arkitrau prej druri, me arkitra prej guri gjithashtu monolit. Në fazat e para të këtij zëvendësimi ruhen disa forma të vjetra të përpunimit të kapiteleve me linja të lakuara e spërdredhje si dhe shija për zbukurimin e tyre me gdhendje me reliev. Në këto vite në portat e banesave gjejmë shumë motive të gdhendura të nxjerra nga bota bimore, ajo e kafshëve, si dhe figura simbolike.

Lloji i dytë i portave me kangjella hekuri, na paraqitet më ndryshe dhe më i përpunuar dekorativisht. Kështu hapësirat e kangjellave dhe portës ndahen nga kolonat prej guri, të ngritura mbi parapetin ose xokolin e rrethimit. Kolonat e portës, të cilat dallohen nga të tjerat zakonisht kanë seksion rrethor, me zvogëlim të tij nga poshtë lart, por takohen dhe kolona me seksion drejtkëndësh. Ato përfundojnë me kapitele të gdhendura të pasuruara me zbukurime. Mbizotërojnë kapitelet me motive bimore, por janë të përhapura gjerësisht dhe motivet antike. Shpesh mbi kapitele, gjejmë të vendosura sfera guri, të cilat janë "shfaqje" në vilat më luksoze.

Në interierët përdorimi i gurit është shumë i kufizuar. Ai ndeshet kryesisht në ndërtimin e vatrës të dhomës së pritjes dhe është i realizuar në gur shtufi me këmbë të zbukuruara thjesht, ndërsa balli i oxhakut ndeshet i zbukuruar me përfytyrime qeniesh ose kafshësh mitologjike.

***Elemente dekorativë në suva.*** Gjatë kësaj periudhe suvatimi i jashtëm shërbeu si një mjet shumë i përshtatshëm për zbukurimin e ndërtesave. Duke e lënë gurin, si material më të fisshëm në vendet më të theksuara në trajtimin arkitektonik të ndërtesave, suvaja e zëvendësoi atë në elementet e tjera, si korniza, pilastra, harkime dritaresh, etj. Në këtë mënyrë suvatimi dekorativ shpejt u përhap gjerësisht dhe në ato banesa të shtresave të gjera të popullsisë, për të cilat dekorimi me gurë të gdhendur ishte e paarritshëm ekonomikisht. Ashtu si dhe ndërtimet e periudhave të mëparshme, janë të njëjtat elemente që i nënshtrohen përkujdesjes dekorative, por tashmë në përputhje me

teknikën dhe materialin e ri. Mund të marrim në analizë zbukurimin e dritares, kreun e saj, që është pjesa më e zbukuruar, i cili në vështrimin e parë të kujton qarkimin me fashatura e korniza druri të periudhave të mëparshme. Motivi më i përdorshëm është krijimi i një kornize mjaft të dalë në formën e një vetulloreje sipër hapësirës së dritares. Në të dy skajet e kësaj kornize dalin pilastrat, të cilat nuk zbresin deri në fund të dritares, por duken sikur luajnë rolin e konsolave për mbajtjen e vetullores. Mënyra e përpunimit të këtyre elementeve është e ndryshme: herë me kanelyra, herë me korniza të dyfishta, me përpunime të lakuara etj. Elementi i mesit shpesh merr vlera të pavarura, si motiv zbukurues i fushës mbi dritare. Ndër format e tjera që u përdorën për zbukurim janë frontet trekëndëshe ose në formë harku, por të shpeshta janë dhe kornizimet e thjeshta të gjithë perimetrit të dritares.

Elemente të tjera të fuqishme dekorative ishin kornizat, e në mënyrë të veçantë, ato nën çati. Si rregull korniza nën çati lidhej me pilastrat e dala në qoshe dhe ndonjëherë, edhe në mes të fasadës, duke krijuar kështu një konturim të sipërfaqeve, ku shpërndahen elementët arkitektonikë e dekorativë. Përgjithësisht, në përpunimin dekorativ në suva mbizotërojnë linjat e drejta, në përputhje me teknikën e realizimit të tyre, por nuk mungojnë dhe rastet, kur ndër elementet e mësipërme zbatohen motive më të ndërlikuara, si lule, stilizime gjethesh, imitime të dentikulave (dhëmbëzime) antike etj.

***Elementët prej hekuri.*** Ky element plotësoi dhe pasuroi trajtimin dekorativ të ndërtesave. Me gjithë arritjet e periudhës së mëparshme, përdorimi i elementeve prej hekuri ishte i kufizuar. Ato i gjejmë në skarat mbrojtëse të dritareve, më vonë në parapetet e shkallëve, ndërsa nga fundi i periudhës në fjalë, ato i ndeshim dhe në ballkone (një element i ri arkitektonik), si parapetë mbrojtëse të tyre. Punimi i hekurit në fillimet e tyre ishte sferë e veprimtarisë së *kovaçëve*. Ata e përpunonin hekurin në të nxehtë, me rrahje, duke formuar së pari shufra me seksion katror ose drejtkëndësh dhe pastaj i kthenin ato sipas formave të dëshiruara. Skarat e para mbrojtëse të dritareve imitonin skarat analoge prej druri të përbëra nga një rjet kuadratik. Më pas u përgjithësuan skarat e formuara nga kombinimi i elementeve në formën e një rrjete rombike, në fushat e së cilës vendoseshin elemente zbukuruese, të punuara me hekur më të hollë (Thomo, 1981, p. 175).

Në vitet e para të shekullit XX, filloi të importohej hekur i gatshëm me seksione të ndryshme për prodhimin e skarave. Me futjen e këtij lloji hekuri dhe duke shfrytëzuar cilësitë fizike dhe gjatësinë e tij, u fut teknika e punimit në të ftohtë. Elementet prej hekuri filluan të përdoren gjerësisht në rrethimin e oborrit, mënyrë kjo e panjohur më parë, duke i shtuar së tepërmi në parapetet e ballkoneve e të shkallëve e deri në skarat mbrojtëse të kanatave prej xhami në portat e hyrjes.

Kangjellat e rrethimit, për vetë funksionin dhe përmasat e tyre, i karakterizon uniformiteti i trajtimit. Ato përbëhen nga shufra të holla, të vendosura në një distancë të caktuar me njëra-tjetrën dhe brenda tyre ka një 'design' të caktuar, i cili përsëritet gjithmonë. Parapetet e shkallëve japin mundësi për trajtime më të lira dhe të shumë llojshme. Dallohen dy lloje motivesh; me përsëritje të motivit sipas aksit simetrik dhe parapete me motive të përsëritura ritmikisht në intervale të caktuara.

Efekte të jashtëzakonshme dekorative janë dhe skarat mbrojtëse në xhamllëkët e portave, të cilat të ndërtuara me hekur të hollë, shquhen për finesën e vizatimit, për fantazinë e kompozimeve, duke krijuar

përshtypjen e dantelave, ku humbet pesha dhe fortësia e hekurit (Thomo, 1981,p. 177).

Duke vazhduar në kontekstin e pjesës për të cilën po flasim mund të bëjmë dhe një analizë të vogël dhe të ***dukurive të reja arkitektonike*** të ndodhura në qytet në vitet '30-'40, vite këto që korrespondojnë me periudhën e ndikimit italian dhe pushtimin e tij. Si në çdo fushë, edhe në urbanistikë dhe arkitekturë, ndikimi i Italisë ishte i dukshëm dhe sidomos me rrymën e saj të ***eklektizmit*** e cila mbizotëronte ende në qytetet e tjera të Ballkanit dhe të Europës. Por, ndonëse në një masë të vogël, edhe zhvillimi urbanistiko-arkitektonik i Korçës nuk mundi të qëndronte i papërfshirë. Mund të përmendim këtu kino-teatrin "Mazhestik", hotel restorant "Pallas", kishën e shën Sotirit (e prishur nga tërmeti i vitit 1931), disa banesa vetjake etj., ku u manifestua më tepër kopjimi i modeleve të huaja dhe ndikimet ekletike. Kjo rrymë u ndie përgjithësisht në ndërtimet e shtresave të pasura, të cilat pasqyrojnë psikologjinë e shtresave të larta dhe zbulojnë prirjet kozmopolite të tyre. Rangun shoqëror dhe fuqinë ekonomike ata synonin t'i paraqisnin dhe së jashmi, me anë të banesës.

Një shembull tipik i këtij ndikimi është dhe banesa në bulevardin e shën Gjergjit. Zgjidhja planimetrike është mjaft e godittur, e arritur nëpërmjet një grupimi të qartë funksional. Katin përdhe e zënë dyqanet, ndërsa kati i sipërm përdoret për banim. Këtu, mjediset prezantuese, salloni dhe dhoma e pritjes, grupohen pranë shkallëve kryesore, ndërsa ato të përdorimit të përditshëm të familjes, si dhoma e zjarrit, dhomat e shërbimit dhe banjoja, janë grupuar më vete. Madje dhe ambientet e shërbimit janë veçuar, duke patur një hyrje të veçantë nga jashtë. Mjediset komunikojnë lirshëm mes tyre ndërmjet sallonit dhe verandës së madhe, të cilat përbëjnë qendrën kompozicionale të shtëpisë. Çatia e pjerrët e tipit ***mansardë***, ka lejuar vendosjen e mjediseve në hapësirën e saj. Studiuesi i njohur i arkitekturës dhe urbanistikës së qytetit, Pirro Thomo, flet për këtë ndërtesë duke thëne se *kësaj zgjidhjeje planimetrike komode dhe të kohës nuk i përgjigjet trajtimi i jashtëm. Në të janë grumbulluar pa kriter të qartë motive nga më të ndryshmet: kolona, harqe, relieve me suva etj., të cilat mbingarkojnë fasadat dhe kanë bërë të humbasë harmonia ndërmjet pjesëve përbërëse. Madje janë përdorur dhe elemente që nuk përligjen nga materialet e ndërtimit dhe strukturat konstruktive të përdorura, si konsolat nën ballkonet betonarmeje, bishtat e gdhendur nën çati etj*(Thomo, 1981, p. 179).

Shembuj të tjerë janë dhe ndërtesa si biblioteka e qytetit, ndërtesa e bankës në hyrje të qytetit, ndërtesa e bashkisë nga arkitekti italian P. Di Fausto etj. Duhet thënë se rrymat e mësipërme nuk gjetën përhapje të gjerë në Korçë, si për faktin që ato u manifestuan në një numër të kufizuar ndërtimesh, ashtu edhe për faktin tjetër se Korça kishte formuar tashmë një fizionomi arkitektonike të sajën, e cila zor se mund të tjetërsohej.

Një rol pozitiv në këtë drejtim luajti dhe opinioni i shëndoshë publik, ku sigurisht rreshtoheshin dhe arkitektët vendas. Në shtypin e kohës gjejmë një artikull me frymë të fortë kritike për ndërtimet, si edhe kërkesën në lidhjen me arkitekturën e vendit.

"*... në ndërtimin e kishës së Mitropolisë, ajo duhet të ketë një arkitekturë të këtij vendi, përndryshe do të jetë si një ndërtesë e huaj që s'e kish vendin në qytetin tonë*" (1928, mars 24, Gazeta e Korçës*)*. Me të drejtë po në këtë artikull, bëhet një krahasim me kishën e shën Gjergjit, ku thuhet se "*ky plan është me pak*

*ndryshime kopje e kishës së shën Gjergjit, një plan i ri për një vend të vjetër*". (Mitropolia e qytetit u ndërtua në vendin e një ish-kishe të rënë kohë më parë).

**Përfundime**

Në përfundim të analizës sonë rreth "Elementeve dekorativo-arkitektonike të banesave në gjysmën e parë të shekullit XX në qytetin e Korçës", duke bërë një përmbledhje të shkurtër, mund të themi se elementet dekorativo-arkitektonike të përdorura kanë patur një vijmësi zhvillimi gjatë gjithë periudhës për të cilën po flasim. Kemi përmirësimin e të gjithë elementeve të marra në shqyrtim, sidomos pas viteve '20 –'30 të shekullit XX, ku spikatin teknikat e ndryshme, si një element i rëndësishëm në mënyrën e ndërtimit. Pra, kemi një kalim nga ndërtimi i shtëpive vetëm me gurë, në futjen gjerësisht të tullës dhe përdorimin e saj në të gjitha ndërtimet e periudhës në shqyrtim, heqjen e trarëve antisizmikë të drurit dhe zëvendësimin e tyre me trarë betonarmeje, për-dorimin e tjegullave marselieze, por, si një risi për kohën, edhe përdorimin e llamarinës për mbulimin e çative.

Përsa u takon elementeve në suva, dalim në përfundimin se kemi një minimizim të rolit të gurit përsa i përket zbukurimit të fasadave dhe elementeve të tjera të dekorimit. Përdorimi i suvasë ishte më i lehtë për t'u përdorur, gjithashtu ishte më pak i kushtueshëm, gjë që e bënte atë më të përdorshëm nga të gjitha shtresat shoqërore të qytetit.

Dy pikat e tjera të punimit, elementet në gur dhe në hekur, mund të themi se kanë një farë vazhdimësie nga periudha paraardhëse, por ndeshen edhe disa elemente të reja siç janë shatërvanët, statujat dhe dekorimi i vatrave me punime guri. Në të dyja elementet kemi dhe futjen e teknikave të punimit dhe formave të reja dekoruese nga ato të shekullit XIX.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Baçe, A., Meksi, A., Riza, E., Karaiskaj, Gj., Thomo, P., (1979). *Historia e Arkitekturës Shqiptare.* Tiranë

Riza, E., Strazimiri, B. (1972). *Vështrim arkitektonik mbi qytetin e Korçës. Monumentet 3.* Tiranë

Riza, E. (1980). *Banesa qytetare shqipëtare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth çerekut të shek. XX. Monumentet 20.* Tiranë

Thomo, P. (1978). *Mbi arkitekturën dhe urbanistikën e qytetit të Korçës. Monumentet historike në vendin tonë.* Tiranë .

Thomo, P. *(1986). Zhvillimi urbanistik e arkitektonik i qytetit të Korçës gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX – fillim i shek.XX. Etnografia Shqipëtare 15.* Tiranë

Thomo, P. (1987). *Qyteti i Korçës dhe arkitektura popullore shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX. Kultura Popullore 1.* Tiranë

Thomo, P. (1981). *Korça urbanistikia dhe arkitektura.* Tiranë .

**Shtojcë**

**Fig.1. Elemente  të punuara prej  guri**

**Fig.2. Elemente  të punuara në suva**



**Fig.3.  Elemente të punuara në hekur**



**Fig. 4-5. Dukuri të reja arkitektonike. Eklektizmi.**

# VLERAT DHE RISQET GJEOLOGJIKE NË ZONËN KORÇË- DEVOLL.

**ERMIRA JASHIKU**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Ky punim ka për qëllim prezantimin e vlerave gjeologjike dhe risqeve të zonës Korçë-Devoll si dhe dhënien e alternativave për shfrytëzimin e pasurive nëntokësore për një zhvillim të qëndrueshëm.

Zona Korçë- Devoll nga pikëpamja tektonike bën pjesë në zonën Mirdita, me shumëllojshmëri të formacioneve shkëmbore dhe formave gjeomorfologjike. Shkëmbinj me pasuri të shumta minerale si hekur- nikeli, argjilat, rëra kuarcore, qymurguri etj., veç ndikimit pozitiv në zhvillimin ekonomik, shoqërohen me risqe gjatë shfrytëzimit jo të qëndrueshëm të tyre, si degradimi i tokës, rrëshqitje, ndotja e mjedisit, probleme në jetën dhe shëndetin e njeriut etj.

Si pjesë e thyerjes së Voskop-Dishnicës e cila përbën një nga linjat më aktive sizmike në Shqipëri, rajoni Korçë-Devoll përfshihet në hartën e tërmeteve me intesitet dhe magnitudë relativisht të lartë. Në historikun e tërmeteve të kësaj zone janë shënuar ngjarje me gjurmë mjaft të mëdha në aspektin njerëzor dhe material, si tërmeti i Korçës i vitit 1931, 1960, dhe ai i Babanit i vitit 2010.

Cili është roli i gjeografit në rastin e njohjes së problematikave dhe minimizimit apo evitimit te pasojave negative? Cila është rëndësia e njohjes së vlerave gjeologjike të zonës Korçë- Devoll? Cilat janë masat që duhen marrë për minimizimin e pasojave negative gjatë shfrytëzimit të mineraleve? Këto dhe të tjera do të jenë çështjet që do të trajtohen në artikull.

Metodat e përdorura në këtë punim janë: metoda e analizës së të dhënave në lidhje me pasuritë nëntokësore dhe intesitetin e tërmeteve të zonës, metoda e prognozës për të bërë parashikime për të ardhmen.

**Fjalët kyçe**: *risk gjeologjik, linja sizmoaktive,pasuri nëntokësore*.

**Abstract**

This piece of work aims to present the geological risks and values of Korça-Devolli region and also to provide alternatives for the exploitation of rich underground resources in order to promote a stable development and to minimize the consequences of the risks.

Korça-Devolli Region is tectonically part of Mirdita zone, with a variety of rock formations and geomorphologic forms. Rocks composed of minerals such as iron-cobalt, clay, quarts sand and coal, do not only create the bases of a good positive economical development, but also, on the other hand, are accompanied by risks during their inconsistent exploitation. To mention but a few, there is the risk of soil degradation, land sliding, environmental pollution, problems in local people's health and life. So, what is the role of a geographer in the process of identifying these problems and minimizing/avoiding the negative effects during exploitation?

Due to the fact that it is part of Voskop-Dishnice split, which in itself stands as one of the most intense active seismic lines in Albania, Korça-Devolli region is included in the map of the relatively high and intense-magnitude earthquakes. In the history of earthquakes of these region are marked events of great negative consequences in the material and human aspect, like the earthquakes of 1931 and1960, and that of Baban in 2010.

What is the importance of knowing the geological values of Korça-Devolli region? What measurements should be taken to minimize the negative consequences during mineral exploitation? These and other relevant issues will be treated in this article.

Methodology used in this work includes: surveillance, the analyses and interpretation of data about underground sources/riches and that of the data of region seismic intensity, the method of prognoses to make predictions about the future.

**Key words***: geological risk, active seismic line, earthquake, underground resources/riches*

Risqet natyrore të shkaktuara nga proceset endogjene dhe ekzogjene sjellin dëme të mëdha për natyrën edhe shoqërinë. Si rezultat i problematikave nga më të ndryshmet për shoqërinë njerëzore, gjeologë, gjeografë, klimatologë, ambientalistë dhe institucione të ndryshme po merren me studimin e shkaktarëve të risqeve. Veç tyre, ata po merren me studimin e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin dhe pasojat të cilat mund të jenë natyrore, materiale dhe njerëzore.

"Tërmetet janë dukuritë më shkatërrimtare të natyrës" (Sulstarova, 1978,p. 10). Ato janë lëvizje të menjëhershmë të tokës të cilat kur kanë intesitët të lartë shoqërohen me pasoja katastrofike. Shkak i zhvillimit të tyre janë proceset endogjene që lidhen me lëvizjen e pllakave tektonike, rrudhosjet apo mbihipjet të cilat lidhen me përbërjen gjeologjike dhe karakterin e truallit. Ato mund të kenë dhe shkaqe të tjera të lindjes dhe zhvillimin e tyre si faktorë antropogjenë, lidhja me trupat qiellorë etj. Tërmetet janë karakteristike kryesisht për zonat akoma të paqëndrueshme si rezultat i lëvizjeve ngritëse, ulëse etj. Ata mund të shkaktojnë të çara të tokës, rrëshqitje, ngritje apo ulje të territorit, ndryshime në hidrografi, krijimin e pseudovullkaneve dhe dëme materiale dhe njerëzore.

Përbërja gjeologjike e zonës Korçë-Devoll me shkëmbinj të larmishëm ka përmbajtje minerale të ndryshme si hekur-nikel, (Foto 1) argjilat, rërat kuarcore, (Foto 2) qymyrguri, bakri, kromi, të cilët gjatë shfrytëzimit të tyre veç përfitimeve nga pikëpamja ekonomike, sjellin dëme të konside-rueshme për natyrën dhe njeriun.

**Foto 1.** ***Kapshticë-Dalje minerali të hekur-nikelit***

**Foto 2** ***Ziçisht-Rëra kuarcore***

## 1. Tektonika dhe gjeologjia

Zona Korçë- Devoll nga pikëpamja e zonimit neotektonik bën pjesë në trevën e brendshme me regjim në tërheqje, si pjesë

e horsteve dhe grabeneve të zonës tektonike Mirdita. Kjo zonë karakterizohet kryesisht nga lëvizjet ngritëse dhe regjim në tërheqje horizontale. (Aliaj, 1988, p.42). Formacionet më të vjetra i përkasin trias-jurasikut. (Qiriazi, 1985, p. 17) Në periudhat e mesozoit dhe kenozoit vihen re shkëmbinjtë karbonatikë, (Foto 3) ofiolitet, (Foto 4) flishet dhe molasat. Gëlqerorët dolomitikë kanë ngjyrë gri të çelur deri në gri në të zezë; kjo gjë duket më së miri në Malin e Thatë(Foto 5). Kompleksi Ofiolitik i Moravës shtrihet nga Floqi deri në Zëmblak; në pjesën perëndimore të tij vendosen depozitimet e fushës së Korçës, ndërsa në lindje depozitimet e Oligocenit të Mesëm.

**Foto 3.** ***Prespa-Shkëmbinj karbonatike***

**Foto 4.** ***Ofiolitet e Moravës***

**Foto 5.** ***Zvezdë, Mali Thatë-Shkëmbinj karbonatikë***

Ndërlikimi i strukturës vihet re në tektonikën rrudhosëse, shkëputëse atë të mbihipjeve e cila ka krijuar forma gjeomorfologjike nga më të ndryshmet (Fig.1,2), ku përmendet Sinklinali i Devollit, Grabeni i Korçës, i Prespës. Këtu vazhdojnë ende lëvizjet diferencuese dhe kjo është një nga arsyet e sizmicitetit të lartë të zonës. Për t'u përmendur janë lëvizjet neotektonike me prirje ulëse në Gropën e Korçës, dhe me prirje ngritëse në Luginën e Devollit dhe gropën e Prespës.




***Fig.1. Sipas Ll.Dimo***

**Një njësi mjaft e rëndesishime në këtë zonë është Gropa e Korçës (Fig.2,3**)

*Gropa e Korçës*, e cila përfaqëson një zonë të ulur grabenore, është një gropë ndërmalore e mbushur me depozitime Oligo-Miocenike. Veprimtaria tektonike e kësaj zone ka qenë intensive sidomos para Oligocenit dhe depozitimet molasike janë vendosur transgresivisht mbi komplekse të ndryshme shkëmbore (Onuzi et al, 2011,p. 15). Në rajonin Cangonj-Bitinckë ato shtrihen transgresivisht edhe mbi depozitimet e Eocenit të mesëm, të cilat nga ana e tyre gjithashtu shtrihen transgresivisht mbi shkëmbinjte ofiolitikë dhe formacionet karbonatike triasiko-jurasike dhe jurasiko- kretake. Në gropën e Korçës nga ana strukturore, dallohen tre njësi kryesore: Sinklinali i Devollit, i Korçës dhe i Gorë-Mokrës (Fig 6,7), (Onuzi et al, 2011, p.15)

***Sinklinali i Devollit*.** Shtrihet në gropën e Devollit në juglindje të vendit me drejtim gati veri-jug ndërsa drejtimi i

Albanideve me drejtim juglindje-veriperëndim (Onuzi et al, 2011, p. 15). Kjo njësi si rezultat i shkëputjeve tektonike të pas Pliocenit, është ndarë nga masivi ultrabazik i Moravës me sinklinalin e Korçës. Ai në pjesën verilindore kufizohet me horstin e Malit të Thatë, "*nëpërmjet shkëputjes së krahut perëndimor, gjatë së cilës daljet e shkëmbinjve ultrabazikë mbulohen pjesërisht nga depozitimet e Eocenit.*" (Onuzi et al, 2011, p. 15)

Sinklinali i Devollit, i përfaqësuar në pjesën më të madhe të tij nga krahu perëndimor dhe me zvogëlim të krahut të tij në jug deri me 10 °, përbëhet kryesisht na depozitimet molasike, ku ato më të vjetrat i përkasin periudhës së Oligocenit të mesëm *(formacioni "Drenova, Drenica" dhe argjilat me chama). "Këto depozitime janë në formën e një rripi të ngushtë dhe të vendosura transgresivisht mbi shkëmbinjt ultrabazikë. Në skajin verior ky sinklinal shprehet vetëm me depozitimet e Burdigalianit, të cilat për efekt të shkëputjeve neotektonike mbihypen pjesërisht nga horsti i Malit të Thatë. Krahu lindor i sinklinalit të Devollit lexohet vetëm sipas depozitimeve të Burdigalianit, të cilat bien nga perëndimi me kënde 20-35°. Pykëzimi i shpejtë i depozitimeve të Oligocen-Akujtanianit në rajonin Plasë-Cangonj, mund të shprehë pykëzimin e tyre edhe në drejtim të lindjes dhe që krahu lindor i këtij sinklinali, të përfaqësohet vetëm me depozitimet e Burdigalianit dhe pjesërisht ato të Langianit*. " (Onuzi et al, 2011, p. 16)

***Sinklinali i Korçës.*** Shtrihet në qendër të gropës së Korçës. Në lidhje me ndërtimin gjeologjik të tij nuk mund të jepen të dhëna të sakta, pasi ka mangësi në të dhënat sipërfaqësore. Duke u bazuar në daljet fragmentare të molasave oligocenike në pjesën jugore (Pulaha), dhe nga disa puse kërkimi nën mbulesën Plio-Kuaternare, ky sinklinal inerpretohet si një ulje grabenore me zhytje drejt Verilindjes të shkaktuara nga shkëputja e tektonikës së vonshme dhe neotektonikës (Onuzi et al, 2011, p. 16**)**. Krahu perëndimor i këtij sinklinali dallohet qartë sipas depozitimeve të Miocenit të poshtëm, të cilat bien në lindje me kënde 20-30°. Trashësia maksimale depozitimeve oligo-miocenike të këtij sinklinali është e krahasushme me ato të sinklinalit të Devollit rreth 3000-3500 m.

Territori i rretheve Korçë- Devoll bën pjesë në zonën e thyerjeve të Librazhd-Mokrës dhe të Korçë- Ohër- Ersekës. Zhytja dhe diferencimi i tyre, ngritjet e zonave përreth dhe thyerja e Voskop-Dishnicës rigjenerojnë termete, shpesh, të fuqishme. Këto tërmete arrijnë vlerat me magnitudë më të vogël se 6.5 dhe Intesitet deri në VIII- IX ballë. Thellësia e vatrës së tërmeteve është e cekët nga 5-25 km. Si rezultat i aktiviteteit të lartë simik, përmenden një numër i madh tërmetesh me paragoditje dhe pasgoditje të shumta, disa me pasoja materiale dhe njerëzore dhe të tjerë të pandjeshëm nga shoqëria njerëzore por, të regjistruar nga instrumentet sizmike. Disa nga tërmetet më të dëmshme për këtë territor janë ai Ohrit i vititi 1911, i Korçës i vitit 1931 dhe 1960 dhe i Babanit i vitit 2010 (Fig.5).




***Fig.2 Skicë tektonike e basenit të Korçës. Sipas Ll.Kumati***



*Fig.3. Skicë gjeologo- tektonike e basenit të Korçë-Devoll. Sipas K.Onuzi 2012*

***Tërmeti i 18 shkurtit 1911,*** me magnitudë 6.7 rihter dhe intesitet 9 ballë, i cili kishte epiqendrën e tij në Liqenin e Ohrit, solli dëme të mëdha materiale dhe njerëzore në qytetin e Ohrit dhe të Pogradecit. Ai shkaktoi dëme të mëdha edhe në qytetin e Korçës dhe Bilishtit. Ka qenë një nga tërmetet më të fuqishme në histori, i cili përfshiu një hapësirë të gjerë jo vetëm në në vendin tonë, por edhe Maqedoni dhe më gjerë. Ai gjithashtu u ndje në Itali me intesitet 5 ballë. (Sulstarova, 1978, p. 26)

***Tërmeti i 28 janarit 1931*** me intesitet VIII-IX ballë dhe magnitudë 5.8, shkaktoi dëme të mëdha materiale sidomos në fshatrat Polenë, Voskopojë, Vithkuq, Gjergjevicë etj. dhe në qytetin e Korçës ku u dëmtuan rreth 80 % e shtëpive. Ndërsa në Polenë, nga 103 shtëpi që kishte fshati, u dëmtuan 90 shtëpi. Ndoshta dëmet do të ishin akoma më të mëdha nëse ky tërmet do të kishte rënë në orët e ditës, pasi njerëzit do te ishin jashtë dhe shkatërrimi i banesave do të ishte shkak për numrin më të madh të viktimave.

***Tërmeti i 26 majit 1960*** i cili ishte me magnitudë 6.4 dhe intesitet VIII-IX ballë shkaktoi dëme të mëdha në qytet dhe në fshatrat e Lavdarit, Vithkuqit, Polenës, Gjergjevicës, Voskopojës etj. Ai bëri të pabanueshme 25 % të banesave; 1479 banesa, 7 të vrarë dhe 127 të plagosur, 103 shtëpi të shkatërruara plotësisht.Në fshatrat përreth u shkatërruan 309 shtëpi, u dëmtuan rëndë 488 dhe lehtë 628 (Sulstarova, 1978, p. 33). Ai shkaktoi dëme të tjera si rrëshqitje, çarje të tokës, daljen e burimeve të reja nëntokësore dhe ndryshim të rrjedhjes për disa të tjera.

***Tërmeti i 28 gushtit 2008*** me intesitet V-VI ballë kishte epiqendrën në qytetin e Maliqit dhe u ndje edhe në qytetin e Korçës , madje deri në zonën kufitare me Maqedoninë. Ai u shoqërua nga 150 goditje.

***Tërmeti i Babanit 11 Shtator, 2010*** i shoqëruar me 149 pasgoditje i lokalizuar në një thellësi vatrore 3 km me magnitudë midis intervaleve 1.3- 3.0 dhe me Intesitet V-VI ballë, u ndie në qytetin e Korçës si dhe në shumicën e fshatrave përreth, në qytetet e Pogradecit dhe Gramshit si dhe në zonën kufitare Shqipëri-Maqedoni.

Gjatë periudhës kohore 2001- 2010 përgjatë zonës së Devollit janë lokalizuar rreth 41 tërmete nga të cilët 8 prej tyre me M≥3.0.

Dëmet e shkaktuara nga tërmetet janë nga më të ndryshmet, si dëme materiale, njerëzore, ndryshime dhe prishja e konfiguracionit të relievit, ndryshimet në rrjedhjen e ujërave nëntokësore etj. Trualli i butë dhe i mbingopur me ujë është ai i cili preket me shumë nga aktiviteti sizmik dhe priret drejt dëmeve më të mëdha.




**Fig.5-** ***Harta e epiqendrave të tërmeteve të zonës së Korçës dhe rreth saj, periudha 2001-2010, ML=2.1-4.4. (Rr. Ormëni 2011).***

**Ndërtimi gjeologjik dhe pasuritë minerale.**

Zona Korçë- Devoll ka ndërtim të larmishëm gjeologjik të përfaqësuar nga shkëmbinj gëlqerorë, ultrabazikë, terrigjenë etj., të cilët paraqiten jo vetëm me format e ndryshme të relievit nga proceset gjeomorfologjike, por edhe me ekzistencën e pasurive të shumta minerare. Përbërja gjeologjike e shkëmbinjve që përfaqësojnë këtë zonë, nisur nga mosha e tyre ose kolona stratigrafike është si më poshtë: shkëmbinjtë më të vjetër janë ata të Triasikut (Foto 3, 5), Jurasikut dhe të Kretakut. Depozitimet e Triasikut arrijnë një trashësi më të madhe se 100 m dhe shtrihen nga mali i Thatë deri në grykën e Trenit dhe përbëhen kryesisht nga gëlqerorë pllakorë. Depozitimet Jurasike përbëhen nga shkëmbinj magmatikë ultrabazikë, të cilët kanë dalje në sipërfaqe në zonën e Moravës (Foto 4), Bitinckë - Bilisht-Vërnik. Depozitimet Kretake të cilat arrijnë trashësinë deri në 80 m, përbëhen nga fragmente të shkëmbinjve gëlqerore. Më sipër vazhdojnë depozitimet e Paleogjenit me trashësi deri në 500 m, të cilat përbëhen nga formacione karbonatike Molasike, gëlqerore Konglomeratike dhe shtrihen nga gryka e Trenit deri në Kapshticë. Më pas vijnë depozitimet e Neogjenit me trashësi deri në 300 m, të përfaqësuara nga formacionet terrigjene të malit të Moravës dhe ranorët e Burdigalianit në zonën Bitinckë-Bilisht–Kapshticë. Mosha e këtyre shkëmbinjve është përcaktuar nga analizat e karbonit si dhe fosilet e gjetura në to. Depozitimet më të reja janë ato të Kuaternarit, me trashësi të depozitimeve deri në 300 m, të cilat përbëhen nga sedimentet deluvionale kryesisht në tokat bujqësore.

Si rezulat i faktorëve gjeologjikë i kohë formimit dhe llojeve të ndryshme të shkëmbinjve, kjo zonë dallohet për shumëllojshmëri të mineraleve. Ato kanë tërhequr vëmendjen e ekspeditave inxhiniero- teknike të specializuara, të cilat kanë bërë vlerësimet në lidhje me rezervat dhe rëndësinë e tyre.




***Harta 1. Pasuritë nëntokësore të zonës Korçë-Devoll.***

Vendburimi i *hekur- nikelit* dhe *nikel-silikatit* në Bitinckë është më i madhi në gjithë Shqipërinë dhe ndodhet në lindje të fshatit të Bitinckës. Ai i përket moshës së Eocenit të mesëm (Ostrosi & Peshkëpia, 1983, p. 17). E gjithë seria e këtij vendburimi ka një trashëri prej 600 m. Hekuri-nikeli i cili gjendet në zonën Bitinckë-Tren-Vërnik dhe Kapshticë (Foto 1), sipas studimeve gjeologjike të kryera në vitet 1958- 2010, përfshin një sipërfaqe prej 30 km$^2$. Shfaqje të xeherorëve të hekurit vihen re dhe në Zëmblak, Progër etj.

*Vendburimi i rërave kuarcore* me shtrirje nga Dembrava (Poloskë) deri në Ziçisht- Çipan (Foto 2), ka shërbyer si lëndë e parë dhe është përdorur në fabrikën e qelqit në Korçë. Shfrytëzimi i këtij vendburimi ka sjellë prishje të konfiguracionit të relievit. Aktualisht nuk po shfrytëzohet, por ka perspektiva për shfrytëzim dhe kërkesa (sidomos qelqi me ngjyra) dhe do të jetë një burim sigurimi të ardhurash të konsiderueshme në të ardhmen, nëse shfrytëzohen sërisht.

*Vendburimi i qymyreve të tipit linjit*, është i përhapur në rrethin e Devollit,

sidomos në Menkulas dhe në malësinë e Mborje-Drenovës. Vendburimi i Menkulasit i cili ndodhet në rrethin e Devollit dhe cilësohet si qymyr brun me rezerva mbi 3 milion ton. (Onuzi et al, 2011, p. 76). Pellgu qymyrmbajtës i Mborje- Drenovës i përket moshës së Oligocen- Miocenit të poshtëm dhe në të janë shfrytëzuar 8658 mijë ton mineral (Onuzi et al, 2011, p. 75). Aktualisht shfrytëzohen nga firma private me kapacitet prodhimi minimal.

*Vendburimi i argjilave* të cilat i përkasin depozitimeve të Miocen- Pliocenit. Argjili është mjaft i rëndësishëm për industrinë e porcelanit, të çimentos, të ndërtimit të tjegullave dhe tullave dhe, kohët e fundit në industrinë e kozmetikës, me përhapje të gjerë sidomos në brigjet e lumit Devoll; nga fshati Fitore deri në fshatin Menkulas dhe Kuç, Vranisht- Pilur, Baban, Eçmenik, Inonisht, Korçë. Vendburimi i Inonishtit me ngjyrë gri të kaltër në të gjelbër, llogaritet në rezerva në mbi 4 000 000 ton. Vendburimi i Vranishtit, me rreth 180 000 ton, me ngjyrë bezhë në gri të çelur, gjen përdorim më të gjerë në industrinë artistike. Vendburimi i Argjilave në JP të qytetit të Korçës, një nga burimet kryesore të prodhimit të tullave dhe tjegullave që në kohët e sistemit komunist, llogaritet me rezerva 879 313 $m^3$. (Onuzi et al, 2011,p. 85)

Vendburimi *i shkrifërimeve* në formën e rërave të trasha, ka një përhapje në dy zona; njëra nga Vishocica deri në Miras dhe e dyta nga Cangonji në Çipan. Ato jo vetëm gjejnë përdorim si materiale ndërtimi, por kanë vlera edhe për pasuritë me minerale të rralla si uranium, sfen, zirkon etj.

*Materialet e ndërtimit në formën e gëlqerorëve- konglomeratikë dhe gëlqerorë granil*, janë të përhapura përgjatë lumit Devoll dhe në Burimas- Kapshticë si dhe Bilisht-Kokogllavë-Kapshticë dhe Progër-Tren. Gëlqerorët shfrytëzohen si material ndërtimi, në Zëmblak, Zvezdë, në jugperëndim të Malit të Thatë dhe kanë sjellë mjaft efekte negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe prishje të konfiguracionit të relievit. Burimet e gëlqerorëve të shfrytëzuara në industrinë e prodhimit të gëlqeres, çimentos etj, llogariten me rezerva prej 5 000 000 ton.

*Materialet e ndërtimit dhe zbukurimit* (si azbest, talk etj.) gjenden në Bilisht, Progër, Boboshticë, Zëmblak, etj.

Kjo zonë dallohet dhe për burime të kromit dhe bakrit me një rëndësi të madhe për metalurgjinë me ngjyra.

Ekzistenca e vendburimeve në rrëzë ose në shpate të maleve, në terrenet shkëmbore, larg sipërfaqeve me nivel të lartë të ujërave nëntokësore, ka sjellë reduktimin e efekteve shkatërruese të tyre. Megjithatë nuk mund të lëmë pa përmendur dhe efektet negative gjatë dhe pas shfrytëzimit të tyre. Këto pasuri po shfrytëzohen intesivisht dhe gjithashtu eksportohen edhe jashtë vendit si p.sh. në Maqedoni. Po kështu, mjaft miniera janë hapur në ultrabazikët e malit të Moravës, boksidet në malin e Thatë etj.

Rëndësia e studimit të pasurive nëntokësore synon evidentimin e vendburimeve minerale dhe vlerave të tyre për zhvillimin ekonomik të kësaj zone, por në të njëjtën kohë edhe për marrjen e masave për një shfrytëzim sa më cilësor të tyre, për evitimin apo parandalimin e pasojave.

**Risqet e shfrytëzimit të mineraleve dhe masat**

Mineralet që shfrytëzohen me kariere si Fe-Ni, rërat, shkrifërimet, qymyret, argjilat, materialet e ndërtimit etj., paraqesin rreziqe të ndryshme për shëndetin dhe jetën e puntorëve, për degradimin e tokës, dëme në botën bimore dhe shtazore.

Për t'u përmendur është prishja e konfiguracionit të relievit, ku përmenden vendburimet e Fe-Ni në Bitinckë,

Kapshticë, gëlqerorët në Progër dhe Zëmblak etj.

Vendburimi i Fe-Ni përbën një nga pikat më të nxehta në Shqipëri përsa i - përket ndotjes së ajrit dhe tokës. Rreziqe te tjera veç shëndetit të punëtorëve përmendet dhe humbja e jetës së tyre.

***Përfundime***

Zona Korçë- Devoll ka ndërtim gjeologjik të larmishëm tektonik të komplikuar dhe është një zonë me një aktivitet të lartë sizmik, ku tërmetet e saj klasifikohen në ata të mesëm dhe të rrallë me M më të vogël se 6.5 dhe I VIII- IX ballë. - Historiku i tërmeteve flet për një përsëritje të këtij risku në periudha 20, 30 dhe 100-vjeçare. -

- Njohja e intesitetit të aktivitetit sizmik veç krijimit të parashikimit të mundësisë së - ndodhjes së tërmeteve jep informacione për marrjen e masave për minimizimin e - dëmeve të shkaktuara prej tyre në mjedisi gjeorafik edhe për shoqërinë njerëzore.
- Zona Korçë- Devoll ka pasuri të shumta - minerale të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës, duke i eksportuar apo edhe duke i përpunuar dhe përdorur në vendin tonë ku përmenden Fe- Ni, argjilat, rëra kuarcore, qymyret, bakri, kromi.

Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore pa përdorur mjetet e domosdoshme dhe pa studiuar mirë terrenin, kanë sjellë dëme të konsiderueshme për natyrën dhe shoqërinë njerëzore.

***Rekomandime***

Hartimi dhe shpjegimi i hartave të risqeve gjeologjike të bashkangjitura me të dhënat për vlerat e mundshme të ndodhjes së tyre.

Ndërtimi i banesave me më pak se 6 kate dhe ndërgjegjësimi i njerëzve rreth pasojave të riskut të rënies së tërmeteve.

Hartimi i planeve të sakta për shfrytëzimin e mineraleve duke studiuar zonën.

Përdorimi i mjeteve dhe metodave të duhura për shfrytëzimin e mineraleve.

Mbushja e gropave pas nxjerrjes së mineraleve dhe mbjellja e gropave me bimësi të përshtatshme për zonën.

Studim i vazhdueshëm i kësaj zone për të parë ecurinë e riparimit të tokës.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Aliaj, Sh. (1988). *Tipare të strukturës neotektonike të Shqipërisë*. Studime Gjeografike 3,Tiranë,

Aliaj, Sh., Koçiu, S., Muço, B., Sulstarova, E. (2010). *Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri*, Tiranë.

Onuzi, K., Kolle,r P., Hock, V., Stoja, Gj., Kosho, P., Ormeni, R. (2011). *Harta Gjeologjike 1: 50 000 dhe teksti spjegues i Planshetit 43 Korça*, Tiranë (UTM.IGJEUM)

Onuzi, K., Koller, P., Hock, V., Palko, A., Kosho, P., Ormeni, R. (2010). *Harta Gjeologjike 1: 50 000 dhe teksti spjegues i Planshetit 42 Maliq,* Tiranë, (UTM.IGJEUM)

Ormeni, R. (1999). *Tërmetet të pazakontët e Botës*, Tiranë, INFOBOTUES.

Ostrosi, B. & Peshkëpia, A. (1983). *Gjeologjia e Vendburimeve të Mineraleve të Dobishme 2.* Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera,

Peza, L. (1967). *Gjeologjia e Shqipërisë.* Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Katedra e Gjeologjisë.

Qiriazi P. (2006). Gjeografia Fizike e Shqipërisë, botimet ideart.

Qiriazi, P. (1985). *Morfologjia dhe morfogjeneza e gropave juglindore*, Tiranë.

Savarenskij, P. E. (1951). *Tërmetet shkaqet dhe studimi i tyre*, Tiranë, Komiteti i Arteve dhe Kulturës.
Sulstarova, E. (1978). Tërmetet, Tiranë.
Trojani, V. (2004). *Gjeografia Fizike e Përgjithshme I,* Tiranë, Afëdita.

# HISTORIA EKONOMIKE E SHQIPËRISË NDËRMJET VITEVE 1920-1939

**METIN VENXHA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Vitet ndërmjet dy luftrave botërore në Shqipëri kanë sjellë debate të shumta në familjen e historianëve dhe studiuesve të shkencave shoqërore mbi suksesin e reformave ekonomike të qeverive shqiptare, për të krijuar një model të ri ekonomik që të shënonte shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë nga tradita osmane dhe të drejtonte ekonominë e vendit drejt tregut të lirë dhe zhvillimit industrial.

Stabilizimi i jetës politike pas qershorit të vitit 1924 i hap rrugë reformave strukturale që do të shënonin në historinë e vendit tentativën e parë drejt sistemeve ekonomike që kishin si model zhvillimi ndërtimin e raporteve kapitaliste në ekonomi. Pikërisht është detyrë e historisë dhe në veçanti e historisë ekonomike të studiojë dinamikat, proceset, dhe ngjarjet ekonomike për të dhënë një përshkrim të qartë të situatës ekonomiko-shoqërore të Shqipërisë në ato vite dhe jo vetëm kaq.

Historia ekonomike i jep përgjigje dilemave që shoqërojnë mendimin historik shqiptar pas vitit 1945 mbi interpretimin e periudhës zogiste.

Objektivi i këtij punimi së pari synon të na bëjë të njohur se cili është objekti i studimit të historisë ekonomike brenda shkencës së historisë dhe së dyti të analizojë dhe të japë përgjigje konkrete mbi situatën ekonomike në Shqipëri përgjatë viteve 1920-1939.

Gjithashtu për të përshkruar sa më mirë të shkuarën ekonomike të vendit, do të merren për analizë dy sektorë të rëndësishëm të jetës ekonomike, si industria ushqimore dhe industria e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Metodat e përdorura në punim kalojnë në tre faza, mbledhja e burimeve dokumentare dhe bibliografike, analiza kritike e tyre dhe interpretimi dhe përdorimi i tyre përgjatë punimit. Meqenëse disiplina e historisë ekonomike në Shqipëri ka fituar terren vetëm në dekadën e fundit, bibliografia është shumë e varfër në këtë aspekt. Për këtë arsye një punim i tillë kërkon një përqendrim më të madh në mbledhjen e burimeve primare dhe analizën kritike të tyre. Punimi ka qëllimin final të na japë një tablo të situatës ekonomiko-shoqërore të Shqipërisë në vitet 1925-1939.

**Fjalë çelëse**: *histori ekonomike, industria, politikat ekonomike, modele zhvillimi, energjia elektrike, kapitalizëm, treg i lirë, bujqësi.*

**Abstract**

The years between the two world wars in Albania have brought numerous debates in the family of historians and shoqëror sciences scholars on the success of economic reforms of Albanian Governments to create a new economic model aiming at the final separation of Albania from the Ottoman tradition and leading country's economy to the free trade and industrial development.

Stabilization of political life after June 1924 gives way to the structural reforms that would mark in the history of the country the first attempt towards the economic systems

that have as a development model the construction of capitalist relations in the economy. It is precisely the task of the history, and particularly of the economic history to study the dynamics, processes, and economic events to give a clear description of the socio-economic situation of Albania in those years.

Moreover, the economic history answers to the dilemmas which go along with the Albanian historical opinion after the year 1945 on the interpretation of the King Zog's period.

Precisely, the objective of this approach is to make known to us in the first place who is the object of study of economic history within the science of history, and secondly to analyze and provide concrete answers on the economic situation in Albania during the years 1920-1939. In addition, to better describe the economical past of the country, there will be analyzed two important sectors of the economic life, such as the food industry and the industry of production and distribution of electricity.

The methods used in this approach pass through three stages: collecting the documentary and bibliographic resources, their critical analysis and interpretation, and their use in the approach. As the discipline of the economic history in Albania has gained ground only in the last decade, the bibliography concerning this field is very poor.

For this reason, such an approach requires a greater focus on the collection of the primary resources and their critical analysis. The approach has the ultimate goal to give us a picture of the Albanian socio-economic situation during the years 1925-1939.

**Keywords:** *economic history, industry, economic politics, development models, electricity, capitalism, free trade, agriculture.*

**Hyrje në historinë ekonomike**

Disiplina e quajtur "*histori ekonomike"* është historia e fakteve dhe ngjarjeve ekonomike në nivel individual, shoqëror apo kolektiv. Si e tillë është e ndryshme nga "*historia e doktrinave*" ose nga historia e teorive ekonomike. Ajo është pjesë përbërëse e historisë së njeriut dhe si e tillë duhet patur parasysh që është e ndikuar nga karakteristikat fiziologjike dhe psikologjike të njeriut, të racionalitetit apo iracionalitetit, të karakteristikave mendore, shoqërore dhe kulturore si në nivel individiual ashtu dhe në nivel kolektiv (Cipolla ,2003, p.13).

Historia ekonomike është një disiplinë relativisht e re. Në të vërtetë, forma e saj embrionale i takon shekullit XVII , por një historiografi e maturuar dhe e njohur në fushën akademike shfaqet vetëm në shekullin XIX dhe merr trajtën përfundimtare në fillim të shekullit XX. Kur ndërmjet viteve 1846-1856 *George Grote*, një nga studiuesit më të mirë të Greqisë publikonte veprën monumentale *"Historia e Greqisë",* ai vetëm sa prekte shkarazi aspektet ekonomike dhe shoqërore, kurse sot pas më shumë se 100 viteve distancë, është e pamundur që diçka e tillë të ndodhë. Në librat më të përgjithshëm të historisë, gjen kapituj të tërë që flasin për aspektet ekonomike dhe shoqërore. Duke u konfirmuar, siç thamë në gjysmën e dytë të shekullit XIX , ajo ndërmjet viteve 1930-1970 arrin suksesin e saj më të madh duke bërë që disa nga fushat e saj të studimit të bëheshin autonome. Sot ka revista të specializuara dhe kurse universitare që i dedikohen specifikisht historisë së popullsisë, historisë së tregtisë, historisë së bujqësisë, historisë së monedhave dhe bankave, historisë së trasporteve dhe historisë shoqërore.

Shembulli më i mirë për të kuptuar rëndësinë e historisë ekonomike në njohjen e së shkuarës është vepra e

historianit belg Henri Pirenne, *"Muhamedi dhe Karli i Madh"* botuar në Bruksel më 1937. Në këtë vepër autori arrin që për herë të parë të japë një interpretim të ri, larg interpretimit tradicional që bënte historiografia europiane mbi shkaqet që çojnë në fundin e periudhës së Antikitetit dhe fillimit të Mesjetës në Europë. Duke nisur analizën e vet mbi studimin e tregtisë, bujqësisë, blegtorisë, zejtarisë dhe demografisë, Pirenne arrin të shkruajë historinë e Mesjetës së hershme mbi baza tërësisht të reja. Sipas tij, pushtimi i Detit Mesdhe nga ushtritë arabo-islamike në fillim të shekullit VIII, ndryshon sjelljen ekonomike të Europës mesdhetare, gjë që reflektohet drejtpërdrejt në ndryshimin politiko-institucional të saj. Studimi i fakteve, ngjarjeve dhe dokumenteve ekonomike nga Pirenne, na jep mundësinë të analizojmë strukturën e shoqërise së re europiane që formohet pas shekullit VIII (Pirenne,1937).

Ndihmesën kryesore në konfirmimin definititiv të historisë ekonomike dhe shoqërore si disiplina akademike dhe të pashmangshme në studimin e së shkuarës, e japin, ndërmjet dy Luftrave Botërore, dy historianët e Universitetit të Strasburgut, March Bloch dhe Lucien Febvre, të cilët në vitin 1929 themelojnë *"Annales d'Histoire Economique et Shoqërore*", e cila është gjatë gjysmës së parë të shekullit XX shtëpia e historianëve antipozitivistë. Me *Annales* fillon leximi i historisë në shumës, e cila kërkon të mbledhë rreth vetes të gjitha dimensionet e mundshme, *"prezencën, aktivitetin, shijet dhe mënyrat e të ekzistuarit tek njerzit" (*Febvre, 1966, p. 577). Kërkimi historik do të ndjekë në mënyrë rigoroze të gjithë hapësirën e ngjarjeve dhe përvojat e së shkuarës, nga teknikat bujqësore në mënyrat e besimit, nga mënyra e të veshurit në besimet popullore, nga sjelljet individuale në psikologjinë e masave (Macry ,2006, p.30).

Duke filluar nga prespektiva e zgjedhur dhe nga hapësira e studimit, kemi disa lloj historie; *histori universale*, që ka për objekt studimi të gjithë shoqërinë njerëzore dhe dinamikat shoqërore të çfarëdolloji; *histori të përgjithshme*, që studion të gjitha aspektet e jetës njerëzore, por që ka si objekt studimi një shoqëri të veçantë të vendosur në një territor të caktuar; *histori speciale*, që ka si objek studimi njeriun në një nga sjelljet e tij shoqërore.

Historia universale lind dhe zhvillohet brenda filozofisë së Mesjetës dhe ka bazat e veta tek vizioni i Shën Agustinit i cili në veprën e tij *De Civitate Dei* mbështet idenë se historia nuk duhet të ketë për objekt studimi një subjek të veçantë politik, por të gjithë njerëzimin në të gjitha dimensionet e tij si protagonistë e luftës së pafundme ndërmjet së mirës dhe së keqes.

Historitë e përgjithshme janë zhvilluar gjatë periudhës së nacionalizmave dhe kanë shërbyer për të justifikuar ideologjikisht lindjen e disa shteteve të mëdha europiane.Veprat e para që konfirmojnë këtë mision të historive të përgjithshme, lindin në mesin e shekullit XVIII, në dy prej shteteve më të fuqishëm të kohës në Europë; në Francë me Voltaire *(Siècle de Louis XIV)* (Voltaire, 2005) dhe në Angli me Hume *(History of England from Invasion of Julies Caesar to the Revalation of 1688)* (Hume , 1985). Ndërsa në vendet e tjera europiane që nuk kishin fituar pavarësinë e tyre dhe kishin krijuar shtetin e tyre të centralizuar, historitë e përgjithshme shërbejnë për ndërgjegjësimin e popullsisë mbi prejardhjen e tyre të njëjtë dhe mbi të gjitha, përgatisin terrenin për rizgjimin kombëtar të këtyre kombeve.[3]

[3] Italia dhe Gjermania mund të shërbejne si shembuj për të kuptuar rolin që kanë pasur historitë e përgjithshme në zgjimin kombëtar të tyre. Në Itali ishte Lodovico Antonio Muratori që me veprën e tij *"Annali d'Italia 1744-49*" shënon lindjen e

Historitë speciale fitojnë autonomi shkencore në fund të shekullit të kaluar, kur hyn në krizë pozitivizmi dhe bie iluzioni që mund të analizosh lehtësisht të gjithë historinë e njerëzimit në tërësi apo edhe të një kombi në veçanti. Me historitë speciale rritet ndërgjegjësimi mbi kompleksitetin e jetës shoqërore dhe mbi domosdoshmërinë e trajtimit të këtyre fenomeneve shoqërore mbi baza shkencore.

Por duhet të tregohemi të kujdesshëm kur bëjmë ndarjen e historisë në disiplina brenda trupit të saj, sepse në të vërtetë historia si shkence është një dhe e pandashme, nuk ekziston histori politike ashtu siç nuk ekziston histori e marrëdhënieve ndërkombëtare apo histori kulturore, por për shkaqe studimi dhe analize ne jemi të detyruar ta ndajmë historinë në kategori të veçanta, proces ky që shpesh herë thjeshtëzohet deri në limitin e absurdit.[4]

Studimi historik i ekonomisë mund të zhvillohet nga tri këndvështrime.

Mund të jetë studimi i një historie të përgjithshme nga një prespektivë ekonomike, që do të thotë që ka për objekt bashkësinë e fenomeneve shoqërore për të studiuar raportet ndërmjet aktivitetit ekonomik dhe proceseve të tjera të jetës shoqërore.

Mund të jetë një analizë e teorive ekonomike, duke konsideruar evolucionin historik të formimit të tyre dhe ambientin ku kanë lindur.

Mund të jetë një analizë e ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur realisht, që do të thotë se ka si qëllim studimi fenomenet ekonomike në një periudhë të caktuar.

Këndvështrimi i parë është një aspekt i veçantë i historisë sociologjike nga një profil ekonomik, këndvështrimi i dytë karakterizon historinë e doktrinave ekonomike dhe të mendimit ekonomik, kurse këndvështrimi i tretë është ai që përshkruan esencën thelbësore të vetë historisë ekonomike.

**Gjendja e historiografisë ekonomike shqiptare në shekullin XX**

Studimi i historisë ekonomike të Shqipërisë është një sfidë e rëndësishme e të gjithë historianëve të rinj shqiptarë për vitet e ardhshme. Megjithëse në dy dekadat e fundit janë bërë hapa përpara në leximin e historisë së Shqipërisë në këndvështrimin ekonomik dhe shoqëror, mbetet akoma shumë punë për t'u bërë.

Fakti që sot në asnjë nga pesë universitetet publike ku ekzistojnë departamentet e historisë, nuk zhvillohet lënda e historisë ekonomike, tregon që kjo disiplinë nuk e ka fituar akoma dinjitetin akademik në hapësirën universitare shqiptare. Megjithatë, ky nuk është problemi më i madh që ndeshet sot historiografia shqiptare.

Ajo që bie në sy është zotërimi i një historie që analizohet sipas ideologjive dhe interesave të ditës. Historianët, gjatë realizmit socialist, e kishin përqendruar veprën e tyre rreth historisë politike, historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe historisë ushtarake, kjo për shkak të karakteristikave që kishte sistemi politik i viteve 1945-1990 dhe për direktivat kulturore që vinin nga sistemi mbi historinë e Shqipërisë.

Gjatë diktaturës, botimet politike zënë vendin më të rëndësishëm të prodhimtarisë botuese në fushën e

historiografisë nacionaliste italiane kurse në Gjermani ishte shkolla historike e Von Savingy (1814) që ndërton justifikimin historik të nevojës për bashkimin e territoreve gjermane në një shtet të centralizuar.

[4] Në të vërtetë ekziston edhe një ndarje tjetër që shtrihet në kohë dhe hapësirë sic është procesi i periodizimit të historisë. Ne kemi pranuar ta kategorizojmë historinë në katër periudha të mëdha si perjudha e antikitetit, perjudha e mesjetës, perjudha e kohes së re dhe periudha bashkohore.

historisë dhe kanë tirazhin më të madh. Në mënyrë të veçantë veprat "ideologjike" duhet të blihen në mënyrë të detyrueshme nga intelektualët shqiptarë. Ndërmjet viteve 1965-1980, numri i botimeve me karakter politik shkon në 6.000.000 kopje, ndërsa librat ideologjikisht të rëndësishëm për propagandën komuniste shkonin nga 100.000-300.000 kopje (Hidri,2008, p.25). Pikërisht, rëndësia që i është dhënë historisë politike gjatë realizmit socialist, ka bërë që ato pak vepra të historisë ekonomike të jenë të ngarkuara emocionalisht me paragjykime ideologjike. Po kështu dhe historia e Shqipërisë ndërmjet dy luftrave botërore, sidomos periudha e monarkisë, është parë nga historanët e periudhës komuniste si periudhë e një vuajtjeje të pafund të popullit shqiptar. Monografia e Iliaz Fishtës dhe Veniamin Toçit, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja*, *shkaqet dhe pasojat,* e publikuar më 1983, mund të merret si model për të kuptuar si punonte historiografia komuniste.

Në hyrjen e librit Fishta dhe Toçi na japin fillin e udhëheqjes së punës së tyre. *Për të shkruar këtë libër jemi bazuar në teorinë marksiste-leniniste mbi rolin e ekonomisë dhe aktorëve të tjerë në zhvillimin e shoqërisë. Na kanë ardhur në ndihmë konkluzionet e Marksit, Engëlsit, Leninit dhe Stalinit mbi faktorët e zhvillimit të kapitalizmit dhe karakteristikat e tij para dhe pas Luftës së Parë Botërore* (Fishta & Toçi, 1983).

Ndërsa për të kuptuar se si historiografia komuniste prezantonte studimet e historianëve perëndimorë mbi ato vite po citojmë edhe një herë hyrjen e librit të mësipërm.

*Mbi ekonominë shqiptare kanë shkruar historianët italianë, francezë, amerikanë, gjermanë, austriakë, jugosllavë dhe të tjerë. Në përgjithësi kanë analizuar situatën nga këndvështrimi borgjez, për të ndihmuar hyrjen e kapitalit të huaj në Shqipëri (Po aty).*

Ashtu siç shihet, edhe ato pak vepra të historisë ekonomike që janë shkruar gjatë komunizmit, nuk kanë qene të 'çliruara' nga politika ideologjike e regjimit.

Një rol të rëndësishëm në studimin e historisë nga ana ekonomike, kanë luajtur dy revista me karakter ekonomik, që janë publikur ndërmjet viteve 1954-1990. Dy revistat ishin "*Ekonomia Popullore",* që del në treg nga 1954 deri më 1972 dhe më vonë revista *"Probleme Ekonomike"* nga viti 1973 deri më 1990. Në këto dy revista janë publikuar një numër i madh shkrimesh nga studiues shqiptarë në përpjekjen e parë serioze për krijimin e historiografisë ekonomike shqiptare.

**Shqipëria e mesjetës së vonë gjatë periudhës Bizantine**

Në këto shekuj ashtu si në të gjithë Ballkanin, situata ekonomike-shoqërore e vendit ishte shumë e vështirë. Shkak i situatës së vështirë politiko-ekonomike të vendit ishte dobësimi politik i Perandorisë Bizantine dhe padyshim pozita gjeografike e Shqipërisë,ku territoret shqiptare ishin pjesa më periferike e perandorisë dhe shërbenin si kufiri natyror i dy realiteteve të ndryshme; realitetit perëndimor dhe atij lindor.

**Shqipëria gjatë pushtimit osman nga shekulli XV-XIX**

Me pushtimin osman ndryshon në mënyrë thelbësore jo vetëm historia politike e vendit, por mbi të gjitha ndryshon fizionomia ekonomike dhe rrugët tregtare të tij. Në qoftë se në shekujt e fundit të pushtimit bizantin ekonomia bujqësore kishte dhënë shenja pozitive drejt tregtisë me Venecian, me ardhjen e osmanve, epiqendra e shkëmbimeve tregtare shkon drej Stambollit. Përveç tregtisë, ajo që vuan më shumë praninë osmane është bujqësia që

ri organizohet sipas sistemit të Timareve. Për tre shekujt e parë të pushtimit ka shumë pak botime me karakter historiko – ekonomik, përveçse atyre me karakter të përgjithshëm. Kjo mungesë interesi nga ana e studiuesve shqiptarë dhe të huaj vjen jo për shkak të mungesës së fakteve dhe dokumenteve historike, por për shkak të izolimit kulturor që kalon Shqipëria në periudhën e kohës së re.

**Industria shqiptare në vitet 1920-1940, një panoramë e përgjithshme e situatës**

Pas viteve '20 të shekullit XX, Shqipëria hyn në një fazë të qetë politike që ka ndikim pozitiv mbi ekonominë e vendit. Vitet ndërmjet dy luftrave botërore janë vitet e përpjekjes së shoqërisë shqiptare për të ndërtuar të ardhmen ndërmjet një sistemi vlerash dhe principesh politike, morale dhe ekonomike të tipit perëndimor. Shqipëria e lirë dhe e pavarur, në vitin 1922 është njohur *de juro* dhe *de facto* si një realitet i padiskutushëm në Ballkan. Nga kjo e drejtë ndërkombëtare, fillon përpjekja e shoqërisë shqiptare, drejt zhvillimit të përgjithshëm , sepse tani e ardhmja e Shqipërisë nuk ishte më në zgjedhjet që do të bënin kancelaritë e huaja dhe diplomacia e tyre okulte. Ishin zgjedhje që duhet të shënonin ndryshimin midis një të kaluare lindore të vendit drejt një të ardhmeje brenda familjes së madhe të popujve evropianë.

Të gjitha reformat që zhvillohen në këto vite nuk na lënë dyshime mbi vullnetin e popullit shqiptar për të bërë pjesë në grupin e vendeve që shikonin zhvillimin e tyre ndërmjet ekonomisë kapitaliste dhe industriale. Në qoftë se dyshimi mbi zgjedhjen që bënë shqiptarët nuk ekziston, është e detyrueshme të ngrihet pyetja se suksesi i këtyre reformave solli ndryshimin e fytyrës së Shqipërisë apo ishte një sistem në shenjën e vazhdimsisë me Shqipërinë osmane të shekujve të kaluar. Sot pas më shumë se gjysmë shekulli mund të japim një përgjigje kësaj pyetjeje duke përdorur kritere të mirëfillta shkencore, larg interpretimeve ideologjike. Për të qenë objektivë në këtë analizë, duhet të shikojmë problemin që në origjinë, me fjalë të tjera, të shikojmë përpjekjet e qeverive shqiptare për t'u bazuar tek industria dhe tërheqja e investimeve të huaja si e vetmja rrugë shpëtimi.

**Grafiku 1. Numri i firmave dhe puntorëve në sektorin industrial**.




***Burimi*: K. Misho, 1970**

Nga grafiku i mësipërm mund të kuptojmë strategjinë e zhvillimit në Shqipëri. Në qoftë se në vitin 1922 në territorin shqiptar operonin shtatëdhjetë e një kompani industriale ku punonin 500 punëtorë, një vit para Depresionit të Madh të vitit 1929, numri i firmave kishte shkuar në 127 dhe numri i punëtorëve në 2000, ndërsa në vitin 1938 numri i firmave ishte trefishuar në raport me vitin 1922 dhe numri i punëtorëve ishte dhjetëfishuar. Duhet theksuar se fenomenet e mësipërme që u zhvilluan në vitet 1920-1940 ishin procese që nuk ishin njohur kurrë nga shoqëria shqiptare. Mbi të gjitha, pas forcimit politik të Zogut, politika ekonomike fokusohet tek sektori industrial me ndihmën e kapitalit të huaj. Kjo nuk ishte një sfidë ekonomike për monarkinë shqiptare, por mbi të gjitha ishte një sfidë e shoqërisë shqiptare për modernizimin e shtetit. Por jo të gjithë ishin gati ta pranonin këtë sfidë, sepse kjo e fundit vendoste në dyshim ekzistencën e një

sistemi ekonomik katër shekullor, ku shqiptarët kishin marrë pjesë në mënyrë aktive. Fatet e borgjezisë së kohës ishin të lidhura ngushtë me pronësinë mbi tokën dhe me tregun e brendshëm dhe pikërisht kjo borgjezi që kishte investuar në mënyrë të limituar në shekujt XIX- XX nuk ndihej gati të pranonte sfidën.

Kushtet natyrore të Shqipërisë për zhvillimin industrial ishin të favorshme. Vendi ishte i pasur me naftë, krom, bakër dhe bitum, të cilat ishin sektorë që nuk ishin eksploruar më parë. Ndërsa nga ana tjetër, nevoja për të përpunuar prodhime bujqësore kërkonte investime serioze dhe gjithashtu nevojitej që të jepeshin me koncesion sektorët industrialë ku kapitali human dhe financiar i Shqipërisë ishte i pa mjaftushëm. Pikërisht, dy rrugët e mësipërme të zgjedhura nga mbreti Zog kanë sjellë debate të pafundme në historiografinë shqiptare. Kjo e fundit, gjatë realizmit socialist, dënonte politikën e portave të hapura të Zogut si politikë skllavëruese për popullin shqiptar nga imperialistët shqiptarë.

**Industria ushqimore** nuk ishte krejt e panjohur nga kapitali shqiptar, gjatë pjesës së dytë të shekullit XIX dhe vitet e para të shekullit XX ishin krijuar nga investitorët shqiptarë një grup i vogël fabrikash, mullinj të bluarjes së drithërave dhe punishte për punimin e vajit të ullirit. Sektori që njeh zhvillimin më të shpejtë është sektori i bluarjes. Gjatë viteve 1920-1940 fabrikat e miellit dhe mullinjtë me energji elektrike, për nga volumi i punës, kapitali i investuar e fuqia mekanike e instaluar, ishin në vendin e parë në industrinë ushqimore. Këto stabilimente ndërtohen në qytetet e mëdha shqiptare. Në Durrës ekzistonin disa mullinj bluarjeje; në vitin 1938 në këtë sektor punonin njëzet e një persona, prodhimi vjetor ishte 147.680 kv dhe kapitali i investuar ishte 500.000 franga ari (AQSH, 1948).

Në Shkodër ndërtohen katër stabilimente të reja në të cilën punonin 26 persona me një kapital të investuar prej 550.00 franga ari. Në vitin 1927, në Korçë ndërtohet një fabrikë me kapital prej 482.000 franga ari (Kareco,1980, p.84).

Në vitin 1927 në Shqipëri ekzistonin rreth 100 mullinj me një kapital të investuar rreth 3.600.000 franga ari në të cilën punonin 424 persona. Veçoria e këtyre investimeve qëndron në modalitetet e investimeve që vinin kryesisht nga borgjezia shqiptare. Kjo e fundit kishte fituar një përvojë modeste në këtë sektor para vitit 1910 dhe ishte e sigurt në llojin e investimit dhe të përfitimit.

Një motiv i rëndësishëm në rritjen e këtij sektori kishte të bënte me investimin e ulët fillestar që nevoitej për të vënë në punë një mulli me energji motorike. Sipas Dhomës së Tregtisë të Tiranës, për të ndërtuar një mulli të tillë duheshin 10-15.000 franga ari ( AQSH, 1937). Për shkak të zhvillimit të shpejtë të këtij sektori mullinjë e mëparshëm pushuan së ekzistuari. Një mulli me motor zëvendësonte mesatarisht 5-7 mullinj uji, ndërtohej në territore lehtësisht të arritshme dhe mund të punonte jo vetëm në dimër, por gjatë gjithë vitit.

Industria e bluajtjes nuk ishte i vetmi sektor që njohu modernizimin teknologjik, në vitet 1920-1940; edhe sektoret e prodhimit të makaronave dhe të orizit njohën zhvillim të madh. Ndërsa me më shumë sukses rezultuan investimet në fushën e prodhimit të vajit të ullirit. Territoret shqiptare qysh në Antikitet kishin njohur kultivimin e ullirit. Deri në fund të viteve 1920, prodhimi në këtë sektor ishte akoma në stade primitive. Shtëpitë e prodhimit ishin mjaft të vogla dhe në shumë raste nuk kishin motorë me djegie të brendshme. Në Elbasan, falë kapitalit francez prej 4.000.000 franga ari

ndërtohet një fabrikë moderne e përpunimit të ullirit, ndërsa qyteti i Vlorës kishte një numër të rëndësishëm fabrikash moderne, rreth nëntë, që u ndërtuan në qytetin bregdetar. Veçoria e këtij sektori qëndron në faktin se kapaciteti i fabrikave moderne dhe primitive ishte disa herë më i madh nga kapaciteti i prodhimit të ullirit në vend. Si shembull mund të marrim fabrikat e Vlorës, të cilat të vetme kishin kapacitet të plotësonin gjithë nevojat e brendshme të vendit. Një fenomen tjetër negative, kishte të bënte me mungesën e rafinimit të vajit, gjë e cila bënte, që në tregun ndërkombëtar çmimi të ishte mjaft i ulët dhe kjo ndikonte drejtpërdrejt në të ardhurat që vinin nga eksportet. Ndërmjet viteve 1921-1933, Shqipëria eksportoi rreth 8.726.548 kg vaj ulliri me një vlerë prej 21.961.998 franga ari.

**Industria elektrike**

Fundi i shekullit të XIX ishte momenti kur industria kaloi nga fuqia e motorëve me avull në motorët me energji elektike, kalim që pati një ndikim të madh në historinë e Evropës industriale dhe në historinë e kapitalizmit. Përdorimi i energjisë elektrike ndryshoi rrënjësisht jetën ekonomike të vendeve. Përdorimi i elektricitetit në proceset prodhuese solli rritjen e prodhimit me uljen e kostos së tij dhe mbi të gjitha përmirësoi kushtet e jetesës së popullsisë evropiane. Industria e energjisë elektrike në Shqipëri kishte kushte ideale për t'u zhvilluar me shumë sukses në raport me vendet fqinje ballkanike, për shkak të pozitës gjeografike shumë të favorshme dhe të pasurive minerale të nëntokës shqiptare. Shqipëria është vendi i dytë në Europë pas Norvegjisë për burime hidrike. Lumenjtë Drin, Mat, Vjosa, Bistrica, Shkumbin ishin një mundësi e mirë për të prodhuar energji elektrike nga burimet hidrike. Kjo nuk ishte mundësia e vetme për prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri. Vendi ishte i pasur me naftë, gaz, karbon të cilat mund të shfrytëzoheshin për ngritjen e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike. Me prodhimin e kësaj te fundit ishte i lidhur i gjithë zinxhiri i zhvillimit industrial të Shqipërisë. Megjithëse, ashtu siç theksuam më lart, Shqipëria kishte kushte të favorshme për prodhimin e energjisë elektrike, realiteti në vend ishte i vështirë. Shkaqet e kësaj vështirësie ishin të shumta, por dy ishin më të rëndësishme; mungesa e investimeve publike nga qeveritë shqiptare në periudhën 1912-1925, dhe struktura e dobët e borgjezisë shqiptare për të investuar kapitale në sektorë që për ta ishin të panjohur dhe plot rreziqe.

Gjithçka ndryshon kur qeveria shqiptare ndërton kuadrin juridik për thithjen e investimeve të huaja. Koncesionet e para fillojnë në vitet '20, në qytetet e mëdha të Shqipërisë.

Në qytetin e Korçës koncesioni i prodhimit dhe shpërndarjes i jepet në vitin 1925 Shoqërisë së Përgjithshme Elektrike, ndërsa në Tiranë monopoli mbi energjinë elektrike i takon Shoqërisë Industriale Tregtare Shqiptare SITA. Në Shkodër prodhimi i energjisë elektrike fillon ne 1928 me investimet italo-shqiptare, ndërsa në Durrës ishte shoqëria STAMLES e cila ka monopolin e prodhimit dhe shpërndarjes . Nga ana ligjore, këto koncesione funksiononin në mënyrë të thjeshtë. Shoqëritë nënshkruanin me bashkitë një marrëveshje, e cila më pas aprovohej nga Këshilli i Ministrave. Të dhënat për zhvillimin e industrisë së energjisë elektrike në periudhën 1925-1944, nxjerrin në dritë dy karakteristika kryesore.

Shpërdarja gjeografike e energjisë elektrike nuk ishte uniforme në të gjithë territorin. Edhe pse kushtet natyrore për zhvillimin e kësaj industrie ishin favorizuese, energjia elektrike ishte prezente vetëm në qytetet e mëdha,

ndërsa qytetet e mesme dhe të vogla si Lezha, Peshkopia, Gramshi, Skrapari etj, nuk e njohën procesin e elektrifikimit gjatë asaj periudhe. Është e thjeshtë për t'u kuptuar që ky proces në zonat rurale ku banonte pjesa e madhe e popullsisë ishte inekzistent. Deri në vitin 1944, asnjë fshat i Shqipërisë nuk ishte i furnizuar me energji elektrike.

Konsumi për frymë i energjisë elektrike gjatë dy luftrave botërore ishte shumë më i ulët në krahasim me vendet e tjera ballkanike. Grafiku numër dy e vendos Shqipërinë në vendin e fundit, me një konsum për frymë 9 Kwh, ndërsa vendet e tjera ballkanike kanë një konsum shumë më të lartë.

**Grafiku 1.2 Konsumi për frymë i energjisë elektrike në Kwh në vitin 1938.**




**Burimi: Iliaz Fishta, Muharrem Doci, 1974**.

Konsumi i energjisë ishte i ndarë në konsum për nevojat e industrisë dhe konsum për nevojat publike të qytetit. Shoqëria italiane SESA për vitin 1939, në qytetet Shkodër, Tiranë, Vlorë, Berat, Fier, Gjirokastër dhe Kavajë prodhoi 1.044.000 kw energji elektrike ndër të cilat 766.440 kw u shpërndanë për nevojat publike të qyteteve dhe 277.660 për sektorin prodhues. Ndërsa në qytetin e Korçës raportet ishin në favor të sektorit prodhues, ndërmjet majit 1934 dhe prillit 1935, Shoqëria e Përgjithshme Elektrike prodhoi 560.000 kw të ndarë për sektorin prodhues 350.000 kw dhe për nevojat publike 210.000 kw. Kjo është një e dhënë për të kuptuar se cilat ishin polet industriale në territorin shqiptar.

**Përfundimet**

Nevoja për studimin e historisë së Shqipërisë nga pikëpamja ekonomike është një përpjekje serioze për të shpjeguar dinamikat e zhvillimit të vendit ndërmjet dy luftrave botërore. Vitet 1920-1944 janë vitet e para të Shqipërisë së lirë drejt rrugës së progresit dhe përpjekjeve të qeverive shqiptare për të drejtuar zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit drejt zhvillimit industrial dhe kapitalist. Me stabilizimin e jetës politike pas Revolucionit të Qeshorit në 1924, politikat ekonomike të qeverive shqiptare kërkojnë të modernizojnë shtetin shqiptar dhe në të njëjtën kohë të drejtojnë zhvillimin ekonomik drejt prodhimit industrial dhe tregut të lirë. Dy sfida kalonin përmasat e një projekti politik, por merrnin përmasa kombëtare nisur nga fakti se Shqipëria ishte vendi më i varfër ekonomikisht në Ballkan dhe nuk kishte një traditë demokratike në administrimin e pushtetit. Nuk duhet lenë pa theksuar së sfida bëhej edhe më e vështirë në qoftë se marrim parasysh strukturën ekonomike dhe politike që kishte borgjezia shqiptare në ato vite. Në aspektin politik ishte një borgjezi që ishte e lidhur ngushtë me traditën osmane dhe e kishte shumë të vështirë të merrtë pjesë aktivisht në jetën politike të vendit, ndërsa në aspektin ekonomik borgjezia shqiptare kishte ndërtuar suksesin e saj duke forcuar raportin me tokën dhe shumica e kapitalit të investuar ishin pikërisht në fushën e bujqësisë.

Ky fakt e vështirësonte më shumë rrugën drejt modernizimit të ekonomisë shqiptare, sepse kapitali shqiptar e shihte të pamundur investimin në fusha që i

kishte të pashkelura më parë dhe në këto kushte, e vetmja rrugë investimi përveç bujqësisë, ishin shkëmbimet e thjeshta tregtare. Në këto kushte qeveritë shqiptare pas 1925-ës ishin para një zgjedhjeje historike; të vazhdonin të ndiqnin një model zhvillimi që i kishte sjellë Shqipërisë vështirësi të mëdha dhe konstante, që do të thotë vazhdimësi me strukturën ekonomike osmane apo të gjenin rrugë të reja zhvillimi që duhet të shënonin shkëputjen përfundimtare me ekonominë e vjetër.

Ky model i ri ekonomik që shkonte drejt zhvillimit ekonomik kapitalist kishte nevojë jetike për investime dhe kapital financiar të rëndësishëm. Në mungesë të një kapitali vendas, qeveritë shqiptare ndoqën politikën e dyerve te hapura për kapitalin e huaj, duke ndjekur rrugën e investimeve të huaja në Shqipëri ndërmjet koncesioneve të sektorëve jetikë të ekonomisë. Shembujt e sjellë në këtë punim në industrinë ushqimore dhe industrinë e energjisë elektrike shërbejnë si etalon matës për të kuptuar rëndësinë dhe ndikimin e kapitalit të huaj në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Me prurjet financiare dhe njerëzore, kryesisht italiane, ekonomia shqiptare fillon një proces të lehtë hapjeje dhe integrimi me ekonominë e tregut dhe me krijimin e një baze solide ku duhet të ndërtohej modeli i ri ekonomik, që duhet të ishte konkurent me ekonomitë e vendeve fqinje. Por kjo ishte një anë e medaljes.

Me fundin e Luftës së Dytë Botërore dhe ardhjes në pushtet të partisë komuniste, ndryshon dhe politika ekonomike që zgjedh Shqipëria, duke braktisur përvojën e viteve 1925-1939, duke futur Shqipërinë në spiralen e një ekonomie të centralizuar dhe planifikuar. Jo vetëm ndryshimi i kursit të zhvillimit ekonomik ndryshon, por edhe historiografia shqiptare gjatë socializmit real lexon dhe interpreton periudhën parakomuniste si një periudhë ku mbizotërojnë interesat imperialiste të përfaqësuara nga kapitali i huaj në kurriz të popullit. Ky interpretim mbeti vetëm në rrafshin ideologjik, sepse studiuesit nuk arritën që në bazë të kërkimit shkencor të konfirmonin me shifra dhe fakte ato që i theksonin në planin teorik. Sot, pas më shumë se gjysmë shekulli është e domosdoshme që të analizojmë Shqipërinë e viteve 1920-1940, në të gjitha dimesionet e saj, ku më e rëndësishmja është pikërisht historia e saj ekonomike.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


AQSH (1948) *Historiku i fabrikës shtetërore 9 Maji*, Letër dërguar Ministrisë së Ekonomisë më 22/11/1948.

AQSH (1937). Oda e Tregëtise, Tiranë.

Cipolla, C. (2002). *Introduzione alla storia economica*, Il Mulino, Bologna.

Febvre, L. (1966). *Studi su Riforma e Rinascimento e altri scritti su problemi di metodo e di geografia storica*, Einaudi, Torino.

Fishta, P., Doci M., (1974).*Ndërhyrja e kapitalit të huaj në industrinë elektrike më 1925 1944*. Studime historike, Tiranë.

Fishta, I., Toçi, V., (1983). *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja, shkaqet dhe pasojat,* Tiranë.

Hidri, (2008). *La produzione e la lettura di libri in Albania: Cenni storici e riflessioni sul contesto attuale"*. Roma.

Hume, D, (1985).History of England from invasion of Julios Caesar to the Revulation of 1688, LibriVox, London.
Fishta, I., Doci, M.,(1974). *Ndërhyrja e kapitalit të huaj në industrinë elektrike nga viti 1925-1944*. Studime historike, Tiranë, p. 92
Macry, P. (2006). La società contemporanea, Il Mulino, Urbino.
*Misho, K. (1970). Lëvizja puntore në Shqipëri,* Tiranë.
Pirenne, H. (x). *Mahomet et Charlemagne*, Libraire Felix Alcan, Bruxelles.
Voltaire, P. (2005). *Siècle de Louis XIV,* La Feltrinelli, Torino.

# KOSOVA, LUFTA PËR ÇLIRIM DHE E DREJTA PËR TË PATUR SHTET.

**ORJON AGO**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Punimi *Kosova, lufta për çlirim dhe e drejta për të patur shtet ,* është mbështetur në disa shtylla kryesore; historiku i shkurtër i çështjes së Kosovës, raportet serbo-shqiptare (kosovare), lufta për pavarësi dhe e drejta për të patur shtet.

Objektivi është që të tregohet rruga e vështirë dhe përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për të fituar të drejtat e tyre të mohuara.

Punimi ka si qëllim që të tregojë vitalitetin e këtij populli që edhe në momente të vështira si ato në të cilat u ndodhën shqiptarët në Kosovë, ata ia arritën që të mos asimilohen, por në sajë të njohjes të së kaluarës dhe të vetëdijes së tyre kombëtare, mundësuan krijimin e shtetit të Kosovës. Vuajtjet dhe lufta e tyre duke qenë të drejta, çuan në krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ky shtet përmbushte të gjitha kriteret, si territorin, popullsinë, të shkuarën historike si dhe aftësinë e shqiptarëve për të ngritur institucione të pavarura pas viteve '90.

Pavarësia e Kosovës është fryt i luftës së popullit të vet, të shqiptarëve në përgjithësi dhe ndihmesës së shteteve demokratike me ShBA-në në krye dhe bombardimeve që bëri NATO-ja kundër Serbisë.

**Fjalë çelës:** *Kosovë, histori , raporti serbo –shqiptar, pavarësi, shtet, të drejta.*

**Abstract**

The paper **"***Kosovo, the struggle for deliverance, and the right to have a self-governed state***"** is based on several important components: the insufficient history of Kosovo issue, albanian-serb relations, fight for independence and the right of being a self-governing country.

The purpose of this article is to show how tough was the struggle of Albanians from Kosovo to gain citizens rights which have been denied for so long.

At the same time, this paper discusses the vitality of this country which even in hard times of oppression, they never got assimilated, contrariwise, due to the recognition of their past and also their national consciousness, they enabled the creation of the state of Kosovo. Their fair war and the great suffering led to the establishment of Kosovo's Independence. Kosovo fulfilled all of the requirements to be a self-governed state such as: territory, population, a significant historical past, lastly the ability to set up independent institutions after 1990s.

Their well deserved independence came as a result of Kosovo's fair war and Albanians from everywhere, but we can't forget the great help of the democratic states but mostly the USA and the bombing that NATO did over Serbia.

**Keywords:** *Kosovo, histoty, the Serbian- Albanian, report, independence, state,rights.*

Përpjekjet e shqiptarëve për të krijuar shtetin e tyre kombëtar nisën që në fillim të shekullit XIX, por për një sërë shkaqesh të karakterit të brendshëm që kishin të bënin me vetë shqiptarët, por edhe ato të jashtme që lidhen me interesat dhe ekuilibrat e Fuqive të Mëdha në Ballkan. Vetëm në fillim të shekullit XX u arrit të krijohej një shtet i pavarur por i cunguar shqiptar.

Pas mbarimit të Luftës së Parë Ballkanike, u mblodh Konferenca e Ambasadorëve në Londër, për të vendosur për situatën në Ballkan. Kjo konferencë mori dy vendime për statusin e Shqipërisë; atë të 17 dhjetorit 1912 dhe 29 korrikut 1913 më anë të cilave u sanksionua pavarësia e Shqipërisë (Dervishi, 2006, p. 15). Mirëpo këto vendime, përveçse formuan shtetin shqiptar, krijuan një problematikë të re në Ballkan. Që nga ky moment zë fill edhe konflikti shqiptaro-serb që në fakt Geert Ahrens një diplomat austriak me përvojë dhe njohës i mirë i rajonit e kufizon këtë konflikt vetëm brenda Jugosllavisë (Ahrens, 2010, p. 13).

Jashtë shtetit të ri shqiptar mbetën shumica e territoreve dhe e popullsisë shqiptare. Kjo popullsi kaq e madhe nuk kishte se si të pajtohej me këtë gjendje. Që nga ajo kohë nisën edhe kundërshtimet e shqiptarëve të këtyre krahinave për këtë vendim, me dëshirën për çlirim dhe për t'u bashkuar me Shqipërinë. Rajoni i Kosovës ishte më i madhi gjeografikisht dhe më kompakti përsa i përket popullsisë dhe kishte një traditë të gjatë dhe të hershme në lëvizjen kombëtare shqiptare** prandaj edhe aty nisi menjëherë kundërshtimi ndaj autoriteteve serbe.

Me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, nuk u zbatua asnjë rregull gjatë luftimeve me Perandorinë Osmane, madje nuk u përfillën as kërkesat e popujve që nuk kishin fituar akoma pavarësinë, siç ishin edhe shqiptarët, por u zbatua ajo që shtetarët ballkanas mësuan nga Kongresi i Berlinit *"se është më mirë të sigurosh përkrahjen e një shteti të fuqishëm, sesa të shkosh mirë me fqinjët. Ky mësim i gabuar do të ndikonte negativisht në gjeostrategjinë e shteteve të rajonit dhe do të prodhonte pasiguri të vazhdueshme për paqen në rajon"* (Shala, 2009).

Përpjekjet e shtetarëve ballkanas konsistonin në dëshirën për të krijuar shtete, të cilat duhet të ishin detyrimisht të pastra nga pikëpamja etnike. Në emër të kësaj politike u përligjën masakra të mëdha ndaj pakicave kombëtare. Për këtë qëllim, këto shtete ngritën edhe platforma ideore që zgjidhnin problemin e shtetasve me kombësi të ndryshme. Duke patur edhe mbështetjen e fuqishme të Rusisë, ushtritë serbe filluan ofensivën kundër ushtrive osmane për të pushtuar sa më shumë toka, të cilat do t'i aneksonin. Parimi i "faktit të kryer" nënkuptonte se para fuqive të mëdha ata do t'i konsideronin këto toka si të fituara me luftë. Nga ana tjetër parrulla "Ballkani i ballkanasve" u la mënjanë dhe u aktivizua komponenti tjetër, që nuk merrte parasysh asnjë lloj realiteti përsa i përket gjendjes reale në momentin e pushtimit. Nuk u përfill asnjë lloj parimi, asnjë lloj norme ndërkombëtare, asnjë e drejtë e atyre njerëzve nuk u mor parasysh, por filloi menjëherë dhuna ndaj popullsisë joserbe (Freundlich, 1995, pp. 40-46).

Pasojat e këtij pushtimi ishin të pallogaritshme; bujqësia u shkretua, zejtaria u përgjysmua, me mijëra familje u privuan ose u shpronësuan nga pronat e tyre, ndërsa mijëra vetë u detyruan të

*Lidhja e Prizrenit e mbajtur në Qeshor 1878 është një nga ngjarjet më të mëdha në historinë e shqiptarëve. Për herë të parë u krijua një organizatë politike dhe ushtarake një qëndër e bashkuar më një program të qartë kombëtar të cilës i reforohen të gjitha ngjarjet e mëvonshme në Shqipëri.Lidhja e Pejës u krijua nën shembullin e saj dhe kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912 që sollën pavarësinë e Shqipërisë e kishin qëndën në Kosovë.

shpërnguleshin në Turqi ose në Shqipërinë politike. Në vend të tyre u sollën dhe u vendosën me mijëra sllavë, serbë dhe malazezë(Verli, 2007, pp. 62-63).

Pas Luftës së parë Botërore në Kosovë nisi një qëndresë dhe një luftë irredentiste e fuqishme për bashkimin me Shqipërinë. Në 1 Maj të vitit 1918, u krijua Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", i cili në programin e tij të themelimit parashtronte tri pika të cilat pasqyronin në mënyrë të përmbledhur dhe të qartë drejtimet kryesore të veprimtarisë së kësaj organizate. Në pikën e parë theksohej bashkimi i krahinës së Kosovës me Shqipërinë nëpërmjet ndihmës së fuqive të Antantës. Në pikën e dytë parashikoheshin protesa kundër politikës anti shqiptare të kryer nga serbët në Kosovë. Pika e tretë bënte fjalë për të zgjedhur dhe dërguar një delegacion i cili do të mbronte dy pikat e lartpërmendura në tryezat diplomatike Europiane(Culaj, 1997, p. 28).

Menjëherë pas vitit 1918, kur përfundoi Lufta e Parë Botërore dhe u formua shteti serbo-kroato-slloven, në territoret shqiptare të Kosovës u vendos një pushtet ushtarak dhe policor. Qarqet politike serbe shpresonin që shkombëtarizimin dhe sllavizimin e krahinave me popullsi shqiptare ta arrinin në një periudhe të shkurtër. Nikolla Pashiçi, kryeministër i Serbisë në dekadat e para të shekullit XX, kishte deklaruar se zgjidhja e çështjes së shqiptarëve në shtetin e sllavëve të jugut mund të realizohej lehtë gjatë 20-25 vjetëve nëpërmjet asimilimit të tyre "si në pikëpamje kulturore, ashtu edhe në atë kombëtare. Në këtë mënyrë filloi një fushatë e tërë për shkombëtarizimin e shqiptarëve dhe asimilimin e tyre.

Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" përveç veprimtarisë diplomatike përcaktoi edhe programin e kryengritjes së vitit 1919, ku parashtrohej edhe lufta e armatosur e shqiptarëve të Kosovës për liri (AShSh, 2007, p. 461).

Lëvizja Nacionalçlirimtare ose siç u quajt lëvizja kaçake, zhvillohej në kuadrin e çetave, rradhët e të cilave u mbushën me rekrutë dhe më pas filloi shtimi dhe oraganizimi i tyre. Ato përbëheshin nga 20-100 veta duke u shtrirë thuajse në të gjithë Kosovën. Në vitet 1919-1924 çetat që vepruan ishin ajo e Drenicës që drejtohej nga Azem Bejtë Galica, i Pejës me në krye Sali Ramën, i Gjakovës me në krye Bajram Currin, etj. Ushtria serbe për të frenuar lëvizjen u hakmor ndaj familjeve të luftëtarëve të Azem dhe Shote Galicës. Si rrjedhojë veprimet e çetave morën më shumë hov. Çetat filluan të veprojnë jo vetëm në fshatra, por edhe në periferitë e qyteteve. Shumë e njohur ishte çeta e Azem Galicës. Kjo lëvizje ndoqi taktikën e luftës guerile. Lëvizja vazhdoi deri më 1924-ën, por kulmin e ka në vitet 1919-1920 (AShSh, 2007, p. 462).

Në këtë periudhë shqiptarët gëzonin shumë pak të drejta. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, një pjesë e Kosovës u bashkua me Shqipërinë prej pushtuesve italianë dhe më vonë gjermanë. Ky bashkim do të merrte fund me largimin e gjermanëve nga Ballkani dhe rikthimin e serbëve në Kosovë. Ky ripushtim nuk u pranua prej shqiptarëve të Kosovës, të cilët që në Konferencën e Bujanit, shprehën vullnetin e tyre për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Shqiptarët në Jugosllavi për të disatën herë u gjendën përballë serbëve dhe masave të tyre represive. Në fund të vitit 1944, në Kosovë filluan arrestimet e shqiptarëve të njohur dhe u grumbulluan të gjitha rezervat e armëve me pretekstin se ata ishin bashkëpunues me forcat e Boshtit. Të udhëhequr nga Shaban Polluzha, 5000 shqiptarë sulmuan kompleksin e Trepçës. Me ta u bashkuan edhe rreth 20 000 të tjerë kryesisht nga zona e Drenicës dhe luftimet u përhapën

në Kosovën Qëndrore(Petiffer, 2013, p. 46). Kjo lëvizje u shtyp nga komunistët e Titos me shumë vështirësi aty nga fundi i vitit 1947 dhe divizionet partizane nënshtruan përsëri Kosovën.

Gjatë viteve '50-'60 në Kosovë pati një farë qëndrese ndaj autoriteteve jugosllave, por masat e marra nga policia sekrete e udhëhequr nga Rankoviçi ishin të ashpra. Sfidë për shqiptarët e Kosovës në këtë kohë ishte që ata të formonin qendra politike dhe kulturore dhe përmes tyre më vonë të kalohej drejt krijimit të një ushtrie. Në vitin 1964 u themelua Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. (LBRSH). Lideri i saj më i rëndësishëm ishte Adem Demaçi, por shpejt në të u grumbullua një grup i vogël dhe i përkushtuar kuadrosh, në Prishtinë dhe Kosovën Verilindore.(Petiffer, 2013, p. 65)

Sipas Jakup Krasniqit ngjarje kthesë në historinë e Kosovës janë demostratat e nëntorit 1968 në Prishtinë dhe në Tetovë, ku demostruesit patën kërkuar hapjen e Universitetit të Kosovës, që Kosova të bëhej Republikë dhe të kishte kushtetutën e saj. Ata kërkuan më shumë të drejta dhe liri. Demostratat u shtypën me forca policore e ushtarake. Shqiptarët ishin të bindur se meritonin një pozicion më të avancuar kushtetues, i cili do të hapte prespektiva të reja politike, ekonomike, arsimore dhe në sferën e sigurisë kombëtare (Krasniqi , 2011, p. 33).

Gjithsesi pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët në Jugosllavi fituan disa të drejta. Dallimi kryesor në pozitën e shqiptarëve qëndron në faktin se tashmë statusi zyrtar i minoritetit u njoh me Kushtetutën e vitit 1946. Ndërsa amendamentet kushtetuese të vitit 1968 i dhanë Kosovës disa nga prerogativat që gëzonin republikat ish-jugosllave. Këto u konfirmuan edhe në Kushtetutën Jugosllave të vitit 1974(Hasani, 2000, pp. 21-22).

Këto ndryshime po ndodhnin, por jo ashtu siç i kishin kërkuar shqiptarët në demostratat e nëntorit të vitit 1968, që Kosova të bëhej republikë njësoj si republikat e tjera të Federatës Jugosllave, pra me të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje. Kushtetuta e vitit 1974 e sanksiononte Kosovën, Krahinë Socialiste Autonome, pjesë konstuitive e RSFJ-së. Duke e lënë qëllimisht në kuadrin e Serbisë, Kosovës nuk i lihej mundësi drejt vetëvendosjes (Krasniqi, 2011, p. 35). Liritë e fituara gjatë viteve '60-'80 sigurisht që nuk i kënaqën shqiptarët, por i nxitën ata për të bërë kërkesa për fitimin e të drejtave të tjera.

Demostratat e Kosovës të vitit 1981 ndodhnin për disa arsye. Përveç problemeve ekonomike, shoqërore, një nga arsyet kryesore ishte edhe ajo me karakter nacional. Fillimi i viteve '80 shënon regres përsa u përket të drejtave të shqiptarëve të Kosovës. Pas vdekjes së Titos, pasi u hoq autonomia e Kosovës prej Milosheviçit, në Kosovë nisi një etapë e re në organizimin politik të shqiptarëve në kuadrin e përpjekjeve të tyre për t'u shkëputur nga Serbia. Në dhjetor të vitit 1989, një grup intelektualësh që dënuan heqjen e autonomisë së Kosovës, formuan Lidhjen Demokratike të Kosovës (Biberaj, 1994, p. 27). Tanimë shqiptarët e Kosovës duke qenë jashtë PKJ-së do të ishin më të lirë dhe do të kishin më shumë mundësi për të artikuluar kërkesat e tyre.

Që nga viti 1968 shqiptarët e Kosovës kishin kërkuar më shumë të drejta. Thirrja e tyre në atë kohë ishte Kosova Republikë. Kjo kërkesë nuk ishte asgjë më shumë sesa barazia midis kombësive në Jugosllavi. Kjo kërkesë u kundërshtua dhe Kosova mundi të fitonte, ashtu si e kemi theksuar, vetëm autonominë në kuadër të Serbisë. Pyetja që shtrohet është se a kishin të drejtën e

vetëvendosjes dhe të shtetit shqiptarët e Kosovës? Po t'i përgjigjemi shkurt, padyshim që po.

Në qoftë se po, atëherë pse nuk pranohej kjo kërkesë e drejtë? Nëse kthehemi prapa në kohë, mund të gjejmë edhe përgjigjen. Që kur nisën përpjekjet e shqiptarëve filluan edhe kundërshtimet e fqinjëve për krijimin e një shteti shqiptar. Si edhe e kemi theksuar, u ngritën platforma ideore nga fqinjët që i konsideronin trojet shqiptare si të tyret. Nga ana tjetër ata shpeshherë theksonin idenë se shqiptarët nuk ishin të aftë të ndërtonin shtet dhe se ata duhet të bëheshin pjesë e këtyre shteteve për t'u civilizuar.

Shqiptarët e Kosovës nuk janë pajtuar me qëndrimin serb se shqiptarët në Jugosllavi ishin pakicë kombëtare. Ja sesi e shpjegon këtë Gazmend Pula: *Shqiptarët e Kosovës përbëjnë një popullsi autoktone. Nga pikëpamja administrative ata banojnë në tri republika të Jugosllavisë, por qendra e tyre është Krahina e Kosovës. Duke mbajtur parasysh faktorët demografikë, siç është numri i popullsisë dhe territoret ku banojnë, shqiptarët e Jugosllavisë nuk janë një pakicë kombëtare as në krahasim me kombësitë e tjera që jetojnë në Jugosllavi*"(Zajmi, 1990, p. 401).

Për këtë arsye, shqiptarët e Kosovës kanë kërkuar status të barabartë kushtetues për Kosovën më atë të republikave të tjera të Jugosllavisë, sepse shqiptarët janë ndier dhe ndihen banorë autoktonë për arsye të të gjithë treguesve demografikë dhe faktorëve të tjerë si tërësia territoriale, vazhdimësia historike, gjuha, kultura, dhe ndërgjegjja e fortë kombëtare (Zajmi, 1990, p. 401).

Në fakt, frika dhe moskuptimi se edhe shqiptarët duhet të kishin të drejta, çuan në një adresim të gabuar të çështjes shqiptare në Jugosllavi. Autoritetet jugosllave të çdo kohe nuk i kanë parë asnjëherë shqiptarët si pjesë përbëresë të shtetit të tyre. Kërkesa e kosovarëve për republikën e tyre i ka rrënjët e veta në zgjimin e një lloj krenarie në mesin e shqiptarëve, një e drejtë që u ishte mohuar. Për nacionalitetet e tjera, krenaria nacionale nuk përbënte kurrëfarë problemi, por për shqiptarët ishte e ndaluar. Shpërthimi në pranverën 1981 është rezultat i vonesës së barazisë dhe të drejtave nacionale (Hasani, 2000, p. 23).

Pas vitit 1989, kur Serbia me dhunë i hoqi Kosovës statusin e krahinës autonome, kosovarët dhe liderët kosovarë jo vetëm që nuk u pajtuan me këtë akt, por filluan të artikulonin më qartë kërkesat e tyre. Mark Krasniqi, akademik kosovar, shprehet se *Kosova ka pasur një traditë të gjatë autonomie dhe se e drejta historike ia garanton Kosovës autonominë. Këtë e tregojnë edhe luftrat e herëpashershme të shqiptarëve të cilat nisin më 1912, duke çliruar Shkupin dhe disa qytete të tjera nga osmanët, po ashtu më 1918 Pejën dhe vise të tjera të Dukagjinit. Edhe në Luftën e Dytë Botërore, mijëra shqiptarë luftuan kundër fashizmit*. Pas statusit të krahinës autonome, sipas Krasniqit, Kosova ka të drejtën e pavarësisë si të gjithë popujt e tjerë në federatën jugosllave. Kësaj duhet t'i shtojmë dhe faktin se në Jugosllavi jetonin 2.5 milionë shqiptarë të cilët zinin vendin e tretë pas serbëve dhe kroatëve (Krasniqi , 1990, p. 415).

Edhe Gazmend Zajmi në një intervistë të dhënë në Zërin e Amerikës 13 maj 1990, shprehej se *është e nevojshme barazia e Kosovës në federatë. Kjo do të ishte kuptimi i autonomisë si republikë socialiste apo si krahinë federative, do të ishte fjala për republikë autonome që të gjithë qytetarët e Kosovës të kishin shtetësinë në Jugosllavi* (Zajmi, 1990). Gjithashtu edhe Ibrahim Rugova artikulonte kërkesën se shpallja kushtetuese më e lartë e autonomisë në Jugosllavi është republika.

Kjo është një çështje që argumentohet me shumë faktorë, historikë, aktualë, etnikë. Ai konsatonte se shqiptarët janë kombi i tretë në Jugosllavi edhe pse mbajnë etiketën minoritet, meqenëse ekziston Shqipëria si shtet. Shqiptarët nuk janë minoritet, por kanë një potencial njerëzor për t'u vlerësuar dhe u takon një status i tillë. (Rugova, 1990, p. 430).

Situata politike ndërkombëtare pas rënies së Murit të Berlinit dhe bashkimit të Gjermanisë, rënia e komunizmit në Bashkimin Sovjetik, në Evropën Lindore dhe në Ballkan, angazhimi i amerikanëve në Lindjen e Afërme bënte të pamundur angazhimin e faktorit ndërkombëtar në Kosovë. Gjithashtu edhe nisja e procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe paqartësia e politikëbërësve të Evropës për të ardhmen e saj, nuk linte mundësi për një angazhim të tyre në Kosovë.

Përplasjet në Slloveni, Kroaci e më pas në Bosnjë-Hercegovinë dhe qetësia relative në Kosovë, të jepnin përshtypjen e gabuar se në Kosovë situata ishte nën kontroll. Por pas paqes së Dejtonit ku problemi i shqiptarëve në Jugosllavi nuk u përmend, ata filluan që të kërkonin rrugë të reja për të arritur qëllimin e tyre.

Procesi i krijimit të shtetit të Kosovës ka hasur në kundërshti të mëdha. Së pari Kosovës nuk iu dha e drejta për të patur shtet në kuadrin e pasluftës në Jugosllavisë komuniste. Së dyti gjatë periudhës '45-'90 autoritetet jugosllave me gjithë lëshimet që bënë nuk lejuan Kosovën të fitonte statusin e republikës në federatë. Së treti arsye e sigurisë dhe e stabilitetit rajonal dhe më gjerë peshojnë më shumë se çështjet e njohjes ndërkombëtare të shteteve të reja, sepse këto njohje mund te sjellin pasoja negative (Hasani, 2000, p. 66).

Periudha pas viteve '90 në Kosovë dukej e tensionuar, por nën kontroll. Serbia mundohej që të gjitha problemet që haste në Kosovë t'i paraqiste si çështje të brendshme. Të dyja palët kishin kundërshtime dhe këmbëngulnin për pozicionet e tyre përsa i përkiste statusit. I gjithë spektri politik në Beograd kundërshtonte pavarësinë ose një lloj autonomie që do të restauronte dy karakteristika të statusit të 1974, pjesëmarrjen e Kosovës në nivel administrativ dhe elementë të shtetësisë, me një president dhe një kushtetutë më shumë se një status (Ahrens, 2010). Pas heqjes së autonomisë së Kosovës nga ana e Beogradit, kosovarët ndërmorën disa hapa të cilat përbëjnë fillesën për krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Deklarata e 2 korrikut 1990, kushtetuta e shtatorit 1991 dhe po në këtë vit shqiptarët e Kosovës, votuan në referendum për "Kosovën shtet të pavarur dhe sovran"(Verli, 2007, p. 437). Kjo tregoi mundësinë por edhe dëshirën që kishin shqiptarët në Serbi për të formuar shtetin e tyre.

Për t'iu kundërvënë masave të marra nga Beogradi, shqiptarët e Kosovës krijuan organet e tyre shtetërore paralele si qeverinë e udhëhequr nga Bujar Bukoshi dhe zgjodhën president të tyre Ibrahim Rugovën, udhëheqësin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kjo politikë kishte përkrahësit dhe kundërshtarët e saj. Përgjithësisht i gjithë faktori ndërkombëtar përkrahte Rugovën me mendimin se ai ndiqte një rrugë paqësore dhe se ishte i pranueshën në kërkesa dhe dialog. Veç kësaj, askush nuk kërkonte që të hapte një vatër tjetër konflikti në rajonin e Ballkanit pas krizave në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Por një pjesë e popullsisë shqiptare ishte e pakënaqur me politikën e pritshmërisë së ndjekur nga Rugova. Kjo pakënaqësi u rrit sidomos pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dayton-it. Edhe pse shqiptarët e kishin qenë viktimat e para të Millosheviçit, ata nuk përfituan asgjë. Sa

kohë që ata do të mbeteshin pasivë, ata do të shpërfilleshin nga bota e jashtme, kurse Milosheviçi do të vazhdonte t'ua mohonte të drejtat shqiptarëve dhe regjimi i tij i shtypjes do të vazhdonte pa u shqetësuar (Glenny, 2007, pp. 651-652)

Me daljen në skenë të UÇK-së konflikti me përmasa të mëdha ishte çështje kohe para se të shpërthente. Milosheviçi dhe gjithë makineria e propogandës serbe u mundua që ta paraqiste këtë konflikt si një problem të brendshëm të Serbisë dhe, kur përmasa e këtij konflikti po bëhej e kuptueshme dhe reale, ai u përpoq që t'i jepjte atij një karakter fetar dhe t'i trajtonte luftëtarët e UÇK-së si terroristë. Krahas rritjes së tensionit mes palëve u rritën edhe përpjekjet diplomatike për të gjetur një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët. Fillimisht, përsa i përket palës kosovare si personi më i pranueshëm për bisedime shihej Ibrahim Rugova. Ai u prit në Shtëpinë e Bardhë nga presidenti amerikan Klinton dhe Al Gore, të cilët i premtuan se ata nuk do lejonin përsëritjen e masakrave që ndodhën në Bosnjë-Hercegovinë (Laurent,2009, p. 29).

Ndërkohë që zhvillimet në terren ishin të shpejta, UÇK-ja po dilte gjithnjë e më shume si faktor që nuk duhej anashkaluar. Në të njëjtën kohë, më rritjen e rolit të UÇK-së , ashpërsohej edhe reagimi i autoriteteve serbe në Kosovë. Ky reagim që sa vinte e rritej shqetësonte edhe më shumë faktorin ndërkombëtar, i cili nga ana e vet po bënte gjithnjë e më shumë presion Milosheviçit. Holbrooku u përpoq që të negocionte një zgjidhje me Milosheviçin më 13 tetor 1998 , e cila parashikonte tërheqjen e pjesshme të trupave Jugosllave nga Kosova, rikthim të refugjatëve, zgjedhje dhe vendosje të autonomisë të mbështetur në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (Ahrens, 2010, p. 375). Edhe vetë komandanti i NATO-s Klark, u përpoq që të binte Milosheviçin që të ndalte dhunën në Kosovë, pasi kjo gjë nuk do të tolerohej dhe se ai duhej të "*vepronte me realizëm"* (Laurent, 2009, p. 41).

Dështimi i diplomacisë do të thoshte fillimi i bombardimeve të paralajmëruara nga NATO-ja. Zbulimet sekrete austriake mundën të zotëronin një material të rëndësishëm, ku autoritet e Beogradit po përgatiteshin që prej disa javësh për një ndërhyrje të rëndësishme ushtarake në Kosovë. Austriakët që zotëronin shumë informacion, zotëronin madje edhe emrin e kodit të operacionit "Potovka", që do të thoshte patkoi dhe objektivi i tij ishte që të dëbonte nga Kosova qindra mijëra shqiptarë (Laurent, 2009, p. 42).

Këto plane së bashku me veprimtarinë në terren të trupave policore dhe ushtarake serbe, të cilat u vërtetuan nga të dërguarit specialë të OKB-së, e përshpejtuan dhe forcuan bindjen, se Miloshevici duhej ndalur. Përpjekja e fundit për ta bërë këtë ishte takimi i Rambujesë në 14 shkurt 1999. Në një përpjekje të fundit, Sekretarja e Shtetit zonja Medlin Ollbright mori pjesë vetë personalisht. Ajo afirmoi në fund të ditës se shqiptarët ishin të gatshëm të nënshkruanin marrëveshjen, duke ua hedhur përgjegjësinë e dështimit serbëve, pavarësisht një stepjeje të fundit nga UÇK-ja(Laurent, 2009, p. 63).

Pas ndërhyrjes brutale të ushtrisë serbe në Kosovë në vitin 1999 dhe masakrave që ajo kreu aty, Serbia e humbi të drejtën njëherë e përgjithmonë mbi Kosovën. Ndërhyrja e NATO-s zgjidhi një padrejtësi shekullore dhe i dha mundësi popullit të Kosovës për vetëvendosje, kur pas një periudhë tanzitore ai shpalli pavarësinë e vet në 17 shkurt 2008.

**Përfundime**

Lufta dhe përpjekjet e kosovarëve kaluan në disa etapa, kjo në varësi të situatave të brendshme por edhe të

kushteve të jashtme. Pas aneksimit të Kosovës dhe rajoneve të tjera nga Serbia, shqiptarët në vitet e para kundërshtuan këtë pushtim me luftë dhe me dëshirë për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Pas Luftës së Parë Botërore, krahas luftës për bashkim kombëtar përpjekjet e shqiptarëve të Kosvës u fokusuan edhe në ruajtjen e ekzistencës së tyre në Jugosllavi, pasi masat e mara nga autoritetet serbe ishin shumë të ashpra dhe synonin asgjësimin fizik të shqiptarëve në Kosovë. Pikërisht, pas Luftës së Parë Botërore, vërehet përqindja më e ulët e shqiptarëve në Krahinë si pasojë e masakrave, por edhe e shpërnguljes së tyre me dhunë drejt Shqipërisë dhe Turqisë.

Lufta e Dytë Botërore dhe fitorja e komunistëve nuk solli ndryshime për statusin e shqiptarëvë në Jugosllavi. Ndryshe nga kombësitë e tjera në Jugosllavi, të cilave iu njoh e drejta për të patur shtetin e tyre shqiptarëve, kjo gjë iu mohua.

Moskuptimi i të drejtave të kosovarëve, politikat nacionaliste të ndjekura nga shtetarët serbë, bënë që në asnjë moment shqiptarët ta ndienin veten të përfaqësuar në shtetin e Serbisë. Kjo mënyrë të menduari dhe të sjelluri solli reagimin dhe mospajtimin e dy popujve. Sa më e egër ishte dhuna, aq më i ashpër ishte reagimi i shqiptarëve.

Përpjekjet paqësore të shqiptarëve në Kosovë në fillim të viteve '90 nuk u kuptuan prej serbëve të cilët vazhduan t'i çonin të dy popujt në një konflikt të ashpër i cili shpërtheu në vitin 1997.

Masakrat e ushtrisë serbe mbi popullsinë civile dhe shpërngulja me forcë e qindra mijëra shqiptarëve solli reagimin e bashkësisë ndërkombëtare, OKB-së, BE-së, NATO-s të cilat kundërshtuan politikat serbe në Kosovë. Takimi i Rambujesë nuk solli marrëveshje mes palëve dhe i hapi rrugën ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë.

Ndërhyrja e NATO-s dhe Lufta e UÇK-së i shkaktuan humbje forcave serbe, të cilat u larguan nga Kosova, që tashmë nën mbrojtjen ndërkombëtare mund të ndërtonte shtetin e vet, të fituar pas një shekulli përpjekjesh.

Kjo e drejtë megjithëse iu mohua për një kohë të gjatë, herë me përpjekjet për t'i shpërngulur dhe herë me arsyetime të paqena, si ajo që shqiptarët e kanë shtetin e tyre dhe se shqiptarët në Kosovë nuk mund të jenë veçse pakica kombëtare në Serbi, nuk mundën që të dekurajojnë ëndrrën e madhe për pavarësinë e Kosovës.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Ahrens, G.-H. (2010). *Diplomaci mbi Tehun e Thikes.* Tiranë, Toena.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007). *Historia e popullit shqiptar, Vëllimi III.* Tiranë, Toena.

Biberaj, E. (1994). *Kosova fuci baroti e Ballkanit .* Tiranë, Dardania.

Culaj, L. (1997). *Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" 1918-1924 .*Prishtinë, Instituti Albanologjik.

Dervishi, K. (2006). *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005.* Tiranë, Shtëpia botuese 55.

Freundlich, L. (1995). *Golgota shqiptare. Akuza kundër shfarosësve të popullit shqiptar.*Tiranë, Lilo.

Glenny, M. (2007). *Historia e Ballkanit 1804-1999.* Tiranë, Toena.

Hasani, E. (2000). *Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova .* Tiranë, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare.
Krasniqi, J. (2011). *Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1981, sipas shtypit shqiptar.* Prishtinë, Buzuku.
Laurent, E. (2009). *Lufta e Kosovës.* Tiranë, Botim i Gazetës 55.
Petiffer, J. ( 2013). *Ushtria çlirimtare e Kosovës. Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit .* Tiranë, Onufri .
Rugova, I. (1990). Ç'*thonë dhe ç'kërkojnë kosovarët*. *Shpallja më e lartë e autonomisë është Republika*, p. 431.
Shala, X. (2009). *Ballkani gjeopolitika dhe siguria I.* Tiranë, Onufri.
Verli, M. (2007). *Kosova sfida shqiptare në historinë e nje shekulli.* Tiranë, Botimpex.

# ZGJEDHJET ELEKTORALE TË VITIT 1945 NË SHQIPËRI

**RUELA AGO**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë**

**Përmbledhje**

Motivi për të shkruar për zgjedhjet elektorale të 2 Dhjetorit 1945, lidhet me faktin se për herë të parë në Shqipëri u zbatuan parimet e zgjedhjeve të përgjithshme, të fshehta dhe të drejtëpërdrejta, duke njohur për herë të parë edhe të drejtën e votimit për gratë, ç'ka e zgjeronte shumë rrethin e zgjedhësve.

Duke bërë një vlerësim të tyre mund të themi se kuadri ligjor përmes të cilit u zhvilluan ato, u përshkruan nga një frymë e lehtë demokratike. Në krahasim me zgjedhjet e mëvonshme , kur u forcua sundimi i partisë- shtet dhe u bë edhe më i rreptë represioni në emër të luftës së klasave, zgjedhjet e 1945-ës shprehën në një farë mënyre ndjenjat e popullit, duke patur parasysh prestigjin e madh të Frontit dhe të Partisë Komuniste, si drejtuese të Luftës Nacionalçlirimtare.

Punimi trajton çështje të tilla si legjislacionin elektoral të zgjedhjeve, ligjin mbi "zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit për Asamblenë Kushtetuese", ligjin "mbi listat elektorale", fushatën elektorale, e cila pasqyron propagandën e madhe të Partisë Komuniste për të fituar zgjedhjet e 2 Dhjetorit, përpjekjet e përfaqësuesve të opozitës për të formuar parti politike jashtë Frontitetj. Trajtim i veçantë i kushtohet zhvillimit dhe rezultateve të zgjedhjeve.

Në këtë punim u jepen përgjigje disa pyetjeve: Në çfarë rrethanash u zhvilluan zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945? Cilat qenë problematikat teknike që shoqëruan zgjedhjet? Cilat janë shifrat zyrtare për pjesëmarrjen në votime? Sa reale dhe të besueshme janë shifrat zyrtare të kohës? etj.

Trajtimi i kësaj çështjeje nga autorë të ndryshëm, studimi i dokumenteve në Arkivin Qendror Shtetëror, i librave, gazetave dhe revistave në Bibliotekën Kombëtare, tregojnë se periudha e trajtuar është një moment i rëndësishëm i Historisë së Shqipërisë.

Zgjedhjet Elektorale të 2 Dhjetorit 1945 të fituara nga Fronti Demokratik , të cilat sanksionuan ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste, përbëjnë edhe fillimin e sundimit gati gjysmë shekullor të komunizmit në Shqipëri.

**Fjalët çelës:** *zgjedhje elektorale, Fronti Nacionalçlirimtar, legjislacion, Partia Komuniste.*

**Absrtact**

The motive that induced me to write for The elections of December 2, 1945 was because for the first time in Albania were applied principles of general elections, secret and direct, recognizing for the first time the right to vote for women, which would expand even more election participation.

If we had to analyze this process, we could say that the legal framework in wich they took place, there was a slight spirit of democracy. Compared to the subsequent elections, at the same time when the strength of the Party became the rule of the state and the

repression of class struggle became more stringent, the 1945 elections expressed in some way people's feelings, given the great prestige of the Front and the Communist Party, as the head of the National Liberation War.

This paper addresses such issues as: election electoral legislation, including the law on the election of representatives of people for constitutional assembly; the law on electoral list etc. The electoral campaign, which reflects the great propaganda of Communist Party for gaining the elections of December 2, efforts of the opposition's representatives to form a political party outside of the Front. A special concentration is also given to the development and the election results.

In this paper there are given the answers of some questions: Under what circumstances were held the elections of December 2, 1945? Which were the technical problems that accompanied the elections? Which are the official figures for the participation in polls? How real and credible are the official figures at that time?

The tratement of this issue by different authors that I've read, the study of the documents in the Central Archive of the State, of the books, newspapers and magazines in the National Library, show that the period that we are talking about is an important moment in the History of Albania. Elections of December 2, won by the Democratic Front which sanctioned the takeover of the Communist Party, constitute the beginning of the communism ruling for about half century in Albania.

**Key Words**: *election, the National Liberation Front, legislation, Communist Party.*

Largimi i pushtuesve pas Luftës së Dytë Botërore jashtë kufijve të vendit dhe vendosja ligjore e Qeverisë së Përkohshme Demokratike mbi territorin e Shqipërisë , hapi një faqe të re në historinë tonë. PKSH-ja, që ishte një parti e tipit të ri joparlamentar, kishte arritur që gjatë viteve të luftës të fitonte të drejtën për të qenë shprehëse e interesave kombëtare dhe të merrte rolin udhëheqës. Ajo si në planin e brendshëm, si në arenën ndërkombëtare gëzonte kapital politik.

Në Shqipërinë e pasluftës "mungonin dy tipare dalluese kryesore të demokracisë popullore: pluralizmi partiak dhe roli udhëheqës i klasës punëtore. Në Shqipëri veç Partisë Komuniste, nuk kishte parti tjetër" (Nina, S. 2004, p. 296).

Nga ana tjetër, organizata të tjera si Balli Kombëtar dhe Legaliteti u konsideruan si bashkëpunëtorë me pushtuesit dhe nuk gëzonin simpatinë e një pjese të madhe të popullit. Kjo situatë u shfrytëzua mjaft mirë nga Partia Komuniste, për të mos i lejuar këto organizata të veprojnë. Balli Kombëtar dhe Legaliteti u konsideruan bashkëpunëtorë të fashistëve dhe nazistëve dhe u larguan nga jeta polilike në Shqipëri. Disa nga drejtuesit e këtyre organizatave u arratisën, disa u larguan nga vendi e disa të tjerë morën dënime ekstreme.

Sfidë për komunistët përbënte mbajtja e pushtetit dhe kontrolli i plotë mbi gjithë vendin. Kjo do të arrihej me kthimin e Shqipërisë në një vend të socializmit real, me vendosjen e sistemit njëpartiak në qeverisje (Duka, 2007, p. 231). Për ta legjitimuar këtë gjë Qeveria e Përkohshme miratoi "Ligjin për dënimin e kriminelëve të luftës" ku u përfshinë bashkëpunëtorët e fashizmit dhe kundërshtarët politikë të PKSH-së. Në 5 Gusht të 1945-ës Fronti Nacionalçlirimtar ndërroi emrin në Front Demokratik, që ashtu si në vendet e tjera të Lindjes, nuk ishte gjë tjetër veçse një perde pas së cilës fshiheshin komunistët. Dhe pse PKSH-ja ishte ajo që drejtonte Frontin, ajo kishte në popull më pak

mbështetje se sa Fronti , sepse shumica e shqiptarëve kishte luftuar me Frontin dhe jo me PKSH-në (Duka, 2007, p. 231).

Në rrethanat e vështira që po kalonte vendi, menjëhërë pas luftës, Partia Komuniste përcaktoi si detyrë prioritare ndërtimin e një sistemi politik, që do t'i përshtatej natyrës dhe qëllimit të saj.

Në këtë kuadër rëndësi të posaçme kishte organizimi i shtetit që do të përdorej si mjet për kryerjen e reformave që do çonin në normalizimin e jetës, por dhe për të shtypur e likuiduar klasat kundërshtare dhe rezistencën e tyre. Këto dy drejtime të veprimtarisë së shtetit përbënin qëllimin kryesor të PKSh-së. Në rrethana të tilla, shteti demokratik që doli nga lufta, dalëngadalë do të merrte tiparet e një diktature të majtë të tipit stalinist. Këtë proces do ta favorizonin dhe disa rrethana të brendshme e të jashtme, që ishin të pranishme e që do të ndikonin në zhvillimet pas luftës (AShSh , 2009, p. 169).

Përballë vështirësive, vendi sigurisht kishte nevojë për një shtet të organizuar mirë që të garantonte sigurinë kombëtare dhe paprekshmërinë e kufijve. Por kjo, nuk nënkuptonte e nuk kërkonte me patjetër ndërtimin e një shteti diktatorial. Përkundrazi vetëm me një sistem e shtet demokratik mund të sigurohej mbështetja e gjerë e popullit si dhe njohja ndërkombëtare e qeverisë. Në këtë mënyrë vendi do të ishte në gjendje të përballonte vështirësitë e brendshme dhe rreziqet e jashtme që do të ishin të pranishme për një kohë të gjatë (AShSh, 2009, p. 169).

Mirëpo Partia Komuniste kishte edhe synime të tjera. Ajo kërkonte të stabilizonte e të kontrollonte sa më parë gjendjen në vend, të likuidonte kundërshtarët politikë dhe rezistencën e tyre, e cila në këto vite ishte aktive, dhe t'i hapte rrugë shndërrimeve socialiste dhe ndërtimit të rendit socialist. Në funksion të këtij qëllimi, PKSh-ja do të përpunonte dhe idetë e një shteti të fortë e të një sistemi politik në dukje demokratik, por që barte në vetvete gjithë elementët dhe premisat për t'u shndërruar shpejt në diktaturë.

**Zgjedhjet elektorale të vitit 1945 në Shqipëri**

Për të ligjëruar pushtetin, qeveria komuniste duhet të organizonte zgjedhje të lira dhe demokratike. Në Shqipëri mungonte legjislacioni i nevojshëm dhe qeveria komuniste nuk pranoi të njihte asnjë kuadër ligjor të trashëguar nga qeveritë e mëparshme. Nga ana tjetër ligji elekloral i monarkisë, i mohonte të drejtën e votës disa kategorive si grave, ushtarakëve etj. Veç kësaj votimi nuk ishte i drejtëpërdrejtë, por ishte indirekt dhe me dy raunde. Në këtë situatë duhej krijuar dhe miratuar një paketë e përshtatshme ligjore për zgjedhjet.

Ligji nr. 123 " Mbi Asamblenë Kushtetuese" që u dekretua nga Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në 27 Shtator 1945, së bashku me Ligjin nr. 124 " Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit për Asamblenë Kushtetuese" dhe Ligjin nr. 125 "Mbi Listat Elektorale", përbënin kuadrin ligjor me të cilin u zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme. Ligji ishte tërësisht demokratik parë në tërësi. Në ligj përcaktoheshin qartë sistemi i zgjedhjeve, subjektet zgjedhore, parimet e zgjedhjes, procedurat e votimit, formula e ndarjes së vendeve për në Asamblenë Kushtetuese (Ilir,B. 2009, pp. 149-150) të drejtat e zgjedhësve, detyrimet e organeve që do zhvillonin këto zgjedhje dhe dispozitat penale për shkelësit e procesit të zgjedhjeve. Me këto ligje u zhvilluan zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945.

Ligji nr. 123 " Mbi Asamblenë Kushtetuese" përmbante 16 nene. Kështu në nenin 1 të tij thuhej: *"...populli të shprehë vullnetin e tij sovran mbi regjimin*

*e ardhshëm të shtetit do të zgjidhen përfaqësues për një Asamblnë Kushtetuese, trupi përfaqësues më i lartë i Shqipërisë Demokratike*".( 1945, Ligji nr. 123). Neni 2 i tij shprehej se "*zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese do të bëhen në bazë të ligjit të posaçëm 'Mbi zgjedhjet e përfaqësuësve të popullit për Asamblenë Kushtetuese dhe të ligjit për listat elektorale' "*. Neni 5: " *Në mbledhjen e parë përfaqësuesit e pranishëm paraqesin certifikatat e lëshuara prej Komisioneve të Zgjedhjeve dhe menjëherë zgjedhin një komision prej 20 anëtarësh për të shqyrtuar vlefshmërinë e zgjedhjeve*( Po aty).

Ligji nr 124, " Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit për Asamblenë Kushtetuese", i miratuar në 28 Shtator 1945 nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, bëri kalimin në një standard të ri zgjedhor, zëvendësoi votimin e tërthortë me dy shkallë, (Anastas, 2004) me votimin e drejtpërdrejtë të shtetasve për zgjedhjen e përfaqësuesve. Kështu në nenin 1 thuhej: "*Përfaqësuesit e popullit për Asamblenë Kushtetuese zgjidhen sipas normave të këtij ligji, me anë të zgjedhjeve të lira dhe me votim të përgjithshëm, të barabartë, direkt dhe të fshehtë*" (1945, Ligji nr.124).

Deri me miratimin e këtij ligji, të drejtën e votës e gëzonin vetëm meshkujt. Femrat ishin të përjashtuara nga e drejta e zgjedhjes, nuk kishin të drejtë as të votojnë për zgjedhjen e përfaqësuesve dhe as të zgjidhen në organet e zgjedhura të shtetit. Ky ligj sanksionoi votim të përgjithshëm, pra të drejtën e votimit edhe për gratë, të cilat deri në këtë moment ishin të përjashtuara nga kjo e drejtë (Ilir,B. 2009, p. 149).

Në Ligjin nr. 125, mbi "Listat Eleklorale", aprovuar më 29 Shtator 1945 nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, jepen shpjegime mbi listat elektorale. Kështu p.sh. neni 1 thotë: " *Listat elektorale shërbejnë për të konstatuar të drejtën e zgjedhjes (votimit) që gëzon shtetasi shqiptar*". Neni 2: "*Listat elektorale hartohen për zonat e cdo katundi dhe qyteti ose lagje qyteti kur kjo ka këshillin e vet*".

Në një kapitull të veçantë të këtij ligji shpjegohet dhe mënyra e formimit të listave elektorale. Neni 7: "*Komisioni harton listat elektorale, ku regjistron të gjithë nënshtetasit që kanë të drejtë votimi, në bazë të regjistrave të popullsisë"*. Neni 8: "*Për çdo katund dhe qytet ose lagje qyteti që ka këshillin e vet, hartohet nga një listë elektorale e veçantë*". Neni 11: " …*komisioni harton listën elektorale të çdo zone në dy kopje dhe e vërteton duke shënuar datën e përfundimit të saj, sa votues përmban dhe sa faqe është*.(Ilir,B. 2009, p. 150). Ligji e lejonte konkurencën e grupimeve politike rivale dhe daljen e kandidatëve të pavarur, duke u munduar të krijojë një imazh pozitiv të regjimit tek SHBA-ja dhe Britania e Madhe, dy shtete që për një kohë të gjatë nuk pranuan të njohin legjitimitetin e regjimit të Hoxhës. Kontrolli dhe presioni nga Sigurimi dhe grupet speciale të regjimit nuk i lejuan grupet liberale dhe antikomuniste të mblidhnin 70 firma sipas ligjit elekloral, kjo dhe për shkak të trysnisë që ushtronte PKSh-ja ndaj kundërshtarëve dhe për shkak të dobësisë së forcave opozitare kundrejt Frontit (Afrim, K. 2006, p. 154). Ligji elektoral përcaktoi edhe subjektet elektorale që do të mernin pjesë në zgjedhje. Sipas ligjit u shpall publikisht se si subjekt elektoral i vetëm në këto zgjedhje do të ishte Fronti Demokratik. Përcaktimi i Frontit si subjekt i vetëm elektoral u arsyetua se ai kishte përbërje pluraliste (pozitë + opozitë).

Në kuadrin e masave të marra për zgjedhje të lira dhe të pranueshme nga faktori ndërkombëtar, kërkohej dhe regjistrimi i popullsisë, i cili u vendos të

bëhej në 30 Shtator 1945. Përveç rëndësisë që kishte për zgjedhjet, këtë regjistrim e kërkonte dhe vetë situata e pasluftës për shkak të së cilës pjesa më e madhe e regjistrave themeltarë ishte zhdukur. Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë kishte për qëllim të vërtetonte gjendjen numerike të popullsisë të ndarë sipas gjinisë, moshës, gjendjes civile etj. Për kryerjen e këtij regjistrimi pati një mobilizim të të gjithë nëpunësve civilë dhe ushtarakë, gjithë nëpunësit e institucioneve publike që paguheshin prej fondeve të posaçme dhe gjithë nënshtetasit që dinin të shkruanin. (AQSH, 1945, p. 3)

Vëmendja e Qeverisë së Përkohshme u përqendrua në fushatën elektorale. Ajo u zhvillua gjatë muajve Tetor - Nëntor 1945. Fushata u çel në 14 Tetor me një entuziazëm të madh. Në gjithë Shqipërinë u mbajtën mitingje të mëdha. U bë një mobilizim i përgjithshëm i forcave komuniste. Në punë u vendosën të gjitha mjetet propagandistike si shtypi, parrullat, radio etj. Gjithë media zyrtare ishte në duart e tyre. Kandidatët e pavarur zotëronin mjete të kufizuara propagandistike. Kandidatëve të vetëm të Frontit iu bëhej një propagandë e madhe në Radio-Tirana dhe në gazetën "Bashkimi" e cila çdo ditë publikonte me foto dhe shkrime kandidatët e saj.

Një rëndësi e madhe iu kushtua propagandës në Veri pasi mendohej se ndikimi i Frontit nuk ishte i madh dhe kjo ishte parë në përpjekjet e tyre për të kundërshtuar Frontin dhe për të krijuar grupe opozitare. Në këtë zonë komunistët ndjenin frikën e një reaksioni kundër tyre ndaj morën masa të menjëhershme. Fillimisht për të neutralizuar klerin katolik kërkuan të bënin koalicion me të në rrethin e Shkodrës e kështu të evitonin krijimin e një opozite në gjirin e Asamblesë (AQSH, 1945, d. 1, p. 2). Në këtë kuadër Enver Hoxha u tha anëtarëve të Pleniumit IV të PKSh-së, mbajtur në fillim të fushatës elektorale, se duhej të punonin me klerin katolik të Shkodrës si individ dhe si ent fetar i cili, sipas tij, "është një ent i organizuar mirë me baza në popullin e asaj krahine, me tradita dhe me lidhje të shëndosha me Vatikanin. Prandaj me klerin katolik duhej, duhej bërë një politikë e zgjuar, sepse " *pozitat e jona janë të dobëta në krahinën e Shkodrës.* (AQSH/AP, 17 tetor 1945, p. 6)

Partia Komuniste theksoi se zgjedhjet duhet të bëheshin një shkollë e madhe politike për popullin, për Frontin dhe për Partinë dhe vuri në dukje nevojën që të luftoheshin haptas forcat armiqësore që mundoheshin të krijonin një opozitë kundër pushtetit dhe Frontit, dhe elementët që përpiqeshin ta cënonin Frontin nga brenda për të dalë më vonë si një parti më vete jashtë Frontit (AShSh, 1983, p. 42). Nga ky konkluzion duket qartë se PKSH nuk e përjashtonte dhunën ndaj kundërshtarëve politikë, që po bënin përpjekje të organizoheshin në parti politike, veçse ajo duhej të kombinohej me punën bindëse propaganduese gjatë zgjedhjeve të kuadrove të PKSH-së (Demir, D. 2011, p. 35). Për t'iu kundërpërgjigjur të gjithë elementëve kundërshtarë të regjimit, udhëheqja e lartë e PKSH-së, aktivizoi elementët më aktivë të saj, të Frontit dhe të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar siç qenë: Nako Spiro, Sejfulla Malëshova, Medar Shtylla, Omer Nishani etj.

Duke qenë gjithë kohës vigjilentë për moslejimin e partive të tjera, Enver Hoxha dhe qeveria e tij, u kujdesën që të zhvillonin një fushatë elektorale, sa më të gjerë , ku ti kërkonte popullit të votonte vetëm për Frontin Demokratik dhe programin e tij.

Në krye të programit të Frontit ishte mbrojtja e pavarësisë dhe e integritetit

tokësor të Shqipërisë; vendosja e një regjimi republikan pas zgjedhjeve ; të drejta të plota demokratike si e drejta e fjalës, e organizimit, e shtypit për të gjithë popullin me përjashtim të grupeve fashiste; pakicat nacionale do të kenë të drejtën për të patur shkollat, shtypin, administratën dhe gjuhën e tyre; gjykatat popullore të përfaqësoheshin nga masat e gjera të popullit dhe të kontrollohen prej tyre; forcimi dhe modernizimi i ushtrisë kombëtare; politika shoqërore për punëtorët, fëmijët, pleqtë, invalidët dhe ngritja e spitaleve; mbrojtja e të drejtave të rinisë, të punëtorëve dhe intelektualëve(1945, *Gazeta Bashkimi* (272), 1).

Përpjekjet për të formuar një opozitë ishin të dobëta dhe vetë krerët opozitarë nuk mundën të hartonin një platformë të përbashkët për të qenë konkurentë përpara Frontit Demokratik, por konkurenti real ishte Partia Komuniste. (2005.,*Tirana Observer* (128), 14).

Përpjekjet për formimin e opozitës jokomuniste u bënë dhe nga përfaqësues të Frontit, por këta elementë nuk ranë dakort për rrugën që duhej të ndiqnin e për këtë arsye u ndanë në dy grupime të kundërta. Grupi i parë i përfaqësuar nga nënkryetari i Frontit Nacionalclirimtar Shefqet Beja, synonte që organizata opozitare të formohej brenda Frontit pas zgjedhjeve të 2 Dhjetorit, me elementë që do të vinin kandidaturën si përfaqësues të Frontit Demokratik dhe më pas të dilte si grup më vete, grupi i dytë i përfaqësuar nga anëtari i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar Gjergj Kokoshi, i cili mendonte që partitë opozitare të formoheshin jashtë Frontit para zgjedhjeve dhe si të tilla të vinin kandidaturën në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese si grupim politik më vete. Të dyja grupimet nuk e gjetën gjuhën e përbashkët dhe u ndanë përfundimisht në Shtator të vitit 1945 (2005,*Tirana Observer* (128), 14) .

Kur u diskutua dhe u miratua ligji " Mbi zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese" Shefqet Beja e mbështeti këtë ligj, kurse Gjergj Kokoshi e kundërshtoi atë dhe kërkoi që në asamble "përbri njerëzve të luftës, të shkojnë edhe njerëz të paqes, që mbi të gjitha kanë idealet e larta të atdheut e të njerëzimit", të cilëve, duke mos qenë të organizuar në parti, u mungonte shtypi dhe propaganda dhe për rrjedhojë ishin të destinuar, siç u shpreh ai, "apriori me falimentue nër zgjedhjet" (Po aty).

Me gjithë përpjekjet për të formuar opozitë, rezultati ishte negativ pasi Partia Komuniste nuk lejoi që në Shqipëri të kishte pluralizëm partiak. Kjo ndihmohej edhe nga fakti që në Shqipëri mungonte tradita e partive politike. Përveç politikës së brendshme, Partia Komuniste duhej të shqetësohej dhe për politikën e jashtme. Qeveria kishte dalë nga lufta dhe nuk ishte legjitime, këtë status mund ta fitonte vetëm me anë të zgjedhjeve, ndaj i duhej njohja nga Fuqitë e Mëdha. Për këtë qëllim në 21 Dhjetor 1944 Enver Hoxha i dërgoi një kërkesë zyrtare Anglisë, SHBA-së dhe BS-së për njohjen e qeverisë së tij. (Demir, D., 1999, p. 98). Raporti i përgatitur nga misioni amerikan rekomandonte njohjen e qeverisë shqiptare nga ana e qeverisë amerikane pas përmbushjes nga ana e saj të dy kushteve: a) mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të fshehta dhe të përgjithshme për Asamblenë Kushtetuese b) sigurimin e të drejtave diplomatike e konsullore për zyrtarët amerikane, të dërguar në Shqipëri (Hamit, K. 2007, pp. 139-140).

Qeveria britanike nuk pranoi njohjen e qeverisë si fillim. Bashkimi Sovjetik i kushtëzuar nga detyrimi për të bashkëvepruar me aleatët lidhur me popujt e çliruar, nuk mund të ndërmerrte vendosjen e marrëdhënieve diplomatike

në mënyrë të njëanshme. Më 30 tetor 1945, qeveria sovjetike i dërgoi ambasadorit të ShBA-së në Moskë, A. Harrimanit një notë, në të cilën bënte të ditur dëshirën e vet për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Qeverinë e Përkohshme Demokratike të Shqipërisë (Nina, S. 2004, p. 311).

Si përfundim, qeveria amerikane, angleze dhe sovjetike vendosën bashkarisht t'ia paraqisnin qeverisë shqiptare notën e njohjes më 10 Nëntor 1945. Ndërsa përpiqej për njohje ndërkombëtare, si partner strategjik ishte zgjedhur një vend fqinj, Jugosllavia, marrëdhëniet me të cilën ishin vendosur që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. (Gjeçovi, 2004, p. 85)

Në mbështetje të nenit 2 të Ligjit nr. 124 i datës 28 Shtator 1945, " Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit për Asamblenë Kushtetuese" dhe mbi propozimin e Kryetarit të Qeverisë Demokratike, Kryesia e Këshillit Nacional-Çlirimtar vendosi që: "*Zgjedhjet për përfaqësuesit e popullit për Asamblenë Kushtetuese të bëhen në 2 Dhjetor të 1945, ditën e Dielë, duke filluar prej orës 7 të mëngjesit deri në orën 19 të mbrëmjes*". Në Mbështetje të nenit 7 të po këtij ligji, u bë emërimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve i cili përbëhej prej këtyre personave: kryetar Andrea Sahatçi, sekretar Andrea Nathanaili, dhe 5 anëtarë që ishin, Faik Dishnica, Xhavit Gjata, Vasil Avrami, Halim Budo dhe Spiro Stringa (1945, p. 15). Zgjedhjet u bënë në rrethe dhe në qarqe zgjedhore.Këto u përkisnin prefekturave sipas ndarjes administrative. Si rregull i përgjithshëm për çdo nënprefekturë zgjidhej një deputet (Dervishaj, 2006). Komisionet e zgjedhjeve ishin në tre nivele: KQZ, KZQ ( për qarkun), KZRR (për rrethin).

KQZ-ja përgatiste teknikisht zgjedhjet, emëronte komisionet e zgjedhjeve të qarqeve, caktonte numrin e përgjithshëm të përfaqësuesve, vërtetonte listat, shpallte përfundimet etj. Fronti kishte muaj që po përgatitej për zgjedhjet duke marrë masa që ato të zhvilloheshin të lira dhe demokratike, kjo sepse qeveria amerikane dhe britanike ia kishte vënë si kusht për njohjen e qeverisë. Gjithashtu këto zgjedhje do të kryheshin edhe në prani të delegacioneve vëzhguese amerikane dhe angleze.

Në zgjedhje do të votohej për një listë të vetme kandidatësh të emëruar nga Fronti Demokratik. Në realitet ligji lejonte konkurencën e grupimeve politike rivale dhe daljen e kandidatëve të pavarur, por koha në dispozicion për formimin e tyre nga 15 shtatori- 30 nëntor ishte e pamjaftueshme për krijimin e partive të tjera. Kjo qe e pamundur jo vetëm nga koha e pamjaftueshme, por edhe nga represioni në rritje i regjimit dhe masave policore ndaj kujtdo që kërkonte të krijonte parti konkuruese. Në kushtet e presionit politik dhe të shanseve të pabarabarta elektorale antikomunistët dhe grupet e tjera liberale vendosën të konkurojnë në zgjedhje në kuadër të Frontit Demokratik. Kjo ishte e vetmja rrugë reale për të arritur përfaqësimin në Asamblenë Kushtetuese. Për të garantuar fshehtësinë e votës dhe si pasojë e analfabetizmit të lartë në vend votimi u krye jo me fletë votimi por me gogla. Votuesi duhet të fuste duart detyrimisht në të dyja kutitë, që të mos merrej vesh se ku e kishte hedhur votën, në të cilat njëra ishte e Frontit dhe që kishte ngjyrë të kuqe dhe tjetra për rastet kur kishte kandidatura të veçanta, jashtë atyre të Frontit, që populli e quante "kutia e zezë" (Afrim, K. 2006, p. 154). Situata e përgjithshme në të cilën u zhvilluan zgjedhjet u konsiderua si një ditë feste, me një entuziazëm të madh ku këndohej dhe kërcehej pranë qendrave të votimit. Ditën e zgjedhjeve në

kryeartikullin e gazetës " Bashkimi" shkruhej: "*2 Dhjetor. Dita e sanksionimit të fitoreve. Dita e shprehjes së vullnetit të popullit. Dita që sintetizon idealin e atyre që ranë për clirimin e atdheut*". (1945, *Bashkimi* (287), 1).

Sipas lajmeve që vinin nga qendrat e votimeve të fshatrave të Tiranës, populli mori pjesë 100% në votime. Edhe në qarqet e tjera si në Durrës, dita e votimit u bë një ditë e madhe gëzimi për popullin. Po ashtu edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë përqindja e votuesve ishte tepër e lartë. Shtypi u bëri thirrje atyre personave që nuk kishin votuar dhe i ftoi të merrnin pjesë në votime pasi vetëm në këtë mënyrë do ta ndienin veten me të vërtetë shqiptarë.

Pavarësisht mbarëvajtjes së zgjedhjeve në përgjithësi, duhet të themi se ato nuk u zhvilluan pa probleme. Në disa raste si në Kavajë dhe Kukës u vunë re manipulime të goglave, ndërsa disa kandidatë të tjerë ishin shpallur fitues në kushte jo të natyrshme. Abuzime pati dhe në Petrelë, ku i dërguari i Frontit së bashku me Shaqir Baxhakun, duke përfituar nga errësira, morën kokrrat që ishin futur në kutinë pa kandidat dhe i hodhën në kutinë e Frontit (AQSH, 1945, d. 5., p. 145).

Ka patur mjaft gabime teknike në përpilimin e listave dhe shumë veta janë lënë pa u regjistruar, (AQSH , 1945, p. 98) janë shkruar me të drejtë votimi të vdekur, janë vënë çamët në listë që s'kanë patur të drejtë votimi, të internuarit nuk ishin në listë etj. Ndarja e qendrave elektorale u bë 500 deri 1000 votues dhe në asnjë vend nuk pati më pak se 500 dhe kjo uli ndjeshëm numrin e pjesëmarrësve në votime në Skrapar, ku fshatarëve u është dashur të udhëtonin 3 orë larg për të arritur në qendrën e votimit. Mënyra teknike e votimit nuk u punua dhe aq mirë dhe për këtë arsye pati raste që partizanët të hidhnin kokrrën e tyre në kutinë pa kandidat (AQSH ,1945, p. 122).

Nga raportet ndryshme që i vinin PKSH-së vërehet se kandidatët e saj nuk kishin miratime të përgjithshme në popull për shkak të sulmeve që i bënin kandidaturave të shpallura. Tregtarët e mëdhenj dhe sidomos ata që u tatuan nga ligjet e qeverisë, ose qëndruan indiferentë ose votuan kundër Frontit. Disa të tjera votuan për Frontin vetëm nga frika dhe votuan në atë mënyrë që kur hidhnin goglën të shikohej se për kë kishin votuar,kurse shtresa e mesme e tregtarëve votoi pothuajse plotësisht për të (AQSH , 1945, p. 91).

Pjesëmarrja në zgjedhje e popullsisë së Shqipërisë së Veriut ishte shumë e ulët për shkak se ajo vazhdonte të ishte në gjendje lufte (me përjashtim të Shkodrës) dhe nuk mund të bëhej fjalë për zgjedhje të lira demokratike. Bandat e Muharrem Bajraktarit, Xhem Gostivarit e të tjera, kalonin nëpër male nga Shqipëria në Jugosllavi dhe kryenin akte terroriste kundër përfaqësuesve të pushtetit. Popullsia ishte e terrorizuar dhe në të shumtën e rasteve nuk pranonte të ndihmonte organet e pushtetit nga frika se këto banda mund të hakmerreshin ndaj tyre (Nina, S. 2004, p. 308). Zona elektorale e Matit refuzoi zhvillimin e zgjedhjeve dhe për këtë morën dënime të ashpra. I gjithë komisioni zgjedhor i zonës së Matit u dënua me burgim të rëndë ose pushkatim (Afrim,K. 2009, p. 193).

Probleme me zgjedhjet pati edhe në zonat ku jetonte minoriteti grek. Në Himarë u gjetën trakte në greqisht, por të përkthyera në shqip, të lëshuara nga Këshilli Vorioepirot, të cilat bënin thirrje për abstenim. Këto trakte ulën ndjeshëm përqindjen e pjesëmarrësve në votime në këto zona (AQSH ,1945, p. 13). Kleri katolik gjithashtu vazhdonte propagandën kundër Frontit. Përfaqësuesit e klerit shkuan të

votojnë, por e hodhën voten e tyre në kutinë pa kandidat. Zgjedhjet për Asmablenë Kushtetuese përbënin kështu një provë të re të metodave të paligjshme që ekzistonin në Shqipëri. Të tjera prova në zotërim të qeverive aleate, falë dokumentacionit të gjerë që u trasmetohej atyre nga misionet ushtarake që vepronin në Shqipëri, kishin të bënin me krimet e kryera nga regjimi i Tiranës kundër italianëve, kundër pakicës greke dhe kundër vetë qytetarëve shqiptarë që u pëkisnin lëvizjeve politike të kundërta me komunizmin. Në të vërtetë, zgjedhjet ishin nje farsë e drejtuar nga qeveria. Vëzhguesi britanik, gjeneral Hoxhson, kritikoi ashpër zgjedhjet, duke u shprehur se "zgjedhjet në Shqipëri bëhen në kinema "Kosova" me forcën e bajonetave partizane"(Afrim, K. 2006, p.156).

Vetë Hoxha në kujtimet e tij, provon falsitetin dhe formalitetin e votimeve. Ai shkruan në ato zgjedhje nuk kishim fletë votimi si sot dhe as atë të ndarën, ku zgjedhësi mund të prishë apo të shtojë në fletën e kandidatit atë që do ose atë që s'do. Çdo zgjedhësi i jepej një kokërr, një top i vogël gome, ku qe e stamposur shqiponja, si simbol i flamurit tonë dhe këtë ai duhet ta hidhte në kutinë që dëshironte. Në sallën ku votohej kishte dy kuti : njëra e Frontit me ngjyrë të kuqe dhe tjetra për rastet kur kishte kandidatura të veçanta, jashte atyre të Frontit dhe që populli e quante kutia e zezë. Votuesi duhej ta fuste dorën në të dyja kutitë që të mos merrej vesh se ku e kishte hedhur votën. Diktatori me krenari të madhe shton se shumë votues "nga entuziazmi dhe emocioni, e dekonspironin të fshehtën e votës së tyre, sepse pasi futnin dorën në kutinë e kuqe thërrisnin *Rroftë partia*! *Rroftë Fronti*! *Votoj për Republikën Popullore*!"( Hoxha, 1984, p. 520).

Nga telegramet që erdhën nga gjithë qendrat e Shqipërisë dhe nga informatat e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve shohim fitoren e plotë të Frontit. Në rezultatet e para votuan rreth 85% deri në 90% e popullsisë në të gjithë Shqipërinë. Për Frontin votuan më tepër se 90%. Duhet shënuar mirë se përqindja e votimit ishte më e lartë në zonat e populluara nga fshatarësia.

Cilat janë shifrat zyrtare për pjesëmarrjen në votime?Ashtu siç pritej, në kushtet e mungesës së plotë të infrastukturës zgjedhore dhe të fushatës elektorale konkuruese, sipas shifrave zyrtare, në votime morën pjesë rreth 90.2 % e zgjedhësve nga të cilët 93.18 % votuan për Frontin (1945, *Bashkimi,* (294), 1). Nisur nga këto të dhëna mund të shtrojmë pyetjen tjetër. Sa reale dhe të besueshme janë shifrat zyrtare të kohës? Të dhënat e deritanishme nga shtypi i kohës bëjnë fjalë për incidente dhe parregullsi teknike gjatë procesit zgjedhor. Këto të dhëna nuk japin prova për cënueshmëri, e duke u bazuar tek ato, mund të vihen në dyshim përmasat e fitores së Frontit, por jo vetë fitorja.

Sipas rezultatave zyrtare të shpallura nga KQZ-ja, nga 603.566 zgjedhës me të drejtë vote 506.319 votuan për listën e kandidatëve të Frontit Demokratik dhe 36.758 kundër. Parë në raport me ngjarjet e mëpasme dhe me sistemin që krijuan komunistët, 36 mijë vota kundër në një votim pa rivalë, ka një domethënie të madhe. Midis dy kandidatëve, qytetarët zgjedhin njërin, por votimi i dhjetorit 1945 kundër kandidatit të vetëm zyrtar tregon se shumë qytetarë shprehën qëndrimin e tyre të hapur ndaj farsës elektorale. Duke hyrë më në detaje, dokumentet arkivore provojnë se diktatori Hoxha në atë kohë kryeministër, ministër i dyfishtë, komandant i ushtrisë dhe drejtues i Partisë Komuniste, mori më shumë vota kundër se të gjithë kandidatët e tjerë. Kundër tij votuan 2151 nga 17.564 votues ose rreth

12%-13 % e elektoratit të zonës së tij në Tiranë. (Afrim, K 2006, p.156)

Pavarësisht këtyre fakteve duhet të themi se fitorja e Frontit pati rëndësi të shumëfishtë, pasi ajo qe një dëshmi e mbështetjes mbarë popullore; ajo i përvetësoi meritat e luftës, ndonëse në këtë fitore kishin luajlur rol dhe forcat e tjera. Kjo i krijoi Partisë Komuniste hapësirë për reforma të thella institucionale. Për rreth 6 muaj u arrit që në Shqipëri të shembej struktura e mëparshme shtetërore dhe të realizohej një reformë e madhe në administratën qëndrore dhe lokale.

E entuziazmuar nga fitorja e zgjedhjeve, Partia Komuniste filloi të zotohej se do mbronte interesat e popullit. Në opinionin publik, u zhvilluan debate të shumta rreth formës së regjimit. Monarkia goditej dhe sulmohej si një mënyrë qeverisjeje antidemokratike dhe antikombëtare, ndaj krahas kritikave për monarkinë, nxiteshin ndjenjat republikane të qeverisjes. Kjo konsiderohej si forma më demokratike dhe më e përshtatshme për qeverisjen e vendit. Këto debate i dhanë një tjetër mbështetje Partisë Komuniste për t'u prezantuar në publik si një forcë progresive dhe që e mbante premtimin.

**Përfundim**e

- Zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945, për kohën në të cilat u zhvilluan treguan se përshkruheshin nga një frymë e lehtë demokratike duke qenë se ato ishin zgjedhjet e para në të cilat votuan të gjithë njerëzit.
- Shtypi i huaj i kohës i cilësoi ato si zgjedhje që u zhvilluan në mënyrë të ndershme dhe me shumë rregull. Sipas tyre zgjedhjet në Shqipëri shërbyen si kontribut për demokracinë dhe paqen në Ballkan dhe ligjin elektoral si një nga ligjet më demokratike të kohës.
- Pas zgjedhjeve, gjithë institucionet e shtetit e të organizatave të masave dhe veprimtaria e tyre drejtoheshin e kontrolloheshin plotësisht nga PKSH-ja dhe Enver Hoxha, i cili mbante postet e kreut të partisë të qeverisë të Frontit dhe Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë.
- Me fitoren e Frontit Demokratik forcat komuniste morën kontrollin politik në vend. Nuk u realizua asnjë nga pikat e programit të Frontit që bënin fjalë për forcimin e pushtetit popullor, të drejta demokratike, nxitje të pjesëmarrjes së masave në punët e pushtetit, kontroll të organeve të pushtetit, pasi në fakt ndodhi krejt e kundërta nga çfarë ishte premtuar; kjo sepse komunistët e konsideruan pushtetin e tyre si të përjetshëm dhe të paprekshëm.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Akademia e Shkencave e Shqiperise (2009). *Historia e Popullit shqiptar IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj*. Tiranë: Toena.

Akademia e Shkencave e RPS të Shqiperise (1983). *Historia e Shqipërisë IV* (Vol. IV). Tiranë.

Afrim, K. (2006). *Partitë politike në Shqipëri (1920- 2006).* Tiranë: Edlor.

Afrim, K. (2006). *Partite politike në Shqipëri (1920-2006).* Tiranë: Botim I Institutit Shqiptar të Studimeve politike.

Afrim, K. (2009). *Sistemet politike në Shqipëri (1912- 2008).* Tiranë: UFO Press.

AQSH / AP fondi 14, d. 5. (1945). .

AQSH / AP, p. 1. (1945).

AQSH / AP, p. 1. (1945). Letër dërguar Komitetit qëndror të PKSh.

AQSH. (1945). *Fondi 18, Dosja 83.*
AQSH/AP fondi 14, d. 1. (1945).
AQSH/AP fondi 14, d. 5. (1945).
AQSH/AP. (17 tetor 1945). *Referati politik i mbajtur nga E.Hoxha në Pleniumin e 4 të KQ të PKSh, Fondi 14, Dosja 2.*
Anastas, A. (2004). *E drejta Kushtetuese.* Tiranë: PEGI.
Demir, D. (1999). "Organizata Opozitare ilegale Antikomuniste Bashkimi Shqiptar Shkurt 1945-1946". *Studime historike* (3-4), p. 98.
Demir, D. (2011). *Lufta politike në udhëheqjen e PKSH (PPSH) 1944- 1960).* Tiranë: Toena.
Enver, H. (1984). *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re.* Tiranë: Sht. Botuese 8 Nëntori.
Gjeçovi, Xh. (2004). *Pushtimi gjerman në Shqipëri. Shtator 1943- 29 Nëntor 1944.* Tiranë: Akademia e Shkencave.
Hamit, K. (2007). *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë.* Tiranë: Botimpex.
Ilir, B. (2009). *Bazat e të drejtës së zgjedhjeve. Zgjedhjet dhe e drejta e zgjedhjeve në Shqipëri.* Tiranë: GEER.
Dervishaj, K. (2006). *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005.* Shtëpia botuese 55.Tiranë.
Nina, S. (2004). *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX.* Tiranë: Ideart.
Valentina, D. (2007). *Historia e Shqipërisë, 1912-2000.* Tiranë: SHBLU.

**Artikuj të gazetave**

(1945). *Gazeta Zyrtare* (54), 15.
“ 2 Dhjetori dita e sanksionimit të fitoreve. Dita e shprehjes së vullnetit te popullit”. (1945). *Bashkimi* (287), 1.
“ Grupimet e zgjedhjeve të 2 Dhjetorit ‘45”. (2005). *Tirana Observer* (128), 14.
“ Mbi Asamblenë Kushtetuese” Ligji nr. 123. (1945). *Gazeta zyrtare* (Nr 54.), 1.
“ Përfundimet e zgjedhjeve të 2 Dhjetorit”. (1945). *Bashkim* (294), 1.
“Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit për Asamblenë Kushtetuese” Ligji nr.124. (1945). *Gazeta zyrtare* ( 54), 2.
” U çpall Programi i Frontit Demokratik të Shqipërisë”. (1945). *Gazeta Bashkimi* (272), 1.

# EDUKIM DHE MËSIMDHËNIE

# TAKIMI INTERKULTUROR: PRESPEKTIVA TEORIKE DHE PRAKTIKA SHOQËRORE

**ARJAN KAMBURI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Edukimit**

**Përmbledhje**

Komunikimi dhe marrëdhëniet ndërkulturore përbëjnë një fushë kërkimi në të cilën konvergojnë studime të ndryshme të shkencave shoqërore. Vitet e fundit, janë rritur studimet me fokus identifikimin e aspekteve që ndikojnë negativisht në ndërtimin e marrëdhënieve ndërpersonale midis individëve të kulturave të ndryshme. Objektivi i këtij punimi është analiza cilësore e karakteristikave të kontaktit ndërtuar midis lehtësuesve kulturorë dhe anëtarëve të komunitetit vendas. Nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuara u mblodhën të dhëna mbi perceptimet e lehtësuesvë kulturorë në lidhje me dinamikat që karakterizonin kontaktet e ndërtuara. Nga analizimi i intervistave drejtuar lehtësuesve u arrit në përfundimin se kontakti që ndërtuan këta të fundit me pjesëtarët e komunitetit vendas, karakterizohej nga faktorë të ngjashëm me kushtet që parashtrohen në teorinë e Allportit (1954) për uljen e paragjykimeve.

**Fjalët çelës**: *paragjykimi, stereotip, lehtësues kulturor, takimi interkulturor, ndërmjetës.*

**Abstract**

Communication and intercultural relations constitute research ground for various studies related to shoqëror sciences. Recently, a lot of studies are focused on identifying the aspects that impact negatively to building interpersonal relations between individuals of different cultures. The aim of this paper is to analyse the contact and its characteristics, built by cultural facilitators with members of local community. This qualitative analysis is achieved through semi-structured interviews which provide information of Facilitator's perception about the dynamics that characterize the contacts created. Analizing the interviews towards the facilitators, it is reached in the conclusion that the contact created between facilitators and the members of the local community, are characterized by similar factors that we find highlighted by the theory of Allport (1954) regarding the reduction of prejudice.

**Keywords**: *prejudice, stereotypes, cultural facilitator, intercultural encounter, mediator.*

Elementet përbërëse të shoqërisë së sotme, për më tepër të asaj perëndimore, janë duke u shndërruar në multikulturorë apo multietnikë. Kontakti midis personave të kulturave të ndryshme nuk është një fenomen i ri; risi do të ishte shtrirja dhe rëndësia që po merr ky fenomen në ditët e sotme.

Koncepti i kontaktit ndërpersonal përmban në vetvete konceptin e komunikimit me gjithë problematikat që ky i fundit paraqet, të cilat studiohen nga shkencat shoqërore. Me qëllim realizimin e një komunikimi ndërkulturor efikas, është e rëndësishme që politikat shoqërore dhe individët të angazhohen në dy drejtime: së pari të mundohen të kundërshtojnë

efektet negative të paragjykimeve dhe stereotipeve dhe së dyti, të lehtësojnë dhe të fitojnë aftësi komunikuese specifike.

Ky studim bazohet në projektin e realizuar nga Bashkia e Padovës në Itali, zhvilluar gjatë dyvjeçarit 2007-2008, i cili parashikonte angazhimin e figurës së "lehtësuesit kulturor" në terren për të lehtësuar kontaktin ndërmjet shtetasve, si dhe të këtyre të fundit me administratën bashkiake dhe forcat e rendit.

Në këtë studim u hetua efekti që puna e "Lehtësuesve Kulturorë" pati mbi shtetasit vendas me fokus të veçantë kontaktin që lehtësuesit kulturorë ndërtonin, duke u thelluar në dinamikat që karakterizonin marrëdhënien interetnike që ndërtoheshin gjatë këtij shërbimi.

Korniza teorike ku u bazua ky hetim është ajo e Allportit (1954), e cila konsideron kontaktin me pjesëtarët e "outgrup" si një faktor që ndihmon në uljen e paragjykimeve nëse prezantohet në kushte të caktuara si: kohëzgjatja, frekuenca dhe thellësia e kontaktit; statusi i barabartë midis personave që ndërtojnë këtë kontakt. Kontakti duhet të jetë i inkurajuar dhe i mbështetur nga institucionet; duhet të jetë i karakterizuar nga ndërveprimi kooperativ dhe pozitiv; duhet të konsiderohet si kontakt i tipit miqësor dhe jo formal; të njihet kultura dhe zakonet e tjetrit. Duke u bazuar në teorinë e Allport-it, hipoteza që u parashtrua për këtë punim ishte të verifikohej se cilësia dhe kushtet në të cilat ndërtohej kontakti midis lehtësuesve dhe nënshtetasve vendas ngjasonin me kushtet që paraqet Allport-i në teorinë e vet, për të patur një efekt të dobishëm në uljen e paragjykimeve.

Objektivi i këtij hulumtimi është analizimi i modalitetit, efektit dhe rëndësisë së kontaktit që ndërtohet midis lehtësuesve kulturore, si pjesëtarë të komuniteteve të huaja, dhe nënshtetasve italianë si pjesëtarë të komunitetit vendas, duke sjellë dhe analizuar këndvështrimet e lehtësuesve.

**Analiza teorike. Paragjykimet dhe Stereotipet**

Paragjykimet janë të rëndësishme për të na mbrojtur "ne" dhe për të mbajtur në distancë "ata" kundrejt të cilëve "ne" përkufizohemi. Allporti interpreton paragjykimet si një formë të thjeshtuar konjitive e përshtatur në nivel shoqëror për të mundësuar lëvizjen e lirshme të individëve në mjedisin që i rrethon. Paragjykimi na lejon të mbajmë të paprekur sistemin tonë të besimeve, gjë që sjell një përzgjedhje të informacioneve që marrim për personat e tjerë në sintoni me çfarë ne dimë mbi kategorinë së cilës ata i përkasin. Sa më e fortë të jetë përfshirja emotive, aq më e fortë është prirja për të filtruar (sipas kategorive interpretative të secilit) informacionet që marrim për të tjerët dhe për të ndërtuar situata diskriminuese, të cilat evidentohen akoma më tepër në situata konfliktuale apo kompetitive (Allport, 1954).

Sigmund Freud-i i konsideronte paragjykimet që ndërtoheshin për grupin e jashtëm si element që ndihmonte në bashkimin dhe forcimin e lidhjeve mes anëtarëve të një grupi. Sipas tij "*është gjithmonë e mundur të bashkosh një numër të konsiderueshëm njerëzish që të duan njeri-tjetrin derisa mbeten të tjerë njerëz mbi të cilët mund të manifestojmë agresivitetin*" (Freud, 1929, pp. 601-602).

Sipas Dollard-it paragjykimi lidhet me ndjenjën e frustrimit, prandaj agresiviteti i shkaktuar nga frustrimi nuk mund të shkarkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nëpërmjet privimit apo pengimit të tij, por drejtohet në formën e paragjykimeve drejt një objektivi zëvendësues që rezulton i disponueshëm (Dollard et al., 1967). Ndërkohë, Adorno reflekton mbi konceptin e "personalitetit

autoritar" për të justifikuar mënyrën sipas së cilës personat autoritarë trasformojnë aftësitë e tyre për të zgjidhur problemet e brendshme në paragjykime negative dhe armiqësore drejt më të dobtëve, të huajve dhe atyre që shfaqen ndryshe (Adorno, 1950).

Mund të dallohen dy mënyra ku gjen përdorim termi paragjykim; e para, i referohet gjykimit të përgjithshëm në mungesë të informacionit të nevojshëm, mund të ketë si karakter pozitiv ashtu dhe karakter negativ dhe mund t'u referohet fakteve, ngjarjeve, objekteve dhe personave; e dyta, karakterizohet nga prirja specifike për të konsideruar në mënyrë jo të favorshme dhe të pajustifikuar individët që i përkasin një grupi shoqëror të caktuar në bazë të atribuimeve me ngjyrim negativ që i bëhet grupit (Amerio, 2004).

Po, cila është sjellja e individëve, anëtarë të një grupi, viktima të paragjykimeve dhe të diskriminimit të projektuar mbi ta nga anëtarët e një grupi tjetër? Në ç'mënyrë arrijnë të mbrojnë identitetin e tyre shoqëror dhe kulturor? Allport-i arriti të dallojë dy lloje sjelljesh: e para, përmban mekanizma agresivë, drejtuar subjekteve apo objekteve të jashtme, me prirje për të eliminuar shkakun e problemit; e dyta, përfshin reagime më introverse, duke pranuar në një lloj vetëvlerësimi përgjegjësitë me qëllim përshtatjen me situatën dhe kontekstin në të cilin prezantohet. Duke iu referuar këtyre sjelljeve, Allport-i i sintetizon me një skemë përmbledhëse, ku një individ, viktimë e paragjykimit, mund të prezantojë tipare, veçori të ndryshme, të cilat luhaten ndërmjet qëndrimeve ekstra-ndëshkuese dhe intra-ndëshkuese (terma të përshtatur nga Rosenzweig, 1978). Në rastin e individëve ekstra-ndëshkues, Allport-i evidenton një seri qëndrimesh të shoqëruara me ndjenja sensibilizimi dhe ankthi; qëndrim shtypës me nota obsesive dhe dyshuese; aftësi dhe hipokrizi; përforcim të lidhjeve brenda grupit të anëtarësuar; paragjykues kundrejt grupeve të tjera; agresion dhe revoltim; vjedhje; konkurencë; rritje të forcës. Në rastin e individëve intra-ndëshkues Allport-i dallon qëndrimet: mohim i të qenit anëtar, refuzim dhe pasivitet, parodi, urrejtje për veten, agresion kundër grupit të vet, simpati për viktimat, neurozë (Allport, 1954, p. 225).

Në hartën e koncepteve të komunikimit interkulturor të prezantuar nga Giaccardi, koncepti i paragjykimit radhitet i parafundit në renditjen e hapave që çojnë drejt racizmit dhe hakmarrjes etnike (Giaccardi, 2005, p. 194). Kategorizimi dhe identifikimi i tipit janë në shkallën e parë në hartën e Giaccardi-t, dhe ndiqen nga parakonceptet dhe etnocentrizmi, të cilat çojnë drejt formimit të stereotipeve që krijojnë terrenin e përshtatshëm për lindjen e paragjykimeve që favorizojnë krijimin e stigmave, racizmit, përvetësimin e ndjenjës së inferioritetit (Po aty).

Kategorizimi është procesi nëpërmjet të cilit klasifikojmë objektet, kafshët apo personat, duke u bazuar në njohjen e tipareve të përbashkëta midis entiteteve të një kategorie apo të një grupi apo të veçanta të entiteteve që përjashtohen nga grupi apo kategoria. Klasifikimi i disa stimujve të një kategorie na lejon të kryejmë "ekonomi mendore", dhe momentin që përcaktojmë cilës kategori i përket një element, këtij të fundit, nëpërmjet një arsyetimi deduktiv, i ngjitim edhe cilësi të tjera duke iu referuar klasës që i përket. Procesi i kategorizimit përshkruhet në fushën e sociologjisë si "tipizim" (Schutz, 1953; it. 1979), ku "tipi" është përfaqësimi mendor që thjeshton kompleksitetin dhe na ndihmon për t'u përballur me një realitet më të lehtë për t'u njohur dhe për të komunikuar.

Kategoritë kanë prirje t'i nënshtrohen një procesi objektivizimi duke trasmetuar idenë se faktet ekzistojnë në mënyrë të pavarur duke eliminuar kështu origjinën shoqërore dhe instrumentale të tyre (Berger & Luckman, 1996). Schutz-i shkruan se "nuk ka fakte të pastra dhe të thjeshta, (por) ka fakte të interpretuara" (Schutz, 1953; it. 1979, p.5). Kjo do të thotë se në jetën e përditshme apo në shkencë, ne nuk jemi në gjendje të prekim realitetin që na rrethon.

Në hartën e koncepteve të Giaccardi-t, koncepti i etnocentrizmit është marrë nga Sumner-i (1906) për të treguar prirjen që kanë anëtarët e një grupi etnik të vlerësojnë grupet e tjera, duke përdorur si kriter referimi kulturën e vet, pra duke mbajtur, në mënyrë implicite, një qëndrim superioriteti drejt grupeve të tjera. Sumner vëzhgoi se si grupe të ndryshme etnike shfaqin prirje të përkufizojnë veten e tyre si " të mirë", "të guximshëm", "ekselentë" apo edhe thjesht "qënie njerëzore" (Sumner,1906). Sipas Teguieff-it, etnocentrizmi është një "fenomen antropologjik universal" (Teguieff, 1997; it. 1999, p. 9), bashkëmbështetur nga faktorë konjitivë, afektivë, vlerësues dhe normative, që presupozon ndarjen "ne" nga "ata" dhe tenton të ekzagjerojë pozitivisht tiparet dalluese të brendshme të grupit. "Ne" i korrespondon në parim qenies njerë-zore dhe civilizimit, "ata" i korrespondon barbarëve dhe botës së egër (Remotti, 1990, cit. në Giaccardi, 2005, p. 236). Sensi i favorizimit për anëtarët e grupit është i paevitueshëm, për faktin se brenda grupit të cilit i përkasim "ne" ndjehemi më të sigurt, më të mbrojtur, pra nuk është thjesht një shkëmbim njohurish dhe vlerash, por edhe një ndjenjë besimi dhe mirëkuptimi (Remotti, 1990, p.218). Etnocentrizmi është dhe një "përgjigje emotive ne lidhje me kulturën dhe nuk lejon mirëkuptimin e identitetit të tjetrit, por mund të provokojë përbuzje intelektuale ose dhunë fizike" (Marazzi, 1998, p. 169).

Stereotipi është një koncept tjetër në hartën e Giaccardi-t i lidhur me perceptimin dhe bazohet në dinamikat që shoqërojnë procesin e kategorizimit. Lippman identifikoi lidhjen midis perceptimit, kategorizimit dhe prodhimit të stereotipeve, si kategori të qëndrueshme dhe rezistente ndaj ndryshimeve (Lippman, 1922). Stereotipet nuk janë sisteme përfaqësimi "neutrale"; ato normalisht përcjellin në mënyrë implicite sisteme vlerash, hierarki kriteresh, preferenca dhe gjykime (Arcuri & Cadinu, 1998, p. 64). Stereotipi krijohet kur kategoria fillestare pasurohet me gjykime, përgjithësisht negative (Allport, 1954). Efekti i shtrembërimit që gjenerohet është më i madh në lidhje me "outgroup", pra me grupin "tjetër", ndërkohë që saktësisë është më e madhe për ingroup, pra grupi të cilit i përkasim, sa më shumë që identifikohemi me të (Arcuri & Cadinu, 1998, p. 53). Për këtë motiv, anëtarët e grupeve të tjera na duken "të gjithë njësoj", duke eliminuar kështu specifikimin e tjetrit, pra duke zbatuar deindividualizimin e tjetrit.

Sipas Chen e Starosta, stereotipet mund të variojnë sipas katër dimensione:

a) sipas drejtimit të stereotipeve, duke iu referuar aspektit pozitiv/i favorshëm dhe negativ/ jo i favorshëm, të deklaratave;

b) sipas intensitetin të stereotipeve që lidhet me forcën e një besimi në lidhje me një grup personash.

c) sipas saktësisë së stereotipeve, si dimension i tretë, duke konsideruar që stereotipet janë besime të ekzagjeruara dhe tepër të përgjithësuara dhe jo gjithmonë false. Stereotipet mund të përmbajnë informacione të vërteta ose mund të jenë vetëm pjesërisht të pasakta,

sipas përmbajtjes së stereotipeve e cila, mund të variojë nëse rikonsiderohen disa tipare specifike që i atribuohen një grupi personash (Chen & Starosta, 1998, p. 40).

Stereotipet, ashtu si dhe një pjesë e besimeve tona, na shtyjnë te seleksionojmë dhe të evidentojmë ato elemente që i verifikojmë, duke kontribuar kështu në ndërtimin e asaj të dhëne apo atij informacioni që jemi duke kërkuar. Zakonisht aktivizohen strategji të tilla për të neutralizuar atë çfarë kundërshton stereotipin, duke krijuar herë pas here përjashtime, të cilat i pozicionojmë në nënkategori që prekin në mënyrë sipërfaqësore kategorinë parësore në të cilën "jeton" stereotipi. Mundësia për të ndryshuar stereotipin është e lidhur me përjetimin e sa më shumë përvojave jokoherente me stereotipin, apo dhe të një numri të limituar përvojash të cilat përmbajnë elemente që kundërshtojnë stereotipin, "përjashtimet e qarta", të cilat mund të sjellin në një riformulim të kategorive (Giaccardi, 2005, p. 212). Në përgjithësi mundësojnë braktisjen e stereotipit të gjitha ato përvoja individuale, ku ndërveprojmë me subjekte të veçanta në situata konkrete.

Përjashtimi simbolik dhe/apo shoqëror i individëve të kategorizuar (stigmatizuar), paraprihet nga ndërtimi i stereotipeve negative. Stigma përkufizohet si një tipar somatik ose kulturor, i lindur apo i fituar, objekt vlerësimi negativ i përhapur, aq sa të shënojë identitetin dhe vetëvlerësimin e subjektit (Po aty). Diskriminimi është një efekt i stigmës, dhe na drejton të konsiderojmë tjetrin si një "joperson dhe jo si dikë për të cilin duhet të shfaqim konsideratë" (Goffman, 1963, p. 29).

Stadi i fundit që përshkruan Giaccardi është ai i racizmit.

"Racizmi konsiston në shënimin e një grupi njerëzish sipas atributeve natyrore, që lidhen me karakteristikat intelektuale dhe morale, të cilat gjenden në çdo individ që i përket atij grupi dhe për këtë shkak, vihen në veprim praktika inferiorizimi dhe përjashtimi" (Wieviorka, 1998; në it. 2000, p. V).

Racizmi nuk reduktohet vetëm në një tërësi qëndrimesh konjitive apo fjalime teorike ose ideologjike-politike, por shfaqet dhe si një përvojë e jetuar, ku ndërthuren afekte, emocione, mite, interesa që lidhen me situata, praktika shoqërore me vlera funksionale (legjitimimi) (Teguieff, 1997; në it. 1999, p. 69) , të cilat shfaqen në qëndrime praktike-shoqërore dhe sjellje te vëzhgueshme, si mbajtja e distancës nën formën e segregimit (ose margjinalizimit), të diskriminimit (apo trajtimit jo të barabartë) apo të dëbimit të të padëshiruarve, persekutimit deri në asgjësim të përfaqësuesve të një kategorie (gjenocid) (Po aty, p. 67).

**Si të luftojmë paragjykimet.**

Duke patur parasysh se paragjykimi është i paeliminueshëm, si për shkak të faktorëve individualë që lidhen me perceptimet ashtu edhe për motive që lidhen me identitetin shoqëror, kjo nuk do të thotë që nuk mund të reduktohet. Janë formuluar teori të ndryshme që ngrejnë hipoteza për strategji efikase për reduktimin e paragjykimeve. Studiues te ndryshëm kanë evidentuar, si më me interes dhe me rezultate më të mira, strategjitë që lidhen me ndërtimin e kontaktit, qëllimin e mbivendosur, rikategorizimin.

Hipotezën e kontaktit ndërmjet grupeve, e propozoi Gordon Allport-i. Sipas tij, qëndrimet dhe sjellja drejt grupeve të jashtme mund të bëheshim më tolerante kur krijohej kontakti me anëtarët e grupit. Që të verifikoheshin këto efekte pozitive do të ishte e nevojshme të konsideroheshin edhe disa kushte të tjera, të cilat po t'i bashkëngjiteshin kontaktit

midis grupeve, do të sillte reduktimin e paragjykimit, p.sh., statusi i barabartë midis anëtarëve të grupeve duke elimininuar marrëdhëniet shoqërore asimetrike, të cilat prezantojnë një rrezik të lartë për përforcimin e stereotipeve të inferioritetit. Kushte të tjera që duhen konsideruar janë frekuenca, kohëzgjatja, forca dhe rëndësia e marrëdhënieve, në mënyrë të tillë që të ofrojnë elemente të mjaftueshme për të luftuar stereotipet dhe paragjykimet. Njohja e thelluar e një anëtari të grupit tjetër, mund të përcaktojë efektin pozitiv që nevojitet për të rikategorizuar të gjithë grupin (mund të zbulohen karakteristika të përafërta që më parë injoroheshin, mund të falsifikohen disa karaktere të stereotipit nëpërmjet informacioneve të reja që sjellin në një rishkim të imazhit të stereotipizuar). Njohja e historisë, kulturës, zakoneve të grupit tjetër, do të ndihmonte në të kuptuarin e tjetrit, të mënyrës se si ai interpreton ngjarjet, se si ai përkufizon vetveten dhe të tjerët. Bashkëjetesa paqësore e grupeve, ku secili ruan specifikat e veta dhe identitetin e vet, do të ndihmonte në realizimin e projektit të integrimit të diversiteteve.

Një tjetër faktor i rëndësishëm, është mbështetja shoqërore dhe institucionale e cila duhet të favorizojë sjelljen antiparagjykuese dhe të ndëshkojë atë paragjykuese. Kjo mbështetje, që do të ofronin institucionet dhe shoqëria, do të kishte efekt nëse shtrihet në kohë, duke evituar kështu ndjenja disonance dhe duke promovuar zhvillimin e një klime shoqërore, në të cilën mund të lindin norma të frymëzuara nga ndjenja e tolerancës.

Strategji tjetër efikase në reduktimin e paragjykimit është të vepruarit për një qëllim të përbashkët, kur jemi përballë një vështirësie. Kjo strategji është evidentuar gjatë eksperimentit të Sherif-it zhvilluar në parkun Robbers Cave të shtetit të Oklahoma, me dy grupe nxënësish të moshës 11 vjeçare. Nëpërmjet eksperimentit u demostrua se sa lehtësisht një grup individësh mund të përvetësojë një qëndrim përjashtues përkundrejt anëtarëve të grupit tjetër, dhe sa shpejt, ky qëndrim mund të degjenerojë në paragjykim dhe antagonizëm drejt këtyre anëtarëve (Sherif, 1954/1961).

Të gjitha strategjitë e listuara më sipër favorizojnë reduktimin e paragjykimit, si kushte që i bashkëngjiten kontaktit që duhet ndërtuar midis grupeve, duke ndihmuar kështu në dekategorizimin dhe në kundërshtimin e deindividualizimit. Dekategorizimi nuk duhet kuptuar si eliminimi i kategorisë por si mundësi për të "rivizatuar kufijtë fizikë dhe konjitivë që i ndajnë" (Brown, 1995) për të thyer ngurtësimin konjitiv dhe për të filluar proceset konjitve drejt rikategorizimit.

**Ankthi intergrup dhe empatia**

Sipas teorisë së Allport-it, kontakti ndërmjet grupeve, në sensin e ndërveprimit të drejtpërdrejtë midis anëtarëve të grupeve të mirëpërcaktuar, nëse vjen në kushte të përshtatshme, mund të reduktojë paragjykimet (Allport, 1954). Lidhja që ekziston midis krijimit të kontaktit dhe reduktimit të paragjykimit përfshin dhe procese të natyrës emotive-afektive. Pra, kontakti mund të reduktojë paragjykimet falë ndërmjetësimit të emocioneve.

Ankthi intergrup dhe empatia janë evidentuar nga studiues të ndryshëm, si faktorë të rëndësishëm në ndërmjetësimin midis kontaktit dhe paragjykimit.

Sipas Stephan e Stephan, ankthi intergrup mund të përkufizohet si "ankth i gjeneruar kur parashikohet kontakti me anëtarë të grupit të huaj" (Stephan & Stephan, 1985, p. 157). Kjo ndjenjë ankthi është e lidhur me reagimet që individi paraqet për t'u paraprirë pasojave

negative që mund t'i ndodhin. Personat duke parashikuar mundësinë për të ndërvepruar me anëtarët e grupit të huaj, gjenerojnë frikë, e cila lidhet me faktin se ata mund të gjenden në situata të vështira ku nuk do të dinë se si të sillen dhe si rezultat do të ndihen të frustruar. Parashikimi i një situate të tillë gjeneron gjithashtu frikë që lidhet dhe me mundësinë e të qenit i refuzuar, i turpëruar, i keqkuptuar. Pra, ankthi intergrup lidhet me frikën në lidhje me krahasimin e tjetrit, të huajit të ndryshëm me veten. Ky lloj ankthi mund të drejtojë individin në sjellje evituese.

Një mekanizëm tjetër që vihet në lëvizje në këto situata është ndërtimi i pritshmërive, se si do të jetë takimi që pritet të realizohet. Ky mekanizëm kërkon fokusimin e vëmendjes së individit dhe të proceseve konjitive për të gjetur skemat konjitive ekzistente të cilat ndihmojnë në parashikimin e asaj që do të ndodhë, pra individi po kërkon të konfirmojë pritshmëritë e veta pre-ekzistuese. Pra, ankthi intergrup do të gjenerojë "bias"[6] në proceset e përpunimit të informacionit duke udhëhequr individin në kërkimin e stereotipeve dhe paragjykimeve (Po aty).

Ankthi intergrup mund të reduktohet nëpërmjet kontaktit me persona që i përkasin grupeve të huaja. Kontakti duhet të ndodhë në kushte të favorshme dhe ka si objektiv që individi të njohë anëtarë të grupit të huaj, në mënyrë të tillë që të ndihet më i sigurt në parashikimet dhe ndërveprimet e ardhshme.

Një variabël tjetër që ka rol thelbësor në ndërmjetësimin e kontaktit me paragjykimin është dhe empatia. Sipas Batsonet al., empatia mund të përkufizohet si një përgjigje emotive e orientuar drejt tjetrit, që pajtohet me përceptimin e mirëqënies së tjetrit (Batsonet al., 1997). Stephan e Finlay propozojnë ekzistencën e tre tipeve empatie: dy tipe empatie emotive dhe empatia konjitive. E para, quajtur ndryshe dhe empatia reaktive, u referohet përgjigjeve që personat gjenerojnë si reagim ndaj kushteve jo të favorshme të tjetrit (keqardhje, ndjeshmëri, ngrohtësi). E dyta, empatia paralele, e cila u referohet ndjenjave që individi provon bashkë me tjetrin, pra emocionet dhe gjendjet shpirtërore që shfaqen paralelisht me shfaqjen e emocioneve dhe gjendjeve shpirtërore të tjetrit që ndodhet në vështirësi (indinjim, urrejtje kundër padrejtësive, trishtim, pakënaqësi) (Stephan & Finlay, 1999).

Përveç dimensionit emotiv, empatia ka dhe përbërësin konjitiv i cili konsiston në "*të vihesh në pozicionin e tjetrit*", pra të konsiderosh gjërat nga këndvështrimi i tjetrit. Kjo perspektive marrjeje mund të përmbajë dhe aspekte emotive-afektive përveç atyre konjitive. Të nxitësh empatinë në lidhje me një person që i përket grupit të stigmatizuar mund të reduktojë paragjykimet që ekzistojnë në lidhje me grupin. Në bazë të kësaj hipoteze, Finlay dhe Stephan në një studim të tyre treguan se rritja e empatisë drejt një individi afro-amerikan ndikonte në sjelljen e pjesëmarrësve të bardhë në lidhje me individët afro-amerikanë në përgjithësi (Finlay &Stephan, 2000).

Batson et al. propozojnë një model me tre shkallë për të shpjeguar se si ndjenja e empatisë mund të ndihmojë në përmirësimin e qëndrimeve drejt grupit të stigmatizuar: përshtatja e perspektivës së një individi në vështirësi që i përket grupit të stigmatizuar sjell rritjen e ndjenjës së

[6] "bias" - në këtë rast, "bias konjitiv", i referohet një mënyre të menduari e cila paraqet gabime, shtrembërime, deformime, pasaktësi apo mungesë arsyeje, në vlerësimin e informacionit me të cilin individi po përballet, si shkak i paragjykimeve apo para koncepteve që bëjnë pjesë në skemat mendore të individit.

empatisë për individin në fjalë; ndjenja e empatisë rrit rëndësinë e përceptuar të mirëqënies së individit; duke supozuar se qenia e individit anëtar i një grupi është një përbërës i rëndësishëm që ka lidhje me vështirësitë dhe vuajtjet që vetë individi shpreh, atëhere do të ketë një proces përgjithësimi të gjykimeve pozitive për të gjithë grupin (Batson et al., 1997, p. 160).

Sipas autorëve, rritja e ndjenjës së empatisë paraqet disa merita: është e lehtë për t'u nxitur, nuk përfshin situata të "rrezikshme", është e kontrollueshme, mund të ndikojë në mënyrë të fortë paragjykimet, nxit motivime altruiste të pjesë marrësve, nxit braktisjen e pikëpamjeve egoiste dhe mund të sjellë "hapje mendore" më të madhe drejt të tjerëve (Po aty).

Ky studim vjen në vazhdimësi të hetimit që u realizua nga Romania e Zamperini[7] për të vlerësuar efikasitetin e shërbimit të ofruar nga *Lehtësuesit Kulturorë* të angazhuar nga bashkia e Padovës.

Në këtë studim morën pjesë *Lehtësuesit Kulturorë* të angazhuar në projektin "Oltre il ghetto di via Anelli" ("Përtej getos të rrugës Anelli") të mundësuar nga Zyra e Projekteve, Pritjes dhe Emigrimit të Kabinetit Bashkiak të Padovës. Projekti u nis me etiketimin e situatave dhe analizimin e konteksteve që paraqisnin, në territorin e bashkisë së Padovës, problematika shoqërore lidhur me integrimin e emigranteve në gjashtë lagjet e qytetit.

Objektivi i këtij studimi është të analizojë se në ç'masë kontaktet e ndërtuara nga *Lehtësuesit Kulturorë* gjatë shërbimit të tyre, paraqesin kushte të ngjashme me ato të përshkruara në teorinë e Allport-it dhe autorëve të tjerë, si faktorë që ndihmojnë në reduktimin e paragjykimit dhe të stereotipeve.

U hipotizua se kontakti i ndërtuar nga lehtësuesit ndihmoi në njohjen më të thellë të "tjetrit" si anëtar i grupit të huaj. Hipotezë tjetër që udhëhoqi në ndërtimin e objektivave, ishte të verifikohej se dhe si, figura e lehtësuesve kulturorë, me personazhin e dyfishtë që mbartte (si figurë e administratës publike dhe si "përfaqësues" i grupit të huaj përkatës) ndikoi në ndërtimin e marrëdhënieve ndërpersonale me shtetasit vendas.

Duke konsideruar këto hipoteza objektivat specifikë të punimit ishin: analizimi i kontaktit që lehtësuesit kulturorë, si anëtarë të komuniteteve/ grupeve përkatës ndërtuan me shtetasit, sipas perceptimeve të tyre; analizimi i efekteve që shërbimi i ofruar nga lehtësuesit pati, sipas perceptimit të lehtësuesve, tek shtetasit vendas për pranimin e anëtarëve të komuniteteve/ grupeve të huaja; analizimi i rëndësisë që kishte ndërmjetësimi i emocioneve me te cilat lehtësuesit përballeshin, në lidhjen midis kontaktit dhe paragjykimit.

**Projekti *"Lehtësuesit Kulturorë"***u realizua nga bashkia e Padovës gjatë dyvjeçarit 2007-2008, në fushën e ndërmjetësimit shoqëror, pjesë e politikave shoqërore që po ndërmerreshin nga shteti italian, si nevojë emergjente që lindi nga dyndjet e emigrantëve gjatë dy dekadave të fundit në këtë shtet. Shërbimi që ofronin lehtësuesit interkulturore[8] lindi me objektivin për të afruar administratën

[7] Adriano Zamperini, pedagog për lëndën e "Psikologji Sociale dhe marrëdhëniet ndërpersonale" në Fakultetin e Psikologjisë të Universitetit të Padovës. Vicenzo Romania, pedagog për lëndën e "Sociologjisë dhe Komunikimit" në fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Padovës.

[8] Lehtësuesit Interkulturore – në prezantimin e projektit u quajtën "Lehtësues Kulturorë", por më pas u evidentua ambiguiteti që fjala "kulturor" paraqiste, duke ngatërruar me lehtësues apo udhëzuesit turistikë të cilët japin informacione mbi monumentet kulturore dhe vendet me interes për t'u vizituar nga turistët.

bashkiake me shtetasit, për të lehtësuar komunikimin ndërkulturor ndërmjet shtetasve dhe për të mbështetur policinë bashkiake në ndërhyrjet operative. Ky shërbim konsistonte në angazhimin e tetëmbëdhjetë lehtësuesve interkulturorë, përfaqësues të fushave të ndryshme gjuhësore-kulturore prezente në bashkinë e Padovës (Rumune, Arabe, Shqiptare, Kineze, Afrika Frankofone, Afrika Anglofone). Projekti që përfshinte angazhimin e lehtësuesve kulturorë, nisi me etiketimin në terren të situatave urbane që konsideroheshin më shqetësuese për klimën shoqërore, me objektiv përmirësimin e kësaj të fundit duke mbështetur rritjen të marrëdhënieve pozitive interetnike, promovimin e sjelljes në respekt të ligjit, rritjen e besimit ndaj institucioneve të qeverisjes lokale (Romania & Zamperini, 2009, p. 40).

Puna e lehtësuesve do të zhvillohej në rrugë, në kontakt të drejtpërdrejtë me shtetasit , me qëllim që të favorizojë kontaktin midis policisë bashkiake dhe popullatës së komuniteteve të huaja, të promovojë dhe përhapë informacione mbi shërbimet dhe institucionet, të mbledhë raportime mbi proble-matikat në terrenin urban, të lehtësojë integrimin e shtetasve të huaj në komunitet dhe sipas rastit, të ofrojë ndërhyrjen e parë në prezencë të fenomenit të bashkëjetesës së "vështirë" interetnike (Po aty). Një nga aftësitë që duhet të kishin lehtësuesit ishte komunikimi shumë i mirë në gjuhën italiane, që do t'u shërbente gjatë kontakteve që do të kishin me shtetasit italianë. Shërbimi i lehtësuesve kulturorë do të matej në bazë të numrit të raportimeve të mbledhura dhe argumenteve që u referoheshin raportimet, numrit të kontakteve që do të kishin me shtetasit duke konsideruar moshën, gjininë dhe nënshtetësinë e këtyre të fundit. Gjatë zhvillimit të projektit, bashkia e Padovës kërkoi mbështetjen e dy studiuesve të Universitetit të Padovës, Adriano Zamperini-t dhe Vincenzo Romania-s, për të monitoruar dhe vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta dhe efikasitetin e projektit. Disa nga konsideratat që dolën nga analiza përfundimtare mbi figurën e "Lehtësuesit Kulturor" dhe shërbimit që u ofrua gjatë zhvillimit të këtij projekti ishin: mbështetje psikologjike për të moshuarit, rritja e ndjenjës së sigurisë për shtetasit, forcimi i besimit midis shtetasve, favorizimi i integrimit të shtetasve të huaj në jetën shoqërore te vendit.[9]

**Metodologjia dhe pjesëmarrësit**

Në këtë studim morën pjesë gjashtë lehtësues; pesë femra dhe një mashkull, të fushave gjuhësore – kulturore rumune, moldave, filipinase, ruandeze. Subjektet pjesëmarrëse ishin angazhuar në rolin e lehtësuesit kulturor gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit "Oltre il Ghetto di Via Anelli" të sipërpërmendur. Mosha mesatare e pjesëmarrësve është 40 vjeç (gamë moshe 32-47 vjet); koha mesatare e qëndrimit në shtetin italian të subjekteve është 12 vjet.

**Materialet dhe instrumentet**

U përpunuan intervista gjysmë të strukturuara të audioregjistruara për mbledhjen e informacioneve në disa dimensione; përvoja e lehtësuesve kulturorë, detyrat që ishin të parashikuara të përmbusheshin gjatë shërbimit, mënyra sipas së cilës realizohej kontakti me shtetasit italianë, ndryshimet që përceptuan lehtësuesit gjatë zhvillimit të projektit në lidhje me kontaktet që ndërtoheshin me shtetasit, marrëdhëniet që u ndërtuan me shtetasit vendas, si përceptohej figura e lehtësuesit dhe a

[9] Presentazione servizio Facilitatori Culturali 2009-2010, Settore Gabinetto del Sindaco- Unita di Progetto "Accoglienza e Immigrazione", 2010

ndryshoi ky përceptim gjatë zhvillimit të projektit nga shtetasit dhe më në veçanti nga shtetasit vendas.

Intervistat kishin për qëllim të analizonin se si lehtësuesit përceptuan punën e tyre, marrëdhëniet ndërpersonale dhe ndëretnike, si përballuan paragjykimet, cilat strategji dhe aftësi komunikuese nevojiteshin për të hyrë në kontakt, për të ndër-vepruar, për t'u përballur me situatat që krijoheshin në terren.

Intervistat u audioregjistruan dhe u transkriptuan për t'u përpunuar më pas me anë të software «Atlas.Ti» për të ndërtuar analizën cilësore të përmbajtjes së intervistave. Software «Atlas.Ti» është një nga instrumentet që përqafojnë qasjen metodologjike të Grounded Theory, propozuar për herë të parë nga Glaser e Strauss (1967), me qëllim për të ofruar një metodë analizimi sistematik në gjendje për të legjitimuar shkencërisht përpunimin cilësor të të dhënave empirike. Metodologjia e "Grounded Theory" mbështetet në një proces kërkimi me karakter induktiv, ku vëzhgimi dhe përpunimi ecin me të njëjtin ritëm duke ndërvepruar vazhdimisht. Grounded Theory priret të reduktojë të dhënat në kategori të veçanta. Analiza zhvillohet në "njësi analize" të teksit (apo bisedës, intervistës, regjistrimit,…) të studiuar, të cilat mund të jenë të dimensioneve dhe strukturave të ndryshme (fjalë, rresht, paragraf, etj).

Me ndihmën e «Atlas.Ti», në intervistat e marra, duke pasur parasysh objektivat e punimit, u përpunuan 39 *codes*, 7 *Primary Documents*, 102 *Quotations* dhe u izoluan 5 *Code Families (CF)*: "P.C., una fig. –diversi ruoli" ("*Lehtësuesit Kulturorë*, një figurë – role të ndryshme"); "Evitamento e Pregiudizio" ("Evitimi dhe Paragjykimi"); "Conoscere l'altro" ("Të njohësh tjetrin"); "Contatto" ("Kontakti"); "Empatia" ("Empatia").

**Rezultatet**

Në fillim të këtij punimi u hamendësua se kontaktet që ndërtonin lehtësuesit ndihmonin në njohjen e "tjetrit", anëtar i grupit të huaj. Gjithashtu u hodh hipoteza se figura e lehtësuesit kulturor ndikoi në mënyrën se si shtetasit, të cilët patën kontakt me lehtësuesit, ndërtonin marrëdhëniet ndërpersonale mbas kësaj përvoje.

Duke konsideruar këto hipoteza, objektivat që drejtuan punimin ishin analizimi i përceptimeve të lehtësuesve për kontaktet e ndërtuara me shtetasit, dhe më në veçanti me shtetasit vendas. Gjithashtu, nëpërmjet analizimit të intervistave të mbledhura nga lehtësuesit, u hetua rëndësia e ndërmjetësimit të emocioneve në lidhjen midis kontaktit dhe paragjykimeve me të cilat përballeshin lehtësuesit.

Nga intervistat e mbledhura rezultoi se lehtësuesit kulturorë, mbi rolin që u ishte atribuar nga projekti, ishin të fokusuar më shumë në imazhin e lehtësuesit si anëtar i komunitetit (grupit) të huaj, sesa si punonjës të administratës. Pra, lehtësuesit vlerësonin mundësinë për të kontaktuar shtetasit si mundësi për t'u njohur nga shtetasit vendas si të huaj, pra anëtarë të grupit të huaj. Gjithashtu, nga intervistat e mbledhura, lehtësuesit rrëfejnë se jo në pak raste ata kishin ndërtuar raporte miqësore me shtetasit vendas, kjo dhe si rezultat i kontaktit të vazhduar me këta shtetas. Shpeshherë, referojnë lehtësuesit, shtetasit italianë shkëmbenin opinione me lehtësuesit mbi argumente me tema të ndryshme, si: "Emigrantët në Itali", "Politika italiane", "Ekonomia italiane" etj. Kjo ishte një mënyrë për të njohur tjetrin, bashkëbiseduesin, opinionet e tij, si një nevojë që lind në marrëdhëniet ndërpersonale. Në shumë raste, sipas

referimeve të lehtësuesve, ishte ndërtuar një kontakt i thellë midis anëtarëve të grupit të shtetasve vendas dhe lehtësuesve kulturorë si anëtarë të grupit të të huajve. Figura e *Lehtësuesit Kulturor* ishte një figurë e veshur me paragjykime, dhe gjithashtu një figurë pozitive në kornizën e interkulturës, gjatë ndërtimit të marrëdhënieve ndëretnike. I huaji-lehtësues, rezulton nga analizimi i intervistave, por edhe nga vlerësimi i projektit i realizuar nga Romania e Zamperini, me rëndësi thelbësore në ndërtimin e marrëdhënieve ndërkulturore me anëtarët e grupit të shtetasve vendas.

Në analizë përfundimtare mund të themi se kontaktet që ndërtonin *Lehtësuesit Kulturorë* prezantoheshin në kushte të ngjashme me kushtet që përshkrueshin nga Allporti si të domosdoshme për të bërë kontaktin sa më efikas në reduktimin e paragjykimeve midis grupeve. Pra, kontakti i ndërtuar nga lehtësuesit ishte i mbështetur nga institucionet (Bashkia e Padovës); pjesëmarrja e lehtësuesve në aktivitete shoqërore përmbushnin kushtin e ndërveprimeve bashkëpunuese dhe pozitive që përfshijnë anëtarë të komuniteteve; kontakti i ndërtuar nga lehtësuesit ishte i vazhduar në kohë, kontakti i ndërtuar nga lehtësuesit me shtetasit u karakterizua në shumë raste, nga raporte miqësie dhe joformale.

Pra shërbimi i ngritur nga bashkia e Padovës nëpërmjet angazhimit te Lehtësuesve Kulturore ndihmoi edhe në uljen e paragjykimeve dhe ankthit intergrup, pra midis grupit të shtetasve vendas dhe grupeve të të huajve.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Adorno, T. W., Frenkel – Brunswik E., Levinson D.J. & Nevitt Sanford R. (1950). *La personalità autoritaria,* në. it. Edizioni di Comunità, Milano, 1973.

Allport, G. W. (1954), *The Nature of Prejudice, Cambridge, MA, Addison – Wesley, në. It. La natura del pregiudizio*, Firenze, La Nuova Italia, 1973.

Amerio, P. (2004). *Problemi umani in comunità di massa*. Torino, Einaudi.

Arcuri, L. & Cadinu, M. R. (1998). *Gli stereotipi*. Bologna, Il Mulino.

Batson, C. D., Polycarpou, M. P., Harmon-Jones, E., Imhoff, … Highberger, L., (1997). *Empathy and attitudes: can feeling for a member of a stigmatized group improve to toward the group?*. Journal of Personality of Shoqëror Psychology, (72), 105-118.

Berger, P. L., & Luckman, T., (1966). *The shoqëror construction of reality*, New York, Doubleday; në It., *La realtà come costruzione shoqërore*, Bologna, Il Mulino, 1969.

Brown, R. (1995). *Prejudice*: Its Shoqëror Psychology. Oxford: Blackwell. Cambridge C.U.P. .

Chen, G. M. & Starosta, W. J. (1998). *Foundations of Intercultural Communication*, Needham Height, Mass., Allyn & Bacon, USA.

Dollard J., Doob L.W., Miller N.E., Mowrer O.H. & Sears R.R. (1939). *Frustrazione e Aggressività*, në it. Giunti–Barbera, Firenze 1967

Finlay, K.A. & Stephan, W.G. (2000). *Reducing prejudice: the effect of empathy on intergroup attitudes*. Journal of Applied Shoqëror Psychology, 30, p. 1720-1737.

Freud, S. (1929). *Il disagio della civiltà.* Opere, Boringhieri, Torino (1978), Vol. X.

Giaccardi, C. (2005). *La comunicazione interculturale*, Mulino, Bologna.

Goffman, E. (1963). *Stigma: Notes on the Management of Spoiled Identity*, Englewwod Cliffs, Prentica Hall; në it. Stigma. L'identità negate. Bari, Laterza, 1970.

Lippman, W. (1922). *Public opinion*, New York, Harcourt Brace; në it. L'opinione pubblica, Roma, Donzelli, 2004.
Marazzi, A. (1998). *Lo sguardo antropologico*, Roma, Carocci.
Remotti, P. (1990). *Noi, Primitivi*. Torino, Bollati Boringhieri.
Rosenzweig, S. (1978). *Aggressive behavior and the Rosenzweig picture-frustration study*. New York: Praeger.
Schutz, A. (1953). *L'interpretazione dell'azione umana da parte del senso comune e della scienza*, , in Id. Collected Papers, Martinus Nijhoff, The hague, , 1971 në It. parz., Saggi Sociologici, Torino, UTET, 1979.
Sherif, M., Harvey, O. J., White, B. J., Hood, W. R., & Sherif C. W., (1954/1961) *Intergroup Conflict and Cooperation: The Robbers Cave Experiment;* citato in Green, C.D., (1997). Classics in the history of psychology. Marrë nga http://psychclassics.yorku.ca/ , 2011.
Stephan, W. G. & Finlay, K. A. (1999). *The role of empathy in improving intergroup relations*. Journal of Shoqëror Issues, 55, fp. 729-743.
Stephan, W.G. & Stephan, C. (1985). *Intergroup anxiety*. Journal of Shoqëror Issues, 41, fp. 157-175.
Sumner, W. G. (1906). *Folkways*, New York, New American Library; në It. Costumi di gruppo. Milano, Comunità, 1962.
Teguieff, P. A. (1997). *Le racism*, Paris, Flammarion; në It. *Il Razzismo*, Milano, Cortina, 1999.
Wieviorka, M. (1998). *Le racisme : une introduction*. Paris: La Découverte; në it. *Il razzismo*. Roma-Bari, Laterza, 2000.

# IDENTIFIKIMI I VËSHTIRËSIVE TË TË NXËNIT NË ARSIMIN FILLOR DHE NDIKIMI I TYRE NË GJITHËPËRFSHIRJEN E NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA EDUKIMI (NVE) NË KLASA NORMALE.

**DONIKA DARDHA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Edukimit**

**Përmbledhje**

Fokusin kryesor të këtij punimi e përbën identifikimi i vështirësive në të nxënë në arsimin fillor dhe ndikimi i tyre në përfshirjen e nxënësve në klasa normale. Punimi do të përqëndrohet më së shumti në qëndrimin që mbajnë nxënësit, prindërit dhe mësuesit në njohjen e këtyre vështirësive, pranimin e tyre dhe krijimin e shanseve të barabarta në shkollat e zakonshme.

Llojet e ndryshme të vështirësive në të nxënë si dhe shkalla e zhvillimit të tyre ndikojnë dukshëm në përfshirjen dhe integrimin e nxënësve në veprimtari mësimore ndërvepruese.

Studimi i vështirësive në të nxënë ka një rëndësi të veçantë në pikëpamjen njohëse dhe metodologjike me qëllim hartimin e strategjive të mësimdhënies, trajtimin e paaftësive në të mësuar dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në veprimtari mësimore.

Në pikëpamjen shoqërore, studimi do të evidentojë rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut në fushën e edukimit për të përfituar mundësi të barabarta shkollimi për të gjithë.

Procesi i gjithëpërfshirjes së nxënësve me NVE është një realitet jo vetëm i pranuar, por edhe një veprimtari konkrete në shkollat tona. Faktorët kryesorë që ndërveprojnë në institucionin shkollor, brenda dhe jashtë saj; mësuesit, nxënësit, prindërit,me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre do të mundësojnë suksesin e këtij procesi.

***Fjalë çelës***: *vështirësinë të nxënë, gjithpërfshirje, integrim, shanse të barabarta*

**Abstract**

This paper focuses on the students of the primary education of Korça city who have difficulties in learning process, with the aim to identify and evaluate their needs. The challenges of education in Albania require the promotion of children's needs in all inclusive classes, whose expectations satisfy the interests of individuals and society itselp. The difficulties in learning process would be analyzed from the viewpoint of the students' interaction with the surrounding environment, with all in and out school experiences which induce changes in learning process.

Through the information collected from the questionnaires completed by students, teachers, and parents, the research would analyze the difficulty phenomena in learning process as a product created within school and its community.

For many children, there are situations which create barriers in learning process, especially if the grownups, parents, teachers and all other shoqëror factors do not engage for the integration, reduction of limited abilities and their inclusion.

Teachers, as professionals, have special responsibilities to guarantee the total participation of children in society according to their abilities, in order to ease the learning process by preparing shoqëror environment in class and strategies for productive teaching.

**Key words:** *all inclusive education, special needs, integration, difficulties in learning process, teaching strategies.*

Fokusin kryesor të studimit e përbëjnë identifikimi i vështirësive në të nxënë në arsimin fillor dhe ndikimi i tyre në përfshirjen e nxënësve në klasa normale. Punimi do të përqendrohet më së shumti në qëndrimin që mbajnë nxënësit, prindërit dhe mësuesit në njohjen e këtyre vështirësive, pranimin e tyre dhe krijimin e shanseve të barabarta në shkollat e zakonshme.

Llojet e ndryshme të vështirësive në të nxënë si dhe shkalla e zhvillimit të tyre ndikojnë dukshëm në përfshirjen dhe integrimin e nxënësve në veprimtari mësimore ndërvepruese.

Studimi i vështirësive në të nxënë ka një rëndësi të veçantë në pikëpamjen njohëse dhe metodologjike me qëllim hartimin e strategjive të mësimdhënies, trajtimit të paaftësive në të mësuar dhe përfshirjes të të gjithë nxënësve në veprimtari mësimore. Në pikëpamjen shoqërore studimi do të evidentojë rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut në fushën e edukimit për të përfituar mundësi të barabarta shkollimi për të gjithë.

Procesi i gjithëpërfshirjes së nxënësve me NVE është një realitet jo vetëm i pranuar, por edhe një veprimtari konkrete në shkollat tona. Faktorët kryesorë që ndërveprojnë në institucionin shkollor, brenda dhe jashtë saj, mësuesit, nxënësit, prindërit, me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre do të mundësojnë suksesin e këtij procesi.

**Prezantimi i problemit.**

Nga studimi i literaturës mbi vështirësitë në të nxënë, njohja dhe kuptimi i tyre në një shoqëri globale të të drejtave të njeriut, mbi domosdoshmërinë e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta edukimi në klasa të zakonshme, mbi legjislacionin dhe politikën në disa vende të zhvilluara, mbi zbatimin e tyre dhe sfidat e hasura, mbi disa përvoja të kërkuesve në shkollën italiane, amerikane dhe të Hong Kongut, lindin disa pyetje që nxitin një debat filozofik-politik dhe psiko-shoqëror, të cilat orientuan ndërtimin e instrumentit shkencor dhe analizën sasiore dhe cilësore të të dhënave të mbledhura prej tij.

1. A është e drejtë e fëmijëve me NVE të arsimohen në shkolla normale me fëmijët e "tjerë"?
2. Përfshirja e nxënësve me NVE cënon të drejtat e fëmijëve për këto nevoja të veçanta?
3. E drejta e prindërve për të zgjedhur atë lloj arsimi që ju duket më i mirë për fëmijët e tyre, qoftë dhe arsimi special.
4. Cilat janë problemet që mund të hasin ose jo fëmijët me nevoja të veçanta si dhe mësuesit në klasat gjithëpërfshirëse?
5. Cilat janë arsyet që duhet braktisur arsimi special, nëse arritjet akademike dhe shoqërore nuk janë shumë të ndryshme?

Mbrojtësit e konceptit të gjithë përfshirjes mendojnë se nxënësit me NVE mund të përfitojnë nga bashkëveprimi me bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë paaftësi dhe se ata duhet të arsimohen së bashku në shkolla të përgjithshme edhe pse kjo kërkon ndryshim në standardet arsimore, mjete të veçanta ndihmëse, shërbime e trajnime për stafin (Stainback & Stainback, 1992).

Të tjera studime tërheqin vëmendjen se klasat gjithëpërfshirëse nuk janë vendi më i mirë për çdo fëmijë. Në një studim të kryer në gjashtë shkolla për zbatimin gjithëpërfshirës, N. Zigmond dhe kolegët e saj (1995) konstatuan se vetëm gjysma e nxënësve me paaftësi në të nxënë, që ishin vendosur në këto shkolla, arrinin të përfitonin realisht. Ata që përfitojnë më shumë janë nxënësit me paaftësi të lehta.

Gjithëpërfshirja varet nga aftësitë dhe njohuritë e mësuesit, nga ndihma që u jepet fëmijëve për të mësuar dhe përkushtimi ndaj gjithëpërfshirjes si filozofi. (Woolfolk, 2011).

Sipas studimeve të dekadave të fundit theksohet se përfitimet në fushën akademike dhe shoqërore janë të pakta ose të moderuara. Megjithëse janë vënë re efekte pozitive zhvillimore dhe të sjelljes të fëmijëve me NVE, ata gjithsesi janë pak të integruar në shoqëri, më pak të pranuar, kishin më pak aftësi shoqërore dhe nivele më të larta të sjelljeve problematike ( Greshman & Mac Millan, 1997).

**Rëndësia e studimit**

Edukimi është një proces natyral, spontan dhe i orientuar nga individi. Ai realizohet jo duke rreshtuar një listë fjalësh, por nga përvoja e mjedisit. Detyra e mësuesit nuk mbetet vetëm tek të folurit, por tek përgatitja e një sërë aktivitetesh që lidhen me mjedisin. Për fëmijët veprimtaritë individuale janë i vetmi mjet i zhvillimit.

"Unë besoj që shkolla duhet të përfaqësojë tek fëmija jetën aktuale - jetën e gjallë dhe reale që ai bën në shtëpi, në lagje, në sheshin e lodrave (Dewey, 2003).

Procesi i edukimit është i vjetër sa vetë shoqëria njerëzore, është i ri sa vetë format e shfaqjes së saj, është i thjeshtë në përditshmërinë dhe dukshmërinë e tij, por është shumë i ndërlikuar në realizimin e qëllimeve të tij.

" Në shumë raste, parimet e hartura nga psikologët e edukimit, pasi kanë shpenzuar shumë kohë, janë menduar shumë dhe kanë harxhuar shumë para – tingëllojnë tmerësisht të qarta. Njerëzit kanë prirjen të thonë: "Këto i dimë të gjithë". (Woolfolk, 2011, p. 11)

Sipas Gage (1991), mund t'ju ketë qëlluar të mendoni se psikologët e edukimit harxhojnë kohën e tyre duke zbuluar atë që duket. Kur një parim i caktuar shprehet me fjalë të thjeshta, ai tingëllon i thjeshtë. Një dukuri e ngjashme ndodh edhe me një valltar ose atlet të talentuar. Është personi me talentin e tij që e bën vallëzimin të duket i lehtë. Ne shohim vetëm rezultatin e punës së tij dhe jo të gjitha përpjekjet dhe mundimet që i janë dashur balerinit për të zotëruar çdo lëvizje të veçantë. Dhe mbani parasysh se rezultati i një pune shkencore, apo e kundërta e tij mund të tingëllojnë si një gjë e ditur. Çështja nuk qëndron në faktin se rezultatet tingëllojnë të ditura, por në atë që ndodh kur parimet u nënshtrohen testeve shkencore- çka do të jetë tema jonë e rradhës.( Woolfolk, p.12)

**Edukimi i veçantë.**

Çdo qënie njerëzore është një kombinim unik i një sërë faktorëve, biologjikë, shoqërorë, natyrorë dhe të edukimit.

"Ne mund t'i përfytyrojmë të gjitha karakteristikat njerëzore si një kontinuum, për shembull, që nga dëgjimi në shkallën më të lartë e deri tek shurdhëria totale. Të gjithë bien diku në këto kontinuum dhe të gjithë ndryshojmë gjatë ciklit tonë "jetësor" (Woolfolk, 2011).

Debatet rreth zhvillimit janë tepër të ndërlikuara dhe nuk mund të sqarohen duke përjashtuar disa alternativa dhe duke pranuar vetëm disa të tjera (Griffins & Gray, 2005).

" Edukimi i veçantë qëndron në skajet e një numri gjërash. Zakonisht duke studiuar

skajet, mund të shohim qartësisht karakteristikat e atyre që nuk janë skajore. Edukimi i veçantë, fëmija i veçantë, mësuesit e veçantë, kurrikulumi i veçantë janë të gjitha variacione të edukimit "normal", mësuesve "normalë", kurrikulumit të veçantë, studimi i njërës do të kthjellojë tjetrën" (Barton & Sally, 1981, p. 42)

Lehtësitë e edukimit të veçantë janë krijuar si përgjigje e kategorizmit të disa fëmijëve të cilët nuk përshtaten në kategorinë "normale". Kështu fëmijët konsiderohen si të veçantë kur ata tregojnë sjellje të cilat mësuesit nuk i identifikojnë si sjellje normale. Domethënë një fëmijë nuk është i veçantë derisa ai nuk identifikohet si i tillë.

Procesi i përkufizimit ndodh brenda mureve të shkollës, të klasës, dhomës së psikologut, sallës së gjyqit ose përmes bashkëveprimit mes tij dhe bashkëmoshatarëve ose mësuesve. Është shumë ndihmuese të bazohesh në ndonjë përcaktim standard ose më saktë në ndonjë përcaktim se ç'është një fëmijë i veçantë. P.sh. një përcaktim standard i Kirk (1970) i marrë nga Cave dhe Maddison në "*A survey of Recent Research in Special Education* (1978)" mund të jetë ndihmues:

*Fëmija i veçantë është fëmija që devijon nga të qenit fëmija normal ose mesatar:*

*a-Në karakteristikat mendore, aftësitë ndijore,*

*b-Në karakteristikat neuro-muskulare ose fizike,*

*c-Në sjelljen shoqërore ose emocionale,*

*ç- Në mangësitë e shumëfishta në atë nivel që kërkon modifikimin e praktikave të shkollës, ose shërbimet e edukimit të veçantë në mënyrë që të rritë në maksimum kapacitetet.*

Sipas këtij përcaktimi, në kuptim të përgjithshëm, do të thotë që një fëmijë i cili nuk mund të përballojë një klasë normale mund të përcaktohet si një fëmijë "i veçantë", ose e thënë në mënyrë më "elegante", fëmija i cili nuk arrin ato qëllime të edukimit normal nëpërmjet përvojës së edukimit normal, konsiderohet si i veçantë. Çështja kryesore është perceptimi i veçantisë së fëmijës nga mësuesit dhe fillimi i një sërë procesesh, duke filluar që nga përcaktimi i fëmijës si i veçantë, kategorizimi i duhur i tij dhe sigurimi i lehtësirave dhe trajtimit të nevojshëm për të.

Në pikëpamjen sociologjike, objekt interesi nuk janë karakteristikat e fëmijës por procesi i përcaktimit të veçantisë së tij. Në të vërtetë është ky proces që përcakton nëse një fëmijë është i veçantë dhe jo karakteristikat që mbart vetë ai.

"Kjo është shumë e vërtetë kur kemi të bëjmë me probleme sjelljeje, sepse mësues të ndryshëm nuk bien dakord me njëri-tjetrin nëse një fëmijë i "çuditshëm" është mjaftueshëm " i keq" për t'u karakterizuar si "i veçantë". Ndodhin shpesh mosmarrëveshje edhe kur bie fjala për defektet fizike, nëse ato janë mangësi të mjaftueshme për ta etiketuar fëmijën si të veçantë , për shembull, një fëmijë me shikim të pjesshëm, një fëmijë i tërhequr , një fëmijë i shurdhër, një fëmijë me spazma, apo autik (Barton& Sally, 1981).

Për këtë arsye është i rëndësishëm studimi analitik i procesit të përcaktimit, njohja dhe evidentimi i rasteve, trajtimi i ideve, qëndrimeve dhe argumenteve të pjesëmarrësve në studim. Në këtë pikëpamje një rol të rëndësishëm luajnë kërkimet etnografike. Marrëdhëniet dhe bashkëveprimet e pjesëmarrësve në studimet e rasteve varen nga një sërë faktorësh shoqërore si gjendja civile, përvojat e mëparshme. Njohuritë dhe kualifikimet varen nga pikëpamjet e pjesëmarrësve, qëndrimi i tyre ndaj botës, ndaj natyrës së njeriut dhe nga këndvështrimi për edukimin e fëmijës.

Për rrjedhim, edukimi i veçantë është produkt i një strukture forcash shoqërore që përqendrohen në procesin e vështirë të përcaktimit. “Por, ndodh shpesh që këto forca shoqërore të manipulohen nga teste, pyetësorë dhe shumë praktikues të tyre fillojnë të besojnë që bota artificiale e këtyre testeve është bota e vërtetë”. (Barton & Sally, 1981)

Krahasimi i “praktikave të mira”, ndërtimi i instrumenteve shkencore, vëzhgimi i realiteteve konkrete, testimi objektiv i tyre, ofrojnë pjesë të vërtetash relative në kushte të veçanta shpesh dhe të kufizuara në kohë dhe në hapësirën shoqërore, por që në thelbin e tyre mund të përmbajnë ide racionale që mund t’i shërbejnë kontekstit.

Dhe çfarë është më e rëndësishme, mund të bëhen objekt diskutimesh e debatesh, mund të bëhen shkak për kërkime të reja dhe të nxitin vëmendjen e forcave shoqërore dhe politike për të bërë investimin e duhur, konkret, material dhe shpirtëror për përcaktimin e edukimit të veçantë, për përkujdesjen e duhur ndaj tij, për përfshirjen e të gjithëve në të. Kjo besoj është e ardhmja.

Në pikëpamjen metodologjike punimi që po paraqitim është një përpjekje modeste, por serioze në fokusimin tek problemi në fjalë. Në rezultatet e studimit do të evidentojmë pikat e forta dhe të dobëta, për të sugjeruar strategji, zgjidhje, alternativa zhvillimi, për të “ndërgjegjësuar” fort profesionistët dhe specialistët e arsimit për t’i shërbyer së ardhmes.

Por e ardhmja është sot, në familje, që kur fëmija lind, në kopsht ku “përpëlitet” midis egocentrizmit dhe përpjekjeve të fuqishme për të zhvilluar iniciativën, në bankat e shkollës ku hap pas hapi formohet identiteti kulturor dhe gjatë gjithë jetës, kur i duhet t’i mbijetojë sfidave të pafundme të saj.

Gjatë këtyre dekadave shkollat janë akuzuar si të papërshtashme për të plotësuar nevojat e nxënësve, për shkak të vështirësive dhe pengesave. Nxënësit nuk kanë përfituar sa duhet nga praktikat standarde të mësimdhënies. “Motoja e Don Milanit: Nëse i shpërfillim nxënësit me vështirësi të theksuara, shkolla nuk duhet të jetë më shkollë, por një spital përgjegjës për individët e shëndetshëm që nuk i pranojnë individët e sëmurë” u citohet atyre që kërkojnë ndryshime në sistemin arsimor (Soresi et al., 2013).

“Më e mira është “të ngrejmë” pyetje se si aktorët normalë dhe jo normalë në procesin e gjithëpërfshirjes kanë kontribuar me përpjekjen dhe përfshirjen e tyre në mbarëvajtjen e një shkolle të orientuar ndaj të gjithëve, por që në të njëtën kohë qëndrojnë të hapur ndaj nevojave të çdo individi.”(Larocca, 2007)

Sipas kësaj pikëpamjeje, në vend të përqendrohemi në mënyrën se si trajtohen tipat e ndryshëm të nxënësve, parapëlqehet, siç tregohet edhe nga Waldron dhe McLeskey (2010),” të merret parasysh si një shkollë gjithëpërfshirëse planifikon , organizon dhe përkrah:

-mikpritjen për të gjithë nxënësit;

-rolet e paracaktuara dhe kompetencat profesionale të të gjithë mësuesve, të cilët duhen parë si “ kapitali edukues” i gjithëpërfshirjes jo vetëm për nxënësit me nevoja të veçanta, por për të gjithë nxënësit;

-llojshmëri në mësimdhënie me qëllim që të lehtësohet të nxënët për të gjithë nxënësit;

-monitorim i rregullt i arritjeve të nxënësve me qëllim që të vendosen mbi sistemin e mbështetjes, bashkëpunimit dhe përfshirjes së komunitetit;

-vlerësim efikas për programet dhe metodat e mësimdhënies të përdorura për të lehtësuar të gjithë nxënësit.

Me fjalë të tjera, kur analizohet gjithëpërfshirja, "e mira është t'i referohemi mënyrës se si kontekste të ndryshme gjithëpërfshirëse janë përpjekur dhe vazhdojnë të përpiqen, nëpërmjet zgjidhjeve strategjike të ndryshme politike, të shmangin vendosjen e pengesave shoqërore dhe t'i japin hov pjesëmarrjes aktive dhe ndarjes së përgjegjësive" (Soresi et al., 2013)

Për të filluar proceset e ndryshme të përmirësimit mbetet domosdoshmëri vlerësimi i analizave dhe "i treguesve të gjithëpërfshirjes" të cilat mund të na lejojnë të kuptojmë arsyet që tregojnë se çfarë po ndodh, arsye të cilat mund të jenë vetëm historike dhe kontekstuale.

E gjitha kjo merr një domethënie të veçantë në shkolla, sepse larmishmëria dhe natyra heterogjene e klasave marrin një rëndësi kaq të madhe, saqë na detyron të besojmë se të gjithë nxënësit kanë nevojë për një shkollë gjithëpërfshirëse dhe vëmendje të personalizuar nga edukatorët( Soresi, Ferrari & Ginevra, inpress). Sot më shumë se kurrë, del nevoja t'u kushtojnë vëmendje mësuesve për t'i nxitur të zhvillojnë aftësi të nevojshme për të kuptuar një arsimim me të vërtetë gjithëpërfshirës, të përmirësojnë dhe zhvillojnë qasje dhe bindje me vlerë për ta, për t'u përballuar me kohët e vështira në të cilat po kalojmë, për të mirën e të ardhmes së tyre dhe të nxënësve të tyre.

Arsimi gjithëpërfshirës në Shqipëri duhet të mbështetet në themele shkencore, në një linjë arsyetimi që i jep përparësi aspekteve etike, politike, shoqërore e ligjore kundrejt atyre me natyrë thjesht psikologjike e pedagogjike.

**Përfundime**

**1**.Kultivimi i një "kampi" të përkujdesjes për nxënësit me NVE nënkupton që shkolla të pakësojë refuzimin ndaj tyre, t'u krijojë kushte për t'u ndier të respektuar, dhe të shprehë kujdesin e vazhdueshëm për mirëqenien e tyre në klasë. Shkolla duhet të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e respektit reciprok dhe eleminimin e diskriminimit.

Për të promovuar këto marrëdhënie shkolla duhet që në mënyrë të vazhdueshme duhet të zhvillojë programe bashkëpunimi dhe aktivitete që nxitin rritjen e aftësive shoqërore të nxënësve me NVE duke mbajtur qëndrime të prera kundër çdo lloj shkeljeje, direkte ose jodirekte, fizike ose verbale.

**2.**Komunikimi dhe bashkëpunimi shkollë-familje.

Shkollat kanë përgjegjësinë ( shprehur edhe në Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar) të informojë prindërit rreth edukimit gjithëpërfshirës, rreth rregullave, në mënyrë që të shmangë mosbesimin dhe shqetësimet e prindërve, të cilët duhet të jenë në dijeni të së drejtës së tyre për të dhënë opinione dhe ide, për të hartuar e zbatuar PEI (Plane Edukimi Individuale). PEI është një platformë e mirë komunikimi shkollë-familje për të rritur opinionin publik edhe të prindërve në lidhje me edukimin e integruar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

**3.**Shkollat mund të ndërtojnë në mënyrë më afatgjatë marrëdhënie bashkëpunimi me organizata OJF, me shkollat speciale dhe me shkolla që kanë më shumë përvoja me NVE që të gjenerojnë më shumë mbështetje dhe shërbime për nxënësit me NVE nëpërmjet të mësuarit dhe trajnimit.

**4.**Universitetet dhe institucionet e edukimit duhet të krijojnë praktika të mirëmenduara për përgatitjen e studentëve mësues në karrierën e tyre të ardhshme, për të punuar e mbështetur më mirë nxënësit me NVE.

**Bibliografi e shfrytëzuar**

Bernstein, B. (1961). *Shoqëror class and linguistic developpement*, in Hasley, p. 196,293
Biehler, R., Snowman, J.( 2004*). Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie*, ISP, Tiranë
Buscaglia, L.(1998). *Të jetosh, të dashurosh, të kuptosh*, Çabej, MCM, Tiranë, David Fulton Publishers
Fullan, M. (2002). *Forcat e ndryshimit*, Pegi, Tiranë
Gardner, H. (2002), *Uneducated mind*, Tiranë, 2002
Gardner, H. (2004), *Dimensions of mind*, "Nënë Tereza", Tiranë
Glenn, A., Cousins, J. at all. (2005). *Eleminimi I pengesave në të nxënë në moshën e hershme*.
Montessori, M. ( 1959). *Absorbened mind*, Theosophical Publishing House
Musai. B,( 2003). *Metodologji e mesimdhënies* ,Tiranë
Piaget, J. (2004). *Psychology of intelligence constellation*
Woolfolk, A. (2011). *Psikologji edukimi*, cde ,Tiranë.

# MËSIMDHËNIA E GRAMATIKËS SË GJUHËS ANGLEZE TEK NXËNËSIT E KLASËS SË TRETË

**DORELA KAÇAUNI (KONOMI)**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Mësimdhënia e gramatikës së gjuhës angleze tek nxënësit e vegjël kërkon njohuri të gjera rreth një sërë çështjesh. Mësuesit jo vetëm që duhet të kenë njohuri të metodave, por duhet të njohin drejtimet kryesore të prezantimit të gramatikës tek nxënësit e vegjël, pasi është e pamundur që ajo të shmanget.

Qëllimi i këtij punimi është të prezantojë dy drejtimet kyesore, ai deduktiv dhe induktiv dhe cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Gjithashtu ky punim studimor mbështetet dhe në anën praktike duke përdorur metodën e vëzhgimit për të parë zbatimin konkret të anës teorike dhe duke dhënë fakte se cili drejtim, induktiv apo deduktiv, është më i përshtatshëm kur shpjegohet gramatika e gjuhës angleze.

Grupi që u vëzhgua përbëhej prej 20 nxënësish në klasën e tretë të një shkolle publike në qytetin e Korçës. Në fund të 6 orëve të vëzhguara, u analizuan përgjigjet që nxënësit dhanë dhe gabimet që u bënë për të arritur në përfundim se cili drejtim është më i duhuri për këtë grupmoshë.

**Fjalët kyçe:** *mësimdhënia e gramatikës së gjuhës angleze, nxënës të vegjël, drejtim induktiv, drejtim deduktiv,*

**Abstract**

Teaching English grammar to young learners of grade 3 requires knowledge about a range of issues. Teachers must not only have knowledge of the methods but should know the basic approaches of grammar presentation to young learners as it is impossible to avoid them.

The main purpose of this article is to present the two principal approaches: deductive and inductive approach and which their advantages and disadvantages are. Also this study is based on the practical part using the observation method to see the concrete application of the theoretical part and to give facts about which approach, deductive or inductive is more suitable when English grammar is taught.

The group that was observed consisted of 20 young learners in the grade 3 in a public school of Korca. At the end of the six observed lessons, the learners' responses and mistakes were analyzed to come to a conclusion which approach is the best for this age group.

**Key words**: *teaching English grammar, young learners, deductive approach, inductive approach*

Mësimdhënia e gramatikës ka qenë gjithmonë një aspekt i diskutuar në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Për shekuj me radhë aktiviteti i vetëm i zhvilluar nëpër klasa ka qenë studimi i gramatikës, por në shekullin XIX, veçanërisht në gjysmën e dytë të tij gjithçka ndryshoi.

Gramatika është sistemi i rregullave të nevojshme për të vendosur marrëdhëniet e fjalëve me njëra- tjetrën në një fjali. Kompetenca gramatikore zë një vend të rëndësishëm si një përbërës kryesor i kompetencës komunikative. Gramatika jep formën e strukturave të një gjuhe, por nga ana tjetër këto forma nuk kanë kuptim pa semantikën dhe përdorimin e tyre ose pragmatikën. Me fjalë të tjera gramatika na tregon se si të ndërtojmë një fjali (rendin e fjalëve, sistemet e foljeve dhe emrave, përcaktuesit, shprehjet, fjalitë e bashkërenditura dhe nënrenditura, etj).

Gramatika është e rëndësishme sepse ajo emërton llojet e fjalëve, grupet e tyre të cilat formojnë fjalitë jo vetëm në gjuhën angleze por në çdo gjuhë. Si qenie njerëzore ne jemi të aftë të lidhim fjali që fëmijë, por njohuritë gramatikore na ndihmojnë që të flasim se si janë ndërtuar këto fjali, llojet e fjalëve apo grupet e tyre.

Mësimdhënia e gramatikës është një çështje kryesore në mësimdhënien e gjuhës angleze. Nxënësit fillojnë të mësojnë gjuhën e huaj në klasën e tretë të shkollës 9-vjeçare, pra në moshën 8-9 vjeçare ata hasin njohuritë e para gramatikore në gjuhën angleze. Për këtë arsye mësuesi duhet që të jetë shumë i përgatitur më njohuri se si duhet t'ua prezantojë këto njohuri në mënyrë që gramatika të mos jetë e mërzitshmë për ta. Drejtimi deduktiv dhe induktiv janë dy drejtime që përdoren shpesh në mësimin e gramatikës, me të veçantat e tyre iu vinë në ndihmë mësuesve të gjuhës angleze.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të prezantojë dy drejtimet kryesore të mësimit të gramatikës së gjuhës angleze tek nxënësit e klasës së tretë në të cilën ata hasin njohuritë e para të gjuhës angleze.

Pyetjet që ky artikull do t'ju përgjigjet janë:

1.Cilat janë principet bazë të drejtimit deduktiv dhe induktiv në mësimin e gramatikës?

2.Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e këtyre drejtimeve?

3.Cili drejtim ka rezultate më të mira në mësimin e gramatikës?

**Metodat**

Metoda e përdorur në këtë kërkim është vëzhgimi. Një klasë e tretë me 20 nxënës ishte në fokus dhe u prezantua me njohuri të reja të kohës së tashme në gjuhën angleze. Fjalitë pohore dhe negative u prezantuan nëpërmjet drejtimit deduktiv dhe fjalitë pyetëse nëpërmjet drejtimit induktiv, përkatësisht nga dy orë mësimi secila. Në vëzhgimet e paraqitura është vënë në dukje vetëm aspekti gramatikor, i cili ishte edhe qëllimi i vëzhgimit.

**Drejtimi deduktiv**

Drejtimi deduktiv vjen nga koncepti i arsyetimit deduktiv ku kalojmë nga e përgjithshmja tek e veçanta. Pra në fillim prezantojmë rregullat, principet, konceptet ose teoritë dhe më pas trajtojmë zbatimin e tyre.

Në gramatikë, mësuesi prezanton në fillim rregullat dhe më pas zbatimin e tyre. Ky drejtim ka qenë shumë i përdorur në të gjithë botën dhe tani përbën një monopol në librat e gjuhës së huaj dhe librat e gramatikave (Fortune, 2002). Nxënësit janë të përqendruar tek problemi që po diskutohet, pasi ata janë bërë të njohur me rregullat gramatikore. Eisenstein-i (1987) sugjeron që me drejtimin deduktiv nxënësit janë në kontroll gjatë praktikës

dhe nuk kanë frikë se po arrijnë në një përfundim të gabuar se si një gjuhë funksionon.

Mishel Svan-i (cit. në Thornburi, p. 32) përkufizon disa udhëzime se si një rregull duhet të prezantohet:

1-Rregullat duhet të jenë të vërteta;
2-Rregullat duhet të jenë të qarta;
3-Rregullat duhet të jenë të thjeshta;
4-Rregullat duhet të përmbajnë koncepte me të cilat nxënësit janë të familjarizuar;
5-Rregullat duhet që të jenë të rëndësishme.

Më e rëndësishmja është që kur rregullat prezantohen në drejtimin deduktiv, prezantimi duhet që të ilustrohet me shembuj, pra që të përfshijë të kuptuarin e nxënësve dhe t'i lejojë ata që të ilustrojnë rregullat.

Por drejtimi deduktiv dhe induktiv ka avantazhet dhe disavantazhet që pasqyrohen në tabelën më poshtë (Brown, 2000).

**Tabela 1. Avantazhet dhe disavantazhet e drejtimit deduktiv në mësimdhënien e gramatikës**

| | |
|---|---|
| Avantazhet | 1. Drejtimi deduktiv përqendrohet direkt në thelbin e çështjes gramatikore, pra kursen kohë |
| | 2. Një numër i madh rregullash mund të jenë shumë më të thjeshta dhe të qarta se sa të nxirren nga shembujt |
| | 3. Shumë shembuj jepen në mënyrë të menjëhershme pas rregullit |
| | 4. Drejtimi deduktiv respekton inteligjencën e nxënësve dhe maturinë e tyre dhe ndihmon rolin e proceseve njohëse në përvetësimin e gjuhës së huaj |
| | 5. Ai konfirmon pritshmërinë e nxënësve për mësimnxënien në klasë në veçanti për ata që kanë një stil analitik |
| Disavantazhet | 1. Në qoftë se mësuesi fillon orën me prezantimin e gramatikës, nxënësit mund të dekurajohen |
| | 2. Nxënësit nuk mund të jenë në gjendje të kuptojnë konceptet që gjenden në terminologjinë e gramatikës së dhënë |
| | 3. Shpjegimi i gramatikës inkurajon mësimin e përqendruar tek mësuesi dhe nuk përfshin nxënësin në ndërveprim me mësuesin |
| | 4. Shpjegimi rrallë mbahet mend në krahasim me format e tjera të prezantimit si shembujt, demostrimi. |
| | 5. Drejtimi deduktiv inkurajon besimin se mësimi i gjuhës së huaj përqendrohet vetëm në përvetësimin e rregullave |

**Drejtimi induktiv**

Drejtimi induktiv vjen nga arsyetimi induktiv që nga e veçanta (vëzhgime, matje, të dhëna) shkojmë tek përgjithësimet (si rregullat, ligjet, konceptet, teoritë**)** (Felder & Henrikues, 1995). Pra kur përdorim induktimin ne shikojmë një numër të madh shembujsh dhe më pas arrijmë në përfundim duke dhënë koncepte apo principe.

Në rastin e gramatikës pedagogjike, ky drejtim sugjeron që një mësues, kur shpjegon gramatikën duhet të fillojë më prezantimin e fjalive shembull. Kështu nxënësit duhet të kuptojnë rregullat nga shembujt. Ky prezantim mund të jetë i shkruar ose i folur. Eisenstein-i (cit. ne Long & Ricards, 1987) vë re se ky drejtim i jep qartësi rregullit dhe kuptim përvojave, sepse ky drejtim përfshin direkt vëmendjen e nxënësve në udhëzimet e mësuesve. Gjithashtu ky drejtim inkurajon nxënësit të zhvillojnë strategji mendore vetjake kur merren me një çështje gramatikore. Me fjalë të tjera drejtimi induktiv inkurajon nxënësit të dalin në përfundim me rregullat që mësuesi do të përçojë tek ata.

Por ashtu si drejtimi deduktiv dhe ai induktiv ka avantazhe dhe disavantazhe, të cilat janë si më poshtë (Brown, 2000)

**Tabela 2. Avantazhet dhe disavantazhet e drejtimit induktiv për mësimin e gramatikës**

| | |
|---|---|
| Avantazhet | 1. Nxënësit janë të trajnuar më gjetjen e rregullave; kjo gjë e lehtëson autonominë e mësimnxënies dhe vetëbesimin. |
| | 2. Nxënësit zhvillojnë shkallën e njohurive njohëse |
| | 3. Nxënësit janë më shumë aktivë në procesin e mësimdhënies, sesa thjesht marrës pasivë. Në këtë aktivitet ata do të jenë më të motivuar. |
| | 4. Drejtimi induktiv përfshin njohjen e stukturave dhe aftësitë për të zgjidhur probleme të cilat nxënësit i kanë qejf pasi janë sfiduese për ta. |
| | 5. Aktivitetet, të cilat kërkojnë zgjidhjen e një problemi, mund të bëhen në grup dhe kështu nxënësit kanë mundësi që të praktikojnë përsëri gjuhën e huaj. |
| | 6. Ky drejtim inkurajon mësuesit që të hartojnë materiale sistematikisht. |
| Disavantazhet | 1. Drejtimi induktiv është konsumim kohe dhe energjie pasi nxënësit duhet që të konceptojnë rregullin e duhur. |
| | 2. Konceptet që jepen në mënyrë implicite mund t'i drejtojnë nxënësit të kenë koncepte të gabuara për rregullat e mësuara. |
| | 3. Ky drejtim mund të pengojë nxënësit, sepse ngaqë mund të jenë mësuar me stilin deduktiv preferojnë të mësojnë në fillim rregullat. |

Drejtimi deduktiv dhe induktiv kanë lidhje me teorinë e mësimit të gjuhës së huaj.

Së pari, drejtimi deduktiv lidhet me procesin e mësimit të ndërgjegjshëm në të cilin ky drejtim vë theksin në korrigjimin e gabimeve dhe prezantimin e rregullave ekplicite (Krashen, 2002). Mësuesi përpiqet që të shpjegojë rregullat në mënyrë që nxënësit të jenë të aftë t'i aplikojnë ato në ushtrime. Por që mësuesit të jenë të suksesshëm në zbatimin e këtij drejtimi, duhet që ai t'I sigurojë nxënësit një numër të madh ushtrimesh.

Së dyti drejtimi induktiv ka të bëjë me procesin e të mësuarit e gjuhës së huaj në mënyrë të nënndërgjegjshme. Sipas këtij drejtimi, nxënësit mësojnë sistemin e gjuhës (për shembull rregullat e gramatikës) në të njëjtën mënyrë si fëmijët mësojnë gjuhën e tyre të parë. Komunikimi i kuptimshëm, natyral është më i rëndësishëm sesa forma e gjuhës. Për këtë arsye korrigjimi i gabimeve dhe mësimi eksplicit nuk vihen në dukje dhe, kur mësuesi përdor këtë drejtim nxënësit i mësojnë rregullat në mënyrë të nënndërgjegjshme.

Sipas hipotezave të mësimit të gjuhës së huaj të Krashen-it (1987, 2002), janë nxjerrë përfundimet në lidhje me dy drejtimet, të cilat janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 3. Marrëdhënia e drejtimit deduktiv me atë induktiv sipas teorisë së Krashen-it (1987, 2002)**

| Drejtimi deduktiv | Drejtimi induktiv |
|---|---|
| Nxënësit mësojnë rregullin në kontekstin e udhëzimeve formale. | Nxënësit mësojnë rregullin si një fëmijë mëson gjuhën e tij të parë. |
| Nxënësit dinë rreth rregullit. | Nxënësit "e dallojnë" rregullin. |
| Nxënësit mësojnë rregullin në mënyrë të ndërgjegjshme. | Nxënësit mësojnë rregullin në mënyrë të nënndërgjegjshme. |
| Nxënësit mësojnë në mënyrë eksplicite. | Nxënësit mësojnë në mënyrë implicite |

***Prezantimi i Kohës së tashme (Present Simple)***

Fjalitë pohore – Ora e parë

- *Qëllimi i kësaj ore mësimi është që nxënësit të mësojnë se si formohen fjalitë pohore në kohën e tashme dhe të praktikojnë vetën e tretë për numrin njëjës*.

Në fillim mësuesi prezanton teorinë që ka për kohën e tashme për fjalitë pohore. Gjithashtu ai iu shpjegon nxënësve se kur përdoret kjo kohë dhe ndryshimin që ka me kohën e tashme të vazhduar (Present Continuous). Nxënësve iu vu në dukje fakti që në vetën e tretë ata duhet të vendosnin *s/es* dhe iu dhanë disa shembuj. E gjithë teoria u prezantua në gjuhën shqipe. Pas këtij prezantimi nxënësit morën gjithçka në fletoret e tyre, pasi e kishin të shkruar në dërrasë.

Më pas mësuesi praktikon me nxënësit këtë kohë. Në fillim merr një nxënës dhe përshkruan një ditë të tijën, duke përdorur vetën e tretë sipas gjinisë. Një nxënës tjetër, i cili është duke dëgjuar imiton të gjitha veprimet që mësuesi i thotë: "*Anxhela gets up at seven o'clock, she goes to the bathroom, she cleans her teeth, she washes her face, she gets dressed, she takes her school bag and she goes to school*." E njëjta procedurë u ndoq më tre nxënës të tjerë. Pjesa tjetër e nxënësve qeshnin pasi iu dukej qesharake se shokët e tyre imitonin veprimet. Të gjithë nxënësit kishin nga një detyrë. Ata duhet të dëgjonin me kujdes dhe të shkruanin të gjitha foljet që dëgjonin. Kur të mbaronte aktiviteti ata vinin dhe shkruanin foljet në dërrase: He / she <u>cleans</u>.

Ora e dytë

- *Qëllimi i kësaj ore është që nxënësit duhet të praktikojnë kohën e tashme, vetën e tretë njëjës.*

Në fillim mësuesi përdori mjete vizuale. Ai shkroi një varg foljesh dhe shkronjash në dërrasë dhe nxënësit duhet dallonin foljet dhe t'i vendosnin ato në kllapa. Ata duhet t'u vendosnin foljeve *s/es*. Më pas nxënësit u ulën në një rreth dhe duhet që t'i tregonin mësuesit se si e formojmë kohën e tashme dhe çfarë i shtojmë foljes në vetën e tretë njëjës. Kjo detyrë nuk ishte e vështirë, pasi ata u kënaqën duke luajtur "*rolin*" e mësuesit.

Pjesa tjetër ishte e njëjtë me aktivitetin e orës së parë, të ngjashëm me imitimet, por kësaj here nxënësit duhet që të udhëzonin shokët e tyre ashtu siç bëri mësuesi në orën e parë. Udhëzimet ishin argëtuese dhe krijuese me fjali të tilla si: "*Kristi rides an elephant, he goes to the toilet, he sleeps at school…"*

Fjalitë negative

Ora e parë

- *Qëllimi kësaj ore mësimore është që nxënësit të mësojnë se si të formojë fjalitë negative në kohën e tashme.*

Në fillim të orës mësuesi kontrolloi detyrat e shtëpisë, i korrigjoi duke vënë në dukje gabimet dhe duke i shpjeguar ato. Të gjitha fjalitë gabim u shkruan në dërrasë. Më pas mësuesi zgjodhi një nxënës që t'i lexonte fjalitë dhe nxënësit e tjerë vinin me radhë që t'i imitonin ato. Ky aktivitet u bë më qëllim që lidhja midis stimulit vizual dëgjues dhe lëvizjeve, rrisin kujtesën e fëmijëve dhe ndihmojnë përmirësimin e materialit të ri.

Më pas fëmijët morën principet bazë se si formohen fjalitë negative në kohën e tashme dhe u treguan shembuj konkretë. Ata i morën të gjitha shënimet në fletore dhe gjuha që mësuesi përdori ishte gjuha shqipe.

Nxënësit vazhduan me një ushtrim në libër, ku ata duhet që të formonin disa fjali negative për figurat e dhëna.

Në fund të orëns së mësimit mësuesi dha detyrat e shtëpisë ku duhet që të plotësonin disa ushtrime në fletoren e punës.

Ora e dytë

- *Qëllimi i kësaj ore është që nxënësit të praktikojnë përdorimin e kohën së tashme në fjalitë pozitive dhe negative dhe të dallojnë fjalitë pohore nga ato negative. Ata do të nxiten që të punojnë me tekstin.*

Në fillim të orës mësuesi kontrolloi detyrat dhe më pas u lejoi nxënësve t'i krahasonin detyrat e tyre me të shokut. Më pas ata shkruan dy ushtrimet në dërrasë.

Mësuesi u jep nxënësve një tekst dhe ata duhet që të dallojnë fjalitë pohore nga ato negative:

*Hello, my name is Cindy and I am ten years old. Ilike pizza with ham and ketchup but I don't like pizza with cheese. On Tuesdays I go shopping and on Thursdays I play tennis. I want to be a good tennis player. My brother Tim is twelve years old and he plays football. He wants to be a football player. Tim plays football every day. He doesn't like Biology but he likes P. E. and Music.*

Nxënësit i lexuan disa herë fjalitë dhe i përkthyen në gjuhën shqipe në mënyrë që të gjithë t'i kuptonin. Në ushtrimin tjetër ata duhet të kthenin fjalitë pohore në negative dhe e kundërta. Ky aktivitet ishte pak i vështirë për disa nxënës që të bënin ndryshimet.

**Drejtimi induktiv - Fjalitë pyetëse**

Ora e parë

- *Qëllimi i kësaj ore është që nxënësit duhet të*

*përgjigjen pyetjeve në kohën e tashme. Ata nuk duhet të formojnë fjali pyetëse vetë.*

Mësimi u fillua me disa pyetje nga mësuesi:

- ✓ What do you do in your free time?
- ✓ Do you like hot chocolate?
- ✓ What do your parents do in their free time?
- ✓ Where do you go on Saturdays?
- ✓ Where do your friends go on Saturdays?

Më pas ata lexuan një tekst dhe pas çdo paragrafi ata do t'u përgjigjeshin nga një pyetje. Për këto pyetje nxënësit dhanë më shumë se një përgjigje.

Mësuesi pyeti të gjithë nxënësit dhe ata përsërisnin përgjigjet herë pas here.

Ora e dytë

- *Qëllimi i kësaj ore është që nxënësit duhet të formojnë pyetje në kohën e tashme me gojë dhe me shkrim.*

Mësuesi ngriti në dërrasë një nxënës dhe ai duhet të mendonte se çfarë bën në kohën e tij të lirë. Nxënësit e tjerë do t'i bënin pyetje shokut si:

- Do you play tennis?
- Do you read books?

Nxënësi duhet të përgjigjeshe vetëm me "Yes, I do", "No, I don't". Të gjithë nxënësit morën pjesë në këtë aktivitet duke bërë pyetje. Më pas mësuesi u tha nxënësve nëse i mbanin mend përgjigjet e shokut të tyre duke i pyetur: " Does he/she…?" dhe u shkroi përgjigjet në dërrasë: "Yes, he/she does" " No, he/she doesn't".

Më pas mësuesi u dha të gjithë nxënësve një fletë ku duhet të plotësonin fjalitë me fjalët që mungojnë:

1-What time _____ you get up in the morning?

2-_____ your brother like chocolate?

3-When _____ your friends play football?

4-Why _____ she go to school by car?

5-What _____ his children do on Saturdays?

Pasi mbaroi aktiviteti mësuesi nxiti nxënësit që të gjenin se si ishin formuar pyetjet ne kohën e tashme për vetën e

tretë. Ata përdorën gjuhën shqipe, sepse nuk e kanë zhvilluar arsyetimin abstrakt të koncepteve gramatikore.

Në fund të orës mësuesi u dha një ushtrim për në shtëpi, në të cilin ata duhet të vendosnin fjalët në vendin e duhur për të formuar pyetje të sakta në kohën e tashme.

**Përfundimet**

Qëllimi i orëvë të vëzhguara ishte të vëzhgohej zbatimi i dy drejtimeve kryesore në shpjegimin e gramatikës në klasën e tretë, ai deduktiv dhe induktiv, por gjithashtu të shihej qëndrimi i nxënësve dhe reagimet e tyre. Është e pashmangshme që të mos prezantosh të paktën rregullat kryesore tek kjo grupmoshë, por në të njëjtën kohë ata do të tronditen nga informacioni gramatikor dhe shprehje që nuk i kuptojnë. Megjithatë në qoftë se duam të aftësojmë nxënësit të komunikojnë dhe të përdorin kohën e duhur, duhet t'i informojmë ata me principet bazë se si formohen fjalitë në kohën e duhur. Pyetja ishte se "Si duhet t'ua prezantojmë rregullat nxënësve dhe se si t'i praktikojnë ato?" Grupi që u vëzhgua ishte prej 20 fëmijësh të klasës së tretë dhe u prezantuan me kohën e tashme. Grupi i nxënësve mësoi se si formoheshin fjalitë pohore dhe negative, duke u bazuar tek drejtimi deduktiv e shtrirë në katër orë mësimore dhe më pas mësuan se si formoheshin fjalitë pyetëse duke u bazuar në drejtimin induktiv në dy orë.

Nga orët e vëzhguara të drejtimit deduktiv u panë se 87% e nxënësve përvetësuan mënyrën se si fjalitë pohore dhe negative formoheshin, por kishin probleme në përdorimin spontan të kohës së tashme dhe kërkonin ndërhyrjen e mësuesit në shumicën e rasteve. Ata i pëlqyen të gjitha aktivitetet që bënë në klasë, por u mërzitën nga prezantimi i rregullave. Ata nuk e kishin hasur më përpara kohën e tashme në gjuhën angleze dhe kështu që ishte e vështirë për t'u prezantuar rregullat gramatikore në një mënyrë argëtuese dhe të shkurtër. Disa shprehje si *don't, doesn't, the third person singular* ishin shumë abstrakte për nxënësit.

Disa gabime që nxënësit bënë gjatë aktiviteteve në orët e vëzhguara ishin:

- He *watch* TV.
- She *have* a doll.
- He *want's* an apple juice.
- I *want's* a ball.
- He *don't* have a ball.
- He *doesn't wants* a chocolate.
- He *don't eat* a vegetable
- He *dosen't have* a computer.

Gabimet që bien në sy janë gabime në vetën e tretë, duke mos përdorur *s/es* në foljet (He watch…), ose gabime me foljen *has* (She have …) apo duke vendosur apostrof tek folja për vetën e tretë dhe në vetën e parë (I/He want's…). Gabime shihen edhe në përdorimin e fjalive negative duke mos përdorur *doesn't* dhe folje pa *s/es* (He doesn't wants…) ose duke mos e përdorur *doesn't* (He don't have …). Gjithashtu shihet dhe një gabim drejtshkrimor që përsëritet nga shumë nxënës si *He dosen't*.

Drejtimi tjetër që u përdor ishte ai induktiv, i cili u pranua nga të gjithë nxënësit më mirë. Ata në fillim praktikuan pyetjet me mësuesin dhe më pas u argëtuan duke gjetur "rregullat" e kohës së tashme për fjalitë pyetëse. Ky drejtim ishte shumë argëtues për fëmijët, sepse ata nuk duhet të dëgjonin rregullat e prezantuara nga mësuesi, por u nxitën që të shprehnin idetë e tyre. Ata u ndien shumë mirë sepse iu duk sikur po "shpiknin" rregullat. Përgjigjet që nxënësit dhanë gjatë aktiviteteve në orët e vëzhguara ishin rreth 89% të sakta.

U vu re që ata përpiqeshin të shmangnin gabimet që kishin të bënin me kohën e tashme. Ata komunikonin spontanisht dhe nuk kishin nevojën e ndërhyrjes nga mësuesi. Informacioni që u mor nëpërmjet drejtimit induktiv ishte më i lehtë për t'u përvetësuar nga nxënësit.

Të dy drejtimet kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, por u vu re që drejtimi induktiv ishte me siguri më i mirë për nxënësit e vegjël. Ky drejtim ishte më argëtues dhe nxënësit nuk u mërzitën. Ata komunikonin lirshëm duke bërë pyetje dhe duke marrë përgjigje të sakta në lidhje me tekstin e dhënë nga mësuesi.

Disa gabime që u vunë re ishin ato në ushtrimin që mësuesi u kishte dhënë për detyrë shtëpie, konkretisht në shkrimin e pyetjeve duke vendosur fjalët në vendin e duhur për të formuar pyetje të sakta:

Sam/?/doll/Does/want/a – Does want a doll Sam?

marbles/Does/?/Jane/want – Jane want marbles does?

want/Does/ball/?/Bob/a – Does want a ball Bob?

Si përfundim njohuritë dhe aftësite e mësuara nga procesi i mësimdhënies induktive të gramatikës së gjuhës angleze thelloi përvetësimin e rregullave të kohës së tashme , përsa u përket fjalive pyetëse dhe u bënë pjesë e aftësive komunikuese të nxënësve.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Brown, H. (2000). *Principles of language learning and teaching* (4th ed.). New York: Addison-Wesley Longman, Inc.

Eisenstein, M. (1987). *Grammatical explanations in ESL: Teach the student, Not the method*.

Felder, R., & Henriques, E. (1995). *Learning and teaching styles in foreign and second language education*. Foreign Language Annals 28(1), 21-31.

Fortune, A. (1992). *Self-study grammar practice: Learners views and preferences*. *ELT Journal 46* (2), 160-171.

Richards, J. (Eds.). *Methodology in TESOL* (pp. 282-292). New Jersey: Heinle & Heinle Publishers.

Krashen, S. (1987). *Applications of psycholinguistic research to the classroom*. In M.Long & J.

Krashen, S. (2002). *Second language acquisition and second language learning* (1st Internet ed). Retrieved January 11, 2006 from http://www.sdkrashen.com/SL_Acquisition_ and_Learning/

Richards (Eds.). *Methodology in TESOL*. New Jersey: Heinle & Heinle Publishers.

Thornbury, S. (1999). *How to teach grammar*. Harlow, Essex: Pearson Education

# ASPEKTI KULTUROR NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS ANGLEZE NË KONTEKSTIN SHQIPTAR

**EDLIRA XEGA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Ky punim konsiston në trajtimin e kontekstualizimit të aspekteve kulturore që shfaqen tek tekstet e gjuhës angleze të autorëve shqiptarë e të huaj në klasat shqipfolëse në rajonin e Korçës, në arsimin parauniversitar.

Janë marrë mendimet e mësuesve të arsimit bazë dhe të mesëm mbi çështjet kulturore trajtuar në tekstet mësimore që ata zhvillojnë me nxënësit e tyre, sa dhe si ndihmojnë materialet e teksteve dhe vendin që zënë aktiviteteve kulturore tek nxënësit në përvetësimin e gjuhës angleze.

Janë nxjerrë rezultate nga pyetësorët, në të cilët jepen opinionet e mësuesve mbi aktivitetet ndërkulturore trajtuar në tekste, mendime mbi mësimdhënien e gjuhës komunikative ku nxënësit përfshihen në komunikim real, dhe ku arritja e suksesshme e detyrës komunikative që ata kryejnë është po aq e rëndesishme sa edhe përpikmëria e përdorimit të gjuhës së huaj. Mësuesit duke zhvilluar një të kuptuar të kulturës tek nxënësit, zhvillojnë ndërgjegjësim kundrejt kulturave të gjuhës së huaj që ata mësojnë.

Të dhënat e nxjerra janë analizuar në mënyrë kualitative dhe kuantitative, duke nxjerrë supozime, pohime, parime dhe vlera mbi atë çka aplikohet në kontekstin shqiptar dhe rolin e aspektit kulturor në mësimdhënien e gjuhës angleze në këtë kontekst.

Janë studiuar mënyrat si konceptohen aktivitetet ndërkulturore të teksteve nga mësuesit e gjuhës angleze në kontekstin shqiptar dhe se si aktivitetet ndërkulturore të teksteve mësimore janë përshtatur dhe përdoren nga nxënësit shqiptarë, me qëllim për të lehtësuar dhe për të bërë më të këndshëm përvetësimin e gjuhës angleze.

Qëllimi i këtij punimi studimor është vështrimi i pikëpamjeve dhe qëndrimit të mësuesve ndaj edukimit të të rinjve me aftësinë e komunikimit ndërkulturor nëpërmjet mësimit të gjuhës angleze.

Aspekti ndërkulturor i ndihmon nxënësit në asimilimin më të mirë të aftësisë së të folurit dhe aftësive të fjalorit. Rezultatet e pyetësorit për aktivitete ndërkulturore, të mbajtur në nivele të ndryshme shkollore mbështetin efikasitetin për nxitjen e perspektivave ndërkulturore dhe si nxënësit, sipas mësuesve, e shohin të mësuarin e kulturës në orët e gjuhës angleze shumë pozitivisht.

Vlerat shoqërore, qëndrimet dhe elementet kulturore janë integruar me qasjen komunikative për të nxitur efektivitetitn e gjuhës së huaj. Tekstet mësimore janë një pjesë integrale e mësimit të gjuhës në klasat shqiptare**.**

**Fjalët çelës** : *aspekt ndërkulturor, mësues të gjuhës angleze, arsimi bazë dhe i mesëm, pyetësor, konteksti shqiptar.*

**Abstract**

This paper consists in the contextualization of the cultural aspects displayed in the English language textbooks in the Albaninan classes of primary and secondary education, in Korca region.

There are taken into consideration the opinions of primary and secondary teachers, on cultural issues handled in textbooks and the way how these textbooks' materials help in a good English language acquisition.

Results are derived from questionnaires, in which are given teachers opinions on intercultural activities in textbooks, their opinions on communicative language teaching, where learners engage in real communication, and where the successful achievement of the communicative task they perform is just as important as the accuracy of the foreign language use.

Teachers by developing a cultural understanding among learners, they develop cultural awareness versus the foreign language they teach.

The data obtained were analyzed qualitatively and quantitatively, generating assumptions, statements, principles and values on what is applied in the Albanian context and the role of the cultural aspect in the teaching of English in this context.

There are studied the ways intercultural activities in the textbooks are conceived by English teachers in the Albanian context and how these activities are adapted and used by Albanian learners, in order to simplify and make the English language acquisition more interesting.

The purpose of this paper is the observation of the teachers' views and attitudes towards learners' education with the ability of intercultural communication through English language teaching.

Intercultural aspect helps learners to better assimilate speaking and vocabulary skills. The results for intercultural activities held at different school levels, support the effectiveness of promoting cross-cultural perspectives, and how the learners, according to the, teachers, see learning culture in English classes more positively.

The shoqëror values, attitudes and cultural elements are integrated with the communicative approach to encourage the effectiveness of foreign language. Textbooks are an integral part of the foreing learning in the Albanian classes.

**Key words:** Intercultural aspect, English language teachers, Primary and Secondary education, questionnaire, Albanian context.

Në një botë shumëgjuhëshe ku nxënësit i përkasin më tepër se një komuniteti folës, qëllimi i tyre kryesor nuk është të bëhet folës amtar i gjuhës angleze, por ta përdorë këtë gjuhë si mjet për ndërveprim mes gjuhëve dhe kulturave të tjera.

Kështu normat pedagogjike duhet të përshtaten me këtë realitet, duke marrë parasysh diversitetin dhe variacionin e nxënësve në klasa (E. Alcón Soler& M.P. Safont Jordà , 2007, p. 1)

Ky punim është bërë në vazhdim të kapitullit të doktoraturës, mbi problematikat e teksteve mësimore si studim dhe vëzhgim mbi përshtatjen ndërkulturore të teksteve mësimore të gjuhës angleze në kontekstin shqiptar, duke parë kontekstualizmin e këtyre aspekteve.

Analiza e të dhënave të këtij pyetësori është bërë në vazhdimësi të analizës së pyetësorit zhvilluar me nxënës pas realizimit të aktiviteteve kulturore, aplikimi

i të cilave, rezultoi në një ndryshim të dukshëm të nxënësve në njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë e tyre, duke i bërë ata të fitojnë njohuri të normave thelbësore dhe zakoneve të kulturës tjetër dhe sjelljeve në sferat shoqërore dhe profesionale. Është pare përshtatja ndërkulturore e tekstit me kontekstin shqiptar si dhe analiza e rezultateve të pyetësorëve, zhvilluar me mësues, pas zhvillimit të aktiviteteve kulturore.

Ky punim studimor është i rëndësishëm, sepse nxjerr në pah pikëpamjet e një numri të konsiderueshëm mësuesish në lidhje me aspektin kulturor në përvetësimin e gjuhës angleze. Përgjigjet e tyre mund të shërbejnë si një kontribut i vyer në përmirësimin e mësimdhënies dhe edukimin e nxënësve me qëndrime e vlera të qytetarisë evropiane.

**Përshtatja ndërkulturore e tekstit me kontekstin shqiptar.**

Nxënësit kanë një kompetencë ndërkulturore, një mënyrë të hyrjes në komunikim dhe të ndërveprimit me tjetrin. Një tekst mësimor i përshtatur në mënyrën e duhur, duhet të fillojë përfaqësimet e nxënësve në një kontekst të dhënë, ose ta drejtojë mësuesin tek ky kontekst që të zhvillojë tek ata një ndërveprim me folësit e gjuhës së huaj.

E pyetur mbi përshtatjen e aktiviteteve kulturore të tekstit mësimor të gjuhës angleze me kontekstin shqiptar dhe konkretisht me nevojat dhe nivelin e nxënësve shqipfolës, një mësuese e një gjimnazi publik në qytetin e Korcës shprehet:

*"Teksti mësimor, nuk duhet të të japë materialin. Ai duhet të të japë metodologjinë se si ti të punosh me ndërkulturoren. Sepse në këtë mënyre ti mund ta përdorësh tekstin si lidhje. Nuk ke pse t'u shpjegosh nxënësve se çfarë është ndërkulturorja. Nuk është e thënë t'u themi nxënësve si flasin anglezët ose amerikanët. Por duhet të krahasojmë kulturën angleze me kulturën shqiptare, sepse asnjë tekst mësimor nuk mund të llogarisë të gjithë kulturat e botës. Pra mendoj që në vend që të propozohet një material i gatshëm, siç e paraqesin tekstet mësimore, duhet propozuar një metodologji ose një krahasim mes mendimeve të njerëzve të ndryshëm"*

Pavarësisht nga mendimi i mësueses së mësipërme, mendojmë që tekstet mësimore, sa vinë e më shumë po i kushtojnë vëmendje të veçantë trajtimit të aspektit kulturor në të gjitha rubrikat dhe aftësitë gjuhësore. Vlen të përmendim këtu tekstet mësimore të autorëve të huaj të shtëpisë botuese "Express publishing" , që kanë edhe rubrika të veçanta mbi trajtimin e aspektit kulturor, ku u krijohen mundësi të shumta nxënësve mbi lidhjet mes kulturave.

Teksti mësimor dhe trajtimi i aspektit kulturor është një ndihmë në integrimin e njohurive të përftuara ( Zherar & Rozhje, p. 116). Ai transmeton njohuri të ndryshme, që lidhen me edukatën, me jetën në shoqëri. Ai mund të jetë i drejtuar jo vetëm në fitimin e njohurive e shprehive, por edhe të luajë rolin e tij në formimin e modeleve të sjelljes, që e lejojnë lexuesin të përcaktojë, në mënyrën më të mirë, vendin e vet në strukturat shoqërore, familjare, kulturore e kombëtare (Po aty, 119)

**Përshtatja e tekstit me kulturën e nxënësit**

Teksti ofron një kuadër pune konkrete për nxënësin. Ai mbledh së bashku dijet gjuhësore e komunikative të nevojshme për të arritur objektivat ose për të marrë një provim të caktuar; teksti vë në dispozicion mjete të ndryshme për t'u arritur. Teksti kthehet në një objekt dijesh për të fituar burimet dhe njohuritë dhe për

t'u bërë një referencë ( Cosaceanu, 2010, p. 39).

Nxënësit mësojnë më mirë kur materiali ose teksti shkaktojnë përfshirje emocionale dhe jo vetëm intelektuale dhe fizike. Me fjalë të tjera, një përvojë e gjatë e të mësuarit, duhet të jetë e tillë që ta bëjë materialin më të paharrueshëm si dhe i motivon nxënësit ta mësojnë at (Nilson, 2010, p. 4)

**Ndikimi i kulturës në mësimdhënen dhe mësimnxënien e gjuhës angleze tek nxënësit shqiptarë**

Një lidhje semiotike ekziston mes komunikimit, kulturës, mësimdhënies dhe të mësuarit. Kjo ndodh sepse ajo për të cilën ne flasim, si flasim, çfarë shohim, ose injorojmë, si mendojmë dhe çfarë mendojmë, ndikohen nga kultura. Bruner (1996) shprehet që "të mësuarit dhe të menduarit janë pozicionuar gjithmonë në një mjedis kulturor dhe varen gjithmonë nga përdorimi i burimeve kulturore. Kultura siguron mjetet për të ndjekur kërkimin për kuptimin dhe t'u transmetojë të kuptuarin tonë të tjerëve. (Samovar , Porter et al., 2007, p. 347)

Porter dhe Samovar's (1991) e përshkruajnë komunikimin si një matriks të ndërlikuar të ndërveprimit të akteve shoqërore që ndodhin në një mjedis që pasqyron mënyrën si njerëzit jetojnë dhe si ndërveprojnë me njëri- tjetrin. Ky mjedis shoqëror është kultura, dhe nëse ne me të vërtetë e kuptojmë komunikimin , ne duhet të kuptojmë edhe kulturën.

Komunikimi udhëhiqet nga rregullat e kontekseve shoqërore dhe fizike. Kultura është sistemi udhëheqës që përcakton format, funksionet dhe përmbajtjen e komunikimit; ajo është përgjegjëse për ndërtimin e "repertotreve tona individiuale të kuptimeve dhe sjelljeve komunikative. (Samovar, Porter et al., 2007, p.349)

Konteksti sociokulturor, biseda logjike dhe dinamike, stilet e ofrimit të materialeve, funksionet shoqërore, pritshmëritë e roleve, normat e ndërveprimit dhe tiparet joverbale, janë po aq të rëndësishme sa fjalori, gramatika, leksiku, shqiptimi, dhe dimensionet e tjera linguistike dhe strukturore të komunikimit. Kjo, sepse forma e shkëmbimit midis fëmijës dhe të rriturit dhe kushtet në të cilat kjo ndodh, do të ndikojnë jo vetëm çfarë thuhet, por edhe sa i përfshirë do të bëhet nxënësi.

Kultura e nxënësit është një faktor i rëndësishëm për t'u marrë parasysh për mësim të suksesshëm. Mësimi i një gjuhë të huaj dhe përvojës së kulturës së huaj parandalon konfliktet e mundshme kulturore dhe lehtëson integrimin e gjuhës së huaj në jetën e nxënësit.

Nga intervistat e ndryshme të zhvilluara me mësues si dhe nga rezulatet e pyetësorëve, ata shprehin mendime të ndryshme në lidhje me tekstet mësimore që zbatohen në shkollat 9- vjeçare , të mesme në zonat urbane e rurale si dhe në qendrat e gjuhëve të huaja, në Korçë e në fshatrat rreth saj.

Një mësues nga një shkollë 9-vjeçare publike në një fshat periferik të Korçës shpjegon :

"*Vlerat e nxënësve në raport me jetën janë të ndryshme. Shpesh në tekstin që përdor flitet për udhëtimet ose diçka e tillë që është larg realitetit të tyre. Mendoj se do të duhet një tekst mësimor i orientuar për nxënës të zonave periferike rurale. Tekstet që aktualisht përdorim nuk janë hartuar për këta nxënës. Ato tregojnë një realitet thjesht kulturor, jashtë ushtrimeve, nxënësit duhet të kenë informacione mbi këtë objekt. Dhe shpesh realiteti i nxënësve tanë, nuk përmban këtë informacion*"

Pra, atë çka ka dashur të thotë ky mësues, konsiston në faktin se tekstet e autorëve të huaj janë shumë të largët për fëmijët e grupeve socio-ekonomike të pafavorizuara, të cilët nuk mbajnë

informacion të mjaftueshëm për të kuptuar të dhënat.Teksti nuk është i përshatur me realitetin në të cilin ata jetojnë dhe kontekstin e tyre socio-ekonomik.

Pra në të njëjtën mënyrë, dinamika e përshtatjes duhet të marrë parasysh referencën hapësinore të situatave të nxënësve dhe t'ua prezantojnë situatat që ndodhin në vende që janë të familjarizuara për ta. Në këtë mënyrë nxënësit do t'i konceptojnë më lehtë gjërat.

**Studimi**

Një individ duhet të jetë i mirinformuar dhe i nevojiten aftësi fleksibël në jetë, kështu që të mësuarit e gjuhës angleze është një mjet i mirë për të krijuar të ardhmen e qytetarëve me njohuri, krijueshmëri dhe aftësi të të menduarit kritik, që të jenë në gjendje të përballen me jetën (Graddol, 2006, p. 71). Për këtë arsye është e rëndësisë parësore komunikimi ndërkulturor në procesin e mësimdhënie- mësimnxënies së gjuhës së huaj. Kultura është e nevojshme sepse ajo është një pjesë integrale e bashkëveprimit midis gjuhës dhe mendimit. Modelet kulturore, zakonet dhe mënyrat e jetesës që shprehin pikëpamje të ndryshme, reflektohen në gjuhë (McKay, 2002, p. 85).

**Pyetja kërkimore**

Pyetja që shtrohet tek ky studim ka të bëjë me mendimet e mësuesve të arsimit bazë e të mesëm në rajonin e Korçës mbi çështjet kulturore trajtuar në tekstet që ata zhvillojnë me nxënësit e tyre, sa dhe si ndihmojnë materialet e teksteve përmes këtij aspekti tek nxënësit në një përvetësim sa më të mirë të gjuhës angleze.

**Qëllimi**

Qëllimi është të nxirret në pah mënyra si konceptohen nga mësuesit e gjuhës angleze aktivitetet ndërkulturore të teksteve në kontekstin shqiptar dhe se si këto aktivitete, shfaqur në tekstet mësimore, sidomos tek tekstet e autorëve të huaj, janë përshtatur dhe përdoren nga nxënësit shqiptarë, me qëllim lehtësimin dhe bërjen sa më të këndshme të orës së mësimit .

Mësuesit duhet të shpjegojnë për komunikim dhe shumë përdorues të gjuhës angleze si lingua franca, komunikojnë në mënyrë të përkryer me gramatikë të kufizuar dhe pa përdorime gramatikore standarde (Jenkins, 2009 ). Kjo është ajo që duam të theksojmë përmes aktiviteteve ndërkulturore-komunikim dhe ndërveprim; dy çështje këto, të cilat janë një mënyrë e mirë për të ndihmuar nxënësit të komunikojnë përmes kulturave.

**Subjektet në studim dhe instrumentat e kërkimit.** Pyetësori është zhvilluar përkatësisht me 21mësues të ciklit 9-vjeçar, dhe 19 mësues të ciklit të mesëm; gjithsej 40 mësues në vitin shkollor 2012-2013.

**Metodologjia e përdorur**

Të dhënat e nxjerra janë analizuar dhe paraqitur në grafikë dhe në përqindje. Mësuesve u është kërkuar të plotësojnë një pyetësor, i cili nxjerr mendimet e tyre aktuale mbi pikëpamjet dhe qëndrimin e tyre ndaj edukimit të të rinjve me aftësinë e komunikimit ndërkulturor nëpërmjet mësimit të gjuhëve të huaja.

Të dhënat e nxjerra janë analizuar në mënyrë kualitative dhe kuantitative, duke nxjerrë supozime, pohime, parime e vlera mbi atë që zbatohet në kontekstin shqiptar dhe rolin e aspektit kulturor në mësimdhënien e gjuhës angleze ne këtë kontekst.

Analiza kuantitative është paraqitur përmes pyetësorëve të dorëzuar mësuesve të arsimit bazë të ciklit 9- vjecar dhe arsimit të mesëm, në analizën e përqindjeve.

Analiza kualitative është një analizë subjektive, bazuar tek të dhënat dhe përgjigjet e mësuesve. Ashtu siç shprehet

edhe Paille, kërkimi kualitativ është opinion direkt i subjekteve të studimit dhe kryhet përmes gjuhës, pa ndihmën e mjeteve teknike. (Paille, 2004, p. 189).

Pyetësorët përkufizojnë fakte dhe mendime, identifikuar nga metoda kualitative (Woods, 2006). Pyetësori konsiston në 18 pyetje.

**Analiza e pyetësorit**

Përmes analizës dhe përqindjeve të nxjerra, bazuar tek mendimet e mësuesve, rezultohet në këto të dhëna:

1. Përqindja më e madhe e mësuesve kanë dëgjuar termin "komunikim ndërkulturor" në leksionet gjatë studimeve të tyre universitare, për funksionet e mësimit të gjuhës së huaj.

2.Për të qenë ndërmjetës kulturor, 76,1% të mësuesve të ciklit të mesëm dhe 78,9% e mesuesve të ciklit 9- vjecar mendonin se mësuesit duhet të kenë njohuri sa më të gjera kulturore nga kulturat e dy vendeve. Të ketij mendimi ishin dhe pjesa tjetër pra 23,8% e mësuesve të shkollave të mesme dhe 21% e shkollave 9- vjeçare, por duke shtuar që për të qenë ndërmjetës kulturor , njohuritë duhet t'i kenë nga të gjitha fushat e jetës, art, histori, politikë, muzikë, civilizim.

5. Përsa i përket përdorimit të aktivieteteve kulturore në orën e mësimit, nga 40 mësues, 60% e tyre i përdorin shumë, 25 % prej tyre i përdorin mjaft dhe 15% e tyre i përdorin pak, këtu përfshihen mësues me përvojë mbi 30 vjet.

6. 97% e tyre mendojnë se përdorimi i aktiviteteve kulturore është një pjesë e domosdoshme në mësimdhënien dhe përvetësimin e gjuhës së huaj; 3% e mësuesve mendonin se nuk duhen përdorur.

7. Përsa i përket masës të përdorimit të këtyre aktiviteteve në klasë mësuesit e ciklit të mesëm kishin përqindje më të lartë përdorimi se mësuesit e ciklit 9- vjecar. Konkretisht nga mësuesit e ciklit të mesëm 76, 8% e tyre i përdorin aktivitetet kulturore në masën 80% dhe 66,6% e tyre në masën 60%; 47,3% e mësuesve të ciklit 9- vjeçar i përdorin në masën 80%, 36,8% e tyre i përdorin më masën 60% dhe 15,7% në masën 40%.

8. Sipas mendimit të 18 mësuesve nga të dy ciklet ose 45% e tyre, gjuha angleze përvetësohet me anën e aktiviteteve ndërkulturorë në masën 80%; 30% e mësuesve mendonin se përvetësohet në masën 60%, 17, 5% e tyre në masën 40% dhe pjesa tjetër pra 7,5 % ishin të mendimit se përvetësohet në masën 20%.

9. Veprimtaritë e komunikimit ndërkulturor mësues të ndryshëm i përdornin në faza të ndryshme të orës së mësimit. Shprehur me përqindje: 40% e tyre i përdornin në fazën e evokimit; 17,5% në fazën e realizimit të kuptimit dhe 42, 5% në fazën e reflektimit. Pjesa e mësuesve që i përdornin në fazën e evokimit komentonin se fillimi i orës së mësimit me aktivitete të komunikimit ndërkulturor e bën më interesant vazhdimin e orës dhe sjell rritje motivimi dhe interesi tek nxënësit për pjesën e mësimit që pason.

10. Përqindja më e madhe e mësuesve mendojnë se përvojat e shkëmbimeve ndërkulturore ndihmojnë mjaft edhe shumë në përmbushjen e qëllimit të mësimit të gjuhës së huaj.

11- 12. Pyetur në lidhje me disa nga përvojat e tyre lidhur me kontaktet e shkëmbimet me njerëz të kulturave të tjera, reagimet ishin të ndryshme: 35% e tyre kanë pasur kontakte me stazhierë të huaj, si dhe përmes literaturës ku shprehen mendimet e njerëzve të ndryshëm për kulturat e tyre, 30% shprehen se nxënësit kanë pasur kontakte me të huajt dhe ndajnë përvojat e tyre në klasë dhe po 35% e mësuesve përmendin pothuajse të njëjtat përvoja. Ata shprehen se këto përvoja kanë ndikuar mjaft në

mësimdhënien e tyre, sidomos kontaktet me të huajt, me anë të të cilave ka pasur shkëmbime ndërkulturore.

13. Mënyrat që mësuesit u krijojnë nxënësve mundësinë për të kuptuar kulturat e tjera janë të shumta. 57% e mësuesve të ciklit të mesëm shohin si mënyra më frytdhënëse për të kuptuar kulturën e huaj përdorimin e internetit, teksteve shkollore, shfaqjes së filmave dhe shkëmbime prvojash. 42, 8% e tyre shohin si mënyra të mundshme gazetat, internetin, organizim spektaklesh ne klasa, ose edhe teatrot. 52,6% e ciklit 9- vjeçar shohin si mënyra të mundshme internetin, revistat, librat dhe 47,3% spektaklet, filmat si dhe shkëmbime përvojash përmes binjakëzimit të shkollave.

14. Ata i sqarojnë dhe u shpjegojnë nxënësve se kultura të ndryshme kanë të veçantat e tyre të cilat duhen pranuar dhe , pse jo duhen shkëmbyer me kulturat amtare të nxënësve, në këtë mënyrë mënjanohen keqkuptimet.

15. Përsa i përket pyetjes nëse duhet vënë theksi në aftësimin ndërkulturor, 32,5 % e mësuesve të të dy cikleve ishin të mendimit se duhet vënë shumë theks në aftësimin ndërkulturor të nxënësve, 42,5% mendonin se duhet vënë mjaft theks dhe 25% disi. Sipas tyre nxënësit që zotërojnë aftësitë ndërkulturore, kuptojnë dhe ndërveprojnë me njerëzit e kulturave te huaja, konceptojnë specifikisht perceptime, mendime, ndjenja dhe veprime, si dhe lirohen nga paragjykimet. Në këtë mënyrë nxënësit kanë një interes dhe motivim për të vazhduar mësimin e gjuhës së huaj, konkretisht të gjuhës angleze.

16. Të pyetur mbi ndihmën që kanë dhënë tekstet shkollore mbi përvetësimin e komunikimit ndërkulturor, 85% e mësuesve punonin me tekste të huaja, konkretisht me tekstet e Express Publishing, dhe u shprehën se tekstet i ndihmonin 80% dhe 100%. 15% prej tyre të cilët përdornin tekste të tjera, tekstet i ndihmonin në masën 40%.

17. Bazuar në mënyrën e punës së tyre se cilat aktivitete kulturore mendojnë se kanë më tepër efektshmëri për përvetësimin e gjuhës e huaj nga nxënësit, 65% e tyre ishin të mendimit se interneti, librat dhe shkëmbimet e përvojave kanë më tepër efektshmëri në përvetësimin e anglishtes dhe 35% e tyre mendonin se teatri, spektaklet dhe filmat ndihmojnë më shumë.

18. Pyetjes se si mendojnë se mund të integrohet aftësia e komunikimit ndërkulturor në programin e formimit e tyre si mësues, përgjigjet ishin nga më të ndryshmet: 35% e tyre shikonin si zhvillime të mundshme ndërkulturore për zhvillimin e tyre profesional organizimin e seminareve rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe sjelljen e specialistëve të huaj në orët e mësimit; 32,5% e tyre mendonin se përvojat dhe shkëmbimet ndërkulturore si dhe binjakëzimet e shkollave çojnë në rritje profesionale dhe integruar me komunikim ndërkulturor; 32,5 % e tyre ishin të mendimit se formimet e ndryshme teorike dhe përvojat e shumta në vendet, gjuhën e të cilëve shpjegojnë do ishin një ndihmë e madhe për ta.

Këto rezultate jepen të ilustruara në grafikët dhe tabelat përkatëse në fund të studimit, shënuar me numrat korrespondues.

**Rezultatet e pyetësorit të mësuesve**

Ky pyetësor tregoi pikëpamjet dhe qëndrimet e mësuesve ndaj edukimit të të rinjve me aftësinë e komunikimit ndërkulturor nëpërmjet mësimit të gjuhës angleze në shkollat shqiptare e konkretisht në qytetin e Korçës. Përgjigjet e tyre japin një ndihmesë të vyer në përmirësimin e mësimdhënies dhe edukimin e nxënësve me qëndrime e vlera të qytetarisë evropiane.

Për të qenë ndërmjetës kulturor mësuesit duhet të kenë njohuri të gjera nga të gjitha fushat. Aktivitetet kulturore janë një pjesë e domosdoshme në mësimin e gjuhës së huaj.

Përqindja më e madhe e mësuesve që përdorin këto aktivitete ishin në gjimnaz. Ndërthurjet lëndore me artin, muzikën, historinë etj, u hapin më shumë horizonte nxënësve. Programet u krijojnë më shumë mundësi mësuesve dhe u japin një hapësirë më të madhe në përdorimin e aktiviteteve kulturore, gjë që çon në perfeksionimin më të mirë të gjuhës.

Sipas 18 mësuesve gjuha përvetësohet në masën 80% me anën e aktiviteteve kulturore dhe pjesa tjetër në masën 60%. Mësuesit i përdorin këto aktivitete në faza të ndryshme të procesit mësimor, më tepër në fillim e në fund të mësimit. Përvojat e tyre në lidhje me shkëmbimet kulturore kanë qenë nga më të shumtat.

Mënyrat që mësuesit e anglishtes u krijojnë nxënësve për kulturat e huaja janë të shumta. Përqindja më e madhe e tyre përveç teksteve shkollore, përdorin internetin, filmat, një përqindje më e vogël kanë përdorur shkëmbime përvojash përmes binjakëzimit me shkolla jashtë vendit. Teknologjia, video-konferencat, faqet e internetit, vizitat në vendin, gjuhën e të cilit mësojnë, sipas mësuesve janë mënyrat më efektive në mësimin e gjuhës për një qëllim të caktuar, duke e lëvizur përvojën e tyre nga teoria në realitet. Në këtë mënyrë nxënësit mësojnë nga kultura e huaj dhe e ndërthurin me kulturën e tyre mëmë. Sipas mendimit të mësuesve, janë mënyra të cilat kanë tepër efikasitet në përvetësimin e gjuhës së huaj.

Përveç fakteve të lartpërmendura, tekstet e Express Publishing, me të cilat punojnë shumica e mësuesve,në qytetin e Korçës, u japin ndihmë të madhe në mësimdhënien e komunikimit ndërkulturor , përmes shumëllojshmërisë dhe gamës së madhe të temave trajtuar në to.Temat kulturore dhe shoqërore ndërthurur me aspektin linguistik, krijojnë një larmishmëri gjatë orës së mësimit, duke e bërë interesante dhe duke krijuar hapësirë për largimin e monotonisë nga orët e mësimit, me anën e aktiviteteve kulturore. Ato i ndihmojnë shumë nxënësit për të fituar një kuptim të plotë dhe të qartë të gjuhës me ndihmën e shprehjeve standarde, strukturave gjuhësore të shoqëruar nga situata reale të përditshme.

Si mundësi për integrimin e aftësisë të komunikimit ndërkulturor në programin e formimit të tyre si mësues , ata shohin organizimin e seminareve dhe trajnimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, sjelljen e specialistëve të huaj në orët e anglishtes në klasat shqiptare, si edhe vizitat dhe shkëmbimet e përvojave në shkollat simotra.

**Diskutime dhe përfundime**

Ky studim synoi në identifikimin e qëndrimeve të mësuesve ndaj dimensioneve kulturore të gjuhës angleze të bazuar në analizën e të dhënave nga pyetësori. Studimi, nga rezultatet e mësipërme, konkludon se në klasat shqiptare ka një ndërveprim shoqëror kur mësohet një gjuhë e huaj. Transmetimi i kulturës është një aspekt i rëndësishëm.

Jo vetëm mësuesit e gjuhëve të huaja, por edhe institucionet arsimore duhet të identifikojnë mundësitë në zgjerim për zhvillimin e një dimensioni ndërkulturor në tekstet e gjuhës angleze, t'i qasin nxënësit me mësimin e kulturës dhe t’i përballin me ndryshimet përmes kulturave që vetë nxënësit t’i sfidojnë ato.

Statistikat tregojnë se ata besojnë se jo vetëm gjuha është e nevojshme, por edhe gërshetimi i saj me kulturën, me qëllim që nxënësi mund të përshtatet dhe të mund të vlerësojë të tjerët që kanë një kulturë të ndryshme nga e tij.

Sipas mësuesve, efektiviteti i aktiviteteve ndërkulturore në mes të nxënësve shqiptarë është i qartë, në faktin se përqindjet më të larta të të intervistuarve ndihen më mirë në anglisht, kur kryejnë këto veprimtari, në vend të veprimtarive të tjera. Ato gjithashtu i ndihmojnë ata në përvetësimin më të mirë të aftësisë së të folurit dhe aftësive të fjalorit. Në reflektim, nxënësit shohin të mësuarin e kulturës në orët e gjuhës angleze shumë pozitivisht.

Rezultatet e pyetësorit për aktivitete ndërkulturore, të mbajtur në nivele të ndryshme shkollore mbështetin efikasitetin për nxitjen e perspektivave ndërkulturore .

Tekstet e gjuhës angleze shkruar nga autorë të huaj nuk mund të asimilohen lehtë nga nxënësit shqiptarë në faktin se ato përmbajnë tekste, aktivitete, dialogje, materiale të dëgjuara, në bazë të përvojave të huaja, të cilat janë larg nga kultura amtare. Anglishtja shpjegohet bazuar në faktorët e njohur nga situatat e njohura të nxënësve dhe krahasimet kulturore, ku nxënësit shqiptarë të shohin kuptimin e përdorimit të gjuhës për qëllimet reale komunikuese. Orët e gjuhës angleze u përshtaten nxënësve shqiptarë, interesave, nevojave të tyre dhe i bëjnë ata të identifikohen në kontekstin e klasës. Në këtë mënyrë ata mund të ndiejnë sensin praktik të gjuhës së huaj (Xega, 2013, p.25)

Gjuha dhe kultura janë dy elemente që lënë të nënkuptohen tek njëra- tjetra. Mësimi i një gjuhe të huaj do të thotë që të merresh me një kulturë të veçantë dhe nëse i referohemi kësaj, jo të gjitha tekstet e anglishtes që përdorin mësuesit janë të duhurit për plotësimin e nevojave dhe interesave kulturore të nxënësve. Çdo gjë varet nga fakti se si mësuesi trajton përmbajtjen dhe ku fokusohet në klasë. Mësimdhënia duhet zhvillohet në atë mënyrë që t'i bëjë nxënësit të ndiejnë që anglishtja nuk i përket një kulture tjetër, por ajo i përket kulturës së tyre. Është shumë sfiduese për nxënësit që nuk e kanë anglishten gjuhë amtare, të përshtasin jetët e tyre shoqërore dhe ekonomike në kontekstin e tanishëm, sepse ata duhet të përballen me ' mosrehatinë ' gjuhësore dhe kulturore. E ardhmja e gjuhës angleze nuk varet vetëm nga ajo që ndodh në vendet ku flitet kjo gjuhë, por edhe në vendet që nuk e kanë gjuhë amtare.

Nga mendimet e mësuesve del se organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore rrit ndërgje-gjësimin e nxënësve dhe zhvillon kureshtjen e tyre në drejtim të kulturës së huaj, duke i ndihmuar ata të bëjnë krahasime mes kulturave. Kjo pasuron përvojën e nxënësve dhe i bën ata të vetëdijshëm se, pavarësisht ekzistencës së elementeve të globalizuara kulturore, ekzistojnë ende dallimet midis kulturave, dallim që duhet të kuptohet e respektohet nga ana e tyre.

Një folësi ndërkulturor i nevojitet një ndërgjegjësim që të dijë dhe të kuptohet më mirë nga perspektiva e personit tjetër, që ka aftësi, qëndrime dhe vlera te përfshira, të cilat janë vendimtare për të kuptuar marrëdhëniet ndërkulturore njerëzore ( Byram et al., 2002, p. 6).

Këto tema duhen konsideruar shumë të rëndësishme dhe dimensioni ndërkulturor duhet të promovohet dhe të përshtatet me kurrikulën dhe programin e hartuar nga institucionet përkatëse në Shqipëri.

## Shtojcë

**Tabela 1**

| | Ndërmjetës kulturor,njohuri. | Përdor sh. aktivitet kulturore | Akt. kulturore të domosdoshme | Masa e përdor. të akt. kulturore | Përvetës. gj. përmes akt. kulturore 80% | Përvetës. i gj. përmes akt. kulturore 60% |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mësues 9-vjeçare | 78.9% | 60% | 97% | 47.3% | 45% | 45% |

**Grafik 1**




**Tabela 2**

| | Ndërmjetës kulturor, njohuri. | Përdor sh. aktivitet. kulturore | Akt. kulturore të domosdoshme | Masa e përdor. e akt. kulturore | Përvetës. i gj. përmes akt. kulturore 80% | Përvetës. i gj. përmes akt. Kulturore 60% |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mësues gjimnaz | 76.1% | 60% | 97% | 76.8 % | 45% | 45% |

**Grafiku 2**



**Tabela 3**

| | **Fazat e përdorimit të aktiviteteve kulturore** | | | Internet, tekste, filma, shkëmbim përvoje | Spektakle shkollore, teater, gazeta | Ndihma e teksteve në përvetësimin e kom. ndërkultur (tekst i huaj) | Ndihma e teksteve në përvetës. e kom. ndërkulturor (tekst shqiptar) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mësues 9- vjeçare | Evokim | Realiz. Kuptimi | Reflektim | | | | |
| | 40% | 17.5% | 42.5% | 52.6% | 43.3% | 85% | 15% |

**Grafiku 3**




**Tabela 4**

| | **Fazat e përdorimit të aktiviteteve kulturore** | | | Internet, tekste, filma, shkëmbim përvojash | Spektakle shkollore, teatër, gazeta | Ndihma e teksteve në përvetës. e kom.ndërkult. (tekst i huaj) | Ndihma e teksteve në përvetës. e kom.ndërkult. (tekst shqiptar) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Evokim | Realizim Kuptimi | Reflektim | | | | |
| Mësues gjimnaz | 40% | 17.5% | 42.5% | 57% | 42.8% | 85% | 15% |

**Grafik 4**




**Bibliografi e shfrytëzuar**


Alcón, E. Soler and Safont, M.P. Jordà (eds.) (2007). *Intercultural Language Use and Language Learning*, Springer.

Nilson, B. L. (2010). Teaching at its best A Research-Based Resource for College Instructors, Third edition Jossey – Bass a Wiley imprint

Samovar, A. L., Porter E. R., McDaniel R. E. (2007). *Intercultural communication*, Wodsworth Cengage learning , 12th edition

Jenkins, J. (2009). *Word Englishes,* 2nd editionsRoutledge London and NewYork.

Pierre, P. (2004). *Pertinence de la recherche qualitative* , në Alex Mucchielli Dictionnaire *des méthodes qualitatives en sciences humaines,* Armand Colin, Paris,

Woods, P. (2006). Qualitative research Faculty of Education, University of Plymouth.

Byram, M., Gribkova B., Starkey H. (2002). *Developing the intercultural dimension in language teaching Council of Europe*, Strasbourg.

Mari Zherar P. , Rozhje K.*(X). Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore*. Pedagogjia në zhvillim praktika metodike.

Cosaceanu, A. (2010). *Politiques linguistiques et réforme des manuels de langue en Roumanie* , Paris

Graddol, D. (2006). *English next*. December British Council.

McKay, Lee S. (2002). *Teaching English as an international language; rethinking goals and approaches,* Oxford University press.

Xega, E. (2013). Contextualization of intercultural aspects displayed in English textbooks in the Albanian classes, Korca city Menon journal of educational research 22- 34.

# ASPEKTE TË SHFAQJES SË AFTËSIVE MENAXHUESE DHE KOMUNUNIKUESE NË KLASË NË FUNKSION TË NJË MËSIMDHËNIEJE EFEKTIVE NË ARSIMIN FILLOR

**EVIONDA PYLLI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Edukimit**

**Përmbledhje**

Komunikimi ka qenë dhe vazhdon të jetë i pranishëm në jetën tonë. Çdo veprimtari e jona varet në një masë të madhe nga ky proces sa dinamik, kompleks dhe simbolik. Ka qenë pikërisht komunikimi ai i cili ka ndihmuar njerëzimin dhe nevojat e përhershme të tyre për t'u shprehur dhe për t'u shoqërizuar. Ai konsiston në transmetimin e mesazheve me anë të fjalëve, gjesteve, intonacionit të zërit, vështrimit etj.

Të gjitha llojet e komunikimeve janë të rëndësishme , sepse na ndihmojnë të përcjellim informacionin e dëshiruar, por komunikimi i mësuesit me nxënësit është thelbësor. Për këtë arsye komunikimi sot është një nga argumentet më të rëndësishme dhe më të diskutueshme në mjediset edukative. Mësuesi, ndër të tjera, ka përgjegjësi të "kapë" emocionet, synimet dhe kuptimet e nxënësve.

Në këto kushte përgatitja e mësuesve kërkon aftësi komunikuese dhe menaxhuese të lidhura ngushtë me të parat, pa bashkëveprimin e të cilave, procesi i transmetimit të dijeve në klasë nuk do të mund të realizohej me sukses.

**Fjalët çelës :***Komunikim, menaxhim, sjellje , proces mësimor, efektivitet*

**Abstract**

Communication has been and continues to be present in our life. Each of our activities depends on a

significantly from this process as dynamic, complex and symbolic. He was communicating exactly who helped

humanity and their permanent needs to express and to shoqërorize . It consists in transmitting messages through words, gestures, voice intonation, observation, etc.

All types of communications are important because help us redirect the desired information, but teachers communication with students is essential. For this reason communication today is one of the most important arguments and most controversial in educational environments. The teacher has the responsibility,among others,

to "catch" the emotions, intentions and meanings of students. In these conditions the preparation of teachers requires communication and management skills closely related to the first, without whose cooperation the transmission of knowledge in the classroom can not be successfully accomplished.

**Key words:** *communication, management, behavior, learning process, effectiveness*

Mund të thuhet me bindje se një komunikim i mirë mësues -nxënës ndikon drejtpërdrejt në procesin mësimor.Në kushtet kur mësuesi shihet si model nga ana e nxënësve në çdo veprimtari që ai kryen, procesi i komunikimit të tij, nuk bën përjashtim. Duke komunikuar me nxënësit në mënyrë korrekte, mësuesi në një farë

mënyre u dikton atyre mënyrën se si duhet të komunikojnë edhe ata me njëri - tjetrin në klasë apo jashtë saj. Po kështu, një komunikim i mirë nënkupton një njohje më të mirë e bashkëvepruese të klasës, pra të mësuesit e nxënësve. Kjo i shërben jo vetëm punës së tij si përcjellës i informacionit, por edhe rezultateve pozitive konkrete të procesit mësimor-edukativ në përgjithësi.

Duket se është bërë tashmë kërkesë e kohës që mësuesit e të gjitha niveleve të pasurojnë formimin e tyre të përgjithshëm me informacione që ndihmojnë në komunikimin e tyre me nxënësit në mjediset shkollore ( Jashari, 2013). Sipas Gordon (1974), çelësi për një marrëdhënie të mirë mësues -nxënës si dhe për rezultate pozitive në procesin mësimor, është që mësuesi të kërkojë dhe të kuptojë se çfarë i shqetëson nxënësit. Madje ai ka përpunuar një procedurë e cila i ndihmon mësuesit të diagnostikojnë situatat normale dhe problematike të nxënësve, në mjedisin shkollor.

Blumi (1976) vëzhgoi 15 studime dhe arriti në përfundimin se ekziston një lidhje e ngushtë midis të nxënit dhe vëmendjes nga ana e nxënësve. Kjo e fundit mund të arrihet vetëm nga mësuesi përmes aftësive menaxhuese të tij. Komunikimi verbal dhe joverbal, së bashku me menaxhimin e klasës, është faktor kryesor që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies, konkretisht në procesin e të nxënit (Cara, 2010).

Studiues të tillë si Sokolone, Garret dhe Sadker (1986), janë të mendimit se mësuesi ndër të tjera ka përgjegjësi të "kapë" emocionet, synimet dhe kuptimet e nxënësve. Në këto kushte përgatitja e mësuesve kërkon aftësi komunikuese dhe menaxhuese të lidhura ngushtë me të parat, pa bashkëveprimin e të cilave procesi i transmetimit të dijeve në klasë nuk do të mund të realizohej me sukses.

Studiuesit Erikson dhe Shult ( 1977) janë shprehur se hapat përmes të cilave mund të realizohen proceset e mësipërme janë të shumta, por kryesisht ato konsistojnë në vendosjen e një atmosfere pozitive në klasë, në planifikimin e rregullave, procedurave dhe veprimtarive, në familjarizimin e nxënësve me këto rregulla, procedura e veprimtari etj.

Në këtë pikë mekanizmi i cili mundëson zhvillimin veprimtarive të mësipërme tek nxënësit është mësuesi i cili në rastin konkret shërben si "udhërrëfyes (Gjini, 2008). Sipas Grin dhe Weade (1985), procese të tilla sjellin edhe pasoja në mjedisin shkollor. Për këtë arsye është e domosdoshme që mësuesi të "ndryshojë" ndonjëherë rregullat me qëllim përfshirjen e të gjithë nxënësve në orën e mësimit. Ky proces nuk mund të kryhet përveçse nga një mësues i cili di të "komunikojë" dhe të "menaxhojë" klasën. Kështu, nëse kërkesa e parë plotësohet, kërkesa e dytë ka shumë mundësi të realizohet më lehtë. Me qëllim që një proces i tillë të realizohet me sukses, Jere Broufi dhe Evertson (1978) përveç të tjerash, shohin domosdoshmërinë e marrjes parasysh të sjelljes së nxënësve dhe nevojat e tyre.

**Objektivat e punimit**

-Të evidentohet roli i komunikimit në klasë.
-Të shqyrtohen dy llojet kryesore të komunikimit si faktorë ndikues në cilësinë e mësimdhënies.
-Të përcaktohet lidhja e drejpërdrejtë midis aftësive komunikuese dhe menaxhuese të mësuesit dhe mësimdhënies produktive.
-Të argumentohet rëndësia e rolit të mësuesit me aftësi menaxhuese.
-Të argumentohen përparësitë e krijimit të një klime komunikuese në klasë.
-Të analizohet nevoja e përvetësimit të aftësive menaxhuese dhe komunikuese nga ana e mësuesit si faktorë thelbësorë në procesin mësimor.

**Metodolgjia**

Puna analitike për këtë studim përfshiu analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Ajo përfshin një rishikim të literaturës ekzistuese si dhe metodat cilësore.

**Menaxhimi i sjelljes së nxënësve, përbërës i rëndësishëm në menaxhimin e klasës.**

Nga momenti kur mësuesi hyn në klasë, para tij shfaqen një sërë detyrash. Po kështu e gjithë veprimtaria që pritet të zhvillohet në klasë do të kryhet në një kohë të kufizuar prej 45 minutash. Nga ana tjetër, ne dimë se faktorët që ndikojnë në procesin mësimor janë të shumtë. Pikërisht, në këtë moment fillojnë dhe sfidat e mësuesit, detyra e parë e të cilit konsisiton në menaxhimin e klasës.

Kur flasim për menaxhim të klasës, me të drejtë mendojmë se këtu futet menaxhimi i ambientit fizik, vendosja e qetësisë, tërheqja e vëmendjes së nxënësve etj. Një sfidë po kaq e rëndësishme sa të parat është edhe "menaxhimi i sjelljes së nxënësve", i cili duket se ka të njëjtin ndikim në procesin mësimor (Karaj, 2008). Ky është një veprim i cili nuk mund të realizohet pa disa masa konkrete nga ana e mësuesit, të cilat kërkojnë edhe domosdoshmërine e zbatimit të tyre sipas hapave përkatëse. Ajo çka kërkohet si fillim është ndjekja me rigorozitet e një sërë procedurave dhe hapave kryesore, të cilat synojnë krijimin e një klime pozitive në klasë. Disa faktorë kanë ndikim të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë, në procesin mësimor; disa të tjerë kanë ndikim të mëvonshëm ose të tërthortë. Kështu, faktorë të tillë si menaxhimi i ambientit fizik të klasës, ai sjelljes së nxënësve, mënyrat e komunikimit mësues-nxënës etj., duket se ndikojnë sa në mënyrë të drejtpërdrejtë aq edhe të tërthortë. Menaxhimi me sukses i të gjithë përbërësve të klasës do të ecë paralelisht me rezulatet pozitive në procesin mësimor, kushte këto, të cilat premtojnë për një mësimdhënie efektive. Kështu, ambienti fizik do të përmirësojë ndjeshëm të nxënët përmes përfshirjes aktive të tyre. Këtu mund të përfshihet edhe krijimi i hapësirave të përshtatshme që lehtësojnë përdorimin e materialeve nga ana e nxënësve. Me fjalë të tjera, jemi ende duke diskutuar mbi përmirësimin e kushteve teknike të klasës.

Shtrohet pyetja: Po çfarë hapash duhet të ndërmarrë një mësues për të "rregulluar sjelljen e nxënësve"? Këtu nuk bëhet më fjalë për krijimin apo përmirësimin e kushtetve teknike (fizike), por metodologjike (Karaj, 2008). Në fillim mësuesit i duhet të identifikojë dhe të dallojë qartë sjelljet pozitive dhe sjelljet negative të nxënësve. Nga ana tjetër, mësuesi duhet t'i ketë të qarta idetë mbi atë çka mund të quhet sjellje pozitive dhe sjellje negative, sepse vetëm në këtë mënyrë do të shmangë subjektivizmin në gjykimin e sjelljeve të nxënësve. Kur ky moment është tejkaluar dhe sjellja negative nga nxënësi është shfaqur, mësuesi kalon në hapin tjetër. Tashmë atij i duhet të kuptojë apo nënkuptojë faktorët që çuan nxënësit në shfaqje të sjellje jo të përshtashme për klasën. Ky është një proces i cili mund të realizohet jo i plotë dhe plot me keqkuptime nëse mësuesi nuk ka qenë vigjilent ndaj çdo sjelljeje të të gjithë nxënësve; dhjetë minuta më parë, një orë më parë apo disa ditë më parë. Edhe në këtë pikë mësuesi bën paralajmërimet e nevojshme, ndoshta jo në emra të përveçëm , në varësi të sjelljes së shfaqur,në rastin kur kjo sjellje cilësohet nga mësuesi si një sjellje negative, kur paralajërimi apo thjesht tërheqja e vëmendjes nuk ka funksionuar.

Një nga masat konkrete të menaxhimit të sjelljes së nxënësve është përforcimi (Karaj, 2008). Jemi mësuar që përforcimi të

jetë një objekt ose ngjarje të cilën ne e kemi përcaktuar si të drejtë përkundrejt një ngjarjeje të mëparshme, që në rastin konkret është një sjellje jo e përshtatshme e nxënësit për ambientin e klasës. Këtu mund të futen grindjet e ndryshme mes nxënësve, refuzimi për të kryer detyrat e përcaktuara etj. Procesi i përforcimit në klasë është i kuptueshëm dhe i realizueshëm, pasi e gjithë kjo veprimtari zhvillohet në ambientin e klasës. Një çështje e rëndësishme që duhet diskutuar këtu, është edhe pasoja që do të shkaktojë ky përforcues, i cili pritet të jetë në funksion të neutralizimit të situatës. Konkretisht një përforcues, mund të jetë një lavdërim , ose një ngritje e tonit të zërit nga ana e mësuesit drejtuar nxënësit që ka shfaqur sjelljen që po diskutojmë. Në të dyja rastet, lipset që përforcuesi të ruajë të njëjtin nivel ose të rrisë shpeshtësinë e përsëritjes së sjelljes. Pra, një lavdërim mund të përcaktohet si përforcues nëse një nxënës vazhdon të mësojë dhe punojë po me të njëjtat ritme ose dhe më tepër. Një rezultat të kundërt do të përftonim, kur një nxënës të vetëkënaqet nga puna e deritanishme e tij dhe lavdërimi është duke shkaktuar një fenomen të kundërt; atë të frenimit të punës. Në këtë rast themi se lavdërimi nuk mund ta kryejë rolin e përforcuesit. Të njëjtën gjë mund të themi edhe në rastin kur ngritjen e tonit të zërit nga ana e mësuesit e kemi përcaktuar si përforcues, vetëm se efekti që do të ketë ky përforcues kërkohet të jetë i ndryshëm.

Konkretisht kërkohet që sjellja jo e mirë që do të manifestojë nxënësi, të reduktohet përkundrejt "të bërtiturës" nga ana e mësuesit. Duhet theksuar se kur flasim për përforcues, njëherazi kuptojmë vlerësimin, shpërblimin dhe motivuesit( Karaj, 2008).

Së dyti, nxitja e angazhimit (Karaj, 2008). Kur flasim për angazhim, duhet të theksojmë faktin se në kontekstin shkollor ai lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me motivimin e nxënësve. Me fjalë të tjera, drejtimi dhe orientimi i nxënësve janë aftësi të cilat do të shfaqen që në minutat e para të një ore mësimi. Më pas angazhimi nga ana e mësuesit do të jetë pa mbikëqyrje, që do të thotë se nxënësit vazhdojnë të mbahen të angazhuar pikërisht për shkak të punës shumë të mirë menaxhuese të mësuesit në fillim të orës së mësimit dhe përgjatë saj. (Karaj, 2008).

Së treti administrimi i problemeve (Musai, 1999) . Këtu nuk është fjala për probleme që lidhen me procesin e të nxënit, sesa me menaxhimin e situatave problematike të shkaktuara nga nxënësit si rezultat i sjelljes jo të përshtashme të tyre. Në këtë rast vihen në pikëpyetje dy procese njëkohësisht: së pari përfshirja aktive e tyre në orën e mësimit dhe së dyti, rezultatet e tyre në procesin e të nxënit. Nuk janë të pakta rastet kur për shkak të grindjeve mes një nxënësi dhe një mësuesi apo midis një grupi nxënësish, të përfshihet e gjithë klasa. Në këto kushte, " të përjashtuar" nga ora e mësimit, rrezikojnë të mbeten jo vetëm nxënësit e përfshirë në grindje, por edhe nxënësit e tjerë të klasës.

Zgjidhja e problemit të krijuar kërkon një trajtim me seriozitet dhe profesionalizëm të situatës nga ana e mësuesit. Në këtë pikë, ai do të ndodhet përballë dy alternativave; të "harxhojë kohën mësimore" duke u përpjekur të "rregullojë sjelljen e nxënësve problematikë" apo të injorojë situatën dhe të vazhdojë mësimin pavarësisht situatës së krijuar në klasë?

Një mësues i mirë, me aftësi menaxhuese po kaq të mira, do të jetë i aftë që në këtë rast të zgjedhë alternativën më të mirë. Në rastin e menaxhimit të sjelljes së nxënësve , zgjedhja më e mirë nuk është as e para dhe as e dyta të marra më vete. Në raste të tilla situata e

dëshiruar do të ishte vendosja e një klime normale në klasë, në kohën më të shkurtër të mundshme, veprimtari e cila në zbatim duket e vështirë për t'u realizuar. Do të kthehemi edhe një herë tek hapat që u përmendën më lart, të cilat siç u theksuan janë të një rëndësie thelbësore në trajtimin e rasteve kur nxënësit shfaqin sjellje jo të përshtashme. Para së gjithash, mësuesi duhet të kuptojë dhe të dëgjojë me vëmendje arsyen për të cilën një nxënës ka shfaqur atë lloj sjelljeje dhe më pas të marrë masa konkrete hap pas hapi, me qëllim normalizimin e situatës. Vetëm në këtë mënyrë, gjendja emocionale e nxënësit apo nxënësve do të ketë prirjen të normalizohet dhe procesi mësimor do të zhvillohet normalisht.

Duke vepruar në këtë mënyrë, një mësues ka parandaluar gjithashtu edhe një konflikt të mundshëm brenda mjediseve të klasës , menaxhimi i të cilit në stade të tjera do të ishte më i vështirë.

**Komunkimi verbal dhe joverbal, parakushte të cilësisë në arsimin fillor**

Çdo individ, mund të komunikojë me të tjerët përmes dy llojeve kryesore të komunikimit që janë komunikimi verbal dhe ai joverbal (Cara , 2008). Procesi i transmetimit të informacionit finalizohet nga një administrim i mirë i tërësisë së vlerave, besimeve, opinioneve, qëndrimeve si dhe përvojës personale të personave të përfshirë në komunikim. Sjellja joverbale në vetvete, qartëson, plotëson ndonjëherë edhe kundërshton mesazhin verbal. Mund të ndodhë që fjala të jetë e tepërt dhe komunikimi joverbal te realizojë me sukses qëllimin kryesor që konsiston në transmetimin e mesazhit.

Po cilat janë shfaqjet e komunkimit joverbal në mjedisin e klasës?

Mësuesi në klasë komunikon me nxënësit përmes fjalëve dhe përmes shumë mënyrave të tjera si pjesë të komunikimit joverbal. Duke qenë se aspekti joverbal i komunikimit është i përbërë më shumë nga veprime sesa nga fjalë, ai do të përfshijë të ashtuquajturën "gjuhë të trupit", ku përmendim: shprehjet e fytyrës, lëvizjet e trupit, (duarve kryesisht), gjeste të ndryshme, prekjet (kontaktet me mjetet që ndodhen në klasë), mënyrat e hedhjes së vështrimit drejt nxënësve, mënyra se si vishet etj.

Mirëpo studiuesit rekomandojnë që në komuni-kimin joverbal të përfshihet edhe paralinguistika ose ato që mund të quhen ndryshe sjelljet vokale. Në sjelljet vokale përfshihen tinguj që nuk janë fjalë, si ritmi i të folurit, toni i zërit, pauzat se sa shpejt apo se sa ngadalë flasim dhe se sa shumë ose sesa pak flasim (Kolstenik, 2010) .

Sa më lart, shfaqja e sjelljeve joverbale nga ana e mësuesit duhet të jetë e përshtatshme për ambientin e klasës, në kushtet kur nxënësit ndikohen sadopak nga mënyrat e komunikimit të mësuesit. Nga ana tjetër kontrolli verbal ose joverbal nga ana e mësuesit kërkon domosdoshmërinë e përvetësimit të një sërë rregullave që lidhen edhe me etikën profesionale. Po kështu në ditët e sotme, kur liria e lëvizjes është e madhe se kurrë, mësuesit dhe nxënësit kanë përkatësi të ndryshme ekonomike -shoqërore e kulturore. Në këto kushte, përgjegjësia e mësuesit dyfishohet pasi komunikimi joverbal i përshtatshëm, kthehet në domosdoshmëri për ecurinë normale të procesit mësimor. Në kontekstin shkollor, në lehtësimin e procesit të komunikimit joverbal ndikojnë ndër të tjera këto elemente:

**1.**Paraqitja fizike e mësuesit. Kompetenca e mësuesit fillon me paraqitjen e jashtme të tij dhe me seriozitetin që shfaq përmes veshjes. Në këtë pikë, ndërveprimi mësues-nxënës priret të jetë frytdhënës (Cara, 2010).

**2.**Mjedisi i përshtatshëm i klasës, i pajisur me mjete e materiale lehtësisht të përdorshme nga nxënësit.

**3.**Distanca midis mësuesve dhe nxënësve, ose e njohur ndryshe si "hapësira shoqërore e klasës" .

**4.** Së fundi lëvizjet, pozicionet, gjestet me trup e gjymtyrë, mimika e fytyrës, mënyra e shikimit, etj.

Po kështu duhet të bëjmë dallimin midis shfaqjes së një sjelljeje korrekte dhe shfaqjes së një sjelljeje jo korrekte në ambientin e klasës nga mësuesi kundrejt nxënësve. Të dyja llojet e komunikimveve verbale ose joverbale, ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e të nxënit përmes dy mënyrave. Një komunikim i mirë do të nxitë motivimin tek nxënësit dhe një komunikim jo i mirë do të shkaktojë efektin e kundërt; atë të frenimit të motivimit tek nxënësit.

Ashtu siç është e rëndësishme shfaqja e sjelljes korrekte nga ana e nxënësve, po kaq e rëndësishme është edhe shfaqja e komunikimit korrekt verbal ose joverbal nga ana e mësuesit. Kjo është arsyeja pse duhet marë në konsideratë ndikimi i tyre në procesin mësimor. Një sjellje korrekte verbale nuk është e vështirë të evidentohet pasi ajo kuptohet qartazi përmes fjalëve të shprehura. Çështja ndërlikohet në rastin e llojit tjetër të komunikimit, atij joverbal.

Një sjellje korrekte joverbale e mësuesit duket se ka ndikim në klimën e krijuar në klasë si një klimë mbështetëse, inkurajuese dhe dashamirëse për nxënësit dhe zhvillimin e orës mësimore. Ajo çka pritet të përftohet nga ky "bashkëpunim" do të jetë krijimi i një marrëdhënieje pozitive mësues-nxënës. Do të jetë pikërisht kjo marrëdhënie e cila do të përbëjë bazën si "lëndë e parë" për zhvillimin e një mësimdhënieje efektive. Ndërsa komunikimi jokorrekt, jo vetëm që i demotivon nxënësit në punën e tyre mësimore, por pengon gjithë procesin mësimor duke çuar në disa raste edhe në dështim të pjesshëm ose të plotë të tij.

Shtrohet pyetja: Si ndikon komunikimit verbal në procesin mësimor? Komunikimi verbal është një nga elementet kryesore që bëjnë diferencën në shprehjen e qartë të mendimeve, opinioneve, bindjeve apo qëndrimeve. Si i tillë nuk është e vështirë të parashikohet se ndikimi i këtij komunikimi është sa më i dallueshëm aq dhe më i shpejtë karahasuar me komunikimin joverbal.

Që një komunikim të jetë efektiv, verbal ose joverbal qoftë ai, kërkon domosdoshmërinë e shfaqjes së durimit dhe qetësisë nga ana e të rriturve, që në këtë rast janë mësuesit. Ata mund dhe duhet të dëgjojnë atë që fëmijët kanë për të thënë. Dëgjimi në këtë rast do të thotë shumë më tepër sesa të mos flasësh e të rrish në qetësi. Kjo nënkupton mirëkuptimin e asaj që thuhet, pavarësisht përmbajtjes. Gjithashtu kjo nënkupton edhe respektimin pa kushte te fjalës, pavarësisht respektimit ose jo të rregullave gjuhësore e strukturore. Kjo duket të jetë e vetmja mënyrë që nxënësit të kuptojnë se idetë dhe mendimet e tyre, por edhe ato çështje që ata i shqetësojnë, vlerësohen nga dikush tjetër. Në rastin kur mendimi i tyre vlerësohet nga një mësues, kjo do të thotë shumë për ta. Mandej ata kuptojnë automatikisht se dhe ata vetë janë të rëndësishëm dhe se meritojnë respekt dhe mirësjellje. Rritja e vetëvlerësimit të tyre do të përkthehet në më shumë përkushtim dhe më shumë përgjegjshmëri në mësim. Në këto kushte, faktorë të tillë si dëgjimi me kujdes, ndërveprimi pozitiv mësues- nxënës, komunikimi korrekt, shfaqja e afërsisë me nxënësit, respekti reciprok etj., do të kenë ndikim të menjëhershëm në procesin mësimor. Midis tyre do të vendosen marrëdhënie gjithnjë e më pozitive, të cilat do të reflektohen shumë shpejt në të gjitha hallkat e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në këtë mënyrë nxitet dhe

fryma bashkëpunuese e cila rrit mundësitë për rritjen e cilësisë në arsim.

Një detyrë me rëndësi që shfaqet para mësuesve është se ai duhet jetë i çliruar nga fjalët, shprehjet, qëndrimet dhe veprimet që bien ndesh me normat e pranuara bashkarisht. Shtrohet pyetja: Si duhet kuptuar kjo kërkesë nga ana e mësimdhënësve? Kjo mund të shprehet përmes kujdesit për të mos fyer asnjë nxënës nëpërmjet fjalëve, shprehjeve, tonit apo ideve përçmuese që mund të ketë. Në komunikimin e tij verbal ose joverbal në klasë, një mësues i mirë shpreh dhe motivon qëndrime që shprehin kulturë dhe respekt për njëri tjetrin; në këtë rast për mësuesin, apo për respektin mes nxënësve.

Të gjithë nxënësit kanë nevojë të ndjehen të mirëpritur dhe të dëshiruar në ambientet e shkollës, e mandej në ambientet e klasës, në të cilën kalojnë një pjesë të mirë të ditës. Ata duan të ndihen të përfshirë në ambientet e të nxënit, në grupin e tyre shoqëror. Komunikimi dhe afeksioni nga ana e mësuesit e mbështesin nxënësin shumë nga ana emocionale.Me anë të këtij komunikimi nxënësit krijojnë përshtypjet dhe pritshmëritë e tyre për ecurinë në mësime dhe në lidhjet shoqërore me bashkëmoshatarët. Nga sa u tha më lart, rezulton se një komunikim miqësor dhe dashamirës i ndihmon ata direkt në procesin e të nxënit, përmes motivimit të brendësuar. Rezultatet pozitive që mund të përftohen nga një komunkim i mirë mësues -nxënës nuk përfundojnë në klasë, por shkojnë më tej duke kaluar tashmë mjedisin e klasës.

Mësuesi mund dhe duhet të zhvishet nga fraza dhe fjalë pa vend që shprehin ose burojnë nga gjendje emocionale negative. Konkretisht dashamirësia dhe komunkimi miqësor me nxënësit, do të çojë në shmangien e fajit dhe të ankthit në situata të vështira. Në këtë mënyrë ata mësojnë të jenë të dashur dhe të ndjeshëm ndaj shokëve në klasë dhe bashkëmoshatarëve në komunitet, ndërkohë që mësimnxënia është arritur në mënyrën më të mirë të mundshme.“Teoria humaniste e motivimit e Maslowt , e trajton nxënësin si një qenie humane që ka nevoja, të cilat i ka klasifikuar në nivele hierarkike (Gjini, Piluri 1998). Ndër të tjera do të përmendim vetëm dy prej tyre në kuadër të rëndësisë që ka shprehja e afërsisë dhe komunikimit nga mësuesi.

**1.**Nevojat e dashurisë dhe të përkatësisë. Nxënësit kanë nevojë të ndihen të dashur nga mësuesja, prindërit, bashkëmoshatarët. Në momentin që ata e kanë fituar këtë ndjenjë ndihen të motivuar dhe mund të rritin ndjeshëm rezultatet e tyre

**2.** Nevoja e respektit. Nxënësit kanë nevojë të respektojnë veten dhe të ndihen të respektuar. Edhe plotësimi i kësaj nevoje ndikon në motivimin dhe rritjen e mësimnxënies.Në bazë të reagimeve të të tjerëve nxënësit e kuptojnë edhe ndjenjën e respektit ndaj tyre. Rrugët dhe mënyrat përmes të cilave ky respekt shprehet, nuk mund të jenë tjetër, përveçse me fjalë të ngrohta dhe me dashamirësi kundrejt nxënësve, të cilët me aq kërshëri presin fjalën e mirë të mësuesit. Po kështu, përdorimi me kujdes i përforcuesve na çon në një formim të respektit të nxënësit për veten e tij dhe respektin e të tjerëve ndaj tij. Të gjitha këto veprime duhet dhe mund të forcohen vetëm përmes komunikimit dhe një vëmendjeje të vazhdueshme kundrejt nevojave të nxënësve.

Lind pyetja : Pse është e rëndësishme vëmendja e mësuesit?

Për t’iu përgjigjur si duhet kësaj pyetjeje, fillimisht duhet theksuar fakti se vëmendja e mësuesit, ndaj çdo aktiviteti të nxënësit apo ndaj vetë nxënësit, luan rol kyç në arritjen e sjelljeve të dëshiruara nga ana e nxënësve, pasi të qenit gjithnjë i

pranishëm në sytë e mësuesit i jep atij siguri dhe besim. Përdorimi më kujdes i lëvdatave, dhënia e stimujve në momentin e duhur etj., luajnë një rol të rëndësishëm në motivimin e nxënësve. Përforcuesit duhet të alternohen dhe të vijnë natyrshëm me qëllim që të arrihet sjellja e dëshiruar. Puna e pavarur në klasë ka rëndësinë e saj, por nxënësit (sidomos ata që kanë vështërsi në të nxënë) kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm të mësuesit. Ata kanë nevojë për durim, dhe vëmendje. Pothuajse asnjë veprimtari që zhvillohet brenda mureve të klasës, nuk mund të ndodhë pa bashkëpunimin frytdhënës mësues-nxënës, mbështetur tek një komunkimi po kaq i frytshëm.

Tërësia e veprimtarive që zhvillohen në klasë si planifikimi i veprimtarive, përgatitja e materialeve, kërkesat specifike të nxënësve, parashikimi i problemeve, parashikimi i zgjidhjes së tyre, përzgjedhja e rregullave të ndjekjes së nxënësve dhe të nxënit të tyre etj., shtrojnë si domosdoshmëri komunkimin efektiv mësues- nxënës.

Një komunikim korrekt midis mësuesit dhe nxënësve, verbal ose joverbal qoftë ai, do të sjellë patjetër rezultate të dukshme dhe të matshme në mësim. Mësuesi duke qenë në sinkron me respektimin e individualitetit të nxënësve në të njëtën kohë ka respektuar dhe dinjitetin e tij. Për të njëtën arsye mësuesi duhet ta edukojë tolerancën dhe shprehitë e nevojshme të pjesëmarrjes në diskutimet në klasë e jo thjesht në diktim të njohurive. Duke përcjellë frymën tolerante, njëherazi ka ndihmuar në forcimin e mirëkuptimit dhe të miqësisë midis nxënësve si brenda klasës po kështu dhe jashtë saj.

Krijimi i gjendjes emocionale pozitive në klasë është një tjetër parakusht i motivimit të brendshëm të nxënësve, i cili do të pasohet patjetër me rezultate pozitive në procesin mësimor.

**Përfundime**

Keqkuptimet në ambientet e klasës janë fenomene me të cilat ndeshemi shpesh. Po kështu edhe shfaqjet e sjelljeve jo të përshatshme të nxënësve nuk janë të rralla. Situata të tilla kërkojnë domsodoshmërinë e përvetësimit të aftësive menaxhuese nga mësuesi.

Menaxhimi i sjelljes së nxënësve bëhet i rëndësishëm për dy arsye: së pari shmanget një konflikt i mundshëm dhe së dyti ora mësimore shkon ashtu siç është programuar. Mënyra se si mësuesi do të menaxhojë situatat shqetësuese në klasë do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin mësimor.

Po kështu procesi i komunikimit është i kudondodhur dhe i rëndësishëm në të gjitha sferat e jetës shoqërore, por komunikimi në kontekstin shkollor është i një rëndësie specifike. Këtu përfshihet komunikimi i mësuesit me nxënësit, i nxënësve me njëri -tjetrin apo i nxënësve kundrejt mësuesit.

Si komunikimi verbal i mësuesit ashtu dhe ai joverbal, ndikojnë në një masë të madhe në ecurinë normale të procesit mësimor.

Respektimi i rregullave të etikës profesionale nga mësuesi si dhe marrja parasysh e nevojave të nxënësve në përputhje me moshën, kthehen në faktorë me rëndësi në procesin e mësimnxënies.

Mungesa në aftësitë komunikuese nga ana e mësuesve, do të shkaktojë probleme jo vetëm në menaxhimin e sjelljes së nxënësve, por edhe në cilësinë e orës mësimore. Në këto kushte është detyrë e mësuesit , të ofrojë modele, t'i përvetësojë dhe t'i shfaqë aftësitë komunikuese në funksion të një mësimdhënieje efektive.

Aftësitë komunikuese dhe menaxhuese bëjnë që organizimi në kohë dhe hapësirë të rritë të nxënit dhe të shfaqë efektivitet në procesin mësimor.

**Bibliografi e shfrytëzuar**

Albanian Helsinki Committee (2007). "*The studying of minorities politics and financial strategies in Albania*", Tiranë,
Alderman, M, K. ( 2008). *Motivation for Achievment*, Routlege 711 Third Avenue, New York.
Cara, M.(2010). *Pedagogji Komunikimi Personaliteti-Bazat e Komunkimit në klasë*.
Dibra, G. (2002). Motivimi i nxënësve me problemet aktuale të shkollës, "Cama-Pipa", Shkodër,
Gazda, G . M.(2006). *Human relations development*.—a manual for educators .(7th edition)Boston, Allyn and Bacon
Gjini, F; Piluri, A. ( 1999). *Hyrje në Psikologji*, Shtypshkronja Ylli, Elbasan.
Hoti, I.; Kazazi, Nj. (2009). *Didaktikë e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë,
Instituti i Kurrikulave dhe Standardeve (2005, 2008). *Shkolla 9-vjecare. Programe lëndore klasa I*.
Jashari, A. (2013). *ABC e të menduarit kritik*, Korçë.
Kane, Th. (2010). *Si të shkruajmë shqip*, CDE
Karaj, Th. (2008). *Menaxhimi i klasës*, (Psikologji e zbatuar në mësimdhënie), Tiranë.
Kostelnik, J. M., Gregory K. M., Soderman K. A., Whiren P. A. (2010). *Guiding children's Shoqëror Developmen and Learning,* WADSWORTH, (7th ed) ,USA ,fq 61-106)
Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*, CDE, Tiranë.
Musai, B. (1999). *Psikologji edukimi,* CDE, Tiranë.
Riggio, R . (2006), *Nonverbal skills and abilities*, Manusov & M.Paterson (Eds)
Wsoolfolk, A. (2011). *Psikologji edukimi*, CDE, Tiranë.

# PËRDORIMI I KORPORAVE NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS ANGLEZE NË AUDITOR (USING CORPORA IN THE ENGLISH LANGUAGE TEACHING CLASSROOM)

**JULIANA ÇYFEKU**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Qëllimi i prezantimit të këtij punimi është parashtrimi i disa pyetjeve hulumtuese në praktikën mësimore, duke dhënë informacion hap pas hapi për mësuesit, studentët dhe hulumtuesit në lidhje me përdorimin dhe avantazhet e përftuara të korporave në mësimin e gjuhës angleze në auditor. Ai përcakton linguistikën e korporave dhe korporat si një mjet për të kuptuar më mirë anglishten si një gjuhë e huaj.

Për më tepër, ky punim studimor ndihmon mësuesit dhe studentët për të eksploruar dhe për të sjellë burime të korporave dhe të mësuarit të vazhdueshëm me materiale autentike në auditoret e mësimit të anglishtes. Ai pasqyron informacion dhe udhëzime të strukturuara për të krijuar nje gamë materialesh dhe aktivitetesh në auditor, duke përfshirë dhe krijimin e korporave për t'iu përgjigjur nevojave specifike e gjuhësore të studentëve.

**Fjalë çelëse:** *korpora, Linguistika e korporave, mësimdhënia e anglishtes në auditor, analizë gjuhësore, burime të korporave.*

**Abstract**

The goal of presenting this paper paper is to address some classroom research questions by providing the step-by-step information for teachers, university learners and researchers concerning the use and the benefits of corpora into the English language classrooms. It defines Corpus linguistics and corpora as a vehicle to better understand English as a foreign language.

Moreover, the present paper assists teachers and learners to explore and bring the resources of corpora and hands-on learning with authentic materials into the English language classroom. It provides background information and principled instructions for creating a range of materials and activities into the classroom, including how to create corpora to address specific and linguistic class needs.

**Key words:** *corpora, Corpus linguistics,English language teaching classroom, linguistic analysis, corpora resources.*

One of the biggest challenges in teaching and learning English as a foreign language or for specific purposes is to help students acquire the immense vocabulary they need in the short time available for their language instruction. Generally speaking, learning English as a foreign/ second language is a process that requires great efforts not only from the learners' part but even from the teachers themselves. Nowadays it has totally become a necessity which requires commitment in learning from all kinds of learners and practice educators as well.

This research stresses the importance of applying corpora for ESP vocabulary learning. It sheds light on the

effective outcomes a demanding teacher can obtain alongside the overall English learning and teaching process and its final product (achievement) in the academic setting. Moreover, the goal of this paper is to provide teachers, student learners and teachers-in-training with the background and information needed to use corpora as a resource for developing materials and hand-on activities for a variety of classroom English language-teaching situations.

Specifically the present paper addresses some research questions for the forth bringing of the issues it covered in the overall flow of it. These questions include:

- What is a corpus?
- Is one corpus as good as the text?
- Should we use a corpus to teach our students English?
- How can we use a corpus to teach our students English?
- How can we adapt and develop materials from corpora for use in the classroom?

We found of great importance to relate the implication of the vocabulary usage in English corpora. Specifically, Corpus linguistics is a means of knowledge that helps teachers and learners to better understand language. It provides a vehicle for bringing natural language into the classroom in a way that evolves learners through hands-on activities interacting with "real" language. In recent years there has been an increased interest in corpus linguistics along with the demand and necessity to use corpora for EFL/ESP instruction. Relatively, few researchers demonstrated much interest in collecting or studying corpora of English learner language output. Thorough investigations into English learner corpora began to proliferate towards the end of the 1980s (Gragner, 2004). The seminal 1998 monograph edited by Sylviane Granger, entitled *Learner English on computer*, helped establish contrastive inter-language analysis as an accepted methodology for studying learner corpora. Corpora based comparisons of writing produced by different groups of English learners with those made by native English speakers, reveals to both learners and researchers which language features are used and misused by different groups of learners. In addition, the incorporation of contrastive inter-language analysis is considered as an important field of study by a range of researchers to examine the occurrences of various linguistic phenomena represented through authentic materials of the English thesaurus and other foreign languages under investigation. Besides using corporawe can examine the degree of student writer's visibility in any required written creations by various university-level learners. The present research aims at providing specific information in developing language teaching materials and present various corporal resources to provide both teachers and learners with language input that accurately reflects the language used in the real world. Specifically the emergence of corpus linguistics and the establishment of large-scale databases or corpora of different genres of authentic language have offered a further approach to get the learners acquainted and deeply involved with authentic language use.

**Defining Corpus Linguistics and corpora**

According to McEnery & Wilson (1996, p.1), *Corpus linguistic*s is 'the study of language based on the examples of real life language use". Unlike purely quantitative approaches to research, corpus linguistics utilizes bodies of electronically encoded text, implementing a more quantitative methodology, for

example by using frequency information about occurrences of particular linguistic phenomena. However, as Biber (1998, p.4) points out, corpus-based research actually depend on quantitative and qualitative techniques: 'Association patterns represent quantitative relations, measuring the extent to which features and variants are associated with contextual factors. However, functional (qualitative) interpretation is also an essential step in any corpus-based analysis.'

Corpus linguistics goes further in the language as it aims at describing what cannot be explained.It looks at language form a shoqëror perspective. It is verbal interaction that allows human shoqëror groups to negotiate content collectively. Various ideas today constitute corpus linguistics as a theoretical approach to the study of language. The field has changed the last ten years. While it was considered as a set of methods primarily for lexicography and language teaching (referring to applied linguistics) it is now seen as language that sets it apart from received views of certain linguists or the views of cognitive linguistics that rely upon the categories gained from retrospection rather than from the data itself (corpora language). Corpus linguists explain this language development through the concept of a corpus-driven analysis. Besides in corpus linguistics, language is always the study of written texts or text pieces that can be heard, read, reproduced, and interpreted as well. Every text segment, word, multi-word, phrase and even idioms etc., can be related under the aspect of form and that of meaning. As it is widely known, the form is what presents the meaning, and there is no meaning without the form by which it is represented.

Corpus linguistics is empirical as its object is real language data. On such a basis, the linguist's task is to define and to limit the object of the research and to specify which language data he or she is willing to analyze (Teubert, 2005) further explains that corpus linguistics makes general claims about language which have to do with rules or with any probable expectations and specific claims that in fact are interpretations of texts or text segments regarded as unique occurrences. Moreover, it employs many different methods to process and analyze corpus data. It displays the real language data taken from the discourse in a principled way and compiled in a corpus. In addition, corpus data provide insights of a kind that has not previously been available. It looks at phenomena that cannot be explained in reference to general rules or assumptions. At first glance, we become aware of the language presented in a type of communication disorders. These 'disorders' are found in the variation we find within and between discourses. On purpose, statistical procedures can be used for detecting them in any kind of corpus no matter how large they are. Significantly, frequency is an important parameter for detecting recurrent patterns defined by the co-occurrence of words. It is an essential feature that permits us in making general claims about the discourse.

In the world of corpus linguistics Reppen (2010., pg .3) states that, a corpus is a large, principled collection of naturally occurring texts (written or spoken) stored electronically. He further explains that '*Naturally occurring texts'* is language that is from actual language situations, such as friends chatting, meetings, letters, class assignments, and books, rather than from surveys, questionnaires, or just made-up language. Whereas, the design of a corpus must be *principled*: The goals of the researcher or the teacher shape the design of the corpus and guide the collection of

texts. The text in the corpus need to represent the type of language that the corpus is intending to capture. For instance if a corpus is to be representative of written language, then various corpus resources make available texts of fiction, academic prose, personal letters, office memos..,etc. Several corpora are available,e.g.,Brown; British National Corpus (BNC); The Corpus of Contemporary American English(COCA), and the International Corpus of English (ICE), that indeed provide valuable resources for information of how spoken and written language are used in a range of settings. Besides both teachers and university English learners need these specialized corpora to examine themselves specific and particular types of language use, such as EFL student compositions, university introductory chemistry lectures, lab reports, or business memos. Innovative teachers can create their own specific corpora for classroom use (linguistic analyses) to retain vocabulary in the most practical and long-term memory devices, thus promoting great leaps of advancement in EFL/ ESP/ EAP situational contexts.

Corpora are generally large as they consist of thousands or millions of words and represent samples of a particular type of naturally occurring language that can be used as a standard reference against which claims about language can be measured. The fact that they are encoded electronically means that complex calculations can be carried out on large amounts of text, revealing linguistic patterns and frequency information that would otherwise take days and months to uncover accurately by hand, and which may run counter to intuition (Baker,2006).

Electronic corpora are often annotated with additional linguistic information, the most common being 'part of speech" information (e.g., weather a word is a noun or a verb), which allows large-scale grammatical analyses to be carried out. Other types of information can be encoded within corpus data-for example, in spoken corpora (containing transcripts of dialogue), information about the sex, age, socio-economic group and region of speaker can be encoded for individual utterances. Such a fact allows for linguistic comparisons to be made about different types of speakers. In his recent book, Harding (2007) provides significant evidence that corpus gives authentic examples and data on frequency of use, allows selection of specific uses in different registers, and analyzes grammatical patterns associated with the word or phrase. A corpus provides evidence with specific examples of collocation to show the relative frequency of the selected keyword into collocations. Students themselves are able to find keyword examples of:

- use as noun/use as verb
- words that appear before and after thekeyword (i.e. possible collocations)
- other specialist words that appear in the extracts
- other features that might be associated with the keyword (for example, prepositions used with it, whether it can ever be a proper noun with capital letter, and so on).

Besides overall university students who are academically-minded, need to work with data at high level, and in reference corpora they can create their own corpus for their specialism. They can get various alternative ways of using authentic texts to practice deducing meaning from context. Further practice can be taken at using corpora by making their own concordance gap-fills and collocation lists to expand the English vocabulary and enhance EFL/ESP learning.

**Using Corpus Internet resources in the EFL/ESP classroom.**

There is a range of resources that are available online providing teaching materials, language learner instructions based on corpus findings. Because Web site addresses change, and some sites go out of existence, this paper refers only to the sites that are reliable and that should remain stable. Besides, it is essential to be aware of the variation in quality that can exist with so many sites appearing daily. When implementing corpora in EFL classrooms practice educators need to establish guidelines before using them in the English language classrooms. These guidelines should include considering who created the site, for what purpose, and how that purpose matches the intended uses. Moreover, the site's integrity is another factor. One indication of a site's integrity is if has been referenced in reputable publications, or if the site has a history of being cited by others as a resource so as to be considered as a useful resource.

Before you begin to look for online corpus resources, use the following questions to help you consider some factors that can inform your choices:

1. Is the site for me, or is it for my students?
2. What do I want to use the site for? Does the site provide information about a particular language feature and then use that information to develop materials or an activity?
3. Do I want my students to use it during lab time, ordinary English classes or on their own?
4. Do I want a site with prepared activities or material?

Considering beforehand the overstated questions you will notice that your specific English teaching goals in reference language corpora make both ends meet and facilitate overall English academic language learning. Besides, the striking feature of implementing them relies on the fact that that may be used by learners independently, teachers for the clear and easy to follow instructions when needed to explain conceptual academic material and above all ambitious researchers that seek the outmost responses to promote easiness in our classroom language teaching.

There are two types of corpus-based teacher resources that are available online. The first type provides information that can be used to inform instruction or that can be used as a starting point for materials development related to a particular language point.The second type provides actual corpus-based lesson plans.

Let's look at two resources:

The Kibbitzer pages developed by Tim Johns (www.eisu.bham.ac.uk/support/online/kibbitzers.shtml), and the MICHASE Kibbitzers (micase.elicorpora.info/micase-kibbitzers). Both sites use the format of providing KWICs (key words in context indexes), (Figure.1) to expose the user to a large number of examples of the target form.

They have proved to be rich and reliable resources for creating lessons that target particular language structures that can be troubling to English learners.

In addition to the teacher resources mentioned, there is an increasing number of Web sites that have activities based on corpus research or resources that can be used with students with little to no modification. One area of corpus research is the use of the Academic Word List (Coxhead 2000) as a source for principled academic vocabulary instruction. One of the most popular Web sites (Figure.2) provided with activities related to the Academic Word List is Tom Cobb's Compleat Lexical Tutor (www.lextutor.ca/).




**Figure.1 Keyword Extractor interface**

**Figure.2 The Compleat Lexical Tutor, site entry web page**

Students and teachers have a number of corpus resources available to them for the main page of this site. For example, students can input texts that they have written and immediately see how the words they used are distributed across the different frequency bands of the Academic Word List.

**Creating corpus materials for classroom use**

Corpus materials are ideally suited for creating a range of different teaching materials. First, KWICs can be used to introduce a new structure or to raise awareness about a language pattern. For example, students could be presented with KWICs of singular and plural regular nouns and be asked to see if they can spot the change that takes place when a regular noun goes from singular to plural (add an –*s* or –*es*).

A second way to use material from a corpus is to provide a rich context for practice. KWICs provide students with an opportunity to see a word or structure in high concentration, that is, multiple exposures in a short period of time.This is a powerful learning tool. Any of these KWIC activities can be created without too much effort on the part of the teacher.Copying and pasting KWICs from a corpus into a word-processing document is not difficult or time-consuming.

Frequency lists are also a useful beginning point for vocabulary instruction and can be used in a variety of ways. A printed frequency list can be a springboard for several vocabulary activities. For example, students can scan for familiar and unfamiliar words or to look for suffixes or prefixes. The KWIC activity has the added benefit of exposing the students to the words that frequently co-occur together with the target vocabulary word, thus increasing and promoting English vocabulary learning.

Besides an English teacher can create corpora for classroom use in such conditions when there is not an existing corpus that meets his/her needs. Teachers may be interested in exploring types of language that are not represented by existing corpora, such as a corpus of their students' papers, or a corpus of class readings. Having a clear goal or question in mind, you will need to build a corpus. In

language classes, most times you will be creating relatively small corpora for class use and not creating large corpora that represent all aspects of language use. These corpora can give information about the difference between our student learners and between learners and native speakers.The essence of work on such "learner corpora" is comparison: between corpora produced by different sets of learners, and between corpora produced by learners and those produced by native or expert speakers.

Comparability between the corpora is important. For our purposes as English language teachers, small but representative is more important than millions of words. The effectiveness of creating corpus materials for classroom use is resolved by two main factors *representativeness* (Have I collected enough texts (words) to accurately present the type of language I am interested in?) and *practicality* (time constraints). For example, it is possible to capture all the papers written by our students for a particular assignment, for a linguistic analysis or to make a corpus of the readings that the students will be working with, or texts from a particular event ( e.g., letters to the editor related to a class topic).

Besides, using corpora in the English language classroom together with its companion Web site enables teachers to corpus-informed teaching that aims at overcoming possible inhibitions and discovering adequate solutions about the use of language corpora.

Thus using the information from a corpus or corpus activities, teachers can make certain that the structuresbeing taught are the ones that students will encounter as they interact in English or that students are reading texts thatare level appropriate.To conclude, having the willingness to promote innovative paths for knowledge that means following thoroughly all the principled instructions and preparatory in class methodological questions, the present research study may serve as a reliable source information and authentic evidence of why and how to use corpora and their specific variety of tools in teaching English in our English language classrooms.

It is the time for those demanding and novice teachers, ambitious learners and contemporary researchers to think about, and act on, to make teaching and learning enjoyable, easy and professional.

**Bibliography**

Baker, P. (2006). *Using Corpora for Discourse Analysis.* London: Continuum

Biber, D. (1998). *Variation across speech and writing.* Cambridge: Cambridge University Press

Cobb, T. (n.d.) Why & how to use frequency lists to learn words. Retrieved November 2013, from http://www.lextutor.ca/ResearchWeb/

Coxhead, A. (2000). A new academic word list. *TESOL Quaterly,* 34, 213-38

Gragner, S. (2004). Computer learner corpus research: Current status and future prospects. In U. Conor and T. Upton (eds.). *Applied corpus linguistics: A multidimensional perspective,* 123-45. Amsterdam and Atlanta: Rodopi.

Harding, K. (2007). *English for Specific Purposes.* Oxford University Press

McEnery, T. and Wilson, A. (1996). *Corpus Linguistics.* Edinburg: Edinburgh University Press

Reppen, R. (2010). *Using Corpora in the language classroom, p.3.* Cambridge language education. Cambridge: Cambridge University

# ANALIZË E STRATEGJIVE TË PËRDORURA NË VENDIN TONË NË MËSIMIN E GRAMATIKËS SË GJUHËS ANGLEZE

**LINDITA KAÇANI**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Edukimit**

**Përmbledhje**

Mësimdhënia e gramatikës së gjuhës së huaj është e lidhur ngushtë me etapat dhe teknikat që përzgjidhen për t'u përdorur në mësimin e gjuhës së huaj.

Ky punim fokusohet në etapat dhe teknikat që janë përdorur dhe mund të përdoren në mësimdhënien e mësimnxënien e gjuhës së huaj në përgjithësi e asaj angleze në veçanti, duke u bazuar në literaturën përkatëse të mësimit të gjuhës së huaj.

Përmes disa sekuencave mësimore të vëzhguara në rajonin tonë, punimi synon të japë një panoramë të etapave dhe teknikave që përdoren momentalisht në mësimin e gramatikës së gjuhës angleze dhe njëkohësisht të reflektojë përmes një analize me qëllim evidentimin e përparësive dhe të metave të tyre.

**Fjalët çelës:** *gramatikë, etapë, teknikë, komunikim*

**Abstract**

Teaching foreing language grammar for communicative purposes is closely connected to the stages and techniques selected to be used in foreing language classes.

This paper focuses on the stages and techniques that have been used over the timein teaching and learning a foreing language in general and English in particular, based on the available literature of foreing language acquisition.

Referring to some sequences of English classes observed in our region, the paper aims at giving a clear view of the stages and techniques that are actually in use in teaching English grammar and reflecting on them through an analysis in order to make evident their advantages anddeficiencies.

**Key words:** *grammar, stage, technique, communication*

Trajtimi i gramatikës në funksion të komunikimit është i lidhur ngushtë me teknikat e mësimdhënies të përdorura nga mësuesit e gjuhëve të huaja. Cilat janë këto teknika dhe si zbatohen ato në orën e mësimit të gjuhës angleze? A janë ato efektive në përvetësimin e gramatikës për qëllime komunikimi? Përmes vëzhgimit të orëve mësimore të gjuhës angleze në sistemin parauniversitar është synuar të sillet një panoramë e etapave dhe teknikave që përdoren në mësimin e gramatikës në rajonin tonë. Pas analizës së disa sekuencave mësimore, jepet një vlerësim i tyre me qëllim përmirësimin e mësimit të gramatikës në funksion të përvetësimit të gjuhës për qëllime komunikimi.

***Mendime të autorëve të ndryshëm***

Duke iu referuar Nenshati-Shllakut (2009, pp. 48-50), profesori anglez Peck dalloi pesë teknika të mësimdhënies së

gramatikës së gjuhës së huaj (si më poshtë vijojnë), pas vëzhgimit të shtatë orëve mësimore të shtatë mësuesve të gjuhës së huaj (katër të frëngjishtes, një të gjermanishtes, një të anglishtes dhe një të gjuhës norvegjeze). Këto teknika mund të konsiderohen dhe etapa të mundshme të mësim-dhënies (induktive ose implicite) të gramatikës.

Njësimi – veçimi i disa fjalive me qëllim për t'u fokusuar në formën gramatikore;

Sistemimi – veçimi (ose grupimi) i formave gramatikore sipas një kuptimi a veçorie gramatikore të caktuar, p.sh. format foljore sipas kategorisë së kohës, aspektit, etj.;

Klasifikimi – sistemimi i formave gramatikor përbën bazën për klasifikimin e tyre, p.sh.foljet *decide, agree, promise*… , folje që ndiqen nga forma foljore '*to-infinitive*'; ndërsa foljet *deny, avoid, enjoy…*, folje që ndiqen nga forma foljore që mbarojnë me morfemën '*-ing'*.

Përgjithësimi – klasifikimi mund të shërbejë si një etapë për të realizuar përgjithësimin. Për shembull, pas veçimit në një grupi të frazave apo fjalive si: *I like…, you love…,* dhe një grupi tjetër: *John likes…, Ann loves*…, nxënësit apo mësuesi mund të përgjithësojë formën e foljes në vetën e I, II dhe III, njëjës, koha e tashme.

Zbatimi – përdorimi i formave gramatikore në ushtrime dhe veprimtari të ndryshme me qëllim përvetësimin e tyre.

Peck vërejti gjithashtu se secili mësues nuk i përdori të pesë teknikat në orën e tij të mësimit; gjithashtu, rendi i zbatimit të tyre ndryshonte në varësi të mësuesit.

Një tjetër studiues, Faerch, pasi vëzhgoi disa orë mësimi të gjuhës së huaj angleze (me studentë danezë), arriti në përfundimin se mësuesit e vëzhguar kalonin në këto etapa gjatë mësimdhënies së gramatikës:

-shtrimi i problemit gramatikor,
-përgjithësimi i tij,
-formulimi i rregullit gramatikor,
-sipas nevojës, dhënia e shembujve të tjerë.

Gerngross, Puchta dhe Thornbury (2006, pp. 6-9) ofrojnë tri etapa për një mësimdhënie krijuese të gramatikës: *Zbulimi*, *Konsolidimi* dhe *Përdorimi*. Ndonësë kjo ndarje mund të ngjasojë me etapat tradicionale '*Prezantim, Praktikë dhe Kumtim*', ato nuk janë të njëjta; së bashku ato synojnë që nxënësi të ndërgjegjësohet, të kuptojë dhe të praktikojë përdorimin e tyre. Pra, ndryshe nga etapat tradicionale që janë të drejtuara vetëm nga mësuesi, këto etapa vendosin në qendër nxënësin.

**Zbulimi.** Mësuesi ofron kushte për ndërgje-gjësimin e nxënësve me formën e re gramatikore (tekst gojor ose i shkruar, i pasur me shembuj të njësisë së synuar gramatikore), ku vetë nxënësit mund të zbulojnë rregullin gramatikor. Prezantimi i tekstit model; një tekst i shkruar që paraqet jo vetëm formën e strukturës së synuar gramatikore, por dhe kuptimin, përdorimin a funksionin e saj. Për ta bërë leximin e teksit më aktiv, mësuesi mund të manipulojë tekstin me vende bosh, duke nxitur nxënësit t'i plotësojnë ato.

**Konsolidimi**. Përfshin detyra që përforcojnë të kuptuarit e çështjes gramatikore. Rindërtimi i tekstit model të paraqitur më parë, ofron mundësi për praktikë të kontrolluar përmes teknikave si përdorimi i fotove a pikturave, fjalëve a frazave kyçe, gjesteve, etj.

**Përdorimi**. Përfshin përdorimin e personalizuar të formës gjuhësore, që do të thotë, përdorim i strukturës për qëllime komunikuese të vetë nxënësve. Krijimi i një teksti tjetër që ka strukturën e tekstit model.

Doff (1988, pp. 32-41) përpiqet të krijojë një situatë reale ose të ngjashme me realitetin në mësimin e gramatikës duke sugjeruar fazat e mëposhtme në një

qasje komunikative të mësimit të gramatikës.

1.Përdorimi i mjeteve vizuale (vizatimeve, gjesteve, pikturave, etj.) ose një situate (reale ose imagjinare) për të prezantuar strukturën gramatikore që synohet të mësohet.

2.Bazuar në etapën e parë, nxënësit hamendësojnë kuptimin, formën dhe përdorimin e saj.

3. Mësuesi përmes pyetjeve kontrollon të kuptuarit e nxënësve formën, strukturën dhe përdorimin e strukturës së synuar gramatikore.

4.Mësuesi nxit nxënësit të praktikojnë strukturën përmes ushtrimeve të kontrolluara (si përsëritje, zëvendësime, krijimi i fjalive bazuar në një figurë, etj.) dhe në kontekst me qëllim që nxënësit të ndihen të sigurtë në përdorimin e saktë të strukturës së re.

5.Në fund mësuesi u krijon mundësi nxënësve të përdorin strukturën e synuar në mënyrë më krijuese, përmes veprimtarive komunikuese (si diskutime)

| | Faktorët | Teknika | Burime |
|---|---|---|---|
| Strukt urë + | Faktori shoqëror | Teknika të ndërveprimit dinamik (p.sh. dramatizimi) | Veprimtar i me orientim shoqëror, si lojë me role, tregimi i një ndodhie |
| Strukt urë + | Kuptimi | Të dëgjuarit dhe dhënia e përgjigjes, demonstrimi, ilustrimi; teknika statike | Objekte si piktura, grafikë, sende. |
| Strukt urë + | Ligjërimi | Gjenerimi dhe modifikimi i tekstit; shpjegimi | Veprimtar i si këngë, tregime. |

që nxitin nxënësit të përdorin strukturën e re. Në përpjekje për të ndihmuar nxënësit që të përmirësojnë metodat tradicionale të mësimdhënies së gramatikës, Celce-Murcia dhe Hilles (1988, p. 27) sugjerojnë një mësimdhënie të gramatikës të lidhur ngushtë me kuptimin, faktorët shoqërorë, ligjërimin, ose një kombinim të këtyre faktorëve:

Sipas tyre, disa struktura (si foljet modale) mund të kuptohen dhe përvetësohen më mirë në rast se faktori shoqëror merret në konsideratë, pasi ky faktor i referohet rolit shoqëror të bashkëbiseduesve, marrëdhënieve mes tyre dhe qëllimi i tyre i komunikimit (përdoret: '*Can I…*' kur i drejtohemi një miku a të afërmi; '*May I …*' një të panjohuri).

Disa struktura të tjera (si shprehjet e sasisë) mund të mësohen në mënyrë më efektive, kur fokusi vihet tek ndryshimet morfologjike, leksikore dhe sintaksore që shënojnë një ndryshim në kuptim (*I have little milk / I have a little milk*).

Disa të tjera (si fjalia veprore vs. fjalia pësore) shpjegohen dhe kuptohem më mirë duke iu referuar funksionit të tyre në ligjërim.

Në orën e mësimit të gramatikës, Celce-Murcia dhe Hilles dallojnë 4 faza:

***a**-prezantimi* (i strukturës gramatikore në mënyrë deduktive ose induktive),

***b**-praktika e fokusuar* (ku nxënësit praktikojnë strukturën e synuar me qëllim zotërimin e formës së saj); kjo fazë është penguese (mësuesi nuk duhet të kalojë në fazën tjetër nëse nxënësit nuk e kanë përvetësuar formën gjuhësore) për fazën pasardhëse,

***c**-praktika komunikuese* (ku nxënësi përfshihet në veprimtari komunikuese për të praktikuar strukturën e re)

***ç**-korrigjimi i gabimeve* (feedback-u) e cila duhet të jetë e pranishme gjatë gjithë orës mësimore.

Megjithëse këto teknika e kanë burimin te përvoja e tyre mësimdhënëse në klasë, Celce-Murcia dhe Hilles shprehen që '*teknika që funksionon për një mësues,*

*mund të mos funksionojë për një tjetër*'. Ato theksojnë përdorimin e një qasjeje eklektike në mësimdhënien e gramatikës.

***Analizë e disa sekuencave të trajtimit të gramatikës nga mësues shqiptarë të gjuhës angleze***

Nga vëzhgimet e bëra në këtë drejtim dhe shqyrtimi i ditareve të mësuesve, në disa orë mësimi të gjuhës angleze, kemi përzgjedhur për të analizuar sekuencat e mëposhtme, të cilat përfaqësojnë disa mënyra të trajtimit të gramatikës nga mësuesit shqiptarë. Në këto sekuenca, vëmë re se trajtimi i gramatikës nga mësuesi mund të ngjasojë ose jo me mënyrën e sugjeruar në tekstin mësimor.

**Sekuenca 1**. Klasa IV, teksti mësimor *Up the ladder 4*, mësimi 9, çështja gramatikore 'koha e shkuar e foljeve të rregullta'.

Është hera e parë që nxënësit prezantohen me këtë çështje gramatikore. Në mësimin me numër 3, nxënësit kanë mësuar kohën e shkuar të foljes së parregullt 'jam'. Mësuesi ka përzgjedhur disa fjali nga teksti i dhënë në tekstin mësimor, të cilat i ka shkruar në dërrasë:

*Monday, December 31*

*It was New Year Eve. We celebrated it at home. We invited my aunts and uncles. My mom cooked Albanian dishes. My dad washed the dishes. My aunt helped with the cooking. I cleaned the house. We were all busy.*

Fjalitë përmbajnë folje të rregullta, në formën e kohës së shkuar. Mësuesi qëllimisht ka lënë mënjanë shembullin që përmban një folje të parregullt (*My sister and I put up the New Year tree*), për të bërë një shpjegim të thjeshtë e të qartë të foljeve të rregullta; përfshirja në shpjegim e foljeve të parregullta – të konsideruara të vështira – do të ngatërronte nxënësit dhe do të ngjallte ndjenja negative në lidhje me përvetësimin e formave foljore.

Për të kuptuar më mirë situatën e dhënë, përveç figurës (dy fëmijë që zbukurojnë pemën e Vitit të Ri) në tekstin mësimor, mësuesi ka sjellë disa foto të familjes së vet, në këtë ditë feste.

Përpara se të fokusohet tek shpjegimi i çështjes së synuar gramatikore, mësuesi nxit nxënësit të kujtojnë formën e shkuar të foljes 'jam' përmes pyetjeve: "*Where were you yesterday?", "Where were you on Sunday*", etj., dhe në fund "*What day is it today*?"

Pastaj , mësuesi nxit nxënësit të përqendrohen tek format e foljeve në fjalitë e shkruara në dërrasë. Pasi sistemon në një kuadrat të caktuar të dërrasës format *was* dhe *were* (të foljes jam) dhe në një tjetër format e tjera (të foljeve të rregullta), përmes pyetjeve në shqip të mësuesit "*Çfarë kanë të përbashkët foljet e këtij kuadrati* (të fundit)", "*Kur janë kryer këto veprime*", mësuesi nxit nxënësit të përgjithësojnë dhe zbulojnë rregullin për çështjen gramatikore. Për t'u fokusuar në të gjitha format e foljes në të shkuarën (pozitive, pyetëse dhe negative), mësuesi përdor një tabelë në të cilën jepen këto forma, në të gjitha vetat, përmes zgjedhimit të foljes *play*.

Pas kësaj etape, mësuesi u jep mundësi nxënësve të praktikojnë formën e shkuar të foljeve të rregullta në ushtrimet e kontrolluara (transformimi i fjalive nga e koha e tashme në të shkuarën), të dhëna në tekstin mësimor.

Siç e shohim në këtë përshkrim, mësuesi përpiqet të përmirësojë qasjen (e sugjeruar në tekstin mësimor) ndaj gramatikës; trajton çështjen gramatikore fillimisht në mënyrë induktive duke ndjekur teknikat (etapat) e Peck-ut dhe më pas atë deduktive, lë jashtë shpjegimit rregullat (format) e vështira dhe fokusohet në ato që janë më të nevojshme për situatën e tyre mësimore, përdor mjete vizuale dhe gjuhën shqipe (gjatë

shpjegimit) për të lehtësuar kuptimin e saj. Por, në këtë sekuencë mësimi mungojnë veprimtaritë e lira komunikuese.

**Sekuenca 2**. Klasa VII, teksti mësimor *Access 2*, mësimi 9, çështja gramatikore '*should / shoudn't*' për të dhënë këshilla.

Mësuesi paraqet një situatë-model (imagjinare ose reale), që nxit nxënësit të bëjnë fjali që përmbajnë strukturën e synuar. Për shembull, mësuesi pretendon se ka një problem shëndetësor, por njëhohësisht ka dhe shumë punë për të bërë; u kërkon nxënësve një këshillë.

Mësuesi: *I have a lot of work to do; but I cannot work because I have a terrible headache. What is your advice?*

Nxënësit japin sugjerimet e tyre përmes strukturës në mënyrën urdhërore, si p.sh. "*Take an aspirin / Have a rest / Drink some water /…*". Pasi mësuesi dëgjon e shkruan në dërrasë sugjerimet e nxënësve, ai udhëzon nxënësit: *Ju mund të jepni këshilla duke përdorur foljen modale 'should', p.sh. You should take an aspirin / you should have a rest.*

Pas këtij udhëzimi, mësuesi vendos nxënësit (të ndarë në grupe) në situata të tjera dhe nxënësit me sukses përdorin strukturën e synuar.

Në të njëjtën mënyrë trajton dhe formën *shouldn't do*. Por këtë radhë nxënësit nuk kanë nevojë për udhëzime eksplicite gramatikore.

Në fund mësuesi paraqet disa situata që kërkojnë përdorimin e njërës strukturë apo tjetrës.

Në këtë orë mësimore, mësuesi përmes situatës së krijuar në klasë kërkon të zbulojë njohuritë e nxënësve në lidhje me çështjen e synuar gramatikore. Meqenëse ajo rezultoi e panjohur (pasi në përgjigjen e tyre përdorën një strukturë tjetër gjuhësore), mësuesi përdori metodën eksplicite (deduktive) për të trajtuar gramatikën (rregulli – shembulli - praktikë). Mësuesi shfrytëzon materialin pedagogjik (shembujt dhe situatat) të tekstit mësimor, por e trajton atë sipas mënyrës së tij (duke mos realizuar të gjitha ushtrimet e sugjeruara). Pra, në varësi të nevojave të nxënësve, mësuesi ka përzgjedhur strategjitë e mësimdhënies të përshkruara më sipër.

**Sekuenca 3**. Klasa VII, teksti mësimor *Access 2*, mësimi 2, çështja gramatikore 'forma foljore *be + v-ing*' (present continuous).

Shpjegimi i çështjes gramatikore me shembuj konkretë nga situata e klasës:

*Look at her! She is wearing a lovely dress. (now), Are you having lesson at the moment?*

*Are you going to the cinema tomorrow? Are you having lesson tomorrow?*

Përmes shembujve të tjerë, po konkretë, mësuesi punon me nxënësit që ata të njihen dhe të kuptojnë funksionimin e formës '*to be + v-ing*', me qëllim që nxënësit t'i praktikojnë ato. Mësuesi ka përzgjedhur një tekst me vende bosh për t'u plotësuar (me strukturën e synuar), përshkrimin e një tabloje të një feste (duke treguar se çfarë po bëjnë njerëzit) dhe një dialog të shkurtër në të cilin nxënësit pyesin për planet e tyre në fundjavë.

Në këtë orë mësimi, mësuesi përdor një qasje implicite për mësimdhënien e përvetësimin e gramatikës dhe u referohet pjesërisht sugjerimeve pedagogjike të tekstit mësimor (duke mos e trajtuar formën foljore '*be + v-ing*' së bashku me formën e foljes në kohën e tashme). Duke qenë se nxënësit janë të njohur me formën foljore ***'be + v-ing'*** gjatë orëve mësimore të viteve të kaluara, mësuesi preferon të fokusojë nxënësit në përdorimin e saj.

Është e nevojshme që nxënësit të praktikojnë përdorimin e strukturave jo në mënyrë të izoluar, por të integruar me struktura të tjera, në kontekstet reale të jetës së përditshme. Profesorët Leech dhe Starvik (2002), duke iu referuar problemit

të renditjes së mendimeve në komunikimin e efektshëm, e konsiderojnë gramatikën si burimin e zgjidhjes së këtij problemi: "*Gramatika është mjaft fleksibile për të ofruar një zgjidhje të konsiderueshme në çështje të tilla (renditja e mendimeve për të komunikuar në mënyrën më të efektshme)"(* Leech&Starvik, 2002,p. 8) . Gramatika bashkon mendimet përmes njësive të ndryshme kohezive. Shumë struktura dhe forma gjuhësore përdoren bashkë në situata të caktuara. Për shembull: në rrëfime, përdorimi i kohës së kryer (present perfect) me kohën e shkuar (past simple, past continuous); përshkrime të një situate të tanishme, përdorimi i kohës së tashme me atë të vazhduarën (present simple me present continuous). Sfida e mësuesve është krijimi i situatave, ku nxënësit të mund të përdorin së bashku struktura të tilla.

**Sekuenca 4.** Klasa VII, teksti mësimor *Off we go*, mësimi 5, çështja gramatikore 'present perfect'.

Mësuesi përmes një tabele paraqet format e foljes në kohën e kryer (present perfect). Për t'i kuptuar këto forma, mësuesi sjell format analoge të gjuhës shqipe (kam ngrënë, ka ngrënë, etj.).

Më pas, mësuesi u kujton nxënësve formën e pjesores të foljeve të rregullta dhe të disa foljeve të parregullta përmes disa shembujve të tjerë në të cilat është përdorur koha e kryer. Pas kësaj, mësuesi u kërkon nxënësve të plotësojnë me shkrim ushtrimet në fletoren e punës, të cilat konsistojnë në format e foljes në formën bazë, të shkuar dhe pjesore; transformin e fjalive pohore (me foljen në *present perfect*) në mohore dhe përfundimin e fjalive (disa prej të cilave kanë foljen në *present perfect*). Ndërkohë që nxënësit punojnë, mësuesi vëzhgon nxënësit, i ndihmon dhe korrigjon gabimet e tyre.

Në këtë orë mësimi, mësuesi përdor një metodë tradicionale për mësimdhënien dhe përvetësimin e gramatikës (që fokusohet në formën dhe kuptimin e strukturës), duke iu referuar sugjerimeve pedagogjike të tekstit mësimor. Por nëse në orët në vijim, mësuesi nuk do t'iu ofrojë nxënësve mundësi për ta përdorur strukturën në mënyrë orale, produkti i kësaj mënyre mësimdhënieje do të mbetet ai i tradicionales; nxënës me njohuri gramatikore, por i paaftë në përdorimin e tyre.

**Sekuenca 5.** Klasa XII, teksti mësimor *Wishes (B2.2)*, mësimi 2.2, çështja gramatikore 'forma foljore në kohë të ndryshme'.

Mësuesi ka dhënë si detyrë shtëpie shkrimin e një e-mail-i një shoku të klasës, në të cilën shkruajnë për ndodhitë e tyre. Nxënësit dorëzojnë detyrën e shtëpisë dhe në grupe (prej 4-5 nxënësish) lexojnë dhe kontrollojnë një detyrë të përzgjedhur, me qëllim gjetjen e gabimeve të bëra. Pastaj, nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe mësuesen e tyre për korrigjimin e gabimeve.

Ndër synimet e programit të gjuhës angleze në klasën XII, me të cilat lidhet kjo veprimtari, përmendim: "*T'i përgatisë nxënësit për t'u përballur me kërkesat*

| | | |
|---|---|---|
| **I You We They** | **have eaten** | **all the cake.** |
| **He She It** | **has eaten** | |

| | | |
|---|---|---|
| **I You We They** | **haven't eaten** | **all the cake.** |
| **He She It** | **hasn't eaten** | |

*standarde të provimeve evropiane për nivelin B2;* të aftësojë nxënësin *... të përdorë forma të ndryshme gjuhësore; ….të debatojë për të mbrojtur argumentet dhe qëndrimin e tij / saj ndaj një teze apo ideje, ….të negociojë për zgjidhjen e saj, …. të korrigjojë gabimet e bëra në ligjërim me shkrim ose me gojë, …të përdorë saktë në*

*mënyrë krijuese foljen në kohë dhe kombinime të ndryshme ….”*(IZHA, 2010).

Ky kontekst mësimor:

-nxit nxënësit të punojnë me gjuhën përmes internetit;

-nxit dhe zhvillon metagjuhën, e rëndësishme për të përballuar diskutimin;

-nxit dhe zhvillon aftësitë gjuhësore (gramatikore) të nxënësve në mënyrë të natyrshme duke përfituar nga njohuritë e të tjerëve;

-nxit nxënësit që të vetëkorrigjohen ose të korrigjojnë njëri-tjetrin, dhe të mësojnë prej gabimeve që ata bëjnë;

-i jep mundësi nxënësit të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të marrë pjesë aktive në ndërveprimin gjuhësor.

Si përfundim, duke u mbështetur në literaturën dhe rezultatet e sipërpërmenduara, është e rëndësishme të theksojmë se praktikisht nuk mund mund të thuhet se cila është mënyra më e mirë për trajtimin e gramatikës. Sikundër shprehen Celce-Murcia dhe Larsen-Freeman, nevojitet përdorimi i një qasjeje eklektike apo ‘qasjeje shumëplanëshe’ (Celce-Murcia & Larsen-Freeman, 1999, p. 7) në përdorimin e teknikave gjatë mësimdhënies së gramatikës, duke përdorur teknika të ndryshme për mësimdhënien e aspekteve të ndryshme të tri dimensioneve të strukturës gjuhësore (forma, kuptimi, funksioni). Kjo për shkak të situatave dhe mjedisit të mësimdhënies, strukturës gramatikore që synohet të trajtohet, forcës së saj komunikuese (nëse struktura shfaqet tek nxënësit për herë të pare), nevojat e nxënësve, niveli i tyre gjuhësor dhe metagjuhësor, stili i të nxënit dhe perceptimet e mësuesve për qasjen më efektive në mësimin e gramatikës së gjuhës së huaj.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Celce-Murcia M., Hilles, S. (1988). *Techniques and Resources in Teaching Grammar*, Oxford University Press.

Celce-Murcia M., Larsen-Freeman, D. (1999). *The grammar Book, An ESL/EFL Teacher’s Course*, second ed.

Doff, A. (1988).*Teach English: A training course for teachers, Trainer’s handbook*, Cambridge University Press.

Gerngross, G., Puchta, H., Thornbury, S. (2006). *Teaching Grammar Creatively*, Helbling Languages.

Instituti i Zhvillimit të Arsimit (2010). *Programet e Kurrikulës Bërthamë të Gjimnazit, Gjuhë Angleze, 12*, Tiranë në http://www.izha.edu.al/programet/klasa12/berthame/anglisht-berthame-12.pdf

Leech, G., Svartvik, J. (2002). *A Communicative Grammar of English*, third ed. Pearson Education Limited.

Nenshati-Shllaku, A. (2009). Tezë Doktorate: *Orientimi i gramatikës drejt metodës komunikuese sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët*, Tiranë.

# AKTUALIZIMI I PARIMEVE PEDAGOGJIKE DHE PRAGAMATIKA E LIGJËRIMIT NË MATERIALET DËGJIMORE NË MJEDISET VIRTUALE

**OLSA PEMA**
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë**
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë**
**Departamenti i Gjuhëve të Huaja**

**Përmbledhje**

Cili është roli i mjediseve virtuale në mësimdhënien e kompetencave në gjuhën e huaj? Ky punim synon të sjellë një kontribut konkret në këtë drejtim, duke vënë në fokus të analizës shqyrtimin e 14 materialeve të programit dëgjimor në mjedisin e *website*-it të kursit – pjesë kjo e një projekti më të gjerë kërkimor i bërë realitet me studentë të Degës së Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti "Fan S. Noli" , në dy këndvështrime: së pari, për nga shkalla e aktualizimit të parimeve pedagogjike bashkëkohore në ndërtimin e tyre dhe së dyti, nga pikëpamja e strukturës pragmatike të ligjërimit në to.

Përmes instrumentit të analizës kritike diskursive në tekste, zbulohet një bazë e shëndoshë të dhënash rreth pranisë së komponentëve ndërkulturorë në kontekstin komunikativ të folësve të ndryshëm.

Ndërkaq, përshkrimi analitik në formë e përmbajtje i materialeve të dëgjimit, flet për një program me kërkesa e pritshmëri të larta në drejtim të kultivimit të shprehive të dëgjimit të studentëve në gjuhën angleze.

Rezultatet e analizës dydrejtimëshe janë domethënëse lidhur me perceptimin e *website*-it si katalizator në zhvillimin e kompetencës dëgjimore e ndërkulturore në gjuhën e huaj.

**Fjalë çelës:** *kompetencë dëgjimore, komponent ndërkulturor, mjedis virtual, analizë ligjërimore*

**Abstract**

What is the impact of virtual environments in teaching competences in a foreign language? This study aims at bringing a concrete contribution while closely examining the fourteen listening class materials on the course website - as part of a greater project initiated with first year students of English branch, Faculty of Education and Philology at "Fan S. Noli" University of Korca – with regards to the degree to which contemporary pedagogical principles are embodied in the listening text structure and content, and the nature of the discourse pragmatic structure.

Through the instrument of critical discourse analysis, we manage to discover a rich database validating the presence of the intercultural components in the communicative context of various speakers.

The results of this bidirectional analysis attribute the website the quality of a catalyst in further developing and promoting the listening and intercultural competences in a foreign language.

**Key words:** *listening competence, intercultural component, virtual environment, discourse analysis*

Studimet tregojnë se rreth 50% e kohës së komunikimit shpenzohet duke dëgjuar (Gilman & Moody, 1984). Në fakt, dëgjimi renditet ndër aftësitë më të rëndësishme që mund të fitojmë gjatë jetës, sepse u paraprin aftësive të tjera. Përmes dëgjimit, në të vërtetë, arrijmë të kuptojmë tjetrin, të pasurojmë jetën si dhe të përvetësojmë informacion të rëndësishëm për përvojën tonë. E cilësuar deri vonë si aftësi komplekse apo e vështirë për t'u përvetësuar, studimet për zhvillimin e kësaj makroshprehie në mësimdhënien e gjuhëve të huaja janë lënë pas dore për dekada të tëra. Nga ana tjetër, tashmë është bërë i njohur fakti se nxënësit që mësojnë një gjuhë të huaj, përveç njohurive gjuhësore, duhet të pajisen edhe me shprehitë për ta përdorur gjuhën në mënyrën e duhur nga pikëpamja shoqërore e kulturore. Ky konceptim i gjerë i mësimdhënies së gjuhëve të huaja përbën edhe risinë themelore të KEPR, ku theksohet rëndësia e "ndërgjegjes dhe shprehive ndërkulturore" gjatë arsimimit në gjuhën e huaj; me fjalë të tjera, nevoja për të zhvilluar tek nxënësit vetëndërgjegjen kulturore dhe, me tej, aftësinë për të kapërcyer muret e kulturës së tyre dhe për të komunikuar me sukses me individë të tjerë me prejardhje të ndryshme kulturore-gjuhësore.

Në kushtet e masivizimit të internetit në shoqërinë e mijëvjeçarit të ri, vetë rrjeti shihet si një platformë për ta promovuar më tej MNGJH efektive (Warschauer, 1996), duke krijuar një mjedis ideal për nxitjen e shprehive komunikative e kulturore si dhe aplikime të larmishme në kontekste të ndryshme.

**Qëllimi i punimit**

Përvoja e sjellë në këtë punim është pjesë e një kuadri më të gjerë të një projekti madhor të titulluar "English for the Net Generation" ("Anglishtja për Brezin e Internetit") – një nismë e bërë realitet me studentë të kursit të parë të degës së gjuhës angleze në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës. Ky projekt në thelb pati çeljen e një *website*-i për zhvillimin e mëtejshëm të shprehive gjuhësore në një mjedis virtual në lëndët Komunikim dhe Qytetërim Amerikan, si një burim mbështetës për informacion e praktikë gjuhësore, promovues i shprehive gjuhësore e kulturore, për zhvillimin e të cilave duket se klasa përbën një mjedis të pamjaftueshëm.

Në fokus të kësaj analize do të jetë pikërisht shqyrtimi i vlefshmërisë së kurrikulës dëgjimore në mjedisin virtual të website-it në funksion të nxitjes së kompetencave dëgjimore e ndërkulturore të studentëve në gjuhën angleze, parë kjo nga dy këndvështrime, aktualizuar përmes dy pyetjeve kërkimore që ngrihen për shqyrtim gjatë këtij punimi:

a-Sa u përmbahet mësimdhënia virtuale përmes *website*-it parimeve universale për një dëgjim të suksesshëm?

b-Cili është karakteri i pragmatikës së ligjërimit në tekstet e programit dëgjimor virtual? Thënë ndryshe, në ç'shkallë mishërohen elementët ndërkulturorë përgjatë ligjërimit në tekstet e programit dëgjimor virtual?

**Metodologjia dhe instrumentet**

Fondi i marrë në shqyrtim përbëhet prej një cikli të plotë programi dëgjimi (gjithsej 14 tekste) në nivelin e parë të përparuar ("First Certificate") të gjuhës i vënë në zbatim me grupin eksperimental të përbërë prej 15 studentësh të kursit I të degës së gjuhës angleze në Fakultetin i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë.

Rezultatet e paraqitura në këtë studim mbështeten së pari, në shqyrtimin me karakter argumentues - përshkrimor të materialeve dëgjimore për evidentimin e shkallës së aktualizimit të parimeve bashkëkohore pedagogjike në to, kusht ky i

domosdoshëm për të siguruar standardet e nevojshme për veprimtari të suksesshme në zhvillimin e dëgjimit në gjuhën e huaj.

Së dyti, materialet i nënshtrohen një analize të hollësishme kritike diskursive, ku tiparet e larmishme gjuhësore e stilistikore që zbulohen e konkretizohen në kontekstin ligjërimor të personazheve në materialet virtuale, nxjerrin në pah aspekte të rëndësishme të natyrës së ligjërimit. Rezultatet e analizës vlejnë për të siguruar një bazë të shëndoshë të dhënash lidhur me vendin që zë përbërësi ndërkulturor gjatë kontekstit diskursiv të mësimdhënies së gjuhës së huaj në mjediset virtuale si dhe për rolin dhe vlefshmërinë e *website*-it në zhvillimin e dy kompetencavenë fjalë në MNGJH.

**Analiza e të dhënave**

**Drejtimi 1: Sa u përmbahet mësimdhënia virtuale përmes *website*-it parimeve universale për një dëgjim të suksesshëm?**

Literatura pedagogjike na lejon të reflektojmë mbi një sërë parimesh që udhëheqin dëgjimin e suksesshëm në gjuhën e huaj, njohja e të cilave do të na shërbente mjaft në shmangien e pengesave gjatë fitimit të kësaj shprehie në gjuhën e huaj (Celce – Murcia, 1995, p.365).

Le të analizojmë më hollësisht natyrën e materialeve të krijuara e të përshtatura në *website*-in e klasës sonë (www.netenglisholsa.org) për të parë nëse integrimi i këtij mjeti në praktikën dëgjimore u përmbahet ose jo parimeve në fjalë.

Rubrika e dëgjimit në *website* vjen si një risi në programin e këtij projekti duke iu adresuar drejtpërdrejt kompetencës dëgjimore. Përmbajtja e saj është konceptuar e tillë që t'i vijë realisht në ndihmë përshpejtimit të zhvillimit të shprehive të dëgjimit për studentët në nivelin e parë të përparuar (*low advanced – FCE)*. I konceptuar në një cikël 14-orësh dëgjimi të shtrira në rreth 10 javë, programi i dëgjimit sjell një mori materialesh autentike nga *website* prestigjoze të një standardi të lartë të pranuar e njohur botërisht (faqja e BBC dhe VOA), si dhe mjaft materiale dëgjimi nga një sërë *website*-sh mësimore autoritare përmes teksteve të larmishme të dëgjimit në formë e përmbajtje, që nga intervistat reale me artistë filmash në BBC, analizat dhe sintezat e lajmeve më të fundit nga bota, siç ishte hyrja e Kroacisë në BE, apo protestat antiqeveritare në Turqi, miratimi i ligjit pro abortit në Irlandë në raste të kufizuara apo të pathënat e njerëzve që kanë bërë epokë në historinë e njerëzimit (Intervista e Thatcher-it në ish-BS-në).

Materialet u pasuruan me diskutime të gjalla dëgjimore mbi çështje shoqërore e kulturore që prekin gjithsecilin prej nesh, siç ishte lajmi mbi operacionin e Angeline Jolie si masë parandaluese kundër kancerit të gjirit nga i cili kërcënohej, dëshmia e dhimbshme e Enrique Ramirez mbi analfabetizmin e tij dhe luftën e gjatë për ta mposhtur atë, apo filmi mbi sfidën e përditshme të fëmijëve autikë, të cilët kërkojnë më shumë mbështetje dhe shanse në shoqëri. Përmes dialogjeve spontane, ngjarjeve nga përvoja e njerëzve të zakonshëm që vijnë vazhdimisht përmes ekstrakteve të shkurtra nga *website-et* mësimore e, madje, edhe kumtesave akademike në trajtën e leksioneve me tematika të ndryshme (leksioni 1 – Antarktida; leksioni 2 - Dimensioni i lirisë)

kemi sjellë një mozaik përvojash interesante, komplekse dhe shpesh të panjohura. Tematika historike, shkencore, gjuhësore, politike, shoqërore e kulturore që ngacmojnë reagimin mbarëshoqëror bëhen të prekshme për studentët e këtij kursi, të cilët përjetojnë një realitet të gjallë e të paeksploruar më parë gjatë studimit *online*. Ky përshkrim i përmbajtjes së materialeve *online* shpreh qartë rëndësinë që u është kushtuar proceseve lart-poshtë, pra, thithjes së të dhënave të kontekstit, komponentit kulturor aq të domosdoshëm për lehtësimin e të nxënit të gjuhës. Proceset poshtë-lart, pra, ato që lidhen me komponentin gjuhësor, kanë zënë një vend po aq parësor përmes larmisë së detyrave me karakter gjuhësor (fonologjik, gramatikor e leksikor), siç do ta përshkruajmë më poshtë.

Tipologjia e larmishme në formë e strukturë e teksteve të dëgjimit, përbën një tjetër pikë të fortë të rubrikës së dëgjimit në fjalë, ku gërshetohen tekste me gjatësi të ndryshme që variojnë nga 2 minuta (dialogje spontane me tematikë të caktuar), në filma në trajtën e dokumentarit 10 – 15 minuta, në leksione e diskutime me karkater akademik rreth 45 minuta. Një tjetër element që bie në sy tek këto tekste është larmia e stileve, thekseve e regjistrave gjuhësorë, ashtu siç ndeshemi në jetën e përditshme, nga anglishtja britanike tek ajo amerikane, nga gjuha e përditshme tek ajo poetike, shkencore apo gazetareske; nga gjuha e fëmijës tek ajo e specialistit. Gama e gjerë aktualizohet edhe në llojin e materialit të ofruar për studim - audio, video, herë e shoqëruar e herë jo me transkriptim të pjesshëm, materiale dëgjimi me informacion paraprak të përmbledhur, shpesh edhe audio cilësore nga *website* mësimore me veprimtari paradëgjimore, dëgjimore e pasdëgjimore që i ofrohen të gatshme studentit, madje në përfundim të ushtrimit ata mund të vetëkorrigjohen në ballafaqim me përgjigjet e sakta, duke u hapur rrugë edhe formave të vetëvlerësimit.

Larmia e teksteve dëgjimore pasohet edhe nga një tipologji e gjerë detyrash e veprimtarish përmes të cilave synohet të zhvillohen tipat e ndryshëm të dëgjimit, si: për informacion specifik, për informacion global (idenë kryesore, tonin apo fokusin e përgjithshëm të një teksti) si dhe dëgjimi midis rreshtave (inferenca). Për konkretizim, disa nga llojet e veprimtarive të kryera më shpesh janë ato të tipit zgjedhje me alternativa, plotësim fjalish mungesore përmes përshkrimit, përkufizim termash në varësi të të dhënave në tekst, dhënie përgjigjesh të argumentuara ndaj pyetjeve të ngritura, e vërtetë/e gabuar, ushtrime fjalori, mbajtje shëni-mesh, detyra me karakter krijues (intervista), ripro-dhim fjalë për fjalë i një segmenti të caktuar të tekstit, realizim i përmbledhjes së një materiali, krahasim i perspektivave mes dy materialeve të ngjashme. Përmbushja e këtyre detyrave në fletë pune pasohet me veprimtaritë reflektuese – komente në faqe ose në forum (sipas kërkesës).

Nisma e ndërmarrë bëhet sfiduese edhe për arsye se krijimi i materialeve ka kërkuar një periudhë e gjatë hulumtimi në *website-t* autoritare që siguronin video dhe audio në përputhje me pritshmëritë e programit për këtë nivel formimi. Çdo material i zgjedhur është përpunuar e analizuar më tej duke pasur për udhërrëfyes metodik strategjitë e dëgjimit të konceptuara në disa hallka: veprimtari paradëgjimore, dëgjimore dhe pasdëgjimore, duke u kërkuar studentëve të marrin informacion paraprak të nevojshëm për të parashikuar atë që duhet të dëgjojnë (p.sh., të dhëna mbi jetën dhe veprimtarinë e Aung San Suu Kyi – lidere e opozitës në Birmani, e cila mban një leksion mbi lirinë, etj). Gjatë dëgjimit të

materialit studentëve u kërkohet të mbajnë shënime dhe t'u përgjigjen kërkesave të tipeve të ndryshme.

Ndërkaq, studentët monitorojnë në vazhdimësi punën e tyre duke ngritur pyetje e duke marrë sqarime përmes *e mail*-it. Për fazën pasdëgjimore nxënësve përgjithësisht u kërkohet të shprehen në forumin e grupit për të dhënë reflektimin e tyre lidhur me temën e porsadëgjuar.

Ky përshkrim i hollësishëm i natyrës së materialeve të krijuara në *website* dëshmon se konceptimi i tyre dhe realizimi i punës me to u përgjigjet parimeve për një dëgjim të suksesshëm. Sigurisht, në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërstudentor dhe pedagog-student duket se gjithçka ka funksionuar në dobi të një pune efektive akademike – mësimore në një mjedis nxitës e komod.

**Drejtimi 2: Analizë kritike diskursive e teksteve të dëgjimit në *website*. Diskutim i rezultateve.**

Krahas qëllimit për nxitjen e aftësisë dëgjimore në gjuhën e huaj, programi i praktikës dëgjimore *online* synoi zgjerimin e horizontit të studentëve në lidhje me vlerat perfaqësuese të kulturave të vendeve anglishtfolëse (por jo vetëm), të shfaqura përmes gjuhës angleze. Me zgjerim të horizontit nuk kuptojmë vetëm procesin e thjeshtë intelektiv të përvetësimit të informacionit të ri kulturor, por, për të përdorur dhe një herë metaforën e Kaikkonen–it, daljen nga 'guacka' e kulturës mëmë, pra, kultivimin e një përfytyrimi më të gjerë e të thellë mbi botën dhe vendin e secilit në të (Kaikkonen, 2001, p.64).

Për të vlerësuar arritjen e këtij qëllimi, le të ndalemi tek materialet dëgjimore të hedhura *online* dhe t'i shqyrtojmë ato si në formë, edhe në përmbajtje përmes një sërë treguesish të analizës kritike ligjërimore.

Së pari, burimet prej nga janë siguruar tekstet dëgjimore janë institucionale dhe me ndikim të gjerë global. Kështu, faqet e BBC-së dhe VOA-s gëzojnë prestigj të lartë anekënd botës, mes të tjerash, edhe për trajtimin e çështjeve delikate në përputhje me parimet bazë për të drejtat e njeriut dhe bashkëjetesën në paqe mes kulturave të ndryshme. Edhe *website-et* me karakter mësimor që kemi shfrytëzuar përgjatë projektit shquhen si autoritare, madje rankohen ndër më cilësoret për mësimin e gjuhës angleze. Prej burimeve në fjalë kemi vjelë një tipologji të larmishme tekstesh, si: intervista radiofonike me artistë filmash, raportime e analiza të lajmeve më të fundit nga bota, materiale filmike në formë ekstraktesh me karakter historik apo diskutime tematike mbi çështje me rëndësi shoqërore, kulturore, apo edhe mjekësore. Mes të tjerave, diskutimet e gjalla dhe debatet e nxehta, historitë nga jeta e vërtetë e njerëzve të zakonshëm që rrëfehen me synim didaktik në *website-et* mësimore apo trajtimet akademike të temave të ndryshme u kanë dhënë mundësinë studentëve shqiptare të ballafaqohen me një game të gjerë e të larmishme dukurish e çështjesh me interes të lartë kulturor.

Për më tepër, çështje e tema të tilla fitojnë një vlerë të shtuar për studentët pasi paraqiten përmes një mjedisi që, përveçse stimulon shqisat, lejon edhe kohën e nevojshme për mendim të thellë reflektues. Nëpërmjet optikës që mundëson mjedisi *online* studentët prekin nga afër pamje të gjalla të jetës prej vendeve anglishtfolëse, diçka krejt e ndryshme kjo nga të fiksuarit mekanik të fakteve dhe informacionit kulturor. Ata mësojnë t'i shohin gjërat prej pikëvështrimeve alternative të individëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore që flasin e veprojnë në materialet *online*. Përmes qasjes krahasuese studentët

zbulojnë të përbashkëtat dhe specifikat dalluese të përvojave të ndryshme që paraqiten në këto materiale. Për ilustrim mund të përmendim trajtimin e problematikës së analfabetizmit në videon *Enrique's Story*. Videoja përshkruan pengesat që has Enrique, një burrë që për shkaqe të ndryshme familjare e shoqërore nuk ka mësuar dot të shkruajë e të lexojë, për të përmbushur detyrat e tij si prind, dhe përpjekjet e tij të suksesshme, të ndihmuara nga një sistem i tërë edukativ-shoqëror, për të mundur (mes të tjerash) t'i lexojë të birit një përrallë për ta vënë në gjumë. Nëpërmjet kësaj videoje, studentët ndërgjegjësohen për pasojat individuale dhe shoqërore të analfabetizmit. Duke u njohur me mënyrën se si shoqëria amerikane i qaset një problematike të tillë, ata fillojnë ta shohin edhe problematikën e analfabetizmit në Shqipëri në një dritë më të qartë. Kështu, mes të tjerash, studentët përpiqen t'u japin përgjigje pyetjeve të tilla si: a do të ishte përvoja e *Enrique*-s e mundur në realitetin shqiptar?; a trajtohet analfabetizmi në Shqipëri me të njëjtat përpjekje të organizuara si në SHBA?

Së dyti, një aspekt i rëndësishëm i ligjërimit që del në pah prej analizës sonë është të trajtuarit e një çështjeje të caktuar prej pikëvështrimesh të ndryshme, tregues ky i pranisë dhe promovimit të shprehive, vlerave dhe qëndrimeve ndërkulturore në materialet *online* (Atay et al, 2009). Shpesh mendimet alternative që gjejnë shprehje në këto materiale vendosen në raporte polemizuese me njëri-tjetrin, siç është rasti i qëndrimeve pro e kundër miratimit të ligjit të ri mbi abortin në Irlandë[10]. Një mori qëndrimesh e pikëpamjesh paraqiten edhe në materialet me burim BBC-në dhe VOA-n rreth protestave në Turqi. Në këtë rast dallimet nuk vërehen vetëm brenda secilit material (mesazhet e ndryshme të protestuesve, përfaqësuesve të qeverisë turke, politikanëve nga vende të ndryshme të botës mbi demonstratat në Turqi), por, edhe mes vetë mënyrës që burime të ndryshme zgjedhin për ta paraqitur lajmin, pra, si të thuash, nëntekstit që rrjedh prej formës së tekstit dëgjimor. Të parit e gjërave nga një shumësi perspektivash që mishërojnë vlera e qëndrime të ndryshme i ndihmon studentët në zhvillimin e ndërgjegjes kritike mbi dukuritë me karakter kulturor.

Së treti, prania e përmasës ndërkulturore në tekstet dëgjimore shprehet në rrafshin ligjërimor edhe nëpërmjet përdorimit të shpeshtë të fjalëve dhe shprehjeve (emra të përgjithshëm, emra të perveçëm, etj.) me ngjyrim ndërkulturor pozitiv (përmes njësive leksikore në fjalë sugjerohen vlera të tilla ndërkulturore si të pranuarit e tjetrit pavarësisht racës, etnisë, etj.) dhe anasjelltas, përmes mungesës së klisheve fyese e përjashtuese. Shembujt e mëposhtëm, të organizuar sipas materialeve prej nga janë përzgjedhur, përbëjnë një ilustrim të zgjeruar të ndërlidhjes mes aspektit leksikor të teksteve dhe elementit ndërkulturor në to.

"My Autism and Me": *a different point of view, accepted, understanding, support, relate, socialize, unique, special,* etc.

"Liberty": *free(dom), reaching out other minds, human exchange, human contact, basic need, democracy, sharing thoughts, hope, a hungarian woman, future, human rights, individuals, citizens, liberty, harmony, no frontiers of space or time, Russian, English, Burmese, Tunisian, Middle East, respect, 'common to all races', dignity, similarities, dissimilarities, prejudice, oppression, women and men, universal human aspiration, nation, human communication, to engage.*

[10] Për më tepër shih në www.netenglisholsa.org:(*Listening Class 12: News report: Abortion Law Vote Polarizes Ireland*).

"Protests in Turkey": *peace, women's rights, listen, respect, citizens' rights, undermine their rights, democracy, 'people's voice will be heard*'.
*"*Abortion Law Vote Polarizes Ireland*"*: *woman, support, solidarity, woman power, ethnic, right to decide, "Woman Power Connect"* (emri i një shoqate indiane).

Emra të përveçëm vendesh: *the USA, Croatia, Dubrovnik, European Union, Yugoslavia, Serbia, Turkey, Istanbul, Paris, Ireland, India, Burma, Egypt, Tunisia, Syria, the Soviet Union, the Great Britain.*

Emra personazhesh protagonistë në tekstet dëgjimore: *Enrique Ramirez, Rosie, Ben, Lennie, Nadan Vidosevic, Recep Tayyip Erdogan, Zlatica Hoke, Jennifer Psaki (spokesperson of US Department of State), Ozan Kecili, Caroline Simons, Declan Meena, Mark Hennesy, Ranjana Kumari, Aung San Suu Kyi, Angeline Jolie, Margaret Thatcher, Boris Kaliegin,* etj.

E përbashkëta e gjithë këtyre personazheve që përfaqësojnë raca e etni të ndryshme, është se të gjithë, për t'i dhënë jehonë sa më të gjerë zërit të tyre, shprehen në gjuhën angleze, fakt domethënës ky mbi statusin e anglishtes sot në botë. Ballafaqimi i studentëve me këtë galeri të larmishme personazhesh (artistë të Hollywood-it, politikanë, shkencëtarë, njerëz te zakonshëm, përfaqësues të nënkulturave të ndryshme të marxhinalizuara, etj.) i shërben zgjerimit të horizontit të tyre kulturor përmes njohjes së gjallë dhe krahasimit kritik të pikëvështrimeve e mendimeve alternative dhe kultivimit të një ndjeshmërie më pak të ndikuar nga shabllonet paragjykuese, pra, më përafruese ndaj atij që është ndryshe.

Së katërti, një element tjetër ndërkulturor në tekstet dëgjimore *online* që e zbulojmë përmes analizës ligjërimore është prania e nënkuptimeve dhe presupozimeve (impliciti gjuhësor). Kështu, jo vetëm përdorimi i tropeve (metafora, epitete, krahasime, etj.), por edhe larmia e procedimeve të tjera me karakter stilistik e gjuhësor bëhet shprehje konkrete e vetëdijes për rëndësinë e gjuhës në përftimin e një imazhi sa më të drejtë e objektiv mbi kompleksitetin e realitetit të botës që na rrethon (si rregull qëndrimet jokritike dhe botëkuptimet e ngushta kanë prirjen të manifestohen përmes një gjuhe të drunjtë, të parafabrikuar me klishe të gatshme). Gjuha e teksteve, pra, vjen si një lloj pasqyrimi në nivel ligjërimor i shpirtit të tolerancës dhe qasjes reflektive që përcillet nga përmbajtja ideore e teksteve të dëgjimit. Nga ana tjetër, përdorimi i tropeve letrare dhe i gjuhës së nënkuptuar në përgjithësi, nuk errëson aspak qartësinë përmbajtësore të teksteve (shmangen metaforat e stisura e stërhollimet e panevojshme të stilit) si dhe nuk bie kurrë në ngjyrime fyese apo përkeqësuese.

Përmasa ndërkulturore e përdormit figurativ të gjuhës ilustrohet më poshtë nëpërmjet një shembulli nga teksti mbi pranimin e Kroacisë në Bashkimin Evropian.
*Nadan Vidosevic: "We'll jump into cold water and start swimming, you know, but we've decided to jump into water, because we believe it will be at the end something that will make pleasure to us. What is the meaning of pleasure? Welfare for the citizens of my country."*

Për kontrast, ekstrakti i mësipërm mund të krahasohet me intervistën e Margaret Thatcher-it dhënë televizionit sovjetik më 1987. Në këtë të fundit stili denoncues i drejtpërdrejtë dhe mënyra emfatike e të shprehurit përcjellin sfondin historik të Luftës së Ftohtë, të karakterizuar nga klima e armiqësisë dhe qëndrimet e ashpra.
*Margaret Thatcher: "You have more nuclear weapons in the Soviet Union than*

*any other country in the world! You started intermediate nuclear weapons, we didn't have any! You were the first to deploy intermediate missiles ...., etc".*

Në përgjithësi, mënyra se si personazhet e ndryshme i referohen njëri–tjetrit, apo se si i paraqitin mendimet e tyre tregon se shtrati botëkuptimor mbi të cilin ngrihet ligjërimi në tekstet tona është ai i respektit për dinjitetin e individit dhe pranimit të ndërsjellë mes njerëzve. Citimi i mëposhtëm na njeh me ndjenjat që ushqen Enrique ndaj udhëheqëses së tij në përpjekjet për të mposhtur analfabetizmin.

"*My tutor, I think, has a lot of patience... she doesn't get mad... I have a problem, she understands me...*",

Thëniet në vijim janë nxjerrë nga dokumentari i BBC-së mbi fëmijet autikë. Në fillim po citojmë dy përshkrime që shokët e klasës i bëjne djalit autik, një prej protagonistëve të dokumentarit.

*"Ben, I find a quite interesting person, quite entertaining..."*

*"He brings a different point of view..."*

Bie në sy qartazi qëndrimi njerëzor, empatizues dhe pranues që fëmijët e tjerë shprehin ndaj shokut të ndryshëm. Ndërkaq, Beni (djali autik), flet rreth vetes duke përdorur gjuhën e vetërespektit, e duke treguar, kësisoj, një shkallë të lartë ndërgjegjësimi rreth identitetit të tij të veçantë.

*"I am clearly OK: clever, occasionally funny and a bit mad..."*

Citimet e lartpërmendura dhe shumë shembuj të tjerë që mund t'i kishim vendosur krah tyre jo vetëm që pasqyrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë vlera e qëndrime me domethënie të madhe ndërkulturore, por shërbejnë edhe për të ilustruar funksionin didaktik të teksteve prej nga janë shkëputur. Nëpërmjet ballafaqimit të vazhdueshëm me një tipologji të tillë ligjërimore dhe, rrjedhimisht, me vlerat, qëndrimet e shprehitë që ajo përcjell, studentët nxiten në interesin e tyre intelektual për të njohur e eksploruar më shumë kulturat e identitetet e ndryshme njerëzore dhe, në një rrafsh më të thellë, çlirohen prej trashëgimisë, shpesh të pavetëdijshme, të perceptimeve e gjykimeve jokritike mbi tjetrin.

Së pesti, prania e strukturave veprore e pësore të ngarkuara nga ana stilistikore i shërben, po ashtu, promovimit të përbërësit ndërkulturor në ligjërimin *online*. Dihet se të shprehurit me anë të pësores, në përgjithësi, e zhvesh ligjërimin prej ngjyrimeve emocionale vetjake, pra, përfton një pikëpamje më pavetore e objektive mbi gjërat. Leksioni mbi lirinë, i mbajtur nga udhëheqësja e opozitës në Birmani, është mjaft i pasur në struktura pësore, çka i shkon më së miri karakterit të tij përsiatës (në leksion analizohet kuptimi dhe vlera praktike e lirisë si një e drejtë e patjetërsueshme e njeriut), që shmang shfryrjen e dufit vetjak apo sulmet *ad hominem* mbi kundërshtarët politikë të ligjërueses (udhëheqësja e opozitës birmaneze është arrestuar e burgosur disa herë për mbrojtjen e kauzës së lirisë politike e shoqërore në Birmani). Përdorimi i shpeshtë i pësores përgjatë leksionit e orienton vëmendjen kah thelbi i çështjeve e kah veprimet që duhen kryer në të ardhmen, duke mënjanuar, njëkohësisht, referencat ndaj emrave të përveçëm e akuzat me karakter personal mbi historinë e hidhur të së shkuarës. Leksioni flet me gjuhën e arsyes, por pa rënë në teorizime abstrakte. Në të kundërt, ideja e lirisë që del prej tij bëhet mjaft e prekshme për audiencën *online* nëpërmjet citimit të mjaft shembujve frymëzues nga jeta dhe vepra e "dëshmorëve të lirisë" prej periudhash të ndryshme historike e vendesh të ndryshme të botës. Mesazhi që përcillet, kësisoj, është ai i nevojës për të luftuar e punuar parreshtur në mënyrë që

ideali i lirisë të mos ngelet vetëm i tillë, por të aktualizohet në përvojën e gjallë të njerëzve.

Shembuj nga leksioni *Liberty* ("Liria"):

*"How many of them had been beaten up?..."*

*"This is how the battle of fear has to be fought...."*

*"A number of young rappers were emprisoned after the Revolution of Monks...."*

Së gjashti, tekstet *online* shmangin përdorimin me funksion kundërvënës të përemrave vetorë si "*us"* (ne) dhe "*them*" (ata). Edhe në ato raste kur përemra të tillë përdoren, kjo nuk i shërben përftimit artificial të ndonjë dikotomie absolute mes identitesh që e përjashtojnë njëri–tjetrin, por theksimit të asaj që e bën të veçantë një kulture apo grupim shoqëror të caktuar, pra, që i jep atij të drejtën të pranohet për çka është në vetvete pa iu nënshtruar standardit kulturor të një shoqërie të dhënë. Për të sjellë një shembull konkret, në filmin dokumentar mbi fëmijët autikë (*My autism and me*) përemrat *"us"* dhe *"them*" përdoren shpesh prej protagonistëve autikë te filmit jo për të ndërtuar përmes ligjërimit ndonjë kundërvënie identitare me të tjerët që nuk e kanë këtë problem, por si për të treguar se ata e pranojnë faktin që janë të ndryshëm, unikë, ndaj kërkojnë të njëjtën gjë edhe prej shoqërisë.

*"They (= normal people) don't mean to be mean, but it hurts my feelings because of my sensitivity… I think things will get much better when we (= the autistic) grow older…. It's worth getting to know us." (Rosie)*

**Përfundime**

Në këtë punim ndërmorëm një shqyrtim kërkimor - analitik të lidhjes mes përdorimit të *website*-it si mjedis e mjet për mësimdhënien e dëgjimit dhe zhvillimin e kompetencës ndër kulturore të studentëve.

Metodologjikisht çështja në fjalë u trajtua në punimin tonë si një çështje e hapur. Realizimi i një eksperimenti që na siguroi të dhënat e nevojshme empirike për të faktuar çdo argument e interpretim, nxorri në pah se, së pari, mësimdhënia virtuale përmes *website*-it u përmbahet rreptësisht standardeve pedagogjike për një dëgjim të suksesshëm si në drejtim të autenticitetit të materialeve, domosdoshmërisë për t'u mëshuar proceseve të ashtuquajtura nga lart-poshtë (*up-down*), ashtu edhe atyre nga poshtë-lart (*bottom-up*); ekspozimit të studentëve ndaj tipave të ndryshëm të dëgjimit dhe detyrave të shumëllojshme; marrjes në konsideratë të shkallës së vështirësisë së tekstit e deri tek njohja dhe përdorimi sistematik i strategjive të dëgjimit, duke i atribuar *website*-it tiparet unike të një katalizatori në zhvillimin e shprehive dëgjimore në gjuhën angleze.

Së dyti, përfundimi që rrjedh nga tërësia e analizës mbi tiparet ligjërimore të teksteve *online* është se ato i shërbejnë më së miri zhvillimit të njohurive, vlerave, qëndrimeve e shprehive ndërkulturore të studentëve. Për me tepër, një ndikim i tillë vjen jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë prej ideve që gjejnë shprehje në këto materiale, por, më tërthorazi, edhe prej vetë mjedisit që bën të mundur komunikimin e tyre tek studentët, me një fjalë, *website*-it. Kontekstualizimi i materialeve dëgjimore *online* brenda një kuadri shumë më të gjerë e domethënës se ai që ofron klasa tradicionale i nxit dhe u krijon mundësinë studentëve të shohin horizontin e gjerë kulturor përtej elementit gjuhësor të teksteve, pra, përbën edhe avantazhin e madh të mësimdhënies *online* në lidhje me promovimin e kompetencës ndërkulturore.

**Bibliografi e shfrytëzuar**


Atay, D., Kurt G., Çamlibel, Z., Ersin, P., & Kaslioglu, Ö.(2009). *The Role of Intercultural Competence in Foreign Language Teaching.* Inonu University Journal of the Faculty of Education, 10/3, 123-135.

Blake, R. J. (2008). *Brave New Digital Classroom – Technology and Foreign Language Learning*, Washington D.C., George Town University Press.

Brown, H. D. (2007). *Teaching by Principles: An Interactive Approach to Language Pedagogy*, San Francisco. Pearson Education ESL.

Byram, M. dhe Tost Planet, M. (2001). *Shoqëror identity and European dimension. Intercultural Competence through Foreign Language Learning*. Graz: Council of Europe.

Byram, M. (1997). Teaching and Assessing Intercultural Communicative Competence. Clevedon: Multilingual Matters.

Celce-Murcia, M. (1995). *Discourse Analysis and the Teaching of Listening*,përg. G. Cook dhe B. Seidlhoper, Principle and Practice in AppliedLinguistics, 363-378. Oxford: Oxford University Press.

Corbett, J. (2003). *An Intercultural Approach to English Language Teaching*. Clevedon: Multilingual Matters.

Council of Europe (2001). *Common European Framework of Reference for Langue :earning, Teaching, Assessment*. Cambridge: Cambridge University Press.

Gilman, R. A. dhe Moody, L. M. (1984). *What Practitioners Say about Listening: Research Implications for the Classroom*. Foreign Language Annals, 17, 331-334.

Larzén, E. (2005). *In Pursuit of an Intercultural Dimension in EFL-Teaching. Finland*: ABO Akademi University Press.

Pennington, M. (1995). *The Teacher Change Cycle.TESOL Quarterly*, vëll. 29/4, 705-731.

Rheingold, H. (1993). *The Virtual Community, Homesteading on the Electronic Frontier*. Cambridge:The MIT Press.

Richards, J. C. (1993). *Beyond the Text Book: The Role of Commercial Materials in Language Teaching*. RELC Journal, 24/1, 1-14.

Schulz, R. A. (2007). *The Challenge of Assessing Cultural Understanding in the Context of Foreign Language Instruction,* Foreign Language Annals, 40(1), 9-26.

Straffon, D. A. (2003). *Assessing the Intercultural Sensitivity of High School Students Attending an International School*. International Journal of Intercultural Relations, 27, 487–501.

Teeler D., Gray P. (2001). *How to Use the Internet in ELT*, Pearson Education Limited.

Turkle, Sh. (1996). *Life on the Screen. Identity in the Age of the Internet*, New York: Touchstone.

Van Dijk, T., A. (1993). *Principles of Critical Discourse Analysis*. Discourse & Society, 4/2, 249-283.

Warschauer, M. (1996). *Virtual Connections: Online Activities and Projects for Networking Language Learners, Honolulu*, HI: University of Hawaii Second Language Teaching and Curriculum Center.